



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

---

## DOKTORATË

---

**EMRI: ADMIR QOSE**  
**PROGRAMI I DOKTORATËS: SHKENCA POLITIKE**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE**

**TEZA**

**REALITETI I DYZUAR MEDIATIK NË MAQEDONI**  
**DHE NDIKIMI SOCIO-POLITIK I TIJ**

**MENTORI**

Prof. Dr. Ali PAJAZITI

**KANDIDATI:**

Admir QOSE

---

**REALITETI I DYZUAR MEDIATIK NË MAQEDONI  
DHE NDIKIMI SOCIO-POLITIK I TIJ**

---

## 1. PËRMBAJTJA

1. PËRMBAJTJA.....	2
LISTA E FIGURAVE .....	4
1. ABSTRAKTI.....	5
1.1 Abstract.....	6
1.2 Абстракт.....	7
2. HYRJE.....	8
2.1 Lënda e hulumtimit.....	8
2.2 Qëllimet e hulumtimit.....	10
2.3 Hipotezat.....	10
2.4 Metodologjia e studimit.....	11
2.5 Rëndësia e studimit.....	12
3. KAPITULLI I.....	14
3.1 Lindja e medias nga Galaksia e Gutenbergut deri në epokën e internetit.....	14
3.1.1 Zanafillat e lajmit, informimit dhe kulturës mediatike.....	15
3.1.1.1 Zhvillimi i medias nga shpikja e printimit.....	16
3.1.1.2 Kultura mediatike në epokat e hershme.....	27
3.1.2 Rritja e medias nga zhvillimet teknologjike.....	32
3.1.2.1 Media dhe zhvillimi i saj falë internetit.....	33
3.1.2.2 Rrjetet sociale dhe efekti në ngjarjet politike.....	36
3.1.3 Rritja e medias nga ngjarjet e mëdha historike.....	38
3.1.3.1 Media në Luftërat Botërore (Radioja dhe lindja e TV-së).....	38
3.1.3.2 Media pas 11 shtatorit 2001; zhvillimi agresiv post-demokraci.....	40
3.1.3.3 Media, në garën për ndikim politik të botës perëndimore.....	43
4. KAPITULLI II.....	44
4.1 Media në periudhën moniste dhe propaganda robëruese.....	44
4.1.1 Historia e komunikimit masiv të Maqedonisë së Veriut nga zanafilla.....	46
4.1.2 Zhvillimi i medias në ish vendet e njëmendësisë; BRSS, Jugosllavi, Shqipëri.....	50
4.1.2.1 Agit-Prop i Bashkimit Sovjet dhe “Pravda” e kultit stalinist.....	50
4.1.2.2 Agjitacioni dhe Propaganda në komunizmin enverist.....	53
4.1.2.3 Bashkim-Vëllazërimi në median titiste dhe kombësitë e RSFJ-së.....	58
4.1.3 Forma, struktura dhe raportimi (propaganda e mediave të robëruara).....	64
4.1.4 Dallimet dhe paralelizmat e medias me sistemet politike.....	73
5. KAPITULLI III.....	75
5.1 Media e Maqedonisë së Veriut në periudhën e re pluraliste.....	75
5.1.1 Media e re e Maqedonisë pas pavarësisë – “monopoli i padukshëm”.....	86
5.1.2 Gara për media përfaqësuese e komuniteteve të tjera.....	92
5.1.3 Media e Maqedonisë pas konfliktit të vitit 2001.....	100

5.1.3.1 Raste të raportimit etnik gjatë konfliktit .....	103
5.1.3.2 Raportimi i konfliktit të vitit 2001 nga fqinjët dhe bota .....	115
5.1.4 Pronësia, struktura dhe raportimi mediatic në ndryshimet politike .....	118
5.1.4.1 Zhvillimi negativ i ish mediave të pavarura të shtypura të WAC-it. ....	129
6. KAPITULLI IV .....	132
6.1. Rregullimi i fenomenit të raportimit të dyzuar mediatic .....	132
6.1.1 Liria e shprehjes / gjuha e urrejtjes në legjislaturën e Maqedonisë së Veriut.....	134
6.1.2 Raportimi i dyzuar dhe luftimi i këtij fenomeni .....	156
6.1.3 Aftësia e medias për rregullim/vetërregullim .....	161
6.1.3.1 Institucionet rregulluese dhe vetërregulluese të medias .....	162
6.1.3.2 Shansi i rregullimit të medias nën syrin vëzhgues të BE-së .....	167
6.1.3.3 Legjislacioni i BE-së për mediat tradicionale, mediat online dhe platformat.....	167
7. KAPITULLI V .....	170
7.1 Shpalosja e rezultateve të studimit; Diada e raportimit mediatic - Nxitja e tensioneve .....	171
7.1.1 Mediat, realiteti i dyzuar për ngjarje të njëjta .....	171
7.1.1.1 Ngjarjet në Kalanë e Shkupit! .....	173
7.1.1.2 Ngjarjet në Smillkovë .....	177
7.1.1.3 Karnavalet e Vevçanit.....	181
7.1.1.4 Vdekja e 4-vjeçarit Almir Aliu .....	184
7.1.1.5 Përplasjet mes ballistëve dhe vojvodëve.....	190
7.1.1.6 Forma të tjera të raportimit të dyzuar .....	193
7.1.2 Intervista me drejtues institucionesh dhe ekspertë të medias – gjetjet. ....	194
7.1.2.1 Raportimi i dyzuar dhe raportimi për tjetrin!.....	196
7.1.2.2 Sa përpjekje kanë bërë redaksitë që të jenë të kujdesshme për sa i përket raportimit për tjetrin? Sa e njohin gazetarët dhe redaktorët konceptin e gazetarisë që raporton objektivisht për tjetrin? .....	201
7.1.2.3 Në çfarë mase arrin që të sigurojë raportim të balancuar Kodi i Gazetarëve? .....	203
7.1.2.4 Sa hapësirë gjen raportimi për tjetrin në programet studimore universitare të gazetarisë dhe komunikimit? A duhet të shtohet niveli i njësive mësimore që trajtojnë këtë çështje?.....	205
7.1.2.5 Si mund të përmirësohet gjendja e raportimit për tjetrin në redaksitë tona? A mund të ndihmojnë trajnimet dhe seminarët e ndryshme? .....	207
8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME .....	209
8.1 Konkluzione.....	209
8.2 Rekomandime .....	218
9. BIBLIOGRAFIA .....	221

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Gurthemelet e komunikimit masiv të Maqedonisë së Veriut .....	50
Figura 2. Radiot lokale në kuadër të Radio-Shkupit.....	61
Figura 3. Niveli i shkrirjes së grupit sundues në shoqëri dhe tendenca e totalitarizmit .....	72
Figura 4. Televizionet e themeluara në pluralizëm në Maqedoninë e Veriut.....	89
Figura 5. Ndarja e shikueshmërisë te popullata shqiptare .....	98
Figura 6. Ndarja e shikueshmërisë te e gjithë popullata .....	99
Figura 7. Dallimet në raportim mes dy programeve të televizionit publik RTVM .....	115
Figura 8. Objektivat e Direktivës së Shërbimeve Mediatike Audiovizuale të BE-së.....	170

## 1. ABSTRAKTI

Rritja e ndikimit politik si dhe ajo e ndjenjës së patriotizmit viteve të fundit, veçanërisht gjatë periudhës së VMRO DPMNE-së në pushtet, ka bërë që mediat në Maqedoninë e Veriut, të shkruara dhe elektronike, të reflektojnë gjuhë të dyzuar në raportimin e ngjarjeve. Rastet më ekstreme të këtij dyzimi kanë nxitur shpeshherë edhe protesta, dhe për rrjedhojë, më shumë ndasi midis komunitetit shqiptar dhe atij maqedonas, jo vetëm nga aspekti etnik por edhe nga ai fetar.

Fenomeni i raportimit të dyzuar daton që nga themelimi i medias në Maqedoninë e Veriut, falë gjuhës që përdorte pushteti monist ndaj *popujve* të tjerë, veçanërisht atij shqiptar. Ky fenomen, i ndryshuar në tipare por jo në përmbajtje dhe subjekte, është i pranishëm ende edhe në Maqedoninë pluraliste të Veriut. Bazuar në stereotipa të bartur nga e kaluara, media vazhdon të gjejë forma të raportimit të dyzuar, duke *atakuar* ose duke u *viktimizuar*, duke *fshehur* detaje ose duke i *tjetërsuar* ato, apo duke *heshtur* në mënyrë totale për ngjarje të caktuara (këtë e bëjnë si mediat maqedonase ashtu edhe ato shqiptare, pavarësisht se ngjarjet kanë të bëjnë edhe me të drejtat themelore të qytetarit *etnik*).

Synimi i këtij studimi nuk është vetëm të konfirmojë ekzistencën e raportimit të dyzuar, por edhe rrezikun që ai paraqet gati 20 vjet pas konfliktit të vitit 2001.

Duke hedhur një vështrim që nga themelimi i medias, ai i medias së njëmendësisë totalitare, i para/pas-konfliktit të vitit 2001, si dhe përdorimi i medias për qëllime nacionaliste nga ana e politikës... por edhe duke sjellë raste konkrete nga ngjarjet që kanë tronditur marrëdhëniet ndëretnike në vend, dilet në përfundimin se *raportimi i dyzuar mediatik thellon ndarjet etnike e fetare dhe bëhet akoma më i rrezikshëm kur shoqëria, për shkak të politizimit, nuk i kontrollon dot format e saj të protestës*. Reagimet kanë lidhje të drejtpërdrejtë me ndjenjën patriotike të nxitur nga politika, si dhe me stereotipat e vjetër të ngulitur nga klasa politike e komunitetit shumicë, i cili imponon edhe superioritet ndaj komuniteteve më të vogla.

Pavarësisht se teoria e gazetarisë bashkëkohore nuk e njeh termin *raportim të dyzuar mediatik*, të gjithë në Maqedoninë e Veriu - drejtues të institucioneve rregullatore, vet-rregullatore, ekspertë të medias, politikanë, qytetarë etj. - e pranojnë fenomenin e tillë.

Edhe pse kemi të bëjmë me një studim mbi raportimin mediatik në përgjithësi, këto gjetje mund të paraqesin nxitje për studime akoma më të gjera mbi raportimin e dyzuar, raportimin për tjetrin (diversitetin), të përmbajturit të etikës gazetareske, rregullimin e medias, pavarësinë politike si dhe atë biznesore të saj. Ky studim mund të jetë shtysë për studime të tjera në të ardhmen edhe për nevojën e marrjes së masave më serioze dhe të menjëhershme për të trajtuar marrëdhëniet ndëretnike e ndërfitare në vend, për të punuar në shuarjen e stereotipave si dhe në përafrimin dhe unifikimin e qëndrimeve të qytetarëve për të bashkëjetuar në Maqedoninë e Veriut, shtet me karakter multi-etnik, multi-fetar dhe multi-kulturor, si dhe për t'u integruar bashkërisht në strukturat e BE-së.

Fjalët kyçe: *Raportimi i dyzuar mediatik, realitete të ndryshme për të njëjtën ngjarje, raportimi për diversitetet, pavarësia politike e medias, pavarësia biznesore e medias, Maqedonia e Veriut*

## 1.1 Abstract

Increasing political influence and a sense of patriotism in recent years, especially during the period of the ruling VMRO DPMNE, has made the print and electronic media in North Macedonia reflect *double-reality* in reporting events. The most extreme cases of this double-reality have often triggered protests, and consequently, more divisions between the Albanian and Macedonian communities, not only ethnically but also religiously. The phenomenon of double-reality reporting dates back to the establishment of the media in North Macedonia, due to the language used by the monist system over other *people*, especially the Albanian one. This phenomenon, changed in features but not in content and subjects, is still present in pluralistic North Macedonia. Based on stereotypes carried by the past, the media continues to find forms of double-reporting, by *attacking* or being *victimized*, *hiding* details or *alienating* them, or *silencing* them completely for certain events (this is done by both, Macedonian and Albanian media, although the events have to do with the fundamental rights of the *ethnic* citizen).

The purpose of this study is not only to confirm the existence of double-reality reporting, but also the risk it poses nearly 20 years after the 2001 conflict.

Looking at the media since its founding, the media of totalitarian mindset, that of pre/post-conflict of 2001, and the use of media for nationalist purposes by politics... but also bringing concrete cases from events that have shaken up interethnic relations in the country, it is concluded that *double-reality media reporting deepens ethnic and religious divisions and becomes even more dangerous when society, due to politicization, is unable to control its forms of protest*. The reactions have a direct bearing on the patriotic feeling fueled by politics, as well as on the old stereotypes embedded by the political class of the majority community, which imposes even superiority on smaller communities.

Although contemporary journalism theory does not recognize the term *double-reality media reporting*, everyone in North Macedonia – leaders of regulatory and/or self-regulatory institutions, media experts, politicians, citizens, etc. – recognize such a phenomenon.

Although we have to deal with a study on media reporting in general, these findings may provide an impetus for even broader studies on double-reality reporting, reporting on diversity, the content of journalistic ethics, media regulation as well as its political and business independence.

This study may be the impetus for further studies in the future as well as the need to take more serious and immediate measures to tackle interethnic and interreligious relations in the country, to work towards eliminating stereotypes, and to align and unify attitudes of citizens to co-exist in North Macedonia (a multiethnic, multi-religious and multicultural state), as well as to integrate into EU structures.

*Keywords: Double Media Reporting, Different Realities for the Same Event, Reporting on Diversity, Political Media Independence, Business Media Independence, North Macedonia*

## 1.2 Абстракт

Зголемувањето на политичкото влијание и чувството за патриотизам во последните години, особено во периодот на ВМРО-ДПМНЕ на власт, направи печатените и електронските медиуми во Северна Македонија да одразат двојствен јазик во известувањето за настаните. Најекстремните случаи на ова двојство честопати предизвикува протести и, следствено, повеќе поделби меѓу албанската и македонската заедница, не само од етнички, туку и од религиозен аспект.

Феноменот на двојствено известување датира од основањето на медиумите во Северна Македонија, благодарение на јазикот што го користеше монистичката власт кон другите *националности*, особено кон албанскиот. Овој феномен, сменет во карактеристиките, но не и во содржината и темите, сè уште е присутен и во плуралистичка Северна Македонија. Врз основа на стереотипите пренесени од минатото, медиумите продолжуваат да наоѓаат форми на двојствено известување, *напаѓајќи* или *жртвувајќи*, *криејќи* детали или со нивно *преиначување*, или со целосно *замолчување* за одредени настани (ова го прават како македонските така и албанските медиуми, независно од тоа што настаните се однесуваат на основните права на *етничкиот* граѓанин).

Целта на оваа студија не е само да се потврди постоењето на двојствено известување, туку и ризикот што го претставува скоро 20 години по конфликтот во 2001 година.

Гледајќи ги медиумите од нивното основање, медиумите на тоталитарното едноумие, од пред/пост-конфликтот 2001 година, и употребата на медиумите за националистички цели од страна на политиката ... но, исто така, носејќи и конкретни случаи од настани кои ги разликува меѓуетничките односи во земјата, се заклучува дека *двојственото медиумско известување ги продлабочува етничките и верските поделби и станува уште поопасно кога општеството, заради политизација, не е во состојба да ги контролира своите форми на протест*. Реакциите имаат директна врска врз патриотското чувство поттикнато од политиката, како и со старите стереотипи вградени во политичката класа на мнозинската заедница, што наметнува дури и супериорност врз помалите заедници.

Независно што современата теорија за новинарство не го признава терминот *двојствено медиумско известување*, сите во Северна Македонија - раководители на регулаторни институции, саморегулаторни институции, експерти за медиуми, политичари, граѓани, итн. - го прифаќаат тој феномен.

И покрај тоа што ова е студија за известување за медиумите во целина, овие наоди можат да дадат поттик за уште пошироки студии за двојствено известување, известување за другиот (разновидност), задржување на новинарската етика, регулацијата на медиумите, политичката независност како и нивниот бизнис. Оваа студија може да биде поттик за понатамошни студии во иднина, како и потребата да се преземат посериозни и непосредни мерки за решавање на меѓуетничките и меѓурелигиските односи во земјата, да се работи на елиминирање на стереотипите, и за усогласување и унифицирање на ставовите на граѓаните да соживеат во Северна Македонија, држава со мултиетнички, мултирелигиозен и мултикултурен карактер, како и да се интегрираат заеднички во структурите на ЕУ.

Клучни зборови: *Двојствено медиумско известување, различни реалности за еден ист настан, известување за различност, медиумска политичка независност, медиумска бизнис-независност, Северна Македонија*

## 2. HYRJE

Maqedonia e Veriut ka një popullatë pak më shumë se 2 milion banorë,<sup>1</sup> sipas regjistrimit të vitit 2002, si dhe 158 operatorë mediatikë, sipas të dhënave nga Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale.<sup>2</sup> Shumëkush e cilëson Maqedoninë e Veriut sa një lagje e ndonjë shteti të zhvilluar, por për nga media, shteti ynë të lë përshtypjen se ka një numër më të madh mediash se edhe shtetet më të zhvilluara në botë.

Maqedonia e Veriut, për nga historia e saj e brishtë që nga ndarja e Ish Jugosllavisë, tranzicioni i gjatë, konflikti etnik i vitit 2001 si dhe rropatjet dhjetëra vjeçare për në aleancën e NATO-s dhe BE, ndoshta është shteti me median më të rrezikuar... këtë e thonë vlerësimet e organizatave të huaja, por edhe gjendja faktike e saj.

Media ka qenë shumë herë pjesëmarrëse aktive në trazirat që ka kaluar vendi, ka qenë vegël e politikës jo vetëm për shkak të politikave superiore që partitë maqedonase kanë treguar ndaj komunitetit shqiptar, por edhe për shkak të ndikimit biznesor të medias, e cila, për të mbijetuar është lehtësisht e kapshme nga sferat e ndikimit (politik, biznesor, grupe interesi etj.)

Dhe këtë, media e ka bërë falë raportimit të dyzuar, një term që kemi vendosur ta shqyrtojmë jashtë kornizës adekuate të terminologjisë së gazetarisë bashkëkohore. Paraqitja e dy realiteteve të ndryshme, për të njëjtën ngjarje ose fenomen, si dhe tjetërsimi ose fshehja e detajeve nga raportime të caktuar, kanë krijuar perceptime dhe botëkuptime të ndryshme në shoqërinë multi-etnike, multi-fetare dhe multi-kulturore të Maqedonisë, dhe në vend që të kontribuonin drejt githëpërfshirjes, kanë kontribuar në fakt drejt krizave të thella ndëretnike dhe duke nxitur stereotipa në shoqëri.

Duke u nisur nga të gjitha këto sa u thanë më sipër, vendosëm të merrnim një studim të tillë për të vërtetuar këtë raportim të dyzuar, tjetërsimin e detajeve, mungesën e objektivitetit, lidhjen e raportimit të syzuar me aspektin socio-politik të komuniteteve që jetojnë në Maqedoninë e Veriut, si dhe për të hetuar lidhjet e politikës dhe biznesit me median.

Duke pasur parasysh edhe kornizën ligjore, institucionet rregullatore, vet-rregullatore dhe reagimin kthyes që vjen nga shoqëria, përpiqemi të vendosim përballë faktet, gjendjen reale, aspiratat si dhe nevojën për të pasur një media përfshirëse, të raportojë për tjetrin, si dhe të nxit bashkëjetesën dhe mirëqenien e të gjithë komuniteteve njësoj.

### 2.1 Lënda e hulumtimit

Shpikja e printimit është po aq e rëndësishme sa edhe shpikja e rrotës për njerëzimin. Shtypja për herë të parë e librave nxiti revolucionin e qarkullimit më të shpejtë të informacionit. Rrugëtimi që nga viti 1453, me shpikjen e Johannes Gutenberg, e deri më sot, ka përjetuar një shpërthim zhvillimi. Lajmi sot udhëton përmes antenave satelitore, dhe viteve të fundit, vetëm përmes një klikimi në internet, në të gjithë botën, në kohë reale.

Zhvillimi i medias, i këtij qarkullimi kaq të shpejtë informacioni, i rritjes së kësaj industrie dhe pushteti, nuk është zhvilluar njësoj nëpër botë. Ai varet shumë nga zhvillimi teknologjik,

<sup>1</sup> Zyra e Statistikave Shtetërore, *Regjistrimi i popullsisë, amvisërive dhe banesave në Republikën e Maqedonisë 2002*, faqja 20, [01.04.2019], <[http://www.stat.gov.mk/pdf/kniga\\_13.pdf](http://www.stat.gov.mk/pdf/kniga_13.pdf)>

<sup>2</sup> Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe AudioVizuale, [30.03.2019], <<http://avmu.mk/>>



globalizimi e po ashtu nga pushtetet politike të vendeve respektive. Si një vend ish monist, Maqedonia e Veriut e përjetoi këtë bum mediatik pas pavarësisë duke shënuar ngritje me demokratizimin e vendit (deri në 250 operatorë mediatike). Për shkak të strukturës multi-etnike dhe pushtetit të ndërtuar asi, në vend të profesionalizimit media pësoi ndryshje; për shkak të varësisë së financimit (shtetëror), varësisë biznesore të saj, presionit politik dhe ndikimit të rrymave apo ndjenjave që manifestojnë komunitetet respektive.

Kështu, kur aspiratat shkojnë në kahe të kundërta, as era e zhvillimit nuk shkon njësoj. Gjatë raportimeve të ndryshme mediatike, sidomos kur vendi ka përjetuar ngjarje të mëdha në historinë e tij politike dhe shoqërore, media shpeshherë është sjellë e dyzuar në qëndrime duke krijuar pakënaqësi, nxitje, ftohje marrëdhëniesh mes komuniteteve e kështu me radhë. Siç tregohet edhe nga titulli “*Realiteti i dyzuar mediatik në Maqedoni dhe ndikimi socio-politik i tij*”, ky studim ka për qëllim nxjerrjen në pah të problemeve me të cilat përballen sot mediat në Maqedoninë e Veriut; varësinë e tyre politike, financiare, sociale, etnocentrizmin kulturor etj., si dhe të hedhë dritë sadopak mbi to për të kontribuar drejt afrimit të qëndrimit të mediave, drejt raportimit objektiv, atij përfshirës dhe drejt një klime më të mirë bashkëjetese. Media është pushtet i katërt, dhe misioni i saj është që të jetë e pavarur dhe objektive! Edhe pse një gjë e tillë për shumëkënd në Maqedoninë e Veriut mund të duket e paarrtshme, e pakta që mund të bëjë media është që në rastet kur vihen në pikëpyetje të drejtat dhe liritë e qytetarit, të mbajë anën e tij dhe jo të bëhet vegël e politikës.

Në kapitullin e parë të këtij studimi hidhet një vështrim retrospektiv i medias, që nga krijimi i saj, përhapja nëpër botë falë globalizimit, zgjerimi bashkërisht me zhvillimet e mëdha teknologjike por edhe ato politike e shoqërore. Rrugëtimi i medias përfshin revolucionin teknik, sinjalin satelitor, internetin, por edhe ngjarjet e mëdha historike si luftërat, sulmet e 11 shtatorit 2001, konfliktet nëpër botë etj.

Në kapitullin e dytë të këtij studimi, fokusi vihet te mediat në ish vendet e njëmendësisë moniste. Një analizë krahasimore sjell ngjashmëritë e medias së pasluftës së Dytë Botërore, në BRSS, Shqipëri e Maqedoninë e Veriut. Media ishte veçse një vegël ideologjike në shërbim të Komiteteve për Propagandë, si dhe organ vis a vis i partive komuniste/socialiste. Përveç thirrjeve për të bashkuar forcat për të ngritur vendet e pasluftës, në raportimet e asokohe bëhej edhe propagandë e huaj, kundër të ashtuquajturave *vende kapitaliste*.

Kapitulli i tretë i përkushtohet kryekëput medias së re “pluraliste”, vrullit nacionalist që nxitu luftërat e shpërbërjes së Ish-Jugosllavisë, raportimit etnik gjatë kësaj periudhe e veçanërisht gjatë konfliktit të vitit 2001, si dhe përpjekjeve dhe ndërjegjësimit të medias pas marrëveshjes së Ohrit. Në këtë periudhë pas-konflikti, media tentonte të linte prapa stereotipat dhe të synonte “objektivitetin”.

Kapitulli i katërt heq linjën e hollë mes lirisë së shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes. Për herë të parë i përfaqësoi zyrtarisht fenomenin të raportimit të dyzuar, atij të sjelljes së dy realiteteve të ndryshme për të njëjtën ndodhi, ndërkohë që hidhet dritë mbi rregullimin, vet-rregullimin, si dhe shansin e mbikëqyrjes së kornizës ligjore vendore nga BE-ja si institucion supranacional.

Në kapitullin e pestë sjellim rastet empirike të diadës së raportimit mediatik dhe efektit socio-politik në shoqëri – nxitjen e tensioneve ndëretnike. Në shqyrtim merren ngjarjet në Kalanë e Shkupit, Ngjarjet në Smillkovë, Karnavalet e Vevçanit, Vdekja e 4-vjeçarit Almir Aliu si dhe Thirrjet e Tifozëve të “Shkëndijës”. Po ashtu, në këtë kapitull ofrohen edhe intervistat me krerët e institucioneve rregullatore/vet-rregullatore dhe ekspertë të medias, lidhur me fenomenin e raportimit të dyzuar dhe mënyrat e kapërcimit të tij.

Më tej, studimi shpalos sugjerimet për zhdukjen e raportimit të dyzuar si dhe ofron rekomandime drejt kalimit në raportimin gjithëpërfshirës, për një klimë më të mirë bashkëjetese, siç dikton edhe tradita shumë-etnike, shumë-fetare dhe shumë-kulturore e Maqedonisë së Veriut.

## 2.2 Qëllimet e hulumtimit

Studimi me titullin “*Realiteti i dyzuar mediatik në Maqedoni dhe ndikimi socio-politik i tij*” është një ndër të paktët studime lidhur me raportimin e dyzuar në Maqedoninë e Veriut, pas vendosjes së pluralizmit politik. Studimi ofron detaje jo vetëm të aspektit kronologjik të zhvillimit të medias, por edhe të frymimit të sotëm të saj, në një kohë që vendi është pjesë e aleancës së NATO-s dhe në prag të datës për çeljen e negociatave me BE-në.

Me një demokratizim deficitar, veçanërisht gjatë qeverisjes së gjatë të VMRO DPME-së, Maqedonia e Veriut e pati ngushtuar shumë shtratin në të cilin rrugëtonte media. Forcimi i pushtetit, politizimi gjithnjë e më shumë i shoqërisë, diferencimi etnik sidomos pas rritjes së ndjenjës patriotike me projektin e antikitetit “Shkupi 2014” etj., tregoi përçarjen e mediave, politizimin e tyre, ndarjen gjithashtu në vija etnike, si dhe anashkalimin e qytetarit dhe të drejtave të tij, që teorikisht duhet të jenë natyrore-të barabarta pavarësisht etnisë që i takon.

Kështu, qëllim primar i studimit tonë nuk është vetëm hetimi i raportimit të dyfishtë dhe arsyeve që e nxitin atë, por të kërkojë gjithashtu një rrugëdalje nga kjo situatë. Prej vitesh, në raportet e progresit të KE-së apo ato mbi lirinë e medias, Maqedonia e Veriut merr nota të ulëta dhe kritika të shumta nga aspekti politik, rregullues, raportues, menaxhues etj.

Një tjetër qëllim është që përmes studimit, të hidhet dritë mbi gjendjen dhe nivelin e ndërgjegjësimit të aktorëve të përmendur: medias, politikës, bizneseve që drejtojnë mediat si dhe shoqërisë civile e cila është kapluar nga kriza e ndërgjegjes dhe e propagandës politike.

Bazuar në faktet historike të së kaluarës, bazuar në tendencat aktuale, bazuar te të dhënat tona empirike e deri te intervistat me ekspertët e fushës, synohet të sqarohet ngërçi mediatik dhe kahu që duhet të marrë media në të ardhmen.

Raportimi i medias luan një rol kyç në ndërtimin e mentalitetit të shoqërisë, kështu që tendenca e vazhdueshme e përçarjes mediatike për shkaqe politike, etnike, financiare etj., nuk i shkon për shtati të ardhmes së vendit tonë multi-etnik e multi-kulturor.

## 2.3 Hipotezat

Ky studim nuk do të përbënte vlerë akademike nëse në të nuk do të ndërtoheshin hipotezat e mirëfillta për vërtetim. Përveç hipotezës bazë që ky studim përpiket të sqarojë, përgjigje gjejnë edhe disa hipoteza të tjera dytësore.

Hipoteza kryesore

*Mediat në Maqedoni krijojnë realitete të ndryshme nga raportimi për ngjarje të njëjta!*

Përmes kësaj hipoteze hidhet dritë mbi format e raportimit të mediave (mungesa e burimeve, tjetërsimi i fakteve etj.) si dhe ai i paraqitjes së realiteteve të ndryshme pavarësisht se bëhet fjalë për të njëjtën ngjarje. Ky dyzim është shkaku kryesor që qytetarët e komuniteteve të ndryshme

krijojnë perceptime të ndryshme mbi të njëjtën ngjarje apo fenomen, e për rrjedhojë botëkuptime të ndryshme që çojnë në përplasje qëndrimesh.

Hipoteza ndihmëse

*Politizimi i medias ndikon thekshëm në politizimin e dimensioneve të tjera të shoqërisë, dhe anasjelltas!*

Kjo hipotezë vërteton lidhjen mes raportimit mediatic dhe perceptimit qytetar, përmes politizimit dhe *etnizimit* të dy faktorëve të përmendur. Reaksioni zinxhir është sa nxitës aq edhe përçues (i ndërsjellë) dhe tregon se, si media ashtu edhe qytetarët e kanë humbur ndërgjegjen në momente të caktuara, për shkak të ndikimit të madh politik. Në këtë trekëndësh, rol më të madh luan politika e cila në vend që të promovojë inkluzivitet (jo montime rastesh), e përdor si median ashtu edhe qytetarin për qëllime të caktuara të saj.

*Raportimi mediatic i njëanshëm dhe prodhimi i realiteteve paralele krijojnë tendosje dhe forma të tjera irritimi mes etnive në vend!*

Kjo hipotezë nxjerr në pah pasojat sociale e politike të fenomenit të raportimit të dyzuar si dhe shkallën e përjetimit të tyre. Shumë raste, sikurse ato në studim, janë shoqëruar me akte dhune, ofendime e lëndime të rënda mes komuniteteve. Në përgjigjet e kësaj hipoteze, ngrihen dilema të tjera pasuese, se kur duhet të hesht media ose politika në mënyrë që qytetarët të mos bien në grackat e një konflikti të ri!

*Në sferën e medias nevojitet vet-rregullim, si mekanizëm për avancimin e cilësisë së informimit.*

Kjo hipotezë vërteton krizën brenda vetë medias si dhe apatinë ku ajo gjendet në Maqedoninë e Veriut. Hipoteza të çon në shqyrtimin e rregullativës ligjore, organeve rregulluese dhe vet-rregulluese në fushën e medias, si dhe hedh dritë mbi gjasat reale të shpëtimit të medias nga kthetrat e politikës!

## 2.4 Metodologjia e studimit

Për vërtetimin e këtij studimi, metodologjia e ndjekur më shpesh është ajo cilësore.

Që në kapitullin e parë, ku hidhet një vështrim historik mbi revolucionin mediatic në botë e deri më sot, studimi bazohet mbi një analizë veprash shkencore, dokumentesh të rëndësishme që vërtetojnë rrugëtimin e medias ndër epoka. Përmes metodës përshkruese, asaj historike dhe dokumentimit, si dhe metodës krahasuese, hidhet dritë mbi evoluimin si dhe shumëllojshmërinë e rrymave mediatiche, të ndikuara nga zhvillimi ekonomik, teknologjia, nga politika, nga ngjarjet e mëdha historike si dhe përpykjet e medias që raportimi të jetë objektiv dhe përfshirës për të gjithë njerëzit.

Këto metoda ndiqen edhe në kapitujt pasardhës ku flitet për zhvillimin mediatic, së pari të vendeve ish socialiste BRSS, Shqipëri e Jugosllavi. Përtej linjës kronologjike ofrohet edhe analizi dhe krahasimi i zhvillimit të medias si dhe toni i saj, në periudhat e vrazhda të

propagandës moniste. Po ashtu, përmes metodës historike dhe dokumentimit si dhe metodës krahasuese hidhet dritë mbi tranzicionin e medias në Maqedoninë e Veriut përgjatë periudhës pluraliste dhe rrugëtimin e saj pas konfliktit të vitit 2001.

Metodë tjetër e përdorur në këtë punim është edhe ajo e transkriptimit të raportimeve (lajmeve), qëmtuar nga gazetat e periudhës moniste, ato të para dhe pas konfliktit, si dhe raportime të rasteve konkrete kur Maqedonia e Veriut është lëkundur në marrëdhëniet e saj ndëretnike (pas vitit 2010). Nga transkriptimi janë nxjerrë në pah elementet cilësore të raportimit, toni, gjuha si dhe interpretimi i ngjarjeve.

Metoda cilësore e intervistave përdoret gjithashtu në këtë studim, ku aktorë kryesorë të institucioneve rregullatore, vet-rregullatore dhe ekspertë/aktivistë të shoqërisë civile rrahin mendimet se si media mund të përmirësohet... në fakt, të pavarësohet nga politika dhe biznesi, si dhe të përmbushë misionin e saj: atë të raportimit objektiv, tolerant, dhe në frymën inkluzive për të gjitha komunitetet dhe për të promovuar diversitetin.

## 2.5 Rëndësia e studimit

Rëndësia e këtij studimi është shumë dimensionale. Së pari, studimi argumenton se *mediat në Maqedoni nuk raportojnë në mënyrë objektive, e aq më pak në mënyrë inkluzive dhe për tjetrin (për diversitetin).*

Përfitimi i realiteteve të ndryshme nga raportimi i dyzuar bëhet akoma më i rrezikshëm për nga pasojat, kur bëhet fjalë për ngjarje me rëndësi në jetën sociale të qytetarëve, për shkak se shoqëria në Maqedoni është multi-etnike dhe raportimet nxitëse, me tone të caktuara etj., për rrjedhojë nxisin tensione, urrejtje, përplasje dhe përçarje në popullatë. Një fenomen i tillë bën që interesat e komuniteteve që jetojnë në Maqedoni të mos jenë në linjë të njëjtë me interesin e përbashkët si shtet, duke shkuar në krah të kundërt me bashkëjetesën që promovohet (në mënyrë deklarative).

Punimi argumenton faktin se si *media është e mbërthyer nga ndikimi politik dhe ai biznesor.* Mungesa e pavarësisë dhe lidhja kryekëput me pushtetin i bën mediat vegla të politikës, ndërkohë që kur bëhet fjalë për interesat politike dhe etnike të klasës në pushtet, qytetari është i parëndësishëm. Dyzimi i tillë i nxit më shumë pakënaqësitë, emocionet si dhe përçarjet mes etnive, edhe pse të gjitha komunitetet duhet të jetojnë në mënyrë të barabartë dhe të gëzojnë të drejta të barabarta. Në rastin konkret, komuniteti shqiptar prej një kohe të gjatë ndihej i përbuzur (sikurse edhe gjatë epokës së njëmendësisë së monizmit) për shkak se nuk mund të përmbushte një sërë të drejtash të tij. Në studim tregohet se media është e pafuqishme t'i bëjë ballë ndikimit politik. Duke qenë se bizneset që drejtojnë mediat varen shumë nga pushteti, lidhja zinxhir me pushtetin forcohet më shumë. Televizionet pengohen nga një sërë rregullativash siç janë ato për reklamim, të drejtat autoriale, detyrimet ndaj muzikës së transmetuar, përqindjes nga të ardhurat vjetore që i paguhen Agjencisë së Filmit etj.

Studimi shërben gjithashtu edhe si një sinjal paralajmërimi se *demokracia është në rrezik.* Media, e vetme, është e paaftë të ndërtojë një sistem të pavarur vet-rregullues, veçanërisht për aq kohë sa ndërgjegjësimi shoqëror dhe ai politik nuk përmirësohet.

Ndërkaq, rëndësia më e madhe e gjithë këtij studimi, si një prurje ndërdisiplinore, është *nevoja e njohjes nga afër e vetë gazetarëve, pronarëve të medias, e pushtetarëve por edhe e lexuesit me median, raportimin, raportimin objektiv, raportimin inkluziv, lirinë e shprehjes, pavarësinë biznesore si dhe me mungesën e demokracisë në vend.*



### 3. KAPITULLI I

#### 3.1 Lindja e medias nga Galaksia e Gutenbergut deri në epokën e internetit

*Mediumi, media ose masmedia*, siç thirret shpeshherë ndryshe, është një nga spektrat e komunikimit të gjerë që njihet sot në shkencat sociale. Emërtimi i tillë, në rast të shqipërimit nënkupton *mjetin/et teknologjik/e* (media-ndërmjetëset)<sup>3</sup> me të cilat komunikohet me masën e gjerë (mass), pra, të komunikuarit ose të ndarit të mendimit me një audiencë më të gjerë, popullatën e një qyteti, shteti apo mbarë botën. Sipas fjalorit terminologjik të Oksfordit, *media* është shumësi i *mediumit*, edhe pse në aspektin bisedor në jetën e përditshme, koncepti i *medias* nënkupton jo vetëm *operatorët mediatikë*, nëse është media transmetuese e informacionit në mënyrë elektronike, pra radio, televizion, media digjitale etj., por edhe *ndikimin në opinion-bërje* me kulturën mediatike që ajo bart me vete (pra, përfshin spektrin e gjerë të operatorëve, shtrirjen e ndarjes së informimit, si dhe atë të bërjes së opinionit dhe ndërtimit të një kulture dhe mentaliteti në shoqëri).

Komunikimi që bart *media*, në themel të saj është në korrelacion të pandashëm me 2 elemente të ngërthyera, *grumbullimin dhe përpunimin e informacionit* si dhe *ndarjen e tij për opinionin e caktuar*, ose grupet shënjestër të cilave iu adresohet. *Masmedia*, po aq sa nënkupton një horizont të gjerë, në gjuhën e përditshme të njerëzve shpeshherë kanalizohet në ditët e sotme vetëm në aspektin e *mjetit të ndarjes së informacionit* - konkretisht përmes radios, televizionit, gazetave; dekadave të fundit edhe gazetave elektronike (ueb-faqet me karakter informimi të krijuara me lindjen e internetit).

Por, ky zinxhir mjetesh komunikimi që përmendim sot, bashkë me botëkuptimin që kemi ndërtuar, është vetëm një pjesë e asaj që përbën median. Shpeshherë, duket se media ka lindur kohët e fundit, dhe konotacioni për të, sot perceptohet ndryshe.

Në fakt, media ka lindur me njeriun, bashkë me fjalën e folur, dhe pavarësisht mungesës së mjeteve të sofistikuara siç ekzistojnë sot, ajo (media) ka një zanafillë tepër të hershme.

Historia e komunikimeve masive paraqet në të njëjtën kohë edhe historinë e shoqërisë, për vetë faktin se mediat dhe teknologjitë e komunikimit formësojnë të kuptuarit tonë dhe jetën tonë. Me evoluimin e njerëzve, evoluon edhe shoqëria. Që nga fillimet e racës njerëzore, komunikimi varej nga mënyra e transmetimit të informacionit, ndërsa vetë informacioni varej nga zëri i njeriut, ose nga fakti se sa kohë është dashur me këmbë, me kalë apo me anije, që të transmetohej deri te subjekti tjetër i synuar. Zhvillimi i teknologjisë së komunikimit e ndihmoi gjithë këtë synim.<sup>4</sup>

Brezi i shekullit XX-XXI ndoshta nuk e mban mend tellallin, njeriun e angazhuar nga autoriteti lokal, i cili thërriste rrugëve dhe pazareve për të informuar mbi rregullat që vendoste prefekti apo njerëz të caktuar që donin të ndanin sihariqet e tyre.

Kështu, media ka ecur nëpër shumë gurthemele e epoka, është rritur, forcuar, ka ndryshuar formë... një gjë është e qartë - ajo është pjesë jashtëzakonisht e rëndësishme e jetës për shkak të informimit dhe pasurimit të jetës së njeriut me informacion, por edhe atë të bërjes së

<sup>3</sup> Konsulto fjalorin enciklopedik të Oksfordit në <<https://en.oxforddictionaries.com/definition/media>>, [9.2.2019]

<sup>4</sup> Dona Kolar Panova, *Историја на масовните комуникации (Historia e komunikimit masiv)*, Ligjërata të autorizuara, Shkup 2007, faqja 6

opinionit, ndikimit në shoqëri... Ndërsa, parë si institucion, ajo është një nga hallkat më të rëndësishme të raportimit objektiv dhe si *pushtet i katërt* (siç thirret ndryshe) shërben si instrument i fuqishëm i monitorimit të pushteteve të tjera në sistemin shtetëror, të politikave të hartuara prej tyre, të vendimeve të marra nga ato, etj.

Në aspektin historik, gurthemelet e medias janë *e folura*, biseda, fjala e lindur me njeriun, janë *pllakat e baltës* me mbishkrime në kohën e lashtë, papiruset, pikturat, librat, muzika... Duke ecur bashkë me teknologjinë, nga korrierët postarë, informacioni i shekullit XXI tani fluturon aq shpejt sa të mjafton vetëm një *klikim*.

Sot, përveç portaleve (platformave që përfshijnë shumë media të së njëjtës kompani shpërndarëse) dhe mediave on-line, rrjetet sociale janë bërë ura më e shpejtë e teçimit të lajmit nga ofruesi (media) te përdoruesi ose klienti (qytetari)...

Pikërisht lindjes dhe rrugëtimit të medias, mjeteve të saj në zhvillim, rolin dhe ndikimin që mediat kanë në jetën tonë të përditshme, do t'i referohemi në këtë kapitull.

### 3.1.1 Zanafillat e lajmit, informimit dhe kulturës mediatike

Lajmi, informimi dhe kultura mediatike i kanë zanafillat që para erës sonë. Pavarësisht se komunikimi lindi me fjalën, me gjestet e njeriut, diku 35000 vjet para erës sonë... nëse marrim parasysh vetëm zinxhirin e zhvillimit të kulturës mediatike (gjithnjë parë nga aspekti i zhvillimit teknologjik që sillte edhe ndryshimet sociale në shoqëri), atëherë hallka e parë e zanafillës së komunikimit dhe përcimit të mesazhit shënohet zyrtarisht diku 22000 vjet më parë, me *pikturat* e lëna nga paraardhësit tanë parahistorikë, të gjetura nëpër shpella në epokën tonë të re.

Këto dy elementë, *gjuha* dhe *pikturat* janë lënë jashtë etapave zyrtare të zhvillimit të komunikimit sipas ecurisë së saj krahe për krahe me teknologjinë. Për Everett M. Rogers, etapat e zhvillimit të komunikimit janë *katër* dhe numërimi konkret nisi me *pllakat prej argjile* ose balte të bëra nga sumerët.<sup>5</sup> Periudha e përdorimit të këtyre pllakave mendohet se daton në vitet 4000 para erës sonë, midis periudhës së bronzit dhe asaj të hekurit.<sup>6</sup> Në vitin 3100 para erës sonë, edhe egjiptianët farkëtuan *hieroglifët* duke bërë që pllakat prej balte dhe argjile të pjekura në zjarr, të shndërroheshin gradualisht në mjetin tjetër të komunikimit - papiruset e stampuara ose të shkruara me penë prej kallami.

Si pllakat prej balte të pjekura ashtu edhe papiruset e koleksionuara, sipas gjetjeve në kërkimet arkeologjike të mëvonshme në Lindjen e Mesme, teçonin nëpër breza përrallat, esetë, proverbat, poezitë, ligjet, kulturën botanike (bimë dhe kafshë të vizatuara) etj.

Rreth 2000 vjet më parë, libraritë në Aleksandri, Egjipt dhe shumë qytete të tjera greke e romake koleksionuan dorëshkrime papirusi.<sup>7</sup> Kishte lindur alfabeti i parë... I pari ishte shkrimi linear (në vitet 1800 p.e.s.), pastaj alfabeti i parë i njohur (në Palestinë në vitet 1600 p.e.s.), shkrimi ideografik kinez (në vitet 1450 p.e.s.), alfabeti fenikas (në vitet 1000 p.e.s.) dhe alfabeti fonetik (në Greqi në vitet 730 p.e.s.)

<sup>5</sup> Everett M. Rogers, *Communication technology, The new media in Society (Teknologjia e komunikimit, Media e re në shoqëri)*, Free Press, 1986, faqja 25

<sup>6</sup> Akademia Khan, *The Sumerians and Mesopotamia (Sumerët dhe Mesopotamia)*, <<https://www.khanacademy.org/humanities/ancient-art-civilizations/ancient-near-east1/sumerian/a/the-sumerians-and-mesopotamia>>, [9.2.2019]

<sup>7</sup> Hugh F. C line, *Information Communication Technology and Social Transformation: A Social and Historical Perspective (Teknologjia e komunikimit të informacionit: Një perspektivë sociale dhe historike)*, Routledge New York – London 2014, faqja 107

Por, arritja më e madhe e shkrimit dhe shpërndarjes në masë të mesazhit, kulturës, ritualeve etj., i atribuohet Pi Sheng-ut në vitin 1041 (të erës sonë) i cili shpiku një lloj shtypshkrimi me shkronja të lëvizshme.<sup>8</sup> Kjo arritje njihet si një nga katër shpikjet më të mëdha kineze dhe shkronjat ishin të bëra prej porcelani. Ato shtypeshin në pllaka prej dylli, rrëshire pishe, balte, dërrasë etj., pas vendosjes së shkronjave së prapthi në një shabllon. Pastaj, shablloni bëhej dublikatë disa herë duke shumëfishuar prodhimin e pllakave. Sipas disa të dhënave, në 10 orë punë, artizani Pi Sheng prodhonte deri në 8000 pllaka të shtypura.

Ky revolucion u pasua në Kore, 200 vjet më vonë. Kjo epokë e artë zyrtarizoi për herë të parë Jikji<sup>9</sup> -n, një koleksion mësimesh në gjuhën koreane. Jikji ishte një libër i printuar me pllaka metali.<sup>10</sup>

Pas 200 vitesh të tjera kjo shpikje u realizua në Gjermani nga Gutenbergu. Shpikja e tij ishte akoma më e sofistikuar. Edhe pse shtypja e asaj kohe nuk bën shumë dallim me shtypjen e sotme si filozofi pune, ajo përbënte suksesin e parë të kohës për printim masiv dhe kishte makineri adekuate për printim, me bojë. Tani, boja mund të hidhej mbi letër, mbi rrobë e kudo tjetër, duke e bërë kështu printimin e presuar të shpërndahej në mënyrë globale. Edhe Johannes Gutenberg ishte artizan, arpunues. Me numrin e madh të faqeve që mund të printoheshin brenda një dite, Gutenbergu hapi kapitullin e Rilindjes (Renesancës) në Evropë nga shekulli XIV deri në atë XVII.

### 3.1.1.1 Zhvillimi i medias nga shpikja e printimit

Ashtu sikurse u theksua më sipër, pikënisja e komunikimit ishte gjuha; komunikimi jo verbal *me gjeste* e deri te ai *verbal*, i folur. Pavarësisht se komunikimi verbal ishte revolucion i madh, me trasimin e fjalëve dhe tingujve për të shprehur nevojat ose rreziqet që i kanoseshin njeriut parahistorik, komunikimi joverbal me shenja bartet si formë komunikimi edhe nga njeriu i sotëm - por shumë herë më pak nga gjestet apo lëvizja e trupit e përdorur 40000 vjet më parë.

Një nga studiuesit më të zellshëm të komunikimit, Frederick Williams, në një botim të vitit 1982, ndërtoi një qark interesant të ecurisë së zhvillimit të komunikimit në një cikël 24 orësh. Me të drejtë ai thoshte se pa komunikimin nuk ka shpikje, dhe pa shpikjet nuk do të kishim komunikimin e sotëm. Edhe vetë njeriu është në një garë me veten për t'iu përshtatur ambientit që kemi krijuar nga shpikjet teknologjike. Nuk ka rëndësi ku jetojmë, përveç nevojës së drejtpërdrejtë fizike e cila gjithashtu nuk mund të përmbushet pa qasje në rrjetet e komunikimit<sup>11</sup> (pra, edhe atje ku duhet të jemi, nuk mund të shkojmë pa mjetet ose rrjetet e komunikimit). Me këto dilema të shpërthimit (explosion) të komunikimit, sipas Williams, njeriu është në një kurbë të përshpejtimit social të vetvetes.<sup>12</sup>

Zhvillimi i mjeteve të komunikimit llogaritet në një ditë 24-orëshe, me pikënisje në orën 00:00. Para 36 000 vjetësh, në këtë moment, sipas një pretendimi të imagjinuar (nga autori Williams) paraqitet homo-sapiens (njeriu) dhe bashkë me të edhe gjuha si

<sup>8</sup> Joseph Needham, Tsien Tsuen-Hsuei, *Science and Civilization in China (Shkenca dhe civilizimi në Kinë)*, Cambridge University Press, 1885, faqja 201

<sup>9</sup> “Jikji” ose “Zen Jikji” janë mësimet Zen, (shpirtërore) dhe nënkuptojnë Dokumentin e parë Budist në Kore, dhe titulli i tij mund të përkthehet si “*Antologjia e Priftërinjve të Mëdhenj Budistë*”.

<sup>10</sup> The Korea Times, Kim Jong-myung, *Jikji: An Invaluable Text of Buddhism (Jikji: Një tekst i paçmueshëm i budizmit)*, <[https://www.koreatimes.co.kr/www/culture/2018/08/293\\_63447.html](https://www.koreatimes.co.kr/www/culture/2018/08/293_63447.html)>, [10.2.2019]

<sup>11</sup> Frederick Williams, *The communications revolution*, Sage Publication 1982, Nju Jork, faqja 18

<sup>12</sup> Po aty, faqja 35



mjet komunikimi. Në orën 3:00 pas mesnate nuk ka ndonjë përparim; në orën 6:00 nuk ka asnjë ndryshim; në orën 8:00 të mëngjesit ndodh revolucioni i parë i komunikimit – gjendet një gravurë shpelle... Në orën 12:00 asgjë e re - shpella pikturohet! Në orën 18:00, e njëjta pamje – në shpella pikturohet... Në orën 20:00 sumerët zbulojnë letrën (rreth 4000 vjet para erës sonë). Në orën 20:40 krijohen hieroglifet në Egjipt, në orën 21:28 krijohet alfabeti, në 22:06 lind poeti i madh Homeri, veprat e të cilit ishin të parat që u ruajtën në letër... mes orës 22:38 dhe 23:01 është koha e mbretërisë romake. Në orën 23:38 në Majnc përgatitet revolucioni i radhës i komunikimit - shtypet Bibla e Gutenbergut. Që atëherë, gjetjet vijojnë me dinamikë shumë më të shpejtë. Në orën 23:53 shpiket makina e shtypit me avull, në 23:53:24 shpiket telegrafi, në 23:55:02 krijohet telefoni. Vijon shpërthimi i telekomunikimit; në orën 23:57:04 krijohet filmi me zë, në 23:58:02 testohet televizori me ngjyra, 2 minuta para vitit 2000 fillon numërimi... për 104 sekonda lëshohet sateliti i parë Sputnik; për 92 sekonda lëshohet në përdorim sateliti i parë komercial; për 78 sekonda marrin jetë kamerat e lëvizshme televizive... për 49 sekonda bëhet viti 1980 ku telekomunikimi bashkohet me kompjuterët – erdhi epoka e kompjuterizimit.<sup>13</sup>

Pra, *gjuha* ishte ajo që e ndihmoi njeriun parahistorik të përparonte drejt qytetërimit.<sup>14</sup> Falë saj koordinohet më mirë kapja e gjahut, përpunimi i veglave të punës etj. Ky progres zgjerohej nga brezi në brez, dhe vetëm falë gjuhës, të folurës së trashëguar, trashëgohej edhe historia, dija, kultura, besimi e kështu me radhë.

Por, revolucioni i dytë pas gjuhës ishte *shkrimi* (arti i simbolizimit të tingujve dhe të folurës së sapolindur). Kjo përbën edhe nivelin e dytë të historisë së komunikimit, quajtur ndryshe “komunikimi nëpërmjet shtypit të shkruar”.<sup>15</sup> Kultura e bazuar pikërisht te teknologjia e alfabetit e redukton në pamje edhe vetë gjuhën e folur.<sup>16</sup> Shkrimi evoluoi gjithashtu me kalimin e kohës. Forma e parë e shfaqur e tij ishte *shkrimi simbolik*, mjete me të cilin njerëzit shfaqnin ose shprehnin fenomene të caktuara. Nga format e thjeshta të shprehjes së diellit, detit, rrufeve, zogut, peshkut, grurit etj., me vizatime në pllaka (3500 vjet më parë në Sumeri), shkrimi u përsos deri në alfabet. Grupi i germave të krijuara u përdor për të simbolizuar secilin prej tingujve që formonin fjalët.<sup>17</sup>

Edhe sipas fjalorëve të ndryshëm botërorë, *alfabeti është një grup germash* ose karakteresh të tjera, me të cilat gjuha ose gjuhët (e ndryshme) shkruhen, veçanërisht nëse vendosen në një radhitje të zakonshme.<sup>18</sup> *Alfa* dhe *Beta* që përbëjnë fjalën *alfabet* kanë qenë kudo të njëjta si në latinisht, greqisht, anglisht etj. I pari alfabet u krijua nga fenikasit, edhe pse disa autorë thonë se sumerët ishin ata që veçse i kishin imponuar shoqërisë së asaj kohe një grup *karakteresh koneiforma* (coneiform) - *simbole rrokjesore* gati 2000 vjet më herët.<sup>19</sup> Fenikasit, të njohur si tregtarë që çanin detet e Mesdheut, jo vetëm që përhapën alfabetin e tyre por nxitën

<sup>13</sup> Dona Kolar Panova, *Историја на масовните комуникации (Historia e komunikimit masiv)*, Ligjërata të autorizuar, Shkup 2007, faqja 10-11

<sup>14</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET Press 2010, faqja 101

<sup>15</sup> Leksione të autorizuar, *Kultura e Medimeve*, faqja 16

<sup>16</sup> Marshall McLuhan, *Instrumentat e komunikimit (Media si një zgjatim i njeriut)*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2008, faqja 179

<sup>17</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET Press 2010, faqja 102

<sup>18</sup> Konsulto fjalorin enciklopedik të Merriam Webster në <<https://www.merriam-webster.com/dictionary/alphabet>>, [11.2.2019]

<sup>19</sup> Ligjërata kursi mbi “Historinë e Alfabeteve” nga Prof. Robert Fradkin i Universitetit të Merilendit <<http://terpconnect.umd.edu/~rfradkin/alphapage.html>>, [11.2.2019]

edhe grekët që ta përmirësonin këtë alfabet<sup>20</sup> duke krijuar alfabetin e parë fonetik me 24 germa. Ka një numër të vogël por të mjaftueshëm shkrimesh në pllaka balte që vërtetojnë alfabetin e parë grek. Ky zhvillim dhe sukses u kurorëzua me Poemën Epike të Homerit, “Kënga e Ilionit” siç quhet ndryshe, në shekullin XVII të para erës sonë. E shkruar në heksametër daktilik, ajo rrëfen përplasjet mes luftëtarit Akil dhe mbretit Agamemnon gjatë rrethimit 10-vjeçar të Trojës.

Alfabeti grek u modifikua nga romakët dhe u bë me 26 germa. Megjithatë, do të duheshin 18 shekuj të tjerë që shkrimi i alfabetit të ngërthehej nga zhvillimi teknologjik dhe ideor. Sipas McLuhan, “shpikja e alfabetit, sikurse shpikja e rrotës, ishte... reduktim i bashkëveprimit kompleks të hapësirave në një hapësirë të vetme. Alfabeti fonetik reduktoi përdorimin e të gjitha shqisave përnjëherësh, falë të folurës, duke bërë që komunikimi vizual të humbte peshën”.<sup>21</sup> Nga ana tjetër, shpikja e alfabetit përbënte “zbulimin e metodës së zbulimit”. Një metodë e re u fut në jetë. Për të kuptuar epokën e re, njerëzimi tani duhej të përqendrohej në vetë metodën, element i së cilës ishte qëllimi se si të vendosej një urë që do të lidhte boshllëkun e deri asaj kohe mes ideve shkencore dhe produktit final.<sup>22</sup> Por, arritja e kësaj ure mori dhjetëra shekuj.

Sipas kronologjisë së komunikimit njerëzor nga Rogers<sup>23</sup>, faza e tretë e komunikimit u shfaq rreth vitit 1450 me shtypshkronjat dhe shkronjat e lëvizshme. Gjermania u bë zanafilla evropiane e shtypshkronjës, falë shpikjes së Gutenbergut, duke hapur kështu edhe epokën e printimit në komunikim. Ndoshta, jo i gatshëm për të përdorur letër sikurse kinezët të cilët e kishin shpikur tashmë, apo si egjiptianët të cilët kishin vënë në përdorim papiruset (nga një bimë që rritej brigjeve të Nilit)<sup>24</sup>, Gutenbergu shtypi për herë të parë Biblën në vitin 1453. Logjikisht, shumë kohë përpara se Gutenbergu të shpikte shtypshkrimin me shkronja të lëvizshme tipografike, falë ksilografisë (shtypshkrimi me blloqe teksti) ishte shtypur edhe *Biblia Pauperum* ose “Bibla e të varfërve”.<sup>25</sup>

Por, Bibla e Gutenbergut e cila filloi së shkruari në 1453, doli në qarkullim si kopje e parë më 22 tetor të vitit 1454.<sup>26</sup> Tirazhi ishte 180 bibla, ndërsa numri i librave që mbijetojnë ende sot e kësaj dite nëpër muzetë e botës është diku 49 (pjesë të tyre). Megjithatë, Bibla e Gutenbergut mendohet të jetë mes librave më të vlefshëm.<sup>27</sup> Ajo ka 1286 faqe të lidhura në 2

<sup>20</sup> Jasper Griffin, *Homer: The Odyssey*, Second Edition, Cambridge, 2004, faqja 22

<sup>21</sup> Marshal McLuhan, *The Gutenberg Galaxy, The making of typographic man*, University of Toronto Press, 1962, faqja 45

<sup>22</sup> Alfred North Whitehead, *Science and the Modern World*, The Free Press, New York, 1967, faqja 96, <<https://books.google.mk/books?id=L6kZPLbCrScC&printsec=frontcover&dq=science+and+the+modern+world+whitehead+pdf&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwiSwdVPwKLFahVMICwKHT08BUoQ6wEIKjAA#v=onepage&q=inv%20of%20the%20method&f=false>>, [12.2.2019]

<sup>23</sup> Everett M. Rogers, *Communication technology, The new media in Society (Teknologjia e komunikimit, Media e re në shoqëri)*, Free Press, 1986, faqja 25,

<[https://books.google.mk/books?id=9uFT080FcRkC&pg=PA23&source=gbs\\_toc\\_r&cad=4#v=onepage&q&f=false](https://books.google.mk/books?id=9uFT080FcRkC&pg=PA23&source=gbs_toc_r&cad=4#v=onepage&q&f=false)>, [12.2.2019]

<sup>24</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET Press 2010, faqja 103

<sup>25</sup> Marshall McLuhan, *Instrumentat e komunikimit (Media si një zgjatim i njeriut)*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2008, faqja 179

<sup>26</sup> Wagner, Bettina; Reed, Marcia, *Early Printed Books as Material Objects: Proceedings of the Conference Organized by the IFLA Rare Books and Manuscripts Section Munich*, 19-21 August 2009, faqja 11

<sup>27</sup> Sipas të dhënave, kopja e fundit e kompletuar e Biblës së Gutenbergut u shit në 1978 për 2.2 milion dollarë. Kjo kopje është tani në Shtutgard. Megjithatë, çmimi i një kopje sot vlerësohet diku mes 25 - 35 milion dollarëve. <<https://www.elitetraveler.com/shopping-lifestyle/most-expensive-books/5>>, [13.2.2019]

vëllime<sup>28</sup> ndërsa shkrimi i saj nuk ishte identik<sup>29</sup> por varionte me *gjerësi fonti* nga 36 deri 42. Shumica e biblave, diku 135 prej tyre, ishin të bëra me letër, por pjesa tjetër u bënë edhe prej *lëkure*. Pësia e tyre ishte e madhe, saqë besohet se për një bibël prej lëkure mund të jenë përdorur diku 175 lëkura kafshësh.<sup>30</sup> Stili i shtypjes së këtij libri ishte me tekstura, pra formate të gatshme shkrimi të presuara mbi letër (lëkurë).

Zbulimi i Gutenbergut dhe metoda e tij e shtypshkrimit u përhap me shpejtësi në Evropë. Me tipografinë e tij, parimi i shkronjave të lëvizshme tregoi se si mund të mekanizohej çdo lloj pune me anë të segmentimit dhe fragmentimit të një veprimi të plotë.<sup>31</sup> Pas 30 vjetësh nga botimi i Gutenbergut, shtypshkronjat u mbollën në më shumë se 110 qytete të Evropës.<sup>32</sup> Në vitin 1472, në Verona të Italisë nisi botimi i revistave të para sikurse “*De re militari*” i Valturios me gravura që shpjegonin makineritë e luftës.<sup>33</sup> Në Francë ndërkohë, në 1470 u shtyp libri i parë “*Epistolae*” nga gjuhëtari i latinishtes Gasparinus de Bergamo. Me dinamikën e përhapjes së shtypshkronjave, shkëmbimit të librave (falë përkthimit në gjuhë të tjera), shtypjes së hartave<sup>34</sup> si një shembull i veçantë komunikimi të informacionit përmes imazheve etj., Evropës iu hap rruga e nacionalizmit, e ndryshimit të fesë, e shpikjeve të reja pasuese, zgjerimit të dijeve dhe ngritjes së nivelit të arsimit. Ishte e qartë se shtypshkronja përbënte tashmë një nga momentet historike të teorisë së mëvonshme të *determinizmit teknologjik - besimin se teknologjia në një shoqëri udhëheq ndryshimin historik*, pra zhvillimin e strukturës sociale dhe vlerave kulturore të shoqërisë.<sup>35</sup>

Sipas Dona Kolar-Panova, nëse konsiderohet se një botim i ka të paktën 500 kopje, kjo do të thoshte se në vitin 1500 mund të numëroje një volum prej 13 milion librash të shtypur në Evropën e asaj periudhe e cila atëherë kishte një popullsi prej 100 milion njerëzish. Më së shumti, sipas përllogaritjeve, u shtypën në Venecia (diku 2 milion kopje), ndërkohë që Parisi (qendra e dytë për botime) numëronte 181 shtypshkronja.

Për dallim nga zhvillimi i shpejtë i shtypit në këto vende, në Rusinë e krishterë dhe me alfabet cirilik, shtypi erdhi shumë vonë. Makina e parë e shtypit në Moskë u soll në vitin 1564 nga një bjellorus por ajo u shkatërrua. Realisht, shtypi në Rusi u paraqit në shekullin XVII (1711) në Shën Petersburg, falë mbretit Petari i Madh. Qendrat e tjera të shtypit u formuan në Akademinë Detare në 1721 dhe në Akademinë e Shkencave në 1727, që të dyja në Moskë.

Në botën myslimane rezistenca ndaj shtypit ishte akoma më e madhe dhe konsiderohet se vendet myslimane kanë qenë pengesë për bartjen dhe shpërndarjen e makinave të shtypit nga Kina drejt perëndimit. Shtypja e librave ishte konsideruar si

<sup>28</sup> Detajet janë nxjerrë nga faqja AMAZON e cila ka vënë në shitje njërën prej kopjeve të biblave.

<<https://www.amazon.com/Gutenberg-Bible-Verlag-Facsimile-Reproduction/dp/1946239011>>, [13.2.2019]

<sup>29</sup> Torbjørn Eng, *InDesign, the hz-program and Gutenberg's secret*,

<[http://www.typografi.org/justering/gut\\_hz/gutenberg\\_hz\\_english.html](http://www.typografi.org/justering/gut_hz/gutenberg_hz_english.html)>, [13.2.2019]

<sup>30</sup> CNA, *7 gjërat që nuk i dini për Biblën Gutenberg*, <https://www.cna.al/2015/02/24/7-gjerat-nuk-i-dini-per-biblen-gutenberg/>

<sup>31</sup> Marshall McLuhan, *Instrumentat e komunikimit (Media si një zgjatim i njeriut)*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2008, faqja 180

<sup>32</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET Press 2010, faqja 106

<sup>33</sup> Marshall McLuhan, *Instrumentat e komunikimit (Media si një zgjatim i njeriut)*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2008, faqja 180

<sup>34</sup> Asa Briggs, Peter Burke, *A Social History of the Media, From Gutenberg to the Internet*, Polity Press 2002, faqja 39

<sup>35</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET Press 2010, faqja 109

mëkat dhe heretizëm. Kështu që, sulltan Selimi në vitin 1515 me dekret e shpalli shtypjen e librave vepër të dënueshme me vdekje. Por, në fund të shekullit XVI, sulltan Murati III lejoi shitjen e librave botërorë, të shtypura në arabisht dhe të botuara me siguri në Itali.

Historia e gjatë dhe e vështirë e shtypit në Perandorinë Osmane tregon se sa rezistencë e madhe ekzistonte ndaj këtij lloji komunikimi si dhe ndaj paraqitjes vizuale. Shtëpia e parë botuese turke u hap në shekullin XVII (1796), 150 vite pas shtëpisë së parë botuese armene. Kjo shtëpi botuese turke shtypi vetëm një numër të vogël librash dhe u mbyll shumë shpejt. Gazeta e parë zyrtare në mbretërinë osmane nuk u shtyp deri në vitin 1831, ndërsa gazeta e parë në gjuhën turke u shtyp në vitin 1840, dhe madje ishte iniciuar nga një anglez.<sup>36</sup>

Nuk ekziston konsensus mes historianëve të mediave masive, rreth fakteve se ku dhe kur u paraqit zyrtarisht gazeta e parë. Disa historianë pohojnë se gazeta e parë u paraqit në Gjermani në vitin 1609 ndërsa të tjerët konsiderojnë se gazeta e parë në fakt u shtyp në Këln në 1594. Edhe Holanda e Zvicra pohojnë se gazetat e para u paraqitën në vendet e tyre.

Mesi i shekullit XVII përbënte kohën e pamfleteve, buletineve dhe gazetave. Ka të dhëna se një bibliotekar në Angli, mes viteve 1640-1663 ka arritur të grumbullojë rreth 15 mijë pamflete dhe më shumë se 7 mijë gazeta të cilat sot e kësaj dite ndodhen në bibliotekën kombëtare britanike. Bumi i materialeve të shtypura sollti me vete edhe përplasjen e parë për lirinë e shtypit, kështu që në Suedi, në vitin 1766 u miratua ligji i parë për lirinë e shtypit, ndërsa pak më vonë edhe në SHBA, me amendamentin e parë të Kushtetutës u garantua liria e shtypit. Është interesante të theksohet se gjatë revolucionit francez, në Paris u botuan 350 gazeta të ndryshme, ndërsa në periudhat e mëvonshme, pas revolucionit, në Paris u shtypën vetëm 4 gazeta. Shtypi komercial në rritje përfshiu në vetvete jo vetëm lajme nga politika, jeta e përditshme, tregtia etj., por edhe një sasi gjithnjë e më të madhe të reklamave. Ndërsa fjala angleze “*advertisement*” (përkth. reklama), u shfaq në gjysmën e dytë të shekullit XVII.

Nga Koha e Gutenbergut, deri në fillimin e revolucionit industrial shtypi nuk ka ndryshuar shumë. Pas vitit 1800, falë zbulimeve të teknologjive të reja, revolucioni industrial mundësoi prodhim masiv të materialeve të shtypura dhe zvogëloi në mënyrë të ndjeshme çmimet e librave dhe gazetave. Kjo çoi në ndryshim të shoqërisë. Edukimi dhe arsimimi bazik u bënë të dëshiruara nga të gjitha klasat shoqërore dhe si rezultat i kësaj, në Angli në vitin 1870 u miratua ligji i parë për arsimim të detyrueshëm. Në dekadat e para të shekullit XIX, më të përhapurat kanë qenë dy lloje gazetash, ato komerciale që informonin më së shumti për tregtinë, dhe ato politike ose partiake që promovonin pikëpamjet partiake dhe pikëpamjet e kandidatëve partiakë.

Për shkak të çmimit të tyre relativisht të lartë, gazetat mbërrinin vetëm te shtresa të caktuara të shoqërisë. Kjo zgjati deri në vitin 1833 kur në Amerikë u paraqitën gazeta të lira, në mënyrë popullore, të quajtura “*penny press*”, sepse kushtonin vetëm 1 *penny* (1 qindarkë – 1/100 e dollarit). Tani edhe njerëzit e thjeshtë e të zakonshëm mund të blinin gazeta. Mes viteve 1830-1840, numri i gazetave të botuara në Amerikë u dyfishua, ndërsa numri i gazetave të shitura u katërfishua.<sup>37</sup>

Gurthemeli i radhës në komunikimin masiv të njerëzimit ishte *fotografia*. Pas stampimit ose shtypjes së vizatimeve, diapazoni i njeriut u zgjerua edhe me kapjen e imazhit real. Ishin Nicéphor Niepce dhe Louis Daguerre ata që zbuluan aparatën e parë fotografik. Edhe pse *fotografi* mund të quhej edhe teknika e shtypjes së gravurave (ajo e Gutenbergut, për shkak se librat stampoheshin me *presim* falë radhitjes së germave) tani, francezët Niepce dhe Daguerre arritën të krijonin fotografinë që i rezistonte dritës. Me një *kamerë obskure* (me dhomë të errët) dhe falë procesit kimik, më në fund fotografia e parë që i rezistoi dritës u shënuar në vitin 1822.

<sup>36</sup> Dona Kolar Panova, *История на масовните комуникации (Historia e komunikimit masiv)*, Ligjërata të autorizuar, Shkup 2007, faqja 10-11

<sup>37</sup> Po aty, faqet 34-36

Zanafilla e përpjekjeve për krijimin e fotografisë së parë daton që në shekullin XV para erës sonë, kur një dijetar i asaj kohe në Kinë me emrin Mo Ti<sup>38</sup> tentoi studimin e rrezeve të diellit dhe kalimin e imazhit përmes vrimës në një dhomë të errët. Megjithatë, krijimi i kamerës obskure erdhi shekuj më vonë kur një dijetar italian, Daniello Barbaro, përdori lentën ose thjerrëzën (xham zmadhues) duke përfutur pamje më të pastër. Nëse në njërin prej mureve të dhomës hapje një vrimë të vogël, peizazhi i jashtëm i një pamjeje plot diell përplasej në murin përballë në formë të përmbysur.<sup>39</sup> Fillimisht, pamja nuk ishte e qëndrueshme jo vetëm për shkak të këndeve, zmadhimit, por akoma më shumë për shkak të rrezeve të diellit. Imazhi i parë i qëndrueshëm u përfutua nga francezi Niepce në vitin 1827. Me këtë arritje, fotografia iu bashkëngjiti *gutenbergianizmit* për të krijuar shkëputjen mes Mesjetës dhe Rilindjes.<sup>40</sup> Imazhet tashmë mund të nguliteshin dhe të fiksoheshin në letër. Sigurisht, fotografia u përsos me shpikjen e elektricitetit dhe tërësisë së teknologjisë (makinerive të ndryshme) e cila nuk po njihte zmbropsje.

*Telegrafi* dhe *telefoni* mposhtën kohën dhe hapësirën, duke vendosur një dimension të ri në botën e komunikimit. Falë elektricitetit dhe fluksit të orientuar të ngarkesave elektrike, krijimit të fushave elektrike, ndikimit të fushave magnetike si dhe ekuacionit pikë-vizë, *telegrafi* u bë mjete i parë digjital i komunikimit. Në vitin 1836, Samuel Morse i dha jetë edhe komunikimit të parë të drejtpërdrejtë, në kohë reale, në diapazon të gjerë deri atje ku shtrihej kabloja përçuese, përmes *kodit Morse*. Tani, i gjithë njerëzimi ishte i arritshëm, në kohë reale. Mjaftonte një çelës dërgues, një tel dhe një marrës që kjo pajisje e re të bënte shënime në një shirit letre, bazuar në alternimet e rrymës elektrike.<sup>41</sup> Kjo pajisje mund të transmetonte deri në 45 fjalë në minutë.<sup>42</sup> Linja e parë e telegrafit u vendos nga Washingtoni në Baltimorë dhe mesazhi i parë i dërguar ishte “What hath God wrought”<sup>43</sup> (“What has God forged – Çfarë farkëtoi Zoti”).

Me telegrafin, mesazhet e të cilit transmetoheshin me shpejtësinë e dritës, jeta dhe zhvillimi morën një kurs të ri. Telegrafi u vu menjëherë nën kontrollin e autoriteteve, të cilat madje formuan edhe Aktin Telegrafik<sup>44</sup> në vitin 1868, një *akt special juridik* që rregullonte përdorimin e tij, duke ia hequr të drejtën kompanive private (apo shpikësve të tij) dhe duke ia lejuar privilegjin vetëm Postës zyrtare shtetërore. Telegrafi u bë më i rëndësishëm se sa vetë hekurudhat, duke përshpejtuar transmetimin e informacionit... Ai u bë mjete me të cilën *Agence Havas* (Paris më 1835) dhe *Reuters* (agjencia e lajmeve e krijuar nga baroni Julius Reuter në vitin 1851 në Londër) do të shpërndanin lajmet mbi ngjarjet e mëdha historike të kohës. Në SHBA, në vitin 1892 lindi edhe *Associated Press*.<sup>45</sup>

<sup>38</sup> Alma Davenport, *The History of Photography: An Overview*, University of New Mexico Press, Albuquerque, 1999, faqja 4,

<[https://books.google.mk/books?id=hca5H\\_rJZnUC&printsec=frontcover&dq=The+History+of+Photography:+An+Overview&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwjPrbmoyJroAhXqQxUIHbvXCnwQ6AEIKDAA#v=onepage&q=The%20History%20of%20Photography%3A%20An%20Overview&f=false](https://books.google.mk/books?id=hca5H_rJZnUC&printsec=frontcover&dq=The+History+of+Photography:+An+Overview&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwjPrbmoyJroAhXqQxUIHbvXCnwQ6AEIKDAA#v=onepage&q=The%20History%20of%20Photography%3A%20An%20Overview&f=false)>, [14.2.2019]

<sup>39</sup> Marshall McLuhan, *Instrumentat e komunikimit (Media si një zgjatim i njeriut)*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2008, faqja 213

<sup>40</sup> Po aty.

<sup>41</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET Press 2010, faqja 111

<sup>42</sup> Asa Briggs, Peter Burke, *A Social History of the Media, From Gutenberg to the Internet*, Polity Press 2002, faqja 136

<sup>43</sup> Po aty, faqja 138

<sup>44</sup> Po aty, faqja 135

<sup>45</sup> Po aty, faqja 136

Bota filloi të lidhej dhe telat e telegrafit ndiqnin jo vetëm linjat e hekurudhës, por po shtriheshin edhe nën ujë.<sup>46</sup> Përveç zhvillimit tregtar, komunikimit ushtarak dhe atij informues, telegrafi e tërhoqi *talentin letrar* drejt gazetarisë<sup>47</sup> dhe jo drejt mediumit tjetër - librit.

*Telefoni* çoi në një stad të ri komunikimin ndër-njerëzor, shpërndarjen e informacionit dhe nxitjen e zhvillimit në botë. Telefoni u patentua në 1876 nga Aleksandër Graham Bell edhe pse si teori kishte lindur shekuj më parë, me tel të tendosur dhe me përcjelljen e vibracionit të zërit nga njëri skaj në tjetrin. Ai përbënte mrekullinë e parë se si magnetizimi i hekurit do të prodhonte notë muzikore - zërin e njeriut.<sup>48</sup> Telefoni i parë pretendohet të jetë shpikur nga Antoniu Meucci i cili kishte lidhur dhomën e gjumit me laboratorin e tij të punës, dhe kishte marrë patentë nga Zyra për Licenca e SHBA-së. Por, duke qenë se në patentën e tij nuk përmendej *transmetimi elektromagnetik i tingullit zanor*, patenta zyrtare e meritave për shpikjen e telefonit i kaloi Bellit, duke e dëshpëruar Meucci-n.<sup>49</sup>

Pavarësisht se edhe për këtë arritje kishte dijetarë skeptikë, se gjoja “*shoqëria ia dilte shumë mirë edhe pa telefonin*”, në shekujt që pasuan telefoni u bë *nevojë* dhe *domosdoshmëri* për njerëzimin, në shtëpi e zyra, e madje edhe kur njerëzit ishin në lëvizje.<sup>50</sup> *Telefoni celular*, edhe pse i lëvizshëm, ishte i lidhur me stacionet tokësore të komunikimit. Ideja për telefon pa tel, e lindur në vitin 1973, i atribuohet Martin Cooper-it, i njohur si babai i celularëve.<sup>51</sup>

Por, telegrafi dhe telefoni, sikurse shkruan Joseph Dominick, nxitën hapin e ri të komunikimit i cili nuk mund të realizohej pa arritjet në fushën e kimisë.<sup>52</sup> Përmendëm tashmë zhvillimin *kimik* të fotografisë e cila arriti më në fund t'i mbijetonte rrezeve të diellit. Kështu, hapi i radhës ishte ai i kinematografisë, krijimit të filmit. Me pak fjalë, *film* nënkupton një seri imazhesh ose fotografish të lëvizshme. Sipas fjalorit enciklopedik të Oksfordit, *film është një ngjarje e kapur ose e filmuar me një seri imazhesh në kohë reale, të shfaqura në kinema ose televizor*. Film quhet edhe vetë shiriti plastik emulsionik ndaj rrezeve të diellit që kap (shkrep fotografitë e çastit) dhe si tërësi shfaq një ngjarje në lëvizje.<sup>53</sup> Zhvillimi i idesë së fotografisë së lëvizshme që sot shënon një industri të mëvetësishme kinematografike i atribuohet fotografit britanik Eadward Muybridge. Duke dashur të vërtetonte nëse gjatë vrapimit, kali i ngrinte të katërta këmbët njësoj ose jo, Muybridge instaloi kamera për të shkrepur momentet. Duke i radhitur fotot me shpejtësi, ai kuptoi se nuk i duheshin 24 aparate fotografike por një aparat i vetëm që të shkrepse sa më shumë herë brenda një sekonde; 24 fotografi (*frames-kuadro filmike*)

<sup>46</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET Press 2010, faqja 111

<sup>47</sup> Marshall McLuhan, *Instrumentat e komunikimit (Media si një zgjatim i njeriut)*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2008, faqja 282

<sup>48</sup> Asa Briggs, Peter Burke, *A Social History of the Media, From Gutenberg to the Internet*, Polity Press 2002, faqja 143

<sup>49</sup> Sandra Meucci, *Antonio and the Electric Scream: The Man who Invented the Telephone*, Branden Books Boston, faqja 90,

<[https://books.google.mk/books?id=Qog0daROwGEC&pg=PA3&source=gbs\\_selected\\_pages&cad=3#v=onepage&q&f=false](https://books.google.mk/books?id=Qog0daROwGEC&pg=PA3&source=gbs_selected_pages&cad=3#v=onepage&q&f=false)>, [15.2.2019]

<sup>50</sup> Asa Briggs, Peter Burke, *A Social History of the Media, From Gutenberg to the Internet*, Polity Press 2002, faqja 144

<sup>51</sup> Zheng Yan, *Encyclopedia of Mobile Phone Behavior*, University of Albany, State University of New York, USA, IGI Global, 2015

<sup>52</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET Press 2010, faqja 114

<sup>53</sup> Konsulto fjalorin enciklopedik të Oksfordit në <<https://en.oxforddictionaries.com/definition/film>>, [19.2.2019]

brenda një sekonde për të përfutur film nga imazhet e lëvizshme.<sup>54</sup> Thomas Edison dhe Williams Dickson jetësuan këtë ide të Muybridge duke shpikur *kinetoskopin* i cili mundësonte lëvizjet e imazheve, dhe më tej, *Vitaskopin* që do të projektonte filmin si shfaqje kinematografike.

Filmi, fillimisht i konceptuar për shfaqje me kuaj, akrobaci etj., do të bëhej një medium i fuqishëm në vitet e mëvonshme. Zhvillimi i tij, së pari në *film me zë* dhe pastaj në *film me metrazh të gjatë*, e bënë këtë medium - instrument të një industrie të madhe, veçanërisht në periudhat e luftës. Përveç shpërndarjes së kulturës apo të lajmit, falë reportazheve të luftës apo filmave të epokës së re, ai u bë një mjet i fuqishëm i propagandës për të nxitur madje edhe luftë. Edhe Jacques Ellul thotë se filmi është një medium i fuqishëm për propagandë sociologjike<sup>55</sup> edhe pse në propagandë (sidomos *Propagandën Totale*), çdo medium ka mënyrën e tij të penetrimit, por në të njëjtën kohë, të lokalizuar dhe kufizuar.

Kur bota përgatitej të hynte në shekullin XX, kushtet ishin pjekur tashmë për shpikjen e një prej medimeve më të rëndësishme të komunikimit, *radios*. Siç shkruan Garret, *radioja ishte vazhdimësi e historisë së hershme të telegrafit pa tel, e valëve elektromagnetike të Faradejit, e dalë nga përkufizimet fizike të Maksuellit dhe e shpikjes së valëve të Hercit*<sup>56</sup> – që në fakt ishin vazhdimësi e shpikjeve të tjera; atyre teknike, fizike e kimike të deritanishme.

Ashtu sikurse Meucci që kishte lidhur telefonin e parë mes dhomës së gjumit dhe laboratorit të tij, edhe Markoni e realizoi shpikjen e tij pas dhjetëra eksperimenteve, duke lidhur shtëpinë e tij me pronën e babait të tij në largësi prej 1 milje, që në vitin 1895.<sup>57</sup> Por, zyrtarizimi i radios si medium, erdhi shumë më vonë. Siç thekson Dominick, “*po të mos ishte Lufta e Parë Botërore, zhvillimi i radios do të kishte shkuar shumë larg*”.<sup>58</sup> Ai theksonte se radioja kishte probleme me patentimin, ndërsa përdorimi i saj për një periudhë mbi 30 vjeçare ishte thujse vetëm për shpërndarjen e *komunikimit luftarak*. Siç theksonte McLuhan, radioja ishte përdorur fillimisht, nëpër anije, si një telegraf që lidhte anijen me bregun.<sup>59</sup> Megjithatë, nuk është ende e qartë nëse lufta ndikoi për mirë apo për keq ndaj zhvillimit të radios, pasi radiot moderne u shfaqën vetëm pas vitit 1920.

*Kutia magjike*, siç është quajtur shpeshherë radioja, është shpikja teknologjike që përdor fushat elektromagnetike me një rreze frekuence nga 3 kHz në 300 GHz për të shpërndarë një informacion. Sipas Elligson, në sistemin radiofonik të komunikimit, transmetuesi e shndërron paketën e informacionit në sinjale analoge (zërin) ose sinjale digjitale (të dhënat) në valë radiofonike.<sup>60</sup> I njëjti parim ndodh edhe nga ana e marrësit, i cili kap sinjalet e lëshuara nga transmetuesi, për t'i konvertuar ato në formën e mëparshme origjinale. Pra, me fjalë të tjera, radioja bën shpërndarjen e informacionit falë rregullimit sistematik të valëve elektromagnetike të transmetuara në hapësirë. Kjo shpikje nuk kishte nevojë për fije, tela apo kablllo sikurse nevojiteshin për telegrafin që ndiqte trasetë e trenave. Tani, vetëm relievi malor mund të

<sup>54</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET Press 2010, faqja 314

<sup>55</sup> Jacques Ellul, *Propaganda, The Formation of Men's Attitudes*, Vintage Books, New York, 1968, faqja 9-10

<sup>56</sup> G. R. M. Garrat. *The Early History of Radio: From Faraday to Marconi, From Faraday to Marconi*, Institution of Engineering and Technology, London, UK, Introduction, faqja 1

<sup>57</sup> Po aty, faqja 75

<sup>58</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET Press 2010, faqja 119

<sup>59</sup> Marshall McLuhan, *Instrumentat e komunikimit (Media si një zgjatim i njeriut)*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2008, faqja 335

<sup>60</sup> Steven W. Ellingson, *Radio Systems Engineering*, Cambridge University Press, 2016, faqja 1

përbënte problem në pengimin e valëve, por edhe për këtë, Markoni dhe fizikanët e tjerë kishin shpikur *përsëritësit radiofonikë* (përsëritësit valorë) që të mund t'i shtrinin valët kudo.

Shpikja e Markonit do të bënte jehonë të madhe në vitin 1912, kur anija transatlantike Titanik u përplas me një ajsberg. Ishte pikërisht stacioni i Markonit në Long Ajlënd që kapi mesazhet SOS që vinin nga anija që mbytej, dhe e dërgoi lajmin drejt e në Shtëpinë e Bardhë.<sup>61</sup> Pavarësisht rëndësisë së kësaj shpikje, autoritetet amerikane nuk mund të gjenin një zgjidhje ligjore për patentimin e radiove, për rregullimin e transmetimit të tyre apo për ndarjen e bandës së valëve midis radiove të klasifikuara si mjet komunikimi (kulla kontrolli për anijet, ushtrinë etj.) dhe gjerësisë tjetër valore për shfrytëzim publik radiofonik. Madje, kongresisti i Masaçusetsit Ernest W. Roberts ishte nga ata që theksonte në debatin e Kongresit për Aktin ligjor radiofonik se “... (deri dje) kemi qenë të idesë se ajri është i lirë për cilindro, por marshimi i qytetërimit na dikton kushte, veçanërisht në çështjen e komunikimit pa tel... nevojitet ndryshim i bindjes së vjetër, në interes të progresit dhe zhvillimit modern”<sup>62</sup> ndërkohë që Akti caktoi përfundimisht se mesazhet radiofonike duhet të mbaheshin të kufizuara në gjatësi valore deri në 200 metra.<sup>63</sup>

Rregullimi më serioz i radiove dhe sinjaleve të tyre, për nga aspekti teknik, erdhi në vitin 1927 kur Kongresi amerikan krijoi Komisionin Federal të Radios.<sup>64</sup> Sipas të dhënave, deri në vitin 1925, më shumë se 5,5 milion radiostacione numëroheshin në SHBA, thuajse gjysma e gjithë numrit të radiostacioneve në tërë botën.<sup>65</sup> Kushtet ekonomike, lirimi i mallrave të konsumit, ngritja e shtresave të të pasurve, por dhe lufta e re për reklamimin e biznesit çoi në krijimin e radiove moderne. Në vitin 1926, radiot zinin pjesëmarrje në audiencë<sup>66</sup> prej 6,4%, por në vitin 1931 pjesëmarrja në audiencë shkoi në 30%.<sup>67</sup>

Ky zhvillim nxiti këtë medium të përforcohej nga aspekti profesional, jo vetëm me muzikën dhe argëtimin, por edhe me lajmet - duke filluar të *vidhte* vëmendje gjithnjë e më të madhe nga gazeta - falë informacionit të shpërndarë në çast (në kohë reale).

Siç theksojnë studiuesit, radioja, ashtu sikurse filmi (kinemaja) klasifikohen si medime të *nxehta* sepse mendohet se e ngopin dëgjuesin me informata.<sup>68</sup> Pavarësisht se shumë studiues ende hamenden edhe sot e kësaj dite nëse radioja kishte fillimisht si qëllim parësor argëtimin apo shpërndarjen e lajmit, McLuhan beson se vetëm kur doli televizioni, radioja u shndërrua në *një sistem informacioni nervoz*.<sup>69</sup> Gjithsesi, pas teknologjisë së Gutenbergut që mbante meritat për

<sup>61</sup> Asa Briggs, Peter Burke, *A Social History of the Media, From Gutenberg to the Internet*, Polity Press 2002, faqja 156

<sup>62</sup> Chester. W. Nimitz, *History of communications, Electronics in the United States Navy, Bureau of Ships and Office of Naval History*, Washington 1963, faqja 156, <<https://archive.org/details/historyofcommuni00howe/page/156>>, [20.2.2019]

<sup>63</sup> Po aty, 157

<sup>64</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET Press 2010, faqja 120

<sup>65</sup> Asa Briggs, Peter Burke, *A Social History of the Media, From Gutenberg to the Internet*, Polity Press 2002, faqja 161

<sup>66</sup> Pjesëmarrja në audiencë ose share/sharing-u siç përdoret shpesh nga ekspertët e marketingut bazohet në një sërë kriteresh; përqindjen e tregut shënjësor të synuar - i ekspozuar ndaj një mesazhi reklamues – në një moment të caktuar, përqindja e amvisërive që ndezin radion/televizionin për një program të caktuar, numri mesatar i atyre që e shohin mesazhin reklamues nga numri total i shikuesve, përqindja e amvisërive që përdorin televizor në një hark të caktuar kohor, etj.

<sup>67</sup> Po aty, faqja 161

<sup>68</sup> Marshall McLuhan, *Instrumentat e komunikimit (Media si një zgjatim i njeriut)*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2008, faqja 30

<sup>69</sup> Po aty, faqja 328



prodhimin dhe ekspansionin industrial në shekullin XVI, radio shënoi zhvillimin më të madh të deri asaj kohe, duke i çuar njerëzit në mendimin se pasurimi përmes ajrit (shërbimet valore ose pa tel) ishin tendenca e re e zbulimit dhe zhvillimit të njerëzimit.

Pas kutisë magjike – radios – një tjetër kuti magjike do të mahniste njerëzimin dhe do e çonte atë drejt një diapazoni të ri. Shumëkush në vitet 1930, e cilësonte edhe si *pasqyra magjike*. Pas shpikjes së kamerës, filmit, shpikja e valëve përmes fushave elektromagnetike do të kurorëzohej me shpikjen e re, atë të *televizorit*. Sipas Rogers, në klasifikimin që ai i bën shpikjeve të njerëzimit në fushën e komunikimit, televizori lindi në vitin 1933, ndërsa transmetimi i parë televiziv u regjistrua në vitin 1941. Këto dy momente historike përbëjnë edhe përmbylljen e fazës III, pikërisht Epokën e Telekomunikimeve.<sup>70</sup>

Televizioni është një pajisje teknologjike e cila përveç transmetimit të zërit (i shpikur veçse më nga radioja) transmeton edhe figurën. Ashtu sikurse studiuesi britanik Muybridge eksperimentoi lëvizjet e kalit, nëse gjatë vrapimit i ngrinte njëkohësisht të katërta këmbët, edhe në televizion aplikohet i njëjti parim. Për të parë një pamje në lëvizje, duhet të ketë më së pakti 24 shkrepje brenda një sekonde, që të ofrohet një vazhdimësi të pamjes. Sot, teknologjia televizive është përsosur mjaft, me fotografi me ngjyra, me zë stereofonik e shumë cilësime të tjera, por gjithsesi, fillimi i tij ishte bardhezi.

Asa Briggs dhe Peter Burke nuk bëjnë ndonjë lidhje konkrete mes radios dhe televizionit, përkundrazi, e lidhin televizionin më shumë me kinemanë për shkak të figurës. Zhvillimi i të dyjave, kinemasë dhe televizionit, varej nga kamera e cila kishte një histori më vete pas saj, atë të kamerës *obscura* (dhomës së errët).<sup>71</sup>

Megjithatë, ishte *televizori mekanik* ai që u shpik i pari. Një risi e tillë (pa rrymë) realizohej përmes një disku rrotullues me vrimë, i përbërë nga linja të ndryshme imazhesh në formë spirale, të cilat *lexoheshin* falë rrotullimit mekanik. Disku mori emrin e shpikësit të tij, *Nipkou* (Paul Gottlieb Nipkow) dhe shpikja e studentit 23 vjeçar gjerman u quajt *teleskopi elektrik*<sup>72</sup> edhe pse parimi i punës së tij ishte kryekëput mekanik. Duke e parë nga aspekti mekanik, studiuesi Shiers e arsyeton arritjen e vitit 1883 me pjekjen e kushteve të tjera; pra, me vazhdimësinë e shpikjeve, atë të seleniumit (substancë kimike për tonifikimin bardhezi të fotografisë), prizmit polarizues, auto-transformatorit, rrezeve katodike, telegrafit, telegrafit kopjues, teorisë elektromagnetike, fonografisë etj.).<sup>73</sup> Televizion mekanik shpikën në vitin 1907 edhe B. Rozing (studentin e tij Zworykin) dhe A.A Campbell-Swinton, duke inkorporuar edhe tubin me rreze katodike në një sistem mekanik skanimit.

Këto përpjekje çuan gjithsesi në televizionin e parë *elektrik* në vitin 1927, i cili i atribuohet Philo Farnsworth-it. Duke mësuar nga shpikjet *mekanike* të hungarezit Kalman Tihanyi i cili kishte provuar veçse parimin “*charge storage*” (rezervë elektrike)<sup>74</sup> në tubin skanues (kamerës),

<sup>70</sup> Everett M. Rogers, *Communication technology, The new media in Society (Teknologjia e komunikimit, Media e re në shoqëri)*, Free Press, 1986, faqja 25, <[https://books.google.mk/books?id=9uFT080FcRkC&pg=PA23&source=gbs\\_toc\\_r&cad=4#v=onepage&q&f=false](https://books.google.mk/books?id=9uFT080FcRkC&pg=PA23&source=gbs_toc_r&cad=4#v=onepage&q&f=false)>, [21.2.2019]

<sup>71</sup> Asa Briggs, Peter Burke, *A Social History of the Media, From Gutenberg to the Internet*, Polity Press 2002, faqja 164

<sup>72</sup> George Shiers, *Early Television, A Bibliographic Guide to 1940*, Routledge, New York, 2013, faqja 13

<sup>73</sup> Po aty, shih listën e shpikjeve në faqen 2

<sup>74</sup> UNESCO, *Kalman Tihanyi's 1926 Patent Application "Radioskop"*, <<http://www.unesco.org/new/en/kalman-tihanyis-1926-patent-application-radioskop>>, [22.2.2019]

si dhe eksperimentimet<sup>75</sup> e shpikësit skocez Baird, amerikanit Jenkins (shpikës i projektorit kinematografik), hungarezit tjetër Mihaly mbi të ashtuquajturin *vizion elektrik në distancë* përmes rrezeve infra të kuqe, Farnsworth-i shkoi më tej me idenë e një sistemi televiziv të tërë elektrik.<sup>76</sup> Falë shpikjes së Farnsworth-it (*kopje imazhi*) dhe atë të Zworykin-it (*ikonoskopi*) transmetimi i parë do të kryhej në Britani, në gusht të vitit 1936 nga BBC.<sup>77</sup> Nga ana tjetër, transmetimi i parë në SHBA u realizua nga Korporata radiofonike e Amerikës (RCA) në vitin 1939 nëpërmjet televizionit NBC që ajo zotëronte.<sup>78</sup>

Zhvillimi i televizionit u ndërpre për shkak të Luftës së Dytë Botërore, por pas saj, kur interesi u rrit mjaft nga përdorimi i radarëve dhe përforcimit të antenave, televizioni u rikthye fuqishëm duke pushtuar familjet. Tashmë, përsosjet teknologjike kishin të bënin me marrësit televiziv, për një pamje me përcaktim më të mirë imazhi. 10 vjet pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Amerika ishte përmbytur nga televizioni – afro 100 kanale televizive që mbërrinin në gati 35 milion shtëpi me televizorë (rreth 67% e popullsisë amerikane).<sup>79</sup>

Në vitet 1950, periudhë kjo e njohur si *periudha e artë e televizionit*, televizioni po përmbushej nga garat sportive, ngjarjet kulturore si komeditë, dramat, intervistat, nga lojërat zbavitëse dhe kuizet televizive, si dhe nga zhanri i ri *western* i filmave me luftime. Ndërsa në vitet 1960, televizionet filluan një orientim më serioz mbi informimin. 95% e amerikanëve kishin tashmë televizor, dhe pas ngopjes me argëtim, autoritetet nxitën aspektin edukativ. 69 stacione edukative<sup>80</sup> numëroheshin në vitin 1965 ndërkohë që dhjetëvjeçari shënoi dy ngjarje të rëndësishme historike, *vrasjen e presidentit Kenedi* dhe atë të *zbritjes së njeriut të parë në Hënë*. Në vitin 1963, anketat tregonin se televizioni, si burim informativ, ia kishte kaluar tashmë gazetave.

Me zhvillimin e teknologjisë në fushën e televizionit, u bë i mundur edhe shndërrimi dhe transmetimi i figurës nga bardhezi në atë me ngjyra. Pavarësisht se një gjë e tillë ishte provuar që në vitin 1928 nga Baird,<sup>81</sup> në SHBA transmetimi mbarë-amerikan do të shënohej në vitin 1966 ndërsa një vit më vonë, këtë përvojë do e përjetonte edhe rrjeti BBC2 në Britani, që do të realizonte transmetimin e parë me ngjyra, nga Wembletoni.

Do të duheshin 40 vite të tjera, deri në vitin 2009 kur televizioni të hynte zyrtarisht në epokën e re digjitale, dhënies fund të sinjalit analog dhe kalimit në transmetim digjital.<sup>82</sup> Megjithatë, prej vitesh, televizioni veçse kishte shënuar momente të tjera historike, atë të transmetimit përmes satelitit si dhe rrisë së fundshekullit XX, përmes internetit.

Kjo epokë, që Rogersi e cilëson si *epoka e komunikimit ndër-aktiv* duket se nuk ka përjashtuar asnjë nga mediumet (as radion dhe as televizionin), përkundrazi, i ka bërë ato të gjejnë hapësirën e tyre. Ashtu sikurse televizioni nuk e vrau radion, e cila mbijetoi jo vetëm për shkak të larmisë që sjell, eksperimentimeve radiofonike, kostos së ulët të programit,

<sup>75</sup> George Shiers, *Early Television, A Bibliographic Guide to 1940*, Routledge, New York, 2013, faqja XI në kapitullin "Understanding a Century of Television"

<sup>76</sup> Asa Briggs, Peter Burke, *A Social History of the Media, From Gutenberg to the Internet*, Polity Press 2002, faqja 177

<sup>77</sup> Po aty.

<sup>78</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET Press 2010, faqja 352

<sup>79</sup> Po aty, 353

<sup>80</sup> Po aty, faqja 355

<sup>81</sup> John Logie Baird, *Television Apparatus and the Like*, Patenta Amerikane e Shpikjes e skeduar në Mbretërinë e Bashkuar në 1928, <<https://patents.google.com/patent/US1925554>>, [22.2.2019]

<sup>82</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET PRESS 2010, faqja 362

ndërveprimit më të shpejtë me njerëzit<sup>83</sup> etj., duket se as televizioni nuk do të mund të përjashtohet nga dixhitalizimi dhe epoka e internetit. Përkundrazi, ai shfaqet në *web*, në platforma të ndryshme sociale, dhe është gjithnjë e më pranë shikuesit, përmes telefonit celular. Ai mbetet një mjet i fuqishëm komunikimi por edhe edukimi. Pavarësisht se ka edhe parashikime pesimiste se televizioni po zbehet në informim – se lajmi tashmë udhëton më shpejt përmes rrjeteve sociale – sërish televizioni mbetet platforma ku shikuesit gjejnë disa minuta për të ndarë për të *konfirmuar* ato që mund të lexojnë gjatë gjithë ditës në internet.

E vetmja frikë e vazhdueshme për McLuhan-in nuk ka qenë zhdukja e televizionit, por vetëm e pasojave të tij, kryesisht zbehja e librit, nxitja e tendencave të dhunës, e propagandës së pakontrolluar etj. “*Ashtu siç mundohemi tani të kontrollojmë bombën atomike, një ditë do të përpiqemi të kontrollojmë demin e shkaktuar nga mediat. Vetëm arsimi është një formë mbrojtjeje civile kundër demit që shkaktohet nga mediat*”.<sup>84</sup>

### 3.1.1.2 Kultura mediatike në epokat e hershme

Kultura mediatike, si koncept lidhet me komunikimin dhe shoqërinë. Sado që ta përkufizosh atë, ajo mbetet një spektër i gjerë për t’u analizuar. Këtë kulturë do të përpiqemi ta shohim nga këndvështrimi i mjeteve të komunikimit dhe ndikimi i tyre në shoqëri, duke ndërtuar kulturën (ose duke e devijuar atë), pra një analizë se si kanë ndikuar të gjitha shpikjet e njerëzimit, në favor të tij ose jo, lidhur me ruajtjen e kulturës, të zhvillimit të saj, si dhe trashëgimisë që shërben si një bazë për dimensione të reja ende të pazbuluara për njeriun.

Kur flasim për komunikimin, në mënyrë të mirëfilltë si term, nënkuptojmë *hyrjen në lidhje*, në komunikim, në shkëmbim të mendimeve dhe marrëveshjes së dy apo më shumë njerëzve.<sup>85</sup> Parë nga këndvështrimi mediatik (gazetarisë), ajo bart edhe kuptimin publicistik, pasi përveç kumtimit të lajmit ose mesazhit, ai bart me vete edhe nocionin e *ndikimit* dhe krijimit të *opinionit publik*.

Edhe sociologjia e komunikimit masiv ose e masmedias, pavarësisht se si teori lindi në fundshekullin XIX, ngërthen natyrën e lidhjeve shoqërore mes lajmëtarit (gazetarit) dhe publikut.<sup>86</sup>

Megjithatë, para krijimit të kësaj sociologjie si shkencë, kultura e komunikimit ka zanafillë që me njerëzimin. Sikurse u theksua edhe më sipër, njeriu që 35 000 vjet para erës sonë tentonte të gjente forma për të përçuar mesazhin, për të lënë gjurmë të tij, e për t’u përsosur... Simbolet, gravurat, pikturat, varret mijëra vjeçare të zbuluara dhe gërmuara e tregojnë më së qarti këtë përprjekje të njeriut për të ndërtuar të folurën, traditën, kulturën, dhe synimin e tyre për t’i tejçuar te brezi pasardhës.

E para ishte *e folura*. Ashtu sikurse u theksua edhe më sipër, e folura ishte revolucioni i parë i njerëzimit. Ajo mendohet se daton 40 000 vjet para erës sonë dhe i dha hov të madh njeriut parahistorik, duke e orientuar atë drejt dijes dhe ngulitjes së saj, lënies së mëtejshme nga njëri te tjetri.

<sup>83</sup> Valbona Sulçe Kolgeci, *Hyrje në media dhe komunikim*, cikël leksionesh, faqja 26

<sup>84</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET Press 2010, faqja 336

<sup>85</sup> Hamit Boriçi, Bashkim Gjergji, Genç Tirana, Sadri Ramabaja, *Gazetaria (Njohuri të përgjithshme)*, Libri Universitar, Tiranë 2003, faqja 12

<sup>86</sup> Po aty, faqja 47

Joseph Dominick, në kërkimet e tij të mëhershme, argumentonte se edhe Çarls Darwin, në teorinë e tij të vëzhgimit, theksonte për herë të parë se gjuha zëvendësoi gjetet duke bërë që njerëzit të kishin duar të lira për gjueti, për armë etj.<sup>87</sup> Njerëzit filluan të shpjegonin dhe të shpërndanin teknikat e gjuetisë, të ndjekjes së presës, të ushqimit të familjes, të përpunimit për herë të parë të veglave të punës, të përsosmërisë së jetës modeste të asaj kohe të menduar, enëve të ushqimit etj.

Gjuha nga ana tjetër tregoi se njeriu nuk mjaftohej me të mirën. Jo vetëm shpërndarja e informacionit, komunikimit verbal dhe jo verbal (ky i fundit edhe sot e kësaj dite përdoret bashkërisht), por edhe vendosja në kujtesë e kulturës, ishte një arritje tjetër e madhe. Njerëzit e parë filluan t'u jepnin jetë *gravurave*, komunikimit dhe përqimit të mesazhit, të gjetura në shpella, varreza, apo qytetërime të fundosura. Gravurat mendohet se lindën diku 22 000 vjet më parë.

E ndërsa shekujt parahistorikë kalonin, studiuesit ia atribuojnë gjuhën dhe lënien e trashëgimisë së saj, zhvillimit të ri të civilizimit - konkretisht formësimit të parë konkret të fshatit dhe qytetit, të bujqësisë dhe artizanateve të para.

Ishte *shkrimi* (zhvillimi i dytë më i madh) ai që do e çonte njerëzimin drejt një ndarje të re punësh, profesionesh, drejt një nxitje akoma më të madhe të dijeve, si dhe do të përbënte trampolinën për shpikje akoma më të mëdha të njerëzimit. Shkrimi, pavarësisht se në format e para ishte *simbolik*<sup>88</sup> (siç u theksua më sipër), vazhdon të jetë aktiv edhe sot e kësaj dite. Në epokën e re ku jetojmë, shenjat ose simbolet përdoren ende nëpër brigje detare, nëpër metro, tabela udhëzuese, e madje, i njëjti parim është edhe në tabelat e qarkullimit rrugor. Shkrimi simbolik i parahistorisë shprehej me shenja fenomenesh të caktuara, ndërkohë që ai u konkretizua për herë të parë në Kinë, falë një forme të përzierë simbolesh dhe germash që nënkuptonin një komplet të tërësishëm mendimi. Simbolet kineze u stërholluan në alfabetin e parë.

Shtresat e para të shoqërisë së shtresuar, ato më të pasurat, filluan të mbërthenin këtë trend të ri, duke u bërë shkruarit e parë të gjuhës dhe kopjuesit e saj duke punuar për llogari të perandorëve. Fazat e para të shtetit ishin krijuar tashmë, madje, në vitin 311 p.e.s, grekët ngritën Bibliotekën e Madhe të Aleksandrisë. Ajo barti edhe efektin më të madh të kohës, atë të organizimit të dijeve si dhe lënies së saj si trashëgimi për brezat e tjerë. Nëpër manastire, kur Kisha dhe krishterimi nisën të pushtonin Evropën, nisi kahezimi i bindjes fetare, pjesë e rëndësishme e identitetit njerëzor edhe sot e kësaj dite.

Pra, shkrimi krijoi një ndarje të re në shoqëri,<sup>89</sup> i dha jetë *organizimit politik njerëzor*, *thelloi bindjen fetare*, *nxiti dijen* drejt një diapazoni të ri, ndërsa për herë të parë, e trashëgoi në formë të shkruar, të gjithë këtë sa u përmend më sipër.

Shpikja e shtypshkrimit (makinës së parë të shkrimit) që i atribuohet Gutenbergut, u bë histori e re e shumë zbulimeve të tjera pasuese. Falë botimit, tërësia e informacioneve u bë e arritshme në kohë më të shpejtë duke nxitur në përhapjen e arsimit, të librave, të kulturës në përgjithësi me veprat e para si romane, fabula etj., ndërkohë që më së shumti, teorinë e shpikura nga fusha e kimisë, fizikës, gjuhëve të huaja etj., theu tabutë e Kishës.

<sup>87</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET PRESS 2010, faqja 101

<sup>88</sup> Po aty, faqja 102

<sup>89</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET PRESS 2010, faqja 104

Siç theksohet nga një sërë studiuesish, përhapja e shtypshkronjave ishte përhapja më e madhe e shpikjeve të deri asaj kohe. Në një hark kohor prej 30 vjetësh, 110 shtypshkronja u shtrinë në gjithë Evropën.<sup>90</sup>

Me përhapjen e arsimit, në botë lindi edhe nacionalizmi. Në shekujt pasues, (pas vitit 1453 kur u botua edhe Bibla e parë nga Gutenbergu) bota do të kahezohej drejt 2 linjave më të gjalla të bindjes politike, ajo e përforcimit të shtetit si dhe ajo e rënies së ndikimit të Kishës dhe njëmendësisë që ajo bartte. Teoritë e Martin Luter King-ut, jo vetëm kundër Kishës por edhe ajo pro lirive të të drejtave të njeriut filluan të lexoheshin fshehurazi dhe me shpejtësi, si një mit i ndaluar por i adhuruar nga njerëzit.<sup>91</sup>

*Njerëzit, për herë të parë mund të lexonin dhe kuptonin pa ndërmjetësim Biblën, teoritë shkencore, si dhe informacionin e shpërndarë nga pamfletet ose broshurat e para informative.*<sup>92</sup>

Ky sukses nxiste vijueshmërinë më të madhe të shkencës. Shkencëtarët veçse bazoheshin në teoritë e shkruara nga kolegë të tyre, duke e shtrirë dhe nxitur shkencën jo vetëm në kohë të shkurtër por edhe në hapësirë duke pushtuar botën.

Një segment tejet i rëndësishëm, sikurse u theksua, ishte ai i përhapjes së lajmit. Për herë të parë, lajmi, si informatë gazetareske, nisi zanafillën jo vetëm për informim mbretëror, ushtarak, por edhe për qytetarët e rëndomtë. Shekulli XVII u bë konkret jo vetëm për teoritë e determinizmit teknologjik<sup>93</sup> por edhe atë të komunikimit masiv.

Hapësira dhe koha u ngushtuan akoma më shumë me shpikjen e telegrafit dhe telefonit, menjëherë pas shpikjes së elektricitetit. Bota kishte lënë mënjanë makinat me avull dhe tashmë, civilizimi u orientua akoma më shumë te shpejtësia, forca shtytëse e proceseve dhe shpërndarjes në çast të informacionit. Siç u theksua më sipër, njerëzit u habitën të shihnin se si informata vinte në kohë reale, duke rregulluar transportin hekurudhor, detar, komunikimin ushtarak në luftëra që kërkonin mobilizim të shpejt trupash, etj. Telegrafi me sinjalin Mors lidhi tregjet, barazoi çmimet, zbehu komunikimin postar me letra që mbërrinin në dorë deri edhe pas 1 muaji, rriti kontrollin qeveritar ndaj proceseve jetësore etj.

Ndërsa telefoni, një shpikje akoma më marramendëse, falë shndërrimit të fjalëve në impulse valore dhe anasjelltas, rriti akoma më shumë këtë komunikim. Tashmë bota u ri-orientua te gazetaria duke vendosur një hendek me *talentin letrar* (shih më sipër) që ofrohej prej librit. Zhvillimi industrial dhe nevoja për komunikim e priu njerëzimin drejt informatave në kohë, organizimit më të mirë të punëve dhe materializimit të tyre.

Telefoni është mjet i gjerë komunikimi në ditët e sotme, dhe një nga mjetet më të rëndësishme të organizimit të punëve në gazetari. Lidhjet me institucionet shtetërore nxitën punën e gazetarëve, punën e tyre ekipore dhe organizative brenda medias, nxitën jo vetëm shpejtësinë në marrjen e informatave por edhe saktësinë e tyre, por edhe në tejçimin e informatës në kohë reale, më të plotë dhe më të njomë. Ndryshe nga telegrafi, telefoni shtonte ndjesinë përshkruese të ngjarjeve, me detaje dhe këndvështrime të gjera... ndërsa telegrafi përdorej deri në këtë kohë për informata shumë të shkurtra. Përveç këtij ndikimi, telefoni u bë një mjet i gjerë jo vetëm në biznes, por edhe në komunikimin privat të njerëzve. Duke shkurtuar kohë dhe distancë, tashmë telefoni shtyu më tej proceset politike, ekonomike dhe sociale të njerëzimit në shekullin XX.

<sup>90</sup> Po aty, faqja 106

<sup>91</sup> Po aty, faqja 107

<sup>92</sup> Po aty, faqja 108

<sup>93</sup> Po aty, faqja 109

=====

Kultura mediatike do të njihete një revolucion të ri falë shpikjes së fotografisë dhe paralelisht me të, edhe të radios. Zhvillimi i kimisë çoi në kapjen e imazhit të parë fiks, falë një procesi të thjeshtë të reflektimit të imazhit përmbyës dhe vendosjes së tij në diapozitiv. Që në vitin 1890, Kodak pushtoi tregun me prodhimin e aparateve dhe filmave fotografik, ndërkohë që për herë të parë, gazetaria dhe media filluan të komunikonin me lexuesit, falë fotografisë.

Mes një debati të nxehtë, mes etikës dhe jo etikës, mes sekretit shtetëror ose jo, fotografia u bë pjesë e foto-realizmit. Në 1862, Mathew Brady, një nga fotografët e parë që njeh SHBA-ja, u bë i famshëm gjatë luftës civile amerikane kur i tregoi botës për herë të parë pamjet reale të masakrave, vrasjeve, viktimave.... Brady njihet si babai i foto-gazetarisë.<sup>94</sup> E kombinuar me stampimin dhe shtypjen, fotografia tashmë kurseu kohë për njerëzit, sepse ajo bartte *një mijë fjalë* në vetvete. Raportimi me fjalë u pasurua dhe e bëri lajmin *të njomë* dhe të prekshëm për lexuesin.

Në gazetarinë e sotme, fotografia është më së shumti pjesë, jo vetëm e raportimit të ngjarjeve të mëdha si luftërat, por edhe e stilit të jetës, e fenomeneve që përjetohen nga njeriu në çdo sferë të jetës, në shëndetësi, në sport, në modë etj.

Përveç gazetarisë, medias në përgjithësi, fotografia ngjizi një kulturë të gjerë në art dhe riprodhim grafik. Ndërsa shpikja e filmit, *fotografisë së lëvizshme* çoi në një industri të re, atë të jetësimit të momentit dhe të argëtimit. Fjalët dhe komentet që bëheshin në radio, tashmë bëheshin të kota sepse zëvendësoheshin lehtë me pamjet.

Industria e filmit filloi të prodhonte në mënyrë marramendëse dokumentarë informativë mbi luftërat, me proceset zhvillimore të jetës, të prodhonte filma dhe ikona kinematografike. Po aq sa paguheshin aktorët, aq filluan të paguheshin edhe gazetarët dhe producentët e asaj kohe të cilët u bënë të njohur e të famshëm me dokumentarët informativë (bobinat 10-minutëshe) me përmbledhje ngjarjesh javore, duke e çuar *gazetarinë ilustrative* drejt *televizionit*. Prirja e televizionit për t'u marrë me tema aktuale dhe me reagime komplekse, i mundësonte filmit dokumentar që të dilte më shumë në pah. Kinemaja mund të paraqesë një proces më të përkryer, por spektatori i kinemasë është konsumues pasiv, jo si ai i televizionit me reagime.<sup>95</sup> Në këtë mënyrë, Kinemaja do të mbetej gjithnjë e goditur nga televizioni, dhe gjithnjë e dyta në *industrinë e imazhit*.

\*\*\*

Radioja ndërkohë kishte krijuar tashmë kulturën popullore. *Radio-dramatizimet* ishin forma më e qartë e pasqyrimit politik. Bazuar në këto shfaqje teatrale radiofonike, radiot tregonin historitë e luftës, që përbënin kështu *sensacion* për njerëzimin. Edhe pse gjatë Luftës së Parë Botërore radioja nuk ishte aq e fuqishme, përkundrazi ishte në fillimet e saj, gjatë Luftës së Dytë Botërore ajo u bë jo vetëm tejçuese e raportimit mediatik, por edhe e propagandës luftarake duke vendosur në majë shtizat mes kampit hitlerian dhe perëndimit.

<sup>94</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET PRESS 2010, faqja 115

<sup>95</sup> Marshall McLuhan, *Instrumentat e komunikimit (Media si një zgjatim i njeriut)*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2008, faqja 352

Siç u theksua më sipër, radioja u bë e prekshme falë komenteve dhe raportimeve, shumë më e qasshme se sa gazetat që tentonin të shisnin titullin e parë dhe fotografitë që nuk ishin aq të lehta për t'u shkrepur nga terrenet e luftës. Ajo i kishte dhënë provat që në përdorimin e parë, të lidhjes së njerit breg me tjetrin. Kryengritësit irlandezë nuk i përdorën më radiot si telegraf, për mesazhe me impulse elektronike, por për transmetim të mirëfilltë duke shpresuar të kontaktonin ndonjë anije e cila pastaj do t'ua komunikonte historinë e tyre gazetave amerikane.<sup>96</sup>

Përveç propagandës luftarake, aspektit teknik të përçimit të mesazhit dhe lajmit, segmenti tjetër i ndikimit të radios ishte ai i argëtimit. Përveç lajmeve që mblidhnin familjet çdo mbrëmje, argëtimi zinte pjesën më të madhe të dëgjimit, duke nxitur kështu më shumë industrinë muzikore. Bandat muzikore tashmë u vunë në garë, duke e bërë muzikën një biznes më vete, e cila lundronte mes ujërave të formësimit të kulturës muzikore dhe argëtimit nga ana tjetër.

Reklamat<sup>97</sup> u bënë pjesë e rëndësishme e rritjes së bizneseve të tjera, e shitjeve të produkteve dhe shërbimeve, duke lehtësuar kështu jetën dhe duke sendërtuar një formë të re në konkretizimin e punëve. Njerëzit ishin më të përqendruar në punët e tyre, dhe ndarja e biznesit ose kategorive të zanatçinjve.

Televizioni zuri një vend goxha të madh të ndikimit të radios. *Aspekti vizual* dhe shprehja me pamje e ngjarjeve, filloi ta lëvizte njerëzimin përtej kulturës tradicionale. Imazhi televiziv ofron shumë më tepër të dhëna në sekondë dhe shikuesit nuk i duhet të bëjë të njëjtin reduktim dramatik për të krijuar përshtypjen e tij. Në fakt, ai priret të pranojë të tërë imazhin si një paketë.<sup>98</sup> Periudha e artë e televizionit, siç u theksua më sipër, njihet ajo pas Luftës së Dytë Botërore kur përdorimi i sistemit të radarit u përshtat edhe për televizionin, për të përforcuar valët e tij si dhe arritjen në çdo familje. Televizioni, sipas studiuesve zë vendin e tretë pas gjumit dhe punës për njeriun.

Ngjarjet më të rëndësishme politike, e veçanërisht sociale u bënë shembull për gjithë familjet amerikane. I pari atribut ishte informimi, me lajmet dhe raportimet mediatike. Lajmi dhe informimi ishin interesi parësor për t'u njohur mbi zhvillimet e njeriut, si qenie politike, duke transformuar gjithashtu edhe vetë politikën. Qytetarët nuk ishin më jashtë zhvillimeve politike dhe presioni ose reagimi i tyre u bë udhërrëfyes për vendimmarrje të shumta politike, veçanërisht gjatë ngjarjeve të mëdha amerikane apo në shtete të tjera të botës.

Njerëzimi përjetonte tashmë luftërat, vrasjen e Kenedit,<sup>99</sup> sukseset në hapësirë, sulmet terroriste, qëllimet politike dhe diplomatike filluan të shpreheshin dhe reflektonin krenarinë ose edhe neverinë e njeriut ndaj akteve jo të drejta ose që binin ndesh me traditën dhe moralin e gdhendur deri në atë kohë.

Ndërkohë, programe të tjera edukuese, si dokumentaret, reportazhet e ndryshme nga shumë sfera të jetës, vendosën një trase të zhvillimit njerëzor. Me kalimin e viteve, sinjalet televizive u bënë digjitale dhe miliona televizione sot janë të arritshme përmes satelitit. Në shumë vende të botës, sasia standarde e kohës përpara televizionit është mesatarisht 8 orë në ditë dhe e zëvendësoi radion, jo vetëm në informim por edhe në argëtim, dy interesat më madhore që ka njeriu.

<sup>96</sup> Po aty, faqja 335

<sup>97</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET PRESS 2010, faqja 121

<sup>98</sup> Marshall McLuhan, *Instrumentat e komunikimit (Media si një zgjatim i njeriut)*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2008, faqja 344

<sup>99</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET PRESS 2010, faqja 123

Përveç informimit në kohë, në sferën e informimit dhe gazetarisë, televizioni i dha një hodh të madh edhe kulturës. Ikona të shumta të botës kinematografike u bënë falë televizionit, shembull ndjekës për miliona njerëz, kryesisht duke kopjuar stilin e tyre të jetës.

Nuk mund të lihet pa theksuar edhe roli edukues që ka televizioni, veçanërisht te brezi i ri, me emisione edukative e argëtuese. James H. Wittebols këmbëngul se televizioni kishte merita të mëdha në hartimin e përcaktimin e vlerave universale, duke ofruar vizionin e *dinjitetit njerëzor si dhe solidaritetin social si mjete të socializimit (shoqërimin social)*. Sikurse fjalët dhe rrëfimet e lëna trashëgimi nga njëri brez në tjetrin, ashtu edhe televizioni sillte rrëfime dhe theksonte se si njerëzit duhet të bëjnë mirë në jetë, të ndihmojnë të tjerët, të jenë të ndershëm e të sinqertë si dhe ndërtojnë besim mes tyre.<sup>100</sup>

Megjithatë, bashkë me këto të mira, sikurse edukimi e socializimi, televizioni krijoi dhe nxiti edhe fenomene jo të mira, sikurse sjelljet anti-shoqërore dhe jo të dëshiruara, duke hapur kështu një betejë që ekziston edhe sot e kësaj dite, mbi etikën, moralin, dhe vetë suksesin e revolucionit televiziv.

Eric Maigret nuk harron të theksojë se televizioni vrau edhe librin, të mësuarit akademik dhe sistematik të njeriut, ndërkohë që shtoi orët e konsumimit para televizorit, ndonjëherë i ndezur *vetëm sa për të bërë zhurmë...*<sup>101</sup>

### 3.1.2 Rritja e medias nga zhvillimet teknologjike

Teknologjia e rriti median duke e bërë edhe atë teknologji më vete! Shpikjet e shumta që njeh njerëzimi, ishin të gjitha fryt i civilizimit në rritje dhe bashkë me të, i arsimimit dhe i përhapjes së dijeve.

Sukseset në fizikë, kimi, përpunimin e fotografisë, shpikjen e elektricitetit dhe elektromagnetikës çuan në një sërë revolucionesh që i përmendëm më sipër, të makinës së shkrimit, telegrafit, telefonit, fotografisë, filmit dhe televizionit, e bënë vetë median një teknologji, një promotor të zhvillimit. Edhe një libër i printuar quhet teknologji më vete, jo vetëm për nga mënyra e tij e printimit, por edhe e nevojës së njerëzimit si dhe ndikimit që printimi, libri, përhapja e dijes patën dhe aktualisht kanë ndaj njerëzimit.

Teknologjia përfshin një grup ose kombinim veglash apo mjetesh të veçanta teknike. Lidhja e tyre në seri dhe vendosja në punë e tyre si një sistem teknologjik bart pikërisht këtë teori, se sikurse teknologjia nxiti median, po aq edhe media përbën teknologji dhe një hallkë të rëndësishme në zhvillimin teknologjik dhe social të njerëzimit.

I tillë ishte edhe telefoni, televizori, pajisje këto të dedikuara teknologjikisht.

Ndërkohë, *interneti* është risia e viteve të fundit që përjetojmë. Edhe për këtë term, botëkuptimi është i gjerë, që nga aspekti teknologjik, ai mediatik, e deri edhe te ai social.

Ka shumë perceptime mbi internetin, por ajo më e shpeshta që dëgjojmë sot është thjesht *rrjetet valor (pa tel)* me të cilët ushqejmë pajisjet tona si kompjuter, telefon të lëvizshëm etj., për të hyrë në botën *në linjë* (on-line) drejt dritareve të tjera të komunikimit, me institucionet shtetërore, me mediat informuese, me njëri-tjetrin për komunikim privat e kështu me radhë.

Në të folur, përdoruesit i referohen shpeshherë si “*po hyj në internet*” kur duan të përdorin shfletues uebi për të nxjerrë informata nga burime të ndryshme *on-line* falë lundrimit në

<sup>100</sup> James H. Wittebols, *Watching M\*A\*S\*H, Watching America: A Social History of the 1972–1983 television series*, McFarland & Company, Inc., Publishers, Jefferson, North Carolina, and London 2003, faqja 155

<sup>101</sup> Eric Maigret, *Sociologjia e Komunikimit dhe e Mediave*, Papirus, Tiranë 2010, faqja 147-149



uebfaqe të shumta. Ueb-et ose uebfaqet janë shërbime të shumta që ofrojnë dokumente të ndërlihdura, *lidhje* (links) që të çojnë te ato, duke ndërtuar kështu rrjete shërbimesh. Vendosja e këtyre rrjeteve, në një rrjet të tërësishëm gjigant, përbën me fjalë të tjera edhe vetë internetin.

Ndërsa, për sa i përket aspektit social, interneti perceptohet si një *Cyberie*, “një fshat planetar” i themeluar mbi lirinë, inteligjencën, njëkohshmërinë dhe vëllazërinë e shkëmbimeve pa kufi. Ai do të nxiste komunikimin ndër-njerëzor, në kushte ose jo anonimati, do i jepte fund hierarkisë shoqërore, do të rriste inteligjencën kolektive,<sup>102</sup> dhe do të *dëmtonte* disi televizionin si një nga mjetet më të fuqishme që mbante mbërthyer njeriun dhe kulturën e masave. Duke na çliruar nga orët para televizorit, gjithsesi njeriu është bërë një “zombie” për kohën që kalon përpara internetit.

### 3.1.2.1 Media dhe zhvillimi i saj falë internetit

Interneti është gjithashtu një teknologji më vete, i cili as që mund të imagjinohej apo shpikëj pa serinë e shpikjeve të mëhershme, veçanërisht të kompjuterëve dhe rrjetëzimit të tyre në shërbim të njeriut.

Kryerja e llogaritjeve ishte qëllimi parësor i krijimit të kompjuterit. Përlllogaritjet në ekonomi, në biznese familjare etj., diktuan nevojën gjithnjë e më shumë të makinave të llogaritjes, për të llogaritur në mënyrë të saktë prodhimin, vlerën e tyre, por edhe për të nxjerrë parashikime për t’i paraprirë lëvizjeve në treg.

Bazuar në parimin e logaritmit<sup>103</sup> të shpikur nga John Napier, u bë më e lehtë mbledhja, heqja, shumëzimi e pjesëtimi. Forma e parë kompjuterike u arrit nga Karl Beibixh në vitin 1834, ndërkohë që shpikja e transistorëve dhe qarqeve të integruara e bënë makinën llogaritëse një kompjuter-paraardhës të kompjuterëve që përdorim sot.

Këta të sotmit janë shumë më të ndërlikuar, me sisteme operative që posedojnë miliona softuerë të cilët i kryejnë shumë shërbime njeriut; shitësit regjistrojnë mallrat, fëmijët luajnë lojëra, njerëzit ndajnë informacione... është ende e pabesueshme se si softuerët që përdorim janë aq të vegjël sa mund të futen në vrimën e gjilpërës, e nga ana tjetër bartin, rezervojnë e përpunojnë aq shumë informacion.

Ndërsa, për sa i përket internetit, sikurse theksojnë studiuesit Asa Briggs dhe Peter Burke, ishte çudi që libri “*The Future of Computing and Communications*” nga universiteti MIT i botuar në fund të vitit 1991, nuk përmendte asnjë fjalë për internetin, për fjalën *World Wide Web* (Uebin mbarë-botëror) apo *krimin kibernetik*.<sup>104</sup> Ishte pikërisht viti i zanafillës së termit *Internet* i cili për nga prejardhja nënkupton *një rrjet global kompjuterik që ofron një gamë të gjerë informacioni dhe komunikimi, duke konsistuar në rrjete të ndërlihdura që përdorin protokolle të standardizuara komunikimi*.<sup>105</sup> Pra, bëhet fjalë për një sistem ose rrjet kompjuterësh që bashkon kompjuterët nga e gjithë bota, në një kompjuter të madh të cilit mund t’i qasemi nga kompjuteri ynë personal.<sup>106</sup> Me këtë duhet marrë parasysh se kompjuterët në rrjet nuk janë dosido, por janë ata nga ministritë, agjencitë, shkollat, bizneset, bibliotekat, gazetatat në linjë, televizionet, etj. Një

<sup>102</sup> Po aty, faqja 300

<sup>103</sup> E. W. Hobson, *John Napier and the invention of logarithms, 1614*, Cambridge University, 1914, faqja 7

<sup>104</sup> Asa Briggs, Peter Burke, *A Social History of the Media, From Gutenberg to the Internet*, Polity Press 2002, faqja 307

<sup>105</sup> Konsulto Fjalorin e Oksfordit në <<https://en.oxforddictionaries.com/definition/internet>>, [26.2.2019]

<sup>106</sup> Asa Briggs, Peter Burke, *A Social History of the Media, From Gutenberg to the Internet*, Polity Press 2002, faqja 421

rrjet i tillë kryqëzon miliona kompjuterë dhe një numër prej trilionësh të dhënash që ndahen në sekondë. Kompjuterët lidhen nëpërmjet një protokollit www (World Wide Web), ndërkohë që për të realizuar kërkesën e një përdoruesi, nevojiten programe specifike kërkimi si dhe motorë kërkimi. Nuk ka të dhëna të sakta se për çfarë përdoren kompjuterët më së shumti, edhe pse praktikisht, qëllimi parësor është ai i komunikimit (email-it), i grupeve të lajmeve (newsgroups) ku përdoruesit informohen, dhe së treti, World Wide Web, që mundëson hiperlidhje të panumërta që na devijojnë ose transferojnë në burime të pafundme.

Interneti, edhe pse në fillim ishte një oqean i rrezikshëm, viteve të fundit është bërë subjekt i shumë *konventave*, jo vetëm të atyre kibernetike për të ruajtur të dhënat personale të përdoruesit (privatësinë e tij), ose që përdoruesi të mos bjerë pre e piratëve kompjuterikë, por edhe e konventave *morale* që kahezojnë përdoruesin se çfarë të klikojë dhe jo, pa u dëmtuar nga aspekti etik e moral. Ofruesit e përmbajtjeve, apo edhe vetë përdoruesit që kanë lirinë e hapjes së blogjeve, i përmbahen rregullave të publikimit, jo vetëm të qeverive të tyre por edhe të vetë uebfaqeve që mundësojnë blogje.

Kjo mundësi e re tashmë e ofruar nga interneti është monetarizuar dhe kërkimi i të dhënave më specifike shpeshherë paguhet. Po ashtu, uebfaqe që ofrojnë lajme ekskluzive (sikurse gazetat) kërkojnë abonim me pagesë. Përveç këtyre formave, thuajse nuk ka asnjë ueb në internet që nuk e bombardon përdoruesin me reklama apo shpallje, prej të cilave nxjerrin fitime dytësore.

Kështu, sikurse shtrihet përdorimi në internet, ashtu artikulohej edhe nevojat e përdoruesit.. dhe ato gjejnë zbatimin më të mirë, falë mundësive të mëdha që ofron interneti, sidomos i lidhur me karakterin e tij si një multimedia që bashkon tingullin, imazhin dhe tekstin...<sup>107</sup>

Nëse ndërlidhemi vetëm me median në internet, duhet të bëjmë një dallim midis ofruesve mediatik ashtu edhe ndaj platformave sociale ku cilido përdorues gëzon të drejtën të shpalosë informata.

Mediat klasike ishin të parat që provuan të kalonin në platformat në linjë, duke tentuar të jenë më afër me lexuesin si dhe të shesin në çast lajmin e tyre të fundit dhe ekskluziv. Kjo formë e re e medias kishte rreziqet e saj. Të frikësura nga tendenca e re *on-line* por edhe probleme të tjera të kostove, mbijetesës financiare e deri te letra, gazetat provuan të shfaqen në internet. Sikundër thotë Ricardo Stagliano, letra kushton por bajtët e diskut kompjuterik, jo!<sup>108</sup> Drejtuesit e gazetave iu përshtatën menjëherë fleksibilitetit të ri që ofronte interneti: jo numër fiks faqesh, arkiv në linjë (lexuesi mund të lexonte edhe tekste të vjetra që gjendeshin në arkivin *on-line*) azhurnim më i lehtë dhe më i shpejt i lajmit, e kështu me radhë.

Po ashtu, gazeta në linjë nuk vuan më nga problemi i shtrirjes gjeografike, duke arsyetuar me plot të drejtë edhe termin "*glokalizim*" ose "*lokalizim global*". Duke ndjekur edhe tendencën në lëvizje të lexuesit, shkrimet u bënë më *pikante* duke dalë nga forma e tyre tradicionale që diktonte letra e shtypur.

Gazetat në linjë në internet gëzojnë përparësinë e klikimit, të ndjekjes, atë të abonimit, të shitjes së hapësirave të tjera me reklama nëpër uebfaqe, e kështu me radhë.

Në shtator të 1994, AOL ofronte 35 gazeta e revista, përfshi Time, Usa Today, The New York Times.<sup>109</sup> Brenda një viti, gazetat filluan t'i përshtateshin edhe sjelljes së abonuesit i cili

<sup>107</sup> Eric Maigret, *Sociologjia e Komunikimit dhe e mediave*, Papirus, Tiranë 2010, faqja 300

<sup>108</sup> Riccardo Stagliano, *Gazetaria 2.0, Të merresh me informacion në kohën e internetit*, Instituti Shqiptar i Medias, faqja 42

<sup>109</sup> Po aty, faqja 19

përveç lajmit, recensionit, temave dhe editorialeve, kërkonte edhe interaksion (ndërveprim), grupe diskutimi për temat, për shfaqjet apo për kohën e lirë. Niveli aktual i pjekurisë së mediave on-line është i lartë dhe idetë e tyre për përfitime ekonomike planifikohen në mënyrë të detajuar.

Në harkun kohor të 2 viteve, numri i mediave në linjë i kaloi 1300 subjektet, vetëm në SHBA. Numri total i gazetave, portaleve, televizioneve, uebsajteve etj., është gjithnjë në lëvizje, por mund të thuhet me miliona. Zyrtarisht, për SHBA-në, 1999-a cilësohet si viti i shkëputjes nga letra.<sup>110</sup>

Në shtete të tjera, kryesisht në Evropë, fenomeni ishte pak më i vonuar, por pa asnjë përjashtim. Është shumë i paktë numri i gazetave që tani ruajnë edhe formën klasike të letrës, ose me një tirazh tepër të ulët.

Në Maqedoninë e Veriut, përveç tendencës së qytetarëve për të lexuar dhe për t'u informuar përmes internetit, problem akoma më i madh ishte ai i financimit. Mosvendosja prej vitesh e një rregullative të qartë financimi, por aty-këtu falë lidhjes me politikën, bëri që mediat e shkruara të shkonin drejt kapitullimit.

Gazetat *Vreme*, *Shpic* dhe *Koha e Re* ishin të parat që përjetuan mbylljen për shkak të presionit politik, pak kohë më vonë nga arrestimi i pronarit të televizionit A1 dhe A2 (Velija Ramkovski).<sup>111</sup> Këto gazeta ishin pjesë e të njëjtit biznes të tij. Pavarësisht arrestimit për evazion fiskal, kjo goditje në media u përfol si presion politik nga partia në pushtet VMRO-DPMNE.

Ndërkohë, në pranverën e 2017-ës, *Vest*, *Utrinski* dhe *Dnevnik* njoftuan shuarjen e tyre pas dy dekadash funksionimi, duke tentuar të rimarrin veten në internet. Por, problemet financiare që në fillim të kompanisë menaxheriale (Media Print-MPM) nuk garantuan sukses, duke lënë në rrugë shumë gazetarë. Ato që mbetën në treg, Nova Makedonija, Sloboden Peçat, Veçer, Koha, Lajm janë në një krizë të vazhdueshme për mbijetesë, pavarësisht daljes së tyre në internet. Në 2019, sërish ndërhyrja politike do të jepte një shpresë për median e printuar, duke subvencionuar gjysmën e shpenzimeve të stampimit dhe distribuimit të tyre.<sup>112</sup>

Me këtë, media tradicionale në Maqedoninë e Veriut është e përgjysmuar dhe drejt kalimit të tërësishëm në internet, fushë kjo po aq e rrezikshme, për shkak se interneti iu jep tashmë njerëzve shumë hapësirë. Edhe një person i vetëm mund të krijojë uebsajt, të bëhet *komunikues masiv*<sup>113</sup> dhe madje, duke gëzuar shumë liri pasi uebsajti personal i anashkalon *gatekeepers*-at, strukturën që kontrollon çdo material jo vetëm nga përmbajtja, por edhe nga aspekti etik, para se të dalë në transmetim të gjërë për publikun.

Në Maqedoninë e Veriut, në kaosin mediatik, ka disa portale që mbahen nga një person. Një fakt i tillë jo vetëm që nxit *personalizimin* (elementi që i bën studiuesit të ngrenë dilema për rrënimin e medias dhe super-segmentimi i shoqërisë)<sup>114</sup> por prodhon edhe të meta të tjera të mëdha. Këto portale një-personësh ndihmohen nga kontribuues të paparaqitur në regjistrin financiar, ndërkohë që shumë prej tyre, në të shumtën e rasteve, i kanë domenet jashtë territorit

<sup>110</sup> Po aty, faqja 162

<sup>111</sup> Europa e Lirë, *Tri gazeta në Maqedoni detyrohen të mbyllen*, <<https://www.evropaelire.org/amp/24253021.html>>, [26.2.2019]

<sup>112</sup> Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Министерот Поповски: Владата на Република Македонија останува посветена на силната поддршка за плурализмот и за обезбедување на средина за одржлив развој на медиумите (Ministri Popovski: Qeveria e Republikës së Maqedonisë mbetet e përkushtuar për një mbështetje të fortë ndaj pluralizimit dhe për sigurimin e një mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm të mediave)*, <<https://vlada.mk/node/16574>>, [26.2.2019]

<sup>113</sup> Asa Briggs, Peter Burke, *A Social History of the Media, From Gutenberg to the Internet*, Polity Press 2002, faqja 51

<sup>114</sup> Eric Maigret, *Sociologjia e Komunikimit dhe e mediave*, Papirus, Tiranë 2010, faqja 56

shtetëror, duke lënë hapësirë të madhe për informata të rreme dhe manipulim të opinionit publik. Mosrespektimi i kritereve bazë të gazetarisë, Kodit Etik të Gazetarisë, apo mosndjekja penalisht e këtyre rasteve (me Ligjin për Përgjegjësi Qytetare për Shpifje dhe Fyerje dhe Kodin Penal) e lënë këtë fushë ende të minuar për nxitje të manipulimeve, por edhe të urrejtjeve ndëretnike.

Parë nga këndvështrimi i përgjithshëm, media on-line duhet ta ketë të qartë se besueshmëria e saj, për shkak të tendencës së klikimit, rrezikohet. Fakti që njerëzit lexojnë gjithçka në internet, (mes të vërtetave, edhe shumë të pavërteta) i detyron ata që të kthehen sërish pranë televizorëve klasik për të konfirmuar vërtetësinë e lajmit. Kontakti direkt me prezantuesin e lajmit është sërish entuziazmues dhe shikimi i drejtpërdrejtë me ta vulos besueshmërinë mes medias dhe shikuesve. Eric Maigret thotë se televizioni i ka rrënjët në rutinën familjare dhe i përgjigjet pritshmërisë për *shoqërueshmëri* dhe për *kulturë* që nuk plotësohen nga interneti. Njerëzit e dëgjojnë televizorin edhe kur flasin mes tyre, kur hanë, lexojnë, hekurosin... madje, televizorin e dëgjojnë edhe ata që në të njëjtën kohë janë duke lundruar nëpër internet.<sup>115</sup>

Pavarësisht të mirave dhe të metave ende të parregulluara në këtë treg të ri shpalosjeje, interneti është dhe do të jetë i tjetërsueshëm. Me pajisjet tona pa tel dhe me komunikimin 4G, 5G etj., si dhe përsosjen e teknologjisë artificiale, interneti po na çon drejt *Evernetit*.... Nuk duhet të habitemi kur kompjuterizimi i një furre do të jetë aq novator sa që vetë furra do të bëjë porosinë e filtrave të saj kur të konstatojë se ata janë afër bllokimit dhe duhen ndërruar.<sup>116</sup>

*Kapitalizmi informativ* dhe *kultura e realitetit virtual* janë të pashmangshme me globalizimin. Rrymat globale rritin flukset financiare duke shkatërruar barrierat kohore e hapësinore dhe duke bërë që marrëdhëniet sociale të çlirohen nga problemi i hierarkisë.<sup>117</sup>

### 3.1.2.2 Rrjetet sociale dhe efekti në ngjarjet politike

Rrjetet sociale, në kuadër të platformave bisedore që lindën me hedhjen e gazetave në linjë, u bënë risia e re e viteve 2000. Të nxitura nga komunikimi dhe komentimi i temave gazetareske, platforma të reja sociale lindën si një urë komunikimi mes qytetarëve, të cilët morën lirinë të shprehnin qëndrimet e tyre, në statuse (qëndrime) në MySpace, Hi5 e më vonë Facebook që pushtoi botën në vitet e tanishme.

Nga etimologjia e fjalës, rrjet social është një rrjet ndërveprimi social dhe marrëdhëniesh sociale. Ai është një sajt ose aplikacion që iu mundëson përdoruesve të komunikojnë ose ndërveprojnë me njëri-tjetrin duke postuar qëndrime si për shembull, informacione, komente, mesazhe, foto etj.<sup>118</sup>

Rangimi i platformave (rrjeteve sociale) është i lëvizshëm, por sipas kërkimeve në internet, rezulton se më i përdorur është Facebook. Edhe blogjet, që lindën si platformë e shprehjes së mendimit të lirë u zbehën sepse Facebook ofron më shumë përparësi ndëraktiviteti, me numrin e lartë të ndjekësve, postimin e lehtë të fotografive, videove, dhe mbi të gjitha, lehtësisë së komunikimit përmes aplikacioneve që mbajmë në telefonat e sotëm celularë (të lëvizshëm).

<sup>115</sup> Po aty, faqja 312

<sup>116</sup> Asa Briggs, Peter Burke, *A Social History of the Media, From Gutenberg to the Internet*, Polity Press 2002, faqja 446

<sup>117</sup> Eric Maigret, *Sociologjia e Komunikimit dhe e mediave*, Papirus, Tiranë 2010, faqja 302

<sup>118</sup> Konsulto fjalorin enciklopedik të Oksfordit në <[https://en.oxforddictionaries.com/definition/social\\_network](https://en.oxforddictionaries.com/definition/social_network)>, [28.2.2019]

Për nga përdorimi i gjerë, është Facebook ai që kryeson me mbi 1 miliard llogari përdoruesish, i ndjekur nga WhatsApp, QQ dhe WeChat (që përdoren gjerësisht në Kinë), QZone, Tumblr, Instagram, Twitter, Google+, Baidu Tieba, Skype, Viber, Sina Weibo, Line, Snapchat, YY, Vkontakto (Rusi), Pinterest, LinkedIn, Telegram, Reddit, Taringa, Foursquare, Renren, Tagged, Badoo, MySpace, Youtube etj.<sup>119</sup>

Por, rrjetet sociale nuk janë vetëm urë komunikimi. Me opsionin e shprehjes së qëndrimeve, rrjetet sociale e kanë bërë qytetarin një qenie politike aktive, i cili promovon organizim (tubim) *politik* mbi fenomene të ndryshme, që nga rastet që e prekin atë në aspektin social, ashtu edhe në atë politik. Qytetarët, jo vetëm që përftojnë dije më të mëdha politike ndaj fenomeneve, por angazhohen dhe ndikojnë ndaj proceseve politike.<sup>120</sup> Pavarësisht se ka ende mëdyshje lidhur me pushtetin politik që iu jep tubimi ose diskutimet e tyre publike mbi politikën, një gjë është e qartë se ata nuk janë më qytetarë të painformuar, përkundrazi, janë qytetarë-politik ose qytetarë-menaxherë (*citizen-governors*).<sup>121</sup>

Në Facebook, rrjetin më të populluar me përdorues, krijohen çdo ditë qindra faqe ose grupe për iniciativa politike ose sociale, ndaj fenomeneve të caktuara shoqërore. Këto iniciativa janë kryekëput politike, edhe pse si grupe interesi askush nga përdoruesit nuk kërkon pushtet politik, por thjesht komenton, jep qëndrime, dënon, kundërshton ose *kahezon* një politikë shtetërore e publike të një shteti të caktuar.

Forma më praktike e presionit politik që vjen nga përdoruesit e rrjeteve sociale është mobilizimi në protesta i qytetarëve (ndoshta jo i mbarë qytetarëve, por të paktën i asaj kategorie qytetarësh që mendojnë njësoj si grupi). Raste të tilla ka me qindra nëpër botë, por ai më domethënës është ai i pranverës arabe. Libia ishte një nga shembujt konkret të mobilizimit qytetar që çuan në rrëzimin e Gadafit.<sup>122</sup> Qytetarët ishin iniciatorët parësorë, të cilët të ndihmuar edhe nga ndërhyrja ndërkombëtare, fituan betejën me regjimin duke e rrëzuar atë brenda disa muajsh. Reagimi qytetar shënoi kulmin kur pikërisht nga rreziku i rrjeteve sociale, qeveria libiane vendosi bllokimin e të gjitha aplikacioneve sociale.

Tubimi qytetar i buruar nga rrjetet sociale preku edhe Francën, shtet me demokraci qindra vjeçare. Vetëm për shkak të rritjes me 10 cent të çmimit të naftës, qytetarët dolën me mijëra në rrugë, duke kërkuar shkarkimin e presidentit, pavarësisht se synimi ishte që shtrenjtimi të nxiste më shumë përdorimin e makinave elektrike.<sup>123</sup> Në Bullgari ndërkohë, i gjithë kabineti qeveritar dha dorëheqjen për shkak të protestave kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike.<sup>124</sup>

Mobilizimi në rrjetet sociale la gjurmë edhe në Maqedoninë e Veriut, me revolucionin shumëngjyrësh. Për muaj të tërë, qytetarët denonconin shpërdorimet që kishin bërë funksionarët e qeverisë Gruevski, duke çuar në një krizë institucionale që për rrjedhojë përfundoi me qeveri

<sup>119</sup> Renditja është nxjerrë nga një artikull social "60+ Social Networking Sites You Need to Know About", <<https://makeawebsitehub.com/social-media-sites/>>, [28.2.2019]

<sup>120</sup> Megan Baker, "The Impact of Social Networking Sites on Politics." The Review: A Journal of Undergraduate Student Research, Published by Fisher Digital Publications, 2009, Article 12 (2009), <<https://core.ac.uk/download/pdf/48615093.pdf>>, [28.2.2019]

<sup>121</sup> Po aty.

<sup>122</sup> Admir Qose, *Ndërhyrja Parandaluese Ndërkombëtare në Libi, Shmangia e Gjenocidit*, Logos-A, Shkup 2015, faqja 203

<sup>123</sup> TvKlan, *Protesta të dhunshme në Francë kundër çmimit të naftës*, <<https://tvklan.al/protesta-te-ne-france-kunder-cmimit-te-naftes/>>, [28.2.2019]

<sup>124</sup> Portalb, *Bullgari, protesta për çmimin e lartë të energjisë, qeveria jep dorëheqje*, <<https://portalb.mk/74776-bullgari-protesta-per-cmimin-e-larte-te-energjisë-qeveria-jep-doreheqje/>>, [28.2.2019]

teknike 100-ditëshe dhe krijimin e Prokurorisë Speciale për hetimin e krimeve (marrëveshja e Përzhinës).<sup>125</sup>

Nuk kanë qenë vetëm të karakterit politik apo ekonomik mobilizimet në rrjetet sociale. Në Maqedoninë e Veriut zunë vend edhe protestat e vazhdueshme për raste të montuara (Monstra)<sup>126</sup> apo raste me epilog të dyshimtë (Almiri).<sup>127</sup> Të dyja këto procese u kthyen në rigjykim për shkak të shkeljeve të shumta procedurale.

Protesta të vazhdueshme shënohen edhe ndaj fenomeneve sociale, sikurse ato të lëvizjes anti-bixhoz<sup>128</sup> që pas një periudhe jo-dëgjueshmërie nga pushteti, e detyruan edhe kryeministrin të ulëj në negociata. Zgjidhje falë ndikimit dhe pushtetit të masës që ofrojnë rrjetet sociale gjetën edhe rastet e shumta me ndotjen (metalurgjiku Jugohrom).<sup>129</sup>

Aq i madh është pushteti i fjalës dhe i mobilizimit që ofrojnë rrjetet sociale, sa që në Maqedoninë e Veriut ndodh që edhe kandidatë për president<sup>130</sup> të shpallin kandidaturën e tyre së pari përmes Facebook, duke kërkuar mbështetje qytetare e politike në zgjedhjen e tyre.

### 3.1.3 Rritja e medias nga ngjarjet e mëdha historike

Ngjarjet e mëdha në historinë e botës bëjnë historinë e njerëzimit. Kjo thënie është tepër e vërtetë, pasi çdo proces politik, social apo ekonomik ka udhëhequr njerëzimit dhe orientuar atë në kahun ku jemi sot.

Bota ka kaluar nëpërmjet një kalvari të gjatë ngjarjesh, dhe nëse kthehemi në kohë, jo vetëm njeriu e ka bërë teknologjinë por edhe teknologjia e ka bërë njeriun. Sociologët shprehin se janë revolucionet ato që e kanë formësuar njeriun, dhe revolucionet nuk ndodhin në mënyrë të rastësishme. *“Nuk ka asgjë më të fortë se sa një ide të cilës i ka ardhur koha”* shkruante Viktor Hygo, shprehje kjo e famshme që është përdorur më së shumti në Francë, por edhe anëmbanë botës, në përpjekjet e njeriut për ndryshime dhe për liri. Idenë nuk e mposhtin dot as ushtritë më të forta të botës, dhe me revolucionin e fjalës së lirë, askush nuk mund të matet.

Të imagjinojmë edhe pushtetin e medias, një instrument kaq i fuqishëm në lëvizjet për ndryshime të njeriut, i cili jo vetëm që është formësuar si qenie, por i ka dhënë formë edhe vetë botës.

#### 3.1.3.1 Media në Luftërat Botërore (Radioja dhe lindja e TV-së)

Ashtu sikurse u përmend më sipër në historinë e instrumenteve të komunikimit (e folura, shkrimi, gravimi, shtypshkrimi, libri, gazeta, fotografia, telegrafi, telefoni, radioja, televizori dhe

<sup>125</sup> SeeNews, *Macedonia's main parties reach crucial agreement to end political crisis, hold elections*, <<https://seenews.com/news/macedonias-main-parties-reach-crucial-agreement-to-end-political-crisis-hold-elections-533464>>, [28.2.2019]

<sup>126</sup> ALSAT, *Sërish protesta kundër rastit Monstra*, <<https://www.alsat-m.tv/38040/>>, [28.02.2019]

<sup>127</sup> ALSAT, *Drejtesi për Almirin, protesta para Prokurorisë*, <<https://www.alsat-m.tv/proteste-ne-shkup-kerkohet-drejtessi-per-almirin/>>, [28.02.2019]

<sup>128</sup> ALSAT, *Zaev priti në takim lëvizjen anti-bixhoz*, <<https://www.alsat-m.tv/zaev-priti-ne-takim-levizjen-anti-bixhoz/>>, [28.2.2019]

<sup>129</sup> ALSAT, *“Dil për ajër të pastër”*, *protesta kundër ndotjes së ajrit në Shkup*, <<https://www.alsat-m.tv/229142/>>, [28.2.2019]

<sup>130</sup> ALSAT, *Presidencialet, Blerim Reka konfirmon kandidaturën e tij*, <<https://www.alsat-m.tv/presidencialet-blerim-reka-konfirmon-kandidaturen-e-tij/>>, [28.2.2019]

së fundi interneti) por edhe në sociologjinë apo ndikimin kulturor të tyre te njeriu, *luftërat* ose *konfliktet, sulmet terroriste, fatkeqësitë natyrore* (tornado e tërmete) dhe *sukseset në hapësirë* (Apollo) kanë qenë nxitëset më kryesore të zhvillimit të medias në botë.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, lajmi, sikurse e njohim në formën e sotme objektive, ishte shumë larg këtij stadi. Kronikanët e kohës, studiues të medias etj., theksojnë se gjatë Luftës së Parë Botërore ishte vetëm *propaganda* ajo që zinte vend në lajme, çdo gjë tjetër ishte e pamundur të perceptohej, përveçse grimcave të vogla kulturore.

Pamfletet, gazetatat, posterat, librat, revistat periodike, madje edhe karikaturat kishin vetëm një qëllim, propagandën!<sup>131</sup>

Nuk ka një prerje të saktë rreth lajm-bërjes së vërtetë në shtete të veçanta, pasi secili prej vendeve kishte thujse të njëjtin problem, të luftonte armikun, pasojat e luftës, të nxiste në rimëkëmbjen e shtetit pas luftës... të gjitha këto bëheshin përmes një propagande tepër të fuqishme.

Ishte shumë i paktë numri i reportazheve sociale, i realitetit të jetës në ato vite. Edhe ato raportime që synonin të reflektonin jetën sociale, kishin të njëjtin konkluzion – luftën dhe mbajtjen lart të moralit qytetar.

Nga lufta 4 vjeçare (1914-1918) mes dy blloqeve, Antantës (Britani, Francë, Rusi) dhe Fuqive Qendrore (Grupit Trepalësh që përfshinte Austro-Hungarinë, Gjermaninë e Italinë), e fituar nga Fuqitë Qendrore, humbën jetën rreth 20 milion njerëz.

Gazetat ishin të pakta dhe të destinuara të mosmbijetonin për shkak të krizës ekonomike ndërkohë që strehim më të sigurt financiar gjetën vetëm ato që u mbështetën qëllimisht nga shteti<sup>132</sup> sikurse *Norddeutsche Allgemeine Zeitung* dhe *Kölnische Zeitung*. Gjermania (pjesë e Fuqive Qendrore) cilësohet si shteti me propagandën më të fuqishme, metodat e zbatimit të së cilës do të zinin vend edhe në librin *Mein Kampf* të Hitlerit në vitin 1925. Ndërsa nga radhët e kampit tjetër, Britania u cilësua për propagandën më të suksesshme.<sup>133</sup> Në SHBA ndërkohë, propaganda ishte një kopje e keqe e asaj britanike, dhe shpeshherë binte ndesh me kulturën amerikane të deri asaj kohe si dhe interesat amerikane.

Në kohën që çështjet etike mbi luftën ishin ende të pakapshme për median e asaj kohe, si radiot dhe televizionet, ashtu dhe gazetatat bënë vetëm raportim të vaktë real. E vërteta e operacioneve ushtarake shpeshherë fshihej (viktimat).

Në studimet e bëra mbi mediat e shkruara britanike gjatë viteve 1939-1945 (*Daily Express, The Daily Mirror, The News of the World, The People dhe The Sunday Express*), të cilat në atë kohë ruanin primatin e informimit, vërehet gjithashtu fakti se si mbijetonin ato vetëm në ujërat e propagandës dhe raportimit të arsyeshëm, që kishin për qëllim mbajtjen lart të moralit qytetar.<sup>134</sup>

Një luftë fjalësh u zhvillua nga viti 1939 deri në 1945 ndërkohë që në vendet demokratike, po aq sa edhe në ato totalitare, mikrofonit u bë një armë e fuqishme.<sup>135</sup> Sikurse theksojnë studiuesit Asa Briggs dhe Peter Burke, në vitet 1930, Hitleri kopjoi Bashkimin Sovjetik

<sup>131</sup> Stephen Badsey, *Propaganda: Media in War Politics*, International Encyclopedia of the First World War, <[https://encyclopedia.1914-1918-online.net/article/propaganda\\_media\\_in\\_war\\_politics](https://encyclopedia.1914-1918-online.net/article/propaganda_media_in_war_politics)>, [1.3.2019]

<sup>132</sup> Po aty.

<sup>133</sup> Po aty.

<sup>134</sup> Portofoli i burimeve digjitale, *Popular Newspapers during World War II*, <[http://www.ampltd.co.uk/digital\\_guides/popular\\_newspapers\\_world\\_war\\_2\\_parts\\_1\\_to\\_5/publishers-note.aspx](http://www.ampltd.co.uk/digital_guides/popular_newspapers_world_war_2_parts_1_to_5/publishers-note.aspx)>, [1.3.2019]

<sup>135</sup> Asa Briggs, Peter Burke, *A Social History of the Media, From Gutenberg to the Internet*, Polity Press 2002, faqja 217

për propagandën, madje shefi i makinerisë së propagandës naziste Goebbels theksonte se radioja e shekullit XX duhet t'i ngjante shtypit të shkruar të shekullit XIX. Fjala e lirë nuk ekzistonte në këto dy shtete, pasi përveç shpëlarjes së trurit nga propaganda, as lajmi real nuk ekzistonte. Kontrolli ndaj medias i detyronte radiot dhe gazetat të flisnin vetëm për apele që iu drejtoheshin aktivistëve partiak.

Në SHBA, shumë më ndryshe nga Gjermania (e Britania), Rusvelti iu drejtohej masës me fjalime periodike por në një formë të veçantë. Ndërsa në Gjermani, Hitleri dhe Josef Goebbels flisnin në distancë nga publiku, duke vendosur altoparlantë të mëdhenj nëpër sheshe e ndërtesa të larta, në SHBA, Rusvelt përdorte formën popullore të komunikimit demokratik me njerëzit, duke hyrë në shtëpitë tyre përmes fjalimeve të përjavshme radiofonike.

Lajmi real, aq shumë i kërkuar, lindi shumë më vonë, pas viteve '50 kur edhe shtetet kishin vendosur paqen dhe filluan të realizonin ëndrrat drejt hapësirës.

Një gjë është e qartë. Përmes peripecive të luftërave dhe propagandës vrastare të fashizmit dhe komunizmit, edhe media mësoi shumë!

### 3.1.3.2 Media pas 11 shtatorit 2001; zhvillimi agresiv post-demokraci

Ngjarjet e 11 shtatorit të vitit 2001 ndryshuan kursin e botës. *Rendi i ri botëror*<sup>136</sup> i shpallur nga Xhorxh Bushi i Vjetër (11 shtator 1990), u vazhdua me shpagimin ndaj amerikanëve - sulmet terroriste të Al Qaida-s ndaj Kullave Binjake dhe Pentagonit, në kohën e Xhorxh Bushit të Ri (11 shtator 2001). Rreth 3 mijë amerikanë mbetën të vrarë kur kamikazët e Al Qaida-s rrëmbyen tre aeroplanë pasagjerësh dhe i përplasën ata me ndërtesat më vitale amerikane, Qendrën Botërore të Tregtisë dhe Pentagonin.<sup>137</sup>

Ngjarjet e 2001-it erdhën tre në një: *tragjedi, rrezik dhe kërcënim i sigurisë kombëtare*.

Nga ana tjetër, në regjistrimet audio që shpaleshin në Al Jazeera dhe letrat e dërguara nga grupi terrorist, Bin Laden theksonte se për sulmet e 11 shtatorit, në kuadër të të ashtuquajturës "*Luftë e shenjtë*" e kishte gjetur frymëzimin të mllëfi ndaj amerikanëve të cilët përziheshin në botën islame duke "*mbështetur*" masakrat ndaj myslimanëve në Somali, Çeçeni, Kashmir, Liban si dhe ndërhyrjen e trupave amerikane në Arabinë Saudite, sanksionet ndaj Irakut si dhe mbështetjen ndaj Izraelit.<sup>138</sup>

Bota u nda....

Bin Laden – i keqi, SHBA-ja dhe aleatët kundër terrorizmit – të mirët!

Ndryshe nga praktikat e deriatëhershme të raportimit mediatic mbi luftërat dhe konfliktet nëpër botë, kësaj here lufta ishte në zemër të vetë SHBA-së. Gazetarët kishin raportuar për luftërat e Vietnamit, ato të Irakut e Afganistanit, duke i gjykuar ato nga këndvështrimi si korrespondentë lufte, dhe duke hequr gjithnjë paralelen e krizave humanitare me atë të të drejtave të njeriut sipas vlerave amerikane.

Përtej raportimit mbi ngjarjet tronditëse, në kaosin e shembjes së kullave, nxjerrjes së viktimave për muaj të tërë nga rrënojat, bllokimin e ekonomisë dhe jetës, gazetarët morën

<sup>136</sup> Qendra Miller (Miller Center) e Universitetit të Virxhinias, *September 11, 1990: Address Before a Joint Session of Congress*, <<http://millercenter.org/the-presidency/presidential-speeches/september-11-1990-address-joint-session-congress>>, [2.3.2019]

<sup>137</sup> CNN, September 11 Terror Attacks Fast Facts (Faktet mbi sulmet e 11 shtatorit 2001), <<https://edition.cnn.com/2013/07/27/us/september-11-anniversary-fast-facts/index.html>>, [2.3.2019]

<sup>138</sup> Bruce Laurence, *Messages to the World, The statements of Osama Bin Laden*, Verso 2005, Londër-Nju Jork, faqja 160



“bekimin” e presidentit amerikan Xhorxh Bush i cili menjëherë i shpalli luftë pa kompromis radikalëve islamikë të Al Qaida-s; *“Our war on terror begins with al Qaeda, but it does not end there. It will not end until every terrorist group of global reach has been found, stopped and defeated”!* (Lufta jonë kundër terrorizmit fillon me Al-Qaida-n, por nuk përfundon këtu. Ajo nuk do të mbarojë deri sa çdo grup terrorist që ka bota, të gjendet, të ndalohej dhe të shpartallohet).<sup>139</sup>

Edhe pse gazetarët duhet të ruanin *gjakftohtësinë dhe objektivitetin në raportim*, kjo nuk ndodhi. Madje, edhe Don Lather, një nga prezantuesit më të njohur për etikën në raportim, në shfaqjen e Davit Letterman theksoi: *President është Xhorxh Bushi... ai i merr vendimet. Unë jam thjesht një amerikan, dhe presidenti kërkon që unë të rreshtohem në një krah.... terroristët janë të këqij, na xhelozojnë!*

Me këtë deklaratë, Lather por edhe gjithë plejada e gazetarëve veçse morën anë...

Gazetaria u nxit në ndjenjat më të larta të patriotizmit ndaj atdheut, sa që në kanalën konservator Fox News ndodhi ajo që zakonisht ishte parë vetëm në lajmet e regjimit të Sadam Huseinit, kur prezantuesit e lajmeve dilnin me pistoletë para kamerave teksa bënë thirrje për luftë ndaj *“pushtuesve amerikanë”*. Fox News, i cili hoqi dorë menjëherë nga forma tradicionale dhe konservatore e lajmeve, duke u privuar nga komentet e lira, lejoi korrespondentin e tij nga Afganistani të thoshte drejtpërdrejtë se *nëse do të gjendej përpara Bin Ladenit, do ta vriste vetë atë*.<sup>140</sup>

Ky polarizim i madh ku çdo lajm reflektonte dozë të *deklaratave patriotike për bashkim dhe qëllime kombëtare*,<sup>141</sup> e kishte bërë tashmë median amerikane *subjekt të kundërshtive*, edhe pse gazetarët tentonin të hiqnin nga vetja vellon amerikane... SHBA gjithnjë ishte akuzuar për pandjeshmëri kulturore ose për politikën e saj të jashtme kundrejt Lindjes së Mesme.<sup>142</sup>

Ndjenja e tillë e paragjyqimit të gazetarëve vinte në rrezik jo vetëm myslimanët që jetonin brenda SHBA-së por edhe jetët e trupave amerikane që gjendeshin në terrene lufte jashtë atdheut.

Ndërsa filloi gjuetia për *“terroristë islamikë”*, media *dështoi* të ofronte një pikëpamje në kontekst dhe me nuanca rreth myslimanëve ose për natyrën e *“rrezikut islamik”* që trumbetonte administrata e Bushit.<sup>143</sup> Në këtë mënyrë, mund të vërehet se media amerikane preferoi ta anashkalonte edhe teorinë e multi-kulturalizmit në trajtimin e realitetit amerikan dhe atë botëror, edhe pse teorikisht e promovonte atë kur bëhet fjalë për imponimin e vlerave amerikane në shtetet arabe.

Edhe studimet e mëvonshme në media, 9 vjet pas ngjarjeve të 2001-it, tregonin se polarizimi qytetar (veçanërisht ndaj emigrantëve ose myslimaneve) i nxitur nga mediat, ishte ende evident. Jo vetëm kaq por... kur myslimanet kërkonin ndërtimin e një xhamie në Nju Jork, mbulimi mediatik nxiti një tjetër efekt të kundërt, atë të një prifti (Terry Jones nga Florida) që shpalli djegien e kuranit (sipas tij, libër me gënjeshtër). Siç vërejnë Barbie Zelizer dhe Stuart Allan, edhe gazetarët ishin të etur të mbulonin planet e tij për të ashtuquajturën *Ditën Ndërkombëtare “Digj një Kuran”* duke e konsideruar si lajm të parë për nga rëndësia.<sup>144</sup>

<sup>139</sup> The Guardian, Text of George Bush's speech (Teksti i fjalimit të Xhorxh W. Bush), <<https://www.theguardian.com/world/2001/sep/21/september11.usa13>>, [2.3.2019]

<sup>140</sup> St. Paul's University, *Le relazioni pericolose: mass media e terrorismo*, Focus On, <<http://www.stpauls.it/pj-online/RUBRICHE/focus-on/2002/genn2002/focus-genn2002a.htm>>, [2.3.2019]

<sup>141</sup> Barbie Zelizer, Stuart Allan, *Journalism After September 11*, Routledge, Londër – Nju Jork 2011, faqja 19

<sup>142</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET PRESS 2010, faqja 625

<sup>143</sup> Po aty.

<sup>144</sup> Po aty, faqja 27

Përveç polarizimit të vetvetes dhe vetë shoqërisë, media u shndërrua në *instrument komunikimi* të dy palëve në këtë luftë të shpallur.<sup>145</sup> Ashtu sikurse Bin Laden apo zëvendësi i tij Mullahu Omar zgjodhën Al Jazeera-n për të shpalosur mesazhet audio të Al Qaida-s, edhe administrata e Bush komunikonte më së shumti me televizionet CNN *International*, Voice of America (edhe BBC si shërbim mediatik i aleatit të saj Britanisë), duke i shndërruar shërbimet ndërkombëtare në altoparlant të luftës verbale. Media nuk kishte shumë mundësi të zgjidhte, pasi ishte politika ajo që diktonte edhe sjelljen mediatike,... jo thjesht kryeredaktorët apo pronarët e mediave.

Studimet flasin se me ashpërsimin e gjuhës verbale, u rrit edhe *gara e sulmeve nga të dyja* palët. Roli i propagandës në media ishte negativ. Al Qaida rriti numrin e sulmeve edhe ndaj civilëve, pavarësisht se fokusi i saj duhet të ishin kryesisht trupat apo bazat amerikane dhe aleatëve. Në 2011, shifrat e civilëve të vrarë ishin gati 80% më të larta nga vitet paraardhëse.<sup>146</sup> Të vendosura në garë për bujë, nga njëra anë Al Qaida për të mbjellë sa më shumë frikë, dhe në anën tjetër SHBA-ja për të promovuar sa më shumë përndjekje ndaj grupeve radikale dhe krehjes së çdo qytetari me prejardhje myslimane, e bënë median *vegël të politikës*.

Primatin që kishin televizionet gjatë sulmeve të 2001, e zunë portalet në vitet e mëvonshme. Forma e re, *E-terrorizmi* siç e quajnë disa studiues, shkoi në një nivel përtej. Qindra uebsajte janë përdorur tashmë nga grupet terroriste jo vetëm për komunikim *luftarak* mes tyre por edhe për promovimin e sulmeve të tyre. Mjaftonte vetëm një klikim dhe sulmet terroriste ishin të qasshme deri te aparatet tona celulare. Një zhvendosje e tillë e vëmendjes nga televizioni te rrjetet sociale, e çliroi disi televizionin nga propaganda por gjithsesi, thelloi krizën etike gazetareske në portale e rrjete sociale.<sup>147</sup>

Portalet (gazetat në linjë) dhe rrjetet sociale përbënë kështu, atë që sot e përkufizojmë si zhvillimin agresiv post-demokraci në historinë e medias. Ishin pikërisht ngjarjet e 11 shtatorit të 2001-it të cilat i dhanë hov portaleve dhe rrjeteve sociale, të cilat Riccardo Stagliano i cilëson si *gazetari personale* (il giornalismo personale).<sup>148</sup> Ajo lindi pikërisht kur njerëz të zakonshëm i shndërruan blogjet dhe uebsajtet e tyre për të raportuar mbi sulmet ndaj kullave binjake, si dhe duke sjellë dëshmi njerëzore, edhe pse qëllimi parësor i blogjeve të tyre kishte qenë krejtësisht tjetër. Duke përdorur bllogjet, por dikush edhe video-kamerat i dhanë zë jo vetëm ngjarjeve të 11 shtatorit, por jetësuan zanafillën e lajmbërjes përmes internetit.

Sikurse theksojnë studiuesit, lehtësia me të cilën publikohen mendimet e tua nuk garanton cilësinë e tyre.<sup>149</sup>

Pjesa më e madhe e shteteve nëpër botë, sikurse u theksua më sipër, nuk e kanë të rregulluar ende këtë revolucion digjital mediatik. Zbatimi i teorisë së vet-rregullimit mediatik varet vetëm nga ndërgjegjja dhe kultura vetjake e zotëruesve të portaleve elektronike.

<sup>145</sup> Për herë të parë shtetet përballëshin me një të keqe, pa entitet – jo një shtet i huaj, por një organizatë ameboide terroriste.

<sup>146</sup> David Bastiani, *Terrorismo e Media, La comunicazione del terrore*, Difesa it, <[https://www.difesa.it/InformazioniDellaDifesa/periodico/periodico\\_2012/Documents/R2\\_2012/36\\_43\\_R2\\_2012.pdf](https://www.difesa.it/InformazioniDellaDifesa/periodico/periodico_2012/Documents/R2_2012/36_43_R2_2012.pdf)>, [2.3.2019]

<sup>147</sup> Adrianna Ciccone, *La sfida del terrorismo ai media e ai social network*, Valigiablue it, <<https://www.valigiablue.it/terrorismo-media-social-network/>>, [2.3.2019]

<sup>148</sup> Riccardo Stagliano, *Gazetaria 2.0, Të merresh me informacion në kohën e internetit*, Instituti Shqiptar i Medias, faqja 180

<sup>149</sup> Po aty, faqja 182

### 3.1.3.3 Media, në garën për ndikim politik të botës perëndimore

Ashtu sikurse kishte njoftuar Xhorxh Bush i Vjetri, rendi i ri botëror i dha një kurs të ri botës. Si një triumf i mbylljes së Luftës së Ftohtë, diskursi amerikan edhe pse u promovua si *shans për gjetjen e mënyrave të reja për të bashkëpunuar me kombet, për zgjidhjen paqësore të kontesteve, për arritjen e solidaritetit kundër agresionit, uljen dhe kontrollin e arsenaleve ushtarake dhe për trajtimin e drejtë të popujve*,<sup>150</sup> nuk ishte punë e lehtë që do të kërkonte vetëm disa vite kohë.

Nga ana tjetër, ngjarjet e 11 shtatorit nga aspekti politik, shënuan një kthesë akoma më të fuqishme, kur shtetet kishin përballë një organizatë terroriste si Al Qaida (pa shtet, pa komb).

Po ashtu, prej vitesh SHBA-ja ishte shndërruar në përkrahësen më të flaktë të teorisë *Responsibility to Protect* (civilians) – në përkthim nga anglishtja (Përgjegjësia për të mbrojtur civilët) që në disa raste i kishte dhënë të drejtën të ndërhynte me operacione ushtarake në shtete të tjera, qoftë edhe pa mbështetjen e Këshillit të Sigurimit të OKB.<sup>151</sup>

Realizimi i kësaj politike ndërkombëtare nuk do të ishte i mundur pa median, që në këtë rast ishin edhe mjetet më të fuqishme të propagandës perëndimore si nxitëse dhe imponuese e këtij diskursi.

Për politikën e veta, SHBA-ja dhe Britania krijuan me plotë fjalën, sistemin e tyre ndërkombëtar të masmedias që i tejkalonte kufijtë kombëtarë, sikurse Zëri i Amerikës dhe BBC me shërbime në gjuhë të caktuara. Këto shërbime u bënë zëri tjetër i qytetarëve, ashtu sikurse e formësonte perëndimi.

Për të gjithë ishte e qartë se radiot ishin qeveritare amerikane e britanike, ose që financoheshin direkt nga Kongresi Amerikan ose Foreign Office (Ministria e Jashtme Britanike). Sipas disa të dhënave, deri para disa vitesh Zëri i Amerikës transmetonte në 40 gjuhë të huaja, ndërsa BBC në 33 gjuhë të huaja.<sup>152</sup>

Përveç lajmeve të paanshme (por me tendencë opozitare ndaj regjimeve në shtetet e huaja), ministritë e jashtme kishin programuar edhe një formë tjetër, atë të fjalimeve të përjavshme të presidentëve ose kryeministrave respektivë të cilët mes të tjerave, iu adresoheshin edhe shteteve të tjera.

Kjo praktikë u zgjatua edhe me shërbime të tjera radio-televizive të shteteve të mëdha, sikurse Deutsche Welle (Vala gjermane) gjithashtu në 30 gjuhë, Radio France International në 20 gjuhë, etj.

Në këtë garë nuk mbetën prapa edhe dy shtetet e tjera anëtare të Këshillit të Sigurisë, Rusia e Kina, të cilat me radiot e tyre plot lajme, komente e analiza bënin *balancë*, si një anti-tezë e propagandës amerikane.<sup>153</sup> Rusia kishte radion *The Voice of Russia* ndërsa Kina kishte *China Radio International* të Kinës.

Por, të pamjaftuar me radiot, shtetet që luftojnë ideologjitë e njëra-tjetrës u zgjeruan edhe me televizione, si CNN International, BBC International, Russia Today etj.

<sup>150</sup> Robert J. McKeever, Philip Davies, *Politics USA*, Toutledge, Londër – Nju Jork 2012, faqja 355

<sup>151</sup> Geneva US Mission, *The U.S. strongly supports the concept of Responsibility to Protect (R2P)*, <<https://geneva.usmission.gov/2012/06/19/the-u-s-strong-supporter-of-the-concept-of-responsibility-to-protect-r2p/>>, 2.3.2019]

<sup>152</sup> Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET PRESS 2010, faqja 624

<sup>153</sup> Po aty, 625

Shtetet ndaj të cilave bëhej kjo shpërlarje propagandistike ishin ato në konflikte, ato që nuk ishin anëtare të NATO-s, shtete me bindje ende komuniste (sikurse Venezuela), shtete me bindje të theksuar fetare (sikurse Irani) etj.

Përveç lajmeve, një ide akoma më pompoze për të imponuar kulturën dhe sportin ishin edhe televizionet muzikore sikurse TVM (akuzuar për imperializëm kulturor), ESPN International për sport etj.

Në karakterin filozofik, mediat perëndimore shpalosin një ndjenjë tjetër mbi gazetarinë, të bazuar te liria e shtypit që njeh të drejtën e medias për të paraqitur ide<sup>154</sup> në përpjekje për të bindur publikun për një pikëpamje të caktuar (nevojat specifike politike dhe ekonomike të publikut), ndërsa ato të tjera, me një stil më të ashpër propagandues (gazetaria në zhvillim e njohur kryesisht në vende me bindje komuniste ose fetare) kanë në linjë të parë informimin me doza propagande, bindjeje dhe edukimi, duke e lënë argëtimin në dorë të dytë.<sup>155</sup>

Në rastin më të fundit të ndërhyrjes ndërkombëtare, Libisë, mediat luanin jo vetëm me propagandën, me tekstet analizuese e deri edhe te pamjet dhe fotografitë. Nga njëra anë, mediat perëndimore tentonin ta paraqitnin sa më dramatike krizën humanitare në Libi (përmes krimeve të dhunës, spastrimit, akteve gjenocidiale etj.) ndërkohë që media ruse numëronte si shkelje çdo lëvizje të forcave aleate në terren, dhe si pengesë e ushtrimit të sovranitetit të vetë nga ana e pushtetit libian.<sup>156</sup> E njëjta situatë me Sirinë, pavarësisht se në mediat properëndimore shfaqeshin raste edhe të përdorimit të gazit helmues ndaj popullatës, lajme këto që nuk dolën asnjëherë në mediat anti-perëndimore.

Një luftë e tillë propagandistike mes mediave ndërkombëtare vazhdon, duke i bërë ato, zgjatim të politikës së shteteve të mëdha, si mjet gare për më shumë ndikim politik.

Një ndikim i tillë preku edhe Maqedoninë e Veriut, veçanërisht pas ftesës si anëtare (fillimisht jo me të drejta të plota) e NATO-s në fazën e saj të referendimit për emrin.

Sipas informacioneve nga struktura të sigurisë, kishte gazeta vendose ose portale që u mbështetën financiarisht nga Rusia për propagandë anti-NATO dhe anti-SHBA, por këto të dhëna nuk u ndanë asnjëherë publikisht për opinionin e gjerë.

Pavarësisht se Maqedonia e Veriut hyri në NATO, rreziku nga influencat e huaja nuk kanë marrë fund, përkundrazi, përmes informatave të nxjerra nga anëtarja më e re, Maqedonia e Veriut, mund të tentohet minimi i strategjive të kësaj aleance.

## 4. KAPITULLI II

### 4.1 Media në periudhën moniste dhe propaganda robëruese

Kur flasim për masmedian duhet të kemi të qartë së pari lidhjen e pashmangshme të medias me politikën... pastaj kur flasim për rastin konkret të Maqedonisë së Veriut, duhet të kemi të qartë se janë suazat specifike politike të një shteti ato që e bëjnë median, ashtu sikurse edhe media që formëson politikën e një shteti të caktuar, si reflektim nga informata kthyesë që merret nga publiku të cilit i ofrohet lajmi.

<sup>154</sup> Po aty, 635

<sup>155</sup> Po aty.

<sup>156</sup> Admir Qose, Ndërhyrja Parandaluese Ndërkombëtare në Libi, Shmangia e *Gjenocidit*, Logos-A, Shkup 2015, faqja 203

Kuptimi i parë i raportit “Masmedia - Politikë” është *vetëqenia politike e medias*. Sikurse arsyetojnë studiuesit e masmedias, çdo organ shtypi edhe kur paraqitet si “i paanshëm” ose si “i pavarur” prapëseprapë përçon një politikë të caktuar shoqërore, ekonomike, kulturore, letrare etj.<sup>157</sup> Duke qenë se media është një pushtet që i ofron publikut në mënyrë të gatshme thelbin e një politike, ajo guxon të japë notën e saj mbi këtë politikë si p.sh. “*politikë e mirë*”, “*politikë e dobishme*”, “*politikë e dëmshme*” ose “*politikë me rrezik social*” etj.

Pra, thënë shkurtimisht, media është po aq e ngjizur nga politika ashtu sikurse vetë njeriu – një qenie politike që e nis ditën me planifikimin se si t’i ofrojë sa më mirë vetes dhe familjes së tij... Edhe media, në këtë vorbull është e pandashme nga politika saqë edhe kur sistemet, strukturat apo rrymat politike ndryshojnë, ajo nuk zhduket por thjesht adaptohet (përshtatet) ashtu sikurse njeriu, dhe në shërbim të njeriut.

Media ka ekzistuar edhe në regjime, junta ushtarake, diktatura, socializëm, kapitalizëm... dhe, me dashje ose pa dashje, ka pësuar ndryshime vetëm për të mbijetuar, por asnjëherë nuk e ka zhbërë lidhjen e saj me pushtetin. Në kushte ideale, media gjithnjë duhet të jetë në raport *konfliktual* (kundërshtues) me shtetin, qeverinë apo elitën drejtuese, sepse siç thekson sociologu Glen Tinde, ushtrimi i pushtetit bart në vetvete joshje, korrupsion dhe shumë të këqija.<sup>158</sup>

Alexis de Tockueville, diplomat dhe shkencëtar politik francez, theksonte se sa pushtet ka media... Duke iu referuar gazetës së viteve 1800, ai thoshte se “*askush tjetër përveç gazetës nuk mund të ngulitë të njëjtin mendim përnjëherësh në mijëra koka njerëzish. Ajo është si një këshilltar që nuk ke nevojë ta kërkosh, por që vjen vullnetarisht, me pëlqimin e vet, dhe të flet shkurtimisht për të rejat e përditshme, begatinë e përbashkët, pa të të shpërqendruar nga punët e tua të përditshme.*”<sup>159</sup>

Roli aktual (në ditët e sotme) i medias pluraliste është shumë herë më i madh, dhe jo më kot cilësohet si *pushtet i katërt* pas pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe atij gjyqësor. Qëllimi primar i medias është që të korrigjojë pushtetet e tjera, ndërsa me diktatin e plotfuqishëm profesional, të ndikojë qoftë drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë ndaj tyre.

Gjithsesi, siç pranojnë edhe vetë studiuesit, nëse pushtetet e tjera janë të kalbura, sigurisht që edhe media do të notojë në të njëjtat ujëra, dhe gazetarët nuk kanë zgjedhje tjetër veçse të bien në grackën e ngritur për ta.. të bëhen “*djaj të nevojshëm*” në shërbim të politikës.<sup>160</sup>

Kështu, sikurse ndryshon sistemi politik apo marrëdhënia ndër pushteteve të numëruara më sipër, ashtu ndryshon edhe struktura e opinionit publik e si rrjedhojë, edhe vetë medias (dhe anasjelltas). Për median bëhet shumë e vështirë që ajo të luajë rolin e saj dhe të bartë me krenari epitetin si *pushtet i katërt*.

Sikurse u theksua në kapitullin e mësipërm, media ka kaluar në kalvarët e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore duke u penguar në zhvillimin e saj, por njëkohësisht duke *u përshtatur* dhe *riformësuar* sipas kushteve politike, ekonomike e shoqërore të shteteve të caktuara.

Gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore media ishte ende e vaktë dhe nuk zhvillohej njësoj sikurse në SHBA (shtypi dhe radioja lulëzonin veçse në SHBA, Britani, Francë, Itali etj.). Bota u nda për shkak të bindjeve të ashpra politike, regjimit komunist, atij fashist dhe pjesës tjetër të botës që cilësohej si *kapitaliste*. Njëri bllok ishte ai mes Gjermanisë, Italisë e Japonisë

<sup>157</sup> Hamit Boriçi, Bashkim Gjergji, Genc Tirana, Sadri Ramabaja, *Gazetaria (Njohuri të përgjithshme)*, Libri Universitar, Tiranë 2003, faqja 51

<sup>158</sup> Po aty, faqja 55

<sup>159</sup> Elliot King, Jane Chapman, *Key Readings in Journalism*, Nju Jork 2012, faqja 332

<sup>160</sup> Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara, *Gazetaria profesionale dhe vet-rregullimi, media të reja - dilema të vjetra në Evropën Juglindore e Turqi*, UNESCO 2010, faqja 60

(Boshti Nazist) ndërsa blloku tjetër, mes SHBA-së, Britanisë, Francës (Aleatët). Pas prishjes së marrëveshjes për mossulmim, Rusia iu hakmor Gjermanisë duke e çuar në kapitullim, e ndihmuar edhe nga fakti se Italia ia kishte kthyer veçmë shpinën Gjermanisë dhe ishte bërë me Aleatët.<sup>161</sup>

Bota e re pas Luftës së Dytë pasoi me bindjet komuniste dhe ato perëndimore, duke startuar edhe luftën e radhës, atë të heshtjes, Luftën e Ftohtë. Me hyrjen e Gjermanisë Perëndimore në NATO,<sup>162</sup> Rusia udhëhoqi bllokun e ashtuquajtur *Pakti i Varshavës*,<sup>163</sup> një marrëveshje kjo e firmosur me shtetet satelite të saj të Evropës Juglindore në vitin 1955 në Poloni (që reflektonte simbolikën e fitores - pasi Polonia u pushtua e para nga Gjermania në Luftën e Dytë Botërore dhe po ashtu, ishte shkaku i fillimit të luftës). Në anën tjetër, pjesa properëndimore e Evropës kishte nisur rimëkëmbjen veçse që prej vitit 1948 nën frymën e *Planit Marshall* (që synonte jo vetëm rimëkëmbjen ekonomike, por edhe kundërpërgjigjen ndaj komunizmit në Evropë si dhe shtimin e radhëve të NATO-s në 1949).

Për të ruajtur një disiplinë ndaj regjimit komunist apo socialist në të gjitha shtetet e Paktit të Varshavës, u udhëhoq një frymë e ashpër propagandistike të cilën vetëm media mund ta përcillte më së miri te publiku. Ndryshe nga pjesa perëndimore e Evropës, media u zhvillua më e lirë madje me një frymë më argëtuese (për të cilën do të flasim më poshtë).

Historia e medias është aq e thjeshtë në këtë periudhë, saqë mund të thuhet se për të mbijetuar, shansi i saj i vetëm ishte ai i përshtatjes me politikën.

#### 4.1.1 Historia e komunikimit masiv të Maqedonisë së Veriut nga zanafilla

Përpara se të flasim për median në periudhën moniste ose totalitariste, pjesë e të cilës ishte edhe Maqedonia e Veriut, Shqipëria e shumë vende të tjera socialiste, le të hedhim një sy mbi zanafillën e komunikimit masiv të Maqedonisë së Veriut.

Historia identitare dhe shtet-formuese e maqedonasve i ndan në qëndrime studiuesit, veçanërisht ata të shkencave politike. Ka një vello që e mjegullon këtë çështje, sidomos duke marrë parasysh edhe ngjarjet e dekadës së parë të shekullit XXI kur pushteti i VMRO DPMNE-së këmbëngulte në theksimin e identitetit kombëtar, duke e cilësuar Aleksandrin e Madh<sup>164</sup> (323-

<sup>161</sup> R. A. C. Parker, *The Second World War: A Short History*, Oxford 1989, faqja 209

<sup>162</sup> NATO, “*A short history of NATO*”, Uebfaqja e NATO-s, <[https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified\\_139339.htm](https://www.nato.int/cps/en/natohq/declassified_139339.htm)>, [5.3.2019]

<sup>163</sup> UN, *Teksti i Paktit të Varshavës*, Koleksioni i Traktateve të Kombeve të Bashkuara, <<https://treaties.un.org/doc/Publication/UNTS/Volume%20219/volume-219-I-2962-Other.pdf>>, [5.3.2019]

<sup>164</sup> Qeveritë e asaj kohe (VMRO DPMNE-PDSH në 2006-2008) dhe (VMRO DPMNE-BDI në 2008-2015) mbështetën një fushatë të gjerë për antikuizimin e vendit dhe miratuan segmentet e para të projektit të *Maqedonisë Antike*. Pavarësisht reagimeve të ashpra, së pari për uzurpim të antikitetit grek dhe historisë bullgare, për dëmtim të buxhetit të shtetit, për monoetnizëm në kurriz të shqiptarëve etj., në qendër të Shkupit u ngrit edhe përmendorja e Aleksandrit të Madh, pavarësisht se zyrtarisht u quajt “Борин на коњ” (Luftëtari mbi kalë). Ajo kushtoi gati 10 milion euro ndërkohë që gjithë projekti numërohet sot në afërsisht 700 milion euro. I parashikuar për 80 milion euro, deri në vendosjen e qeverisë teknike (janar 2016) VMRO-ja e çoi këtë shifër në 580 milion euro. Duhet të theksohet se disa vendime ishin marrë që gjatë qeverisjes me PDSH-në dhe pjesa tjetër u vazhdua me BDI-në. Projekti synohej të përmbyllej brenda vitit 2014 por ndërtimi i disa objekteve ende vazhdon edhe sot. Porta3, *Цена на за „Скопје 2014“ е точно 700 милиони евра! (Kostoja e “Shkupi 2014” është fiks 700 milion euro)*, <<https://www.porta3.mk/cehot-za-skopje-2014-e-tochno-700-milioni-evra/>>, [5.3.2019]

356 p.e.s.) si heroin e vet, edhe pse fama e tij i ndesh edhe grekët ashtu edhe shqiptarët (që e thërrasin Leka i Madh).<sup>165</sup> Një pjesë këmbëngulin se shteti filloi me sundimtarin Car Samuili (958-1014) i pretenduar si figurë edhe nga bullgarët; një pjesë tjetër thonë se shteti lindi me Kryengritjen e Ilindenit (1903); të tjerë thonë se shteti i mirëfilltë lindi pas referendumit për ndarjen nga Ish Republika Socialiste Federative Jugosllave (që përbëhej deri asokohe nga 6 republika dhe 2 krahina).<sup>166</sup>

Maqedonia e Veriut ishte i vetmi shtet që u nda në mënyrë paqësore nga RSFJ-ja. Me 25 ndryshimet kushtetuese të vitit 1990, Maqedonia e Veriut shënoi fillimin e tranzicionit politik drejt sistemit të ri parlamentar dhe drejt krijimit të shtetit sovran dhe të pavarur. Mes të tjerash me amendamentet kushtetuese mundësohet pluralizëm politik dhe pronësor.<sup>167</sup> Një vit më vonë u vendos për referendumin me pyetjen “*A jeni për shtetin e pavarur dhe sovran të Maqedonisë me të drejtë për t’u përfshirë në aleanca të ardhshme të shteteve sovraane të Jugosllavisë?*”. Kjo pyetje ende iu linte një shpresë të vaktë qytetarëve se gjoja Jugosllavia do të ekzistonte në një farë forme si në kohën e Titos.

Referendumi, megjithatë, u bojkotua nga shqiptarët për shkak të injorimit të kërkesave të tyre për barazi. Kushtetuta e re e shpallte gjuhën maqedonase dhe shkrimin cirilik si gjuhën e vetme zyrtare në Republikë dhe *nuk bënte referencë të përdorimit të shqipes në Parlament*.<sup>168</sup> Pavarësisht se neni 8 i Kushtetutës garantonte “të shprehurit të lirë të përkatësisë kombëtare”, përfshi edhe përdorimin e flamujve<sup>169</sup> dhe simboleve të tjera (për përdorim lokal në komuna), prapëseprapë *flamuri shqiptar kontestohet për nga madhësia*. Këto çuan në protesta e përlëshje policore.

Diskriminimi vazhdonte edhe në rrafshin social me padëgjueshmërinë e shtetit për lejimin e *të drejtës së studimit në gjuhën amtare*, ndërkohë që një pjesë e tyre nuk gjetën zgjidhje edhe pas konfliktit të vitit 2001 dhe Marrëveshjes së Ohrit. Njohja e elementit shtet-formues të shqiptarëve as sot e kësaj dite nuk mund të zyrtarizohet me akt në Maqedoninë e Veriut. Populli shqiptar në Maqedoninë e Veriut, meqenëse i plotëson të gjitha karakteristikat e një kombi, e

<sup>165</sup> Edhe historianët shqiptarë pretendojnë se Leka i Madh është me prejardhje ilire. Madje, ata thonë se gjatë fitoreve, Leka i Madh këndonte në një gjuhë që asnjë tjetër nuk e kuptonte, duke pretenduar se ai këndonte në ilirishte.

Naim Flamuri, Sami Flamuri, *E përjetshme është Shqipëria, bisedë rreth të drejtës mbi kombin më të vjetër në Evropë, popullin shqiptar*. Shtëpia Botuese Naim Frashëri, 1999, faqja 66

<sup>166</sup> Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Formimi, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit demokratik*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 73

<sup>167</sup> Kuvendi i Maqedonisë së Veriut, *Historia e Parlamentarizmit në Maqedoninë e Veriut*,

<<https://www.sobranie.mk/content/%D0%9F%D0%B0%D1%80%D0%BB%D0%B0%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82%D0%B0%D1%80%D0%B5%D0%BD%20%D0%B8%D0%BD%D1%81%D1%82%D0%B8%D1%82%D1%83%D1%82/%D0%98%D1%81%D1%82%D0%BE%D1%80%D0%B8%D1%98%D0%B0%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%BF%D0%B0%D1%80%D0%BB%D0%B0%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82%D0%B0%D1%80%D0%B8%D0%B7%D0%B0%D0%BC-ALB.pdf>>, [5.3.2019]

<sup>168</sup> Aisling Lyon, *Decentralization and the Management of Ethnic Conflict: Lessons from the Republic of Macedonia*, Routledge 2016, Nju Jork, faqja 34,

<<https://books.google.mk/books?id=JKXhCgAAQBAJ&pg=PA33&dq=Macedonia+Constitution+of+1991+ignored+by+albanians&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwjBio-DzJXhAhXHeZoKHSeqB68Q6AEILjAB#v=onepage&q=Macedonia%20Constitution%20of%201991%20ignored%20by%20albanians&f=false>>, [5.3.2019]

<sup>169</sup> Kuvendi i Maqedonisë së Veriut, *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë 1991*, <<https://www.sobranie.mk/kushtetuta-e-rm-s.nspix>>, [5.3.2019]

gëzon edhe të drejtën për vetëvendosje, si e drejtë e tij e pamohueshme që të caktojë fatin e vet brenda Maqedonisë së Veriut.<sup>170</sup>

Autoritetet maqedonase nuk do të lejonin asnjëherë të humbisnin atributin e tyre si zotër të pushtetit, dhe këtë do ta bënin përmes edhe përbuzjeve të tilla sikurse “*shqiptarët kishin zbritur nga mali*” (planinci) – sipas enciklopedisë së tyre – dhe madje, të ngulitnin në opinion teorinë se “*maqedonasit janë autoktonët e këtyre trojeve*”.<sup>171</sup>

Kur flitet posaçërisht për identitetin, pretendimet bëhen akoma më të vrazhda pasi ajo që thoshte në vitin 1992 ish presidenti Kiro Gligorov se “*maqedonasit janë sllavë të ardhur në shekullin VI*”<sup>172</sup> dhe nuk kanë të bëjnë aspak me Aleksandrin e Madh”, u zhbë nga pushteti i Nikolla Gruevskit që pretendonte tezën e antikitetit se “*maqedonasit e sotëm të Maqedonisë së Veriut janë po aq antikë sa vetë Maqedonia e lashtë*”, duke u shtyrë në garë me grekët dhe duke pretenduar uzurpim të historisë së vjetër. Të pyesësh sot për çështjen e identitetit, ndërton një realitetet të ri. Pas Marrëveshjes së Prespës me të cilën *Maqedonia* e deridjeshme hoqi dorë nga emri i saj duke u cilësuar Maqedonia e Veriut,<sup>173</sup> janë lënë mënjanë edhe pretendimet për përkatësinë e Aleksandrit të Madh, emri i të cilit u hoq si nga aeroporti ashtu edhe nga autostrada që të çon në të. Së fundi, edhe emrat e institucioneve u ndryshuan ku përcaktori *македонскиот/македонската* (përkth. *maqedonas/maqedonase*) i vendosur para çdo emërtimi, doli në fund të emërtimit me lidhëzën “*на Северна Македонија*” (përkth. *i/e Maqedonisë së Veriut*).

<sup>170</sup> Mersim Maksuti, *Aspekti juridiko-kushtetues dhe politik i statusit shtet-formues të popullit shqiptar në Maqedoni*, Logos-A 2005, Shkup-Prishtinë-Tiranë, faqja 149-151

Maksuti e legjitimon të drejtën e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut për vetëvendosje në rezolutën e OKB-së të vitit 1952 (E drejta e popujve dhe kombeve për vetëvendosje), rezolutën e OKB-së të vitit 1960 (... të gjithë popujt kanë të drejtë për vetëvendosje... dhe të vendosin lirshëm për rregullimin e vet ekonomik, shoqëror e kulturor), deklaratën për arritje të pavarësisë (të gjithë popujt kanë të drejtën për vetëvendosje dhe të gjitha mjetet represive duhet të pezullohen në mënyrë që popujt të lihen në paqe dhe lirshëm të realizojnë të drejtën e tyre për pavarësi të plotë), deklaratën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së të vitit 1970 për marrëdhënie miqësore mes shteteve, paktin e OKB-së për të drejtat qytetare dhe politike të vitit 1966, konstatimin se Jugosllavia e asaj kohe ishte produkt i një kontrate që u prish dhe gjithë popujt e tjerë fituan të drejtën për vetëvendosje, konstatimin se në Maqedoninë e Veriut zbatohet sistemi i margjinalizimit, kontrollit dhe pengimit të zhvillimit të shqiptarëve, konstatimin se pushteti në Maqedoninë e Veriut nuk i përfaqësonte shqiptarët etj.

<sup>171</sup> Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, Studime Albanologjike, Volumi 4, Shkup 2011, Kristo Frashëri, *E vërteta mbi shqiptarët e Maqedonisë dhe shtrëmbërimet e Enciklopedisë së Shkupit*. Sipas Enciklopedisë Maqedonase të vitit 2009 bazuar kryesisht në veprën e Hristo Andonov Polljanski, “*Shtojcë mbi marrëdhëniet maqedono-shqiptare në të kaluarën*”, kolonizimet shqiptare në Maqedoni janë regjistruar kryesisht pas shekullit XVI. Janë dyndur heshtazi kur tashmë ishin të islamizuar. Dyndjet përfituan nga tollovia e shekullit XVIII, kur feudalët shqiptarë vepronin për pavarësinë e tyre nga pushteti qendror dhe përpiqeshin për zgjerimin e tyre edhe në Maqedoni... Periudha e dytë e kolonizimeve të dhunshme shqiptare në viset maqedonase ndodhi në fillim të viteve ‘40 të shekullit XIX, pra në vitet e Tanzimatit. Këtë radhë, "ardhacakët" shqiptarë erdhën nga Elbasani, Luma dhe Mati, por edhe nga Korça e gjetkë. Vala e tretë e kolonizimit ka ndodhur në fillim të shekullit XX, kurse vala e fundit, e katërta e kolonizimit shqiptar të Maqedonisë ka ndodhur pas vitit 1944....

<sup>172</sup> Kiro Gligorov, ish president i Maqedonisë nga 1991 deri në 1999 thekson qartë se maqedonasit janë sllavë, të ardhur në shekullin XI dhe nuk kanë asnjë lidhje me Aleksandrin e Madh. Ai e bëri këtë deklaratë disa herë, në media dhe në OKB, ku theksoi “*Ne jemi maqedonas, por jemi sllavo-maqedonas. Këta jemi. Ne nuk kemi lidhje me Aleksandrin e Madh dhe Maqedoninë e tij. Maqedonasit e lashtë nuk ekzistojnë më. Ata janë zhdukur nga historia prej shumë kohësh. Paraardhësit tanë erdhën këtu në shekullin V dhe VI (të erës sonë)*”.

Ljupco Mircevski-Trepet, *My fight for Macedonia*, Shkup 2013, faqja 311, si dhe intervistën e Gligorov për mediat, <<https://www.youtube.com/watch?v=9opi-M9E37A>>, [10.3.2019]

<sup>173</sup> Qeveria e Maqedonisë së Veriut, *Marrëveshja finale për zgjidhjen e kontestit maqedono-grek për emrin dhe për partneritet strategjik*, <<https://vlada.mk/mkgrdogovor>>, [10.3.2019]



Kur flasim në prizmin e komunikimit masiv të Maqedonisë së Veriut (referuar gjeografikisht me emrin e ri), duhet të kthehemi po aq herët në mesjetë për t'u ndërlidhur me historinë dhe gjuhën e sllavëve. Historia e këtij komunikimi fillon me alfabetin cirilik të dy vëllezërve Kiril dhe Metodij në vitin 863.<sup>174</sup> Dy misionarët e shquar bizantinë krijuan shkrimin në bazë të fonetikës së gjuhës sllave dhe shumë shpejt e vunë në përdorim atë, në shkrimin e librave të shenjtë. Shkrimi cirilik u njoh zyrtarisht nga Kisha përkrah shkrimit latin, grek dhe atij hebraik.

Elemente të para të gjuhës popullore maqedonase hynë vonë në shkrimin cirilik, diku nga shekulli VI, pasi deri në atë kohë mbizotëronte alfabeti i parë gllagolik me tone të sllavishtes së vjetër.

Pasuesit e Kirilit dhe Metodijit, Klimenti dhe Naumi, vetëm në harkun kohor të 30 viteve të ardhshme do të nxirrnin nga shkolla gllagolike e Ohrit diku 3 500 kuadro mësonjëtorësh, priftërinjësh, gjuhëtarësh dhe veprimtarësh kulturorë.<sup>175</sup>

Kthesë në historinë e komunikimit do të bënte libri i parë i shkruar në maqedonisht, pas gati 7 shekujsh nga shpikja e alfabetit. Libri i parë erdhi në 1814 nga Joakim Kërçovski. Po ashtu, shtypshkronja e parë maqedonase u hap në Selanik ndërsa librat e parë të shtypur dolën në vitin 1838.

Vitet	Gurthemet e komunikimit masiv të Maqedonisë së Veriut
863	Vëllezërit Kiril e Metodij shpikën alfabetin e parë cirilik gllagol <sup>176</sup>
893	3500 priftërinj dalin nga shkolla e Ohrit, nga pasuesit Klimenti dhe Naumi
1814	Libri i parë në cirilik nga Joakim Kërçovski
1816	Libri i dytë në cirilik nga Kiril Pejçinovski
1837	Në Veles hapet mësonjëtorja e parë në maqedonisht
1838	Hapet shtypshkronja e parë maqedonase në Selanik, prej nga dolën librat e parë të shtypur në cirilik
1852	Dalin vargjet e para në gjuhën maqedonase
1857	Partenie Zografski nxori abetaren e tij “Начелное учение за децата” (Edukim i përgjithshëm për fëmijë)
1858	Antonio Zografski nxori librin “Кратка свјазитена историја” (Histori e shkurtër fetare)
1858	Anatolij Zografski nxori përpunimin e parë filologjik në gjuhën maqedonase.
1878	Botohen gazetata e para nga emigrantë maqedonas në Bullgari
1878	Gjorgjija Pulevski nxjerr poemën “Самовила македонска” (Zana maqedonase)
1879	Pulevski nxjerr veprën dy-volumesh “Македонска песнарка” (Këngët folklorike maqedonase) dhe përmbyll pjesën e parë të gramatikës së tij “Словница речовска”
1903	Në Sofje botohet libri i parë në gjuhën bashkëkohore maqedonase “За македонските работи” (Për çështje maqedonase) nga Kërste Misirkov <sup>177</sup>

<sup>174</sup> Dona Kolar Panova, *Историја на масовните комуникации (Historia e komunikimit masiv)*, Ligjërata të autorizuara, Shkup 2007, faqja 124

<sup>175</sup> Po aty, faqja 125

<sup>176</sup> Dona Kolar Panova, *Историја на масовните комуникации (Historia e komunikimit masiv)*, Ligjërata të autorizuara, Shkup 2007, faqja 124-126

<b>1905</b>	Misirkov boton revistën e parë shkencore “ <i>Вардар</i> ” (Vardar).
<b>1913</b>	Fotografia e parë me ngjyra nga Dimitrija Çupovski, në Rusi
<b>1944</b>	Kuvendi i Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare maqedonase vendoset zyrtarisht që maqedonishtja të jetë gjuha e maqedonasve
<b>1945</b>	Bëhet kodifikimi i gjuhës letrare maqedonase (standartizimi)

FIGURA 1. GURTHEMELET E KOMUNIKIMIT MASIV TË MAQEDONISË SË VERIUT

Kthesë të re në historinë e komunikimit masiv të maqedonasve të veriut do të përbënin gazetatat dhe revistat e para, të botuara nga emigrantët maqedonas në Bullgari, ajo e fotografisë së parë me ngjyra nga Çupovski, zyrtarizimi i vetë gjuhës maqedonase nga Kuvendi i Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare Maqedonase si dhe kodifikimi i saj në vitin 1945. Deri në këtë periudhë, veçse më ishte krijuar një fond voluminoz i materialeve gjuhësore, përfshi edhe gazetatat “*Илинденски пат*” (Rruga e Ilindenit), “*Млад борец*” (Luftëtari i ri) etj.

#### 4.1.2 Zhvillimi i medias në ish vendet e njëmendësisë; BRSS, Jugosllavi, Shqipëri

Siç u theksua më sipër, në shtetet ku menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore u instalua sistemi komunist, media nuk kishte fat tjetër veçse atë të njëmendësisë dhe propagandës totalitare për të trumbetuar *forcën e masave* dhe për të jetësuar *idealet* e Marksit, Engelsit, Leninit e më vonë edhe Stalinit.

Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike, Republika Socialiste Federative Jugosllave por edhe Shqipëria ishin pjesë e të ashtuquajturit *Blloku Lindor*. Këto vende, kush më herët e kush më vonë - varësisht braktisjes së bllokut - morën mjaftueshëmtribute nga ashpërsia e sistemit komunist.

Në nënkapitujt e mëposhtëm do të mësojmë për propagandën, sistemin hierarkik të propagandës, strukturat shtetërore dhe kornizat ligjore me të cilat shtetet ushtronin propagandën dhe dënonin cilindo që mendonte ndryshe nga partia-shtet. Po ashtu, do të shohim ndikimin e drejtpërdrejtë të udhëheqësve komunistë, të cilët impononin lidhjen e patjetërsueshme të shtetit me median, si një detyrim moral (të pashkruar) ndaj tij, si dhe lidhjen me masat e gjera popullore të cilat duhet të ishin doemos në *të njëjtën vijë* me partinë.

##### 4.1.2.1 Agit-Prop i Bashkimit Sovjet dhe “Pravda” e kultit stalinist

Fryma komuniste në BRSS në fakt ishte ngulur që prej Luftës së Parë Botërore. Komunizmi i Leninit lulëzoi që në vitet e Luftës së Parë Botërore me Revolucionin e Tetorit.<sup>178</sup> Gazeta *Pravda* (Drejhtësia) u themelua në vitin 1912 nën direktivat e Leninit, me qëllim forcimin e bolshevizmit. Për dy vite me radhë, deri në vitin 1914, Lenini ishte vetë drejtues i saj.<sup>179</sup> Së

<sup>177</sup> Ka studiues që këmbëngulin se pikërisht libri i Kërste Misirkovit “*За македонските работи*” (Për çështje maqedonase) është edhe libri i parë i shkruar në gjuhën maqedonase. Të gjitha librat e mëparshëm, siç u theksua edhe më sipër, ishin shkruar në gjuhën e vjetër sllavo-maqedonase - më e afërt me bullgarishten e sotme.

<sup>178</sup> Etem Aziri, *Sistemet politike*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 458

<sup>179</sup> Ludmila Pöppel, *The rhetoric of Pravda editorials: A diachronic study of a political genre*, Stockholm U. 2007, faqja 47

bashku me *Izvestia* (Raporti), këto dy gazeta përbënin zërin kryesor të *partisë-shtet*, njëra - zëri i partisë dhe tjetra - zëri i qeverisë. Në to punonin kuadro të arsimuar universitarë dhe specialistë, por të gjithë ishin të angazhuar ideologjikisht në parti.<sup>180</sup>

Kishte edhe gazeta të tjera ose revista periodike, por asnjë prej tyre nuk përbënte dallim. Të gjitha kishin në qendër *propagandën uniforme të njëmendësisë*. Pas tyre qëndronte shteti dhe *klasa punëtore* që promovonte forcën e *draprit dhe çekanit*. Studiuesit kanë vërejtur se përgjatë gjithë viteve të komunizmit, *Pravda* udhëhiqej nga një bord redaktues që kishte marrë pëlqimin e Komitetit Qendror të Partisë, ndërkohë që kryeredaktor ishte një anëtar i vetë këtij Komiteti.<sup>181</sup>

Pavarësisht se pjesa më e madhe e informimit një-mendjesor bëhej në gazeta, edhe radioja ishte një mjet që nuk mund të nënvlerësohej. Radioja në Bashkimin Sovjetik u zyrtarizua në vitin 1924. *Radio-Moska*, në kuadër të propagandës së saj drejtuar jashtë territorit të Rusisë, filloi transmetimin e saj në disa gjuhë të botës.<sup>182</sup> Deri në vitet 1970, diapazoni shtrirës i saj shkoi në 64 gjuhë transmetimi, ndërkohë që shtrirja e mëvonshme falë transmetuesve në Evropën Lindore, Kubë, Amerikën Latine, Afrikë e Azi i kaloi 70 gjuhët e transmetimit (përfshi edhe në gjuhën shqipe).

Pavarësisht se Radio-Moska mbeti si radio me synim jashtë vendit, 4 kanale të tjera përbënin propagandën vendore dhe orientimin popullor; kanali 1 kishte lajme shtetërore dhe disa programe kulturore<sup>183</sup> ndërsa kanalet e tjera synonin rininë, muzikën patriotike ruse, zërin sindikal, komentet pro-shtetërore mbi ekonominë dhe politikën - si dhe një kanal tjetër me muzikë klasike dhe edukuese.

Po ashtu, edhe televizioni i cili nisi transmetimet në vitin 1934 (bardhë e zi) dhe në 1967 (me ngjyra) i përkiste kryekëput regjimit socialist. Pavarësisht se kishte gjithsej 6 programe televizive, ato përdorshin për transmetim me orar të caktuar në gjuhët rajonale, ndërsa pjesa tjetër kishte të njëjtën pasqyrim sikurse radiot. Madje, në vitin 1970, si radioja ashtu edhe televizioni u vendosën nën të njëjtin komitet kontrolli - Komitetin e Radios dhe Televizionit Shtetëror (Gosteleradio), nën Byronë ose Këshillin e Ministrave.<sup>184</sup>

Bolshevikët e mbajtën kontrollin e medias deri në vitin 1991 me të njëjtën frymë socialiste. Madje, edhe kur Gorbaçovi erdhi në krye të BRSS-së (atëherë kur socializmi ishte në prag të dorëzimit si filozofi politike), reformat e tij për ndryshimin e filozofisë së të menduarit<sup>185</sup> si dhe strategjisë së zhvillimit të shtetit në frymë më demokratike, nuk do të ishin të lehta për t'u realizuar. Madje, këto ide reformuese nxitën edhe një grusht-shtet ndaj tij. "*Perestrojka*" (dëgjimi i popullit - rindërtim) që lejoi për herë të parë sipërmarrjen vetjake dhe "*Glasnost*" (zëri - hapja me popullin - transparencë) që zbuti agjitacionin dhe i dha fund kontrollit totalitar mbi krijimtarinë intelektuale e kulturore ishin dy reformat e Gorbaçovit të viteve 1986-1987. "*Asnjë parti nuk guxon të posedojë monopol ndaj të vërtetës*" - deklaronte Gorbaçovi i cili synonte të reformonte sistemin komunist stalinist në *socializëm human e demokratik*.<sup>186</sup> Në Këshillin e

<sup>180</sup> John Calhoun Merrill, Harold A. Fisher, *The world's great dailies: profiles of fifty newspapers*, Hasting House, Nju Jork 1980, faqja 248

<sup>181</sup> Ludmila Pöppel, *The rhetoric of Pravda editorials: A diachronic study of a political genre*, Stockholm U. 2007, faqja 47

<sup>182</sup> Tatiana Smorodinskaya, Karen Evans-Romaine, Helena Goscilo, *Encyclopedia of Contemporary Russian Culture*, Routledge, Londër - Nju Jork 2007, faqja 511

<sup>183</sup> Po aty.

<sup>184</sup> Thomas F. Remington, *The Truth of Authority: Ideology and Communication in the Soviet Union*, Pittsburgh Press 1988, faqja 98

<sup>185</sup> Etem Aziri, *Sistemet politike*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 475

<sup>186</sup> Po aty, faqja 477

Evropës në Strasburg, Gorbaçov theksoi se popujt e tjerë që qeverisen nga partitë komuniste simotra, kanë të drejtë të bëjnë vetë zgjedhjen e tyre.<sup>187</sup> Me këtë ai i la të lira nga ndikimi rus shtetet komuniste në Evropën Qendrore dhe pranoi dështimin politik, ekonomik, shkencor etj., të komunizmit. Në asnjë shtet, filluar me Rumaninë ku nisën trazirat për rrëzimin e komunizmit, Rusia nuk u përzje më. Muri i Berlinit (1989) hapi siparin e rënies së gjithë *Perdes së Hekurt* si dhe rënies së muzgut të mjegullt të Luftës së Ftohtë dhe të heshtur mes dy sferave, sovjetike dhe perëndimore që kishin ndarë botën për gati 45 vjet me radhë.

Por, pikërisht për këto vite, BRSS-ja kishte qenë modeli më agresiv i ndikimit në gjithë kryeqendrat socialiste të Evropës Qendrore e Lindore. Çdo germë e marksizëm-leninizmit dhe format më të ashpra të Stalinit ishin kopjuar dhe ishin trasuar në këto vende simotra. Dhe siç theksojnë një sërë studiuesish, pa kontrollin e policisë sekrete dhe atë të mediave propagandistike, komunizmi nuk do mund të qëndronte aq gjatë.

Që të gjitha mjetet e informimit ishin në shërbim të fjalimeve politike të liderëve dhe të propagandës, ndërkohë që për gazetarët nuk mbetej shumë.... Lajmi nuk mund të komentohej, nuk mund të tjetërsohej sipas interesit publik dhe madje nuk mund të shkurtohej. Orë të tëra iu jepeshin në dispozicion vetëm kongreseve partiake, fjalimeve, *zërit të popullit* si dhe këngëve patriotike. Gazetarët nuk mund ta sfidonin zyrtarin politik, pasi t'u drejtoje pyetje zyrtarëve ishte jashtë çdo diskutimi... Ndërkohë, gazetarëve të huaj as që iu mundësohej qasja.

Media kalonte madje edhe kufijtë kur bënte publike *fletërrufe* të spiunëve dhe tradhtarëve<sup>188</sup> të atyre viteve, njerëzve që shfaqnin bindje kapitaliste e kështu me radhë. Përveç përndjekjes së tillë, të drejtat e njeriut ishin në gjendje të mjerueshme ndërkohë që sikurse në të gjitha vendet komuniste, të drejtat fetare ishin të mohuara. BRSS-ja ishte shpallur si shtet *ateist* për nga doktrina e saj politike, dhe një nga pretendimet që përdorej në atë kohë ishte teoria e transformimeve sociale<sup>189</sup> – thënë shkurtimisht, *mirëqenia arrihet nga duart e njeriut dhe jo nga Zoti*.

Edhe vetë sistemi politik socialist rus diktonte mbylljen hermetike dhe moslejimin e zërave ndryshe. Pavarësisht se Lenini shtroi trasenë e komunizmit, pas vdekjes së tij në krye erdhi Stalini, i njohur për *kultin e personalitetit*. Qeverisja e tij karakterizohej nga 3 elemente; 1) *eliminimin fizik dhe politik të rivalëve*, 2) *mbështetjen dhe përdorimin e policisë sekrete për të mbajtur postin*, si dhe 3) *përzgjedhjen e klikës rreth vetes* - njerëzve partiakë që siguronin besnikëri të palëkundur ndaj liderit.<sup>190</sup>

Siç theksojnë studiuesit politikë, kushtetuta e Stalinit e vitit 1936 e bëri sistemin politik dhe atë partiak *një të vetëm* duke mbjellë *totalitarizmin* në të gjitha sferat e jetës. Defektet e këtij totalitarizmi do të tentonte t'i zbuste edhe Hrushovi, ndërkohë që në vitin 1977, kushtetuta e Brezhnjevrit do të tentonte *destalinizimin* dhe *demokratizimin e sistemit politik sovjetik* - por që në fakt, nuk ishte asgjë tjetër veçse një *rikthim te politika e Leninit*. Pavarësisht se krijoheshin më shumë mundësi veprimi për sindikatat, organizatat rinore, të grave etj., sërish asnjë prej këtyre formave shoqërore organizuese nuk mund të shkëputej nga roli udhëheqës i partisë komuniste.<sup>191</sup> I vetmi ndryshim ishte ai i ndërprerjes së *trojkave* ose togave të policisë sekrete që ekzekutonin

<sup>187</sup> Fjalimi i Gorbaçovit para Këshillit të Evropës më 6.7.1989, <[https://www.cvce.eu/content/publication/2002/9/20/4c021687-98f9-4727-9e8b-836e0bc1f6fb/publishable\\_en.pdf](https://www.cvce.eu/content/publication/2002/9/20/4c021687-98f9-4727-9e8b-836e0bc1f6fb/publishable_en.pdf)>, [12.3.2019]

<sup>188</sup> Ludmila Pöppel, *The rhetoric of Pravda editorials: A diachronic study of a political genre*, Stockholm U. 2007, faqja 47

<sup>189</sup> Sabrina Petra Ramet, *Religious Policy in the Soviet Union*, Cambridge University Press 1993, faqja 218

<sup>190</sup> Etem Aziri, *Sistemet politike*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 464

<sup>191</sup> Po aty, faqja 467

cilindo kundërshtar politik të kohës. Edhe ardhja e Gorbaçovit nuk do ta zhvishte këtë shtet nga filozofia e njëmendësisë.

“Televizioni dhe radioja jonë duhet të jenë kryekëput radio dhe televizion politik. Të gjitha programet televizive dhe radiofonike duhet të jenë nën kontroll, vetëm për një qëllim – propagandë, proklamim dhe zbatim i politikave partiake. Në thelb programet duhet t’i adresohen klasës punëtore” – shprehej Sekretari për Ideologji i Gorbaçovit, Egor Ligaçev në vitin 1985 në takimin me kreun e Komitetit Gosteleradio.<sup>192</sup>

Kështu, për t’ia arritur këtij qëllimi, veçanërisht për t’i mbyllur gojën mediave që frynin nga jashtë, shteti socialist rus nuk harroi të ngrinte zhurmuesit (bllokuesit e valëve të huaja kapitaliste). Nga viti 1948 deri në 1988 asnjë radio e huaj nuk mund të dëgjohej për shkak të ngritjes së transformatorëve 45-megavatësh që krijojnë ndërhyrje elektrike në valë. BRSS-ja shpenzonte 48 milion dollarë në vit vetëm për të frenuar valët e radiove sikurse BBC, Zëri i Amerikës, Evropa e Lirë, Deutsche Welle, China International Radio, Kol Israel, Radio Vatikan, Radio Koreja etj.<sup>193</sup>

Ndërkohë, periudha e Boris Jelcinit (presidenti i parë i Federatës Ruse pas shpërbërjes së BRSS-së) njihet si ajo e komunizmit dogmatik dhe çlirimit nga marksizëm-leninizmi, për ta zëvendësuar me *demokracinë klasike parlamentare*.<sup>194</sup>

#### 4.1.2.2 Agjitacioni dhe Propaganda në komunizmin enverist

Komunizmi ishte akoma më i ashpër në Shqipëri, vendin e vogël të Ballkanit Perëndimor i cili e thërriste Rusinë, *Motra e Madhe*. Marrëdhëniet ishin aq të forta, saqë Shqipëria i atribuonte merita tepër të mëdha Ruisë jo vetëm për fitoren ndaj Luftës së Dytë Botërore dhe asgjësimin e nazizmit gjerman, por edhe instalimin e komunizmit. Marrëdhënie të shkëlqyera lulëzuan edhe me Jugosllavinë e asaj kohe, madje partizanë nga Shqipëria kishin luftuar përkrahë çetave të Titos për përzënien e okupatorit nazist. Komunizmi në ngritje cilësohej si sistemi më ideal i punës dhe i të jetuarit, me pretendimin se pas suksesit do të materializohej në *jetë me lugë të florinjte*.<sup>195</sup> Të gjithë ata që e kanë përjetuar sadopak epokën e regjimit të Enver Hoxhës, i mbajnë mend fort mirë këto epitete të cilat përbënin propagandën e përditshme të asaj nomenklature.

Menjëherë pas çlirimit dhe vendosjes së kontrollit komunist mbi të gjitha sferat e jetës, edhe shtypi do të centralizohej. “Zëri i Popullit” ishte themeluar që në vitin 1942 dhe madje që në kryeartikullin e numrin e tij të parë shpaloste mesazhin tipik se “Gazeta “Zëri i Popullit” ka një mision, ka një qëllim, të bashkojë popullin shqiptar rreth e qark këtij organi, të bashkojë çdo gjë që është e ndershme dhe antifashiste, pa marrë parasysh besimet, grupet politike, korrentet (rrymat) e ndryshme. “Zëri i Popullit” është i vendosur t’i bëjë luftë okupatorit... “Zëri i

<sup>192</sup> Thomas F. Remington, *The Truth of Authority: Ideology and Communication in the Soviet Union*, Pittsburgh Press 1988, faqja 99

<sup>193</sup> A. Ross Johnson, R. Eugene Parta, *Cold War Broadcasting: Impact on the Soviet Union and Eastern Europe, A Collection of Studies and Documents*, Central European University Press, Budapest-Nju Jork 2010, faqja 53

<sup>194</sup> Etem Aziri, *Sistemet politike*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 482

<sup>195</sup> Nëse në vitin 1946 synohej një Shqipëri socialiste dhe ndërtimi i socializmit, 30 vjet më vonë kjo e arritur i adresohet shoqërisë komuniste “si forma më e lartë e socializmit”.

Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipëri, 1912-2008*, UFO Press, Tiranë 2009, faqja 212-213

*Popullit” do të jetë tribuna e bashkimit ku do të pasqyrohet lufta jonë për liri dhe lufta e popujve liridashës të Evropës. Kjo është e vetmja ambicie që kemi ne të “Zërit të Popullit”.*<sup>196</sup>

Siç tregohet në dokumentet e mëvonshme të Partisë së Punës së Shqipërisë, kjo gazetë redaktohej dhe udhëhiqej nga vetë Enver Hoxha gjatë viteve të luftës, me qëllim që të unifikonte përpjekjet e popullit në luftën kundër pushtuesve me moton: *“Se liria fitohet, por nuk dhurohet!”*. Gazeta “Tomori” e italianëve ishte e vetmja që vepronte në këtë kohë (burim jo i besuar për shkak se menaxhohej nga pushtuesit) edhe pse në historinë e gjatë të medias në Shqipëri, pjesa më e madhe e shtypit vinte nga mërgata dhe mbërrinte me vonesë në dorën e lexuesit.<sup>197</sup>

“Zëri i Popullit” u bë gazeta më e rëndësishme dhe mbajti këtë kryesim edhe përtej vitit 1991, kur regjimi komunist në Shqipëri u shemb. Pavarësisht shumë mediave të tjera të shtypura që u themeluan ndër vite sikurse “Bashkimi”, “Zëri i Rinisë”, “Drita”, “Luftëtari”, “Mësuesi” e “Sporti Popullor”, tirazhi i “Zërit të Popullit” mbante rekordin me 120 mijë kopje. Gazetat e tjera asnjëherë nuk arritën tirazh më të lartë se 55 mijë kopje. Të gjitha botoheshin nga shteti, institucione apo organe nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e rreptë të vetë shtetit.<sup>198</sup>

Vetë udhëheqësi Enver Hoxha nuk linte asnjë mëdyshje për funksionimin e medias, dhe këtë e kishte shprehur edhe në një vendim të Partisë së Punës së Shqipërisë në vitin 1952. *“Çdo vendim se “ne jemi të pavarur, se mund të shkruajmë pa u influencuar nga komitetet e Partisë”, është i gabuar. Kryeredaktori, redaktorët dhe gazetarët kanë kompetencat e tyre, por njëkohësisht kanë edhe përgjegjësi përpara Partisë për punën që u është ngarkuar. Asnjë gazetar nuk mund të jetë i shkëputur nga Partia e sidomos nga Organi i Komitetit Qendror – “Zëri i Popullit”. Përkundrazi, ai duhet të jetë i lidhur shumë me Partinë”.*<sup>199</sup>

Me këtë, Enver Hoxha thoshte disa të vërteta... Së pari, gazetarët ishin vërtet *masha*<sup>200</sup> të përzgjedhura për ushtrim propagande. Kuadri i tyre nuk ishte dosido... Ata ishin njerëz të përzgjedhur nga radhët më të flakta komuniste dhe vërtet ishin të ngarkuar nga Partia me misionin e gazetarit (propaganduesit). Po ashtu, lidhja e tyre nuk mund të ishte e rastësishme me organet e Komitetit Qendror, me makinerinë shtetërore të propagandës, filluar nga vetë Enver Hoxha si Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë e deri te drejtorët e Drejtorisë për Agjitacion.

Sekretari i Parë jepte drejtpërdrejtë orientimet dhe detyrat e përgjithshme për mediat, ndërkohë që fjala dhe detyrat që ai shtronte në mbledhjet e Komitetit Qendror ishin të padiskutueshme (të detyrueshme) për t’u zbatuar...

Sekretari për propagandën ishte personi i cili drejtohte më konkretisht në linjë partiake, mesazhet dhe detyrat në fushën e arsimit, kulturës, shkencës, shtypit. Ai transmetonte urdhrat të kryeredaktorët dhe kishte gjithë të drejtat t’i thërriste ata në përgjegjësi dhe llogaridhënie, shkruante vetë shkrime për mediat etj.

<sup>196</sup> Dokumente kryesore të PPSH - Vëllimi I (1941 – 1948), *Kryeartikulli i Numrit të Parë të “Zërit të Popullit” 25 gusht 1942*, faqja 94-96, <[http://www.enver-hoxha.net/librat\\_pdf/shqip/ppsh\\_dokumenta\\_kryesore/1/2.prill\\_1942-shkurt\\_1943.pdf](http://www.enver-hoxha.net/librat_pdf/shqip/ppsh_dokumenta_kryesore/1/2.prill_1942-shkurt_1943.pdf)>, [12.3.2019]

<sup>197</sup> Gazeta e parë zyrtare në shqip njihet e përmuajshmja “*Flamuri i Arbrit*” e botuar në Kalabri në vitin 1883, edhe pse me studimet e fundit mbi gazetarinë, nga zhbirimi i arkivave turke, u mësua se gazeta e parë që ka qenë botuar në gjuhën shqipe ka qenë “*Iskodra*” në vitin 1868.

Illirjan Agolli, *Zbulohet gazeta e parë e Shqipërisë “Iskodra”, Zëri i Amerikës*, <<https://www.voal.ch/zbulohet-gazeta-e-pare-e-shqiperise-iskodra/>>, [12.3.2019]

<sup>198</sup> Ilda Londo, *Albania*, Instituti i Medias, Tiranë 2014,

<<http://www.institutemedia.org/Documents/PDF/media%20ownership%201.pdf>>, [12.3.2019]

<sup>199</sup> Artan Fuga, *Monolog: mediat dhe propaganda totalitare*, Tiranë, Dudaj 2010, faqja 84

<sup>200</sup> Në mënyrë figurative: “një njeri që përdoret nga dikush si vegël për një qëllim të caktuar”

Shefi i sektorit të shtypit ose Drejtori i Drejtorisë për Agjitacion-Propagandë ishte realisht ai që ushtronte drejtpërdrejtë pushtetin e Komitetit Qendror mbi median dhe shtypin. Lajmet (madje edhe lajmet nga bota), fjalimet, dokumentet kryesore etj., nuk mund të transmetoheshin kurrësi pa kaluar nën kontrollin e syrit të tij.<sup>201</sup>

Radioja ishte gjithashtu një mjet i fuqishëm i propagandës komuniste. Radio-Tirana i nisi transmetimet në 28 nëntor të vitit 1938 në kohën e Mbretit Zog, me një studio modeste në ndërtesën e Bashkisë së asaj kohe të kryeqytetit e cila përdorej edhe si kullë transmetimi për Romën, siç e përkrauan studiuesi Fuga. Hapësira transmetuese për dëgjuesit nuk i kalonte 2 orë e gjysmë në ditë.<sup>202</sup>

Në vitin 1945, menjëherë pas çlirimit të Shqipërisë, ato pak orë transmetimi u bënë më të kërkuarat për qytetarët, për shkak të lajmeve dhe muzikës tepër të munguar. Duke marrë parasysh analfabetizmin e madh të qytetarëve, etjen e tyre për të kuptuar mbi rrugëtimin e Shqipërisë, si dhe nga ana tjetër mungesën e gazetarëve, mungesën e pajisjeve teknike qoftë edhe për të regjistruar një këngë ose zërin e folësve, mund të thuhet se radioja nuk i përmbushte dot kërkesat e qytetarëve. Shteti komunist investoi pa mëdyshje ndaj radios duke e ditur se ajo do të ishte një instrument i fuqishëm komunikimi dhe propagande.<sup>203</sup> Radio-Tirana e përforcuar (ndërtesa e re) u përrua në dhjetor të vitit 1965 dhe nga dëshmitë e gazetarëve kuptohet se ende sot e kësaj dite ka gjurmë me mbishkrime ruse nëpër pajisje (bashkë-investim me rusët).

Nga ana tjetër, televizioni i bëri hapat e parë të tij në prill të vitit 1960 me transmetimin eksperimental 3-orësh, një herë në tre ditë. Ekipi ishte vetëm prej 5 njerëzish dhe Shqipëria nuk ishte ende e përgatitur për këtë instrument kaq të shtrenjtë, jo vetëm në pajisje teknike, në kuadro, por edhe në pajisje mbështetëse (antena, përsëritës, transformatorë etj.) Kujtojmë se elektrifikimi në Shqipëri përfundoi tepër vonë, në vitin 1978. Më e keqja ishte se Shqipëria (e izoluar nga bota dhe zhvillimi teknologjik) nuk kishte ende një fabrikë të prodhimit të televizorëve. Prodhimi i televizorëve bardhezi filloi në 1961, ndërsa ai me ngjyra (prodhime eksperimentale) filloi në 1980.<sup>204</sup>

Kështu, televizioni shqiptar i filloi transmetimet e tij me program të rregullt në vitin 1971 ndërkohë që 10 vjet më vonë, në 1981 u lëshua materiali i parë filmik me ngjyra. Transmetimi vazhdoi me orar të cunuar me vite me radhë: nga 2 orë e gjysmë transmetim në ditë. Vetëm në vitin 1986 u kalua në 4 orë transmetim në ditë.<sup>205</sup>

Në këtë mënyrë, televizioni nuk i mbërrinte të gjitha skajet e Shqipërisë jo vetëm për shkak të mungesës së prodhimit të aparateve televizive, por edhe për shkak të varfërisë së popullatës; çmimi i një televizori ishte 4 500 lekë ndërsa rroga e një kooperativisti nuk i kalonte 300 lekët në muaj. Përveç parave që ishin vështirë të siguroheshin për një *lüks të tillë shtëpiak*, qytetari nuk mund të blinte dot televizor pa dërguar së pari kërkesë te Këshilli i Fshatit apo Lagjes, të merrte miratim nga Byroja e Partisë dhe konsensus nga fqinjët e tij, si dhe të priste madje edhe me vite të tëra deri sa kërkesa e tij të miratohej dhe të konkretizohej me mallin, konkretisht, televizorin e prodhuar. Në këtë betejë kaq të vështirë për t'u pajisur me të vetmin mjet argëtues (për shkak se televizori përbënte risi më vete si diçka e panjohur më parë për shqiptarët) bënte punë edhe lidhja me ndonjë zyrtar më të lartë ose statusi si *familje dëshmori, komunist i dalluar* etj.

<sup>201</sup> Artan Fuga, *Monolog: mediat dhe propaganda totalitare*, Tiranë, Dudaj 2010, faqja 85-86

<sup>202</sup> Po aty, faqja 49

<sup>203</sup> Po aty, faqja 74-75

<sup>204</sup> Sipas Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, botim i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2009

<sup>205</sup> Artan Fuga, *Monolog: mediat dhe propaganda totalitare*, Tiranë, Dudaj 2010, faqja 75

Në kushtet kur varfëria e bënte të pamundur shuarjen e etjes për televizion, media e shkruar do të vazhdonte të kryesonte me propagandën e saj. Fillimisht, gazetat qarkullonin kryesisht në qytete, por shpejt u morën masa që ato të mbërrinin edhe në fshatin më të largët me synim informimin e popullit me fjalën që vetë Partia impononte. Gjatë kësaj kohe, roli indoktrinues i shtypit u përdor si instrument kryesor i propagandës shtetërore.<sup>206</sup>

Në përgjithësi, mjetet e komunikimit masiv në shoqërinë totalitare të Shqipërisë ishin thjesht *rripa transmissioni*.<sup>207</sup>

Televizioni ishte i destinuar të ecte shumë ngadalë edhe për shkak të një fakti tjetër; atë të vet-izolimit. Shqipëria veçse i ndryshonte *partnerët e saj komunistë*. Në vitin 1948 u prishën marrëdhëniet me Jugosllavinë e Titos edhe pse deri në atë kohë, në dokumentet partiake që i tregoheshin popullit, Jugosllavia e kishte ndihmuar shumë Shqipërinë për anëtarësimin e saj në OKB.<sup>208</sup>

Në fillim të viteve 1960, Shqipëria i prishi marrëdhëniet edhe me Bashkimin Sovjetik<sup>209</sup> dhe disa vende të tjera të Bllokut Lindor (Evropës Lindore). Pavarësisht se me Jugosllavinë, Shqipëria e rriti paksa tonin e akuzave<sup>210</sup> - me BRSS-në nuk guxoi! Toni u ruajt më neutral me Bashkimin Sovjetik për shkak të frikës për ndonjë sulm të mundshëm, sikurse ishte kërcënuar Shqipëria pas shkëputjes së marrëdhënieve. Nga ana tjetër, BRSS-ja trumbetohej si shteti i vetëm që fitoi Luftën e Dytë Botërore dhe Shqipëria ishte tepër e vogël për t'i matur forcat me të. Nën pretekstin se Jugosllavia dhe BRSS-ja devijuan nga linjat e komunizmit, Shqipëria tentoi me Kinën. Marrëdhëniet u ngrohën aq shumë sa Kina mori epitetin *Nëna e Madhe*. Një epokë e tillë, sidomos në vitet 1970 kur Kina kishte interes të madh për ndikim dhe propagandë në Evropë,<sup>211</sup> u quajt *epoka e përjetshme e vëllazërimit komunist*. Por, edhe me Kinën marrëdhëniet përfunduan në vitin 1975, sepse “... kreditë dhe ndihmat nga Kina nuk jepeshin në frymën e internacionalizmit proletar siç kishin kujtuar PPSH-ja dhe populli shqiptar”. Po ashtu, pas vdekjes së Hrushovit (BRSS), Kina nisi të flirtonte me Brezhnjevin. Një gjë e tillë e nervozoi klikën komuniste shqiptare.<sup>212</sup>

Në këto kushte, Shqipëria përqafoi vet-izolimimin dhe reformoi kursin e propagandës se *nga sot e tutje do të ecte vetëm me forcat e veta*. Ajo vazhdoi me ndërtimin e një lloji të veçantë socializmi, fanatik dhe konservator<sup>213</sup> ndryshe nga ai që ekzistonte në vendet e Evropës Lindore, por unik dhe i pakrahasueshëm edhe nga vetë komunizmi i lindur dhe zhvilluar në Bashkimin Sovjetik.<sup>214</sup>

<sup>206</sup> Ekspozitë e realizuar nga Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC) me mbështetjen e Arkivit Qendror Shtetëror (AQSH), *Propaganda gjatë diktaturës komuniste*, faqja 4, <<https://www.idmc.al/assets/idmc-propaganda-gjate-diktatures-komuniste.pdf>>, [13.3.2019]

<sup>207</sup> Sokol Paja, *Roli i mediave në propagandën ateiste në periudhën totalitare*, Studim Doktorate, Universiteti i Tiranës, Tiranë 2018, faqja 61

<sup>208</sup> Telegrafi, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948 (3): Shqiptarët glorifikonin jugosllavët!*, <<https://telegrafi.com/marredheniet-shqiptaro-jugosllave-1945-1948-3-shqiptaret-glorifikonin-jugosllavet/>>, [13.3.2019]

<sup>209</sup> Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipëri, 1912-2008*, UFO Press, Tiranë 2009, faqja 211

<sup>210</sup> Dokumente kryesore të PPSH - Vëllimi I (1941 – 1948, “*Deklaratë e Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare me anën e së cilës hidhen poshtë shpifjet e Komitetit Central të Partisë Komuniste të Maqedonisë*” shtator 1948, faqja 507, <[http://www.enver-hoxha.net/librat\\_pdf/shqip/ppsh\\_dokumenta\\_kryesore/1/8.17\\_qershor\\_1947-nentor\\_1948.pdf](http://www.enver-hoxha.net/librat_pdf/shqip/ppsh_dokumenta_kryesore/1/8.17_qershor_1947-nentor_1948.pdf)>, [13.3.2019]

<sup>211</sup> Artan Fuga, *Monolog: mediat dhe propaganda totalitare*, Tiranë, Dudaj 2010, faqja 49

<sup>212</sup> Lisen Bashkurti, *Diplomacia e vet-izolimit*, Tiranë, GEER 2004, faqja 467

<sup>213</sup> Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipëri, 1912-2008*, UFO Press, Tiranë 2009, faqja 211

<sup>214</sup> Po aty, 212



Me Fuqitë e Mëdha si SHBA-në, Britaninë e Madhe etj., Shqipëria jo vetëm që nuk kishte marrëdhënie por u kishte shpallur haptazi atyre luftë ideologjike, propagandistike e madje edhe diplomatike që në vitin 1945.<sup>215</sup>

Në vitet 1980, Shqipëria nuk kishte më asnjë aleat, asnjë vend mik socialist, asnjë partner të cilit mund t'i ankorohet ose t'i bashkëngjitet (të bashkëpunonte) për fuqizimin e mbrojtjes së vendit, për të rritur kapacitetet ushtarake e teknologjike të saj në këtë fushë. Kështu, mbrojtja tani ishte vetëm në duart e Shqipërisë dhe rialokimi i tillë i buxhetit të shtetit do të përbënte faturën më të rëndë për ekonominë e vendit dhe *mirëqenien e masave*.<sup>216</sup>

Këtë mllef në politikën e jashtme, Shqipëria do e zbrazte në marrëdhëniet e brendshme jo vetëm përmes bombardimit me propagandë, por edhe me thirrje të fuqishme për punë dhe mbrojtje - sepse Shqipëria mund të *rrezikohet nga jashtë* në çdo moment.

Propaganda ushtrohet në formën më të ashpër të saj, sa që në lajme nuk kishte *pardon* në numërimin apo leximin e emrave të tradhtarëve apo armiqve të shtetit, të ekzekutuar apo internuar çdo ditë. Këtë fat kishin edhe figurat politike të vetë Byrosë së Enver Hoxhës, mbështetës të marrëdhënieve të dikurshme me Jugosllavinë, BRSS-në, Kinën apo edhe ata që *fllirtonin me shfaqje të huaja*<sup>217</sup> nga Perëndimi. Të gjithë patën të njëjtin fund!

Të shprehje qëndrimet politike ose personale në atë kohë, ishte e dënueshme në bazë të nenin 55 për *Agjitacion dhe Propagandë kundër Shtetit (vepër kjo që atribuohet për minim të shtetit të diktaturës së proletariatit)*.<sup>218</sup>

Neni famëkeq, i miratuar me ligjin e posaçëm me numër 5591 të datës 15.6.1977 në Kodin Penal të RPSSH-së theksonte:

*“Agjitacioni e propaganda fashiste, antidemokratike, fetare, luftënxitëse, antisocialiste, si edhe përgatitja, përhapja ose ruajtja për përhapje e literaturës me përmbajtje të tillë për të dobësuar ose minuar shtetin e diktaturës së proletariatit, dënohet:*

*me heqje të lirisë nga 3 deri në 10 vjet.*

*Po këto vepra, kur janë kryer në kohë lufte ose kanë shkaktuar pasoja veçanërisht të rënda, dënohen:*

*me heqje të lirisë jo më pak se 10 vjet ose me vdekje.*”<sup>219</sup>

Ishte çështje interpretimi e nomenklaturës se në çfarë shkalle interpretohet agjitacioni dhe në çfarë shkalle zbatohet dënimi për *armiqtë e popullit*.

Forma e ndëshkimit të kundërshtarëve politik kishte ekzistuar që në vitin 1946 me ligjin *“Mbi fajet penale kontra popullit dhe shtetit”* (neni 8). Ajo ishte përforcuar në vitin 1952 me ligjin e ri shtesë për ndryshime të Kodit Penal të RPSSH-së (neni 73), ndërsa u përkufizua, sikurse u theksua më sipër, me nenin 55 të Kodit Penal të RPSSH-së në vitin 1977. Në vitin 1990, neni 55 u ndryshua duke e *fshirë dënimin me vdekje*. Neni famëkeq me numër 55 mbeti në fuqi madje deri në vitin 1992, kur u *shfuqizua* me ligj të posaçëm (nr.7553, datë 30.1.1992).<sup>220</sup>

<sup>215</sup> Lisen Bashkurti, *Diplomacia Shqiptare në fillimet e Luftës së Ftohtë*, Tiranë, GEER 2003, faqja 23

<sup>216</sup> Lisen Bashkurti, *Diplomacia e vet-izolimit*, Tiranë, GEER 2004, faqja 563-564

<sup>217</sup> Shfaqje të huaja quheshin të gjitha ato tendenca që sistemi komunist i cilësonte si *devijime nga kultura komuniste*.

<sup>218</sup> Artan Fuga, *Monolog: mediat dhe propaganda totalitare*, Tiranë, Dudaj 2010, faqja 41

<sup>219</sup> Ministria e Drejtësisë e Shqipërisë, Qendra e botimeve zyrtare, *Ligji nr.5591 i datës 15.6.1977 i Kodit Penal të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*,

<<http://www.qbz.gov.al/doc.jsp?doc=docs/Ligj%20Nr%205591%20Dat%2015.6.1977>.htm>,

[14.3.2019]

<sup>220</sup> Duhet theksuar se paralelisht me Ligjin për Agjitacion dhe Propagandë kundër Shtetit, të dënueshme ishin edhe të ashtuquajturat “shfaqje të huaja” siç thirreshin të gjitha tendencat e huazuara nga jashtë. Ndaloreshin flokët e gjata,

Ndërkaq, sistemi parti-shtet nuk lejonte kurrësi forca të tjera politike. Balli Kombëtar dhe Partia e Legalitetit ishin shpërbërë që në vitin 1944, ndërsa krijimi i disa partive të tjera kryesisht *ilegale* si Partia Demokristiane, Grupi i Rezistencës, Grupi i Monarkistëve etj. u shpërbënë që në gjenezë. Të gjithë drejtuesit e tyre, ose u pushkatuan ose u burgosën me dhjetëra vite.<sup>221</sup>

Liritë fetare, sikurse diktonte sistemi komunist, nuk ekzistonin. Madje, shteti jo vetëm që u vuri kazmën kishave dhe xhamive, por burgosi dhe internoi gjithë klerin duke i veshur fajin e vjetër si *kulak*<sup>222</sup> - mbështetës të bejlerëve të paraluftës.

Me këtë terror policor të shërbimit sekret dhe propagandën mediatike të patjetërsueshme, Shqipëria zgjodhi ndarjen si nga Lindja ashtu edhe nga Perëndimi.<sup>223</sup> Kjo konsiderohet si periudha më e vrazhdë në Shqipëri duke e futur vendin në një errësim total nga fqinjët dhe bota.

Sikurse edhe në Bashkimin Sovjetik, asnjë sinjal i huaj radiofonik nuk mund të përshkonte hapësirën transmetuese të Shqipërisë për të dëgjuar qoftë edhe për shqiptarët që jetonin jashtë kufijve administrativë të vendit. Zhurmuesit pengonin edhe valët televizive italiane, pavarësisht se relievi detar ofronte kushte të mira për kapjen e sinjalit. Vetëm pas vitit 1990 dhe përmbysjes së regjimit socialist, Shqipëria filloi jo vetëm një periudhë tranzicioni por edhe një fazë *eksperimentale* për të përjetuar gjërat e mohuara për gati 45 vite me radhë. Një prej tyre ishte edhe lulëzimi i valëve të huaja radiofonike e televizive, për të shikuar për herë të parë se çfarë kishte përtej kufirit.

#### 4.1.2.3 Bashkim-Vëllazërimi në median titiste dhe kombësitë e RSFJ-së

Maqedonia e Veriut (në vitet 1900 thirrej Вардарска-Бановина - përkth. Qarku i Vardarit)<sup>224</sup> ishte territor në kuadër të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, e cila ishte krijuar nga një bashkim trojesh, popujsh, kombësish, mbretërisht dhe shtetesh menjëherë pas Luftës së Parë Botërore në vitin 1918.

Mbretëria e Serbisë, e cila i ishte bashkuar Mbretërisë së Malit të Zi në dhjetor të vitit 1918 dhe shtetit vetëm njëmuajor të deri asaj kohe mes slllovenëve, kroatëve dhe serbëve themeloi kështu entitetin e ri, Jugosllavinë. Ky entitet i tillë vazhdoi deri në vitin 1929 duke përfshirë

---

mustaqet, syzet e errëta, pantallonat xhins (jeans), pantallonat e gjera (cowboy), çanta me rrip në supë etj. Madje, e ndaluar ishte edhe për ndonjë turist me pamje ose veshje të tillë. Për këtë qëllim, në aeroportin e Rinasit ishte i punësuar një berber i cili me urdhër të autoriteteve, u hiqte mjekrën dhe u priste flokët të huajve që zbrisnin aty. Shkelja e të Drejtave të Njeriut nga Legjislacioni Shqiptar dhe nga autoritetet shtetërore, në veçanti në procesin penal, gjatë regjimit komunist në Shqipëri (1945-1990),

Lirie Dina, *Human Rights Defenders School*, Tiranë 2018,

<[https://www.academia.edu/35962456/SHEKELJA\\_E\\_T%C3%8B\\_DREJTAVE\\_T%C3%8B\\_NJERIUT\\_NGA\\_LEGJISLACIONI\\_SHQIPTAR\\_DHE\\_NGA\\_AUTORITETET\\_SHTET%C3%8BRORE\\_N%C3%8B\\_VE%C3%87ANT\\_I\\_N%C3%8B\\_PROCESIN\\_PENAL\\_GJAT%C3%8B\\_REGJIMIT\\_KOMUNIST\\_N%C3%8B\\_SHQIP%C3%8BRI\\_1945-1990](https://www.academia.edu/35962456/SHEKELJA_E_T%C3%8B_DREJTAVE_T%C3%8B_NJERIUT_NGA_LEGJISLACIONI_SHQIPTAR_DHE_NGA_AUTORITETET_SHTET%C3%8BRORE_N%C3%8B_VE%C3%87ANT_I_N%C3%8B_PROCESIN_PENAL_GJAT%C3%8B_REGJIMIT_KOMUNIST_N%C3%8B_SHQIP%C3%8BRI_1945-1990)>, [14.3.2019]

<sup>221</sup> Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipëri, 1912-2008*, UFO Press, Tiranë 2009, faqja 197

<sup>222</sup> Sipas Fjalorit Shqip, *kulak* - Fshatar i pasur që kishte shumë tokë, shfrytëzonte punën e argatëve a të fshatarëve të varfër dhe pasurohej në kurriz të tyre. Origjina e fjalës (кулак – dorështrënguar) është nga rusishtja, dhe si term është përdorur gjatë gjithë periudhës komuniste.

<sup>223</sup> Po aty, 223

<sup>224</sup> Marija Jovanović, *Prosvetno-političkite priliki vo Vardarska Makedonija: (1918-1929)*, NIO: Studentski izbor, Skopje 1983, faqja 39

popuj të përkufizuar mirë (Serbia, Kroacia-Sllavonia, Dalmacia, Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina dhe Maqedonia) por edhe popuj që nuk njiheshin, sikurse Sllovenia dhe Vojvodina.<sup>225</sup>

Megjithatë, ky union i parë i popujve të sllavëve të jugut mori jetë si shtet sovran (pavarësisht se emri ishte *Mbretëria Jugosllave*) pas shekujsh të gjatë nën perandorinë osmane dhe monarkinë austro-hungareze. Mbretëria do të qeverisej nga një *qeveri e unifikuar parlamentare* nën monarkun. Ndërkaq, Maqedonia ishte thjesht *trofe* nga Lufta e Parë Botërore. Serbia, e njohur për manovra diplomatike të fuqishme gjatë kësaj periudhe, e kishte kërkuar Maqedoninë si fryt të fitores së luftës ballkanike 1912-13.<sup>226</sup> Siç sqaron historiani Alan Fogelquist, pjesa më e madhe e popullatës së Maqedonisë në atë kohë ishte e krishterë dhe fliste dialekt sllavo-maqedonas - më i afërt me bullgarishten se sa me serbishten.<sup>227</sup>

Kur Mbretëria Jugosllave ra nën pushtimin e Fuqive të Boshtit (Itali, Gjermani e Japoni) në Luftën e Dytë Botërore, mbreti Peter II shkoi në azil. Forcat partizane të udhëhequra nga Josip Broz Tito shpallën Jugosllavinë Federale Demokratike. Ndihmesa e rezistencës partizane jugosllave në këto vite është cilësuar shpesh si rezistenca më efikase në Evropën e pushtuar të asaj kohe.<sup>228</sup>

Menjëherë pas çlirimit nga Lufta e Dytë Botërore, Jugosllavia përqafoi sistemin komunist i cili ishte bartur më së shumti nga Rusia e Leninit. Jugosllavia u emërtua në *Republika Popullore Federale e Jugosllavisë* në vitin 1946, dhe siç theksojnë studiuesit e shkencave politike, pas miratimit të kushtetutës e cila bazohej më së shumti në kushtetutën e Bashkimit Sovjetik filloi një centralizim i madh i pushtetit në favor të organeve federative.<sup>229</sup>

Sa i përket medias, gazeta e parë në gjuhën maqedonase ishte “Nova Makedonija” e themeluar në 29 tetor të 1944. Ajo u ndoq menjëherë nga gazeta turke “Birlik” në 24 dhjetor të vitit 1944. Gazeta “Flaka e Vëllazërimit” në gjuhën shqipe nisi botimin në 4 prill të vitit 1945. Ndërsa gazeta e dytë në maqedonisht “Veçer” u paraqit në treg në vitin 1963. Është e qartë se të gjitha gazetat e asaj kohe ishin kryekëput nën kontrollin e Partisë Komuniste Jugosllave.<sup>230</sup>

Që në numrin e parë të faqosur të gazetës “Nova Makedonija” dalloheshin parullat “*Vdekje Fashizmit-Liri Popullit*” ndërsa nën logo theksohej përkatësia si *Organ i Frontit Popullor Çlirimtar të Maqedonisë* ose *Organ i Lidhjes Socialiste të Popullit Punëtor të Maqedonisë*.<sup>231</sup> Edhe gazeta në shqip “Flaka e Vëllazërimit”, pavarësisht se duhej të shërbente si udhërrëfyes për të drejtat e shqiptarëve, përfshihej gjithashtu nën kontrollin e Komisionit për Censurë e Propagandë të PKJ-së, sikurse çdo media tjetër.

Radioja, një mjet tjetër i fuqishëm propagande për Partinë Komuniste të Jugosllavisë, ashtu sikurse edhe në vendet e tjera të Bllokut Lindor ku zbatoheshin komunizmi, kishte të njëjtin trajtim. E drejta ndërkombëtare për frekuencë për *Shkupin* u sigurua në vitin 1931 në bazë të

<sup>225</sup> Jozo Tomasevich, *War and Revolution in Yugoslavia: 1941-1945, Occupation and collaboration*, Stanford University Press, California 2001, faqja 1

<sup>226</sup> Alan Fogelquist, *Politics and Economic Policy in Yugoslavia, 1918-1929*, Global Geopolitics Net, Los Angeles, California 2011, faqja 11

<sup>227</sup> Po aty.

<sup>228</sup> Rhodri Jeffreys-Jones, *In Spies We Trust: The Story of Western Intelligence*, Oxford Press, United Kingdom 2013, faqja 87

<sup>229</sup> Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Formimi, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit demokratik*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 74

<sup>230</sup> Dona Kolar Panova, *Историја на масовните комуникации (Historia e komunikimit masiv)*, Ligjërata të autorizuara, Shkup 2007, faqja 124-126

<sup>231</sup> Foto për konsultim, e nxjerrë nga Wikipedia,

<[https://upload.wikimedia.org/wikipedia/mk/4/4d/Nova\\_Makedonija\\_logo\\_prv\\_broj.jpg](https://upload.wikimedia.org/wikipedia/mk/4/4d/Nova_Makedonija_logo_prv_broj.jpg)>, [15.3.2019]

Planit të Gjenevës që çdo shteti në Evropë t'i ndahej frekuencë transmetimi.<sup>232</sup> Frekuenca e ndarë në Luçernë funksionoi deri në vitin 1941 në kuadër të ndërmarrjes shtetërore Radio-Beogradi ndërsa programi që ajo transmetonte kishte për qëllim kolonizimin e Maqedonisë dhe asimilimin e maqedonasve.<sup>233</sup>

Programin e parë në gjuhën maqedonase në Republikën e lirë të Maqedonisë së asaj kohe, Radio-Shkupi e realizoi me transmetimin e Mbledhjes së Dytë të ASNOM-it më 28 dhjetor 1944. Ndërkohë, më 28 janar 1945,<sup>234</sup> në rrjetin transmetues nëpër Maqedoni u dëgjua për herë të parë edhe fjala shqipe. Kjo datë merret si dita e lindjes së radios shqip, pavarësisht se kohëzgjatja e programit ishte vetëm 15 minuta.<sup>235</sup> Po aty i kushtohej edhe gjuhës turke. Ndërkaq, programi radiofonik në gjuhën shqipe filloi me punë të rregullt më 4 maj të vitit 1948.<sup>236</sup>

Radio-Shkupi e filloi veprimtarinë e vet me 3 orë e gjysmë program, ndërsa në fund të vitit 1946, hapësira për dëgjuesit u rrit në 5 orë. Të dielave, transmetimi shkoi deri në 10 orë e gjysmë. Në Radio-Shkupi, në këtë periudhë punonin 39 persona (gazetarë, teknikë dhe personel tjetër) ndërkohë që radioja kishte marrë përsipër të bëhej faktor për ndërgjegjësimin, edukimin dhe ngritjen kulturore të numrit të dëgjuesve gjithnjë e në rritje.<sup>237</sup>

Po ashtu, në kuadër të Radio-Shkupit vepronin si degë derivate edhe radiot lokale në shumë rajone. E para nga radiot lokale që filloi transmetimin ishte Radio-Manastiri. Të gjitha këto radio merrnin udhëzime vetëm nga Partia Komuniste, që nga lajmet e deri te programet e tjera edukative e argëtuese që transmetonin. Deri në vitin 1974, partia ishte kontrolluese e rreptë e programeve ndërkohë që asnjë informatë nuk mund të dilte në transmetim pa urdhër nga lart.

Datat	Radiot lokale
27 mars 1950	Radio-Manastiri <sup>238</sup>
29 nëntor 1954	Radio-Koçani
25 maj 1956	Radio-Gjevgjelia
13 tetor 1957	Radio-Ohri
21 prill 1958	Radio-Kavadari
1 maj 1959	Radio-Veles
5 nëntor 1959	Radio-Strumica
1 maj 1960	Radio-Shtip
1 maj 1960	Radio-Resnja
29 nëntor 1960	Radio-Kërçova

<sup>232</sup> Bllagoja Nineski, *Локалните електронски медиуми во Македонија (Mediat elektronike lokale në Maqedoni)*, Qendra për shtyp, Radio-Televizioni Prilep 1998, faqja 19

<sup>233</sup> Dona Kolar Panova, *Историја на масовните комуникации (Historia e komunikimit masiv)*, Ligjërata të autorizuara, Shkup 2007, faqja 127

<sup>234</sup> Historia e Radio-Shkupit dhe Televizionit të Maqedonisë, <<http://al.mrt.com.mk/node/61101#>>, [15.3.2019]

<sup>235</sup> Më 20 korrik 2016 u arrit marrëveshja transmetim 24 orë në shqip për programin e dytë të Radio-Shkupit dhe Kanalit të dytë të Televizionit Kombëtar (të Maqedonisë së Veriut). Në momentin që po shkruhet ky tekst, në Radio-Shkupi transmetohet 17 orë program në gjuhën shqipe, 5 orë në gjuhën turke dhe nga 30 minuta program në gjuhën rome, vllahë, boshnjake dhe serbe. <<https://www.youtube.com/watch?v=-xyakjCAB0Q&feature=youtu.be>>, [15.3.2019]

<sup>236</sup> Bllagoja Nineski, *Локалните електронски медиуми во Македонија (Mediat elektronike lokale në Maqedoni)*, Qendra për shtyp, Radio-Televizioni Prilep 1998, faqja 51

<sup>237</sup> Po aty.

<sup>238</sup> Po aty, faqja 55-99

1962	Radio-Vallandova
23 prill 1963	Radio-Gostivar
1 maj 1963	Radio-Struga
15 prill 1964	Radio-Kumanova
22 maj 1964	Radio-Radovishi
1 shtator 1964	Radio-Negotina
7 shkurt 1965	Radio-Dibra
2 gusht 1966	Radio-Berova
28 gusht 1966	Radio-Probishtip
29 nëntor 1966	Radio-Dellçeva
1967	Radio-Kriva Pallanka
25 prill 1968	Radio-Vinica
1 maj 1969	Radio-Tetova
1 maj 1971	Radio-Sveti Nikolla
8 shtator 1980	Radio-Krusheva
10 mars 1983	Radio-Makedonski Brod
1 prill 1985	Radio-Kratova
21 maj 1985	Radio-Demir Hisar

FIGURA 2. RADIOT LOKALE NË KUADËR TË RADIO-SHKUPIT

Lista e radiove u zgjerua, sidomos afër viteve 1970 kur Jugosllavia po i afrohej periudhës së *komunizmit liberal*.

Ndërkaq, televizioni i Shkupit - i pari stacion televiziv në Maqedoninë e Veriut - filloi punën në vitin 1964. Televizioni-Shkupi (*Телевизија Скопје*) punonte në kuadër të Radio-Televizionit Jugosllav, ndërsa vazhdoi në këtë varësi deri në pavarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Sikurse vërejnë studiuesit, si radioja ashtu edhe televizioni i Shkupit punonin nën të njëjtën politikë të unifikuar rregulluese dhe radiodifuzive në kuadër të Radio-Televizionit Jugosllav, dhe shanset ishin tepër të vogla për krijimtari të lirë programesh apo liri informimi.<sup>239</sup>

Nuk ka pasur një kuadër të qartë ligjor për rregullimin e veprimtarisë së mediave në periudhën komuniste.

Sipas kushtetutës së vitit 1946 të Republikës Popullore Federative Jugosllave, një nen i vetëm (neni 27) fliste për liritë e njeriut ndërkohë që e prekte shumë pak të drejtën për informim dhe lirinë e shtypit (pa përkufizime të qarta).

### Neni 27

*“Qytetarëve iu garantohet e drejta e lirisë së shtypit, e shprehjes, e shoqërimit, e fjalës, e tubimit publik dhe manifestimit”*<sup>240</sup>

<sup>239</sup> Dona Kolar Panova, *Историја на масовните комуникации (Historia e komunikimit masiv)*, Ligjërata të autorizuara, Shkup 2007, faqja 127

<sup>240</sup> Kushtetuta e Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë (Устав Федеративне Народне Републике Југославије), faqja 10, <<http://mojustav.rs/wp-content/uploads/2013/04/Ustav1946.pdf>>, [15.3.2019]

Kjo fjali përbënte gjithçka që u kushtohej lirive të njeriut, përfshi atë për informim. Për sa i përket aspektit teknik dhe normativ të mediave të shtypura dhe radios së asaj kohe, me Ligjin Kushtetues të vitit 1953, radiostacionet nuk ishin më organe shtetërore por *organe të pavarura*. Edhe pse neni 4 i këtij ligji e garantonte këtë pavarësi, deri në vitin 1960 ky harmonizim nuk ndodhi në realitet. Në vitin 1960 u miratua Ligji për Mediat e Shkruara dhe Mjetet e tjera të Informimit i cili për herë të parë përcaktoi që radiot të kenë *kryeredaktorë*, ndërkohë që ligji e bëri të detyruar regjistrimin e korrespondentëve dhe gazetarëve të huaj.<sup>241</sup> Me rregullore të veçantë u përkufizuan edhe licencat e punës, miratimet për punësime të reja si dhe mbikëqyrja e punës së mjeteve të informimit. Në vitin 1974, kushtetuta e re zgjeroi hapësirën e lirisë së informimit, në 3 nene të veçanta; 216, 217, 218.

Në nenin 218 garantohej mundësia e rregullimit të përbashkët të bazave të sistemit shoqëror të informimit në RSFJ. Kjo nënkuptonte se ngushtohej hapësira në të cilën vepronte shteti i përbashkët. Në veprimtarinë informative përkufizohej kështu edhe sovraniteti i Republikave dhe Krahinave.<sup>242</sup>

#### **Neni 216**

*Është e garantuar liria e mendimit dhe e përcaktimit.*

#### **Neni 217**

*Është e garantuar liria e shtypit dhe formave të tjera të informimit dhe shprehjes publike, liria e shoqërimit, liria e shprehjes dhe qëndrimit publik, liria e mbledhjes dhe e formave të tjera të tubimit publik.*

*Qytetarët kanë të drejtë, përmes mediave, të shprehin dhe të publikojnë mendimet e tyre.*

*Qytetarët, organizatat dhe shoqatat e qytetarëve munden, nën kushtet e përcaktuara me ligj, të botojnë dhe të shpërndajnë informacione nëpërmjet mjeteve të tjera të informacionit.*

#### **Neni 218**

*Garantohet e drejta e qytetarit për t'u informuar mbi ngjarjet në vend dhe botë, të cilat janë me interes për jetën dhe punën e tij, sikurse edhe çështje interesi për mbarë komunitetin.*

*Media e shtypur, radio/televizioni dhe mjete të tjera të informimit publik dhe komunikimit, ka për obligim që ta informojë publikun në mënyrë të drejtë dhe objektive, si dhe të publikojë mendime dhe informacione të organeve, organizatave dhe qytetarëve, që janë me interes për publikun.*

*E garantuar është e drejta për të korrigjuar informacionin e publikuar që shkel të drejtën dhe interesin e një personi, organizate ose organi të caktuar.<sup>243</sup>*

Në kushtetutën e vitit 1974 gjendej edhe neni tjetër 299, i cili në paragrafin 26 për herë të parë e detyronte shtetin t'i garantonte Republikave dhe Krahinave, mjete shoqërore për informim publik.

#### **Neni 299**

*Republika Socialiste e Maqedonisë ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:*

*-#-#-#-#*

*26) kujdeset për zhvillimin e mjeteve shoqërore për informim publik;*

<sup>241</sup> Bllagoja Nineski, *Локалните електронски медиуми во Македонија (Mediat elektronike lokale në Maqedoni)*, Qendra për shtyp, Radio-Televizioni Prilep 1998, faqja 29

<sup>242</sup> Po aty, faqja 31

<sup>243</sup> Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë (Устав на Социјалистичка Република Македонија од 1974), <<https://www.marxists.org/makedonski/istorija/makedonija/ustav-srm1974/05.htm>>, [16.3.2019]

Siç theksojnë studiuesit e shkencave politike, kushtetuta e vitit 1974 ofroi më shumë të drejta por nga ana tjetër (veçanërisht nga aspekti politik) rriti aspiratat e Republikave dhe Krahinave Autonome - Vojvodinës dhe Kosovës. Teoria e *Bashkim-Vëllazërimit* që promovonte Titoja nuk bënte gjë tjetër veçse i fshihnte nën rrogos problemet, pa u gjetur zgjidhje të vërtetë atyre.<sup>244</sup>

Media e shkruar dhe radioja, pavarësisht se nuk kishin rregullativë të qartë ligjore dhe as ndonjë organ zyrtar monitorues sa i përket raportimit, etikës etj., (sikurse u theksua më sipër se roli dhe pozita e kryeredaktorit u zyrtarizua vetëm në vitin 1960) punonin më së shumti falë disa tipareve;

- 1) vetëdijes redaktoriale të mediave për të pasqyruar ngjarjet. Pavarësisht se struktura redaktoriale nuk kishte organizim sikurse strukturat e sotme në mjetet e informimit, megjithatë mund të vërehet qartë se fryma komuniste ishte dominuese ndërkohë që në fillimet e medias ishte ende e paimagjinueshme të bëhej dallimi i objektivitetit dhe raportimit të drejtë.
- 2) frymës së mbjellë nga Partia Komuniste e cila përmes sistemit të nomenklaturës kishte mbërthyer çdo segment institucional dhe të jetës shoqërore. Çdo organ i sistemit dhe çdo punonjës në to, nuk mund të ndante bindje të tjera politike kur vetë sistemi u kishte mbyllur dyert forcave të tjera politike. Partia Komuniste, përmes Komitetit për Propagandë të saj kishte nën kontroll jo vetëm organet e shtypit por çdo formë organizative tjetër (sindikata, organizatë shoqërore, rinore etj.) që ishte e detyruar të lexonte shtypin, posterat, broshurat komuniste e kështu me radhë.
- 3) lidhjes parti-shtet. Nuk mund të prisje ndryshe nga një sistem i tillë parti-shtet kur drejtorët e NGB-së (Ndërmarrjes Botuese Gazetareske) dhe RTVM-së ishin automatikisht edhe anëtarë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste. Pozitat e tilla, të rregulluara me ligj, vazhduan deri në pluralizëm. Për vite me radhë, drejtor i NGB-së ishte Pande Kolenishevski ndërsa i RTVM-së, Slobodan Trajkovski. Në zyrat e tyre, telefoni i kuq i instaluar ishte i paevitueshëm. Vendimet nga lart vetëm zbatoheshin, dhe mospërgjigjja në telefonin e kuq mund të të kushtonte jo vetëm karrierën por edhe jetën!

Nga sa u tha më sipër, duhet të theksohet gjithashtu edhe Ligji për Informim Publik i vitit 1974, i cili kishte për bazë *informimin, forcimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të vetëqeverisjes socialiste, demokracisë së drejtpërdrejtë socialiste, barazisë, solidaritetit dhe bashkim-vëllazërimit të popujve dhe kombësive jugosllave, si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar mbi parimet e bashkëjetesës paqësore dhe krijuese.*

Në nenin 19 të këtij ligji kërkohet që “*gazetarët dhe personat e tjerë që merren me informimin e publikut, në kryerjen e kësaj veprimtarie janë të detyruar t’i përmbahen ligjeve, parimeve shoqërore dhe të etikës profesionale si dhe kodit të gazetarëve, të respektojnë të vërtetën, nderin, reputacionin dhe të drejtat e popullit punëtor dhe qytetarëve, të respektojnë interesat e bashkësisë shoqërore, të kontribuojnë në realizimin e vet-menaxhimit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut, të kontribuojnë në forcimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të vetëqeverisjes socialiste, forcimin e barazisë, bashkimin dhe vëllazërimin e popujve dhe kombësive në Republikën Socialiste të Maqedonisë në RSFJ, të kontribuojnë për pavarësi dhe afirmim, si dhe*

<sup>244</sup> Jasmina Udovički & James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë, Historia e vërtetë e dhimbjes së pashprehur të Europës*, Tiranë, Libra për një shoqëri të hapur, Albin 1998, faqja 79

*forcimin e politikës së pavarur dhe të painkuadruar të vendit tonë. Gazetarët dhe njerëzit e tjerë që merren me informimin e publikut janë përgjegjës për saktësinë e përcjelljes së informacionit.*<sup>245</sup>

Ndërsa Ligji për Informim Publik theksonte *respektimin e të vërtetës*, nga ana tjetër, bënte të qartë se gazetarët *duhet t'i përmbahen ligjeve*. Ndërkaq, ligji më i lartë (kushtetuta e vitit 1974) i bënte gazetarët përgjegjës për “korrigjimin” e teksteve (*E garantuar është e drejta për të korrigjuar informacionin e publikuar që shkel të drejtën dhe interesin e një personi, organizate ose organi të caktuar*).<sup>246</sup> Nuk mund të thuhet se kishte një hendek të qartë për veprën e shkeljes së të drejtës së personit, organizatës ose organit të caktuar, në kohën kur propaganda mbizotëronte median, pavarësisht se Kodi Penal e cilësonte një vepër të tillë si shpifje (neni 84), ofendim (neni 85) apo nënçmim (neni 86), të dënueshme më së shumti me 6 muaj burg.<sup>247</sup>

Ndërkaq, gazeta “Flaka e Vëllazërimit” nuk bënte dallim në këtë “zhvillim” mediatik. Pavarësisht se i adresoj opinionit publik shqiptar të Maqedonisë së asaj kohe, *në emër të vëllazërim-bashkimit*, kjo gazetë duhej të dënonte po aq fort aspiratat e shqiptarëve për të drejta. Çdo formë manifestimi, proteste dhe demonstrimi e shqiptarëve cilësohej si *nacionalizëm, separatizëm dhe irredentizëm*. Ideo-politikisht, gazeta nuk bënte diferencim nga mendësia komuniste shumicë – ajo maqedonase. Gazeta mbështeste parimin parti-shtet dhe lartësonte figurën e *shokut* Tito. Ndër kryeredaktorët udhëheqës të gazetës “Flaka e Vëllazërimit” mund të përmenden Petro Janura,<sup>248</sup> Fejzi Bojku, Abdylhadi Zylfiqari, Faik Mustafa, Zeqirja Rexhepi, Daut Dauti etj.

Pavarësisht prefiksit *ideo-politik*, nuk mund të mohohet që kjo gazetë i jepte sado pak peshë arsimit shqip dhe kulturës së shqiptarëve.

#### 4.1.3 Forma, struktura dhe raportimi (propaganda e mediave të robëruara)

Si mund të jetë forma e ndërtimit të mediave, struktura e lajmit dhe raportimi gazetaresk në regjimin komunist?

Janë dhjetëra pyetje që mund të konkretizojnë këtë segment, edhe pse për gjithsecilën prej tyre, përgjigjja është e ditur tashmë.

Sikurse hodhëm një vështrim mbi sistemin politik të BRSS-së, Shqipërisë dhe RSFJ-së, dallimet janë shumë të vogla. Rrënja ishte e njëjtë: *komunizmi marksist-leninist*. Përjetimi në këto shtete kishte shumë pak nuanca që linin hapësirë për të komentuar *propagandën*.

<sup>245</sup> Gazeta Zyrtare e Maqedonisë, *Ligji për Informim Publik 1974*, 29 prill 1974, faqja 453, <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/A13900384849485BA96D4F3F2B8FE59B.pdf>>, [17.3.2019]

<sup>246</sup> Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë (Устав на Социјалистичка Република Македонија од 1974), <<https://www.marxists.org/makedonski/istorija/makedonija/ustav-srm1974/05.htm>>, [17.3.2019]

<sup>247</sup> Kodi Penal, Gazeta Zyrtare e Maqedonisë, 18 qershor 1974, faqja 499, <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/5B14302A444C45DA848F1F21C9E34933.pdf>>, [17.3.2019]

<sup>248</sup> Petro Janura ishte kryeredaktori i parë i gazetës “Flaka e Vëllazërisë”. Ai ishte me origjinë nga Shqipëria, dhe sipas studiuesve, Janura dha kontribut jo vetëm në themelimin e gazetës, por edhe në themelimin e Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Shkupit. Ai ishte edhe delegat në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe në vitin 1972 në Tiranë.

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, *70 vjetori i botimit të gazetës “Flaka e Vëllazërimit”*, Tribunë shkencore 2015, Vëllimi 10, faqja 9-10, <<https://www.scribd.com/document/353298430/Scupi-10-pdf>>, [18.3.2019]



Ndërtimi i mediave në periudhën komuniste ka qenë tepër i thjeshtë; grupe të vogla gazetarësh në fillimet e veprimtarisë së tyre dhe në përpjekje për të bërë “gazetari”, të varur kryekëput nga shteti dhe qendrat partiake të propagandës, pa mos e anashkaluar edhe faktin që gjithsecili prej të punësuarve në media ishte i mbushur dhe ngarkuar me *ideo-politikën komuniste*, i etur për të luftuar vetëm format “armiçësore” që numëronte regjimi në pushtet, pa të drejtë drejtimi pyetjesh ndaj zyrtarëve, pa kritikë për të bërë akoma më mirë aty ku kishte vend, pa analizë të qëndrimeve, pa mundësi ndërtimi teksti objektiv, pa palë të parë akuzuese etj. Në plan të parë, gjithnjë duhej të ishte vetëm zyrtari politik ndërsa në tekst duhej të përdorej gjuhë dhe ton sa më i pasur *proletar* me fjalë kyçe klishe dhe pompozitet fiktiv. Gazetarët kishin frikë nga paraqitja e zërave ndryshe, zërit real të qytetarit (popullit), gjetja e këndeve gazetareske për trajtime të ndryshme të ngjarjes.<sup>249</sup> Këto dhe dhjetëra e dhjetëra të meta të tjera kishin vetëm një fajtor – *censurën* që kishte vendosur partia-shtet dhe *autocensurën* që kishin ngritur nga kulti i frikës vetë punonjësit e medias.

Censura e cila nënkupton ndonjëherë edhe normativën penalizuese në rast të mosrespektimit të propagandës që vinte nga lart, ushtrohej në media në tri rrafshë; 1) nga Komiteti Qendror i Partisë që e transmetonte atë te kupola redaktoriale 2) nga organizatat e masave që përfshinin edhe botuesit, si dhe 3) nga letrat që dërgoheshin në redaksi nga masa... Ndërsa autocensura ishte mekanizmi vetëmbrojtës (vetëkontrolli dhe vetëpërmbytja) i gazetarit që të frenonte dhe parandalonte idetë dhe konceptet e papranueshme për autoritetet pushtetare që ushtronin censurën.<sup>250</sup>

Në kohën kur mbretërit ishin *mbretër*, Luigji XIV bëri deklaratën e tij modeste “L’Etat s’est moi!” (Shteti jam unë!). Përafërsisht kishte të drejtë.<sup>251</sup> Regjimet e mëvonshme ishin specifike për nga karakteri dhe ideologjia politike, veçanërisht edhe nga rrethanat në të cilat u instaluan; pas luftërave, pas përmbyesjeve të regjimeve etj.

Propaganda, sipas studiuesve, ka nevojë për të paktën 3 elementë; 1) *shoqërinë individualiste dhe shoqërinë e masave* (kjo ndarje e shoqërisë në dy bindje nënkupton se individit krijon vlera individualiste më të mëdha se grupi ndaj të cilit ai ndikon për ta nënshtruar), 2) *opinionin* që formohet në grupe dhe që zgjerohet në shoqëri, si dhe 3) *masmedian për komunikim*. Opinioni nuk mund të formohet dot pa mjetet e komunikimit që i drejtohen masës, pa ndjesinë e një supra-mendjeje. Njeriu s’mund t’i shpëtojë tërheqjes nga radioja dhe televizioni.<sup>252</sup>

Pra, tani që e kemi të qartë propagandën, mund të kuptojmë akoma më mirë formën e ndërtimit të mjeteve të komunikimit në vendet e Bllokut Lindor. Edhe sikur asgjë të mos përmendet për to, mjafton të kujtojmë vetëm faktin që drejtuesit e tyre ishin edhe anëtarë të

<sup>249</sup> Sami Nezaj, *Gazeta - Menaxhimi i krizës në median e shkruar*, Tiranë 2014, UET Press (Shtëpia botuese universitare e Universitetit Evropian të Tiranës), faqja 53

Fatos Lubonja në një shkrim “Variacion mbi temën” të botuar në gazetën Panorama në Shqipëri, në 31 gusht, i cituar nga Nezaj në librin e mësipërm “Gazeta” shkruante: *Një gazetar, sipas meje nuk mund të ulet të shkruaj pa pasur mendimin se shkrimi i tij do të ndryshojë diçka lidhur me çështjen apo shqetësimin që ngre, sigurisht në drejtim të vizionit dhe vlerave që ai mbron. Pa këtë motivim, është e vështirë kjo punë... tashmë, gjithnjë e më shpesh më duket sikur gazetarit nuk i ka mbetur gjë tjetër veçse ose ta marrë rryma me vete (me këtë, kuptoj vënien në shërbim të politikës dhe jo idealit të së vërtetës) ose të dalë në një breg të lumit, ndoshta duke pritur të realizojë thënien e proverbit kinez, sipas të cilit “Nëse do të shohësh kufomën e armikut, rri e prit në breg të lumit”.*

<sup>250</sup> Afërdita Hysa, *Statusi i gazetarit shqiptar në shtypin e viteve 45-90*, Autoreferat, Universiteti i Tiranës, 2015, faqja 8

<sup>251</sup> Edward L. Bernays, *Propaganda*, New York, Horace Liverlight, 1928, faqja 19

<sup>252</sup> Jacques Ellul, *Propaganda, The formation of man’s attitudes*, Vintage Books, New York 1973, faqja 90-104

Komitetit Qendror të Partive Komuniste. Kështu ndodhte në BRSS, kështu ishte në Shqipëri, dhe po kështu ishte edhe në RSFJ.

Media shtetërore, censura dhe organet e propagandës ishin të gjitha vegla të veprimtarisë së Partisë Komuniste. Në të gjitha vendet e Bllokut Lindor kishte vetëm një model për t'u ndjekur... Edhe pse nuk kishte *ligj mbi shtypin* dhe as *censurë zyrtare*, të gjitha mediat ishin nën kontrollin direkt të partisë-shtet. Për këtë qëllim, një departament për median në Komitetet Qendrore të Partive Komuniste ishte i ngarkuar me funksionin mbikëqyrës, për të realizuar takime me kryeredaktorët.<sup>253</sup>

Nëse i hedhim një vështrim të shkurtër vetëm logove të gazetave kryesore shtetërore, mund të shohim përkatësinë shtetërore dhe partiake të tyre. Në gazetën “Pravda” shkruhej “*Орган Центрального Комитета и МК ВКП*”<sup>254</sup> (Organ i Komitetit Qendror dhe i Komitetit Moskovit të Partisë Komuniste Bolshevike të Mbarë-Bashkimit Sovjetik).<sup>255</sup> Prapashtesa “МК ВКП” ndryshonte jo vetëm për nga komiteti lokal që mbikëqyrte gazetën por edhe kur Republika Ruse ndryshonte etiketimet nga Komuniste në atë Socialiste.

Ndërkaq, “Zëri i Popullit” në Shqipëri, po ashtu me krenari vuloste përkatësinë partiake të saj. Nën titull shkruhej “*Organ i Komitetit Qendror të PPSH*”.<sup>256</sup> Në fillimet e saj, “Zëri i Popullit” ishte organ i Frontit Popullor ose organ i Partisë Komuniste. Edhe këtu, fillimisht kishim Partinë Komuniste, Partinë e Punës dhe më vonë Partinë Socialiste të Shqipërisë.

“Nova Makedonija” gjithashtu mbante shënimin “*Орган на Народно-Ослободителниот Фронт на Македонија*” (Organ i Frontit Popullor Çlirimtar të Maqedonisë).<sup>257</sup> Siç u përmend më sipër, edhe gazeta në gjuhën shqipe “Flaka e Vëllazërimit” nuk bënte aspak dallim, pasi ishte gjithashtu produkt i të njëjtës frymë komuniste. Nën logon e saj qëndronte gjithashtu “*Organ i Frontit Nacional-Çlirimtar të Maqedonisë për Shqiptarët e Maqedonisë*” ose “*Organ i Lidhjes Socialiste të Popullit Punëtor të Maqedonisë*”.<sup>258</sup>

Për sa i përket strukturës së lajmit dhe raportimit mediatic, gjithçka të linte për të dëshiruar, nëse e krahasojmë me zhvillimin e sotëm të gazetarisë sipas standardeve dhe mbi të gjitha, gazetarinë pluraliste dhe të lirë.

Në shkrimet nëpër gazeta apo edhe në radio, nuk gjeje gjë tjetër përveç gjuhës agresive politiko-propagandistike, jo vetëm të *mobilizimit të masave* sipas direktivave të partisë komuniste, por edhe tonin e ashpër ndaj *revizionistëve, shteteve imperialiste, kapitaliste* etj., siç thirrreshin vendet përëndimore SHBA-ja, Britania, Franca etj.

<sup>253</sup> Patrick H. O'Neil, *Post-Communism and the Media in Eastern Europe*, Londër&Nju Jork, Routledge 2013, faqja 125

<sup>254</sup> Emri origjinal “*Орган Центрального Комитета и Московского комитетов Всесоюзная коммунистическая партия большевиков*”.

<sup>255</sup> Foto nga një botim i gazetës “Pravda”, <[http://www.aboutww2militaria.com/image/item\\_img/March2013/10-days-before-finnish-winter-war-pravda-soviet-newspaper-from-18-november-1939-year--93361.JPG](http://www.aboutww2militaria.com/image/item_img/March2013/10-days-before-finnish-winter-war-pravda-soviet-newspaper-from-18-november-1939-year--93361.JPG)>, [19.3.2019]

<sup>256</sup> Foto nga një botim i gazetës “Zëri i Popullit”, <<https://lapsi.al/2017/06/26/fotolajm-kur-zgjedhjet-i-fitonte-nje-parti-me-99-99-por-kishte-dhe-vota-kunder/>>, [19.3.2019]

<sup>257</sup> Foto nga një botim i gazetës “Nova Makedonija”, <<https://www.novamakedonija.com.mk/makedonija/%D0%B3%D0%BB%D0%B0%D0%B2%D0%B5%D0%BD-%D1%83%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B8%D0%BA-%D1%81%D0%B0%D0%BC%D0%BE-%D0%B7%D0%B0-%D0%BF%D1%80%D0%B2%D0%B8%D0%BE%D1%82-%D0%B1%D1%80%D0%BE%D1%98/>>, [19.3.2019]

<sup>258</sup> Foto nga një botim i gazetës “Flaka e Vëllazërimit”, <<http://flurudha.blogspot.com/2015/04/nga-historiku-i-filleve-te-gazetes.html>>, [20.3.2019]

Në shkrimet e gazetës “Pravda” të përzgjedhura në mënyrë rastësore në internet, dallohet fare qartë ky stilizim propagandues si më poshtë.

*“Kujt i shërbejnë këta përbindësh? Kush orkestroj aktivitetet kriminale, terroriste dhe keqdashëse të tradhtarëve të ligë ndaj atdheut tonë? Çfarë qëllimi donin të arrinin me vrasjen e figurave udhëheqëse të qeverisë sovjetike?....*

*Populli sovjetik nuk do të harrojë për asnjë moment nevojën për vigjencë të çfarëdo mënyre, të jetë syçelur për të gjitha skemat e agresorëve të shtetit tonë dhe agjentëve të tyre, si dhe të shtrëngoje radhët e Forcave të Armatosura dhe organeve të sigurimit të shtetit.*

*Shoku Stalin na ka paralajmëruar gjithnjë, se sukseset tona kanë edhe rrezikun e tyre. Të mos jemi të përgjumur, sepse përgjumja na bën shënjestër sabotimi.... Ashtu na mëson i pavdekshmi Lenin, kështu na mëson edhe shoku Stalin.*

*“Në revolucionin tonë – na ka thënë Lenini – aq sa rritet forca dhe përcaktimi ynë, aq rritet edhe kundërshtimi i borgjezisë....”<sup>259</sup>*

Në analizën e këtij teksti dallohen shumë aspekte të propagandës; 1) përdorimi i shkallës sipërore të mbiemrave si: *kriminal, terrorist, keqdashës, i lig* 2) pyetjet (e pazakontë në tekstet gazetareske) si: *kush orkestroj, çfarë qëllimi, kujt i shërbejnë* etj. 3) përdorimi i ndjesisë së fajit me fjalët si: *popull i përgjumur, përgjumja na bën shënjestër sabotimi, sukcesi ka rrezikun e vet, revolucioni e nxit më shumë borgjezinë* 4) apelet për të luftuar fenomenin me fjalët si: *të jemi syçelur, të jemi vigjilentë, të shtrëngojmë radhët, të rritim forcën, të përcaktohem* 5) morali i nxjerrë nga ngjarja me fjalët kyçe si: *Shoku Stalin na kishte paralajmëruar, Lenini na ka mësuar* etj.

\*\*\*

Le t’i hedhim një sy njërit prej shkrimeve të gazetës “Zëri i Popullit” e cila ishte e mbushur që në kreun ballor të saj me mbishkrimet “*Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!*” ose “*Për një Shqipëri socialiste të të gjithë shqiptarëve*”. Përveç lajmeve me vendimet e Plenumeve apo Kongreseve të Partisë, një hapësirë e madhe i kushtohet lajmeve mbi realizimin e planeve të drithërave, bollëkun e perimeve,<sup>260</sup> mishit, e kështu me radhë, edhe pse pamja në realitet ishte krejtësisht e ndryshme dhe buka e grurit ndahej me gramaturë për kokë banori. Nga ana tjetër, shkrimet për daljen masive të qytetarëve deri në 100% në zgjedhjet e kandidatëve të Frontit Demokratik për deputetë në Kuvendin Popullor ishte një farsë e radhës pasi partitë e tjera, siç u theksua më sipër, u *shpartalluan*. Titujt me superlativa për partinë dhe masat pushtonin të gjitha faqet e “Zërit të Popullit”, sikurse: “*Shprehje e shkëlqyer e unitetit të çeliktë të popullit rreth Partisë e Pushtetit popullor*”.<sup>261</sup>

<sup>259</sup> Pjesë e një artikulli në “Pravda”, botuar në vitin 1953. Me aq sa kuptohet nga teksti propagandues, lajmi për vrasjen e disa zyrtarëve nga një grup doktorësh të paguar nga shërbimi sekret amerikan, përdoret për mobilizim të radhëve kundër çdo shfaqje të huaj. “Pravda”, E martë, 13 janar 1953, faqja 1. “*Spiunë agresorë dhe vrasës nën maskën e doktorit*”, <<http://www.cyberussr.com/rus/vrach-ubijca-e.html>>, [21.3.2019]

<sup>260</sup> Fotografia ilustruese nga një numër i gazetës “Zëri i Popullit” që mban datën e 26 shtatorit të vitit 1989 me titullin “*Puna, festa e gëzimi në Konispol, i grave të Sarandës*”, <<https://www.qmksh.al/en/25-gusht-1942-doli-gazeta-zeri-i-popullit/>>, [21.3.2019]

<sup>261</sup> Fotografia ilustruese nga një numër i gazetës “Zëri i Popullit” që mban datën e 3 shkurtit të vitit 1987, <<http://www.javanews.al/saimir-tahiri-ringjall-gazeten-zeri-i-popullit-zbulohet-projekti/>>, [21.3.2019]

Në një shkrim të gazetës “Zëri i Popullit” me titull “*Të ndjekim sistematikisht realizimin e 300-ditëshit*” (E shtunë, 9 korrik 1960) mund të vërehet fryma revolucionare dhe mësimet e partisë, madje edhe në çdo aksion bujqësor për korrjet dhe shirjet.<sup>262</sup>

*“Në të katër anët e vendit tonë ka shpërthyer një vrull i madh për punë, për nder të Kongresit të 4-të të Partisë. Në këtë valë të madhe revolucionare janë përfshirë edhe punonjësit e bujqësisë të cilët në këtë periudhë kanë shumë punë të rëndësishme dhe urgjente, të vendosin për fatin e prodhimeve bujqësore. Tani kudo ka filluar korrja, shirja dhe grumbullimi i të lashtave.*

*Dhe kjo është një punë që s’pret, duhet kryer shumë shpejt dhe me kujdes, që të mos humbet asnjë kokërr grurë. Krahas me korrjen dhe largimin e duajve, kooperativistët duhet të bëjnë menjëherë dhe pastrimin e fushës dhe mbjelljen e misrit në hamullore, si kulturë për kokërr dhe për sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë....*

*Pra, kooperativistët tanë të cilët janë zotuar të bëjnë 300 e më shumë ditë pune për këtë vit, kanë tani zotime të shumta pune për të plotësuar boshllëqet që mund të kenë pasur gjatë muajve të parë të vitit, të cilët qenë me shi. Tani shumë kooperativistë të Lushnjës, Fierit, Vlorës, Gjirokastrës dhe rretheve të tjera kanë tejkualuar mesataren e 6 mujorit sipas zotimit, dhe po punojnë për realizimin por edhe tejkalimin e zotimeve të tyre.*

*Anëtari i Kooperativës Bujqësore të Pirrës në rrethin e Lushnjës, Thoma Çili, deri më sot ka bërë mbi 350 ditë pune. Ai i ka vënë detyrë vetes që ditën e parë të Kongresit të 4-të të PPSH-së të ketë realizuar zotimin që ka marrë për të bërë 630 ditë pune. Dhe rezultatet e deritanishme tregojnë se zotimin do ta plotësojë me nder.*

*Lëvizja e 300-ditëshit, si një lëvizje e madhe patriotike që lindi për nder të 15 vjetorit të çlirimit të atdheut, dhe që u përqaftua dhe u përhap nga kooperativistët e Gjirokastrës, dhe u bë lëvizje masive në të gjithë vendin, duhet të ndiqet sistematikisht nga kryesitë dhe organizatat bazë të partisë të kooperativave bujqësore.*

*.... është e nevojshme që këto zotime të ndiqen çdo ditë, javë, muaj dhe gjithë vitin. Është e nevojshme që kryesitë e kooperativave bujqësore për çdo brigadë të bëjnë një plan të posaçëm për ndjekjen e këtij problemi dhe numri i ditëve të punës që është zotuar të bëjë çdo anëtar gjatë vitit, të ndahet në muaj dhe përbri tij të shënohen ditët e punës që ka kryer secili....*

*Lëvizja e 300-ditëshit, si një lëvizje përparimtare, ka për qëllim që krahas me kryerjen e 300 e më shumë ditëve të punës në vit, t’i edukojë kooperativistët me ndjenjën e përgjegjësisë ndaj punës që iu besohet, d.m.th. jo vetëm të tejkalojnë sa më shumë normat, por ti kryejnë ato me cilësi të mirë, d.m.th., çdo ditë pune të matet me prodhimin që jep si sasi e cilësi. Ajo ka njëkohësisht për qëllim, forcimin e disiplinës në punë dhe ndjenjës së kursimeve, të dashurisë....”*

Siç shihet nga lajmi, i vetmi detaj informues është se lëvizja 300-ditëshe e shpallur nga shteti nxit kooperativistët të punojnë për ta tejkualuar këtë normë, në nder të Kongresit të Partisë. Por, vetë informata për *zotim* përbën një propagandë të pushtetit për nxitje, edhe pse realiteti është i ndryshëm. Siç kuptohet nga shkrimi, gazetari ka frikë të përmend se në muajt e parë të vitit ka pasur boshllëqe. Madje, kur shkruan: “*boshllëqet që mund të kenë pasur gjatë muajve të parë të vitit*”, gazetari nuk është i sigurt nëse guxon ta përmend një gjë të tillë apo jo, duke dashur ta zbutë dramaticitetin e situatës me shprehjen: “*që mund të kenë pasur...(boshllëqe)*”.

Për të kompletuar frymën e propagandës, mjafton të shihen superlativat si *vrull i madh, zotime pune, tejkalim zotimesh, punohet shpejt, punohet me kujdes, nuk humbet asnjë kokërr gruri*. Pastaj, nuk mund të harrohet morali i punës si *puna është nder e lavdi, puna rrit ndjenjën e*

<sup>262</sup> Fotografia ilustruese nga një numër i gazetës “Zëri i Popullit” që mban datën e 9 korrikut të vitit 1960, <[68](https://www.facebook.com/photo.php?fbid=10102508416145890&set=a.10100876214895280&type=3&theater></a>, [21.3.2019]</p>
</div>
<div data-bbox=)

*përgjegjësisë, puna rrit prodhimin në sasi e cilësi, rrit mirëqenien, forcon disiplinën, nxit kursimin, rrit dashurinë për atdheun etj.* Në fund, nuk mund të anashkalohej kërkesat shpesh që ka shtruar partia, tani që plani përparimtar i 300-ditëshit po funksionon: *duhet të shënohen zotimet, duhet të ndiqet sistematikisht përparimi nga kryesitë e kooperativave bujqësore dhe organizatat bazë të partisë...*

Në RSFJ, realiteti mediatik i viteve të komunizmit kishte dy karakteristika të veçanta që e bënin lajmin dhe gjuhën e tij të dallonte në krahasim me BRSS-në dhe Shqipërinë;

1) *komunizmi në zbutje*, veçanërisht pas kushtetutës së vitit 1974 dhe

2) *karakteri federal* (i republikave dhe 2 krahinave) si dhe kombësive të tyre ose *narodnosti*<sup>263</sup> siç quhej në atë kohë komuniteti shqiptar dhe ai turk.

Megjithatë, ishte e qartë se sërish faqja e parë e gazetës “*Nova Makedonija*” do të ishte me lajme rreth mbledhjeve të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste, mbledhjet farse të Lidhjes së Sindikatave që zotoheshin për më shumë punë në vend të të drejtave të punëtorëve, telegramet e urimit që Tito merrte apo u dërgonte përfaqësuesve të lartë të shteteve të tjera komuniste, me lajme që bënin thirrje për *bashkim-vëllazërim* (teorinë frymëzuese të marrëdhënieve të mira mes kombësive përbërëse të RSFJ-së), lajmet mbi realizimin e planeve në industri, në bujqësi etj.

Përveç lajmeve të pozicionuara në anën e majtë me mesazhet e Titos, gjithnjë në faqe të parë *duhej të gjendej vend* edhe për politikën e jashtme, për problemet me Tiranën apo marrëdhëniet me Moskën zyrtare.

Ja dy lajme në ballinën e gazetës në datat 6 dhe 7 nëntor të vitit 1959 që tregojnë se sa i rëndësishëm ishte imazhi i vendit në arenën ndërkombëtare në krahasim me imazhin e brendshëm.<sup>264</sup>

#### ***Telegram i presidentit Tito për Hrushovin.***

***Beograd, 6 nëntor.*** Sekretari i Përgjithshëm i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë Josip Broz Tito i dërgoi Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Kryetarit të Këshillit të Ministrave të BRSS-së Nikita Sergejeviç Hrushov një telegram me përmbajtjen si vijon: “*Më lejoni që me rastin e festimit të 40-vjetorit të Revolucionit të Madh të Tetorit, t’ju dërgoj urime të përzemërta, juve personalisht dhe anëtarëve të Partisë Komuniste të lavdishme të Bashkimit Sovjetik e*

<sup>263</sup> Kushtetuta e ndryshuar u miratua më 25 shkurt 1974 (Fletorja zyrtare, numri 7 Одлука за прогласување на Уставот на Социалистичка Република Македонија),

<<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/0AF2E0456C964935B7705FB5BF6F31F9.pdf>>, [22.3.2019]

Në të theksohet se “Kombi maqedonas, së bashku me kombësitë në Maqedoni, në luftën e përbashkët nacional-çlirimtare së bashku me kombet dhe kombësitë e tjera jugosllave, krijoi Republikën Socialiste të Maqedonisë si shtet kombëtar të kombit maqedonas dhe shtet të kombësisë shqiptare dhe turke në të, në të cilën u realizuan aspiratat historike të kombit maqedonas për liri kombëtare dhe mëvetësi shtetërore, të kombësive për barazi dhe të popullit punëtor dhe të gjithë njerëzve punëtorë për shoqëri socialiste.

Neni 1

*Republika Socialiste e Maqedonisë është shtet kombëtar i kombit maqedonas dhe shtet i kombësisë shqiptare dhe turke në të, e themeluar mbi sovranitetin e popullit, mbi pushtetin dhe vetëqeverisjen e klasës punëtore, të gjithë njerëzve punëtorë dhe bashkësisë vetëqeverisëse socialiste demokratike të njerëzve punëtorë dhe qytetarëve, të popullit maqedonas dhe të barabartëve me të, kombësia shqiptare dhe turke. Republika Socialiste e Maqedonisë është pjesë e Republikës Socialiste Federative Jugosllave.*

Në kapitullin e 11-të të Kushtetutës me titull “*Barazia e kombësive*”, neni 177 në pjesën e parë të tij thonë në mënyrë të qartë se “*Kombi maqedonas dhe kombësitë në Republikën Socialiste të Maqedonisë janë të barabarta dhe kanë të njëjtat të drejta e detyrime*”.

<sup>264</sup> Shkrimet janë nxjerrë nga arkivi i gazetës “*Nova Makedonija*” që mban datën 18.3.2019 dhe i përkasin datave 6-7.11.1959

*cila nën udhëheqjen e gjenit Lenin realizoi Revolucionin dhe me këtë hapi epokën e re të zhvillimit të njerëzimit - epokën e zhvillimit të Socializmit.*

*Popullit të Bashkimit Sovjetik, qeverisë suaj dhe juve shoku Hrushov, ju uroj shumë suksese në realizimin e një të ardhme të madhërishe dhe të lumtur. Besoj në fitoren e ideve të paqes dhe bashkëpunimit paqësor ndërkombëtar, për të cilin po luftoni ju dhe të gjithë njerëzit progresiv në botë. Shpreh dëshirat e të gjithëve ne, për një zhvillim të mëtejshëm edhe më të suksesshëm të raporteve mes dy vendeve tona, për bashkëpunim miqësor dhe mirëkuptim të ndërsjellë.”*

#### ***Në Tiranë sulmohet sërish dhe në mënyrë të ashpër Jugosllavia.***

Realizuesi i Punëve të Jugosllavisë Vujoviq braktis në shenjë proteste Akademinë e organizuar për nder të 42-vjetorit të Revolucionit të Tetorit.

***Beograd, 7 nëntor.*** Në akademinë e mbajtur mbrëmë në Tiranë për nder të 42-vjetorit të Revolucionit të Tetorit, që u hap nga zëvendësi i parë i Kryetarit të Qeverisë, gjeneral-kolonel Beqir Balluku, dhe në të cilën përkaj mysafirëve të tjerë ishin të pranishëm edhe udhëheqësit më të lartë shtetërorë dhe partiakë të Shqipërisë si dhe anëtarët e trupit diplomatik, kandidati për anëtar i Byrosë Politike dhe Sekretari i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë Haki Toska, në fjalimin e tij sulmoi me ashpërsi popujt dhe udhëheqjen e Jugosllavisë. Realizuesi i Punëve të Jugosllavisë në Tiranë, Milutin Vujoviq, i cili ishte ftuar zyrtarisht të merrte pjesë në këtë ngjarje, në shenjë proteste e braktisi akademinë.

Në këto dy lajme, të pasuara nga një seri komentesh mbi marrëdhëniet mes shteteve të familjes komuniste, lartësohej vetëm partneri momental që kishte Jugosllavia. Siç shihet nga toni, Tito theksonte se: *vetëm ideja e Leninit – socializmi – hapi epokën e zhvillimit të njerëzimit.* Jugosllavia lartëson socializmin dhe Bashkimin Sovjetik si vend mik, ndërsa garanton ndjekjen e të njëjtës rrugë. Nga ana tjetër, nuk harrohet pasqyrimi i marrëdhënieve me Shqipërinë dhe përplasjet ideo-politike mes vendeve. Pavarësisht se të dyja shtetet ishin komuniste, interpretimet mbi mësimet e Leninit ishin të ndryshme.

Bashkëngjitur me këtë seri lajmesh gjenden edhe lajme të tjera mbi mbledhjet e Partisë Komuniste, plenumet, byrotë, organizatat lokale komuniste etj., me një numër politikash e rregullash të publikuara që duket se merrnin në menaxhim edhe vetë jetën e *popullit punëtor.*

Ndërkaq, “Flaka e Vëllazërimit”, gazetë në gjuhën shqipe e cila gjithashtu ishte pjellë (organ) e Lidhjes Socialiste të Popullit Punëtor të Maqedonisë, në qindra raste shfaqte më shumë *atdheadashuri* dhe *titizëm* se sa vetë “Nova Makedonija” apo gazetat e tjera në gjuhën maqedonase. Në faqen e parë të kësaj gazete, jo vetëm që të binte në sy mungesa e profesionalizmit, varfëria e gjuhës shqipe, faqosja e çoroditur etj., por ndeshej edhe fryma komuniste dhe një propagandë shpëlarëse lidhur me çdo mbledhje, çdo vendim e konkluzion të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë. Dominonin shprehjet pompoze sikurse “*Socializmi nuk ndërtohet me bajoneta por me koshiencë (ndërgjegje) të lartë të qytetarëve*”, “*Dita e kryengritjes u shënua me një sërë solemnitetesh në mbarë Republikën*”, “*Zbatim më të shpejtë të ligjit për praktikantë në bujqësi (agronomë e pemëtarë)*”, “*Rezultatet e deritanishme nuk mjaftojnë*” etj., të nxjerra përgjatë botimeve të vitit 1968.

Aq e ashpër ishte propaganda *pro-socializmit* dhe *bashkim-vëllazërimit* sa që gazeta “Flaka e Vëllazërimit” iu dilte kundër edhe vetë shqiptarëve në rast se ndonjë grup i caktuar ngrihej për të protestuar, sikurse ndodhën protestat e 22-23 dhjetorit të vitit 1968 në Tetovë. Në numrin e 26 dhjetorit (duke qenë se gazeta dilte njëherë në tre ditë), lajmi i parë mbante titullin “*Demonstrata armiqësore në Tetovë*”, i ndjekur nga “*Armiqtë u mashtruan*”, “*Mbledhje e drejtuesve të organizatave shoqëroro-politike të Tetovës – njëzëri u dënuan demonstratat dhe*

*organizatorët e tyre – ato janë të orientuara kundër fitoreve të ndërtimit socialist”, “Konstatim unik: Demonstratat, armiqësore dhe reaksionare”.*

#### **Demonstrata armiqësore në Tetovë**

**26 dhjetor.** Më 23 të këtij muaji në Tetovë pati demonstrata në të cilat morën pjesë disa qindra qytetarë nga kombësia shqiptare, kryesisht nxënës. Ata demonstruan nëpër rrugët e Tetovës. Demonstratat kryesore u mbajtën në sheshin e qytetit dhe zgjatën deri në mbrëmje.... rreth orës 14:00 demonstruesit hynë në ambientet e Komitetit Komunal të Lidhjes Komuniste, thyen një pjesë të xhamave, shkaktuan dëme dhe nga dritarja e zyrës së kryetarit të Lidhjes Komuniste valëvitnin flamurin shqiptar duke hedhur parulla reaksionare dhe armiqësore.... e gjithë kjo nisi në mbrëmje, më 22 dhjetor kur një grup nacionalistësh shqiptarë duke shfrytëzuar si shkak tentativën e një qytetari që të hiqte flamurin shqiptar, u grumbulluan në sheshin e qytetit. Mirëpo, pas bisedës me shumë punonjës shoqëroro-politikë të qytetit, ata u shpërndanë nëpër shtëpitë e tyre. Këtë ngjarje, maqedonasit e Tetovës e dënuan si provokuese dhe nacionaliste. Kështu reagues edhe shqiptarët e Tetovës, të cilët, një shfaqje të tillë nacionaliste nuk mund ta cilësojnë si nënçmim të popullsisë shqiptare, por si një akt individual të një shovinisti, që në bazë të dispozitave pozitive ligjore, dënohet....

*I rëndësishëm është fakti se në mes të demonstruesve gjendej edhe një numër i madh personash të panjohur që nuk janë nga Tetova. Ky është vetëm një nga elementet që tregojnë se demonstratat janë të organizuara dhe janë vepër e forcave reaksionare dhe të errëta, veprimtaria e të cilave është regjistruar edhe më parë.*

#### **Armiqtë u mashtruan**

Më 22 dhe 23 të muajit vijues, duke shfrytëzuar rastin e festës fetare myslimane të Bajramit, forcat e errëta reaksionare të ngjyrave të ndryshe përsëri, sikurse më 28 e 29 nëntor, kur disa persona reaksionarë dhe armiq shfrytëzuan flamurin shqiptar për të organizuar eksese provokuese, dolën në rrugët e Tetovës... Demonstratat dhe organizatorët e tyre kishin për qëllim të nxitnin për ballafaqim popullsinë shqiptare kundër popullit maqedonas, dhe kundër socializmit dhe vetëqeverisjes duke dëshiruar të ngjallnin mosbesim dhe urrejtje nacionale për të thyer frytin më të shtrenjtë të revolucionit tonë popullor, bashkim-vëllazërimin e popujve dhe kombësive të bashkësisë sonë socialiste... Me këtë rast u vërtetua një e vërtetë e vjetër se nacionalizmi dhe shovinizmi i njëjës palë ushqen nacionalizmin dhe shovinizmin e palës tjetër, dhe kështu, duke nxitur njëri-tjetrin, luftojnë pa mëshirë dhe pa zgjedhur mjete, kundër të ardhmes së popullsisë së vetë si dhe kundër shoqërisë socialiste dhe marrëdhënieve vetëqeverisëse....

I njëjti lajm, i katapultuar fjalë për fjalë nga Qendra për Propagandë e Partisë Komuniste, barte të njëjtën frymë edhe në gazetatat e tjera. Kishte edhe nga ato që e tepronin dozën e kritikës, sidomos “Rilindja” apo “Veçer” të cilat shfaqnin një ton akoma më të vrazhdë që në titujt e lajmeve; “*Qëllimi i organizatorëve – shkatërrimi i Bashkim-Vëllazërimit*”, “*Liria shfrytëzohet për qëllime të errëta*”. Këto gazeta mbështesnin madje edhe diferencimin e arsimtarëve ose mjekëve shqiptarë të larguar nga puna, për shkak të akuzave si pjesëmarrës në protesta. Ata që prishnin këtë koncept socialist e titist ishin veçse *armiq*, sidomos duke ditur se shqiptarët si *kombësi e RSFJ-së* e artikulonin veten e tyre kolektivisht në aspektin kombëtar (pasi kishin shkollat shqipe, ansamble kulturore dhe madje mund të përdornin edhe simbolet kombëtare – flamurin, në ngjarjet e tyre historike).<sup>265</sup>

<sup>265</sup> Nebi Dervishi, Skënder Asani, Xhemil Daci, Isak Sherifi, Sefer Tahiri, Sevdail Demiri, *Demonstratat popullore të vitit 1968 në Tetovë*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup 2018

\*\*\*

Kështu, media në vendet e Bllokut Lindor, përveç tipareve që përmendëm më sipër, varej shumë edhe nga izolimi individual. Shqipëria, për shembull, përbënte shtetin më të vet-izoluar nga të gjitha shtetet e tjera që zbatonin komunizmin, ndërsa media, në këtë mënyrë ishte e destinuar të vepronte në sinkronizim të njëjtë me partinë.

Jo vetëm në komunizëm por në çdo sistem politik, lidhja e medias me shtetin është e patjetërsueshme. Sikurse përmendim një sërë autorësh, veçanërisht ata të shkencave politike të cilët e shohin këtë çështje jo thjesht nga prizmi mediatik por më së shumti nga ai politik, *ai që posedon informatat sundon shoqërinë*.<sup>266</sup>

Në sisteme të ndryshme, sa më e lartë të jetë shkalla e shkrirjes (infiltrimit) së grupeve sunduese në shoqëri, aq më i ashpër bëhet totalitarizmi.<sup>267</sup>



FIGURA 3. NIVELI I SHKRIRJES SË GRUPIT SUNDUES NË SHOQËRI DHE TENDENCA E TOTALITARIZMIT

Ndërkaq kapitalizmi, teoria *më e papëlqyer* e komunistëve, nuk do të thotë doemos se ka ndonjë lidhje me demokracinë. Studiuesi Colin Sparks thekson se shembujt e shoqërive perëndimore janë kapitaliste, por jo doemos demokratike.

Demokracitë në kapitalizëm paraqesin një dallim midis jetës politike (e cila synon interesin e përbashkët dhe të mirat publike) dhe jetës ekonomike (ndjekjen e interesit privat e individual, i cili nuk nënkupton doemos të mirën publike dhe interesin e përbashkët). Edhe pushteti politik (që e bazon suksesin të zgjedhjet konkurruese dhe të lira – pluralizmi) nuk nënkupton se frymon me të njëjtin qëllim sikurse pushteti ekonomik (që e bazon suksesin të pronësia dhe zaptimi sa më shumë i pronës produktive).<sup>268</sup>

Kështu, nëse masmedian e ndërlihim me demokracinë, duhet të hapim një kapitull të ri për të diskutuar së pari korrelacionin politik, atë ekonomik dhe pronësor të mjeteve mediatike me subjektet shtetërore, private, grupet e interesit etj. Duke qenë se pushteti dhe kontrolli janë në dorë të grupeve të ndryshme, jo doemos në dorë të të njëjtit grup, edhe zhvillimi i medias është i larmishëm, falë forcave të ndikimit politik, ekonomik, grupor etj. Por, për këtë do të flitet më konkretisht në nënkuptujt e zhvillimit të medias në Maqedoni pas pavarësisë së saj dhe në epokën e re pluraliste.

<sup>266</sup> Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Formimi, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit demokratik*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 31

<sup>267</sup> Colin Sparks, Anna Reading, *Communism, Capitalism and the Mass Media*, Sage publications 1998, London – Thousand Oaks – New Delhi, faqja 29

<sup>268</sup> Po aty, faqja 22



#### 4.1.4 Dallimet dhe paralelizmat e medias me sistemet politike

I gjithë blloku lindor komunist ishte i destinuar të përjetonte të njëjtin rrëfim, kur bëhet fjalë për mjetet e komunikimit masiv. Totalitarizmi dhe vendosja nën ombrellën partiake të mjeteve të informimit nuk ofronte hapësirë për progres dhe zhvillim të lirë të gazetave dhe radios, për një milion arsye... por më të rëndësishmet: për shkak se media ishte në fillimin e saj, ishte mjet propagande kundër agresorëve të huaj, mjet propagande për ndërtimin e vendeve të dala nga Lufta e Dytë Botërore, varej nga financat e shtetit, e kështu me radhë.

Komiteti i *Agit-Prop* siç thirrej shkurt *Komiteti për Agjitacion dhe Propagandë* i Partisë Komuniste, në të gjitha shtetet e Bllokut Lindor (dhe shtetet që trajtuam më sipër) përbënte organin e vetëm që lidhte mjetet e komunikimit me partinë-shtet. *Agit-Prop* ishte qendra organizatore e teorive ndërsa mediat bëheshin për rrjedhojë, altoparlanti i shpërndarjes së propagandës. Mediat kontrolloheshin rreptësisht nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë, Sekretari për Propagandën i Komitetit Qendror të Partisë, Shefi i Sektorit të Shtypit apo Drejtori për Agjitacion e Propagandë.<sup>269</sup> Madje, dokumentet e kohës tregojnë se në këto vende ka pasur edhe projekt për zgjedhjen nga radhët e komunistëve dhe edukimin e propagandistëve në shërbim të shtetit.<sup>270</sup>

Në BRSS, emrat më të shquar të propagandës kanë qenë Dmitri Shepilov (ka mbajtur edhe pozitën e drejtorit të gazetës Pravda), Georgi Aleksandrov, Mikhail Suslov, Juri Zhdanov, ndërsa në Shqipëri vetë Enver Hoxha, Hysni Kapo, Fadil Paçrrami,<sup>271</sup> Todi Lubonja<sup>272</sup> (ka mbajtur edhe pozitën e drejtorit të TVSH-së) etj. Në Maqedoninë e RSFJ-së, spikat emri i Tihomir Ilieskit, Mirko Mironskit, Radule Kostovskit etj.

Ishte i patjetërsueshëm disiplinimi i lexuesit dhe dëgjuesit (pra, opinionit publik) në këto shtete. Ndryshe nga vendet e tjera pluraliste/demokratike (kapitaliste dhe revizioniste siç i quante blloku komunist këto vende) ku opinionit publik kishte në radhë të parë argëtimin dhe pastaj informimin, e ku informimi përqafohej në mënyrë të lirë dhe jo të dhunshme, në vendet komuniste kishte një praktikë të ashpër të disiplinimit të shoqërisë. Informata politike (propaganda) duhej doemos të mbërrinte në zemër të çdo familjeje.

Sot ngjan marramendëse të mendohet, por në periudhën komuniste ka qenë i detyrueshëm *leximi kolektiv, në stenda, në vende pune, në shkolla, në burgje* e kudo tjetër i shtypit të ditës. Kjo praktikë zbatohet në çdo pushim të mundshëm të punëtorëve ose në oraret para fillimit të punës, jo vetëm për të zbutur analfabetizmin e klasës punëtore (kjo nuk thuhet asnjëherë

<sup>269</sup> Sokol Paja, *Shtypi komunist, si një element i rëndësishëm në propagandën ateiste në regjimin totalitar shqiptar 1960-1970*, Studim shkencor, faqja 234, <<https://aab-edu.net/assets/uploads/2016/12/02-2015-SQ-20-Sokol-Paja.pdf>>, [23.3.2019]

<sup>270</sup> Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi punën për edukimin marksist-leninist të komunistëve 24 janar 1974, faqja 423, <[https://www.marxists.org/shqip/subjekt/dokumente-shqiptare/ppsh/dokumentet\\_kryesore/06/vellimi6.2.pdf](https://www.marxists.org/shqip/subjekt/dokumente-shqiptare/ppsh/dokumentet_kryesore/06/vellimi6.2.pdf)>, [23.3.2019]

<sup>271</sup> Forcimi i partishmërisë proletare, kusht i domosdoshëm për zhvillimin në rrugë të drejtë të letërsisë e të arteve, Enver Hoxha – *Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre*, Tiranë, 1973, faqja 364, <[https://www.marxists.org/shqip/subjekt/dokumente-shqiptare/ppsh/dokumentet\\_kryesore/06/vellimi6.2.pdf](https://www.marxists.org/shqip/subjekt/dokumente-shqiptare/ppsh/dokumentet_kryesore/06/vellimi6.2.pdf)>, [23.3.2019]

<sup>272</sup> Po aty, faqja 373.

“Todi Lubonja ishte drejtor i TVSH-së në periudhën e Festivalit të 11-të të Këngës, i fajësuar për shfaqjet e huaja që u sollën në këtë garë muzikore. Sipas Enver Hoxhës, nga programet kulturore e artistike të Radiotelevizionit u dobësua dalëngadalë fryma revolucionare, brendia socialiste dhe karakteri kombëtar. Programet filluan të shkëputeshin nga kërkesat shpirtërore të masave të gjera punonjëse, sidomos të rinisë, dhe të bëheshin përçuese të shijeve dhe të një morali të huaj, që u pëlqenin vetëm një kategorie snobistësh...”

publikisht) por edhe për t'u *informuar* (në fakt, për të bombarduar klasën punëtore me propagandë) mbi politikat e udhëheqësve dhe byrosë së shtetit që konsideroheshin më shumë se të shenjta.<sup>273</sup>

Nën simbolin e draprit dhe çekanit, nën frymën e planeve përparimtare të nxitjes së masave të gjera për rimëkëmbjen e shteteve të dala nga lufta, nën krenarinë e rrejtshme të mburrjes para botës për forcën e shtetit me anë të parakalimeve (paradave) ushtarake, si dhe nën terrorin moral (formave të edukimit dhe riedukimit social të njeriut të ri komunist), mediat në BRSS, RSFJ dhe Shqipëri u rritën në mënyrë thuajse të barabartë, edhe pse të gjitha kishin të njëjtën vijë starti.

Më konsistente në politikën e jashtme dhe të brendshme do të shfaqej BRSS-ja dhe RSFJ-ja, të cilat si shtete federative do të ndiqnin një kurs në përpjekje për të *dëgjuar* dhe *menaxhuar* republikat e tyre që shpeshherë kërkonin më shumë të drejta. Ndërsa Shqipëria do të luante me zjarrin përgjatë gjithë viteve të komunizmit së saj, duke i prishur marrëdhëniet së pari me RSFJ-në në vitin 1948, për t'u hedhur në krahët e Hrushovit, për të përfituar nga prestigji rus.<sup>274</sup>

Një lëvizje e tillë e Shqipërisë nuk e la keq RSFJ-në, përkundrazi... Distançimi jo vetëm nga Shqipëria por edhe nga BRSS-ja, i dha mundësi Titos që të zgjidhte një rrugë më të moderuar politike dhe të nxiste ndryshime më pozitive dhe më efikase kushtetuese, veçanërisht në mesin e viteve 1970.

Duke adoptuar modelin më novator të socializmit, RSFJ-ja i dha dinamikë sistemit ekonomik e social, përmirësoi menaxhimin dhe bashkëpunimin ekonomik me jashtë, krijoi infrastrukturë dhe hapje për investime të huaja, adoptoi reformën që parashtroi në një masë të konsiderueshme ekonominë e tregut mbi atë të planifikuar socialiste, ndjekjen e një politike vet-administruese në marrëdhëniet me jashtë në përputhje me interesat e veta, një politikë të qartë në fushën e mbrojtjes (jo si Shqipëria që në këtë periudhë e shpenzonte pjesën më të madhe të buxhetit për bunkerë e tunele) si dhe e la këtë republikë pas vdekjes, në dorë të një presidence kolektive 9-anëtarëshe që duhet të qeveriste me konsensus.<sup>275</sup>

Ndërkaq, roli i RSFJ-së gjatë Luftës së Ftohtë dhe bashkëpunimi i moderuar me të dy krahët, edhe me BRSS-në por edhe me Perëndimin (për të shmangur rreziqet që mund t'i vinin nga superfuqia sovjetike) ishte një manovër e bukur politike në ato kohë të vështira. Suksesi jugosllav buronte pjesërisht nga përkushtimi vetjak i Titos ndaj idesë së re të *mosinkuadrim*, që do të thoshte neutralitet i gjerë nga ana e kombeve të Azisë, Afrikës dhe Amerikës Latine, në mes të fuqive kapitaliste e sovjetike.<sup>276</sup> RSFJ-ja u bë lidere e Lëvizjes së Vendeve të Painkuadruara.

Kjo liri e brendshme dhe hapje me botën e jashtme u përçua sadopak edhe në media.

Një nga dallimet më drastike të RSFJ-së krahasuar me BRSS-në dhe Shqipërinë, pavarësisht ngjashmërive të mëdha në sistemet politike, ishte mungesa e bllokatorëve në hapësirën transmetuese. Në vitet 1970, *kombësitë* siç thirreshin shqiptarët, turqit, romët etj. në atë kohë në RSFJ, jo vetëm që kishin orar të veçantë transmetimi në gjuhët e tyre por kishin mundësi të dëgjonin dhe shikonin edhe radio e televizione të huaja, valët e të cilave shpërndaheshin në rajone të gjera të RSFJ-së. Veçanërisht për *kombësinë shqiptare*, televizioni kryesor i Shqipërisë (TVSH-ja) si dhe ai i Prishtinës (RTP) pasuronin deri diku kulturën e shqiptarëve të Maqedonisë.

<sup>273</sup> Artan Fuga, *Monolog: mediat dhe propaganda totalitare*, Tiranë, Dudaj 2010, faqja 71

<sup>274</sup> Lisen Bashkurti, *Diplomacia Shqiptare në fillimet e Luftës së Ftohtë*, Tiranë, GEER 2003, faqja 342

<sup>275</sup> Lisen Bashkurti, *Diplomacia e vet-izolimit*, Tiranë, GEER 2004, faqja 536-537

<sup>276</sup> Jasminka Udovički, James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë – Historia e Vërtetë e dhimbjes së pashprehur të Europës*, Tiranë, Libra për një shoqëri të hapur, Albin 1998, faqja 64

Nga ana tjetër, falë zhvillimit të teknologjisë satelitore, shumë familje blinin pajisje për ndjekjen e programeve televizive satelitore, ndërsa shumë shpejt filluan të organizoheshin edhe sistemet e para mini-kabllore që lidhnin disa ndërtesa ose një paralagje, në një sistem të mbyllur që funksiononte në bazë të marrëveshjes mes vetë banorëve të lagjes. Valët satelitore apo organizimet kablllore nuk ishin të rregulluar me ligj në RSFJ, dhe pikërisht një gjë e tillë, krijonte praktikë të lejuar ose të pandëshkuar nga ligjet vendore.<sup>277</sup>

Vitet e gjata të komunizmit e kishin ngulitur thellë frikën dhe pasivitetin te qytetari pasi çdo hallkë e shoqërisë post-komuniste ishte kapluar nga ndjenja e *autocensurës*, madje edhe pasi kishin nisur lëvizjet e para për përmbyshjen e regjimeve. Maqedonia, ndryshe nga trazirat që përjetoi Shqipëria për daljen nga regjimi komunist, ishte e vetmja republikë e RSFJ-së që u nda në mënyrë paqësore. Epoka e re e tranzicionit do të hapte një fazë të re, atë të lirisë së shtypit por me shtyp jo të lirë.

## 5. KAPITULLI III

### 5.1 Media e Maqedonisë së Veriut në periudhën e re pluraliste

Vdekja e Titos (më 4 maj 1980) dhe kalimi i RSFJ-së në dorë të presidiumit 9-anëtarësh (nga viti 1988 prej 8-anëtarësh) ishte dyshimi i parë se kjo republikë federative po lëkundej. Madje, protestat e nisura në Kosovë një vit më vonë (në pranverën e vitit 1981), sipas një pjese të studiuesve të shkencave politike, njihen pikërisht si *fillimi i fundit të RSFJ-së*.<sup>278</sup> Demonstratat e studentëve kosovarë nuk drejtoheshin kundër ndonjë populli të RSFJ-së, por pasqyronin nevojën e përparimit të *statusit politiko-juridik*; pra, barazi reale dhe jo fiktive brenda kornizave të shtetit ekzistues.<sup>279</sup>

Me shpërndarjen me dhunë të protestave “*Për Kosovën-Republikë*”, autoritetet serbe faktuan kështu irredentizmin ndaj shqiptarëve duke iu veshur edhe teoritë se protestat kishin gjoja për qëllim krijimin e një *republike të pastër etnike* me synimin e mëvonshëm të *bashkëngjites së trojeve* dhe krijimit të *Shqipërisë së Madhe*.<sup>280</sup>

Fryma e tillë u rrit ndjeshëm në të gjitha njësitë e tjera federative ku jetonte e ashtuquajtura kombësi shqiptare (narodnost); Maqedoni e Mal të Zi. Me Millosheviqin në krye, Serbia printe politikë anti-shqiptare jo vetëm me qëllimin ndaj Kosovës por edhe me oreksin në

<sup>277</sup> Dona Kolar Panova, *Историја на масовните комуникации (Historia e komunikimit masiv)*, Ligjërata të autorizuara, Shkup 2007, faqja 128

<sup>278</sup> I të njëjtit mendim ishte edhe presidenti i parë i Maqedonisë së pavarur Kiro Gligorov, sipas një deklaratë të tij në një seancë plenare në vitin 1999.

“Случувањата на Косово кон крајот на 80тите беа симболот на антидемократските обиди на господином Милошевиќ и почеток на распаѓањето на СФРЈ” (*Zhvillimet në Kosovë në fund të viteve ‘80 ishin simbol i përpjekjeve antidemokratike të z. Millosheviq dhe fillimi i shpërbërjes së RSFJ-së*).

Стенографски белешки од Седумнаесеттата седница на Собранието на Република Македонија, одржана на 15 април 1999 година (Shënime stenografike nga Seanca e Shtatëmbëdhjetë e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, e mbajtur më 15 prill 1999),

<<https://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/017%20sednica%2015.04.1999.pdf>>, [25.3.2019]

<sup>279</sup> Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Formimi, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit demokratik*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 101

<sup>280</sup> По аты.

rritje të saj për përforcimin e pozitive ndaj popujve dhe njësisive të tjera të Federatës Jugosllave në shpërbërje.

Përveç etiketimit të shqiptarëve si *armiq të përbetuar të popullit serb*, filozofia e re e Millosheviqit e përkrahur nga shërbimi sekret dhe propaganda, etiketonte edhe sllovenët si *popull vetjak dhe mosmirënjohës*, ndërsa kroatët si *popull i prirur për gjenocid*.<sup>281</sup> Në mënyrë zinxhir, republikat e tjera do të tentonin me të shpejtë shkëputjen nga RSFJ-ja; filluar me Slloveninë, Kroacinë, e më së voni edhe vetë Maqedonia (sot Maqedonia e Veriut).

Me deklaratën e Sllovenisë për sovranitet, Serbia ndërhyri me të shpejtë me masa shtrenguese duke ia marrë kompetencat Kuvendit dhe Këshillit Ekzekutiv slloven dhe duke ia transferuar ato Kuvendit dhe Këshillit Ekzekutiv serb. Këtë gjë e bëri edhe me Kosovën që të mos e humbiste atë. Në vitin 1991 veçse mbaroi faza e parë e procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë; proces i përgjakshëm dhe me krime lufte.

Teoria e *bashkim-vëllazërimit* që promovonte Tito për gati gjysmë dekadë, vdiq!

Vetëm Maqedonia ishte ajo që u nda *pa konflikt ushtarak*. Me klimën e re politike, zgjedhjet e para shumë-partiake çuan në themelimin e kuvendit të parë pluralist.<sup>282</sup> Presidenti i vendit u zgjodh *Kiro Gligorov*<sup>283</sup> në tentativën e dytë të votimit për të në kuvend, edhe pse figura e tij kundërshtohet ashpër nga VMRO DPMNE-ja dhe partitë shqiptare PPD (Partia për Prosperitet Demokratik)<sup>284</sup> e PDP (Partia Demokratike Popullore).<sup>285</sup> Qeveria e re (e ekspertëve), me një karakter mbipartiak u udhëhoq nga *Nikolla Klusev*<sup>286</sup> i cili do ta orientonte vendin drejt ndryshimeve të mëdha kushtetuese.

Përgjatë vitit 1991, me ligj kushtetues (16 prill) u fshi së pari termi “*socialist*”, ndërsa në 17 nëntor Maqedonia e Veriut do të hartonte kushtetutën e parë të mëvetësisë së saj si sovranë. Por, kushtetuta e re la jashtë kërkesat për barazi të shqiptarëve, të cilët e kishin bojkotuar veçmë si referendumin e 8 shtatorit ashtu edhe regjistrimin e popullsisë.<sup>287</sup> Bojkoti arsyeohej së pari me *pyetjen e paqartë* të parashtruar në referendum e cila nuk e shmangte mundësinë e *një ri-*

<sup>281</sup> Po aty, faqja 104

<sup>282</sup> Kryetari i parë i kuvendit pluralist të Maqedonisë së asaj kohe (1991) ishte Stojan Andov, deputet i Lidhjes së Forcave Reformatore.

<sup>283</sup> Kiro Gligorov ishte me origjinë nga Shtipi i Maqedonisë, por para shpërbërjes së RSFJ-së ai ishte Sekretar Shtetëror për Financa në Këshillin Ekzekutiv Federal, anëtar i presidencës jugosllave, si dhe kryetar i Kuvendit të RSFJ-së. Me një të kaluar si ish avokat dhe komisionar financash në Presidiumin e ASNOM-it, Gligorov shërbeu gjithashtu edhe si ministër i Financave i Jugosllavisë. Gligorov mori 114 vota nga deputetët e Kuvendit, midis të cilëve edhe nga pjesa më e madhe e deputetëve shqiptarë.

<sup>284</sup> PPD-ja u themelua më 16 prill të vitit 1990 në Xhepçishtë të Tetovës, kryetar i së cilës u zgjodh Nevzat Halili. Pas zgjedhjeve të vitit 1991 kjo parti në koalicion me Partinë Demokratike Popullore fitoi 23 deputetë. Të dhënat janë nxjerrë nga uebfaqja zyrtare e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut.

Kuvendi i Maqedonisë së Veriut, *Partia për Prosperitet Demokratik në Maqedoni*,

<<https://www.sobranie.mk/partia-p-r-prosperitet-demokratik-n-magedoni.nspx>>, [25.3.2019]

<sup>285</sup> PDP-ja u formua më 23 qershor të vitit 1990. Me formimin e kësaj partie, si forcë e dytë, filloi edhe pluralizmi politik ndërshqiptar. Kryetar i parë i saj ishte Jusuf Rexhepi, mjek nga Tetova. Pas zgjedhjeve të vitit 1994, kjo parti fitoi 5 deputetë. Të dhënat janë nxjerrë nga uebfaqja zyrtare e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut.

Kuvendi i Maqedonisë së Veriut, *Partia Demokratike Popullore*, <<https://www.sobranie.mk/partia-demokratike-popullore.nspx>>, [25.3.2019]

<sup>286</sup> Klusev ishte kryeministri i parë i Maqedonisë pluraliste menjëherë pas pavarësisë. Ai qëndroi në pushtet vetëm 1 vit, në këtë format qeverie ekspertësh dhe ishte akademik në fushën e ekonomisë.

Janusz Bugajski, *Ethnic Politics in Eastern Europe: A Guide to Nationality Policies, Organizations and Parties*, Qendra për Studime Ndërkombëtare dhe Strategjike, M.E. Sharpne, Londër – Nju Jork 1995, faqja 124

<sup>287</sup> Regjistrimi i Popullsisë, sipas të dhënave nga Enti i Statistikave, ishte jo-gjithëpërfshirës (për shkak të bojkotit të shqiptarëve) prandaj edhe u përsërit në vitin 1994 për t'u bërë *i pari regjistrim real* nga mëvetësia e Maqedonisë. Enti i Statistikave i Republikës së Maqedonisë, <<http://www.stat.gov.mk/OblastOpsto.aspx?id=31>>, [28.3.2019]

*bashkimi jugosllav*, si dhe me *mosrealizimin e kërkesave* që kishin të bënin me gjuhën, shkollimin, simbolet kombëtare etj. Autoritetet shumicë (maqedonase) të asaj kohe manifestonin shpërfillje dhe madje e trumbetonte bojkotin në opinion si dëshmi se *shqiptarët nuk janë të interesuar për shtet të përbashkët*. Në fakt, shqiptarët ndanin qëndrimin se *Maqedonia është atdhe edhe i shqiptarëve* dhe e mbështesnin *Maqedoninë sovranë* që do të përkufizohej në kushtetutën e re.

Siç vëren studiuesi Etem Aziri, shpërfillja e kërkesave të drejta të shqiptarëve, mbivotimi në procese, përdorimi i dhunës dhe trysnisë psikike ndaj tyre, pas një dhjetëvjeçari do të vërtetohej se kishte qenë një strategji e gabuar për vetë shtetin maqedonas dhe maqedonasi.<sup>288</sup>

“Paqe, barazi dhe demokraci” ishte motoja e protestave të shqiptarëve që vis a vis kishin mbështetjen e partive shqiptare. Mosdëgjueshmëria e autoriteteve maqedonase ndaj kërkesave të artikuluara nga grupi parlamentar PPD-PDP për *hapje të paraleleve shqipe* (të kulmuara me protesta në Ladorisht të Strugës), për *evidenca pedagogjike në shqip*, për *përdorim adekuat të simboleve kombëtare* (flamurit<sup>289</sup> që kontestohej nga madhësia), për *gjuhën shqipe* përkrah maqedonishtes (e cila nuk u përkufizua në kushtetutën e vitit 1991)<sup>290</sup> etj., veçse vazhdonin të thellonin përplasjet etnike mes dy komuniteteve më të mëdha në Maqedoni.

Gjithsesi, në rrafshin me Serbinë (e cila udhëhiqte përpjekjet për përfitim sa më të madh nga ish RSFJ-ja që veçse kishte nisur shpërbërjen) si dhe në atë ndërkombëtar (përkufizimin e qëllimeve të Maqedonisë për anëtarësim në strukturat euro-atlantike), kushtetuta e vitit 1991, sipas studiuesve, ishte një hap i mirë-ndërmarrë. Në vitin 1992, Maqedonia, me ligj kushtetues vendosi të *mos marrë më pjesë* në organet e pushtetit federativ të mbetur dhe ua ndërpreu mandatin të gjithë funksionarëve të atëhershëm federativ. Me tërheqjen paqësore të Armatës Popullore të Jugosllavisë nga territori i Maqedonisë, përfundimisht u shënuar edhe shkëputja në mënyrë të qetë dhe pa konflikt luftarak e Maqedonisë nga RSFJ-ja.<sup>291</sup>

Por, pavarësisht klimës paqësore të kësaj shkëputje dhe trumbetimit nga ana e Gligorovit se kishte merita të jashtëzakonshme për të, Serbia nuk u nda e kënaqur. Millosheviqi nuk e kishte të lehtë ta njihte Maqedoninë nën emrin e saj kushtetues. Një gjë e tillë ndodhi 5 vjet më vonë, në prill të vitit 1996.<sup>292</sup>

<sup>288</sup> Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Formimi, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit demokratik*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 137

<sup>289</sup> Kuvendi i Maqedonisë së Veriut, *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë 1991*, <<https://www.sobranie.mk/kushtetuta-e-rm-s.nsp>>, [28.3.2019]

<sup>290</sup> Aisling Lyon, *Decentralization and the Management of Ethnic Conflict: Lessons from the Republic of Macedonia*, Routledge 2016, Nju Jork, faqja 34, <<https://books.google.mk/books?id=JKXhCgAAQBAJ&pg=PA33&dq=Macedonia+Constitution+of+1991+ignored+by+albanians&hl=en&sa=X&ved=0ahUKewjBio-DzJXhAhXHeZoKHSeqB68Q6AEILjAB#v=onepage&q=Macedonia%20Constitution%20of%201991%20ignored%20by%20albanians&f=false>>, [28.3.2019]

<sup>291</sup> Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Formimi, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit demokratik*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 146

<sup>292</sup> Serbia e njohu Maqedoninë me emrin kushtetues të saj vonë, pavarësisht rrethanave se dy vendet kishin qenë republika brenda të njëjtës federatë, u ndanë në mënyrë paqësore në vitin 1991 e kështu me radhë. Madje, në një intervistë të mëvonshme, ish ministri i jashtëm Daçiq do të bëhej pishman që Serbia e njohu Maqedoninë në 1996, duke marrë në konsideratë faktin që vite më vonë Maqedonia jo vetëm që njohu Kosovën, votoi pro saj për në UNESCO, por nga ana tjetër përzuri spiunin serb dhe këshilltarin e ambasadës serbe në Shkup Goran Zhivaljeviq, pas ngjarjeve të përgjakshme të 27 prillit në Parlamentin e Maqedonisë.

Ndërkaq, media, ashtu sikurse edhe klasa politike dhe tranzicioni për *vetëpërcaktim* të republikave të RSFJ-së, ishte në gjendje kaotike. Ditët e bukura me programe *shumëngjyreshe* të *televizioneve federative*; me harenë e përcjellë nga katër anët e RSFJ-së, me vajet maqedonase, harmoninë dalmate të detit, odeve boshnjake të dashurisë, kërcimeve serbe, këngëve të Zagrebit, polkave sllovene etj., kishin filluar të numëroheshin mbrapsht që në vitin 1974. Edicionet e lajmeve në orën 17:00 dhe 19:30 transmetoheshin në gjithë rrjetin televiziv jugosllav dhe dilnin çdo ditë nga një kryeqytet i ndryshëm federal; Zagreb, Beograd, Lubjanë, Prishtinë, Sarajevë, Titograd, Shkup e Novi-Sad.<sup>293</sup>

Siç theksojnë edhe gazetarët e kësaj periudhe, ky lloj transmetimi bënte qarkullimin e lajmit dhe informacionit, përzierjen e kulturave dhe nxitjen e diversitetit si *e mirë shoqërore e RSFJ-së* dhe motivim i teorisë së *bashkim-vëllazërimit*, pavarësisht se nuk mund të mohohej edhe kontrolli politik i elitës që menaxhonte propagandën shtetërore.

Ky qarkullim transmetimesh filloi të çahet nga vitet 1980. Me shpërbërjen e RSFJ-së, republikat filluan transmetimet e mëvetësishme, por jo të lira. Ashtu sikurse në të gjitha vendet e Bllokut Lindor ku ra socializmi, televizioni nuk u çlirua ashtu sikurse pritej.

Për më tepër, protestat në Kosovë në mars të vitin 1981 (siç u theksua në hyrje të këtij kreu) e kishin përgatitur opinionin serb me fazat paraprake të kalimit nga *propaganda socialiste*, në *nacionalizëm*. 10 vjet më vonë, gjatë përgatitjes për luftë ashtu edhe gjatë luftës, televizioni serb i shërbeu ëndrrës së Millosheviqit si trampolinë për të zëvendësuar Titon, ndërsa televizioni kroat luante të njëjtin rol me synimet e Tuxhmanit për t'u hequr si mbrojtës i dëshirës mijëravjeçare të kroatëve për pavarësi. Për të dyja ambiciet, nacionalizmi do të ishte *mjet* ndërsa televizioni *instrument*.<sup>294</sup>

Ideologjisë socialiste po i vinte fundi. Vendin e saj, gradualisht po e zinte nacionalizmi i cili po bazohej në një sërë elementesh, por veçanërisht mbi atë të paraqitjes së serbëve si viktimë, jo vetëm të shkeljeve gjatë Luftës së Dytë Botërore<sup>295</sup> por edhe kushtetutës së 1974 (që kishte lejuar Kosovën të ishte popull me autonomi politike, kulturore, me gjuhë shqipe në media etj.) të cilat Millosheviqi ia hoqi nën pretendimin se *Kosova iu mohonte të drejtat pakicës serbëve të atjeshme...* Media serbe ia ofronte këtë teori qytetarëve serbë, që çdo ditë e më shumë ngrinin lavdi për Millosheviqin se ai po vendoste në vend këtë të drejtë të bashkëkombësve të tyre.

Për më shumë, gjatë luftërave që do të zhvilloheshin me kroatët, boshnjakët, shqiptarët e Kosovës etj., media do të shndërrohej në një përbindësh propagande dhe në një nxitëse të nacionalizimit. Millosheviqi dhe Tuxhmani, me akuzat e tyre gjatë luftës së vitit 1991 çuan në *një raportim të dyzuar* si asnjëherë më parë në ish Jugosllavi. Media kroate shfaqte dhunën në Vukovar, Dubrovnik e Zagreb, qytete këto të sulmuara nga serbët, ndërsa televizionet serbe raportonin se ato që digjeshin ishin vetëm varrezat e partizanëve serbë në Kroaci. Përkundrazi, përdorimi i fjalës fyese “*ustashë*” që iu referohej kroatëve, zbrazte mllëfin e padrejtësive nga Lufta e Dytë Botërore.

Gazetarët e vërtetë që ngritën zërin, ose u hodhën edhe në grevë urie për *raportimin e dyzuar* në televizionin serb, ose linin punën apo shkarkoheshin grupe-grupe nga puna. Ata që

<sup>293</sup> Jasmina Udovički & James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë, Historia e vërtetë e dhimbjes së pashprehur të Europës*, Tiranë, Libra për një shoqëri të hapur, Albin 1998, faqja 107

<sup>294</sup> Po aty, faqja 109

<sup>295</sup> Televizioni serb kishte nisur një fushatë të ashtuquajtur “De-mistifikimi i historisë”, se gjoja historia zyrtare e Luftës së Dytë Botërore nuk tregonte gjithë të vërtetën dhe përmasat reale të masakrave kroate. Bëhej fjalë për “persekutimin kroat” në kampin Jasenovac, i cili sipas serbëve, nuk ishte llogaritur si duhet për nga numri i viktimave. Tani, televizioni merrte përsipër të tregonte *fytyrën e vërtetë të gjakatarëve kroatë*.

qëndronin, duhet të bënin *betimin e besnikërisë* te shefi, në krah të të cilit qëndronin trupa komando muskolorë dhe të armatosur me kallashnikovë.

Televizioni serb, me *raportimin e tillë* gjatë viteve të luftës, u bë po aq fajtor sa vetë lideri Millosheviq. Manifestimi i urrejtjes në raportimin gazetaresk bënte që televizioni i Beogradit të shfaqte robër kroatë luftime me varëse në qafë të thurura me gishtërinj fëmijësh, ndërsa televizioni kroat jepte lajme për ushtarët serbë se më parë ua nxirrnin sytë e pastaj u prisnin gurmazin civilëve kroatë.<sup>296</sup>

Në një raportim mediatik të Televizionit të Beogradit në vitin 1991, raportuesi serb nga terreni thumbonte kroatët si *ustashë*<sup>297</sup> ndërkohë që regjia mbulonte raportimin gazetaresk pa asnjë pamje nga lufta (vetëm me harta dhe me pamje arkiv të forcave ushtarake dhe lëvizjes së tankeve). Në raportim theksohet:

*“Përqendrimi i forcave ustashe dhe ndërhyrja e tyre me ndihmën edhe të mjeteve teknike që kanë në dispozicion, në rajonin e Pasaçke-Gore, si në rastin e ndërhyrjes së grupeve të ustashëve në Lipi, sjell frikë te banorët sidomos në pjesën veriore të Okučanës..... Dhe kjo ndodh para paralajmërimeve të sulmeve nga ustashët në disa fshatra të rajonit të Bërçkos, Pakracit, Daravinës dhe Podravska-Sllatinës. Për këtë ndihmojnë edhe mjetet kroate të informimit me propagandën fashiste të ustashëve, për gjoja suksese të tyre ushtarake, por edhe informacione të tjera që jepen pa ndonjë qëllim të mirë”.*<sup>298</sup>

Po ashtu, në një tjetër lajm në të njëjtin edicion, serbët viktimizohen. Në raportim ata thuhet se kanë qenë pre e sulmeve gjakatare të ustashëve kroatë, në Podravska-Sllatinë, në një numër prej 120 viktimash.

*“Nga informacionet e mara nga Qendra për Informim e Korpusit Ushtarak të Banja-Lukës është shuar dilema e masakrimit të banorëve të pafajshëm në rajonin e Podravska-Sllatinës. Informacione të detajuara për gazetarët ka dhënë përfaqësuesi ushtarak i cili konfirmoi lajmin e publikuar më herët, se bëhet fjalë për të paktën 120 viktima. Të dhënat e masakrës janë nxjerrë nga marrja në pyetje e të kapurit Zheljko Llain nga Podravska-Sllatina, i cili përshkroi me saktësi shumë krime. Përveç tij përmendet edhe emri i Stevo Matijeviqit, komandant i grupit gjakatar. Zheljko Butorac, Rajko Bozhiq, Dragan Butorac dhe disa masakruet të tjerë janë emrat e tjerë që kanë nxjerrë organet hetuese ushtarake nga marrja në pyetje e Llainit.*

*Krimet janë bërë në 10 ditët e fundit në territorin e kontrolluar nga formacionet paraushtarake kroate. Përmenden stacioni i trenit ku janë vrrarë 15 njerëz, stacioni i autobusëve, mulliri i vjetër dhe Radosavci.”*<sup>299</sup>

Me një propagandë të rrezikshme, pas çdo masakre të kryer, serbët dilnin me lajme të rreme se ishin kroatët ata që kishin kryer sulme. Gjatë një përleshje në Pakrac, gazeta “Večernje Novosti” doli me lajmin se *40 serbë ishin vrrarë* – lajm ky që nuk u vërtetua kurrë. Në Vukovar, menjëherë pas vrasjes së 264 të burgosurve të luftës, mediat e Beogradit dolën me lajmin e

<sup>296</sup> Jasmina Udovički & James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë, Historia e vërtetë e dhimbjes së pashprehur të Europës*, Tiranë, Libra për një shoqëri të hapur, Albin 1998, faqja 121

<sup>297</sup> *Ustash* ishte quajtur Lëvizja Revolucionare Kroate me bindje nacionaliste e fashiste e viteve 1944 e njohur për vrasjen e shumë serbëve, hebrenjve e romëve, për llogari të Gjermanisë naziste, sikundër ballistët në Shqipëri.

<sup>298</sup> Edicion lajmesh i RTB (Radio-Televizionit të Beogradit) i vitit 1991 “*Dnevnik 3 - Rat u Jugoslaviji - (TV Beograd 1991)*”. Lajmet flasin vetëm për masakra ndaj serbëve. Nga minuta 5:20 deri në 14:48, nxjerrë nga Youtube, <<https://www.youtube.com/watch?v=5PGj3zMumMY&feature=youtu.be>>, [30.3.2019]

<sup>299</sup> Po aty.

*therjes së 41 fëmijë serbë.* Edhe ky lajm nuk u vërtetua asnjëherë.<sup>300</sup> Po ashtu, lajme të rreme edhe mbi djegien e Dubrovnikut kur televizioni i Beogradit simuloi tymin me *djegien e gomave nga fshatarët.* Po ashtu, edhe manipulimi me Gjermaninë dhe Vatikanin që nxitën protesta të fuqishme para këtyre dy ambasadave, për gjoja mbështetje të *neo-fashizmit kroat.*<sup>301</sup> Skandali i propagandës së sëmure serbe shkoi deri aty sa në lajme të jepej raportim se gjoja *foshnjat serbe u hidheshin për ushqim luanëve* në kopshtin zoologjik (shih raportimin).<sup>302</sup> Qëllimi ishte nxitja e nacionalistëve serbë për të ekzekutuar kroatë.

Paralelisht me këtë, një tjetër fenomen i medias serbe më vonë ishte ai i *promovimit të vetë kriminelëve të luftës* apo elementeve ekstremistë, duke u thurur lavdi si figurat më mbrojtëse të kombit serb. Millan Paniq, ish kryeministër jugosllav u shpall *tradhtar* vetëm e vetëm pse doli si kundër-kandidat i Millosheviqit në zgjedhjet presidenciale të 1992. Më së keqi e pësoi Vuk Drashkoviq, një opozitar i moderuar, i cili bashkë me gruan u rrahën rëndë me shkopinj gome deri në alivanosje gjatë një proteste, dhe për dy javë asnjërit prej avokatëve apo familjarëve të tij nuk iu lejua qasja. Kjo dhunë ishte sinjal për cilindo intelektual apo opozitar. Vojisllav Sheshel, një ekstremist dhe kriminel luftime si dhe themelues i *Lëvizjes Çetnike Serbe* u bë i përkëdheluri i Millosheviqit. Falë medias, në krye të Partisë Radikale Serbe, ai fitoi 73 deputetë në kuvendin me 250 ulëse.<sup>303</sup> Sipas disa analistëve, Shesheli ishte një nga pjesëmarrësit më aktiv në krijimin e politikës së Millosheviqit ndaj Kosovës, e ashtuquajtur “Operacioni Patkoi”, me qëllim përzënien e shqiptarëve nga provinca jugore e asaj kohe, Kosova.<sup>304</sup> Figura tjetër kundërthënëse ishte Zhelko Razhnjatoviq - *Arkan*, i kërkuar nga Interpoli për veprimtari terroriste dhe njëri i UDB-së<sup>305</sup> i cili shfaqej si hero në media falë angazhimit të tij për llogari të Serbisë, në masakrat që kryheshin në Kroaci dhe më pas në Bosnjë. Media doli jashtë kontrollit saqë edhe astrologët (Zorica Cvetkoviq) që lexonin horoskopin, e nisnin transmetimin televiziv me mallkimin se Amerika (që përzien hundët në punët e brendshme) do të bjerë, ndërkohë që parashikonin se Jugosllavia do të jetojë si konfederatë.<sup>306</sup>

Edhe gjatë luftës në Bosnjë, televizioni serb për dy muaj me radhë nuk dha asnjë pamje masakrash, madje, kronikat e tij për luftën i mbulonte thjesht me pamje hartash ose pamje arkivi të forcave ushtarake sikurse ishte bërë zakon tashmë. Ndërkohë, kur OKB-ja veçse përgatitej të miratonte sanksionet kundër Serbisë, televizioni serb, në përpjekje që Serbia t’u shmangej sanksioneve, në minutat e fundit lexoi një rezolutë të qeverisë serbe që dënonte bombardimin e Sarajevës nga forcat serbe.

<sup>300</sup> Renaud de la Brosse, *Political Propaganda and the Plan to Create a "State for all Serbs" - Consequences of Using the Media for Ultra-Nationalist Ends - Part I*, Report compiled at the request of the Office of the Prosecutor of the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia, by Renaud de la Brosse, senior lecturer at the University of Reims, Champagne, Ardennes, France, faqja 6, <[http://balkanwitness.glypx.com/de\\_la\\_brosse\\_pt1.pdf](http://balkanwitness.glypx.com/de_la_brosse_pt1.pdf)>, [31.3.2019]

<sup>301</sup> Stephen Engelberg, *Carving out a Greater Serbia*, The New York Times Magazine, <<https://www.nytimes.com/1991/09/01/magazine/carving-out-a-greater-serbia.html?pagewanted=all&src=pm>>, [1.4.2019]

<sup>302</sup> Youtube, *Televizija Srbija (RTS): Srpsku decu bacaju lavovima*, <<https://www.youtube.com/watch?v=LzUqQxNb8qw>>, [1.4.2019]

<sup>303</sup> Në zgjedhjet e vitit 1992 në Serbi, Partia Socialiste Serbe e Millosheviqit mori 101 deputetë, ndërsa ajo e Drashkoviqit, Lëvizja Demokratike e Serbisë, fitoi 50 deputetë.

<sup>304</sup> Marija Ristic, *Vojislav Seselj: Faded Cheerleader for a 'Greater Serbia'*, BIRN, Beograd, <<https://balkaninsight.com/2016/03/29/voislav-seselj-faded-cheerleader-for-a-greater-serbia-03-28-2016/>>, [1.4.2019]

<sup>305</sup> UDB (Uprava Državne Bezbednosti / Управа Државне Безбедности / Drejtoria për Siguri Shtetërore)

<sup>306</sup> Youtube, *RTS devedesete - najava 3*, <<https://www.youtube.com/watch?v=3A9S89n7CrS>>, [2.4.2019]



E njëjta pamje u shfaq edhe në luftën e mëvonshme në Kosovë, edhe pse ishte e qartë se Millosheviqi e kishte ndarë mendjen për sulmim të saj që kur zbriti plot madhështi me helikopter në Gazimestan (1989), simbol i betejës historike të vitit 1389 gjatë luftës me perandorinë osmane. Media, duke i thurur elozhe Millosheviqit, si pasues i Princit Llazar që pranoi të vritej në luftë se sa të mbijetonte si humbës, nxiti kultin e personalitetit të Millosheviqit i cili paralajmëroi beteja të reja, që në fakt do të ndodhnin në vitin 1999.

\*\*\*

Ndërkaq, një tjetër realitet përjetonte media në Maqedoni. Ashtu sikurse edhe klasa politike që ishte në kaos për shkak të zhvillimeve rreth ndarjes së saj, edhe vetë media qëndroi e vobektë deri në vitin 1993. Gazetat kryesore “Nova Makedonija”, “Veçer”, “Flaka e Vëllazërimit” si dhe Radio dhe Televizioni-Shkupi raportonin nën ndjenjën e pasigurisë, por ende nën hijen e dyshimeve se Maqedonia, pavarësisht kësaj ndarjeje, do të ishte sërish një ditë *pjesë e ndonjë bashkimi federativ* me republikat e tjera të ish RSFJ-së, ose të paktën me ndonjërin prej tyre.

Jo më kot, Gligorov, strateg i Lidhjes Komuniste Jugosllave dhe bashkëpunëtor tepër i ngushtë i Beogradit, në pyetjen për referendumin: *“A jeni për shtetin e pavarur dhe sovran të Maqedonisë me të drejtë për t’u përfshirë në aleanca të ardhshme të shteteve sovraane të Jugosllavisë?”* linte ende shpresën se Federata nuk do të vdiste.<sup>307</sup>

Në raportimet e tij, Televizioni-Shkupi, pavarësisht se me një dozë më të butë (për shkak të krizave të brendshme vendore dhe kërkesat në rritje të shqiptarëve të lëna në harresë me kushtetutën e re) sërish reflektonte frymën e Beogradit. Vlejnë të theksohen disa fenomene që u vërejtën në shtypin dhe median elektronike të kohës;

1. Distanca e madhe e përjetimit të luftës, si në Kroaci ashtu edhe në Bosnjë. Në qendër ishin zhvillimet e brendshme, ato me ndarjen e Maqedonisë nga federata, ato me epokën e re me Greqinë (ndryshimet kushtetuese se nuk ka pretendime territoriale dhe se vendi nuk përzihet në politikën e brendshme të shteteve të tjera ku jeton popullata maqedonase)<sup>308</sup> si dhe problemet ndëretnike që nisën me shqiptarët për më shumë të drejta, mbi arsimimin shqip, gjuhën, flamurin kombëtar etj., të mohuara nga kushtetuta e vitit 1991.

2. Distancë e madhe edhe në trajtimin e lajmeve nga konflikti. Të gjitha lajmet trajtoheshin si të dorës së dytë, si lajme nga bota, me të cilat dukej se Maqedonia ecte në fije të perit për të mos prodhuar probleme më të mëdha me Serbinë apo republikat e tjera. Mediat e shtypura dërgonin *shumë-shumë rrallë* reporterë specialë në këto rajone lufte për të raportuar mbi ngjarjen. Raportimi i ngjarjeve bazohej vetëm te mediat serbe, kryesisht te agjencia shtetërore serbe “Tanjug”. Televizioni përdorte më së shumti pamje filmike të huazuara nga stacione të tjera, dhe jo të vetat.

Megjithatë, mund të vërehet se për shkak të këtij dominimi (përdorimit të materialeve nga mediat serbe) shkrimet dhe lajmet televizive në Maqedoni binin në frymën pro-serbe. Udhëheqja e re e Maqedonisë së asaj kohe bënte kujdes dhe jepte direktiva ndaj RTVM-së apo gazetave se;

1) mbështeste idenë e ruajtjes së tërësisë territoriale të Jugosllavisë, e më pas,

<sup>307</sup> Pyetja e referendimit ishte sugjeruar nga Nikolla Popovski, funksionar i lartë i LSDM-së në atë kohë, dhe ishte shkruar në zyrat e Kuvendit me makinë shtypi.

<sup>308</sup> Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Formimi, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit demokratik*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 149

2) mbështeste edhe konceptin e Alija Izetbegoviqit dhe Kiro Gligorovit për të ndërtuar një lloj federate me sistem prej dy republikave (Serbia me Malin e Zi, Bosnja me Maqedoninë dhe Sllovenia me Kroacinë).<sup>309</sup>

Narrativi pro-serb ndërlidhej ndonjëherë edhe me hapësirën që i jepej akoma qëndrimeve të Partisë Socialiste të Millosheviqit, duke synuar një formë arsyetimi të ndërhyrjeve ushtarake në Kroaci dhe Bosnjë.

Në të njëjtën kohë synohej edhe demonizimi i Kosovës, me qëllimin për të mbrojtur pozitën e Serbisë se Kosova është krahinë serbe dhe se shqiptarët nuk kanë të drejtë vetëvendosjeje (madje edhe liritë e garantuara nga Kushtetuta e vitit 1974 ishin të tepërta për shqiptarët).

Në arkivat e TVM-së është tepër e vështirë të gjenden materiale të kësaj periudhe, jo vetëm për shkak të mosruajtjes së tyre, por edhe për shkak të kontrollit politik të kohës dhe shkatërrimit të mundshëm qëllimisht të tyre.

Ndërkaq, në gazetën “Nova Makedonija”, pavarësisht se në faqe të parë qëndronin zhvillimet e njëpasnjëshme brenda vetë Maqedonisë, sikurse shpallja e pavarësisë, referendumi, kushtetuta, zgjedhja e qeverisë, regjistrimi i popullsisë etj., gjendej *pak vend* edhe për raportimin e konfliktit në Kroaci që kishte filluar veçse më, si dhe grimca të vogla nga situata jo e qëndrueshme në Bosnjë.

Por, sikurse u theksua më sipër, ky raportim shumë rrallë kryhej nga reporterë specialë të dërguar në vendngjarje, pasi në të shumtën e rasteve dominonin lajmet nga agjencia shtetërore e lajmeve “Tanjug”. Tepër të pakta ishin edhe rastet kur ndonjë lajm krahasohej me burime kroate. Gazetarët në redaksi i përpunonin ngjarjet kryesisht në mënyrë telegrafike, por duke marrë më së shumti për bazë agjencinë shtetërore serbe “Tanjug”.

Për qëllime studimi, u kërkua për raportime gjatë ngjarjeve më të rëndësishme të konfliktit. Për shembull, për rrethimin e Vukovarit dhe ngjarjet në spitalin e këtij qyteti në 20 nëntor, u vërejt se gazeta “Nova Makedonija” nuk kishte publikuar asnjë shkrim për këtë ngjarje, për 3 ditë me radhë, në numrat e saj më 21 nëntor, 22 nëntor dhe 23 nëntor. Të vetmin lajm me të dërguar special, gazeta e publikoi në datën 24 nëntor me titullin “*Përfundimisht, ujë dhe ushqim për refugjatët e Vukovarit*”. Fatkeqësisht, lajmi nuk ishte nga vatra e Vukovarit, por një reportazh nga Zagrebi, vendi ku kishin zbarkuar refugjatët që mbaheshin prej muajsh në kampin e Vukovarit.

*“Unë jam serbe” – thotë Trifka Vuksan. “Atë që na bënë çetnikët asnjëherë nuk do ta harroj, sidomos atë që na bënë rezervistët në Vukovar. Kur na hoqën nga kampi, të gjithë ne i njohëm... ishin kolegët dhe fqinjët tanë të deridjeshëm. Ata që na keqtrajtonin*

<sup>309</sup> Në fund të pranverës së 1991 u shënuar përpjekja e fundit por e dështuar për “shmangien” e luftës. I fundit nga këto takime, më 6 qershor 1991, e ndau përfundimisht jo vetëm federatën e deridjeshme, por shoi edhe shpresat për federatë ose konfederatë të re mes republikave të dala nga RSFJ-ja. Kiro Gligorov (president i Maqedonisë) dhe Alija Izetbegoviq (president i Bosnjë-Hercegovinës) hodhën idenë për krijimin e një komuniteti republikash të pavarura të Jugosllavisë. Tuxhman (president i Kroacisë), Millosheviq (president i Serbisë) dhe Millan Kučan (president i Sllovenisë) e hodhën menjëherë poshtë këtë propozim. Me një mbështetje nga Gjermania dhe Austria, Sllovenia dhe Kroacia e ndanë mendjen për pavarësi, akt ky që për Serbinë ishte i papranueshëm të kalonte aq lehtë në paqe.

Jasmina Udovički & James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë, Historia e vërtetë e dhimbjes së pashprehur të Europës*, Tiranë, Libra për një shoqëri të hapur, Albin 1998, faqja 158-159

*ishin shokët tanë” – thotë Trifka Vuksan e cila e vazhdon rrëfimin e saj për qëndrim 3-mujor në kamp, pa ushqim, ujë dhe në baltë.*

*Rrëfime të pabesueshme, përjetime të pabesueshme, për të cilat askush nuk mund të gjej sqarime të vërteta. Përse ndodhi? Kujt i duhet tashmë një qytet i tillë?*

*“Nuk e di përse. Me siguri u pengonim! Është për të ardhur keq ajo që kemi përjetuar nga bashkëfshatarët tanë, me të cilët deri dje hanim e pinim. Dhe përnjëherë na thanë “këtu nuk ka më vend për ju, këtu do të jetë Serbia e Madhe dhe pikë”. A është kjo urrejtje apo politikë.. nuk e di! Nuk jam aq e mençur ta kuptoj përse ndodhi e gjithë kjo... 4 muaj kaluan në kamp, qelbeshim në tokë, nuk kishim çfarë të vishnim, nuk kemi asnjë dinar.. ja, këtë që po shihni që kam veshur, është e vetmja që më ka mbetur. Gjithçka tjetër është rrënuar dhe djegur” – thotë 80 vjeçarja Jelka Inesh, e cila nuk di asgjë për fatin e familjes së saj.*

*Në bisedë ndërhyjnë edhe një grua tjetër, e cila e paraqiti veten si serbe të Vukovarit, sepse ajo nuk sheh ndonjë dallim mes fëmijëve të saj dhe të “tyre”, mes njerëzve, duke mos mundur ta shpjegojë këtë tmerr.*

*“Së pari, na dërguan në kazermën e qytetit... këtu na ndanë, burrat nga gratë, dhe serbët nga kroatët. Para syve tanë, komshinjtë tanë të deridjeshëm, serbët, keqtrajtuat vëllezërit tanë. Këtë nuk e bënë ushtarë të rinj, por rezervistët. Pastaj na hipën në kamionë ushtarakë dhe autobusë, duke na thënë se Zagrebi nuk na dëshiron, dhe se atje gjithçka është e minuar, se për atje na duhen pasaporta, gjithnjë duke na sharë “nënë, juve ustashëve” – thotë 18 vjeçarja Anica Shimunoviq .*

*Asnjë nga këto gra nuk harron që të shprehë edhe mllëfin e vukovarasve ndaj Zagrebit, kundër politikës kroate, e cila sipas tyre, nuk i ka vlejtur aspak Vukovarit.*

*“Vukovari mund të mbrohej, nëse do të na dërgohej në kohë ndihmë nga ushtria si dhe armë. Kemi pritur dhe jemi lutur për këtë. Fëmijë 18 vjeçarë kanë mbrojtur rrugët e tyre, shtëpitë e tyre. Kjo është e tmerrshme. Të vrarët, kur kishim mundësi, i varrosnim me arkivole që i bënim nga dyert e dollapëve” – sqaron në vaj dhe dhimbje Ivana Shumanoviq, e cila nuk di asgjë për fatin e burrit të saj, babait të Anicës.*

*Paqartësia për të ardhmen e këtyre njerëzve se ku dhe si do ta vazhdojnë jetën e tyre, ku i kanë të afërmit e tyre, familjarët, miqtë, vazhdon edhe më tej...”*

Në këtë raportim, i dërguari special Aleksandar Damovski përpiket të ofrojë një këndvështrim korrekt, jo vetëm në deklaratat e të anketuarve nga të dyja palët; serbë e kroatë, por edhe në rreshtat e shkruara nga vetë ai, ku ngre pyetjen (se kujt i duhet kjo luftë) ose kur përfundon tekstin (se paqartësia për të ardhmen do të vazhdojë). Reporteri ka lënë të anketuarit ta orientojnë tekstin, një herë kundër serbëve (rezervistët që kryen masakrat dhe se serbët nuk zgjedhin metoda në spastrimin e Vukovarit, duke përzënë madje edhe banorë serbë në radhët e kroatëve) e njëherë kundër kroatëve (për politikën e dështuar kroate që nuk e mbrojtën dhe as nuk e armatosi popullin kroat). Gazetari nuk ka dhënë detaje të thella për sulmuesin, shkelësin e territorit, për shkeljen e të drejtave të njeriut etj., por e ka përpiluar tekstin pa denjuar të shkojë në vatrën e ngjarjes – Vukovar. Ai ose redaktorët e tij janë mjaftuar me pasqyrimin e situatës vetëm nga zbritja e refugjatëve në Zagreb.

Ndërkaq, në një tjetër lajm të po të njëjtës datë të gazetës “Nova Makedonija” me titullin “Betejat po ndizen” përfshihen shkurtimisht të gjitha vatrën luftarake kroate në Osijek, Banja-Llukë, Knin, si dhe informacione nga Zagrebi, të cilat shpalosen në mënyrë telegrafike. Bie në sy raportimi i njëanshëm me burime të huazuara nga mediat pro-serbe lidhur me zhvillimet në terrenet luftarake (qytetet kroate) ku zhvilloheshin betejat. Në këtë lajm madje citohej si burim vetëm Radio-Beogradi, gjë që lë hapësirë për dyshime për vërtetësinë e ngjarjeve. Lajmi i përpunuar i referohej edhe burimeve të Televizionit të Malit të Zi i cili gjithashtu ishte aleat i fuqishëm i Serbisë në atë kohë.

*“Në rajonin e Osijekut, luftimet janë gjithnjë e më të ashpra. Lajmi i ditës nga betejat mund të jetë rënia e Llasllövës, nëse konfirmohet raporti i radios serbe nga Borovo-Sello. Kjo radio thotë se forcat tokësore serbe, në bashkëpunim me forcat e Armatës Popullore të Jugosllavisë dhe vullnetarët serbë, pasdite kanë marrë kontrollin e këtij fshati. Në vetë qytetin e Osijekut mbizotëron atmosferë kaotike dhe qytetin duan ta braktisin një numër i madh qytetarësh. Sot, siç njofton radioja serbe, në mënyrë të organizuar është kryer edhe evakuimi i rreth 1 000 banorëve”.*

Në lajmin e mësipërm, sikurse edhe në shumicën e lajmeve që shfaqeshin në mediat e Maqedonisë, referenca kryesore ishin agjencitë shtetërore serbe. Millosheviqi, në fakt, përveç mediave shtetërore (Radion dhe Televizionin e Serbisë) që shpalosnin kryekëput linjat nacionaliste, e kishte shtrirë kontrollin edhe ndaj gazetave “Politika”, “Politika Ekspres”, “Duga” si dhe “NIN”. Edhe “Borba” që tentoi të ishte e pavarur, humbi një numër të botimit të saj për shkak të problemeve që shteti u nxirrte me shtypjen e gazetës. Më në fund, në vitin 1994, gazeta iu dorëzua ndikimit të Millosheviqit i cili vendosi si drejtor dhe kryeredaktor, ish ministrin për Informim (shëf i propagandës nacionaliste) Dragutin Bërçin.<sup>310</sup>

Përveç medias, Millosheviqi përdori edhe armën tjetër, atë të policisë sekrete, jo vetëm ndaj rivalëve ose kundërshtarëve të tij por edhe ndaj gazetarëve të pavarur, sikurse ishte Sllatko Ćuruvija. Gazetari u vra nga policia sekrete, e cila zakonisht kryente “punët e pista” për Millosheviqin.<sup>311</sup>

Ndaj tendencave të qarta të Millosheviqit, i cili me etjen e tij për “Serbinë e Madhe” i bëri serbët të humbnin edhe ato që kishin fituar deri në atë kohë, autoritetet maqedonase ishin të vetëdijshme. Teksa komentonte konfliktin e mëvonshëm Serbi-Kosovë dhe sukseset e Maqedonisë për të ruajtur stabilitetin e brendshëm, atë ndërretnik në vend si dhe marrëdhëniet me fqinjët, Gligorov theksonte në një fjalim të tij në seancën plenare të 15 prillit të vitit 1999 se:

*“Qëndrimi ynë është një dhe i pandryshuar. Angazhohemi për gjetjen e mjeteve paqësore për kapërcimin e keqkuptimeve dhe përplasjeve që u shfaqën në Kosovë. Ky në fakt është qëndrimi që kemi pasur dhe kemi përkrahur gjatë gjithë procesit të shpërbërjes së ish RSFJ-së. Për një arsye të vetme... përdorimi i çdo lloj mjeti lufte si mënyrë për zgjidhjen e problemeve politike, në fakt nuk përbën zgjidhje, por në mënyrë të pashmangshme herët a vonë, do të nxitë nevojën për negociata politike, doemos. Nga ky parim u udhëhoqëm gjatë gjithë procesit të pavarësimit të Republikës së Maqedonisë. Unë besoj thellë se ky vendim ishte i duhuri. Republika e Maqedonisë mund të jetë krenare që e kapërceu sindromën ballkanike për të krijuar shtet me gjakun e fëmijëve të saj. Për fat të keq, jo gjithkund në hapësirat e ish Jugosllavisë ishte e njëjta qasje. Fatkeqësisht, disa nga liderët e shteteve të sapoformuara konsideronin se forca është argumenti më i fuqishëm në bisedime. Kështu, në vend të mësimit, pas gjithë luftërave në Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë ku Millosheviqi humbi gjithçka që serbët kishin fituar si territore në të cilat zbatohej forca - me një fuqi tejet të madhe luftarake të Ushtrisë Jugosllave - forca u përdor përsëri në Kosovë për të pastruar të ashtuquajturën “Ushtri Çlirimtare të Kosovës” por edhe kundër qytetarëve të Jugosllavisë. Për fat të*

<sup>310</sup> Sabrina P. Ramet, *The Three Yugoslavias: State-building and Legitimation, 1918-2005, State Building and Legitimation 1918-2005*, Woodrow Wilson Press and Indiana University Press, SHBA 2006, faqja 498, <[https://books.google.mk/books?id=FTw3IEqi2-oC&pg=PA405&dq=Macedonia+foreign+ministry+official+stance+about+Croatian+war+1991&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwie75iCr6XhAhUI\\_CoKHfuUBJEq6AEIOzAD#v=onepage&q=Macedonia&f=false](https://books.google.mk/books?id=FTw3IEqi2-oC&pg=PA405&dq=Macedonia+foreign+ministry+official+stance+about+Croatian+war+1991&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwie75iCr6XhAhUI_CoKHfuUBJEq6AEIOzAD#v=onepage&q=Macedonia&f=false)>, [3.4.2019]

<sup>311</sup> Po aty.

*keq, kundërpërgjigja ishte identike: e njëjta forcë ushtarake (kundërpërgjigje) erdhi si shpagim nga bashkësia ndërkombëtare.”<sup>312</sup>*

Gligorov ndërmori edhe një nga hapat më të vështirë të asaj kohe, atë të tërheqjes së ushtarëve nga Maqedonia, i nxitur sidomos nga reagimet që pasuan vrasjen e një të riu maqedonas në Split (6.5.1991), në kuadër të ushtrisë jugosllave.

Raportimi në mediat e Maqedonisë ishte emocional për shkak të karakterit të ngjarjes, por jo i njëanshëm. Raportohej për situatën kaotike në terren, e krijuar pas armatosjes së popullatës serbe të Kroacisë nga ana e ushtrisë jugosllave. Ky akt ngriti në demonstrata kroatët, ndërkohë që policia kroate dhe ushtria jugosllave u përfshinë në përlëshje me armë.

*“(Pas komunikimit)...me Komandën Luftarake Detare në Split, në trazirat e ndodhura sot në këtë qytet, nga plagët me armë zjarri vdiq ushtari Sasho Geshovski nga Kavadari, ndërsa ushtari Toni Stojčev nga Makedonska-Kamenica është plagosur në krahun e majtë, megjithatë është jashtë rrezikut për jetën dhe gjendet për mjekim në Spitalin Ushtarak të Splitit.”<sup>313</sup>*

Ndërsa në lajmin e të nesërme (7.5.1991) për ceremoninë ushtarake mortore me përshëndetje të shtënash nga bashkëluftëtarët e viktimës, tregohen sekuenca të ushtarëve që përqafohen dhe ndahen të përлотur, sekuenca nga fjala përshëndetëse e tyre para arkivolit si dhe breshëria e të shtënave të lamtumirës.

*“I dashur Sashko, miku ynë, shok dhe bashkëluftëtar! Në fund, ne ushtarët dhe eprorët e njësitit tonë, mund të të themi vetëm një falënderim njerëzor. I paharruar qoftë kujtimi yt!”<sup>314</sup>*

Pikërisht ky qëndrim zyrtar i mospërzierjes në konflikt dhe direktivat që iu shpërndaheshin mediave, ishin arsyeja që edhe Radio-Televizioni i Shkupit (pas viti 1993 i njohur me emrin RTVM) si dhe mediat e shtypura, të tregonin një farë *indiferentizmi dhe ftohtësie* ndaj luftërave për ndarjen e ish Jugosllavisë.

Në fakt, vrasjen e të riut maqedonas më shumë e përdori propaganda serbe dhe mediat e Millosheviqit, duke e shfaqur atë në ekrane për 6 javë me radhë si provë përfundimtare e ringjalljes *ustashe*.<sup>315</sup>

Me këtë ngjarje, ministri serb i Mbrojtjes Velko Kadujeviq shpalli “luftë civile shtetërore” duke lënë të kuptonte vendimin që kishte marrë ushtria se *do t’i përgjigjej me forcë* çfarëdo sulmi që do të vinte nga kroatët.

Maqedonia ende e shikonte për së largu konfliktin, duke tentuar një ekuilibër *objektiv* i cili u ruajt deri diku edhe në pasqyrim mediatik gjatë luftës së mëvonshme Serbi-Kosovë (1998),

<sup>312</sup> Стенографски белешки од Седумнаесеттата седница на Собранието на Република Македонија, одржана на 15 април 1999 година (Shënime stenografike nga Seanca e Shtatëmbëdhjetë e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, e mbajtur më 15 prill 1999),

<<https://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/017%20sednica%2015.04.1999.pdf>>, [3.4.2019]

<sup>313</sup> Dokumentar në Youtube, 20 години независност: Македонија е се што имаме, 1991 година [EΠ02] (20 vjet pavarësi: Maqedonia është gjithçka që kemi, 1991 [EΠ02]), minuta 18:38 – 18:56,

<[https://www.youtube.com/watch?v=yq21R\\_o6MeU&list=PLE9113101A9B82EB5&index=2](https://www.youtube.com/watch?v=yq21R_o6MeU&list=PLE9113101A9B82EB5&index=2)>, [4.4.2019]

<sup>314</sup> Po aty, minuta 19:50 – 20:05

<sup>315</sup> Jasmina Udovički & James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë, Historia e vërtetë e dhimbjes së pashprehur të Europës*, Tiranë, Libra për një shoqëri të hapur, Albin 1998, faqja 137

por që u provokua dhe u prish rëndë kur shqiptarët e këtushëm u ngritën në vitin 2001 për më shumë të drejta – atë që vetë udhëheqja maqedonase e asaj kohe kishte përkrahur si teori për popujt e tjerë të ish Jugosllavisë.

### 5.1.1 Media e re e Maqedonisë pas pavarësisë – “monopoli i padukshëm”

Hedhja pas shpine e komunizmit dhe futja në një tranzicion të dhimbshëm e të gjitha vendeve të Bllokut Lindor, veçanërisht RSFJ-së, e bënë median të jetë pluraliste por jo edhe të lirë... aq më pak të pavarur.

Siç shkruan Remzi Lani, në rastin e Ballkanit, situata u ndërlikua më shumë si pasojë e shpërthimit të llojeve të ndryshme të nacionalizmit dhe luftërave (siç ndodhi me RSFJ-në që sqarua më sipër). Ndërsa për sa i përket tranzicionit, këto vende nuk kaluan nga diktatura komuniste në demokraci, por nga regjimet totalitare komuniste në regjimet autoritare post-komuniste.<sup>316</sup>

Maqedonia e asaj kohe nuk bënte dallim në këtë grup vendesh, pavarësisht se pas viteve 1990 ajo u mbajt si fëmija i përkëdhelur i komunitetit ndërkombëtar, pasi tranzicioni jo i dhunshëm i saj iu përmendej shteteve të tjera të rajonit si shembull i mirë.<sup>317</sup>

Megjithatë, parë në aspektin e përgjithshëm, të gjitha këto vende vuanin nga një sërë sindromesh; agjenda post-komuniste, agjenda post-konflikt, agjenda e globalizimit dhe agjenda e europianizimit.

Maqedonia e asaj kohe kishte një start të mirë, por përjetimi i konfliktit të brendshëm dhe nacionalizmi që e çoi në të, e detyruan që jo vetëm të ngecte në rrugëtimet e saj, por edhe të bënte hapa prapa (sidomos në agjendën e europianizimit). Post-komunizmi, si periudhë, pasoi me një elitë post-komuniste të dalë nga Lidhja Komuniste, ndërkohë që agjenda post-konflikt, pavarësisht se Maqedonia nuk ishte në konflikt të drejtpërdrejtë në vitet 1991, e bëri atë prapëseprapë pjesë të vorbullës serbe në luftërat jugosllave si dhe shënjestër rreziku të ruajtjes së ekuilibrave për të mos rënë vetë në këtë vorbull. Distancimi nga konflikti ishte barrë e rëndë, ndërkohë që pas disa vitesh, si çdo shtet post-konflikt do ta bënte atë të ballafaqohej me pasojat e të kaluarës.

Duke qëndruar në fije të perit, media në Maqedoni veç vegjetonte (pasive dhe e varur nga shteti që kishte nisur procesin e privatizimit). Radioja dhe Televizioni i Shkupit do të *provokoheshin* në vitin 1993 kur do të lindnin edhe mediat e para private, ndërkohë që me realitetin e ri, Maqedonia do të vendoste për herë të parë edhe një kornizë më të qartë ligjore për zhvillimin e medias si dhe do të themelonte Këshillin për Radiodifuzion (1997)<sup>318</sup> - si të parin

<sup>316</sup> Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara, *Gazetaria profesionale dhe vet-rregullimi, media të reja - dilema të vjetra në Evropën Juglindore e Turqi*, UNESCO 2010, faqja 42, <<https://books.google.mk/books?id=7nPs6xpFOXwC&pg=PT38&lpg=PT38&dq=Media+e+ballkanit,+lost+in+transition&source=bl&ots=VWD9LhWaeT&sig=ACfU3U1q7eGgqG2ICj-l8W22XS7XmwYQFw&hl=en&sa=X&ved=2ahUKEwj6JmFl ePgAhVwtosKHZ5xDkgQ6AEwAXoECAIQAQ#v=onepage&q=Media%20e%20ballkanit%2C%20lost%20in%20transition&f=false>>, [5.4.2019]

<sup>317</sup> Mark Thompson, *Slovenia, Croatia, Bosnia and Herzegovina, Macedonia (FYROM) and Kosovo International Assistance to Media*, OSCE – Representative on freedom of the Media, Vienna 2000, faqja 50, <<https://www.osce.org/fom/25448?download=true>>, [5.4.2019]

<sup>318</sup> Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, *KRD sot kremtoi 15 vjetorin që nga themelimi - mbledhje solemne*, <<http://avmu.mk/sq/05-09-2012-krd-sot-kremtoi-15-vjetorin-qe-nga-themelimi-mbledhje-solemne/>>, [5.4.2019]

trup që do të diktonte rend në radhët e medias, do të nxiste cilësinë e pluralizmit mediatic përmes rritjes së krijimtarisë, do të nxiste standardet profesionale gazetareske si dhe do të shndërronte mediat e asaj kohe në subjekte të mirëfillta audiovizuale.

Mund të theksohet vetëm fakti që Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë ekzistonte që në vitin 1946, edhe pse, sikurse folëm më sipër për kontrollin politik komunist, ky trup nuk shërbente për etikë, rregullim mediatic etj., por më shumë si një organizim shoqëror gazetarësh.

\*\*\*

Megjithatë, le t'i ndjekim me radhë hapat e ecuresisë së medias në periudhën pas pavarësisë së saj.

Mediat, që veçse funksionin në fillim-vitet '90, ishin thuajse të njëjtat e periudhës socialiste të pas-vitit 1974. Radio-Shkupi (themeluar në vitin 1941) dhe Televizioni-Shkupi (themeluar në vitin 1964), pavarësisht shkëputjes së tyre nga domeni ose Unioni i Radio-Televizioneve Jugosllave (me ndarjen e RSFJ-së) vazhduan të funksiononin me plogështi dhe me mentalitetin e njëjtë deri në vitin 1993 (në fakt, mentaliteti i vjetër përbën ende sot e kësaj dite *sindromin e RTVM-së*). Edhe pse mundësitë për krijim të lirë programesh apo liri informimi ishin ende larg synimit, dy subjektet mediatiche (Radio-Shkupi dhe Televizioni-Shkupi), pavarësisht se braktisën sistemin e vjetër të funksionimit, dështuan në zbatimin e vlerave të reja të rregullimit demokratik.<sup>319</sup>

Megjithatë, tani trokiste epoka e mediave të pavarura elektronike, e lulëzimit të radiove dhe televizioneve të para private. Duhet të theksohet se shumë prej tyre, kur i sheh nga prizmi i sotëm, ishin thjesht kioska të vogla, pa rregullativë ligjore, pa financa të sigurta dhe pa kuadër të mirëfilltë.

Datat	Televizionet e themeluara në pluralizëm
janar 1991	Themelohet televizioni i parë privat TV Zdravkin (Veles)
tetor 1991	Themelohet radioja e parë private Kanal 77 me sinjal fillestar në Tetovë
1992	Themelohet Agjencia Shtetërore e parë e Informimit MIA
22 janar 1993 (deri në 31 korrik 2011)	Themelohet televizioni i parë i pavarur privat A1. Shumë shpejt, sondazhet do e radhitnin atë <i>të parin</i> në hapësirën transmetuese të Maqedonisë për nga shikueshmëria.
22 janar 1993	Themelohet televizioni i dytë i pavarur privat Sitel, i cili do të merrte primatin e shikueshmërisë si televizioni i parë, vetëm pas shuarjes së televizionit A1
1991	Radio-Shkupi dhe Televizioni-Shkupi ndahet nga Unioni i Radio-Televizioneve Jugosllave dhe nisin veprimtarinë e mëvetësishme si të pavarur.  Radio-Shkupi dhe Televizioni-Shkupi themelojnë subjektin RTVM.

<sup>319</sup> SHGM & Fondacioni "Konrad Adenauer", *Raportimi etik i mediave në Evropë dhe Maqedoni, Etika mediatiche dhe vetërregullimi në Maqedoni*, Shkup, SHGM 2016, faqja 83, <<http://znm.org.mk/wp-content/uploads/2016/03/RAPORTIMI-ETIK-I-MEDIEVE-N%C3%8B-EVROP%C3%8B-DHE-MAQEDONI-DHJETOR-2016.pdf>>, [6.4.2019]

<b>1993</b>	Në të njëjtin vit (korrik), ky subjekt i ri bëhet pjesë e EBU-së, Unionit Evropian të Transmetuesve
<b>24 prill 1997</b>	RTVM-ja ndahet në dy subjekte: Radiodifuzioni i Maqedonisë (28.01.1998) <sup>320</sup> dhe Radio-Televizioni i Maqedonisë
<b>2000</b>	Tepër vonë, RTVM-ja aplikoi edhe për televizion satelitor. Maqedonia ishte shteti i fundit në Evropë për një licencë të tillë satelitore.
<b>20 korrik 2017</b>	<p>Me marrëveshjen politike “Përzihno 2” (15 korrik 2015) shërbimi shqip i TVM2 do të bëhej televizion 24-orësh në gjuhën shqipe.<sup>321</sup> Ende sot e kësaj dite (2019) ky televizion nuk është shndërruar si i tillë, ndërkohë që i paqartë mbetet edhe statusi i 5 etnive të tjera që kanë nga disa orë transmetim në të njëjtën frekuencë.<sup>322</sup></p> <p>Deri në vitin 2016, RTVM-ja financohej kryesisht nga taksa radiodifuzive (fillimisht 330 denarë pastaj 190 denarë) si dhe reklamimi, sponsorizime, donacione, shitje programesh dhe shërbimesh si dhe mjete që siguroheshin nga buxheti i shtetit.<sup>323</sup> Tani, me ligjin e ri, TVN-ja (ish RTVM-ja) financohet në masën 0,7% të buxhetit të shtetit. Taksa radiodifuzive ishte e vështirë të mblidhej dhe nga ana tjetër nuk i mbulonte realisht shpenzimet. Po ashtu, për shkak të punësimeve politike, stafi i RTVM-së numëron gati 850 të punësuar, 170 prej të cilëve janë shqiptarë në shërbimet në gjuhën shqipe.</p> <p>RTVM-ja, si ndërmarrje publike përmban 5 televizione (TVM1, TVM2, TVM Kuvendi, MKTV SAT me dy sinjale në shqip e maqedonisht) si dhe 3 radio (Radio-Skopje, Radio-Shkupi, Radio 3 SAT)</p> <p>Me ligjin për riemërtimin e institucioneve në bazë të Marrëveshjes së Prespës me Greqinë (për zgjidhjen e çështjes së emrit), RTVM u emërtua NTV (Национална Радио-Телевизија) dhe në shqip RTN (Radio-Televizioni Nacional)<sup>324</sup></p>

<sup>320</sup> Ndërmarrja Publike “Radiodifuzioni Nacional – Shkup” (RDN) është ndërmarrje publike e themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut më 28.1.1998, <<https://jpmrd.gov.mk/%D0%B7%D0%B0-%D0%BD%D0%B0%D1%81/>>, [7.4.2019]

<sup>321</sup> TVM2, *Shqip-për herë të parë në RTVM, Ibrahim: Servis të veçantë publik për shqiptarët*, <<http://al.mrt.com.mk/node/32277>>, [7.4.2019]

<sup>322</sup> ALSAT, *24 orë shqip në TVM2, larg realizimit*, <<https://www.youtube.com/watch?v=-xyakjCAB0Q&feature=youtu.be>>, [7.4.2019]

<sup>323</sup> Pravo.org.mk, *Ligji për Veprimtari Radiodifuzive 1997, neni 116*, <<http://www.pravo.org.mk/documentDetail.php?id=342>>, [7.4.2019]

<sup>324</sup> Libertas, *Македонската радиотелевизија станува Национална радиотелевизија – а ова се и другите нови имиња на државни институции (Radiotelevizioni maqedonas bwhet Radiotelevizion kombëtar – këta janë edhe emrat e rinj të institucioneve shtetërore)*, <<https://www.libertas.mk/makedonskata-radiotelevizija-stanuvana-natsionalna-radiotelevizija-a-ova-se-i-drugite-novi-imina-na-drzhavni-institutsii/>>, [7.4.2019]



<b>2019</b>	
<b>1997</b>	Në pajtim me Ligjin për Radiodifuzion, Këshilli për Radiodifuzion vendosi që 29 radiostacionet publike lokale të transformoheshin në operatorë komercialë radiodifuzivë. <sup>325</sup>
<b>1997</b>	Themelimi i rrjetit të parë kabllor për herë të parë lidhi qytetin e Strumicës. Pavarësisht se veprimtaria e rrjeteve kablore u rregullua me ligj pas një dekade (2006), ende nuk dihet numri i tyre i saktë nëpër Maqedoni, pasi mes tyre ka edhe ndonjë kabllor të paligjshëm. Në kuadër të rregullimit, shërbimet kablore jo vetëm që duhet t'i regjistrinin shërbimet e tyre programore pranë KRD, por duhet të siguronin edhe vërtetimin për respektim të të drejtave autoriale.
<b>1991-2001</b>	Thuajse 250 operatorë audio dhe audiovizualë mbizotëronin në hapësirën transmetuese në Maqedoni

FIGURA 4. TELEVISIONET E THEMELUARA NË PLURALIZËM NË MAQEDONINË E VERIUT

Siç mund të shihet nga tabela, radiot dhe televizionet në Maqedoni krijoheshin lehtë, për shkak edhe të një mundësie tjetër; së pari për shkak të mungesës së rregullativës ligjore dhe së dyti, për shkak të opsionit tjetër që ofronte Kushtetuta. Akti më i lartë juridik në vend ishte avangardë dhe i lejonte çdo qytetari që të *themelonte* media. Pikërisht në nenin 16, kushtetuta e vitit 1991 theksonte:

*Garantohet liria e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe e shprehjes publike të mendimit.*

***Garantohet liria e fjalës, paraqitjes publike, informimit publik dhe themelimit të lirë të institucioneve për informim publik.***

*Garantohet qasja e lirë tek informatat, liria e marrjes dhe e përcjelljes së informatave.*

*Garantohet e drejta e përgjigjes në mjetet e informimit publik.*

*Garantohet e drejta e korigjimit në mjetet e informimit publik.*

*Garantohet e drejta e mbrojtjes së burimit të informatës në mjetet e informimit publik.*

*Censura është e ndaluar.*<sup>326</sup>

Një element shtesë për rritjen në numër të mediave ishte edhe investimi i huaj nga Soros-i. Sektori privat pati një mbështetje të rëndësishme nga “Instituti për Shoqëri të Hapur” i filantropistit Xhorxh Soros gjatë këtyre viteve. Qëllimi i këtij programi financues në media nga ky Institut kur filloi zbatimin në vitin 1993, ishte të siguronte pluralizmin (se Maqedonia do të

<sup>325</sup> Pravo.org.mk, *Ligji për Veprimtari Radiodifuzive 1997, neni 173*, <<http://www.pravo.org.mk/documentDetail.php?id=342>>, [8.4.2019]

<sup>326</sup> Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e vitit 1991, *Gazeta Zyrtare e datës 22 nëntor 1991, numër 52*, faqja 806, <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/19D704B29EC040A1968D7996AA0F1A56.pdf>>, [8.4.2019]

hiqte dorë nga sistemi njëpartiak). Sipas të dhënave të kohës, më shumë se 50 operatorë transmetues përfituan nga ndihma financiare e Sorosit.<sup>327</sup>

Në hapësirën transmetuese në Maqedoni filloi kaosi, madje shpeshherë valët e radiove apo televizioneve *ngatërroheshin*<sup>328</sup> me ato të një radioje apo televizioni tjetër, për shkak të frekuencës së njëjtë që *zптоhej* nga operatorët audio dhe audiovizualë.

Radio, televizione, si dhe operatorë të vegjël kabllorë filluan të pushtonin vendin, por jo si subjekte të pavarura. Qëllimi primar i tyre ishte ai komercial. Në atë kohë, shumëkush i quante edhe kioska, sepse numri i tyre pa kriter dhe pirateria e transmetimit nxiste një treg jo korrekt e jo të drejtë.

Sipas të dhënave, deri në 1997 numri i operatorëve audio dhe audiovizualë kishte shkuar gati 250 syresh<sup>329</sup> kështu që kishte ardhur koka për autoritetet e Maqedonisë që të miratonin ligjin e parë për veprimtari radiodifuzive.<sup>330</sup> Përveç faktit që përcaktonte rregullat e themelimit dhe të punës së mediave, Ligji për veprimtari radiodifuzive garantonte edhe lirinë e shprehjes, të drejtën e korrigjimit dhe përgjigjes, qasjen të informatat dhe mbrojtjen e burimit të informacionit.<sup>331</sup>

Me ligjin e ri u krijua edhe Këshilli për Radiodifuzion, i cili për herë të parë ndau licenca transmetimi, duke hedhur hapat e parë drejt rregullimit të medias. Dy licencat e para kombëtare iu ndanë të vetmeve televizione private të pavarura të asaj kohe që falë shikueshmërisë pushtuan gjithë Maqedoninë; A1 dhe Sitel. Po ashtu, si lojtare të fuqishme kombëtare ishin sprovuar tashmë edhe dy radiot Kanal 77 dhe Antenna 5.<sup>332</sup>

Megjithatë, duhet theksuar se Ligji për Veprimtari Radiodifuzive i vitit 1997 kishte ende të meta, edhe pse në atë kohë ai konsiderohej si hapi i parë i rregullimit të sferës mediatike. Shumë sfera u testuan jo vetëm nga ligji por edhe nga konkurrenca mediatike, sa i takon themelimit, financimit, RTVM-së dhe këshillit të saj drejtues i cili kishte vetëm funksion “këshillëdhënës”. Ndërsa për radiodifuzerët privatë, *koncesionet* (siç quheshin deri në 2015 kur u riemërtuan dhe përkufizuan si *licenca*) nuk ishin parashikuar për *rreze rajonale* apo për qëllime jofitimprurëse (sikurse radioja studentore e Universitetit “Shën Kirili e Metodij” në 2007), ndërkohë që për privatët kishte kufizime rreth *investimeve të huaja* apo edhe *përqendrimin pronësor* në subjekte *paralele* radiodifuzive (p.sh., nëse përveç televizionit të mund të zotërohej edhe gazetë ose radio me të njëjtën shtrirje lokale, rajonale apo kombëtare).

Sipas ligjit, në bazë të propozimit të Këshillit për Radiodifuzion, Qeveria iu mundësonte operatorëve radiodifuzivë përdorimin e frekuencave në bazë të koncesionit. Një gjë e tillë

<sup>327</sup> Mark Thompson, *Slovenia, Croatia, Bosnia and Herzegovina, Macedonia (FYROM) and Kosovo International Assistance to Media*, OSCE – Representative on freedom of the Media, Vienna 2000, faqja 51, <<https://www.osce.org/fom/25448?download=true>>, [9.4.2019]

<sup>328</sup> Dona Kolar Panova, *Историја на масовните комуникации (Historia e komunikimit masiv)*, Ligjërata të autorizuara, Shkup 2007, faqja 128

<sup>329</sup> Huw David Jones, *The Media in Europe's Small Nations*, Cambridge Scholars Publishing, Newcastle 2014, faqja 35

<sup>330</sup> Pravo.org.mk, *Ligji për Veprimtari Radiodifuzive 1997, neni 173*, <<http://www.pravo.org.mk/documentDetail.php?id=342>>, [9.4.2019]

<sup>331</sup> Sandra Buzlieva & Mila Isakovska, *Manual për lirinë e shprehjes dhe gjuhën e urrejtjes, Aspekte juridike*, projekt i BE-së dhe Ambasadës britanike mbi gazetarinë, Shkup, Botuar nga Shoqata e qytetarëve “Instituti për të Drejtat e Njeriut” dhe Shoqata për Zhvillim “Qendra për Administrim me Ndryshime” 2016, faqja 10, <[http://www.cup.org.mk/publications/ipa\\_piracnik\\_al-ilovepdf-compressed%20\(4\).pdf](http://www.cup.org.mk/publications/ipa_piracnik_al-ilovepdf-compressed%20(4).pdf)>, [9.4.2019]

<sup>332</sup> Huw David Jones, *The Media in Europe's Small Nations*, Cambridge Scholars Publishing, Newcastle 2014, faqja 35

konsiderohet si influencë e drejtpërdrejtë në çështjet e radiodifuzionit.<sup>333</sup> Vetëm pas vitit 2005, koncesionet u eliminuan jo vetëm si term (u quajtën *licenca*) por u mundësua ligjërisht që qeveria të hiqej nga ky trekëndësh i deritanishëm.

Në pajtim me dy ligjet e tjera; Ligjin për Koncesion dhe Ligjin për Telekomunikime, Këshilli për Radiodifuzion i lëshonte koncesionet në bazë të një sërë kritereve që përfshinin natyrën dhe shumëllojshmërinë e shërbimit programor, orët e transmetimit (veçanërisht orët e prodhimit vendor në transmetimin ditor), të dhënat mbi bartësin e licencës, kërkesën teknike për prodhim dhe transmetim sipas standardeve të caktuara, mjetet teknike për transmetim, kapacitetet financiare, burimet njerëzore, rajonin gjeografik që mbulohej, afatet transmetuese, etj.

*“Leja për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive të shoqërive tregtare radiodifuzive si dhe ente jo-fitimprurëse radiodifuzive jepet për një periudhë kohore prej 9 vjetësh dhe nuk mund t’i transferohet ndonjë personi tjetër”* thoshte neni 58 i Ligjit për Veprimtari Radiodifuzive.<sup>334</sup>

Nga konkursi i parë për ndarjen e koncesioneve në nivel lokal e kombëtar, të radiove dhe televizioneve, përveç dy televizioneve A1 dhe Sitel dhe dy radiove Kanal 77 e Antenna 5 në nivel kombëtar, u ndanë koncesione edhe për 57 televizione dhe 80 radio të tjera në nivel lokal.

Deri më sot janë zhvilluar 3 konkurse për ndarje licencash ndërkohë që tregu mediatik ka ndryshuar jo vetëm për nga numri i operatorëve (disa prej tyre janë mbyllur, ka ndryshuar në programe dhe përmbajtje apo kanë ndërruar pronarë), por edhe nga numri i licencave kombëtare, rajonale e lokale. Numri është tepër i lartë, qoftë edhe ai i mediave kombëtare, nëse merret në konsideratë edhe popullata e Maqedonisë së Veriut, mungesa e financimit, ndikimi shtetëror apo biznesor mbi to, si dhe një sërë problemesh për të cilat do të flasim më poshtë.

\*\*\*

Në dekadën nga viti 1991 deri në 2001, sfera mediatike u pasurua edhe me televizione të tjera, ndërkohë që pas konfliktit të 2001, për herë të parë filloi edhe lulëzimi i mediave në gjuhën shqipe, përfshi këtu edhe gazetatat.

Në vitin 2019, Maqedonia numëron 158 operatorë: televizione, radio e gazeta.<sup>335</sup> Sipas të dhënave nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale,<sup>336</sup> janë 5 televizione private kombëtare; *Sitel, Kanal 5, Alsat, Telma* dhe *Alfa*, si dhe 3 televizione publike *TVM1, TVM2, TVM Kuvendi*. Nga ana tjetër, 3 radio private kanë marrë licencë kombëtare; *Kanal77, Antenna 5* dhe *Metropolis*, përveç edhe dy radiove publike të RTVM-së, *Radio-Skopje* dhe *Radio-Shkupi*.

Po ashtu, në nivel shtetëror shihen përmes sitemit kabllor edhe televizionet; *TV21, Shenja, Klan-Maqedoni (ish TV ART), ITV* (i shuar tashmë prej shtatorit të vitit 2019)<sup>337</sup> dhe *TV Sonce*. Në nivel shtetëror përmes sitemit kabllor shihen edhe *24-Vesti* dhe *Nasha TV*.

Në listën e operatorëve me licencë rajonale numërohen 18 televizione, *TV Amazon, TV Tera, TV M, TV Star, TV Kanal-Vis, TV Iris, TV Kobra, TV Uskana, TV Tepostrada, TV 3, TV*

<sup>333</sup> Open Society Institute, *Televizioni në Evropë: Raporti për mbikëqyrjen e situatës 2008*, Budapest 2008, faqja 31, <[https://www.opensocietyfoundations.org/sites/default/files/macedoniaalbanian\\_20080429\\_0.pdf](https://www.opensocietyfoundations.org/sites/default/files/macedoniaalbanian_20080429_0.pdf)>, [10.4.2019]

<sup>334</sup> Pravo.org.mk, *Ligji për Veprimtari Radiodifuzive 1997, neni 56*, <<http://www.pravo.org.mk/documentDetail.php?id=342>>, [10.4.2019]

<sup>335</sup> Portalet nuk janë të listuara për shkak se nuk janë pjesë e legjislacionit mediatik në Maqedoninë e Veriut.

<sup>336</sup> Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, <<http://avmu.mk/>>, [11.4.2019]

<sup>337</sup> Gazeta Express, *Mbyllet televizioni ITV*, <<https://www.gazetaexpress.com/mbyllet-televizioni-1tv/>>, [11.4.2019]

*Edo, TV Era, TV MTV, TV Shutell, TV Sitel 2, TV Kiss dhe TV Koha.* Po ashtu, në nivel rajonal numërohen edhe 16 radio, *Radio Haraçina, Radio Buba-Mara, Radio Vati, Radio Zona, Radio Urban, Radio Life, Radio Rosa, Radio RFM, City Radio, Radio Sky, Radio Hepi, Sportsko Radio, Radio Studenti, Radio Kapitol, Radio Fortuna dhe Radio Jazz.*

Në listën e operatorëve lokalë ka një numër akoma më të madh televizioneesh prej 19 syresh, *TV Festa, TV Nova, TV Koçani, TV Kanal 8, TV Protell, TV Kanal 21, TV Zdravkin, TV Svet, TV Kanal-Vizija, TV Moris, TV Kaltrina, TV Spektra, TV Dibra, TV Gurra, TV Anisa, TV 2, TV Globi, TV Plus dhe TV Uskana.* Ndërsa nga radiot lokale numërohen 51 syresh, *Skaj Radio Plus, Radio 106, Radio Aktuel, Radio B-97, Radio Delfin, Radioja Universitare UKLO, Radio Vallandova, Radio Goldi, Radio Merak 5, Radio La-Kosta, Radio Kometa, Radio Pro-FM, Radio Ballkan-FM, Radio Time, Radio Zona, Radio Galaksi 2002, Radio Kavadari, Radio Aleksandar Makedonski, Radio Akord, Radio Medison, Radio Uskana-Plus, Radio Koçani-FM, Radio Albana, Radio Bravo, Radio Bum, Radio Jehona, Radio Puls, Radio Llav, Radio MX, Radio Super, Radio 5 Çoki, Radio Meff, Radio Holidej, Radio Pela, Radio Eko, Radio Modea, Radio Sveti-Nikolla, Radio Drini, Radio Play, Radio Rrapi, Radio Ekspres, Radio Hit, Radio Bleta, Radio Kiss, Radio Plus-Forte, Radio Fama, Radio Red-FM, Radio Angels-FM, Radioja Universitare UGD, Radio 102-ka FM dhe Radio Marija.*

Sa u përket mediave të shkruara, nga lista e nxjerrë nga Agjencia e Mediave në vitin 2019 (mars), rezultojnë 25 gazeta; *Nova Makedonija, Sloboden Peçat, Veçer, Koha, Lajm* (ditore), *Kapital, Fokus* (periodike) si dhe një numër i madh revistash të përjavshme apo të përmuajshme, kryesisht sociale, shëndetësore apo mbi stilin e jetës. Numri i gazetave dhe revistave në shqip është i vogël; *Koha, Lajm* dhe *Shenja*, si dhe ndonjë revistë e përmuajshme e përkthyer në shqip (por, si botim parësor është në maqedonisht) sikurse *Libi* e *Mini-Libi*.

### 5.1.2 Gara për media përfaqësuese e komuniteteve të tjera

Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, që në kohën e Josip Broz Titos kur kushtetuta bënte klasifikimin mes kombeve dhe kombësive, kishin një pjesëz të vogël të përfaqësimit mediatik. Por, siç u theksua më sipër, media në atë kohë ishte nën propagandën e sistemit komunist (më vonë socialist) dhe teorisë së *bashkim-vëllazërimit* që zgjati deri në pavarësinë e vendit. Është mëse e qartë se raportimet e kohës nuk mund të merren as si *objektive*, dhe as *në favor të komunitetit shqiptar për më shumë të drejta*.

“Flaka e Vëllazërimit” dhe më vonë “Flaka” e kishte fillimin e saj me mediat e kohës së RSFJ-së dhe ishte *Ndërmarrje Publike* nën domenin e shtetit, si financiarisht ashtu edhe politikisht, pa përjashtuar edhe ndikimin e partive shqiptare në pushtet.<sup>338</sup> Nga shkrimet e saj, siç u vërejt në kapitullin paraprak, kjo gazetë ishte mjet i sistemit të kaluar, dhe madje, në raste të protestave dhe revoltave të popullit shqiptar, ishte një nga mjetet që dënonte kërkesat e shqiptarëve që shkonin përtej dispozitave që parashikonte kushtetuta, shteti dhe vetë shoqëria socialiste. Gazeta do të mbahet mend megjithatë, për betejën e saj në vitet 1980 lidhur me *ruajtjen e toponimeve shqipe* (sepse ato maqedonase binin ndesh me normat e gjuhës shqipe), ndërkohë që sistemi asokohe impononte në libra, shkolla e media, përdorimin e tyre sipas normave të gjuhës maqedonase; Shkupi të quhej Skopje, Dibra - Debar, Kërçova - Kiçevo e kështu me radhë. Më karakteristik ka qenë toponimi për Manastirin - Bitola. Gazeta “Flaka e

<sup>338</sup> Sevdail Demiri, *Gazetat me histori – shkojnë në histori!*, Centrum 9, <<http://centrum.mk/wp-content/uploads/2018/07/PJESA-22-1-1.pdf>>, [11.4.2019]

Vëllazërimet” sikurse edhe revistat e saj “Fatosi” dhe “Gëzimi”<sup>339</sup> janë vlerësuar prapëseprapë si trashëgimi kulturore dhe historike e shqiptarëve të Maqedonisë.<sup>340</sup> Intelektualët shqiptarë theksojnë gjithsesi se duke marrë parasysh rrethanat politike të kohës, “Flaka e Vëllazërimet” luajti rol të madh në kulturën dhe arsimimin e shqiptarëve. Rol të fuqishëm në këtë gazetë kishte *Nexhat Agolli*, ministër për Punë Sociale në Qeverinë e Parë të Maqedonisë si dhe *Petro Janura*, drejtor i gazetës. Numri i parë i gazetës doli në 4 prill të 1945 dhe ajo dilte 3 herë në javë. Ajo vazhdoi si ndërmarrje publike deri kur mjetet publike të informimit, me ligjin e ri, u shpallën për privatizim ose transformim komercial. Në këtë kohë, “Flaka e Vëllazërimet” e kishte ndërruar edhe emrin, duke hequr prapashtesën “*Vëllazërim*” që imponohej nga nomenklatura e kaluar. Në vitet e pluralizmit, gazeta filloi të bëhej e përditshme (1994). Megjithatë, privatizimi i saj zgjati shumë, deri në vitin 2003, kur u ble për 3 mijë euro<sup>341</sup> nga Vait Ajro. Vështirësia financiare për mbijetesë e detyroi prapëseprapë gazetën që të humbte shpeshherë disa numra të saj para publikut, deri sa 9 muaj më vonë, të shuhej përfundimisht për të mos u aktivizuar më.

Një tjetër gazetë me emër dhe me rol të fuqishëm në sferën mediatike shqiptare në Maqedoni ishte edhe gazeta e parë e pavarur “Fakti”. Numri i parë i saj doli në 10 prill të vitit 1998, por edhe kjo gazetë, për shkak të mbijetesës së vështirë financiare pati të njëjtin fat të shuarjes së saj në vitin 2011. Kjo gazetë tuboi një numër prej 30-40 gazetarësh dhe intelektualësh të cilët u bënë tribunë jo vetëm e mendimit të çliruar nga propaganda komuniste për shqiptarët, por edhe zëri i fuqishëm i opionencës gjatë vitit të konfliktit 2001 përballë përbaltjes nga mediat maqedonase. Me raportime të përditshme mbi konfliktin, me numrin e gazetarëve nga rajonet e konfliktit si dhe me zyrë korrespondentësh në Tetovë, gazeta u bë zëri i identifikimit të shqiptarëve. Nuk mund të mohohet se në këto vite, ndikimi politik ishte gjithashtu i fuqishëm. PDSH-ja ishte produkt i shkrirjes në 1997 të PPDSH-së (Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve – krah radikal i dalë nga PPD-ja) me PDP-në (Partinë Demokratike Popullore). PDSH-ja ishte pjesë e pushtetit nga viti 1998 deri në 2002, dhe ishte e qartë se do të bënte presion për të shtendosur dhe amortizuar luftimet, për të ruajtur pozitën e saj. Edhe ashtu, pa kurrfarë kompleksi, duhet thënë se asnjë parti shqiptare e mijëvjeçarit të kaluar si pjesëmarrëse në qeveri nuk ia arriti qëllimit të impononte ndryshime të karakterit thelbësor, si p.sh., *ndryshim të kushtetutës, parlament dy-dhomësh, demokraci konsensuale* etj. Arritjet e tyre ishin vetëm në aspekte sociale se sa kombëtare.<sup>342</sup> Gazeta Fakti ishte ajo që lidhi dy shekujt e shkrimit shqip<sup>343</sup>

<sup>339</sup> Redaktor i të dyja këtyre revistave ishte Fejzi Bojku, i cili në 70-vjetorin e gazetës “Flaka e Vëllazërimet” theksoi se në mungesë të abetares në gjuhën shqipe, revistat “Fatosi” dhe “Gëzimi” u bënë udhërrëfimi i shkrimit dhe këndimit në shqip për fëmijët e të gjitha moshave, me mijëra tregime, vjersha, përralla, hartime, reportazhe, materiale nga gjuha e historia, tema nga shkenca mbi natyrën dhe shoqërinë si dhe pjesë teatrale, vizatimore, humor, folklor, për mësim dhe argëtim.

Bekim Laci, *A do “përndizet” sërish “Flaka e Vëllazërimet” në Maqedoni?!*, Tesheshi, <<http://tesheshi.com/a-do-perndizet-serish-flaka-e-vellazerimit-ne-maqedoni/>>, [12.4.2019]

<sup>340</sup> Instituti i Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve, “*Flaka e Vëllazërimet*”, abetare e dytë për shqiptarët, <<http://www.itsh.edu.mk/en/flaka-e-vellazerimit-abetare-e-dyte-per-shqiptaret/>>, [12.4.2019]

<sup>341</sup> Bekim Laci, *A do “përndizet” sërish “Flaka e Vëllazërimet” në Maqedoni?!*, Tesheshi, <<http://tesheshi.com/a-do-perndizet-serish-flaka-e-vellazerimit-ne-maqedoni/>>, [12.4.2019]

<sup>342</sup> Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Formimi, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit demokratik*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 284

<sup>343</sup> Ish botuesi i gazetës Fakti, Emin Azemi, në 20 vjetorin e gazetës e cilësonte atë si një projekt dritëdhënës në një nga periudhat më të rëndësishme të zhvillimit dhe emancipimit shqiptar në aspektin kombëtar, politik e kulturor. Megjithatë, Azemi ishte i pakënaqur që firma e re drejtuese e gazetës nuk ia doli mbanë financiarisht dhe ndërpreu botimin në një periudhë po aq të rëndësishme për emancipimin shqiptar dhe të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni. Emin Azemi, *Para 20 viteve u botua gazeta e parë e pavarur shqipe në Maqedoni*, BotaSot,

por problemet financiare ishin të vazhdueshme<sup>344</sup> deri sa çuan në shitjen e saj kompanisë Eurokoha<sup>345</sup> e cila gjithashtu pas një periudhe kohore e çoi gazetën në shuarje në vitin 2011.

Lulëzimi i ri i mediave të shkruara erdhi pas vitit 2001, në kohën kur perdja e frikës shtetërore dhe policore ndaj shqiptarëve filloi të bjerë dalëngadalë. Si investim nga Kosova, në vitin 2005 u soll marka e gazetës Lajm, fillimisht në filial dhe më pas edhe si gazetë. “Lajm” u soll nga biznesmeni Behxhet Pacolli dhe fillimet e saj i kishte në formatin *tabloid*. 2 vjet më vonë, në vitin 2007, gazeta u ble nga Fejzi Hajdari dhe stampimi i saj kaloi në format të vogël për të qenë më praktike për lexuesin.

Gazetë me ndikim gjatë konfliktit ishte edhe e përjavshmja “Lobi” e cila nisi si një projekt i Qendrës Multi-Kulturore në Shkup. Numri i parë i saj doli në shkurt të vitit 2001, në momentin kur opinioni publik sapo ishte vënë në dijeni të një lëvizjeje të armatosur që kishte filluar të vepronte në Maqedoni (UÇK-së). Siç vëren studiuesja e medias gjatë konfliktit, Aurora Ndrio, Lobi ishte akuzuar në mjediset mediatike dhe politike si një informative që lindi posaçërisht për konfliktin e vitit 2001.<sup>346</sup> Gazeta tuboi gazetarë si Iso Rusi (themelues), Kim Mehmeti, Seladin Xhezairi etj. Format i saj ishte *tabloid*.<sup>347</sup>

Investim nga Kosova ishte edhe gazeta Koha Ditore e cila u themelua në Shkup në vitin 2005. Por edhe kjo gazetë u shua shpejt.

Jetëgjatësia e bizneseve të huaja ishte e shkurtër; në të shumtën e rasteve për shkak edhe të mungesës së studimit të situatës së tregut në fushën e medias.

Viti 2006 do të sillte para lexuesit gazetën Koha. Numri i parë i kësaj gazete doli në qarkullim më 22 nëntor të vitit 2006, datë kjo që jo rastësisht përkon edhe me Ditën e Alfabetit shqip. Gazeta Koha hyri shpejt dhe me ndikim në tregun mediatik, dhe po ashtu fitoi primatin në shtypin ditor në gjuhën shqipe në Maqedoni. Duke afruar rreth vetes një staf gazetarësh dhe intelektualësh, diku 40 syresh, gazeta i dha një rëndësi të veçantë shtrirjes në terren me korrespondentë në thuajse të gjitha qytetet, filluar nga Kumanova e deri në Strugë, madje edhe në Manastir. Në vitin 2008, bordi drejtues i gazetës zgjeroi shtrirjen dhe ndikimin duke filluar me shpërndarjen falas të gazetës dhe depërtimin e saj edhe në vendbanimet rurale. Kjo strategji çoi në rritjen e tirazhit deri në 10 mijë kopje. Për të tretën herë me radhë, USAID-i dhe IRI e nxjerrin gazetën Koha si gazetën e parë më të besuar dhe më me influencë në krijimin e opinionit

---

<<https://www.botasot.info/maqedonia/869012/azemi-para-20-viteve-u-botua-gazeta-e-pare-e-pavarur-shqipe-ne-maqedoni/>>, [13.4.2019]

<sup>344</sup> Emin Azemi pranon në një shkrim të tij se për mbijetesën e gazetës kishte marrë mbështetje financiare nga kreu i PDSH-së por pa dhënë detaje për vitin e saktë.

Emin Azemi, *Fakti ka kushtuar 5 milion euro, Menduhu nuk t'i jep falë as 5 banka*, BotaSot, <<https://www.forumishqiptar.com/threads/97339-Urim-publik-p%C3%ABr-kryetar-in-e-BDI-s%C3%AB-mikun-tim-Ali-Ahmeti>>, [13.4.2019]

<sup>345</sup> EuroKoha ishte një kompani udhëtimesh ajrore nga Kosova me pronar Remzi Ejupin, gazetar dhe analist në Kosovë. Nën siglën e kompanisë EuroKoha, me 50% të aksioneve, gjendej edhe gazeta Zëri në Kosovë. Isuf Berisha, *Media integrity report: Media ownership and financing in Kosovo*, South East European Media Observatory, <<http://mediaobservatory.net/radar/media-integrity-report-media-ownership-and-financing-kosovo>>, [15.4.2019]

<sup>346</sup> Aurora Ndrio, *Viti 1, Media dhe Gjeopolitika e një konflikti etnik*, USHT, Tetovë 2014, faqja 99

<sup>347</sup> Studiuesja Ndrio vëren se gazeta Lobi raportonte në liri të plotë profesionale ndërsa gazeta Flaka pozicionohej si gazetë nën një presion të caktuar të shtetit dhe pamundësisë për të bërë një mbulim të gjerë dhe të plotë të aktualitetit. Nga ana tjetër, Fakti, pozicionohej në qendër duke mbajtur një qëndrim që lundron midis veprimtari si organ mediatik i pavarur dhe funksionimit si sipërmarrje private.

Aurora Ndrio, *Viti 1, Media dhe Gjeopolitika e një konflikti etnik*, USHT, Tetovë 2014, faqja 191

në Maqedoni.<sup>348</sup> Sipas të dhënave të Regjistrit Qendror, pronarë të saj janë Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi. Ajo është e regjistruar si kompani e vogël me emrin “Koha Production”. Të dhënat për vitin 2017 tregojnë se të ardhurat mesatare vjetore të saj janë 350 mijë euro ndërsa shpenzimet janë 340 mijë euro. Fitimi neto i saj i realizuar ishte 1655 euro. Firma numëron 12 të punësuar të paraqitur.<sup>349</sup>

Në hapësirën e shtypit shqiptar në Maqedoni kanë vepruar dhe vepron edhe periodikë, por ndër to vlen të theksohet revista Shenja, e përmuajshme mbarëkombëtare politike, ekonomike dhe kulturore. E shtrirë edhe në kryeqendrat e tjera shqiptare, Tiranë e Prishtinë, revista sjell një shumëllojshmëri temash, të shikuara nga prizmi shqiptar dhe kombëtar. Sipas të dhënave nga regjistri i Agjencisë së Mediave, revista Shenja doli në treg në 1 prill të vitit 2011 dhe botuese e saj është *Shoqata Qytetare Kulturore “Vizioni M” – Shkup*.

Një element që duhet theksuar është se të gjitha gazetatat në Maqedoni, kryesisht kanë qenë biznes i lindur nga vetë gazetarët, dhe kjo i bënte ato të cenueshme përballë tregut financiar.

\*\*\*

Në fushën e televizioneve, arena shqiptare u pasurua së pari me televizionin Toska në vitin 1992, i ndjekur nga TV Art në Tetovë në vitin 1993, si dhe TV Uskana, TV Gurra, TV 2 në Gostivar. Pas tyre, në Tetovë në vitin 1995 u hap edhe TV Koha. Duhet të theksohet se televizionet lokale private nuk kanë pasur ndikim të madh në jetën politike të shqiptarëve, por me modesti mund të thuhet, deri diku në atë kulturore. Në sinjalin e tyre për gati 10 vjet me radhë është transmetuar vetëm muzikë, humor, emisione me kërkesa muzikore dhe ndonjë reportazh i shkurtër nga jeta e përditshme në qytetet e tyre. Në raste sporadike këto televizione transmetonin edhe lajme, por kryesisht të huazuara nga televizionet e tjera të mëdha në Shkup ose nga programet e huaja si Zëri i Amerikës, Deutsche Welle etj. Format i tyre, me lajme dhe me emisione interaktive apo nga fusha të tjera u formësua vetëm në vitet e mëvonshme, kur ato u detyruan të përkufizonin licencat e tyre.

E njëjta situatë është edhe në rajonet e tjera me shqiptarë, si në Kumanovë me televizionet Hana dhe Festa, në Strugë me TV Kaltrinën, e gjetkë.

Ndër televizionet më me vëmendje në Shkup ishte televizioni i parë TV Toska e pastaj TV Era. TV Toska (1992) kishte të njëjtin format sikurse televizionet e tjera lokale, ndërsa TV Era (1994) kishte edicione të rregullta informative, por edhe modeste për shkak të kushteve të varfra me kuadrin e gazetarëve, teknikën televizive etj. Në vitin 1998, TV Era u bë një zë më i pavarur jo vetëm për shqiptarët e Maqedonisë por edhe në Kosovë, ku sinjali depërtonte në disa rajone, duke ofruar reportazhe nga lufta, kampet e strehimit, ndërhyrjet ushtarake e kështu me radhë. TV Era mban të njëjtën shtrirje si televizion rajonal, por jo edhe të njëjtin ndikim në sferën e medias në Maqedoni, për shkak të kalimit të pronësisë së saj nën një tjetër televizion, TV Shenjës. Sipas të dhënave të Regjistrit Qendror, TV Era është nën pronësinë e kompanisë Media World News, e cila përfaqësohet nga Muhamer Beqiri. Nga ana tjetër, Media World News është në pronësi të Fondacionit për Kulturë dhe Arsim “Kult-Vizioni”, ndërkohë që ky i fundit është në pronësi të personit fizik Taxhudin Shabani. Sipas të dhënave të Regjistrit Qendror, TV

<sup>348</sup> Shtegu, *Gazeta KOHA serish e para, Alsati kalon Shtetin*, <<http://shtegu.com/lajme/gazeta-koha-serish-e-para-alsati-i-afrohet-sitetit/>>, [15.4.2019]

<sup>349</sup> Të dhënat janë nxjerrë nga Regjistri Qendror i Maqedonisë së Veriut për qëllime studimore dhe janë të qasshme për informim të lirë.

Era ka punuar me humbje për vitin 2017. Të ardhurat e saj kanë qenë 230,5 mijë euro, shpenzimet kanë qenë 261 mijë euro ndërsa humbja e përlogaritur është afro 31 mijë euro. TV Era është e regjistruar si biznes i vogël dhe numëron 36 të punësuar të paraqitur.

Sferën mediatike në Maqedoni do e pushtonte Televizioni ALSAT-M, sinjali i të cilit në Shkup erdhi fillimisht në vitin 2004 përmes satelitit. Së pari u themelua televizioni mëmë ALSAT në Tiranë nga fondacioni “Velija” në vitin 2000, dhe në vitin 2003 mori licencë nga autoritetet shqiptare për transmetim satelitor. Që në këtë kohë, ALSAT hyri në shtëpitë e 10 milion shqiptarëve anëmbanë botës,<sup>350</sup> përfshi Maqedoninë, dhe menjëherë nisi zgjerimin e studiove në Shkup (deri atëherë funksiononte vetëm byroja e informimit për llogari të televizionit në Tiranë). Me program vendor dhe të rregullt, ALSAT-M në Shkup filloi në maj-qershor të vitit 2006. Ky televizion aplikoi për herë të parë në Maqedoninë e Veriut formulën e dygjuhësisë jo vetëm për të afuar shqiptarët mes tyre, me programe të gërshetuara nga Shqipëria e Kosova, por edhe për ta njohur dhe ndërgjegjësuar komunitetin tjetër maqedonas lidhur me kulturën, vlerat, traditën dhe elemente të tjera kombëtare të shqiptarëve. Pavarësisht se ëndrra e këtij televizioni ishte e madhe, për një trekëndësh informimi mes tre kryeqendrave Tiranë-Prishtinë-Shkup, vite më vonë biznesi pronësor u nda dhe ALSAT-M (sot ALSAT) mbeti i vetmi televizion me këtë emër, duke shuar zyrat mëmë në Tiranë.

Objektiviteti dhe profesionalizmi bënë që lajmet të bëheshin shtylla kryesore e informimit, ndërkohë që emisionet debatuese politike, ekonomike e shoqërore; ato nga fusha e shëndetit dhe muzikës; që të gjitha në dy gjuhë, bënë që Departamenti i Informacionit të mbante rolin kryesor jo vetëm në informim por edhe në ndërtimin e opinionit në shoqëri. Për vite me radhë, nën licencën kombëtare, ALSAT-M mban primatin si media më e suksesshme në Maqedoni dhe sondazhet tregojnë se këtij televizioni i besojnë 86% e shqiptarëve. Dhjetëra çmime të fituara nga organizata të huaja, vendore, ndërkohë që elementi i dygjuhësisë dhe iniciativa e ngritjes së urave të komunikimit nga ALSAT M, u përshëndet edhe nga Komisioni Evropian, i cili për herë të parë përmendte konkretisht një televizion në raportet e tij të Progresit.<sup>351</sup> Po ashtu, në anketat e IRI-t, ky televizion renditet i dyti për shikueshmëri në rang shtetëror, dhe me një besueshmëri të padiskutueshme.<sup>352</sup> Televizioni numëron rreth 170 të punësuar (përfshi një numër të madh të angazhuarish me kontrata autoriale) dhe me çmimin e vitit 2019 u shpall “*Medium-promotor në gazetari, si e mirë publike*”.<sup>353</sup> Sipas të dhënave nga Regjistri Qendror, ALSAT është në pronësi të VEVE Group i cili për vete është në pronësi të Zana Velijës dhe Imihane Velijës. VEVE Group përfaqësohet nga Ferik Velija ndërsa ka nën pronësi përveç ALSAT, edhe *Call Partner* dhe *MakWind Energy*. Të dhënat e vitit 2017 flasin se të ardhurat kanë qenë 2 milion e 575 mijë euro, shpenzimet kanë qenë 2 milion e 464 mijë euro, ndërsa fitimi neto ka qenë 95 mijë euro. Kompania është e regjistruar si biznes i mesëm dhe ka 110 punëtorë të paraqitur (për vitin 2017).

<sup>350</sup> Dokumentar në Youtube, Admir Qose, “10 vjet ALSAT”, nga minuta 8:54 deri në 9:55, <<https://www.youtube.com/watch?v=sN2EXHHj2eQ>>, [16.4.2019]

<sup>351</sup> Në vitin 2010, në raport shkruhej konkretisht: “*Vetëm një kanal televiziv (në gjuhën shqipe) transmeton programe dygjuhësore dhe kontribuon aktivisht në një mirëkuptim më të madh të përbashkët mes dy komuniteteve më të mëdha*”.

European Commission, *The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2010 Progress Report*, faqja 15, <[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2010/package/mk\\_rapport\\_2010\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2010/package/mk_rapport_2010_en.pdf)>, [16.4.2019]

<sup>352</sup> ALSAT, *IRI: ALSAT-M televizioni më i besueshëm në Maqedoni*, <<https://www.alsat-m.tv/256417/>>, [16.4.2019]

<sup>353</sup> ALSAT, *Alsats, fitues i çmimit “Roberto Belicanec”*, <<https://www.alsat-m.tv/https-www-alsat-m-tv-alsat-fitues-i-cmimit-vjetor-roberto-belicanec/>>, [16.4.2019]



TV Shenja lëshoi sinjalin eksperimental të saj në verën e vitit 2015 por transmetimet me formatin dhe programin e tij të rregullt ky televizion e filloi më 16 nëntor të vitit 2015. Shenja ofroi një format thujtë identik sikurse televizioni kombëtar ALSAT, me moton “*Pesë minuta më herët, pesë minuta më afër*”, duke sfiduar këtë televizion përfshi edhe për formatin *dygjuhësor*, shqip e maqedonisht.<sup>354</sup> Televizioni erdhi si investim i zgjeruar i revistës Shenja, duke marrë gjithashtu nën domen edhe televizionin ekzistues Era. TV Shenja është aktualisht një televizion me shtrirje shtetërore përmes kabllorëve, por në fund të vitit 2018, për shkak të financave, televizioni hoqi dorë nga formati në maqedonisht dhe shkurtoi stafin e tij. Sipas të dhënave nga Regjistri Qendror, TV Shenja ka pronësi të njëjtë me strukturën pronësore të televizionit Era, e shpjeguar më lart.<sup>355</sup> Të dhënat flasin se TV Shenja është e regjistruar si biznes i vogël dhe numri i punëtorëve të paraqitur është 42. Nga aspekti financiar, si në vitin 2016 ashtu edhe në vitin 2017, televizioni ka punuar me humbje. Duke iu referuar vetëm vitit 2017, të ardhurat vjetore kanë qenë 247 mijë euro, shpenzimet kanë qenë 291 mijë euro ndërkohë që humbja është shënuar afërsisht 44 mijë euro.

TV 21 ishte televizioni i radhës privat shqiptar që nisi transmetimet në Shkup, në vjeshtën e vitit 2015. Ky televizion hyri në tregun mediatik si një biznes me prejardhje nga Kosova, duke bartur emrin dhe logon e të njëjtit televizion me qendër në Kosovë, në pronësi të Afërdita Saraçinit. Motoja e televizionit “*përtej kufijve*” tregonte etjen për të testuar në Shkup suksesin e tij që kishte edhe në Kosovë. Transmetimi i parë me program të rregullt në Shkup mban datën e 21 shtatorit. Programi i këtij televizioni erdhi në 2 gjuhë; maqedonisht dhe shqip, si dhe me një gamë emisionesh të ndryshme informative e kulturore. Televizioni ka një licencë për transmetim në nivel shtetëror përmes rrjetit kabllor. Sipas të dhënave nga Regjistri Qendror, TV 21 është i emërtuar si “Company 21-M” e cila ka në pronësi edhe firmën “Square 21” që përfaqësohet nga Valon Saraçini dhe Petko Donevski. Për dy vite me radhë, 2016 dhe 2017, TV 21 ka punuar me humbje. Referuar të dhënave të fundit për vitin 2017, TV 21 ka pasur të ardhura prej afro 606 mijë eurosh, shpenzime prej afro 1 milion e 589 mijë eurosh, ndërsa humbja është përlllogaritur në 982 mijë euro. Sipas të dhënave në Regjistrin Qendror, TV 21 ka borxhe të pashlyera edhe ndaj Drejtorisë së të Ardhurave Publike ndërkohë që nga shifrat e nxjerra nga DAP-i, borxhi real është në shumën e 78 mijë eurove; 60 mijë prej të cilave janë kontribute shoqërore të papaguara ndaj punëtorëve dhe 18 mijë euro përbëjnë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH). I regjistruar si biznes i mesëm, TV 21 ka 69 punëtorë të paraqitur.

Në Maqedoninë e Veriut funksionon edhe televizioni tjetër Klan-Maqedoni, një markë që vjen nga Shqipëria. Klan-Maqedoni bleu TV Art-in e deridjeshëm që vepronte në Tetovë që prej vitit 1993. Ky televizion kishte fillimisht licencë rajonale, por në vitin 2015 mori licencë transmetimi në nivel shtetëror përmes rrjetit kabllor, sikurse edhe TV Shenja dhe TV 21. Në vitin 2018, TV Art u ble nga Klan-Maqedoni dhe i transferoi zyrat në Shkup. Transmetimet vazhdojnë të të njëjtit format. Televizioni Klan-Maqedoni ofron program vetëm në gjuhën shqipe, me lajme, emisione politike, ekonomike si dhe argëtuese. Duke qenë se televizioni është i ri nën pronësinë e TV Klan të Shqipërisë, ende nuk ka të dhëna vjetore financiare mbi të në Regjistrin Qendror.

<sup>354</sup> Portalb, *Maqedoni, zhvillime në tregun medial, kuadri i Alsat-M kalon në TV Shenja*, <<https://portalb.mk/216405-maqedoni-zhvillime-ne-tregun-medial-kuadri-i-alsat-m-kalon-ne-tv-shenja/>>, [17.4.2019]

<sup>355</sup> TV Shenja, dhe TV Era janë nën pronësinë e kompanisë Media World News, e cila përfaqësohet nga Muhamer Beqiri. Nga ana tjetër, Media World News është në pronësi të Fondacionit për Kulturë dhe Arsim “Kult-Vizioni”, ndërkohë që ky i fundit është në pronësi të personit fizik Taxhudin Shabani.

Pavarësisht shifrave jo të kënaqshme të shikueshmërisë mesatare të këtyre televizioneve, diku 1-1,5% të ndarjes totale të kohës së shikueshmërisë, të dhëna këto të nxjerra nga kompania e matjeve të shikueshmërisë GB Nielson, televizionet gjithsesi pasuruan jetën politike, kulturore por edhe vetë rrafshin mediatik në Maqedoni, veçanërisht atë shqiptar, duke ndihmuar që zhvillimet dhe proceset të ecin më shpejt, si dhe duke nxitur në një edukim dhe ndërgjegje më të lartë në popullatën shqiptare.

Shifrat e mëposhtme tregojnë të dhënat e shikueshmërisë në popullatën shqiptare vetëm në televizionet shqiptare aktive në Maqedoni.




FIGURA 5. NDARJA E SHIKUESHMËRISË TE POPULLATA SHQIPTARE<sup>356</sup>

Ndërkaq, në tabelën e mëposhtme shihen të dhënat në total të të gjithë popullatës së Maqedonisë, pa marrë parasysh se më shumë se 50% e saj sheh kanale të huaja përmes rrjeteve kabllore ose satelitore.

<sup>356</sup> Shifrat janë nxjerrë në bazë vjetore, ndërkohë që pas shkurtit të vitit 2018, të gjitha televizionet e tjera shqiptare hoqën dorë nga matja. Në matje mbeti vetëm ALSAT.




FIGURA 6. NDARJA E SHIKUESHMËRISË TE E GJITHË POPULLATA<sup>357</sup>

Duhet sqaruar edhe koncepti “*other*” që nënkupton përqindjen e popullatës e cila shikon televizione të huaja falë sistemeve kablore dhe satelitore. Shifra e popullatës shqiptare që shikon media të huaja (kryesisht nga Shqipëria e Kosova) është shumë e lartë 46,4% (fig.1) ndërsa në total, gjithë popullata e Maqedonisë sheh kryesisht 36,3%. Kjo tregon se popullata shqiptare ka më shumë zgjedhje dhe informim përmes rrjeteve kablore, ndonjëherë edhe të palegalizuara, apo aparateve android për të parë filma sipas kërkesës (*on demand*) ose gara sportive.

Ndërkaq, në hapësirën e transmetimeve në Maqedoni ka një numër të konsiderueshëm edhe të televizioneve lokale. Për sa i përket popullatës shqiptare dhe mediave lokale në shqip mund të veçojmë dhjetëra televizione sikurse TV Koha, TV Kaltrina, TV Uskana, TV Gurra, TV 2, TV Festa, TV Zëri i Kumanovës, Tv Zëri i Çeganit etj.

Nuk duhet të harrohet edhe tregu radiofonik në të cilin vepron Radio-Shkupi në gjuhën shqipe, si pjesë e transmetuesit publik RTN (Radio-Televizionit Nacional të Maqedonisë së Veriut). Ashtu sikurse u përmend më sipër, Radio-Shkupi filloi transmetimet më 28 janar 1945, edhe pse transmetimet e saj fillestare ishin vetëm nga 15 minuta. Pavarësisht presionit dhe propagandës së kohës, radioja u bë një faktor edukimi dhe ngritjeje kulturore për shqiptarët, por edhe një faktor për ruajtjen e ndjenjës kombëtare. Radio-Shkupi transmeton sot *17 orë program në gjuhën shqipe*, me emisione të ndryshme që nga lajmet, emisionet kulturore dhe ato argëtuese. 7 orët e tjera janë dedikuar për komunitetet e tjera, 5 orë për komunitetin turk dhe nga gjysmë ore për komunitetet akoma më të vogla, serbët, boshnjakët, romët dhe vllahët. Sikurse shërbimi televiziv në shqip (TVM2) që pritet të bëhet me program 24-orësh në shqip, ashtu pritet të ndryshojë format edhe Radio-Shkupi.

<sup>357</sup> Në interpretimin e grafikut duhet marrë parasysh edhe fakti se një numër i konsiderueshëm i popullatës maqedonase ndjek mediat shqiptare ashtu sikurse një numër i konsiderueshëm i popullatës shqiptare ndjek televizionet maqedonase.

Ndërkaq, në tregun radiofonik, radio të tjera shqiptare janë edhe Radio-Haraçina (e vendosur nën domenin e TV Shenja), Radio-Vati, Radio-Life etj., por pa ndikim të veçantë. Këto radio transmetojnë vetëm muzikë por edhe lajme të shkurta si dhe emisione interaktive me qytetarët.

Në *luftën* e komuniteteve të tjera për media duhet të theksojmë së pari se Maqedonia e Veriut është oazë popujsh, gjuhësh dhe kulturash ndërkohë që të pasurit mjet informimi (sidomos televizion) është luks i madh (riktheju të dhënave mbi fitimet neto vjetore që kanë televizionet). Përçindjen më të madhe të popullsisë së Maqedonisë, pas shqiptarëve, e përbëjnë turqit. Nga ana tjetër, lidhjet fetare, kulturore e shpirtërore me Turqinë nga sundimi 500-vjeçar i trojeve të Ballkanit kanë lënë gjurmë të thellë. Komuniteti turk renditet i dyti për nga madhësia në Maqedoninë e Veriut, edhe pse shifrat tregojnë se ky komunitet është gati 10 herë më i vogël se ai i shqiptarëve, duke u bazuar në rezultatet e regjistrimit të fundit të vitit 2002. Maqedonasit numëroheshin 1 130 000, shqiptarët 509 000, ndërsa turqit gati 78 000. Pas tyre vinin romët me gati 54 000, serbët me 36 000, boshnjakët 17 000, vllehtë afërisht 10 000 etj.<sup>358</sup> Kështu, kur flasim për median turke në Maqedoni, duhet të kujtojmë së pari se ky komunitet ka pasur gazetën e tij, madje më herët se shqiptarët. Gazeta “Birlik” doli në qarkullim më 24 dhjetor të vitit 1944, vetëm 2 muaj pas hapjes së gazetës së parë maqedonase “Nova Makedonija”, dhe gati 4 muaj para se shqiptarët të kishin gazetën e tyre “Flaka e Vëllazërimit”. “Birlik”, në kohën e Titos, u referohej edhe turqve të Kosovës. Ajo vazhdoi aktivitetin e saj deri në vitin 2003. Nga ana tjetër, në vitin 1994, turqit u përfaqësuan me gazetën “Vardar” dhe “Zaman”. Sa u përket radiove, gjallëri në kulturën e turqve të Maqedonisë ofruan radiot Rumeli FM (Gostivar), Super FM (Shkup), Radio-Turka në Vrapçisht, “Dost FM” në Shtip etj., por të gjitha këto radio u mbyllën për shkaqe financiare.<sup>359</sup> Tani, komuniteti turk mjaftohet për momentin me transmetimet radiofonike prej 5 orësh në Radio-Shkupi, si dhe transmetimet televizive prej 2,5 orësh në ditë<sup>360</sup> në TVM2.

Komunitetet e tjera më të vogla përfaqësohen gjithashtu nëpërmjet shërbimit publik, me orë të caktuara të destinuar për to, sikurse parashikohet me ligj.<sup>361</sup>

### 5.1.3 Media e Maqedonisë pas konfliktit të vitit 2001

Shtypja e të drejtave dhe aspiratave të shqiptarëve, të ndrydhura që nga regjimi komunist, vazhdoi me të njëjtën tendencë në Maqedoninë e Veriut edhe pas ndarjes nga RSFJ-ja. Madje, shumë studiues thonë se me pavarësinë e Maqedonisë dhe me kushtetutën e re, shqiptarët humbën edhe ato të drejta që i gëzonin nga kushtetuta e vitit 1974.

Klasa e re (e vjetër) politike e Maqedonisë u siguroi që shqiptarët të mos merrnin shtrirje në të drejtat e tyre politike dhe kombëtare (duke marrë mësim nga Serbia lidhur me rastin me

<sup>358</sup> Zyra e Statistikave Shtetërore, *Regjistrimi i popullsisë, amvisërive dhe banesave në Republikën e Maqedonisë 2002*, faqja 34, <[http://www.stat.gov.mk/pdf/kniga\\_13.pdf](http://www.stat.gov.mk/pdf/kniga_13.pdf)>, [17.4.2019]

<sup>359</sup> Alban Tartari, *Mediat Turkofone në Ballkan*, Studim doktrate, Universiteti i Tiranës, Tiranë 2015, <[http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2017/04/Doktoratura\\_Alban-Tartari\\_-Punimi-Final-1.pdf](http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2017/04/Doktoratura_Alban-Tartari_-Punimi-Final-1.pdf)>, [17.4.2019]

<sup>360</sup> Transmetimi në turqisht i Radio-Shkupit në RSFJ kishte filluar në vitin 1945.

<sup>361</sup> Sipas të dhënave, në TVM2 orari i transmetimit të komuniteteve është nga 14:30 deri në 18:00. Një herë në dy ditë, serbët dhe boshnjakët shfrytëzojnë nga 30 minuta transmetim, ndërsa po ashtu, një herë në dy ditë nga 30 minuta, transmetimet i shfrytëzojnë dy komunitetet e tjera, romë dhe vllehtë. Çdo ditë, nga ora 15:30-18:00 transmetimet i kushtohen komunitetit turk.

Kosovën) pasi e dinin shumë mirë se vetë jeta politike dhe proceset në Maqedoni do të vareshin prej shqiptarëve.

Kushtetuta e vitit 1991, sikurse u theksua më sipër, i la shqiptarët me *statusin e nacionalitetit* (që nuk i eliminonte suazat e nënçmimit), pavarësisht se përqindja e tyre i bënte ata faktor *shtet-formues* të pazëvendësueshëm. Mosnjohja e këtij elementi, mos njohja e të drejtës së gjuhës, ajo e arsimimit shqip në nivel universitar, mosnjohja e përdorimit të simboleve që janë thelbësore në identitetin e njeriut dhe kombit, si dhe shkelje të tjera, u mohonin shqiptarëve të drejtën si qytetarë të barabartë të të njëjtit vend.

Me këtë mënyrë, po aq e ngjashme sikurse ajo që serbët përdornin në vitet '90 gjatë ndarjes së ish RSFJ-së apo ndaj shqiptarëve të Kosovës (1998-99), Maqedonia vetë i dha një grusht të fortë bashkëjetesës, pa të cilën, sipas studiuesit Etem Aziri, as që mund të mendohej ekzistimi i shtetit të Maqedonisë. Sovraniteti mbetej *ekskluzivisht* vetëm i popullit maqedonas, dhe si i tillë, nuk kishte hamendje që gjuhë zyrtare do të ishte vetëm maqedonishtja dhe shkrimi i saj cirilik.<sup>362</sup>

Mjafton të marrësh një element për referencë për të kuptuar qëllimet që fshiheshin pas kushtetutës së vitit 1991; *gjuhën*. Duke refuzuar gjuhën, shteti maqedonas refuzonte shtetësitë e mijëra shqiptarëve që nuk e flisnin maqedonishten (për shkak të arsimimit jo adekuat), por nga ana tjetër, refuzimi i gjuhës në universitete (shqiptarët kishin pak mundësi arsimimi deri në shkollat e mesme) i bënte ata sërish të cenueshëm për të ushtruar të drejtën për arsimim. Kjo politikë i linte shqiptarët në Maqedoni si qytetarë të dorës së dytë, edhe pse, opsionet për ndjekje studimesh në Shqipëri e Kosovë u mundësonin atyre shkollimin e kuadrove që do të ndikonin më pas në kultivimin e identitetit shqiptar në Maqedoni. Pavarësisht se këto mund të duken në shikim të parë si teori konspiracioni, mbivendosje e klasës politike maqedonase konsiderohej edhe fakti tjetër se nxënësit maqedonas nuk ishin të detyruar të studionin shqip sikurse shqiptarët maqedonishten.

Është e domosdoshme të ritheksohet se të drejtat e shqiptarëve në vitin 1991 ishin më të cinguar krahasuar me kushtetutën e vitit 1974 ku ata manifestonin të gjitha të drejtat sikurse edhe republikat e tjera përbërëse të ish RSFJ-së, kishin të drejta të formimit të institucioneve pedagogjike dhe mësimi në gjuhën e tyre amtare, atë të përdorimit të shqipes përfshi edhe në tabelat dygjuhëshe etj.<sup>363</sup>

\*\*\*

Represioni i shtetit maqedonas i cili u shtua pas çdo forme proteste dhe shprehje revolte nga ana e komunitetit shqiptar, por edhe pas çdo bojkoti politik të proceseve nga partitë shqiptare, e ashpërsonte akoma më shumë *qasjen e shqiptarëve te shteti* dhe anasjelltas. Refuzimi i deklaratës së PPD-PDP për barazi të shqiptarëve, refuzimi i kërkesave të shqiptarëve gjatë regjistrimit të popullsisë, ato për ndryshime në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm,

<sup>362</sup> Kuvendi i Maqedonisë së Veriut, *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë 1991*, <<https://www.sobranie.mk/kushtetuta-e-rm-s.nsp>>, [18.4.2019]

<sup>363</sup> Problematika e përdorimit të gjuhës në emërtime nuk gjeti zgjidhje as pas Marrëveshjes së Ohrit, edhe pse u theksua se ajo ishte e detyrueshme për të gjitha rajonet ku flitet nga 20% e popullatës përkatëse. Në një cikël investigimesh gazetareske, televizioni ALSAT denoncoi me vite mospërdorimin adekuat të shqipes në tabela, në autobusë etj., ndërkohë që edhe në ato raste ku përdorej, përveç gabimeve përçudnuese të shqipes pasonte edhe fenomeni i shkarravitjeve të tyre për shkak të urrejtjes ndëretnike.

moskonstituimi i kuvendeve të komunave të Tetovës dhe Gostivarit,<sup>364</sup> testuan edhe klasën politike shqiptare - nëse do të mbante anën e popullit të saj apo do të binte nën presionin e pushtetit dhe joshjes së kolltukut.

Protestat masive 4-ditore në Strugë për hapje të paraleleve shqipe<sup>365</sup> të cilat përfshinë edhe Kërçovën përbënë rastin e parë të zinxhirit të ngjarjeve të tensionuara mes shqiptarëve dhe maqedonasve. Vazhduan rastet e dhunës policore në Dibër, në Luboten, në Kumanovë, operacionet policore në Ladorishtë për armë pa leje, në Bit Pazarit për gjoja ndërprerjen e tregtisë së paligjshme,<sup>366</sup> afëra e armëve e vitit 1993, aksioni policor në Reçicë të Vogël, objekti i bashkësisë lokale të së cilës ishte përgatitur për mbajtjen e mësimit në kuadër të Universitetit të Tetovës (14 dhjetor 1994) etj.... Protestat dhe dhuna e mbuluan këtë ngjarje ndërkohë që universiteti u quajt nga ministri i Brendshëm i asaj kohe Lubomir Fërçkovski si “*foshnjë që ka lindur e vdekur*”<sup>367</sup>.

Regjistroheshin me qindra raste të dhunës policore, sidomos ato ku shqiptarët jo vetëm keqtrajtoheshin por edhe vdisnin në dhomat e hetuesisë, si mësuesi Arif Seferi nga Kumanova (1992) apo Halil Latifi nga Gërçeci (1993) se gjoja pësoi infarkt gjatë marrjes në pyetje nga policia... Të gjitha këto akte nxitnin herë pas here valë të madha protestash nga ana e popullit shqiptar dhe gjithnjë e më shumë gëzonin mbështetjen e rinisë.

Rast po aq i rëndë ishte ai i Gostivarit, për shkak të heqjes së flamurit shqiptar nga forcat speciale (edhe pse një ditë më herët ishte miratuar ligji për përdorim të kufizuar të simboleve kombëtare). Përveç dhunës, dënime drastike u caktuan për ish kreun e Komunës së Gostivarit Rufi Osmani<sup>368</sup> dhe kreun e Këshillit Komunal Refik Dauti, si dhe për kreun e komunës së Tetovës Alajdin Demiri e kreun e Këshillit Komunal, Vebi Bexheti.

Autoritetet maqedonase synonin jo vetëm shtypjen e shqiptarëve në mënyrë që të mos kërkonin të drejta, por nga ana tjetër, të binin në sy para ndërkombëtarëve se gjoja vendi rrezikohej nga konflikti i brendshëm andaj duhej të njihej sa më shpejt si shtet i pavarur.

Teoritë më të zakonshme të rasteve të montuara nga policia maqedonase kundër shqiptarëve ishin; *arsenal armësh për destabilizim ose luftë, tregti me armë nga Shqipëria, komprometim i shtetit, shkelje e kushtetutës, nacionalizëm shqiptar, formime njësitësh ushtarake për mbrojtjen e Iliridës, aferë për “Shqipërinë e Madhe”, formime formacionesh ushtarake që kërcënojnë rendin kushtetues, bashkëpunim kriminal me qëllim grusht shteti* etj.

<sup>364</sup> Po aty, faqja 156

<sup>365</sup> Ngjarjet në Strugë ndodhën në muajin shtator të vitit 1991.

Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Formimi, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit demokratik*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 141

<sup>366</sup> Rasti i Bit Pazarit ndodhi më 6 nëntor të vitit 1992 dhe nga përdorimi i armëve drejtpërdrejt ndaj qytetarëve, 4 shqiptarë vdiqën ndërsa u plagosën 23 të tjerë. Ministri i Brendshëm Fërçkovski deklaroi fillimisht se policia nuk i kaloi kompetencat, ndërsa më vonë, nga presioni i opinionit vendor dhe ndërkombëtar, shpiku teorinë se shqiptarët e kishin nxitur incidentin, dhe madje ditë më parë kishin sjellë zhavorr, goma dhe lëndë djegëse në afërsi të Bit Pazarit për të shkaktuar përplasje të qëllimshme dhe incident më të madh. Për rastin e Bit Pazarit u ngrit edhe Komisioni Hetues Parlamentar i kryesuar nga Ismet Ramadani, por rasti nuk gjeti zgjidhje kurrë.

Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Formimi, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit demokratik*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 175

<sup>367</sup> Po aty, faqja 188

<sup>368</sup> Për ngjarjet e Gostivarit, studiuesi Etem Aziri thekson se Komisioni Hetimor Parlamentar i kryesuar nga deputeti i asaj kohe Mersel Bilalli tregoi “*tejkalime të kompetencave nga policia por edhe nga individë*”, por megjithatë nuk ofroi asnjë zgjidhje dhe asgjë të re. Madje, Aziri e quan raportin përfundimtar të Komisionit, si një *hartim me shkrim i nxënësve të dobët*.

Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Formimi, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit demokratik*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 201

Një ecuri e tillë e ngjarjeve, ndërkohë që vendi kishte lënë regjimin socialist për të hyrë në shekullin e ri të ndryshimeve të mëdha, solli edhe në konfliktin e vitit 2001.

Përpyekjet politike të shqiptarëve që nuk dhanë sukseset e pritura, rezultuan me mobilizimin e disa forcave ushtarake shqiptare, të cilat u organizuan nën emblemën e të ashtuquajturës “Ushtria Çlirimtare Kombëtare” dhe filluan përballjet me forcat ushtarake policore maqedonase.

Vrasja e të riut Muzafer Xhaferi më 16 shkurt të vitit 2001 konsiderohet si data e fillimit të konfliktit të armatosur.<sup>369</sup> Ai cilësohet si dëshmori i parë i konfliktit të vitit 2001.

Nëse përshkruhen shkaqet dhe interesat e këtij konflikti, apo edhe ato çfarë humbi Maqedonia nga konflikti, është më se e qartë se janë të gjitha ato që u përmendën më sipër. Shqiptarët kërkonin kategorikisht *çlirimin nga shtypja maqedonase që iu mohonte atyre barazinë në këtë shtet që e konsiderojnë atdheun e tyre, ndërsa maqedonasit kërkonin që parlamenti të reagonte më fuqishëm, të shpallte vis a vis gjendje lufte dhe ushtria të merrte në dorë situatën për shtypjen e shqiptarëve, duke mos e lënë konfliktin vetëm në dorën e policisë (edhe pse në realitet, ushtria ishte gjithashtu e përfshirë në aksionet për shtypjen e luftëtarëve shqiptarë të UÇK-së).*

\*\*\*

Kështu, ky polarizim në dy kampe luftarake ARM-UÇK dhe popullatë maqedonase – popullatë shqiptare nuk kishte si të mos ndihej në median e asaj kohe. Media e shtypur dhe ajo elektronike, të reja në pavarësinë e tyre si pushtet i katërt, në fakt ranë nën propagandën shtetërore. Media maqedonase e bartte të gatshme frymën se *grupet e armatosura të shqiptarëve ishin terroriste*, ndërsa për shqiptarët ata ishin *luftëtarë të lirisë*. Kjo situatë vinte në rrezik më të madh gazetaret shqiptarë që ndonjëherë ishin pre jo vetëm e konfliktit, e nënçmimit nga institucionet e shtetit për të siguruar informata, por edhe pre e politikës shqiptare, forcave që gjendeshin në pushtet gjatë konfliktit. Por, për këto pjesë do të hedhim më shumë dritë më poshtë, me zberthimin e rasteve konkrete të raportimit gjatë konfliktit të vitit 2001.

### 5.1.3.1 Raste të raportimit etnik gjatë konfliktit

Konflikti i vitit 2001 nuk i zgjidhi problemet por la dy të vërteta të ndryshme në opinion, atë maqedonase dhe atë shqiptare. Megjithatë, gati dy dekada nga ai konflikt, gabimet e kohës u pranuan nga një pjesë e madhe e klasës së atëhershme politike dhe vetë opinionit maqedonas. Dhe ishte prapë media ajo që e demaskoi ish ministrin e Brendshëm Lubomir Fërçkovski i cili pranoi në televizionin ALSAT se ndaj shqiptarëve ka bërë gabime<sup>370</sup> ndërsa ish udhëheqësi i “Branitellave” (Forcave Mbrojtëse) të Maqedonisë Stojanço Angellov (po ashtu për ALSAT) merrte përsipër fajin e trajtimit politik dhe ushtarak të shqiptarëve, duke thyer akujt dhe duke shkuar për herë të parë në vizitë të varrezat e familjes së Abedin Zimberit, ish komandant i policisë ushtarake të UÇK-së.<sup>371</sup>

<sup>369</sup> Minir Ademi, *Dëshmorët e kombit (UÇK 2001)*, Shoqata e Historianëve Shqiptarë, Shkup, 2010

<sup>370</sup> Nazim Rashidi, *Programi 200: "Burgosësi" dhe "i burgosuri" ballë përballë për Maqedoninë e të ardhmes!* [02.03.2019], <[https://www.youtube.com/watch?v=cs-AZ\\_35Ukc](https://www.youtube.com/watch?v=cs-AZ_35Ukc)>, [20.4.2019]

<sup>371</sup> Nazim Rashidi, *Programi 200: Zymberi dhe Angellov - Dikur përballë në luftë, tani në ballë për paqe!*, <<https://www.youtube.com/watch?v=m7NUIK2Bg1c&t=13s>>, [20.4.2019]

- Media maqedonase, para, gjatë por edhe pas konfliktit të vitit 2001, shërbeu si mashë e zgjatur e represionit politik të klasës maqedonase, ndërsa ato shqiptare, nën presionin e partive shqiptare në pushtet. Për mediat maqedonase, konflikti konceptohej si pretekst për realizimin e *Shqipërisë së Madhe, federalizimin e Maqedonisë* (sidomos kur u kundërshtua vendosja e kufirit me Kosovën nga Cërvenkovski e Koshtunica), ose përmes kërkesave të shqiptarëve që minimizonin të drejtën e maqedonasve si shumicë dhe si pronarë të shtetit. Po ashtu, kritika të ashpra iu adresoheshin edhe partive shqiptare, që nxisnin në hije këtë nacionalizëm, nën *pretendimin* se luftohej për të drejtat dhe liritë që shqiptarët i kishin fituar më herët që në kushtetutën e vitit 1974. Madje kishte qëndrime më mbytëse se gjoja klasa maqedonase kishte bërë shumë gabim që *u kishte lejuar pakicave të krijonin edhe parti politike*.<sup>372</sup> Kriza në Kosovë ishte një arsye më shumë se gjoja Maqedonia po *dyndej nga kriminelët, terroristët, mercenarët islamikë* etj.

- Për median në gjuhën shqipe vlente mjaftueshëm *diskriminimi ndaj shqiptarëve* në të gjitha sferat e jetës shoqërore, mospërfaqësimi dhe përbuzja në institucionet e shtetit (sidomos në strukturat e sigurimit), ajo e *mohimit të arsimimit në shqip* (në Strugë në 1991 u protestua për 4 ditë me radhë për rihapjen e paraleleve në gjuhën shqipe), ajo e ndalimit të *përdorimit të gjuhës amtare* (mësuesit shqiptarë detyroheshin të flisnin maqedonisht me nxënësit shqiptarë), *represioni* i vazhdueshëm dhe gjithnjë e më i ashpër policor, *dështimi i përfaqësuesve politikë shqiptarë në institucionalizimin e kërkesave të popullatës shqiptare* etj.

Në raportimet e medias së asaj kohe, përplasja e penës ishte po aq e ashpër sa ajo e pushkëve në prita mes ARM-së dhe UÇK-së. Në gazetën “Nova Makedonija”, lajmi, toni, përzgjedhja e fjalëve, propaganda, urrejtja etj., bien lehtë në sy.

*Vazhdojnë të shtënat në rajonin e Likovës edhe gjatë ditës e natës së kaluar*  
**Terroristët janë rrethuar, por prapë nuk dorëzohen**

*1 korrik 2001 (Nova Makedonija)*

*Boris Bugnazovski, Igor Panov: Grupet terroriste-diversante shqiptare në Likovë dhe Karadak, pavarësisht se të shpartalluar dhe të paktë në numër, edhe gjatë ditës së djeshme sulmuan pozicionet ushtarake të Forcave të Sigurisë Maqedonase në fshatin Mateç. Në orën 13:45 minuta, nga Manastiri “Shën-Bogorodica”, terroristët shqiptarë sulmuan pozicionet e ushtrisë në Mateç me minahedhëse dore dhe të shtëna mitralozash.*

*Për 1 orë, terroristët shqiptarë kryen sulme me të shtëna edhe në drejtim të fshatit Hotël, ndaj të cilave forcat maqedonase të sigurisë u kundërpërgjigjën me zjarr artilerie të rëndë.*

*Në orët e pasdites, terroristët i vunë zjarrin edhe pyllit në fshatin Vaksincë, në afërsi të pikës së karburantit të Makpetrolit, me qëllim që të dëmtonin depon e karburantit të Makpetrolit - deklaroi koloneli Bllagoja Markovski, zëdhënës i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së Maqedonisë. Megjithatë, siç na informuan burimet nga Armata e Maqedonisë, gjatë sulmit të parë të terroristëve shqiptarë ndaj forcave policore në Mateç u lëndua një pjesëtar i policisë maqedonase.*

*Sulme të reja të terroristëve shqiptarë*

***Në Vaksincë vriten 2 ushtarë, një kapet rob***

<sup>372</sup> Deklarata të tilla bëheshin nga deputetët maqedonas, sikurse Vlladimir Gollubovski në vitin 1993, nga foltorja e kuvendit.

Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Formimi, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit demokratik*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 171



4 maj 2001

Dy pjesëtarë të Forcave Maqedonase të Sigurisë janë vrarë dhe një tjetër është kapur rob gjatë sulmit të djeshëm të terroristëve shqiptarë ndaj një patrulle të Armatës së Maqedonisë në afërsi të fshatit Vaksincë. Gjatë vëzhgimit të rregullt të terrenit, patrulla kufitare e Armatës së Maqedonisë dje herët në mëngjes u gjet në pritën e terroristëve, rast në të cilën humbën jetën pjesëtarët e Brigadës së Parë të Këmbësorisë, Dimitar Dvojakovski (29 vjeçar nga Shtipi) dhe Vlatko Petrov (24 vjeçar nga Çardaklija e Shtipit) ndërsa ushtari Goran Mitrovski nga Pehçeva u kap rob.

Sipas informatave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, terroristët po mbajnë peng edhe dy civilë që ishin rrëmbyer një natë më parë në fshatin Mateç... Me qëllim që popullata e fshatit Vaksincë të mos keqpërdoret dhe të mos shfrytëzohet si mburojë njerëzore, ministria e Brendshme dhe ajo e Mbrojtjes bënë apel për evakuimin e saj.

Ndërkohë, terroristëve të infiltruar në rajonin e fshatrave Vaksicë dhe Sllupçanë u është dhënë urdhër që deri në orën 15:00 të lënë armët dhe të vetëdorëzohen... Gjendja aktuale e sigurisë në shtet do të jetë pika e vetme e rendit të ditës në mbledhjen e sotme të jashtëzakonshme të kuvendit, në të cilën do të mbajë fjalim kryeministri Lubço Georgievski ku pritet që të japë një pasqyrë të gjerë lidhur me aksionet terroriste në vendin tonë. Deputetët duhet të miratojnë edhe deklaratën që do t'i dërgohet OKB-së me qëllim që "UÇK-ja" të vendoset në listën e organizatave terroriste. Ministria e Punëve të Brendshme mori vendim për kufizimin e lëvizjes së qytetarëve në komunat Kumanovë dhe Likovë, nga ora 22:00 deri në 5:00 të mëngjesit. (A.M.M)

Sfida të vështira për koalicionin e madh

**Xhaferrri dhe Imeri nënshkruan dokument për tradhtinë e Maqedonisë**

24 maj 2001<sup>373</sup>

Nga burime të besueshme por si duket të sigurta, Agjencia Informative Maqedonase (MIA) transmeton se dje në afërsi të Prishtinës, liderët e partive politike shqiptare në Maqedoni, PDSH dhe PPD, Arbën Xhaferrri dhe Imer Imeri, si dhe lideri i vetëshpallur i të ashtuquajturës UÇK, Ali Ahmeti, nënshkruan një dokument me të cilin obligohen për bashkëpunim dhe "aksion të përbashkët". Sipas diplomatëve të huaj, të cilët ishin në dijeni të nënshkrimit të këtij dokumenti, dy liderët e partive politike shqiptare dhe Ali Ahmeti, me këtë dokument obligohen për bashkëpunim dhe një farë aktiviteti të përbashkët për mbrojtjen e terroristëve, dhe në thelb, ideologjinë dhe politikën e tyre për kauzën e madhe shqiptare. Burimet e besueshme të MIA-s thonë se me këtë hap nuk janë vënë në dijeni as Presidenti i Republikës së Maqedonisë Boris Trajkovski dhe as kryetari i Qeverisë Lubço Georgievski. Siç thekson MIA, Xhaferrri dhe Imeri ditëve të fundit kanë qenë të zëshëm në shprehjen e gatishmërisë dhe lojalitetit të tyre që kriza politike dhe e sigurisë në Republikën e Maqedonisë të zgjidhet në kuadër të rekomandimeve të Bashkësisë Evropiane dhe asaj ndërkombëtare.

Pas shpalljes së këtij lajmi, i cili flet për tradhti anti-maqedonase nga ana e liderëve të dy partive shqiptare në Maqedoni, PPD dhe PDSH, siç mësojmë jo zyrtarisht, dje qeveria me kërkesë të kryeministrit Lubço Georgievski ka mbajtur një mbledhje urgjente të krerëve të shtetit.

<sup>373</sup> Ky lajm i referohet Marrëveshjes së Prizrenit mes Ali Ahmetit, Arbër Xhaferrit dhe Imer Imerit, më 22 maj të vitit 2001. Kronikanët e kohës flasin se kjo marrëveshje erdhi vetëm disa ditë pasi Maqedonia (Ilinka Mitreva, si ministre e Jashtme) e shpalli person non-gratta ambasadorin e OSBE-së në atë kohë, Robert Frowick i cili kishte kërkuar të merrte pjesë në *lehtësimin* e bisedimeve me UÇK-në. Ndërkaq, studiuesi Etem Aziri thekson se kjo marrëveshje bëri të qartë se UÇK-ja nuk ishte organizatë terroriste, por përkundrazi, një ushtri që kishte si pikësynim kryesor, përparimin e statusit kombëtar të shqiptarëve si dhe demokratizimin e Maqedonisë.

(Për më shumë nga kjo marrëveshje, lexo:

Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Formimi, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit demokratik*, SEEU, Tetovë 2012, faqja 206)

Siç shihet në shkrimet e gazetës “Nova Makedonija”, shqiptarët ishin *terroristë* - klasa politike shqiptare bënte *tradhti*, ndërsa ushtria ishte *në hall* – ajo veç *ndihmonte banorët në evakuim*; shteti kërkonte *shpëtim* nga komuniteti ndërkombëtar për njohjen e pavarësisë (qëllime këto të notuara më parë). Për gazetën “Nova Makedonija” nuk kishte rëndësi ana tjetër e medaljes se granatimet e ushtrisë shkatërronin *qindra shtëpi, xhami, rrugë, ura, e mbi të gjitha shkaktonin edhe viktima civile*.

Le t’i hedhim tani një sy gazetës shqiptare “Fakti”, për të parë formën e lajmit, tonet dhe përzgjedhjen e fjalëve mbi ngjarjet e vitit 2001.

*Fakti në mesin e luftëtarëve të Tanushës*

***Bilanci i luftimeve të pardjeshme, tre ushtarë të vrarë të Maqedonisë***

*Motivi i incidentit të fundit është dhuna sistematike që ushtron ushtria dhe policia maqedonase ndaj popullatës civile – Ushtria Çlirimtare Kombëtare është e pakënaqur nga loja e serbëve dhe maqedonasve të cilët me marrëveshjen e fundit për caktimin e kufirit kanë zhvendosur vijën kufitare 5 kilometra në thellësi të Kosovës.*

*E mërkurë, 28 shkurt 2001*

*Bilanci i luftimeve të ditës së diel në Tanushë është tre ushtarë maqedonas të vrarë ndërsa është plagosur lehtë një ushtar i UÇK-së (Ushtria Çlirimtare Kombëtare), thonë burime brenda UÇK-së. Dje, ekipi i Fakti-t arriti të depërtojë në afërsi të vendit ku ishin zhvilluar luftimet. Atje takuam një komandant të lartë të UÇK-së i cili për gazetën tonë rrëfeu rrethanat e këtij operacioni luftarak. Sipas bashkëbiseduesit tonë, incidenti i pardjeshëm ka qenë i provokuar nga pala maqedonase e cila në orët e pasdites, e pajisur me armatim të rëndë dhe me një numër të madh ushtarësh, kishte mësyre drejt marrjes së fshatit Tanushë. Me këtë rast, ushtarët maqedonas kanë dëmtuar katër shtëpi të banorëve të këtij fshati, siç janë shtëpia e Sefer Xhaferit, Bejtush Xhaferit, Sami Arifit dhe Zenun Arifit të cilat janë shkatërruar tërësisht. Këtij provokimi, Ushtria Çlirimtare Kombëtare i është përgjigjur me kundërsulm, ku sipas komandantit të lartë të UÇK-së, la të vrarë 3 ushtarë maqedonas dhe disa të tjerë të plagosur. Me ndihmën e një autoblinde, ushtria maqedonase kishte arritur të tërhiqte viktimat në anën e saj dhe pastaj kishte braktisur fshatin. Sipas UÇK-së, tani fshati Tanushë është nën kontrollin e plotë të saj, ndërsa pritet që gjatë ditëve të ardhshme ushtria maqedonase të ndër marrë edhe ndonjë ofensivë, për të cilën bashkëbiseduesi ynë – komandanti i lartë i UÇK-së, thotë se “do t’i përgjigjemi në mënyrë të njëjtë”...*

*Në bisedë me komandantin e lartë të UÇK-së mësuam se motivi i incidentit të fundit është dhuna sistematike që ushtria dhe policia maqedonase kanë ushtruar ndaj popullatës civile. Kjo ka shkaktuar pakënaqësi të vazhdueshme te banorët e këtij fshati të cilët kanë qenë pamundësuar të lëvizin pa dokumente të nevojshme në kryerjen e obligimeve të tyre të përditshme. Siç kuptuam, bëhet fjalë për një numër të madh banorësh të fshatrave që gjenden përgjatë vijës kufitare Kosovë-Maqedoni të cilët nuk posedojnë statusin e shtetësisë së Maqedonisë, dhe si pasojë nuk kanë poseduar as dokumente identifikimi... Me këtë pretekst, ushtria dhe policia maqedonase kanë ushtruar dhunë në mënyrë të pakontrolluar ndaj popullatës së atjeshme, e cila, siç thotë bashkëbiseduesi ynë, ka qenë e detyruar të dalë në vetëmbrojtje... Nga komandanti i lartë i UÇK-së mësuam se në radhët e ushtrisë dhe policisë maqedonase janë vërejtur njerëz të maskuar dhe me mjekra të cilët kanë komunikuar në gjuhën serbe. Ushtria Çlirimtare Kombëtare është e pakënaqur nga loja e serbëve dhe maqedonasve të cilët me marrëveshjen e fundit për caktimin e kufirit kanë zhvendosur vijën kufitare 5 kilometra në thellësi të territorit të Kosovës. Kjo padrejtësi, sipas bashkëbiseduesit tonë, është bërë para 4 muajve kur pjesëtarët e ushtrisë maqedonase në disa raste kanë pasur konflikte edhe me pjesëtarët e KFOR-it... “Nuk kemi nevojë për ndihmën subjektive kosovare sepse ne luftojmë për territoret që cenohen padrejtësisht nga serbët në bashkëpunim me maqedonasit. Jemi të fortë dhe mund t’ia dalim mbanë ndaj ushtrisë maqedonase. Shtimi i forcave të tyre nuk na bën aspak përshtypje” – thotë komandanti i lartë i UÇK-së.*

Emin Azemi &amp; Lirim Dullovi

Stevo Pendarovski, zëdhënës i MPB-së

**Policia sekuestron gabimisht Fakti-n**

Në emër të MPB-së dua të bind njerëzit që punojnë në atë redaksi dhe publikun tjetër demokratik në Maqedoni se bëhet fjalë për lëshim teknik të organeve zyrtare, sepse as me kushtetutë e as me ligj nuk guxon të sekuestrohet gazeta, aq më pak me ndonjë aksion të policisë “kokë më vete”

E shtunë, 24 mars 2001

Në qendër të vëmendjes në konferencën e djeshme për shtyp të organizuar nga zëdhënësi qeveritar, ishte tentimi i disa krerëve të strukturave të policisë të cilat botimin revyall të gazetës Fakti i cili shtypet për vendet e Perëndimit, e penguan pa kurrfarë arsye, që të mos mund të arrijë në duart e lexuesve shqiptarë që punojnë e veprojnë atje. Ky pengim i shpërndarjes së gazetës sonë, në konferencën e djeshme për shtyp u dënua nga zëdhënësi i MPB-së Stevo Pendarovski i cili tha: “Një sasi e konsiderueshme e gazetës Fakti është sekuestruar në aeroportin e Petrovecit para se të bëhet tentimi që të shpërndahet në vendet e Perëndimit, mirëpo në emër të MPB-së dua të bind njerëzit që punojnë në atë redaksi dhe publikun tjetër demokratik në Maqedoni se bëhet fjalë për lëshim teknik të organeve zyrtare, sepse as me kushtetutë e as me ligj nuk guxon të sekuestrohet gazeta, aq më pak me ndonjë aksion të policisë “kokë më vete”. Gazetës duhet t’i lejohet patjetër, sikurse edhe botuesit dhe gazetarit që ta shpreh qëndrimin e vetë, dhe pastaj të mund të vërtetohet nëse ka bazë eventuale për të ngritur kallëzim penal. Këtu është vepruar e kundërta e asaj që duhet të veprohet, ndaj përsëri kërkoj falje për gabimin administrativ në procedurë, mirëpo në bazë të njohurive të para, aty ka disa tekste të cilat në këso kushtesh mund ta rrisin tensionin. Nëse është apo jo e mjaftueshme që ndaj cilitdo që punon në gazetë të ngrihet kallëzim penal, do të duhet të vendos prokurori publik i cili pasi të lexojë këto tekste, dhe nëse organet zyrtare të MPB-së do të mendojnë se ka dyshime të bazuara, atëherë do të merret një vendim i tillë. Pra, kallëzimi penal mund të ngrihet vetëm pasi të publikohet gazeta”.

Ismail Sinani

Kulmi i propagandës antishqiptare në mediat maqedonase

**Si përgatitet opiniononi ndërkombëtar për vrasjet eventuale të civilëve në****Tanushë**

Nëse nuk është fjala (vetëm) për edhe një tentim që të paraqiten shqiptarët si egërsira që bëjnë tregti me kufoma, atëherë ekziston rreziku që qëllimi i propagandës së mediave maqedonase të jetë që të justifikohen viktimat eventuale civile në ndonjë aksion të forcave maqedonase.

E mërkurë, 7 mars 2001

Ngjarjet e fundit që po ndodhin në kufirin e Maqedonisë me Kosovën në rajonin e Tanushës, treguan edhe një herë unitetin e mediave maqedonase si “Makedonija Denes”, që kur bëhet fjalë për shqiptarët, jo vetëm që marrin qëndrime të njëjta por edhe sikur veprojnë sipas një strategjie për të cilën kanë konsensus të pakushtëzuar.

Fushata më e re në mediat maqedonase për kush e di të satën herë, dëshmon sërish faktin se në kokat e krijuesve të opinionit maqedonas, shqiptarët mbeten element i rrezikshëm, terroristë, destabilizues e kështu me radhë, me të cilët nuk ia vlen të sillesh ndryshe përveç se me të keq. Ndërkaq, që të mund t’u përgjigjesh “siç e meritojnë” (shqiptarët), siç e kanë mësuar këtë mirë (maqedonasit) duke marrë shembull nga kolegët serbë, duhet njëherë ta përgatitësh opinionin ndërkombëtar që ai ta kuptojë se “sa i zi është ky dreg” (shqiptari). Shkas për t’i rikujtuar këto fakte është shkrimi i pardjeshëm i gazetës Veçer, konstrukti më morbid që vështirë se do të jetë parë ndokund tjetër deri tani, ku thuhet se luftëtarët në Tanushë (kuptohet, të quajtur “terroristë shqiptarë”) po sjellin kufoma shqiptarësh nga Kosova, me qëllim që kur të përfundojnë atje luftimet, gazetarëve të huaj t’u tregojnë se ja se çfarë kanë bërë forcat maqedonase. Sipas Veçerit, (i cili, kuptohet, nuk i referohet asnjë burimi, pasi për lajme të tilla nuk nevojitet ndonjë

konfirmim prej dikujt, kur ato vetvetiu nënkuptohet se janë “të vërteta” – aq sa i nevojitet dikujt) “bëhet fjalë për kufoma pleqsh dhe grash, por mendohet se ekzistojnë edhe kufomat e dy-tre fëmijëve”. Aksioni – vazhdon gazeta qeveritare – ka filluar para disa ditësh dhe vazhdon edhe më tej, ndërsa qëllimi është që të sigurohet një numër i mjaftueshëm civilësh të vrarë, të cilët pas sulmit eventual nga forcat maqedonase, do t’u tregohen gazetarëve të huaj si viktima të terrorit maqedonas dhe të pastrimit etnik. E “përkthyer”, kjo do të thotë se “terroristët” në pauzat ndërmjet dy “terrore” mbi ushtarët e pafajshëm maqedonas, shkojnë nëpër vendbanimet e afërta të kosovarëve dhe i mbledhin kufomat e pleqve, grave dhe (ruana Zot!) fëmijëve, të cilët pasi kanë vdekur janë lënë ashtu rrugëve që t’i përdorë kujt t’i nevojiten. Nënkuptohet, e gjithë kjo bëhet në emër të “Shqipërisë së Madhe”. Veçeri shkon edhe më larg dhe “informon” se “aksioni duhet të vazhdojë më tej për arsye se të njëjtat kufoma nuk mund të ruhen për një kohë të gjatë, dhe kur pas disa ditësh kufomat duhet të varrosen, në vend të tyre të sillen të reja”. Ja edhe kulmi i mendjes perverse morbide të autorit të këtij konstrukti: “Deri tani, kjo gjë për terroristët nuk përbën problem, me përjashtim të kufomave të fëmijëve, për të cilët opinioni ndërkombëtar është më i ndjeshëm (!!!)”. Duam të besojmë se shkrimi i tillë është pjellë e mendjes së ndokujt që ka probleme serioze me shëndetin mendor, pasi po të mos jetë kështu, atëherë ekziston rreziku që kjo të jetë bërë vërtet me qëllim të mbrapshtë. Me fjalë të tjera, ndoshta ky shkrim vërtetë është me qëllim propagandistik (ajo që shqiptarët tentohet të prezantohen si egërsira, veçse s’na habit më”, në kuptimin që në rast të ndonjë aksioni të forcave maqedonase, vrasjes eventuale të pleqve, grave dhe fëmijëve në Tanushë nga ana e tyre, të mbulohet me arsyetimin veçse më të paralajmëruar nga “Veçeri” (dhe të transmetuar pothuajse pa përjashtim nga mediat e tjera maqedonase) se nuk bëhet fjalë për banorë vendas, por për kufoma që “terroristët shqiptarë” i kanë mbledhur nëpër Kosovë. (Të habit fakti se si nuk u është kujtuar të thonë se po i blejnë, e kështu kishin mund të tregojnë se kanë “zbuluar” edhe çmimin që paguhet për një viktimë në Kosovë?). Gazeta antiqeveritare (për faktin se është antishqiptare, as që ka nevojë të thuhet) “Makedonija Denes” ndërkaq, me siguri do ta ketë parë se “çfarë është e tepërt, e tepërt është!” (për çështjen me kufomat) dhe “zbulon” (kuptohet, pa burime) se “terroristët” në Tanushë po mbajkan peng serbë (!!!) të cilët kur të hyjë ushtria maqedonase atje, t’i vrasë e pastaj të thotë se viktimat janë banorë të Tanushës. Kjo gazetë harron të tregojë se sa prej “pengjeve serbe” janë fëmijë, meqenëse, siç tha Veçeri, ndaj fëmijëve, opinioni ndërkombëtar është shumë i ndjeshëm. Dhe kështu vazhdon rrëfimi i vjetër për sjelljen e mediave maqedonase në raste të tilla: gënjeshtrenë e njëri-tjetrit e merr si fakt dhe në bazë të saj zhvillohet një fushatë e tërë. Kësaj radhe, këtë fushatë e përkrahu i pari “specialisti për çështjet shqiptare” Lubomir Fërçkovski (në kolumnën e tij në numrin e djeshëm të gazetës Dnevnik) i cili duke u nisur nga “fakti” se “terroristët” po sjellin kufoma nga Kosova, nxjerr përfundime për zhvillimin e “projektit të Shqipërisë së Madhe”. Vërtet, kur është e tepërt, e tepërt është....

Arben Ratkoceri

Familja Zymberi nga Sllupçani jep edhe viktimën e shtatë

**Valbona 7 vjeçare varroset pa të afërmit e saj – granatimet vazhdojnë**

Parmbrëmë në Spitalin e qytetit të Shkupit vdiq vajza 7 vjeçare Valbona Zymberi nga fshati Sllupçan e cila u plagos rëndë nga raketat e lëshuara nga helikopterët e Armatës së Maqedonisë më 24 maj. Varrimi i saj u bë dje në varrezat e qytetit të Kumanovës, madje pa praninë e anëtarëve më të afërt të familjes së saj, të cilët ende kishin mbetur pa u vrarë nga bombat e ushtrisë dhe policisë maqedonase.

E shtunë, 2 qershor 2001

Pas tragjedisë së 24 majit kur si pasojë e granatimeve të papërzgjedhura të armatës maqedonase, në një nga bodrumet e fshatit Sllupçan mbetën të vdekur 6 anëtarë të familjes Zymberi, pardje kësaj familjeje iu shtua numri i viktimave në shtatë persona. Në orët e vona të mbrëmjes së pardjeshme, pas një jave e shtruar në spitalin e qytetit të Shkupit, vajza 7 vjeçare e kësaj familjeje Valbona Zymberi mbylli përjetë sytë, për t’iu

*bashkëngjitur edhe gjashtë pjesëtarëve të tjerë të kësaj familjeje, të cilët u vranë në mënyrë mizore më 24 maj të vitit 2001. Kujtojmë se më shumë se 70 anëtarë të kësaj familjeje ishin vendosur në bodrumin prej vetëm 16 metrash katrorë të shtëpisë së tyre në fshatin Sllupçan, kur disa raketa të lëshuara nga helikopterët e ushtrisë maqedonase depërtuan muret e bodrumit dhe lanë të vranë 6 persona, ndërsa lanë të plagosur edhe shumë të tjerë të kësaj familjeje, mes tyre edhe vogëlushen 7 vjeçare Valbona Zymberi. Falë këmbënguljes së kryetarit të komunës së Likovës, Husamedin Halili, i cili disa herë ishte penguar të depëronte në Sllupçan nga ana e policisë maqedonase, Valbona u transferua në spitalin e qytetit të Shkupit ku gjatë gjithë kohës, jeta e saj ishte në rrezik. Përkundër tri ndërhyrjeve të rënda kirurgjike, plagët që kishte marrë Valbona ishin tejet serioze. Këtë e konstatuan edhe mjekët e këtij spitali, të cilët pas shumë mundimesh për t'i shpëtuar jetën vogëlushes, e panë se ajo kishte marrë plagë të rënda trupore... Kështu, më 31 maj në orën 20:30, Valbona ndërroi jetë. Varrimi i saj u bë dje në varrezat e qytetit të Kumanovës, madje pa praninë e anëtarëve më të afërt të familjes së saj, të cilët ende kishin mbetur pa u vranë nga bombat e ushtrisë dhe policisë maqedonase...*

Siç shihet, gazeta “Fakti” ofron një tjetër realitet, madje e njeh dhe e legjitimon si entitet UÇK-në që në luftimet e para në Tanushë, në muajin shkurt. Nga ana tjetër, përveç reportazheve të shumta nga lufta dhe vrasjet e civilëve (për të cilat asnjëherë nuk kishte vend në mediat maqedonase), gazeta “Fakti” kishte guxim t’i kundërvihet edhe mediave të shtypura dhe elektronike maqedonase për gjuhën e urrejtjes dhe realitetin e dyzuar që krijonin para opinionit dhe ndërkombëtarëve. Jo pa qëllim, *tirazhi i kësaj gazete u sekuestrua në aeroportin e Petrovecit se gjoja në një lajm të saj bëhej thirrje për mobilizim të mërgatës në Zvicër, për të ndihmuar popullatën shqiptare në Maqedoni gjatë konfliktit.*

\*\*\*

Media elektronike ishte po aq e ndarë sikurse edhe shtypi. Fatkeqësisht shqiptarët nuk kishin aq mjete radio e televizione sikurse pjesa maqedonase.<sup>374</sup> Një ndër zërat më të fuqishëm për shqiptarët ishte vetëm TVM2, shërbimi në shqip i Radio Televizionit të Maqedonisë – i cili sikurse notuam më herët, ndiqte një politikë krejtësisht të kundërt me atë të programit në maqedonisht. (Sikurse u përmend më sipër, konflikti pasqyrohej edhe nga TV Era).

\*\*\*

Gazetarët e asaj kohe thonë se TVM-ja ishte si *shqiponja me dy koka*. Pavarësisht se në të njëjtin trup, institucion, dy shërbimet *shqip e maqedonisht* mendonin ndryshe - në një tendosje të skajshme raportimesh, pavarësisht presionit politik. Brezi i ri i gazetarëve nuk binte lehtë pre e represionit.

Beteja më e madhe mes dy redaksive dhe mendësive të tyre ishte ajo e përkufizimit të UÇK-së. *Të dyja, nën të njëjtën çati!*<sup>375</sup> Dy redaksitë, pavarësisht se mbanin të njëjtën mbledhje

<sup>374</sup> Në këtë pjesë nuk do t’i referohemi raportimit të televizioneve të tjera private maqedonase, A1, Sitel, Kanal5 etj., të cilët, pa hequr asnjë presje, raportonin po aq vrazhdë sa gjithë spektri mediatik maqedonas gjatë konfliktit të 2001.

<sup>375</sup> Gjatë kërkimit në arkiv, një sfidë më vete për të siguruar materialet e vitit 2001, notuam edhe faktin se edhe mënyra e arkivimit dhe referenca e shkruar në atë kohë, në të shumtën e rasteve përmbante fjalët: “*Kronikë nga Haraçina – terroristët shqiptarë fillojnë luftimet!*” (Pavarësisht se gazetarët, punonjësit teknikë, ndanin të njëjtën

dhe dirigjime, sërish vepronin të ndara me përplasje të përditshme mes tyre. Ato ndanin të njëjtat burime logjistike (kamera, pikë leximi, arkiv, studio) por jo edhe burime të njëjta informimi. Përplasia e zakonshme përgjatë gjithë konfliktit ishte fakti se si duhej të quhej UÇK-ja; *terroriste* apo *formacion çlirimtar*.

Presionit të drejtorisë së RTVM-së por edhe politikës nuk iu përkulën gazetaret shqiptarë të cilët në mënyrë demonstrative lanë studiot dhe ndërprejnë transmetimin televiziv për gati 3 javë, pas vendimit të drejtorisë për heqjen e lajmeve të mesnatës. Përplasia më e madhe mes dy linjave të politikës redaksionale vinte për shkak të (mos) referimit të UÇK-së si terroriste si dhe rolit të saj në terren.<sup>376</sup> TVM2 doli “kokë më vete” ose “tradhtare e kauzës që impononte shteti maqedonas”, duke refuzuar ligjin dhe sjelljen konvencionale të imponuar nga shteti.

Raportimin mediatik të dy redaksive do ta analizojmë përmes disa kronikave të transkriptuara. Fillimisht TVM1.

***Terroristët shqiptarë sulmojnë varganin e ARM-së në autostradën Shkup-Tetovë në vendin e quajtur Karpallak. Dhjetëra ushtarë të vdekur, 3 të plagosur.***

8.8.2001

*Në autostradën Shkup-Tetovë ndodhi një vrasje qyqare, mizore dhe çnjerëzore, siç mësojmë zyrtarisht, e dhjetëra pjesëtarëve të Forcave të Sigurisë së Maqedonisë. Në vendin e aktit mizor dhe gjakatar të bandave terroriste shqiptare, ekipi i televizionit maqedonas ishte dëshmitar i aktit çnjerëzor të banditëve shqiptarë. Populli maqedonas dhe opinioni ndërkombëtar kanë mundësi të shohim pamjet e automjeteve thuajse tërësisht të djegur të Armatës së Republikës së Maqedonisë, dëshmi për mënyrën se si terroristët shqiptarë e respektojnë armëpushimin....*

*Autostrada Tetovë-Shkup u hap në orën 19:45 minuta. Policia largoi barrikatad, ndërsa drejt Tetovës u nis një kolonë prej 100 automjeteve me banorë tetovarë që punojnë në Shkup, ose që sot rastësisht janë gjendur në kryeqytet. Në momentin kur u nisëm drejt Tetovës, autostrada ishte e shkretë dhe morbide, pa asnjë automjet. Për thuajse një minutë, kolona e automjeteve tetovare e vërshoi autostradën. Tetovarët ngutëshin drejt shtëpive të tyre ku, siç na thanë para se të nisemi, kanë lënë familjet e tyre. Në autostradën Tetovë-Shkup, momentalisht është qetë dhe nuk dëgjohen veprime ushtarake, por ende është një gjendje e shkretë dhe morbide.*

***Në rrugën Shkup-Tetovë në vendin e quajtur Karpallak, në një tub ujësjellësi prej betoni gjenden 255 kg eksploziv i vendosur nga terroristët.***

8.8.2001

*Pas sulmit tinëzar të terroristëve shqiptarë ndaj varganit ushtarak pas përfundimit të të shtënave në ora 13:00 dje e deri në orën 14:00 sot, njësitet speciale të zbulimit dhe çmontimit të mjeteve shpërthyes në Ministrinë e Punëve të Brendshme përfunduan aksionin e pastrimit të terrenit. Në një gyp të madh të ujësjellësit, në rrugën Shkup-Tetovë te vendi i quajtur Karpallak u gjetën dhe u çaktivizuan 253 kilogram eksploziv me fuqi të madhe shkatërruese. Supozohet se eksplozivi ka qenë dedikuar për shkatërrimin ose këputjen e rrugës, apo për atentat ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë. Eksplozivi nuk është përdorur, por ndaj kontingjentit tonë është vepruar me minahedhës, topa-dore dhe me raketahedhës. Nëse përdorej, sipas ekspertëve, eksplozivi do të bënte një krater të madh prej 100-200 metra dhe dëmtim të rrugës në rreze prej 200 metrash më tej. Nga sasia e përgjithshme e eksplozivit, 90 kg është i llojit trotil, 10 mina kundër tankeve të prodhimit kinez, 6 mina magnet kundër tankeve dhe 11 mina anti-magnet të prodhimit jugosllav. Gypi ishte mbyllur mirë me gurë të shumtë, në mënyrë që*

---

vend pune dhe kulturë disa vjeçare pune, sërish urrejtja dhe ndarja ishte e pranishme edhe mes tyre gjatë konfliktit por dhe pas tij.)

<sup>376</sup> Referuar bisedës me drejtorin e TVM2 Harun Ibrahimimi dhe kryeredaktores Migena Gorenca, ish raportues të konfliktit dhe përjetues të presionit psikik, pezullimeve nga puna etj. gjatë vitit 2001.

të arrihet forcë më e madhe shpërthimi. Eksplozivi ka qenë i lidhur me një kablo të gjatë 350 metra deri te akumulatori për aktivizim dhe me 55 kapsolla për aktivizim. Sipas njësisë speciale të MPB-së, për vendosjen e kësaj sasive të armatimit nevojitet më shumë se një natë, nëse punojnë dhjetëra profesionistë. Nga kjo mund të dilet në përfundim se aksioni i terroristëve shqiptarë ka qenë i mirë-planifikuar dhe i realizuar në mënyrë profesionale... Armët e sekuestruara do të përdoret si material dëshmues në procedurën e mëtejme nëse zbulohen autorët.

**Gjendja në rajonin e Kumanovës, fshatin Opajë dhe Sllupçan si dhe gjendja e tre punëtorëve të Ndërmarrjes së Ndërtimit “Mavrova” të rrahur nga ana e terroristëve. Në trupat e tyre shihen tatuazhet që u janë bërë nga terroristët 8.8.2001**

Nga mesnata deri në orët e pasdites në rajonin e krizës në Kumanovë dhe Likovë, asnjë provokim me armë nga ana e terroristëve shqiptarë. Përjashtim bënë vetëm të shtënat në breshëri nga fshati Sllupçan në orën 9:30 në drejtim të pikës policore në fshatin Opajë... E zakonitë për këtë rajon krize ku terroristët shqiptarë lëvizin gjatë natës. Kështu që, mbrëmë janë regjistruar rigrupime në fshatrat Mateç, Nikushtak dhe Vishticë. Kumanova këtë mëngjes u zgjua pa ujë të pijshëm. Nga mbrëmë në orën 1:00 (pas mesnate), nëpër gypat e ujësllësit të qytetit derdhen 15 litra ujë në sekondë, që në fakt, përbëjnë pikat e fundit që vijnë nga liqeni i Likovës. Shtabi për Mbrojtje Civile jep alarmin: “Kumanovës, urgjentisht i nevojiten burime alternative ujit të pijshëm sepse vetëm në këtë mënyrë shantazhet nga terroristët shqiptarë do të jenë të kota”.

Që të lejojnë hapjen e valvuleve të digës Gllazhnja prej ku mbushet liqeni i Likovës, terroristët kërkojnë të sigurohet energji elektrike për fshatin Likovë. Shtabi informon se punonjësit e kompanisë elektrike “Elektro-Ekonomia” punojnë tashmë në terren për evitimin e këtij problemi.

Në qytet banorët e Kumanovës thonë se nuk i kanë për herë të parë situata të tilla, por me dallimin se tani, edhe temperatura është ndjeshëm më e lartë. Ministria e Shëndetësisë dhe Enti Republikan për Mbrojtje Shëndetësore veprojnë në mënyrë parandaluese që të mos mbërrihet te ndonjë katastrofë humanitare në Kumanovë.

Ndërkaq, në Spitalin e Kumanovës mbrëmë rreth orës 22:00 në Repartin Kirurgjik u shtruan tre nga pesë punëtorët e rrëmbyer të kompanisë ndërtimore “Mavrovo”. Punëtorët, sipas dëshmimeve të tyre, ishin rrëmbyer dje gjatë orës 11:30 teksa punonin në Zhelinë të Tetovës. Dy terroristë shqiptar të armatosur dhe në uniforma, së pari i kanë çuar tre punëtorët, të gjithë nga Kumanova, në malin më të afërt, ku me lopata dhe shkopinj janë rrahur nga rreth 30 terroristë deri në orën 20:30 minuta mbrëmë...

Pas një orë e gjysme nga rrëmbimi i tyre, terroristët kanë rrëmbyer edhe dy punëtorët e tjerë, njëri nga Kumanova ndërsa tjetri nga Velesi, ku edhe ata kanë pësuar të njëjtin fat. Që t’u jepej pak ujë për të pirë, punëtorët e rrëmbyer është dashur të luten në gjuhën shqipe ndërsa gjithashtu janë detyruar të brohorasin “Rroftë Kosova, UÇK-ja dhe Shqipëria”. Nëpër trupat e të rrëmbyerve mund të shihen iniciale nga prerjet, si dhe shenja me thikë, ndërsa punëtorit më të moshuar, terroristët i kanë ngulur thikën në këmbë duke i prerë një copë mishi.

Sipas dëshmimeve të punëtorëve, ata janë ende gjallë falë një shqiptari civil i cili i ka lutur terroristët që t’i lëshojnë ndërsa u ka thënë punëtorëve se kjo që u ndodhi, është hakmarrje për pesë terroristët e vrarë dje në Çair. Personi i njëjtë, me makinë të tipit “Ascona” të kuqe me targa të Tetovës i ka larguar të rrëmbyerit në distancë prej 12 km nga vendi i ngjarjes. Prej atje, pesë punëtorët kanë ndaluar një automobil dhe kanë shkuar deri në Matkë. Pas ecjes së shumtë, në lagjen “Gjorçe Petrov” në Shkup, ata kanë hipur në autobus dhe kanë arritur deri në stacionin e qytetit në Shkup. Tre prej tyre janë marrë nga shokët e tyre që i kanë çuar në Kumanovë, ndërsa dy të tjerët janë nisur për tek të afërmit e tyre në qytet.

Interesant është fakti se në Ndihmën e Shepjtë në Kumanovë, mjeku kujdestar Fikret Jahiu nuk u ka dhënë ndihmë mjekësore punëtorëve të lënduar, kështu që infermieret i kanë dërguar në Repartin Kirurgjik në Spitalin e Kumanovës ku kanë marrë

*përkujdesje mjekësore. Për momentin, gjendja e tyre e përgjithshme shëndetësore është e mirë, por punëtorët e rrëmbyer ende janë të tronditur dhe i tremben rrezikut për jetën e tyre sepse terroristët shqiptarë u kanë marrë dokumentet personale dhe numrat e telefonave të shtëpisë.*

Në këto kronika dallohet fare qartë mllëfi i gazetarit, jo vetëm ndaj formacionit ushtarak UÇK që quhet “terrorist”, por edhe anësisë që ai merr kur thotë “ndaj kontingjentit tonë ushtarak”. Gazetari, i ndihmuar nga komunikata zyrtare e policisë, nuk ka nevojë të kërkojë detaje shtesë ose pista të tjera hetimi, por thjesht *mjaftohet* me kualifikimet se terroristët paskan punuar kaq shumë për minimin e rajonit (një punë që kërkon dhjetëra profesionistë) dhe kanë pasur për synim *atentat ndaj funksionarëve ose këputje të rrugës*. Gazetari e ka të lehtë të besojë informacionin policor ose shtetëror që merrej me faks, pa pasur palë të dytë në lajm, dhe madje, pa ngritur pyetje ose dilema se në konflikt çdo informatë mund të jetë edhe *spin* (trillim) i përgatitur për të përbaltur kundërshtarin. Në përshtkrim nuk mungojnë ngjyrimet me shprehjet si *tinëzar, qyqar*, etj., për të nxitur stereotipa klasike ndaj gjithë shqiptarëve, sikurse tentohet të pasqyrohet gjithë popullsia shqiptare. Po ashtu, në këto kronika dallohen qartë edhe konstatimet personale ndërkohë që nuk harrohet të theksohet se “*mjeku kujdestar shqiptar nuk ka dashur të ofrojë ndihmë mjekësore ndaj punëtorëve të rrëmbyer..*”

TVM2, nga ana tjetër, e kishte kaluar hendekun e presionit nga drejtorja e përgjithshme e televizionit që impononte linjën shtetërore. Në raportimet e saj, UÇK-ja legjitimohej si entitet... Megjithatë, vlen të vlerësohet se lajmi nga gazetarët e TVM2 ishte shumë herë më objektiv dhe brenda standardeve bashkëkohore të raportimit.

Ja disa lajme nga kronikat e nxjerra nga arkivi i këtij televizioni, enkas për qëllim të këtij studimi:

#### ***Adnan Hajdari***

*Armata dhe policia maqedonase kanë ndërmarrë sot herët në mëngjes një ofensivë ushtarake ndaj pozicioneve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Haraçinë, e cila prej dy javësh e mban këtë fshat nën kontroll. Zëdhënësi i Armatës, Bllagoja Markovski tha se aksioni ushtarak ka filluar rreth orës 4:00 të mëngjesit për eliminimin, siç tha ai, të terroristëve shqiptarë dhe për krijimin e kushteve për kthimin e sigurt të popullatës vendase. Burime nga ky fshat bëjnë të ditur se gjatë granatimeve kanë humbur jetën 3 banorë të Haraçinës, ndërsa mësohet edhe për të plagosur. Në ofensivën e sotme ushtarake janë përdorur helikopterët ushtarakë dhe tanket, ku janë goditur disa shtëpi, prej të cilave dilte tym dhe flakë.*

*Një nga udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare i njohur me pseudonimin “Hoxha”, i ka deklaruar radios BBC, se nëse granatimet nuk ndërpriten, ai ka forcë ushtarake dhe teknike sa të sulmojë edhe Shkupin. Komandant Hoxha ka deklaruar për mediat e huaja se luftëtarët e tij e kanë respektuar armëpushimin por kanë qenë Forcat Maqedonase të Sigurimit të cilat gjatë ditës kanë filluar provokimet ndaj pozicioneve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në fshatin Haraçinë.*

*Ndërkaq, deputeti i zonës Ismet Ramadani duke u prononcuar rreth ofensivës së Armatës dhe Policisë Maqedonase ndaj Haraçinës tha: ...kjo ofensivë është një atakim i cili prish krejt marrëveshjen e vendosur për të mbajtur një gjendje status-quo, si dhe marrëveshjen tjetër të shpalljes së armëpushimit nga udhëheqësia e UÇK-së. Ky është një aksion i atyre të cilët, sikurse edhe kanë deklaruar publikisht, kanë zgjedhur opsionin e luftës. Fatkeqësisht këtu është e përfshirë pjesa më efektive e qeverisë, duke filluar nga kryeministri dhe kreu i shtetit... në një kohë kur vetëm 4-5 orë më herët u dhanë deklarata*



optimiste se megjithatë, ardhja e Solanës vendosi rend që të vazhdonte dialogu te kryetari i shtetit. ....në qoftë se nuk ndalet menjëherë ky aksion i ushtrisë dhe policisë me të cilat dikton kryeministri, kryetari i shtetit dhe ministri i punëve të brendshme, atëherë krejt kjo që ne si grup parlamentar dhe si parti kemi shqyrtuar... ndërkohë jemi duke koordinuar edhe me PDSH-në... mund të ndodh që të tërhiqemi nga ky dialog që po zhvillohet te kryetari Trajkovski.

### **Isuf Kadriu**

(stand up)...fshati Straçincë i cili ditëve të fundit ishte në shënjestër të mediave maqedonase. Gjendja në këtë fshat sot ishte relativisht e qetë ndërsa banorët e fshatit rrëfëjnë për vuajtjet që kanë përjetuar ditëve të fundit.

Fshati Straçincë me rreth 1 000 banorë, shumica e të cilëve kanë braktisur shtëpitë, ditëve të fundit ishte në shënjestër të mediave maqedonase të cilat thonë se nga ky fshat sulmohen punktet e policisë maqedonase.

Kryetari i bashkësisë lokale, Adnan Hajrullau, thotë se gjendja në fshat është mjaft e tendosur ndërsa i hedh poshtë spekulimet se gjoja nga Straçinca janë provokuar pjesëtarët e policisë dhe ushtrisë maqedonase. "Gjendja e sigurisë është jashtëzakonisht e tensionuar dhe jemi të brengosur me situatën aktuale sepse te ne... nuk ka të stacionuar Ushtri Çlirimtare Kombëtare, mirëpo forcat policore ose pushteti me çdo kusht tentojnë nëpër mjetet e informimit në gjuhën maqedonase të tregojnë se këtu janë të stacionuara... madje prej fshatit tonë gjuhet ndaj punkteve policore. Ne si bashkësi lokale, me të gjitha forcat tentuam që ato t'i demantojmë ato spekulime, dhe prej te ne asnjëherë nuk është gjuajtur ndaj forcave policore maqedonase" – thotë Hajrullahu i cili shton se në përkeqësimin e gjendjes e cila rezultoi me braktisjen e fshatit nga banorët ka ndikuar mobilizimi i pjesës rezervë të policisë. "Deri sa ishin vetëm policia e rregullt, ne si fshat nuk kemi pasur problem. Prej atë ditë që u bë mobilizimi i të ashtuquajturve "rezervistë" këtu lindën edhe problemet më të mëdha, filluan të gjuajnë nëpër shtëpitë tona, në xhaminë tonë, mbi fshatarët duke shkuar në fushë dhe më në fund edhe kafshët, bagëtitë i kanë gjuajtur... Një numër i vogël ka mbetur këtu. Numri më i madh janë shpërngulur në qytet, nëpër familjet e tyre... Rrymën tashmë prej 8 ditësh na e kanë ndaluar kurse te ne rryma lidhet edhe me furnizimin e fshatit me ujë. Tani fshatarët nuk kanë as rrymë dhe as ujë... për këto arsye ata nuk kthehen nëpër shtëpitë e veta."

Disa nga banorët e Straçincës që kanë mbetur në fshat thonë se janë të vendosur të qëndrojnë në vatrën e tyre përkundër kushteve të vështira jetësore. "Ne jemi këtu në fshat, mirëpo, në rrezik jemi kur vijmë lart. Kemi punkte në Hasanbeg e në Stajkovcë. Gruri na ka mbetur pa korrur, bostani na ka mbetur pa mbledhur" - thotë një banor, ndërsa një tjetër shton – "Ne e kemi jetën nga fusha. Nëse shteti s'na lejon ta mbledhim fushën dhe na gjuan neve nëpër fushë... S'na lejon ta mbledhim. S'kemi jetë ne këtu nëse s'na lejon dhe na gjuan si lepuj nëpër fushë." Një tjetër banor thotë "Unë i kam pasur 15 lopë. 8 lopë m'i kanë vrarë."

Ne, thonë fshatarët jemi të vendosur t'i përballojmë gjendjes së krijuar pasi jemi në vatrën tonë të cilat i kemi ngritur me mund dhe djersë, dhe sipas tyre, duhet të vazhdojë bashkëjetesa. "Bashkërisht e kemi fituar këtë vend ne. Nuk e kanë fituar vetëm ata. Bashkërisht e kemi fituar, bashkërisht kemi jetuar dhe bashkërisht prape do të jetojmë. Duhet me kokë pak të mendojnë maqedonasit se çfarë fitojnë me këtë punë që vetëm ata na bëjnë neve presion".

### **Imrane Bakiu**

Në takimin e djeshëm të ndërmjetësuesve ndërkombëtar, Leotar dhe Përdju dhe liderëve politikë të vendit është bërë e ditur se bisedimet kanë kaluar në një atmosferë të tensionuar, sidomos me Georgievskin dhe Červenkovskin. Leotar dhe Përdju kanë bërë presion te liderët maqedonas që t'i japin korniza dokumentit që nesër duhet të firmoset. Amendamentet e ekspertëve shqiptar fokusohen në miratimin e ndryshimeve të preambulës së kushtetutës, sidomos në përdorimin e gjuhës shqipe në institucionet e shtetit. Por, ekspertët e huaj e dinë se me doemos duhet të arrihet edhe pëlqimi politik me përfaqësuesin politik të UÇK-së, se ndryshe, edhe liderët tanë vështirë se do të bien

*dakord për të nënshkruar çfarëdo dokumenti. Flet fakti që Leotar ka kërkuar nga Komisioni i Venecias që të dërgojë përfaqësues në Maqedoni i cili do tu japë sugjerime dhe njëkohësisht do të vëzhgojë punën e ekspertëve të kushtetutës. Kjo flet se Maqedonia është para aktit të kryer dhe se të kota janë përpëlitjet e politikanëve maqedonas, si dhe të kota i kanë tentimet për të mbajtur frontin, apo thënë ndryshe, për të mbetur me bindje edhe më tej se Kushtetuta e Maqedonisë na qenka libër i shenjtë që nuk ka nevojë për ndryshime. Maqedonia duhet ta ketë të ditur se krizën në vend e menaxhon BE dhe SHBA, andaj, edhe krahas reagimeve të liderëve maqedonas, kushtetuta aktuale domosdo do të marrë trajtë tjetër. Aq më pak merren parasysh reagimet apo opinionet e juristëve të Maqedonisë, të kategorisë së Gordana Siljanovska, e cila e di veten për eksperte të çështjeve të kushtetutës. Ajo, në tribunën e djeshme me temë “A jemi të gatshëm për koncept qytetar” tha se po qe se kushtetuta e Maqedonisë është gjeneratorë e krizës, atëherë sipas saj, jo vetëm në Maqedoni por do të kishim luftë në mbarë Evropën. A thua juristja Gordana Siljanovska nuk përballlet me realitetin në vend, apo gënjen veten. Këtë e themi sepse ka kohë që te ne debatohet rreth ndryshimeve të kushtetutës. Qytetarët në Maqedoni duhet të kuptojnë se me apo pa dëshirën e tyre duhet të krijojnë një shtet i cili do të ketë kushtetutë me koncept qytetar, shtet multi-etnik, multi-konfesional dhe multi-kulturor, e jo të bëjë të kundërtën, ndarje. Sipas burimeve jozyrtare të partive politike shqiptare, ekspertët ndërkombëtarë kanë dhënë dritë jeshile për ndryshimin e preambulës së Kushtetutës, me të cilën Maqedonia do të definohej si shtet qytetar; të pësojë ndryshime neni 7 i Kushtetutës i cili rregullon përdorimin e gjuhëve por akoma nuk dihet se cili do të jetë statusi i gjuhës shqipe. Por edhe përkundër faktit se partitë politike maqedonase nuk janë të gatshme të pranojnë ndryshimet kushtetuese me të cilat Maqedonia do të definohej si shtet shumë-etnik, kjo si duket do të ndodhë pasi kjo është edhe intencë e faktorit ndërkombëtar i cili është i përfshirë në zgjidhjen e krizës në vend.*

Siç shihet nga këto kronika, TVM2 guxoi të bënte edhe shënime editoriale duke dënuar fuqishëm sjelljen e klasës politike, ekspertëve të saj, aktivistëve civilë etj., që ndanin të njëjtën mendësi *përrjashtuese* ndaj shqiptarëve. Në tekstin e mësipërm sulmohet profesorja Siljanovska e cila ishte kundër karakterit *qytetar* të Kushtetutës, kërkesë jo vetëm e klasës politike shqiptare, por edhe e faktorit ndërkombëtar për arritjen e një zgjidhjeje paqësore të konfliktit.

Nga dallimet që pikasëm gjatë trajtimit të lajmeve nga 2 kampet e TVM-së, kemi klasifikuar këto elemente (në tabelën e mëposhtme).

TVM1	TVM2
<b>Terroristë shqiptarë</b>	UÇK, luftëtarë të lirisë
<b>Ushtria evakuon, pastron terroristët</b>	Ushtria sulmon civilë e shkatërron
<b>Notim personal me tone mllefi në raportim (qyqarë, banditë, kaçakë)</b>	Notim korrekt në raportim ndërsa patos në komente dhe shënime redaksionale
<b>Raportim pa presion politik përveç direktivave të përgjithshme nga autoritetet maqedonase – reflektim i njëmendësisë</b>	Raportim me presion të trefishtë politik (autoritetet maqedonase, ato shqiptare në pushtet si dhe vetë UÇK-ja)
<b>Mungojnë vëzhgimet nga civilët dhe banorët shqiptarë</b>	Mungojnë vëzhgimet nga civilët dhe banorët maqedonas

<b>Përdorimi në hije i përjashtimit “Ne” dhe “Ata”</b>	Përdorimi në hije i përjashtimit “Ne” dhe “Ata”
<b>Përdorim i ndjenjave të lavdisë (me fjalët “vendi ynë”, “Republika e Maqedonisë”)</b>	Përdorim i ndjenjës dalluese (në vend të “vendi ynë” dhe “Republika e Maqedonisë”, vetëm “Maqedonia”)
<b>“Përvetësim” i figurave pro kundërpërgjigjes ushtarake (frymë radikale) dhe kundër shqiptarëve (deklarata nga zyrtarë të Serbisë, Ruisë, diplomatë pro qëndrimit shtetëror)</b>	“Përvetësim” i figurave pro mbështetjes së shqiptarëve si dhe liberalë të cilët nuk arsyetonin sulmet e ushtrisë dhe policisë ndërsa mbështesnin përpjekjet për të drejta. Referim i tepruar ndaj SHBA-së

FIGURA 7. DALLIMET NË RAPORTIM MES DY PROGRAMEVE TË TELEVISIONIT PUBLIK RTVM

Siç mund të dallohet edhe nga kjo tabelë, viti 2001 ishte viti i gazetarisë *etnike* dhe lajmeve *patriotike*. Gazetarët maqedonas duket se mezi gjenin shkas që me fjalën *terroristë shqiptarë* të përfshinin në konotacion edhe gjithë popullatën shqiptare. Marrëdhëniet mes gazetarëve maqedonas dhe shqiptarë ishin të ftohta sepse të dyja palët kishin arsyet dhe ndjenjat e tyre, edhe pse gazetaria si koncept, si profesion dhe si aktivitet, është *të konsideruarit veten si palë e tretë dhe i pandikuar*. Për gazetarët shqiptarë, UÇK-ja ishte formacioni i *luftëtarëve të lirisë...* kështu, kjo ndarje kaq e thellë mes gazetarëve lokalë, arsyetonte më së miri edhe studimet e Institutit Maqedonas për Kërkime Sociologjike dhe Institutit për Raportimin e Luftës dhe Paqes, që konkludonin se *“falë ndarjes së mediave, 45% e popullatës maqedonase dhe 80% e popullatës shqiptare ishin gati të merrnin armët për të mbrojtur veten dhe të drejtat e tyre”*.<sup>377</sup>

Siç vërejnë shumë studiues, konflikti me shqiptarët ishte i pakuptueshëm. Dy palët kurrë nuk kanë luftuar kundër njëri-tjetrit, dhe të vetmet probleme reale maqedonasit i kishte me grekët të cilët u mohonin emrin, me bullgarët që u mohonin historinë dhe kombin, si dhe me serbët që u mohonin kishën.

### 5.1.3.2 Raportimi i konfliktit të vitit 2001 nga fqinjët dhe bota

Në pasqyrimin e konfliktit të vitit 2001, një rol të veçantë luajti edhe media e huaj. Përveç agjencive të mëdha si AFP, Reuters, IPTV etj., që zbritën në Maqedoni, edhe shtetet fqinje kthyen antenat nga Maqedonia kur panë se ajo u bë *lajmi i parë* në të gjithë botën.

Shqipëria reflektoi një pjekuri të veçantë për mënyrën se si i menaxhoi zhvillimet mbi konfliktin e vitit 2001, jo vetëm politikisht por edhe përmes medias - duke qëndruar në *distancë* dhe *duke vepruar me maturi*. Shqipëria etiketohej si *shkaktare e konfliktit* në çdo përfundim-lajmi në median maqedonase, madje cilësohej si nxitëse e këtyre aspiratave *të tepruara* të shqiptarëve në Maqedoni; iniciatore e teorisë së *“Shqipërisë së Madhe”* e kështu me radhë. Kështu, në median shqiptare munguan editorialet e flakta nacionaliste, madje edhe gazetat ishin të kujdesshme në shkrimet e tyre duke përsëritur herë pas here se Qeveria e Tiranës ishte në

<sup>377</sup> Aurora Ndrilo, *Viti 1, Media dhe Gjeopolitika e një konflikti etnik*, USHT, Tetovë 2014, faqja 105

harmoni absolute me veprimet e mediatorëve ndërkombëtarë.<sup>378</sup> Megjithatë ishte e qartë se media në Shqipëri mbështeste pa mëdyshje *luftën e shqiptarëve të Maqedonisë për të kërkuar të drejtat e tyre*. Një dozë e lehtë përkrahjeje e konfliktit vinte nga mediat në Kosovë. Pasi kishin përjetuar krizën me refugjatët, kosovarët i kishin përforcuar *paragjykimet* ndaj maqedonasve dhe kishin vërejtur me sytë e tyre ftohtësinë e marrëdhënieve midis popullatës maqedonase dhe asaj shqiptare. Ishte e qartë po ashtu se, asnjë derë maqedonase nuk u hap për kosovarët gjatë krizës së vitit 1999.<sup>379</sup> Në kohën kur Haga filloi të ngrinte padi ndaj *kasapëve të Ballkanit* për krime lufte, ndonjë media në Kosovë guxonte të thumbonte (si p.sh., gazeta “Bota Sot” që ndonjëherë e nxiste konfliktin), por njëkohësisht e përgatiste popullatën shqiptare të Maqedonisë se lirisht mund të gjente strehim te vëllezërit në Kosovë. Megjithatë, amerikanët ishin ata që e mbajtën median shqiptare në *fre dhe kontroll*. Kristofer Dell (kreu i zyrës së SHBA-së në Prishtinë) mbante kontakte të ngushta me mediat dhe politikanët shqiptarë, duke i përmbajtur ata nga nxitja e mëtejshme e konfliktit. Madje, Dell ndante qëndrimin se shqiptarëve nuk iu duheshin më konflikte.

Serbia ishte kryekëput subjektive dhe e njëanshme me klasën politike maqedonase. Pavarësisht se e zënë me lajmin e parë vendor, *arrestimin e Millosheviqit dhe dërgimin e tij në Hagë (1 prill 2001)*, Serbia tentonte të vriste tre zogj me një gur, edhe shfaqjen e *formacioneve të UÇPMB-së* në Preshevë, *separatistët shqiptarë* në Maqedoni si dhe *mercenarët dhe terroristët e Kosovës* që gjoja barteshin nëpërmjet Zonës së Sigurisë përgjatë kufirit me Maqedoninë. Duke luajtur me stereotipat ndaj shqiptarëve, media serbe e kishte më të lehtë të jepte ngjyrimet sipërfaqësore dhe gjithëpërfshirëse ndaj shqiptarëve, edhe pse zëri i tyre në kronikat ose tekstet në gazetatat e shtypura, mungonin. Kjo njëanshmëri shkonte deri te dilemat që ngriheshin ndaj NATO-s dhe faktorit ndërmjetësues. *Vreme* e Beogradit thoshte se *shqiptarët po kapin trenin e fundit për bashkim trojesh me Shqipërinë dhe Kosovën*, (krijimin e Iliridës dhe shkëputjen nga Maqedonia – teori e përfolur që në vitin 1992) si dhe *çuarjen e Maqedonisë drejt një marrëveshje të dytë Dejtoni*.<sup>380</sup> NATO cilësohej si një aleancë *pa vullnet dhe dëshirë* në kontrollimin e ekstremizmit shqiptar, madje përmes ngritjes së pyetjeve sikurse “*Përse na duhet NATO?*”, Serbia i dërgonte sinjal autoriteteve maqedonase për forcë më të madhe ndaj të ashtuquajturve luftëtarë shqiptarë dhe që, të mos ua vinte shumë veshin ndërkombëtarëve.

Bullgaria, fqinji tjetër me të cilin Maqedonia kishte probleme me historinë dhe kombin, raportonte në media me një *karshillëk distant* (nuk e besonte konfliktin pasi deri në atë kohë ishte mësuar të ishte vigjilente vetëm ndaj histerive të medias maqedonase kur shkruante për bullgarizim të tokave përgjatë Vardarit). Madje, për një kohë të gjatë Bullgaria nuk konsideronte se Maqedonia kishte krizë. Teoritë bullgare thoshin se kjo situatë ishte si pasojë e ndarjes ekonomike dhe shoqërore; shqiptarët kishin në dorë sektorin privat ndërsa maqedonasit mbanin administratën shtetërore, policinë dhe arsimin. Pavarësisht se e shihnin Maqedoninë në kuptimin formal, mediat bullgare nuk dëshironin të shprehnin qëndrim të qartë ndaj palës shqiptare, edhe pse nuk mbeti pa rënë në fokus politika e kryeministrit Ivan Kostovit, vizita e tij në Shkup, refuzimi i tij ndaj refugjatëve të Kosovës, mosmbështetja e bisedimeve me shqiptarët (përveç partisë së re Lëvizja Kombëtare “Simeon II”), qëndrimi kundër ndërhyrjes së NATO-s në

<sup>378</sup> Llazari Semini, *Mediat e Shqipërisë: Një qasje profesionale - Maqedonia; konflikti dhe mediat*, Instituti Maqedonas për Media, Shkup 2003, faqja 19

<sup>379</sup> Haqif Mulliqi, *Keqkuptime dhe rreziku i ndarjes së përhershme - Maqedonia; konflikti dhe mediat*, Instituti Maqedonas për Media, Shkup 2003, faqja 83

<sup>380</sup> Dragan Gjokoviq, *Larg nga Serbia Jugore - Maqedonia; konflikti dhe mediat*, Instituti Maqedonas për Media, Shkup 2003, faqja 120

konfliktin e vitit 2001, frika e komb-formimit në shekullin XXI (Shqipëria e Madhe ose federalizimi i Maqedonisë) apo edhe mbështetja dhe furnizimi me armë i ushtrisë maqedonase.<sup>381</sup>

Ndërsa Greqia, me të cilën Maqedonia kishte probleme me emrin që në lindjen e saj si shtet, pretendon se ka qenë e kujdesshme në raportimin mediatik, edhe pse gazetarët që ndoqën konfliktin, ndryshe nga ngjarjet e Kosovës, nuk i trajtuan asnjëherë *kryengritësit shqiptarë* si viktima të një pushteti shtypës, përkundrazi i cilësuan shqiptarët (UÇK-në) si *burim kryesor i trazirave*.<sup>382</sup> Që në sinjalizimin se konflikti në Maqedoni po afronte, lajmi që pushtoi mediat greke ishte se “*grupe të armatosura nga Kosova lëviznin drejt kufirit për në Maqedoni*”. Duke përdorur kryesisht burime nga gazetarët maqedonas, media greke tregonte prapëseprapë njëanshmëri. Roli i ri i Greqisë (anëtare e BE-së por edhe për shkak të pozitës gjeografike) e vendoste atë në supremaci, duke krijuar madje edhe një distancë nga mediat e tjera si CNN, BBC etj., raportimet e të cilave klasifikoheshin se udhëhiqeshin nga propaganda e qendrave të pushtetit botëror.

Ndërkaq, ishte e qartë se media ndërkombëtare do të ndahej në dy taborë. Rusia ndante qëndrimin zyrtar se *nacionalizmi shqiptar ishte më i rrezikshmi në të gjithë Evropën Juglindore*, madje kritikonte NATO-n se kishte zhvilluar *bisedime me “terroristët” shqiptarë*,<sup>383</sup> duke ia shtuar pa nevojë vlerën UÇK-së. Rusia kishte kërkuar nga perëndimi heqjen e embargos ndaj Serbisë, në mënyrë që ajo dhe Mali i Zi të ndihmonin Maqedoninë kundër UÇK-së.<sup>384</sup> Në mënyrë të fshehtë, Rusia (ministër i Mbrojtjes së asaj kohe ishte Sergej Lavrov) ndihmoi me vullnetarë dhe instruktorë njësitin e sapokrijuar “Luanët” për të shtypur UÇK-në.<sup>385</sup> Tonet shkonin deri aty sa *UÇK-ja të cilësohej si produkt i CIA-s*. Rusia trumbetonte teorinë e nxjerrë nga vetë kryeministri Georgievski kundër NATO-s, duke theksuar se “*Aleanca perëndimore po krijonte një talibanizëm të ri në Evropë*”.<sup>386</sup> Kjo gjuhë e qeverisë së Putinit e cila hiqte paralele mes “terroristëve shqiptarë” dhe “terroristëve çeçenë”<sup>387</sup> reflektohej në mediat ruse gjithashtu. Nga ana tjetër, politika *perëndimore* e bazuar në vlera të tjera; respektimin e të drejtave të njeriut dhe jetës së tij, tubonte mediat e veta. Nga frika e një *Kosove të dytë*, gazetarët ndërkombëtarë arritën së pari që të kthenin me sukses vëmendjen e ndërkombëtarëve ndaj këtij konflikti, dhe së dyti, vendosja e *interesit njerëzor* në plan të parë i printe ato të raportinin pa doza nacionalizmi (sikurse mediat ruse). Mediat perëndimore gjithsesi dënonin të dyja palët për ushtrimin e dhunës,

<sup>381</sup> Nikolaj Petrov, *Maqedonia, nyja e Ballkanit - Maqedonia; konflikti dhe mediat*, Instituti Maqedonas për Media, Shkup 2003, faqja 45

<sup>382</sup> Takis Diamantis, *Ku përfundoi objektiviteti? - Maqedonia; konflikti dhe mediat*, Instituti Maqedonas për Media, Shkup 2003, faqja 60

<sup>383</sup> Përveç Ruisë, fuqitë e mëdha hoqën dorë nga përdorimi i UÇK-së si terroriste.

Zhidas Daskalovski, *Walking on the Edge: Consolidating Multiethnic Macedonia, 1989-2004*, Globic Press, USA, faqja 130

<sup>384</sup> Ministri i jashtëm rus Ivanov kërkoj nga malazezët që së bashku me serbët të veprojnë kundër ekstremistëve shqiptarë,

Qendra për Informim e Kosovës, <<http://www.trepca.net/2001/03/010320-qik.htm#19>>, [25.4.2019]

<sup>385</sup> Кој застана на страната на Терористите, а кој на страна на Македонија: Колку Руски доброволци имаше во „Лавовите“ во 2001!, <<https://infomax.mk/wp/%D0%BA%D0%BE%D1%98-%D0%B7%D0%B0%D1%81%D1%82%D0%B0%D0%BD%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D1%82%D1%80%D0%B0%D0%BD%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D1%82%D0%B5%D1%80%D0%BE%D1%80%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B8%D1%82/>>, [25.4.2019]

<sup>386</sup> Washington Post, *Macedonia Gets Ready for War With Albanians / Fighting with guerrillas expands*, <<https://www.sfgate.com/news/article/Macedonia-Gets-Ready-for-War-With-Albanians-2940531.php>>, [25.4.2019]

<sup>387</sup> Charlotte Wagnsson, *Developing the “moral” arguments: Russian rhetorical strategies on security post-Kosovo?*, Institute for Security Studies – Western European Union, Paris 2001, faqja 21, <<https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/occ028.pdf>>, [25.4.2019]

si veprimet *ekstremiste* ashtu edhe sulmet *ushtarako-policore* maqedonase. Trajtimi i lajmeve nga New York Times, The Washington Post, Le Monde, Liberation, televizioni CNN, rrjeti Reuters, AFP etj., ishte thuajse identik; pa mbështetje për palët në konflikt dhe pa mbajtur anë. Megjithatë, në çdo lajm notohej apeli drejtuar ndërkombëtarëve për të ndërhyrë sa më shpejt në lehtësimin dhe gjetjen e një zgjidhjeje mbi konfliktin, si dhe ruajtjen e interesit njerëzor, e mbi të gjitha paqen në rajon.<sup>388</sup>

\*\*\*

Gati 20 vjet nga konflikti i vitit 2001, Maqedonia ende raporton në mënyrë të ndarë. Mllefave dhe stereotipave të vjetër u është hedhur sipër vetëm një pëlhurë, dhe ato ende janë të dukshme herë pas here në raportimet e sotme. Përveç mediave private kombëtare, edhe televizioni publik TVN me dy shërbimet TVN1 dhe TVN2 ende në nënndërgjegje vepron me frymën përjashtuese. TVN1 (shërbimi në gjuhën maqedonase) raporton vetëm për ngjarjet përkujtimore në Karpallak, ndërsa TVN2 (shërbimi në shqip) raporton vetëm për ngjarjet përkujtimore në Sllupçan. Që nga konflikti i vitit 2001, dallohet qartë edhe sot e kësaj dite leksiku ose terminologjia e përdorur në referim; mediat maqedonase thonë: “*vendi ynë*” ndërsa mediat shqiptare (veçanërisht ALSAT) i referohet thjesht si “*Maqedoni e Veriut*”.<sup>389</sup>

Një tjetër element është edhe ai i përdorimit të përcaktorit në prapashtesën “*maqedonase*” dhe “*e Maqedonisë së Veriut*”. Mediat maqedonase gjithnjë janë siguruar të përforcojnë ndjenjën e përvetësimit dhe përkatësisë me prapashtesën “*maqedonase*” ndërsa mediat shqiptare (veçanërisht ALSAT) i referohej si “*e Maqedonisë*”, duke i treguar korrektësi popullatës shqiptare por edhe duke i dërguar mesazhin popullatës maqedonase se çdo gjë në këtë shtet, është edhe e shqiptarëve. Prapashtesa “*e Maqedonisë*” nënkupton se institucionet, shteti, e gjithçka tjetër, është e të gjithëve dhe jo vetëm apo në mënyrë ekskluzive “*maqedonase*”. Televizioni ALSAT ishte ai që bëri këtë imponim, si pjesë të politikës së vetë për të thelluar ndjenjën mbarë-shqiptare, korrektësinë politike ndaj popullatës maqedonase, si dhe dhënien e leksionit se shqiptarët janë për shtet social që iu përket të gjithëve njësoj.<sup>390</sup>

#### 5.1.4 Pronësia, struktura dhe raportimi mediatic në ndryshimet politike

Media në Maqedoninë e Veriut ka përjetuar turbulenca në fazën e saj të lulëzimit, jo vetëm për shkak të politikës, për shkak të biznesit të lidhur me to, ngjarjeve etnike që e kanë karakterizuar vazhdimisht këtë shtet, por edhe *tekave* të pronarëve dhe *papjekurisë* së tyre.

Tranzicioni i gjatë në Maqedoninë e Veriut kishte gati-gati tiparet e *anarkisë* në vitet e para të pluralizmit (1990), ndërkohë që dallgët e vrazhda të zhvillimeve politike, problemet me fqinjët, ato të brendshme dhe konflikti etnik, e hodhën shtetin shpeshherë si një anije në ujëra të trazuara. Për rrjedhojë, edhe media vinte me të njëjtën vorbull dhe ekspozohej në margjina, jo

<sup>388</sup> Aurora Ndrio, *Viti I, Media dhe Gjeopolitika e një konflikti etnik*, USHT, Tetovë 2014, faqja 164

<sup>389</sup> Aurora Ndrio, *Multikulturalizmi dhe media shqiptare në Maqedoni: modelet moderne globale dhe problematika lokale*, Studim shkencor, 2015

<sup>390</sup> Kjo politikë zbardhet nga vetë autori (Admir Qose), kryeredaktor dhe me një eksperiencë prej 15 vjetësh në televizionin ALSAT. Qose është pjesë e ekipit të parë nga Shqipëria për çeljen e ALSAT në Maqedoni, si drejtues dhe trajnues i ekipit të gazetarëve të televizionit ALSAT.

vetëm për shkak të interesave të politikës, por mbi të gjitha, për shkak të interesave vetjake dhe biznese të pronarëve të tyre, të cilët, pa shumë drojë, ose binin në rrjetën e ndikimit shtetëror ose iu pëlqente me vetëdëshirë të *flirtonin* me pushtetin.

\*\*\*

Siç u përmend më sipër, sfera mediatike në Maqedoninë e Veriut njohu për vite të tëra televizionin A1, i themeluar që në vitin 1993. Deri në vitin 1998, kur në atë kohë ishte në pushtet LSDM-ja, kjo media ishte e afërt me pushtetin. Falë kësaj afërsie, si dhe faktit që ishte i pari televizion privat që theu tabutë e informimit të vjetër socialist, ky televizion njohu një ngjitje duke rrëmbyer shifrat më të larta të shikueshmërisë. Lidhja me politikën vazhdoi edhe më vonë, pavarësisht se ecuria politike dhe ajo e sigurisë së vendit u kërcënuan në vitin 2001 nga konflikti i armatosur. Gjatë konfliktit, televizioni ndoqi linjat e ashpra kundër shqiptarëve, ndërkohë që ndalimi i një ekipi televiziv nga UÇK-ja u shndërrua në sensacion për këtë televizion, duke zaptuar vëmendjen e popullatës pas paraqitjes së ngjarjes si *rrëmbim*. Sipas raportimit televiziv, ekipi ishte rrëmbyer nga shqiptarë të armatosur, dhe një gjë e tillë nxiti përlëshjet e para me forcat maqedonase të sigurisë.<sup>391</sup> Me rikthimin në pushtet të LSDM-së në vitin 2002, pronari i këtij televizioni Velija Ramkovski ndërtoi një zinxhir të gjerë prej të paktën 10 firmash në të njëjtën adresë - “Pero Nakov” pa numër. Përveç televizionit A1, Ramkovski themeloi edhe gazetat *Vreme*, *Shpic*, lidhi partneritet me gazetën *Koha*, themeloi televizionin tjetër A2 (02.07.2008) në shqip, pastaj edhe gazetën tjetër në shqip “*Koha e re*” (pas prishjes së partneritetit me gazetën *Kohën*), revistën “*IE*”, shtypshkronjën “*UNI Prokom Vemaks*”, ndërkohë që nga bizneset e tjera jo-mediatike ai kryesonte me zinxhirin e marketeve “*Hedis*”, “*Sinim*”, “*Tërgokos*”, “*Stratus*” dhe “*Aks-tra*”. Me ardhjen në pushtet të VMRO-së në 2006, por edhe me shprehjen e synimeve të tij politike dhe biznese, që sipas zërave të asaj kohe i tubuan shumë armiq, Velija Ramkovski ra në “*rrjetën e merimangës*”<sup>392</sup> që kishte krijuar vetë. Krimet e tij kishin filluar që nga moskthimi i borxheve amerikanëve – një donacion i marrë në vitin 1995 për pajisje teknike për televizionin – para të cilat u përdorën për biznesin tjetër të tij me *kofsha pule* – siç përkufizohej në media. Falë lidhjeve dhe shpërdorimeve me institucionet vendore gjatë kohës së LSDM-së, Ramkovski nuk ia ktheu borxhin prej 1,4 milion dollarësh<sup>393</sup> kredi-dhënësit, Fondit Amerikan për Kreditimin e Zhvillimit të Medias (US Media Development

<sup>391</sup> Në shkurt të vitit 2001, ekipi i televizionit A1, me gazetaren Snezhana Llupevska u ndalua në Tanushevë, në afërsi të kufirit mes Maqedonisë dhe Kosovës nga pjesëtarët e UÇK-së. Pas disa orësh ajo u la e lirë, me mesazhin se fshati ishte pavarësuar (në dorë të UÇK-së). Gjatë kësaj periudhe, 1998-2002, qeveria drejtohej nga VMRO DPMNE-ja dhe PDSH-ja.

Keith Brown, *Transacting Transition: The Micropolitics of Democracy Assistance in the Former Yugoslavia*, Kumarian Press 2006, SHBA, faqja 125,

<<https://books.google.mk/books?id=fqrsG2jgpkAC&pg=PA125&dq=Sne%C5%BEana+Lupevska&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwjhyN233sjhAhVitIsKHajnDP4Q6AEILzAB#v=onepage&q=Sne%C5%BEana%20Lupevska&f=false>>, [28.4.2019]

<sup>392</sup> “Rrjeta e merimangës” (Пајажина) ishte emri i koduar i operacionit për arrestimin e Velija Ramkovskit, magnatit mediatik dhe biznesmenit të mbi 10 subjekteve të tjera juridike. Ai u arrestua më 23 dhjetor të vitit 2010.

<sup>393</sup> Lubomir Kostovski, *Газда Велија во костумот на Берлускони (Bosi Velija në kostumin e Berluskonit)*, <<http://www.globusmagazin.com.mk/?ItemID=8E5555695961EA42A306BF8AD5C4A6F6>>, [28.4.2019]

Loan Fund - MDIF)<sup>394</sup> deri në vitin 2006. Për një kohë të gjatë, pas këtij skandali, Fondi Amerikan e ndërpreu për disa vite me radhë financimin e mediave në Maqedoni.<sup>395</sup> Një gjë e tillë theksohej edhe në një kablllogram të Wikileaks<sup>396</sup> ku notohej se gjykatat e Maqedonisë ishin të pafuqishme të *urdhëronin pronarin e televizionit maqedonas A1 për t'i paguar borxhet Fondit për Kreditimin e Zhvillimit të Medias (Media Development Loan Fund)*.<sup>397</sup> Gjithsesi, hetimet financiare ndaj Ramkovskit dhe veprimtarisë së tij biznesore nisën më 24 nëntor të vitit 2010, ndërkohë që pas zbulimit të shkeljeve, ai ra në pranga bashkë me 22 persona të tjerë (që të gjithë menaxherë dhe themelues firmash, përfshi edhe vajzën e tij Emel) për evazion fiskal, larje parash dhe bashkëpunim kriminal. Vetëm djali i tij Hedi qëndroi në arrati. Sipas Drejtorisë së të Ardhurave Publike, Ramkovski kishte realizuar në mënyrë jo ligjore 16 milionë euro të ardhura, për të cilat i kishte fshehur shtetit rreth 4,1 milionë euro tatim.<sup>398</sup> Pavarësisht presionit të opinionit dhe ndërkombëtarëve, si dhe lajmeve që u zhvendosën në rrugë para qeverisë, A1 më në fund falimentoi më 26 korrik të vitit 2011. Pas 60 seancash gjyqësore pronari i tij Velija Ramkovski u dënua me 13 vjet burg. Ai u lirua përkohësisht nga burgu më 21 gusht të vitit 2017 me rikthimin e LSDM-së në pushtet, ndërkohë që pas kryerjes së 2/3 të dënimit, Ramkovski u lirua përfundimisht nga burgu. Gjithsesi, rënia e perandorisë së tij dhe fati i kultit të personalitetit që kishte ngritur, tregojnë qartë interesat biznesore dhe politike tepër të forta në fushën e medias.

Në sferën mediatike aktualisht funksionojnë 5 televizione kombëtare private tokësore, por një pjesë e tyre varen sërish nga bizneset si dhe lidhjet politike me pushtetin.

\*\*\*

Televizioni Sitel është në pronësi të firmës *Monteko* (100%) dhe ka pronar Goran Ivanov-Xingon<sup>399</sup> - një figurë politike dhe biznesore e cila ka përfutuar prej një kohe të gjatë nga lidhjet politike, pasi babai i tij Lubisav Ivanov-Xingo ishte deri vonë kryetar i Partisë Socialiste të Maqedonisë<sup>400</sup> - çdo herë në koalicion qeveritar me të gjitha partitë fituese që merrnin pushtetin. Xingo është pronar gjithashtu i firmës *Sileks Nemetali*. Ai kishte qenë drejtor i kësaj ndërmarrjeje në periudhën socialiste, ndërkohë që pas pavarësisë, me procesin e privatizimit, e bleu atë. Xingo është pronar edhe i disa hoteleve, i ujit “*Lladna*” etj. Kratova, vendlindja e Xingos, kishte qenë gjithnjë bastion fitoreje i Partisë Socialiste (për herë të parë, komuna e

<sup>394</sup> Fondi për investimin e zhvillimit të medias investon në ndihmë të vendeve në tranzicion, për zhvillimin e medias nëpër botë duke ndikuar në një media të lirë për qytetarët (lajme, informacion dhe debate) për lulëzimin e shoqërisë. Media Development Investment Fund, <<https://www.mdif.org/>>, [28.4.2019]

<sup>395</sup> Kronikë lajmesh, *Криминалната империја на Велија Рамковски. Рамковски зад решетку (Perandoria kriminale e Velija Ramkovskit. Ramkovski prapa grilave)*, <<https://www.facebook.com/SekulaVojvodaFanClub/videos/567146850127543/?v=567146850127543>>, [28.4.2019]

<sup>396</sup> Lubomir Kostovski, *Газда Велија во костумот на Берлускони (Bosi Velija në kostumin e Berluskonit)*, <<http://www.globusmagazin.com.mk/?ItemID=8E5555695961EA42A306BF8AD5C4A6F6>>, [28.4.2019]

<sup>397</sup> Wikileaks, *Macedonia & NATO membership: Defense reforms on track; Political & Economic reforms key obstacles*, <[https://wikileaks.org/plusd/cables/06SKOPJE105\\_a.html](https://wikileaks.org/plusd/cables/06SKOPJE105_a.html)>, [28.4.2019]

<sup>398</sup> Voice of Amerika, Уапсен сопственикот на А1 Телевизија (Arrestohet pronari i televizionit A1), <<https://mk.voanews.com/a/velija-112431984/453279.html>>, [28.4.2019]

<sup>399</sup> Të dhënat janë nxjerrë nga Regjistri Qendror për qëllime studimore dhe janë të qasshme për informim të lirë.

<sup>400</sup> Profili i kryetarit të Partisë Socialiste të Maqedonisë, si deputet në vitin 2006, i shkëputur nga faqja zyrtare e Kuvendit, <[https://www.sobranie.mk/partia-socialiste-e-maqedonis-9631a674-fc15-41da-a12f-9e3715f632d5-ns\\_article-lubisav-ivanov-xingo-06.nsp](https://www.sobranie.mk/partia-socialiste-e-maqedonis-9631a674-fc15-41da-a12f-9e3715f632d5-ns_article-lubisav-ivanov-xingo-06.nsp)>, [30.4.2019]



Kratovës u fitua nga LSDM-ja në zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2017).<sup>401</sup> Bastioni i fitores i mundësonte atij pjesëmarrjen në koalicionet qeverisëse veçanërisht gjatë pushtetit të VMRO-së nga viti 2006 deri në vitin 2017. Politika editoriale pro-qeveritare nën drejtimin e Dragan Pavllloviq-Llatasit u shpërblye me fitimin e shumë projekteve, ndërkohë që kuadrot socialistë që mbajtën për vite me radhë ministrinë e Bujqësisë sot janë në pranga për shpërdorime me toka bujqësore.<sup>402</sup>

Ndërkaq, qeveria e LSDM-së zbuloi në vitin 2017, skandalet e njëpasnjëshme të qeverive të Gruevskit të cilat kishin shpenzuar shuma marramendëse parash, gati 130 milion euro për fushata reklamuese qeveritare, prej të cilave 31 milion euro vetëm në mediat e huaja (si CNN, BBC etj.). Nga shuma prej 12,8 milion eurosh e ndarë mediave vendore,<sup>403</sup> Sitel kryesonte me pjesën më të madhe të parave të përfituara nga shteti, sikurse të gjitha mediat e tjera pro-qeveritare, Kanal 5 dhe Alfa.<sup>404</sup> Buxhetet e parashikuara për fushatat reklamuese qeveritare nuk ndaheshin sipas kriterit të shikueshmërisë së televizioneve, por falë lidhjes politike, biznese dhe propagandës pro-pushtetit. Proporcionalisht, krahasuar me media më objektive ose jo-qeveritare (p.sh., krahasuar me televizionin ALSAT apo Telma), mediat pro-qeveritare morën 10 herë më shumë para. Në tregun mediatik, ky injeksion dhe ndarje e padrejtë parash shkaktoi turbulenca sepse televizionet që përfituan më shumë, i rritën qëllimisht dhe në mënyrë artificiale çmimet e produkteve televizive (si blerje filmash, serialesh etj.).<sup>405</sup>

Televizioni Sitel do të mbahet mend edhe për firmat (marketing dhe shëndetësi) që krijuan të punësuarit e tij, kryeredaktori Dragan Pavllloviq-Llatas dhe Ivona Taleska të cilët u paditën më vonë nga Prokuroria Speciale Publike për fshehje tatimesh në Drejtorinë e të Ardhurave Publike.<sup>406</sup> Po ashtu, televizioni Sitel do të mbahet mend, jo vetëm për animin e tij politik, por edhe për atë etnik dhe anti-shqiptar<sup>407</sup> - *megafon i politikës së VMRO-së*. Llatas, siç

<sup>401</sup> Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, *Rezultatet nga zgjedhjet lokale të tetorit 2017*, <<https://rezultati.sec.mk/Local/Results?cs=mk-MK&r=r&rd=r1&m=42&ps=All>>, [30.4.2019]

<sup>402</sup> Aco Spasenovski, Mihail Cvetkov dhe Lupço Dimovski ishin ministra në qeverinë e VMRO DPMNE-së me propozimin e Partisë Socialiste të Lubislav Ivanov-Xingos.

ALSAT, *Policia ndalon ish ministrat e bujqësisë në kohën e VMRO-së*, <<https://www.alsat-m.tv/policia-ndalon-ish-ministrat-e-bujqesise-ne-kohen-e-vmro-se/>>, [30.4.2019]

<sup>403</sup> ALSAT, *Reklamata dhe fushatat kanë kushtuar 130 milionë euro*, <<https://www.alsat-m.tv/reklamata-dhe-fushatat-kanë-kushtuar-130-milione-euro/>>, [30.4.2019]

<sup>404</sup> Kristina Ozimec, *“Sitel”-i, „Сител“, „Канал 5“ и „Алфа“ се офајдиле најмногу, „Телма“ и „Алсат-М“ најмалку од колачот за владини реклами (“Канал 5” dhe “Алфа” kanë përfituar më së shumti, “Телма” dhe “Алсат-М” kanë marrë më së paku nga kulaçi i reklamave qeveritare)*, PINA, <<https://pina.mk/2109-sitel-kanal-5-alfa-se-ofajdile-najmnogu-telma-alsat-m-najmalku-od-kolachot-za-vladini-reklami/>>, [30.4.2019]

<sup>405</sup> Sipas përfaqësuesve të medias, Kanal 5 i hipi çmimet madje deri në 50% më shumë nga të tjerët për të krijuar konkurrencë të pandershme.

<sup>406</sup> Sipas hetimit të Prokurorisë Speciale Publike, firmat e Llatasit ishin “Total Marketing Agencija”, “Total Marketing”, “Mediamaks” dhe “Total Media Centar” ndërkohë që tatimi i fshehur ishte 164 mijë euro, ndërsa Ivona Taleska me firmën e nënës së saj që përfitoi tender prej 1 milion eurosh nga Ministria e Shëndetësisë, përmes dy firmave të saj Smart Centar – import/eksport – Shkup dhe Smart Grup – Skopje, iu shmang tatimit prej 44,558 mijë euro.

C. K. Делевска, *Латас за луксузни душеџи и брајтлинг затаил 164 илјади евра, а Ивона за гаки и сминки, 44 илјади евра (Ллатаси shpenzoi për dyshkë luksozë dhe orën Breitling 164 mijë euro, ndërsa Ivona 44 mijë euro për të brendshme dhe produkte zbukurimi)*, SDK, <<https://sdk.mk/index.php/makedonija/latas-za-luksuzni-dushetsi-i-brajtling-zatail-164-iljadi-evra-a-ivona-za-gaki-i-shminki-44-iljadi-evra/>>, [30.4.2019]

<sup>407</sup> Llatasi bëri thirrje edhe gjatë zgjedhjeve për të votuar sa më bindshëm VMRO-në, në mënyrë që shqiptarëve të mos u jepej e drejta e kushtëzimit të qeverisë për të kërkuar shqipen, si gjyhë të dytë zyrtare në Maqedoninë e Veriut.

do të shohim në elaborimet e mëposhtme, nxiste shpeshherë *urrejtje etnike*. Madje, dyshime nxiti në opinion edhe transhi i parave prej 2,6 milion eurosh që shteti ia lëshoi mediave pro-qeveritare Sitel, Kanal 5 dhe Alfa, vetëm një ditë pas ngjarjeve të Kumanovës në 9 dhe 10 maj të vitit 2015.<sup>408</sup> Sitel zbuti linjën e ashpër ndaj LSDM-së pas ardhjes në pushtet të kësaj partie, madje ndryshoi edhe strukturën drejtuese të televizionit duke emëruar në postin e kryeredaktorit, muzikantin Risto Samarxhiev.<sup>409</sup> Drejtori i përgjithshëm i Televizionit është Goran Gligorov.

Sipas të dhënave të Regjistrat Qendror, televizioni Sitel është i regjistruar si biznes i mesëm dhe në vitin 2018 ka pasur të ardhura 7 031 700 euro, shpenzime prej 6 714 600 eurosh dhe një fitim neto prej 303 721 eurosh. Krahasuar me fitimet e vitit 2017 (761 860 euro) fitimet kanë shënuar një rënie prej 60,13%. Në vitin 2018, numri i të punësuarve të paraqitur i këtij televizioni është 141. Nga ana tjetër, televizioni Sitel, si biznes ka në pronësi edhe firma të tjera sikurse shoqërinë ekonomike të interesit (SHEI) *Komiteti për Matjen e Publikut në Republikën e Maqedonisë (së Veriut) – Skopje, Bogman – Skopje, Grenader – Skopje, Asociacionin maqedonas të mediave (Makedonska Mediumska Asociacija) – Skopje, Hotel Sileks – Kratovë dhe TV Sitel 2 - Skopje.*

Sipas të dhënave nga Regjistri Qendror, kompania ka të evidentuar dhënie hipoteke si garanci ose shpallje për ekzekutim procedure përmbarese.<sup>410</sup>

Duhet të theksohet se me mbylljen e televizionit A1, pa ndonjë meritë të veçantë dhe pa ofruar ndonjë risi në tregun mediatik, televizioni Sitel në mënyrë të natyrshme mori vendin e parë në hapësirën e transmetimit në Maqedoni.

\*\*\*

Televizioni Kanal 5 është në pronësi të Emil Stojmenovit (100%) – edhe ai i lidhur ngushtë me politikën. Babai i tij, Boris Stojmenov (ministër i Financave në vitet 1998-1999)<sup>411</sup> ishte një njëri me ndikim në VMRO si dhe në qeverinë VMRO-PDSH të kësaj periudhe. Edhe gjatë përçarjes së VMRO-së kur Stojmenov themeloi partinë “VMRO-Makedonska”,<sup>412</sup> lidhjet me VMRO DPMNE-në mbetën prapëseprapë të konsoliduara. Në vitin 2008, Stojmenov u zgjodh deputet dhe në 2012 e shkriu partinë sërish në VMRO-DPMNE.

Në kuadër të marrëdhënieve të mira me VMRO-në, Emil Stojmenovi (njëri nga djemtë që udhëheq biznesin e televizionit) mori masa të menjëhershme për të ndërruar kryeredaktorin Aco Kabranov në vitin 2009, me Lidija Bogatinovën, nën *redaktimin* e së cilës, sipas të gjitha

Sinisa Jakov Marusic, *Macedonian Editor Accused of Ethnic Hate Speech*, BIRN,

<<https://balkaninsight.com/2014/02/04/macedonian-editor-accused-of-ethnic-hate-speech/>>, [30.4.2019]

<sup>408</sup> ALSAT, *Një ditë pas “Lagjes së Trimave”*, 2.6 milion euro për Sitel, Alfa dhe Kanal 5, <<https://www.alsat-m.tv/235150/>>, [30.4.2019]

<sup>409</sup> Republika.mk, *Sitel mu najde замена на Латас: Познат македонски музичар доаѓа на позицијата главен и одговорен уредник (Sitel i gjen zëvendësim Llatasit: Një muzikant i njohur maqedonas vjen në pozicionin e kryeredaktorit)*, <<https://republika.mk/vesti/makedonija/sitel-mu-najde-zamena-na-latas-poznat-makedonski-muzichar-doagja-na-pozicijata-glaven-i-odgovoren-urednik/>>, [30.4.2019]

<sup>410</sup> Në Regjistrin Qendror qëndron konkretisht si më poshtë; “*Компанијата има евидентирано залог на имот или објава за извршување*” (Kompania ka evidentuar lënie në hipoteke ose shpallje për ekzekutim procedure përmbarese).

<sup>411</sup> Ministria e Financave, *Ish ministrat*, <<https://www.finance.gov.mk/en/node/11>>, [1.5.2019]

<sup>412</sup> Nikolla Osillo, *Istoriја на расколи: Ќе се родат ли нови партии со предзнакот ВМРО (Historia e përçarjeve: A do të lindin parti të reja me parashenjën e VMRO-së)*, E-magazin, <<https://emagazin.mk/istori-a-na-raskoli-e-se-rod-at-li-novi-partii-so-predznakot-vmro-dpmne/>>, [1.5.2019]

raporteve relevante, kjo media u bë propaganduese.<sup>413</sup> Ndjekja e frymës së pushtetit e bëri televizionin Kanal 5 që të përfitonte një pjese të mirë të parave nga fushatat reklamuese qeveritare, projekte të ndryshme ministrore etj. Stojmenovi ka edhe një sërë firmash të tjera, si *Kursimorja Mak-BS* (Штедилница МАК-БС që më vonë u transformua pa u likuiduar në FD Financiski Krediten Centar - ФД Финанциски кредитен Центар БС),<sup>414</sup> *Consulting BS* (Консалтинг БС), *Shtypshkronja BC* (Печатница БС), biznese në ndërtimtari, hoteleri (*TCC Grand Plaza*) etj.<sup>415</sup> Nga skandali i përgjimeve, dhjetëra telefonata dolën në publik mes pronarit të këtij televizionit dhe eksponentëve të ndryshëm të pushtetit, veçanërisht telefonata me shefin e Drejtorisë për Siguri e Kundërzbulim të asaj kohe Sasho Mijallkov me të cilin merreshin vesh për kronika sa më sensacionale rreth arrestimit të Lube Boshkovskit.<sup>416</sup> Kur u ndërrua pushteti, Kanal 5 ndryshoi menjëherë politikën e tij duke e shkarkuar Bogatinovën dhe duke emëruar në vend të saj, Maja Damjanovskën.

Drejtori i televizionit Ivan Mirçevski i kërkoi falje publike LSDM-së (në një intervistë me ministrin Robert Popovski) për sjelljen jo korrekte të televizionit Kanal 5 për vite me radhë kur LSDM-ja ishte në opozitë.<sup>417</sup> Aktualisht, fryma raportuese është më korrekte, pavarësisht se në xhirollogaritë e tij ky televizion përfitoi disa milion euro nga lidhja e kaluar me VMRO-në deri në vitin 2017.<sup>418</sup> Drejtor i përgjithshëm, sipas regjistrimit të televizioneve në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale është Ivan Mirçevski. Ndërkaq, sipas Regjistrimit Qendror, televizioni Kanal 5 është i regjistruar si biznes i mesëm, me të ardhura në vitin 2018 në shumën prej 3 068 700 eurosh dhe harxhime prej 3 034 530 eurosh, me fitim neto prej 4 553 eurosh. Krahasuar me fitimin neto të vitit 2017, (13 270 euro) ky televizion ka shënuar humbje prej 67,48%. Numri i të punësuarve të paraqitur është 138 persona ndërkohë që vetë biznesi Kanal 5 ka nën pronësi edhe shoqërinë ekonomike të interesit (SHEI) *Komiteti për Matjen e Publikut në Republikën e Maqedonisë (së Veriut) – Skopje*, si dhe *Asociacionin maqedonas të mediave (Makedonska Mediumska Asociacija) – Skopje*.

\*\*\*

<sup>413</sup> Sead Rizvanović, *Negociata për rregullimin e medieve dhe luftë për situatë status-quo*, Shërbimi për verifikimin e fakteve në media, <<http://verifikimiifakteve.mk/negociata-per-rregullimin-e-medieve-dhe-lufte-per-situatë-status-quo/>>, [1.5.2019]

<sup>414</sup> FD Financiski Krediten Centar, <<https://fkCBS.com.mk/%D0%B7%D0%B0-%D0%BD%D0%B0%D1%81/>>, [1.5.2019]

<sup>415</sup> Built, *Отворен хотелот „Гранд Плаза“ во Скопје (Hapet hoteli “Grand Plaza” në Shkup)*, <<http://build.mk/otvoren-hotelot-grand-plaza-vo-sko/>>, [1.5.2019]

<sup>416</sup> Brif, *Mijallkov dhe Emil Stojmenov merren vesh për lajm në Kanal5 mbi arrestimin e Boshkovskit*, <<https://www.brief.mk/audio-mijalkov-i-emil-stojmenov-dogov/>>, [1.5.2019]

<sup>417</sup> Libertas, *Mirçevski se izvini za “nanesenite nepravdi”: Ako bilo režim, mislite se rabotelo vo rozevu uslovi (Mirçevski kërkon falje për “padrejtësitë e shkaktuara”): Nëse ishte regjim, mendoni se është punuar në kushte rozë)*, <[https://www.libertas.mk/mirchevski-se-izvini-za-nanesenite-nepravdi-ako-bilo-rezhim-mislite-se-rabotelo-vo-rozevu-uslovi/?utm\\_source=daily.mk&utm\\_medium=daily.mk](https://www.libertas.mk/mirchevski-se-izvini-za-nanesenite-nepravdi-ako-bilo-rezhim-mislite-se-rabotelo-vo-rozevu-uslovi/?utm_source=daily.mk&utm_medium=daily.mk)>, [1.5.2019]

<sup>418</sup> Sipas konferencës për shtyp të LSDM-së, vetëm për 3 vite Kanal5 ka marrë 4 milion euro, por kjo shumë është akoma më e madhe duke marrë parasysh mbështetjen politike të qeverive të VMRO-së që në vitin 2006. Uebfaqja zyrtare e LSDM-së, *Kiračovski: Grujevski dal 13 milioni eвра народни pari na Сител, Kanal5 и Алфа за само 3 години! (Kiračovski: Grujevski i ka dhënë 13 milion euro para të qytetarëve Sitel-it, Kanal5-ës dhe Alfa-s për vetëm 3 vjet)*, <<http://arhiva.sdsM.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=6&articleId=13585>>, [1.5.2019]

Televizioni ALFA, i cili sot është vis a vis me opozitën (VMRO DPMNE-në), ka pasur një kalim të dyshimtë të pronësisë por edhe të politikës redaktuese të tij. Televizioni filloi transmetimet e tij në vitin 2008 dhe ishte në pronësi të *Alfa Skop Eksport-Import* (100%),<sup>419</sup> një shoqëri aksionare me 4 aksionarë; *Fershped-it*, *Evropa-s*, *Makoshped-it* dhe *Tehnometal-it*. Shterjo Nakov, pronar i *Fershped-it* (kompanisë për transport, shpërndarje, terminale doganore) zotëron edhe hotelin “*Aleksandar Palace*”, kantinën e verërave “*Skovin*”, si dhe është aksionar në biznese të tjera si banka, lojëra fati etj. Në vitin 2012, Nakov filloi të kishte probleme me pushtetin e VMRO-së (ai ishte mbështetës i opozitës së asaj kohe, LSDM-së) si dhe me gjykatat, të cilat në shkallën e parë sollën vendim se gjatë privatizimit të kompanisë *Fershped* ishin *shkelur ligjet*. Nakov nxori menjëherë në shitje aksionet e tij, pasi u bind se asnjë nga 3 aksionarët e tjerë nuk donte t’i blinte ato (Nakov ishte gjithashtu aksionar edhe te firmat e tjera përbërëse të *Alfa Skop*). Pas një tentative të dështuar me *Pink TV* në Serbi, aksionet e Nakovit iu shitën një tjetër biznesmeni serb, Veselin Jevrosimoviqit. *Grupi CHS Invest* - i themeluar nga *ComTrade* i Serbisë bleu kështu për vetëm 150 mijë euro 56,9% të aksioneve të televizionit Alfa, vlera reale e të cilit ishte 2,5 milion euro. Ky  *pazar*  kaq i lirë u fsheh për më shumë se 4 muaj nga publiku dhe vetë gazetarët e televizionit. Megjithatë, vendimi i Gjykatës së Apelit për Nakovin ishte çlirues, sepse u rrëzua vendimi i shkallës së parë. Nga ana tjetër, Jevrosimoviqi, një biznesmen *i preferuar* i pushtetit, njihej që prej vitit 2007 në Maqedoni me firmën CT Computers sepse i kishte shitur kompjuterë Ministrisë për Shoqëri Informatike në vlerë prej 15 milion dollarësh<sup>420</sup> në kuadër të projektit “Kompjuter për çdo nxënës”.<sup>421</sup> Me këto para ai iu qas televizionit Alfa si një shpërblim pushtetit të VMRO-së, i cili gjithashtu i akordoi licencën kombëtare këtij televizionit në vitin 2013.<sup>422</sup>

Ky ishte hapi i parë i blerjes jo vetëm të pronësisë por edhe të politikës redaktuese të këtij televizionit. Stafi televiziv përjetoi për disa muaj krizën e kontratave si dhe mbylljen e dy programeve, *Win-Win* të Olivera Trajkovskës si dhe “*Fjalë për fjalë*” (Збор по збор) të Zoran Ivanovit. Kështu, zëri kritik ndaj pushtetit heshti! Me këtë, VMRO DPMNE-ja rumbullakoi sferën ndikuese të saj në media, duke i bërë televizionet e mëdha maqedonase, vegël të saj (përveç *Telmës* dhe *ALSAT-it*). Kur pushteti i VMRO-së do të binte, në vitin 2017 Grupi CHS Invest<sup>423</sup> përjetoi krizën; fillimisht kompania kaloi në duart e Ivo Jovanovskit, por për disa muaj u transferua në drejtimin e Goran Balaqit.<sup>424</sup> Përveç kompanisë serbe që ruan pozitën e saj, në pronësinë e TV Alfa ka hyrë edhe Peter Schatz<sup>425</sup> nga Hungaria, i cili zotëron edhe në një sërë biznesesh të tjera, sikurse portalin “*Ripost Media*”. Schatz ka themeluar firmë në Shkup - “*Target media*” me ndihmën e zyrës së avokatisë “*Çukiq & Markov*” përmes të cilës hyri edhe në pronësi të televizionit.

<sup>419</sup> Bloomberg, *Company Overview of Alfa Skop DOO*,

<<https://www.bloomberg.com/research/stocks/private/snapshot.asp?privcapId=140988973>>, [4.5.2019]

<sup>420</sup> Sase Dimovski, *Secretive Takeover Leaves Macedonian TV's Fate in Dark*,

<<https://balkaninsight.com/2013/01/25/secretive-takeover-leaves-macedonian-tv-s-fate-in-dark/>>, [4.5.2019]

<sup>421</sup> Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë, *Компјутер за секој ученик (Kompjuter për çdo nxënës)*,

<<http://arhiva.mioa.gov.mk/?q=node/1974>>, [4.5.2019]

<sup>422</sup> Radio Evropa e Lirë, *Телевизијата Алфа ја доби националната концесија (Televizioni Alfa merr konsension kombëtar)*, <<https://www.slobodnaevropa.mk/a/24995050.html>>, [4.5.2019]

<sup>423</sup> Inbox, *Клучни играчи во медиумскиот бизнис: Кој ги поседува медиумите во Македонија? (Lojtarë kuçë në biznesin mediatik: Kush i zotëron mediat në Maqedoni?)* <<http://inbox7.mk/archives/4479>>, [4.5.2019]

<sup>424</sup> Prizma, *Промени во сопствеништвото на телевизија Алфа (Ndryshime në pronësinë e televizionit Alfa)*, <<https://prizma.mk/tag/tshs-grup/>>, [4.5.2019]

<sup>425</sup> Prizma, *Унгарец дел од сопствеништвото на „Алфа ТВ“ (Një hungarez, pjesë në pronësinë e TV Alfa-s)*, <<https://prizma.mk/ungarets-del-od-sopstvenishtvoto-na-alfa-tv/>>, [4.5.2019]

Kjo lidhje serbo-hungareze vazhdon t'i përgjigjet linjës pro partiake të VMRO DPMNE-së. Televizioni, në raportimet e tij, ka mbetur thujse megafon i kësaj partie edhe pse shikueshmëria e tij gjithsesi, në totalin e popullatës është gati 2%. Vendet e emisioneve të dikurshme “Win-Win” apo “Fjalë për fjalë” u zunë nga dy emisionet kundërthënëse; “Vo Centar” i Vasko Eftovit dhe “Milenko Nedelkovski Show” i Milenko Nedelkovskit. Drejtor i përgjithshëm i televizionit është Vasko Eftov.

Sipas Regjistrisë Qendror, televizioni ALFA është i regjistruar si biznes i vogël, me të ardhura në vitin 2017,<sup>426</sup> në shumën prej 1 702 380 eurosh dhe harxhime prej 1 671 860 eurosh, me fitim neto prej 27 120 eurosh (krahasuar me televizionet e tjera që janë biznese të mesme – televizioni Alfa ka një xhiro të madhe parash dhe një fitim disa herë më të madh se sa edhe vetë Kanal 5). Krahasuar me fitimin neto të vitit pararendës 2016, (-34 800 euro) ky televizion ka shënuar një kthesë fitimi të madhe. Televizioni ALFA është në pronësi të Shoqërisë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar për Tregti dhe Shërbime ALFA SKOP e cila është gjithashtu nën pronësi të Shoqërisë për shërbime CHS INVEST GROUP – Скопје. Kjo e fundit është në pronësi të Shoqërisë për Tregti dhe Shërbime TARGET Media, e cila është vetë në pronësinë e serbit Goran Balaq. Siç u theksua më sipër, vetë Shoqëria për Tregti dhe Shërbime Target Media është në pronësi të hungarezit Peter Schatz. Numri i të punësuarve të paraqitur është 87 persona (gjithnjë sipas shifrave për vitin 2017) ndërkohë që vetë biznesi i televizionit ALFA ka nën pronësi edhe shoqërinë ekonomike të interesit (SHEI) *Komiteti për Matjen e Publikut në Republikën e Maqedonisë (së Veriut) – Skopje*, si dhe *Asociacionin maqedonas të mediave (Makedonska Mediumska Asociacija) – Skopje*.

\*\*\*

Telma është një tjetër televizion kombëtar privat tokësor i cili gjithashtu është themeluar nga një firmë e privatizuar pas pluralizmit. Telma është në pronësi të *MakPetrol* (100%), e cila aktualisht është kompania më e madhe e shpërndarjes dhe shitjes së karburanteve në Maqedoninë e Veriut. Edhe ky televizion (sikurse Sitel dhe Alfa) u themelua nga njerëz të cilët përfituan nga procesi i privatizimit të kompanive shtetërore. Pronar i televizionit është Andrea Josifovski i cili është aksionari dhe kryetar i bordit të Makpetrol. Ky televizion funksionon që prej vitit 1996, dhe ka një veprimtari më të qartë në këto 23 vite të punës së tij. Gjatë pushteteve të kaluara, Telma nuk ka mbajtur ndonjë linjë të ashpër *pro* ose *kundër*, pasi ka mbijetuar kryesisht nga financat e Makpetrol-it, pavarësisht se procesi dhe mënyra e privatizimit të kësaj kompanie bart gjithashtu dyshime ende sot e kësaj dite.

Nga paratë që pushteti i kaluar ofronte për mediat, në kuadër të fushatave reklamuese, Telma nuk përfitoi thujse asgjë, krahasuar me mediat pro-qeveritare.

Sipas të dhënave të Regjistrisë Qendror, të ardhurat gjatë vitit 2018 të televizionit Telma u regjistruan në shumën e 2 354 340 eurove, shpenzimet në shumën e 2 703 600 eurove dhe me një humbje prej 349 250 eurove. Televizioni numëron 99 të punësuar të paraqitur, dhe sikurse u theksua më sipër, është nën pronësinë e Shoqërisë Aksionare për Shitjen e Naftës dhe Derivateve të Naftës – Makpetrol. Megjithatë, vetë biznesi i televizionit Telma ka nën pronësi edhe shoqërinë ekonomike të interesit (SHEI) *Komiteti për Matjen e Publikut në Republikën e Maqedonisë (së Veriut) – Skopje*, si dhe *Asociacionin maqedonas të mediave (Makedonska Mediumska Asociacija) – Skopje*.

<sup>426</sup> Të dhënat për vitin 2018 nuk janë përditësuar në Regjistrinë Qendror gjatë kohës së përgatitjes së këtij studimi.

Televizioni menaxhohet nga Atanas Kiracovski, drejtor i përgjithshëm dhe njëkohësisht kryeredaktor.

\*\*\*

Televizioni ALSAT (për të cilin u fol në pjesën e mediave shqiptare në Maqedoninë e Veriut) është gjithashtu një televizion privat kombëtar tokësor i cili për nga struktura financiare dhe drejtuese e tij është nën pronësi të *Grupit VEVE*.<sup>427</sup> Ky grup ofron shërbime këshillimi në fushën e ekonomisë dhe energjetikës. ALSAT ruan një linjë më konsistente në politikë, duke kritikuar gjithnjë pushtetin. Gjatë pushtetit të kaluar, në shënjestër të kritikave ishte VMRO DPMNE-ja veçanërisht pas skandalit të përgjimeve. Televizioni ALSAT i transmetonte madje në mënyrë integrale këto përgjime, ashtu sikurse publikoheshin nga opozita. Tani, pas ardhjes në pushtet të LSDM-së, televizioni ALSAT është sërish në pararojë të kritikave për korrigjim të një sërë politikave shtetërore, ekonomike e sociale.

Si gardian i të drejtave të shqiptarëve, ALSAT kanë qenë dy herë më shumë i ndëshkuar financiarisht nga pushteti i kaluar. Nga fushata reklamuese, ALSAT nuk përfitoi thuajse asgjë. Krahasuar me mediat e tjera kombëtare, ALSAT është televizioni me koston më të madhe për shkak të redaksisë dygjuhësore. Televizioni shquhet për shtyllën e informimit – lajmet. Ndërkohë, emisionet “*Rruga Drejt...*”, “*200*”, “*360*” me investigime si dhe “*Magazina Ekonomike*” ofrojnë jo vetëm një diapazon të gjerë të debatit politik, ekonomik, social etj., por edhe një shikueshmëri të garantuar. Në pronësi të televizionit është *Shoqëria për Prodhim, Inxhinieri, Këshillime, Tregti dhe Shërbime VEVE Group* në masën 99,86%, *Ferik Velija* me 0.07% si dhe *Imihane Velija* me 0.07%. Drejtori i Përgjithshëm i Televizionit është Ferik Velija.

\*\*\*

Një tjetër televizion në sferën e medias ishte edhe 1TV i cili e pati marrë licencën për transmetim në mars të vitit 2018.<sup>428</sup> 1TV përflitej gjatë në rrethet gazetareske për mbështetje të pushtetit aktual pasi tubonte edhe ish gazetarë dhe drejtues të njohur – mbështetës të LSDM-së. Ky televizion ishte me licencë kombëtare kabllore dhe ishte në pronësi të *Shoqërisë për Prodhim, Tregti dhe Shërbime BMJ Media Group* (100%) të babait të Bojan Jovanovskit (i njohur si Boki13), Mile Jovanovski.<sup>429</sup> Ndërsa nga të dhënat e Regjistrat Qendror, saktësohet se

<sup>427</sup> Sipas regjistrat të televizioneve në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, VEVE Group që është *shoqëri për prodhim, inxhinieri, konsultim, tregti dhe shërbime* kryeson me 99,85%. Bashkë me të janë edhe Ferik Velija me 0,07% dhe Imihane Velija me 0,07%.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, *Regjistri i operatorëve radiodifuziv që transmetojnë program televiziv (Регистар на радиодифузери што емитуваат телевизиска програма)*,

<<http://avmu.mk/registar-na-televizii/>>, [8.5.2019]

<sup>428</sup> Smartportal, *Нов медиум во етерот – „1TV“ започнува со работа (Media e re në hapësirën transmetuese – “1TV” fillon aktivitetin)*, <[https://www.google.com/search?q=1%D1%82%D0%B2+%D0%BC%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%98%D0%B0&rlz=1C1GCEA\\_enMK835MK835&oq=1%D0%A2%D0%92+%D0%9C%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8&aqs=chrome.1.69i57j0.14862j1j4&sourceid=chrome&ie=UTF-8](https://www.google.com/search?q=1%D1%82%D0%B2+%D0%BC%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%98%D0%B0&rlz=1C1GCEA_enMK835MK835&oq=1%D0%A2%D0%92+%D0%9C%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8&aqs=chrome.1.69i57j0.14862j1j4&sourceid=chrome&ie=UTF-8)>, [10.5.2019]

<sup>429</sup> *Tocka.com.mk, Нова национална телевизија 1TV: Гламур и нова свежина во телевизискиот етер (Televizioni i ri me licencë kombëtare (kabllore) 1TV: Shkëlqim dhe freski në hapësirën transmetuese televizive)*,

1TV kishte edhe dy pronarë të tjerë veç Mile Jovanovskit; Jasna Ercegoviqin dhe Jasna Mandiqin. Drejtore e përgjithshme e televizionit, sipas të dhënave nga regjistri i televizioneve në Agjencinë e Medias, rezultonte Jasna Ercegoviq, ndërsa kryeredaktor ishte Aco Kabranov. Nga të dhënat e Regjistrat Qendror figuronte gjithashtu se 1TV ishte i regjistruar si biznes i vogël dhe për vitin 2018 të ardhurat e tij ishin shënuar në shumën e 637 930 eurove, shpenzimet në 607 530 euro ndërsa fitimi neto në 24 120 euro. Zyrtarisht, kompania kishte të paraqitur 46 të punësuar. Televizioni u mbyll pas aferës së ashtuquajtur “Reket” në fillim të shtatorit të vitit 2019.

\*\*\*

Një media me ndikim në sferën mediatike është edhe 24Vesti (24Вести) - televizion aspirant për licencë *kombëtare tokësore*. Licenca aktuale e tij është *kombëtare kablllore*. Por, në të njëjtën kohë, ekzistojnë dyshime serioze për konflikt interesash me operatorin kabllorik *Telekabel* pasi vetë televizioni është në pronësi të *Cable 24 Link (Austri)* në masën 100%. Agjencia e Mediave ka konstatuar se 24Vesti financohet kryesisht nga kompania Telekabel edhe pse Këshilli i Agjencisë votoi se një gjë e tillë nuk përbën shkelje ligjore. Ndërkaq, kryeredaktori i televizionit Mlladen Çadikoski u zgjodh kryetar i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, gjë që ngriti dyshime lidhur mbi veprimtarinë e lirë dhe korrekte të SHGM-së. Kjo çoi në dorëheqjen de-jure të tij nga posti i kryeredaktorit. 24Vesti është i njohur për linjat e tij pro-qeveritare dhe mbështetës i LSDM-së. Ky televizion tuboi një numër gazetarësh nga formacioni i dikurshëm i redaksisë së televizionit A1 dhe në skemën programore të tij bien në sy lajmet si dhe emisioni “Analiza 24” me tema politike e ekonomike.

Sipas të dhënave të Regjistrat Qendror, 24Vesti – Shtip është i regjistruar si biznes i vogël dhe nga qarkullimi për vitin 2018, numëron 1 446 900 euro të ardhura, 1 486 500 euro shpenzime, me një humbje prej 39 600 eurosh. Krahasuar me humbjen e vitit 2017, tendenca e humbjeve shënohet në -88,30%. Nga 71 të punësuar në vitin 2016, ky televizion zgjeroi oreksin për të pushtuar tregun mediatik menjëherë pas ardhjes në pushtet të LSDM-së, duke e çuar numrin e të punësuarve në 102, pavarësisht se si biznes i vogël kufiri minimal i numrit të të punësuarve është te 40 të punësuarit. Nën të njëjtën kupolë të Cable 24 Link janë edhe firmat me të njëjtën adresë; Niko Trans – Shtip, Zlatev Inzhiniring (Engineering) - Shtip, Shoqëria për Tregti dhe Shërbime Veteks Group – Shtip, Mangala – Shtip.

Drejtore e përgjithshme e televizionit është Sonja Stojanova.

\*\*\*

Mediat në Maqedoninë e Veriut janë një *materie* që merr formë ashtu sikurse formësohen edhe marrëdhëniet e pronarëve të tyre me politikën. Ai që ka rëndësi *parësore* për mediat, në mënyrë që ato të mbijetojnë, është *biznesi*... ndërkohë që bindjet politike, si shkak i mëvetësishëm, janë shumë më të largëta për t’u marrë në konsideratë. Marrëdhënia biznesore është jetësore në rregullimin e sferës mediatike, sidomos kur edhe fryma vetërregulluese, trupat e pavarur, ligji etj., nuk zbatohen si duhet. Në mediat e Maqedonisë së Veriut, sikurse theksuam më sipër, ka biznese të dyshimta, qendra influencash të dyshimta, ka punonjës mediatikë që nuk i

---

<<https://tocka.com.mk/vesti/264941/nova-nacionalna-televizija-1tv-glamur-i-nova-svezina-vo-televiziskiot-eter>>, [10.5.2019]

marrin pagat, nuk janë të paraqitur në Entet për Sigurime Shëndetësore e Pensionale, për të mos folur pastaj për *mediat online dhe portalet* të cilat nuk janë të rregulluara aspak me ligj. Një gjë e tillë i lë atyre hapësirë për shpifje, ofendime e nxitje të urrejtjes ndëretnike, ndaj grupeve të margjinalizuara e kështu me radhë.

Politika, si ajo e kaluar (me VMRO-në) dhe ajo e tanishme (me LSDM-në) – referuar vitit 2019 që po flasim – është sërish ajo që dikton mënyrën e funksionimit të mediave, dhe pastaj mediat e manifestojnë këtë të objektiviteti që i ofrojnë opinionit publik.

Për të krijuar një qëndrim më konkret, mjaftojmë të krahasojmë dy raporte mbi lirinë e medias, gjatë dy pushteteve.

Sipas raportit mbi lirinë e medias (indeksi i World Press Freedom) i “*Reporterëve pa Kufij*” (Reporters without boarder), në vitin 2006 (kur VMRO DPMNE-ja erdhi në pushtet), Maqedonia e Veriut renditej e 46-ta nga 168 vende, 3 vende më poshtë se sa në vitin 2005 (kur në pushtet ishte LSDM-ja).<sup>430</sup> Në vitin 2014 (kur në pushtet ishte ende VMRO-ja, në prag të daljes në publik të përgjimeve që do e çonin vendin në qeveri teknike pas marrëveshjes së Përzhinës), liria e medias në Maqedoni u rendit në vendin e 123-të, duke shënuar rënie tejet të madhe prej 87 vendesh.<sup>431</sup> Në vitin 2019, indeksi i lirisë së medias e renditi Maqedoninë në vendin e 95-të,<sup>432</sup> një ngjitje prej 14 vendesh krahasuar me vitin 2018, që për “*Reporterët pa Kufij*” cilësohej si “*Slight improvement*” (përkth. *Përmirësim i lehtë*).<sup>433</sup> Kjo rritje, sipas të dhënave të të njëjtës organizatë, filloi vetëm në vitin 2017 me ndryshimin e pushtetit. Rezultate pritet të japë edhe ligji i ri i medias, i miratuar në fillim të vitit 2019.

Gjithsesi, Maqedonia mbetet ende në gjendje të mjerueshme për sa i përket lirisë së medias, madje vlen të nënvizohet se *edhe sikur shteti të mos influencojë media të caktuara, janë pronarët e mediave ata që tentojnë të flirtojnë me shtetin për shërbime të tjera në favor të bizneseve të tyre!*

Vite më parë, ish Shefi i Drejtorisë për Siguri e Kundërzbulim Sasho Mijallkov – një nga njerëzit më me ndikim në pushtetin e VMRO DPMNE-së – në një nga përgjimet me ish kryeredaktorin e televizionit Sitel, Dragan Pavloviq-Llatas theksonte se “*me 2 milion euro sa iu jepte në vit televizioneve pro-pushtetit, ai do kishte hapur më mirë një televizion të tijin* (sepse ishte ende i pakënaqur nga shërbimet që këto televizione i bënin pushtetit të atëhershëm).<sup>434</sup>

Nëse praktikat e tilla të pushtetit si dhe *klientelizmi apo servilizmi* i mediave do të vazhdojë ende kundrejt pushtetit, atëherë Maqedonia e Veriut do të jetë në kufijtë e keqardhjes për media të lirë, korrekte, korrigjuese të pushtetit apo promovuese e aspiratave të qytetarëve.

Mediat dhe bizneset e pronarëve të tyre vazhdojnë të punojnë... por historia u vjen pas!

<sup>430</sup> Jeannette Goehring, *Nations in Transit 2007: Democratization from Central Europe to Eurasia*, (Zhidas Daskalovski) Freedom House 2007, Hungari, faqja 461, <<https://books.google.mk/books?id=drjJRxs2HRMC&pg=PA461&dq=sitel+tv+macedonia&hl=en&sa=X&ved=0ahUKewjH0ZjQ083hAhVDmYsKHfe-C2oQ6AEINDAC#v=onepage&q=sitel%20tv%20macedonia&f=false>>, [12.5.2019]

<sup>431</sup> ALDA – European Association for Local Democracy, *Mediat e lira dhe liria e të shprehurit në Maqedoni (Free media and freedom of expression in Macedonia)*, <[http://www.alda-europe.eu/newSite/news\\_dett.php?id=906](http://www.alda-europe.eu/newSite/news_dett.php?id=906)>, [12.5.2019]

<sup>432</sup> ALSAT, *Reporterë pa kufij: Gabim informatik në të dhënat për vitin 2018*, <<https://www.alsat-m.tv/reportere-pa-kufij-gabim-informatik-ne-te-dhenat-per-vitin-2018/>>, [12.5.2019]

<sup>433</sup> Reporterët pa kufij (Reporters without borders), *Indeksi për lirinë e medias në botë (World Press Freedom Index)*, <<https://rsf.org/en/republic-north-macedonia>>, [12.5.2019]

<sup>434</sup> Biseda: Llatasi me Sasho Mijallokovin (Разговор: Латас со Сашо Мижалков), <<https://www.youtube.com/watch?v=s005w6V12r4&feature=youtu.be>>, [12.5.2019]



#### 5.1.4.1 Zhvillimi negativ i ish mediave të pavarura të shtypura të WAC-it.

Më shumë se sa media elektronike, ajo e shtypura është në gjendje akoma më të mjerueshme në Maqedoninë e Veriut. Në historinë e mjeteve të komunikimit, fati i tre gazetave *Dnevnik*, *Utrinski Vestnik* dhe *Vest* do të mbeten një *njollë e zezë* në sferën mediatike.

*Dnevnik* ishte gazeta e parë e pavarur në Maqedoninë e Veriut, e themeluar në vitin 1996 nga Branko Gerovski, Aleksandar Damovski dhe Mile Jovanovski që krijuan *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "Krug"*.<sup>435</sup> Në vitin 1998, gazeta *Dnevnik* u ble nga *Fondi Amerikan i Investimeve SEAF (i mbështetur nga EBRD)*. "Krug", së bashku me firmën tjetër "Evropa '92", themeluan shtypshkronjën "DE" ku printohej gazeta. Bashkë me disa suplementare si *Antena*, *Vikend* dhe *Ogllas*, kjo gazetë shënoi një sukses veçanërisht në vitin 2002-2003 me një tirazh që arriti në 100 000 gazeta të shitura në ditë.

Ndërkaq, gazeta *Utrinski Vesnik* u themelua në vitin 1999 dhe nën kryesimin e Erol Rizaov shënoi historinë e saj në Maqedoni në fushën e medias të printuar. Gazeta ishte krijuar gjithashtu nga një grup gazetarësh por pastaj u mbështet nga magnati i çelikut Trifun Kostovski. *Utrinski* mbështetej nga LSDM-ja (në pushtet deri në 2006) pavarësisht se gazeta tentonte të mos dukej drejtpërdrejt e lidhur me këtë parti.<sup>436</sup>

Një vit më vonë, në vitin 2000, numrin e parë në qarkullim e lëshoi edhe gazeta *Vest*. Kjo gazetë u themelua nga gazetari Goran Mihajllovski, pas të cilit u vendos kompania Fershpel e Shterjo Nakovit. Me formatin e saj tabloid, kjo gazetë ishte akoma më e pavarur se gjithë të tjerat në tregun e asaj kohe në Maqedoni.<sup>437</sup>

Gjithsesi, këto tre gazeta, të formuara nga grupe gazetaresh, ishin gazeta pararojë në shtypin e Maqedonisë. Në vitin 2002 u shfaq grupi mediatik *Westdeutsche Allgemeine Zeitung* (WAZ) i cili filloi blerjen e të tri gazetave, njëra pas tjetrës, në harkun kohor të një viti. Sërgjan Kerim, falë miqësisë së ngushtë me Bodo Hombach - ish kryesues i Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore - e solli në Maqedoni degën e WAZ-it nga Serbia (ku Kerim drejtonte gazetën *Politika* nën të njëjtin grup).<sup>438</sup>

Në analogji me rastin e pronësisë së televizionit ALFA, të njëjtin fat do të kishin edhe këto tre gazeta. Grupi WAZ filloi të bëhej i afërt me VMRO, saqë Kerim<sup>439</sup> në vitin 2006 u

<sup>435</sup> Michael Biggins, Janet Crayne, *Publishing in Yugoslavia's Successor States*, The Haworth Press, SHBA 2000, faqja 197, <[https://books.google.mk/books?id=0g1CIRHeO4YC&pg=PA197&lpg=PA197&dq=krug+doo+Makedonija&source=bl&ots=FXyQ6R1NOU&sig=ACfU3U22oOkjAqoHtlKsYhWJPF0Kn53EMg&hl=en&sa=X&ved=2ahUKEwiL45q\\_iM7hAhVvoYsKHeg2CrgQ6AEwAHoECAkQAQ#v=onepage&q=krug%20doo%20Makedonija&f=false](https://books.google.mk/books?id=0g1CIRHeO4YC&pg=PA197&lpg=PA197&dq=krug+doo+Makedonija&source=bl&ots=FXyQ6R1NOU&sig=ACfU3U22oOkjAqoHtlKsYhWJPF0Kn53EMg&hl=en&sa=X&ved=2ahUKEwiL45q_iM7hAhVvoYsKHeg2CrgQ6AEwAHoECAkQAQ#v=onepage&q=krug%20doo%20Makedonija&f=false)>, [15.5.2019]

<sup>436</sup> Balkanmedia, *Media and Democracy in South East Europe, Gazetat e përditshme (Daily Newspapers)*, <<https://www.kas.de/web/balkanmedia/newspapers5>>, [15.5.2019]

<sup>437</sup> Po aty.

<sup>438</sup> Dimitar Bechev, *Historical Dictionary of the Republic of Macedonia*, The Scarecrow Press, SHBA 2009, faqja 115, <[https://books.google.mk/books?id=iIGfCf4Ao4C&pg=PA115&lpg=PA115&dq=the+history+of+Dnevnik,+Vest+and+Utrinski&source=bl&ots=VxHXBOIYmV&sig=ACfU3U2XhAxuOrWCKuPh0CbOdQdQ1VFqMw&hl=en&sa=X&ved=2ahUKEwj-qemq\\_M3hAhUKposKHdwtAOWQ6AEwB3oECAkQAQ#v=onepage&q=the%20history%20of%20Dnevnik%20and%20Utrinski&f=false](https://books.google.mk/books?id=iIGfCf4Ao4C&pg=PA115&lpg=PA115&dq=the+history+of+Dnevnik,+Vest+and+Utrinski&source=bl&ots=VxHXBOIYmV&sig=ACfU3U2XhAxuOrWCKuPh0CbOdQdQ1VFqMw&hl=en&sa=X&ved=2ahUKEwj-qemq_M3hAhUKposKHdwtAOWQ6AEwB3oECAkQAQ#v=onepage&q=the%20history%20of%20Dnevnik%20and%20Utrinski&f=false)>, [15.5.2019]

<sup>439</sup> Sërgjan Kerim më vonë themeloi edhe kompaninë "Mireks Plus" me të cilën do të ndante një pjesë të aksioneve të kompanisë "Grafički Centar" (Графички центар) që ishte pronare e MPM-së (kjo e fundit mori në pronësi këto gazeta). Vetë firma "Grafički Centar" përbëhej nga dy pronare "Телеграф" e Jevrosimoviqit (me pjesëmarrje prej 3,4 milion eurosh) dhe "Mireks" (me 1,7 milion euro).

caktua nga qeveria e re ambasador në Kombet e Bashkuara. Ishte e qartë se gazetatat nuk do të kishin më frymën e lirë të dikurshme me të cilën ishin krijuar nga grupimet e gazetarëve. Në vitin 2004, Gerovski e braktisi Dnevnik-un dhe në vend të tij erdhi Katerina Bllazhevaska. Ndërsa politika shtrëngohej, tre gazetatat ranë në pronësi të MPM-së, (*Media Print Makedonija*) si degë e “Orka Holding” në vitin 2012. MPM-ja ishte në pronësi të magnatit pro-qeveritar Jordan (Orce) Kamçev (mik i afërt i ish shefit të Drejtorisë për Siguri e Kundërzbulim, Sasho Mijallkov) i cili paditet nga Prokuroria Speciale për një sërë shkeljesh (rasti “Perandoria”).<sup>440</sup> Nga ana tjetër, 50% të aksioneve në këto gazeta e posedonte edhe magnati serb Veselin Jevrosimoviqi i grupit *CHS Invest* që bleu televizionin ALFA në vitin 2013.<sup>441</sup> Drejtorët dhe kryeredaktorët e këtyre gazetave u ndërruan, ndërkohë që edhe gazeta Vest, e njohur si më e pavarur në politikën e saj redaktuese, kaloi nën drejtimin e Goran Petrevski, ish gazetar i televizionit A1 që ndërroi thellësisht bindjen politike ndaj VMRO-së. (Ai u komandua në këtë detyrë, pas ushtrimit të detyrës së kryeredaktorit në televizionin publik TVM1).<sup>442</sup>

Në maj të 2017, gjykata vendosi për falimentimin e kompanisë mëmë “Graficki Centar”. Pak përpara kësaj procedure, një nga magnatët e MPM-së, Aleksandar Dinev hapi një firmë re “Media Print” duke shpallur madje konkurs për 100 gazetarë e redaktor, për kalimin e këtyre mediave në formë elektronike. Një pjesë e tyre konkurruan, por më shumë se gjysma, jo!

Kështu, gazetatat filluan të shuheshin një e nga një; Utrinski Vesnik dhe Vest publikuan numrat e fundit të tyre në 29 prill të vitit 2017, ndërsa Dnevnik në 13 korrik të të njëjtit vit duke lënë në rrugë edhe 60 punonjësit e fundit të kësaj kompanie.<sup>443</sup> Imazhi dhe ndikimi i gazetave edhe ashtu kishte rënë në mënyrë drastike viteve të fundit, për shkak të rrëzimit të standardeve profesionale në shërbim të interesave dhe politikave të qeverisë së VMRO-së.<sup>444</sup>

Prizma, „Utrinski vesnik“ и „Vest“ излегоа за последен пат (“Gazeta Utrinski” dhe “Vest” dolën për herë të fundit), <<https://prizma.mk/utrinski-vesnik-vest-izlegoa-za-posleden-pat/>>, [15.5.2019]

<sup>440</sup> Orce Kamçev ishte njëri nga pronarët e MPM-së dhe njihet në opinionin gazetaresk si mbështetësi dhe financuesi më i madh i fushatave të VMRO-së (në zgjedhjet lokale të vitit 2013 dhuroi 252 843 euro në VMRO) ndërkohë që emri i tij lidhet edhe me firmat Eksiko. I akuzuar bashkë me Mijallkovin për pastrim parash, Kamçev kishte krijuar kompani *offshore* në Ishujt Sejshelle, Panama, Belize etj., duke e dëmtuar buxhetin e shtetit me përfitime personale në 10 milion euro.

ALSAT, *PSP: Kamçev dhe Mijallkov kanë pastruar paratë nëpër “off-shore” kompani*, <<https://www.alsat-m.tv/psp-kamcev-dhe-mijallkov-kane-pastruar-parate-neper-ofshor-kompani/>>, [15.5.2019]

<sup>441</sup> Disa të dhëna mbi kryqëzimin e pronësive mund t’i shihni te pronësia e portalit Telegraf kur tre manjatët tentuan kalimin digjital on-line të këtyre gazetave menjëherë pas shpalljes së mbylljes së tyre nga formati klasik.

Mediapedia, *Kerim, Kamçev и Јевросимовиќ (Kerim, Kamçev dhe Jevrosimoviќ)*,

<<http://mediapedia.tamijov.webfactional.com/sopstvenici/kerim-evrosimovi-i-kamchev>>, [15.5.2019]

<sup>442</sup> Fokus, *ЗНМ: МРТ изврши брутална манипулација за дневно-политички потреби! (SHGM: MRT bën manipulim brutal për nevoja ditore politike)*, <[http://fokus.mk/znm-mrt-izvrshi-brutalna-manipulatsija-za-dnevno-politichki-potrebi/?utm\\_source=rss&utm\\_medium=rss&utm\\_campaign=znm-mrt-izvrshi-brutalna-manipulatsija-za-dnevno-politichki-potrebi](http://fokus.mk/znm-mrt-izvrshi-brutalna-manipulatsija-za-dnevno-politichki-potrebi/?utm_source=rss&utm_medium=rss&utm_campaign=znm-mrt-izvrshi-brutalna-manipulatsija-za-dnevno-politichki-potrebi)>, [16.5.2019]

<sup>443</sup> Tocka.com.mk, “Дневник” згасна: Денес излезе и последниот број, а од утре нема да се печати (Shuhet “Dnevnik”: Sot doli edhe numri i fundit, ndërsa nga nesër nuk do të shtypet më),

<<https://tocka.com.mk/vesti/234941/intervju>>, [16.5.2019]

<sup>444</sup> Deutsche Welle, *Згаснува „Дневник“, фирмата оди во ликвидација (Shuhet “Dnevnik”, firma shkon në likuidim (falimentim))*,

<<https://www.dw.com/mk/%D0%B7%D0%B3%D0%B0%D1%81%D0%BD%D1%83%D0%B2%D0%B0-%D0%B4%D0%BD%D0%B5%D0%B2%D0%BD%D0%B8%D0%BA-%D1%84%D0%B8%D1%80%D0%BC%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%BE%D0%B4%D0%B8-%D0%B2%D0%BE-%D0%BB%D0%B8%D0%BA%D0%B2%D0%B8%D0%B4%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0/a-39231814>>, [16.5.2019]

Arsyeja zyrtare e çuarjes së firmës në falimentim ishte *vështirësia financiare*. Firma ishte mbajtur mirë gjatë pushtetit të kaluar, por me ardhjen e LSDM-së në pushtet, mbijetesa financiare e MPM-së do të ishte më e vështirë. Edhe përpjekja e Media Print për kalimin e gazetave në formë *elektronike* dështoi plotësisht (u morën zyrat e reja dhe u testua forma elektronike e gazetave por ato nuk dolën asnjëherë on-line për publikun e gjerë), duke i dhënë një grusht të fortë sferës mediatike në Maqedoninë e Veriut.

Aktualisht, në fushën e shtypit të shkruar në Maqedoninë e Veriut funksionojnë gjithnjë e më pak gazeta ditore, javore, të përdyjavshme, mujore etj. Sipas regjistrimit të botuesve të mediave të shtypura, numri i përgjithshëm në gjithë vendin është vetëm 38. Nga ato, bien në sy vetëm 4 gazeta të përditshme: “Nova Makedonija”, “Sloboden Peçat”, “Veçer” dhe “Koha”. Me ndikim renditen edhe dy revistat “Kapital” dhe “Fokus”. Në 2019, pas negociatash me qeverinë, pronarët e këtyre gazetave i varin ende shpresat te subvencionimi i shtypjes së tyre.<sup>445</sup> Shoqata e sapokrijuar e Mediave të Shkruara ia vinte fajin qeverisjes së kaluar të VMRO-së. Kryetari i saj, Lirim Dullovi (Drejtor i gazetës Koha) thoshte në vitin 2017 se *“pas 11 vitesh kaos të krijuar në mediat e shkruara, për herë të parë përfaqësuesit e mediave të shkruara në Maqedoni kërkojnë me Ligj që shteti të subvencionojë gjysmën e shpenzimeve që bëhen për shtyp dhe distribuim”*.<sup>446</sup> Zgjidhja erdhi vetëm 2 vjet më vonë, ndërkohë që mbetet të shihet mbijetesa reale e mediave të shtypura. Një pjesë e përfaqësuesve të mediave shohin dyshime te kjo praktikë, jo vetëm për varësinë e shtypit të shkruar nga shteti, por edhe te krijimi i precedentit se në rast të borxheve, shteti duhet t’u ofrojë garanci edhe subjekteve të tjera që do të vijnë në situatë të njëjtë borxhesh apo mbijetese financiare.

Gjithsesi, historia e shtypit të shkruar në Maqedoni do të mbajë mend gjatë rastin e tre gazetave të WAZ (siç thirren ende e kësaj dite), atë të blerjes politike të shtypit, atë të emërimit të komanduar të njerëzve pinjollë të pushtetit si dhe atë të përdorimit të gazetarëve për propagandë politike në favor të partisë. Opinioni mediatik ishte tronditur njëherë në vitin 2004 nga rasti “Fabrika”.<sup>447</sup>

Në ujërat e tranzicionit, edhe shtypi i shkruar është në të njëjtën anije me gjithë pjesën tjetër të mediave, dhe në një udhëkryq mes vet-rregullimit, varësisë nga politika dhe kupolës së BE-së për një veprimtari të lirë (për të cilat do të flasim në kapitullin e mëposhtëm).

<sup>445</sup> Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Министерот Поповски: Владата на Република Македонија останува посветена на силната поддршка за плурализмот и за обезбедување на средина за одржлив развој на медиумите (Ministri Popovski: Qeveria e Republikës së Maqedonisë mbetet e përkushtuar për një mbështetje të fortë ndaj pluralizimit dhe për sigurimin e një mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm të mediave)*, <<https://vlada.mk/node/16574>>, [16.5.2019]

<sup>446</sup> Koha, *Shteti të mbështet mediat e shkruara*, <<https://www.koha.mk/shteti-te-subvencioje-mediat-e-shkruara/>>, [16.5.2019]

<sup>447</sup> Në vitin 2004, një grup gazetarësh nën drejtimin e Petar Arsovskit (analist) dhe Zoran Jaçev “nga “Transparenca Maqedoni” e Sllagjana Tesevës” shkruanin tekste për llogari të LSDM-së. Skandali doli në vitin 2006. Mes gazetarëve të përfolur në këtë “fabrikë” (një shtëpi afër qeverisë që shkruante lajmet në favor të LSDM-së opozitare të asaj kohe) ishin edhe Borjan Jovanovski, Sabina Fakiq, German Filkov, Goran Temenugov etj. Një rast tjetër që përmendet si gazetari në shërbim të shtetit ishte edhe i Branko Gerovskit që redaktonte gazetën policore të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Netpress, *Аферата „Фабрика“ - доказ за фабрикуваното новинарство на СДСМ (Afera “Fabrika” – dëshmi për fabrikimin e gazetarisë nga LSDM-ja)*, <<https://netpress.com.mk/aferrata-fabrika-dokaz-za-fabrikuvanoto-novinarstvo-na-sdsm/>>, [16.5.2019]

## 6. KAPITULLI IV

### 6.1. Rregullimi i fenomenit të raportimit të dyzuar mediatik

Diferencimi etnik i shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, sikurse u theksua në kapitujt e mësipërm, daton shumë herët. Pavarësisht konceptit të *bashkim-vëllazërimit*, dallimi ka ekzistuar që në periudhën socialiste e cila u trondit nga demonstratat e vitit 1968 në Tetovë kur shqiptarët u ngritën kundër *dominimit etnik e kulturor* (etnocentrizmit) maqedonas. Shqiptarët nuk iu trembën sistemit një-partiak i cili nuk lejonte pluralizmin politik e aq më pak pluralizmin e mendimit për komunitetet, në mënyrë që të kërkonin të drejtat që u takonin sikurse u ka hije demokracive bashkëkohore.

Dominimi i popullit shumicë ishte ngulitur që në kushtetutën e parë të vitit 1991, me pavarësinë e vendit. Ajo i la shqiptarët në një gjendje *jo të barabartë* me maqedonasit, dhe u bë burimi kryesor i revoltave të njëpasnjëshme që do të konkretizoheshin me konfliktin e armatosur të vitit 2001. Pavarësisht se maqedonasit fajësojnë ende shqiptarët për konfliktin, politikanët shqiptarë, analistët por edhe vetë komuniteti shqiptar thotë se konflikti erdhi *natyrshëm* dhe si *nevojë*, për shkak të mohimit të kërkesave të shqiptarëve për të drejta të barabarta. Kushtetuta (në komunizëm) i klasifikonte shqiptarët si *kombësi*, u mohonte të drejtën e gjuhës, të arsimimit të lartë shqip, atë të përdorimit të simboleve kombëtare etj., ndërkohë që shteti *dominues* dhe *etnocentrik* maqedonas ushtronte presion të vazhdueshëm *policor* ndaj çdo revolte të shqiptarëve.

Kjo sjellje si dhe proceset e montuara e *përçanë* shoqërinë multi-etnike në Maqedoninë e Veriut.

*Klasa politike maqedonase jo vetëm që nuk pranonte të drejta të barabarta për shqiptarët, natyrale (të drejta të barabarta që nga lindja), por nuk ishte e gatshme të pranonte as zgjerim të të drejtave për komunitetin shqiptar.*

Pikërisht, ashtu sikurse zhvillohej jeta politike dhe shoqërore në Maqedoninë e Veriut, ashtu zhvillohej edhe media. Sikurse përmendëm në *raportimin mediatik socialist*, me demonstratat e Tetovës por edhe me raportimin gjatë konfliktit të vitit 2001, dyzimi i medias filloi të trasonte një rrugë pa kthim.

Ky raportim i dyzuar mediatik<sup>448</sup> zhvillohet edhe sot, pavarësisht se me nota më të buta.

Shumë kërkesa të shqiptarëve janë përmbushur, madje, sipas klasës politike shqiptare në pushtet, Marrëveshja e Ohrit – dokumenti i dalë nga konflikti i vitit 2001 – është përmbushur tashmë (viti 2019). Ky dokument i cili u dha *garancinë* maqedonasve për mosndarjen e shtetit (pra, ruajtjen e karakterit unitar të shtetit) si dhe garancinë se qëllimet politike të shqiptarëve nuk do të synoheshin asnjëherë më *përmes dhunës* (parimi numër 1 dhe 2 i marrëveshjes), nga ana tjetër u garantoj njëkohësisht shqiptarëve *jo-diskriminimin* (barabarësinë që nuk është arritur ende) dhe përfaqësimin e drejtë në të gjitha institucionet e shtetit, arsimimin në gjuhën e tyre amtare dhe përdorimin e gjuhëve (me Ligjin e ri për Përdorimin e Gjuhëve)<sup>449</sup>, manifestimin e identitetit kombëtar si dhe zhvillimin e pushtetit lokal të decentralizuar.<sup>450</sup>

<sup>448</sup> Sqarim! Më poshtë do të mësoni kuptimin e zbrëthyer të këtij termi dhe përdorimin ekskluziv të tij për qëllim të këtij studimi.

<sup>449</sup> Ligji për Përdorimin e Gjuhëve u miratua në janar të vitit 2018, pa praninë e opozitës, e cila kundërshtonte jo vetëm dispozitat që shprehnin zgjerim të përdorimit të gjuhës shqipe, por edhe mënyrën e miratimit të ligjit (me flamur evropian). Në dhjetor 2019, Ligji mori vërejtje nga Komisioni i Venecias me notimin se Maqedonia e Veriut

Procesi i përmbushjes së të drejtave të shqiptarëve, realisht vazhdon ende edhe sot e kësaj dite, pavarësisht se tani është shuar edhe vetë Sekretariati për Zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit, i cili u shndërrua në Ministri për Sistem Politik dhe Marrëdhënie mes Bashkësive.<sup>451</sup> Çështja e përdorimit të gjuhës (ligj i kontestuar gjatë – i miratuar për të dytën herë nga Kuvendi pas refuzimit të dekretimit nga ana e presidentit të atëhershëm Gjorge Ivanov)<sup>452</sup> nuk pritet të përmbillet thjesht me krijimin e Agjencisë për Përdorimin e Gjuhëve si dhe Inspektoratin e saj.<sup>453</sup> Sikurse ndodh shpesh, edhe ky ligj u miratua si *marrëveshje politike* – kusht i partive për koalicion, dhe pa një analizë të thellë të burimeve njerëzore dhe financiare për zbatimin e tij (vërejtje të Komisionit të Venecias).<sup>454</sup>

Po ashtu, përfaqësimi është ende i mjerë në disa segmente shtetërore. Për herë të parë në vitin 2017 u caktua një ministër i Brendshëm në qeverinë teknike të Përzhinës si dhe kryetari i parë shqiptar i Parlamentit (edhe pse zgjedhja e tij në ngjarjet e përgjakshme në 27 prill të vitit 2017 do të nxiste jo vetëm krizë ndëretnike por edhe mes vetë maqedonasve për shkak të politizimit të ashpër të shoqërisë).<sup>455</sup> Akoma më i mjerë është përfaqësimi, veçanërisht në struktura të caktuara të sigurisë. Ende përjetohet fryma anti-shqiptare, madje në të kaluarën janë shënuar edhe akte që kanë lëkundur rëndë pozitat e shtetit multi-etnik, sikurse rrahje nëpër autobusë vetëm për shkak se flitej shqip, djegie biznesesh shqiptare (në Nerez të Shkupit), shkarravitje të tabelave në gjuhën shqipe e dhjetëra raste të tjera.

Pavarësisht zgjerimit të të drejtave politike dhe juridike të shqiptarëve, në këtë kohë paqeje ku jetojmë, media sërish ndahet në taborë; atë që sheh si parësore etninë maqedonase, dhe atë tjetrën që ka në fokus parësor shqiptarët, e pastaj maqedonasit!

Megjithatë, këto zhvillime, duke filluar nga të drejtat e njeriut, e drejta e shprehjes, e drejta për informim, liria e medias, lajm-bërja korrekte dhe diversiteti i raportimit, do t'i shohim të konkretizuara me ligje, konventa si dhe me shembuj konkret, më poshtë në këtë kapitull.

nuk ka kapacitet për ta përmbushur atë, veçanërisht në gjyqësor dhe administratë, si dhe nuk ka burime kuadrore dhe financiare për t'ia dalë mbanë me zbatimin e tij.

<sup>450</sup> SIOFA, *Marrëveshja Kornizë e Ohrit*, <[http://www.siofa.gov.mk/data/file/Ramkoven\\_dogovor\\_al.pdf](http://www.siofa.gov.mk/data/file/Ramkoven_dogovor_al.pdf)>, [20.11.2019]

<sup>451</sup> Sipas normativës ligjore të përcaktuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kjo ministri është përgjegjëse për funksionimin e sistemit politik, realizimin e mëtejshëm të obligimeve që rrjedhin nga Marrëveshja Kornizë (e Ohrit) përshi realizimin e buxhetit, gjuhëve, etj.,

Министерство за политички систем и односи меѓу заедниците (Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie mes Bashkësive), <<https://vlada.mk/node/18376>>, [20.11.2019]

<sup>452</sup> ALSAT, *Në atmosferë të tensionuar Kuvendi miratoi Ligjin për gjuhët*, <<https://www.alsat-m.tv/ne-atmosfere-te-tensionuar-kuvendi-miratoi-ligjin-per-gjuhet/>>, [20.11.2019]

<sup>453</sup> ALSAT, *Ligji për përdorimin e gjuhëve avancon përdorimin e shqipes*, <<https://www.alsat-m.tv/zbatimi-i-ligjit-per-perdorimin-e-gjuheve/>>, [21.11.2019]

<sup>454</sup> ALSAT, *Komisioni i Venecias rekomandon rishqyrtimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve*, <<https://www.alsat-m.tv/https-www-alsat-m-tv-komisioni-i-venecias-rekomandon-rishqyrtim-te-ligj-per-perdorimin-e-gjuheve/>>, [21.11.2019]

<sup>455</sup> Deutsche Welle, *211 години затвор за крвавиот упад во Собранието на 27 април, (211 vite burg për sulmin e përgjakshëm në Kuvend më 27 prill)*, <<https://www.dw.com/mk/211-%D0%B3%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D0%BD%D0%B8-%D0%B7%D0%B0%D1%82%D0%B2%D0%BE%D1%80-%D0%B7%D0%B0-%D0%BA%D1%80%D0%B2%D0%B0%D0%B2%D0%B8%D0%BE%D1%82-%D1%83%D0%BF%D0%B0%D0%B4-%D0%B2%D0%BE-%D1%81%D0%BE%D0%B1%D1%80%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D0%B5%D1%82%D0%BE-%D0%BD%D0%B0-27-%D0%B0%D0%BF%D1%80%D0%B8%D0%BB/a-47934820>>, [21.11.2019]

## 6.1.1 Liria e shprehjes / gjuha e urrejtjes në legjislaturën e Maqedonisë së Veriut

“Nuk jam dakord me ato që thua, por do të mbroja deri në vdekje të drejtën tënde që ta shprehje atë!” – i thoshte Voltaire kolegut të tij Helvetius teksa përplaseshin ashpër për qëndrimet e tyre filozofike në Francën e shekullit XVIII. Nuk ka prova nëse kjo shprehje është thënë vërtet, por të paktën, kështu qëndron në librin e Evelyn Beatrice Hall, në një vepër “Shokët e Voltaire” në 1906.<sup>456</sup> Ky citim u bë i famshëm në përpjekjet për lirinë e shprehjes.

\*\*\*

*Liria e mendimit dhe e shprehjes* janë parimet themelore të një shoqërie demokratike bashkëkohore. Madje, mundësia për ta shprehur mendimin, për ta shkëmbyer mendimin, për ta shpërndarë lirshëm atë, ashtu sikurse edhe e drejta për informim të lirë, tregojnë kapacitetin demokratik dhe pozicionin institucional të demokracisë në një shoqëri, të cilat vis a vis shkojnë në linjë me konceptin e qytetarisë dhe pluralizmit.<sup>457</sup>

Historia e të drejtave të njeriut daton gati 9 shekuj më parë me Kartën e Madhe të Lirive (Magna Carta Libertatum) e vitit 1215 kur mbreti Xhon i Anglisë, për të ulur gjakrat me një grup baronësh, firmosi marrëveshjen (kartën) se do t’u garantonte gjykim të drejtë në rast burgosjeje. Duke qenë se mbreti Xhon nuk gëzonte oborre (sepse ishte vëllai i vogël i familjes dhe nuk kishte prona dhe tituj), ai u angazhua që asnjë person i lirë nuk do të arrestohej, nuk do t’i hiqej prona, të burgosej, të dëbohej apo të shpallej i jashtëligjshëm pa iu garantuar më parë gjykim i barabartë në bazë të ligjeve të vendit.<sup>458</sup> Pavarësisht se përbënte një dokument të rëndësishëm, kjo Kartë nuk kuptohej si duhej në atë kohë. Do të duheshin shekuj të tërë që, nga fryma e saj të buronin aktet e tjera për të drejtat dhe liritë e njeriut. Parimet e saj se *ligji është i pari – edhe mbi vetë titullarin*, u interpretua më vonë në Peticionin e të Drejtave (Petition of Rights) në vitin 1628 nga mbreti Çarls I i Anglisë i cili i garantonte qytetarit liritë personale, të drejtën e mbrojtjes, ndalim të arrestimeve abuzive, moszbatim taksash pa pëlqim të kuvendit etj.<sup>459</sup>

Ndërsa, një formë më të qartë, këto parime morën me Kushtetutën e Virxhinias (12 qershor 1776) e cila përkufizoi qartë që në nenin 1;

*Neni 1*

*se të gjithë njerëzit, sipas natyrës, janë si të lirë ashtu edhe të pavarur dhe kanë të drejta të caktuara të qenësishme<sup>460</sup> prej të cilave, kur të hyjnë në ndonjë gjendje të shoqërisë, me çfarëdo marrëveshje, nuk mund t’i privojnë ose t’i zhveshin (nga e drejta) brezat e ardhshëm, përkufizuar në mënyrë të qartë, nga gëzimi i jetës dhe lirisë, mjetet*

<sup>456</sup> Raphael Cohen-Almagor, *The Scope of tolerance: Studies on the costs of Free Expression and Freedom of the Press*, Routledge, SHBA 2006, faqja 96, <<https://books.google.mk/books?id=W96CMNnRYv0C&pg=PA96&dq=I+disapprove+of+what+you+say,+but+I+will+defend+to+the+death+your+right+to+say+it&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwjhzNevwIriAhVisIsKHeQrDdAQ6AEIMDAB#v=onepage&q=I%20disapprove%20of%20what%20you%20say%2C%20but%20I%20will%20defend%20to%20the%20death%20your%20right%20to%20say%20it&f=false>>, [25.11.2019]

<sup>457</sup> Elena Mihajlova, Jasna Baçova, Tome Shekerxhiev, *Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes*, OSBE, Polyesterday, Shkup 2013, faqja 5, <<https://www.osce.org/sq/skopje/116609>>, [25.11.2019]

<sup>458</sup> Ervis Martani, *Orgjigjina dhe evoluimi i të drejtave të njeriut*, Studim shkencor, faqja 3, <<http://myschool.al/resources/Historia-e-te-drejtave-te-njeriut.pdf>>, [26.11.2019]

<sup>459</sup> Po aty.

<sup>460</sup> (inherent rights - përkth.: të drejta të qenësishme ose të pandara, që nënkuptojnë të drejtat që ata i fitojnë me lindje (të drejta imanente, të drejta natyrore, të trashëguara nga të lindurit si shtetas)

*për fitimin dhe zotërimin e pronësisë, si dhe nga kërkimi dhe arritja e lumturisë dhe sigurisë.<sup>461</sup>*

Këto parime, se njerëzit i gëzojnë të drejtat që në lindje, se janë të lirë dhe të pavarur, se kanë të drejtë ta gëzojnë jetën dhe të kërkojnë lumturinë, veçse u vulosën edhe në Deklaratën e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara e miratuar më 4 korrik të vitit 1776. Tomas Xhefëron (Thomas Jefferson) bëri një kthesë të madhe mbi të drejtat e individit, falë frymëzimit të tij mbi të drejtat natyrore të njeriut që burojnë me lindjen e tij si *i barabartë*.<sup>462</sup> Me këtë akt, për herë të parë u garantua heqja e skllavërisë, e drejta e votës etj.

*Konsiderojmë se këto të vërteta janë evidente vetvetiu se; të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë, se Krijuesi i ka pajisur me të drejta të caktuara të patjetërsueshme, se ndër to janë jeta, liria dhe kërkimi i lumturisë,*

*se për të siguruar këto të drejta janë formuar qeveri midis njerëzve dhe se autorizimet e tyre (këto qeveri) i nxjerrin nga pajtueshmëria e atyre (njerëzve) mbi të cilët ushtrojnë pushtetin (qeverisin);*

*kur ndonjë formë e sundimit bëhet pengesë për t'i sendërtuar këto qëllime, populli ka të drejtë në cilëndo kohë, qoftë ta ndryshojë ose pezullojë dhe të vendosë qeveri të re, duke mbështetur bazën e saj mbi parime të tilla dhe duke organizuar pushtetin e saj në atë formë që i duket më së miri për të arritur lirinë dhe lumturinë e vet...<sup>463</sup>*

Të drejtat e njeriut *u forcuan më shumë* me akte të njëpasnjëshme sikurse Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit (Francë 1789), ndërkohë që pas Luftës së Dytë Botërore, për herë të parë ato morën karakterin ndërkombëtar. Deri në këtë kohë, ato trajtoheshin vetëm si çështje e kompetencës së brendshme kombëtare; me kushtetutë dhe ligje, por pas Luftës së Dytë Botërore rrezja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut u shtri jo vetëm te liritë e tij, por edhe te fakti se vetëm falë njohjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut në aspektin ndërkombëtar do të pengoheshin krimet, dhuna, trajtimet çnjerëzore të njeriut nga luftërat etj.<sup>464</sup>

Karta e OKB-së ishte hapi i parë në drejtim të njohjes ndërkombëtare, edhe pse shumë studiues thonë se ajo prapëseprapë nuk ka dispozita për sigurimin e respektimit të të drejtave të njeriut. Ajo gjithsesi, shkoi në mënyrë më përcaktuese se sa Deklarata e Pavarësisë e SHBA-së (për skllavërinë, votën etj.) duke riafirmuar barazinë e të drejtave të meshkujve dhe femrave, si dhe pa dallim race, gjuhe e feje. Sa i përket lirisë së shprehjes, në nenin 19 të Deklaratës së Përgjithshme (Universale) për të Drejtat e Njeriut theksohet se:

*Neni 19*

*Çdo njëri ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë.<sup>465</sup>*

<sup>461</sup> Kushtetuta e Virxhinias, <<http://www.nhinet.org/ccs/docs/va-1776.htm>>, [26.11.2019]

<sup>462</sup> Zejnulla Gruda, *Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Libri I-III*, Botimi IV, Universiteti FAMA, Prishtinë 2017, faqja 8

<sup>463</sup> Po aty, faqja 313-314

<sup>464</sup> Po aty, faqja 8

<sup>465</sup> Elena Mihajlova, Jasna Baçova, Tome Shekerxhiev, *Liria e shprehjes dhe gjuha e urrëjtjes*, OSBE, Polyesterday, Shkup 2013, faqja 8, <<https://www.osce.org/sq/skopje/116609>>, [28.11.2019]

Pra, shkurtimisht, siç e cilëson edhe Gruda, neni 19 nënkupton lirinë e shprehjes së lirë të mendimit, që përfshin edhe të drejtën e mos trazimit të njeriut për shkak të mendimit të vet.<sup>466</sup> Për rrjedhojë, liria e opinionit nënkupton më vete edhe të drejtën për të mos u prekur për shkak të opinionëve të shprehura.<sup>467</sup> Nga ana tjetër, neni 29 (paragrafi 2) i të njëjtës deklaratë thotë se;

*Neni 29*

*Në ushtrimin e të drejtave dhe në gëzimin e lirive të tij, çdo njeri u nënshtrohet vetëm kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe vetëm me qëllim që të sigurohet njohja dhe respektimi i të drejtave të të tjerëve dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të drejta të moralit, të rendit publik dhe të mirëqenies së përgjithshme në një shoqëri demokratike.<sup>468</sup>*

Në këtë notim theksohet për herë të parë në mënyrë të qartë se duhet të bëhet kujdes me zbatimin e lirisë, pasi *kur fillon liria e njerit, mund të ketë përfunduar liria e tjetrit.*<sup>469</sup> Në mënyrë të veçantë, duhet të bëhet kujdes me lirinë e të shprehurit dhe të informimit (të cilat do i shohim më poshtë edhe se si keqpërdoren). Kështu, liria të shprehurit është subjekt i kufizimit gjithashtu në rast të keqpërdorimit të saj. Për shembull, në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike u vendos për herë të parë një rregullim përmes nenit 19, veçanërisht paragrafit 3.

*Neni 19*

1. Askush nuk mund të shqetësohet për opinionet e tij.
2. Çdo njëri ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të kërkuar, për të marrë dhe përhapur informata dhe ide të çdo lloji, pavarësisht nga kufijtë, në formën me gojë, me shkrim, të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij.
3. Ushtrimi i lirive të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni nënkupton detyra të posaçme dhe përgjegjësi të posaçme, për rrjedhojë (ushtrimi i lirive) mund t'u nënshtrohet kufizimeve të caktuara të cilat, megjithatë duhet të përcaktohen shprehimisht nga ligji dhe duhet të jenë të domosdoshme;
  - (a) për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve;
  - (b) për ruajtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit dhe të moralit publik.<sup>470</sup>

Siç mund të shihet, alinetë (a) dhe (b) tregojnë qartë se kufizimi vlen kur ligji e parashikon një gjë të tillë, për të respektuar të drejtat dhe reputacionin e tjetrit (dëmtimin e dinjitetit të të tjerëve), për të mos shkelur sigurinë kombëtare, integritetin territorial, rendin

<sup>466</sup> Zejnulla Gruda, *Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Libri I-III*, Botimi IV, Universiteti FAMA, Prishtinë 2017, faqja 33

<sup>467</sup> Garantimi i të drejtave të njeriut u zgjerua me një sërë paktesh të mëvonshme, sikurse Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe me një sërë institucionesh gardiane të të drejtave të njeriut, nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut e deri te Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke qenë se në këtë studim i referohemi vetëm lirisë së shprehjes, nuk do të marrim në shqyrtim edhe të drejta dhe liri të tjera të njeriut, të cilat çdo ditë përmirësohen falë angazhimit të shteteve, por edhe falë angazhimit të shoqatave jo qeveritare për të drejtat e njeriut.

<sup>468</sup> Po aty, faqja 330

<sup>469</sup> Ndërlidhur me citatin e Faik Konicës; “Ç’është liria? Liria është të mundet njeriu: 1) të besojë ç’i do zëmbëra; 2) të thotë ç’i do zëmbëra; 3) të shkrojë ç’i do zëmbëra; 4) të bëjë ç’i do zëmbëra, veç ato që janë kundër lirisë tjetëri njeriu”, Faik Konica, Ese “Ç’është liria”, <<http://www.arsalbanica.mk/ceshte-liria/>>, [28.11.2019]

<sup>470</sup> Zejnulla Gruda, *Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Libri I-III*, Botimi IV, Universiteti FAMA, Prishtinë 2017, faqja 350



publik (përhapjen e informatave konfidenciale) por edhe moralin publik (shoqërinë e shëndoshë dhe demokratike), si një baraspeshë që edhe sanksionimi ndaj *fjalës së lirë të dikujt* të mos nënkuptojë dëmtim të lirisë së tij të mendimit dhe as dëmtim të së mirës së përbashkët në shoqërinë pluraliste.

Këto kufizime janë qartësuar edhe në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (1950) e cila në nenin 10 të saj i lë *mëvetësi* shteteve përkatëse ta trajtojnë *sanksionimin e fjalës* sipas ligjeve vetjake të bazuar në kulturën dhe praktikën e tyre gjyqësore (shih paragrafin 1).

#### Neni 10

1. Çdo person ka të drejtën e shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë ose dhënë informata ose mendime, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë shtetërorë. Ky nen nuk i ndalon shtetet që të vendosin një sistem autorizimesh për institucionet e radio-përhapjes, të kinematografisë ose të televizionit.

2. Ushtrimi i këtyre lirive, që lidhet me disa detyra dhe përgjegjësi, mund t'u ushtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve që parashikohen me ligj dhe që përbëjnë masë të nevojshme në një shoqëri demokratike, për sigurimin kombëtar, integritetin territorial ose sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e informatave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.<sup>471</sup>

Po ashtu, parimi i përshtjellë më sipër nga neni 10 është *subjekt i gjykimit* nga ana e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut (i cili monitoron palët firmosëse që t'i përmbahen Konventës në fjalë). Ndërkaq, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e *përdor* nenin 17 të Konventës për parandalimin e grupeve totalitare që mund t'i keqpërdorin të drejtat e garantuara në Konventë.

#### Neni 17

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet sikur i jep një shteti, një grupim ose një individ, çfarëdo të drejte që të kryejë një veprimtari ose një akt që ka për qëllim zhdukjen e të drejtave ose lirive të njohura në këtë Konventë, ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave dhe lirive se ato që parashikohen nga kjo Konventë.<sup>472</sup>

Pra, siç mund të shihet më sipër, veçanërisht nga paragrafi 2 i nenit 10 për lirinë e shprehjes, pikërisht kjo e drejtë (liria e shprehjes) vjen me kufizime përkatëse që të mos bjerë në konflikt me të drejta të tjera, sikurse interesin publik, sigurinë kombëtare, sigurinë publike, parandalimin e krimit, apo mbrojtjen e shëndetit dhe moralit, dhe që të arrihet një ekuilibër i përshtatshëm veçanërisht duke pasur në konsideratë se shpifja (liria e *tepruar* e shprehjes) rrezikon *dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve*.<sup>473</sup>

<sup>471</sup> Po aty, faqja 371

<sup>472</sup> Po aty, faqja 373

<sup>473</sup> Instituti Shqiptar i Medias, *Monitorim për zbatimin e ligjeve për shpifjen dhe fyerjen*, Tiranë 2015, faqja 4

Duke qenë se në këtë studim do t'i përmbahemi vetëm lirisë së medias, të shprehurit në media dhe sanksionimit të saj, do të ndjekim vetëm këtë kurs të sqarimeve ligjore si në rrafshin kombëtar ashtu edhe atë ndërkombëtar. Pikërisht për lirinë e medias dhe pluralizmin e tyre, u vulos në vitin 2009, me Traktatin e Lisbonës. Karta e të Drejtave Themelore (2000), deri në Traktatin e Lisbonës përbënte një deklaratë pa forcë obliguese juridike, por pas tij (traktatit), Karta fitoi statusin e dokumentit të obligueshëm juridik.<sup>474</sup>

Neni 11, paragrafi 2, sqaron përfundimisht se;

*Neni 11*

*Liria dhe pluralizmi i mediave duhet të respektohen.*<sup>475</sup>

Ndërkaq, Maqedonia e Veriut i garanton liritë e njeriut në Kushtetutë, në nenin 8 të saj, ndërsa lirinë e shprehjes në nenin 16 të saj;

*Neni 8*

*Vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë:*

- liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të qytetarit, të njohura me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë
- të shprehurit të lirë të përkatësisë kombëtare;
- sundimi i së drejtës;
- ndarja e pushtetit shtetëror në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- pluralizmi politik dhe zgjedhje të lira, të drejtpërdrejta dhe demokratike;
- mbrojtja juridike e pronësisë;
- liria e tregut dhe e sipërmarrjes;
- humanizmi, drejtësia sociale dhe solidariteti;
- vetëadministrimi lokal;
- rregullimi dhe humanizimi i hapësirës si dhe mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor dhe i natyrës;
- respektimi i normave përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare.

*Në Republikën e Maqedonisë së Veriut është e lirë çdo gjë që nuk është e ndaluar me Kushtetutë dhe me ligj.*<sup>476</sup>

Pra nëse i referohemi vetëm paragrafit të parë, Kushtetuta e Maqedonisë specifikon se ajo njeh (pranon) të gjitha atotribute që edhe e drejta ndërkombëtare i konsideron si vlera. Ndërsa sa i përket lirisë së shprehjes, neni 16 i Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut thekson:

*Neni 16*

*Garantohet liria e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe e shprehjes publike të mendimit.*

<sup>474</sup> Elena Mihajlova, Jasna Baçova, Tome Shekerxhiev, *Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes*, OSBE, Polyesterday, Shkup 2013, faqja 18, <<https://www.osce.org/sq/skopje/116609>>, [28.11.2019]

<sup>475</sup> Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, faqja 11, <[http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text\\_en.pdf](http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf)>, [28.11.2019]

<sup>476</sup> Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë me amendamentet e kushtetutës I-XXXII*, Shkup 2016, faqja 16-17

*Garantohet liria e fjalës, paraqitjes publike, informimit publik dhe e themelimit të lirë të institucioneve për informim publik.*

*Garantohet qasja e lirë te informatat, liria e marrjes dhe e bartjes së informatave.*

*Garantohet e drejta e përgjigjes në mjetet e informimit publik.*

*Garantohet e drejta e korigjimit në mjetet e informimit publik.*

*Garantohet e drejta e mbrojtjes së burimit të informatës në mjetet e informimit publik.*

*Censura është e ndaluar.<sup>477</sup>*

Neni 16 i jep një përkufizim të qartë lirisë së shprehjes së individit, - lirisë së fjalës dhe paraqitjes publikisht në ndarjen lirshëm të mendimit të tij – themelimit të lirë të institucioneve të informimit publik – qasjes së lirë te informatat, marrjen dhe shpërndarjen e tyre. Ky nen është në korrelacion edhe me nenin 19 (1. *Garantohet liria e besimit fetar; 2. Garantohet shprehja e lirë dhe publike e fesë, individualisht ose në grupim me të tjerët*), nenin 20 (1. *Qytetarëve u garantohet liria e tubimit me qëllim të realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe bindjeve të tyre politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të drejtave dhe bindjeve të tjera; 3. Programet dhe veprimtaria e shoqatave civile dhe partive politike nuk mund të orientohen drejt rrënimit të dhunshëm të rendit kushtetues të Republikës dhe drejt nxitjes ose thirrjes së agresionit ushtarak, ose nxitjes së urrejtjes dhe mosdurimit kombëtar, racor ose fetar*), nenin 25 (*Çdo qytetari i garantohet respektimi dhe mbrojtja e privatësisë së jetës së tij personale dhe familjare, e dinjitetit dhe e autoritetit - reputacionit*).<sup>478</sup>

Nga ana tjetër, liria e shprehjes është nën mbrojtjen e Gjykatës Kushtetuese. Vetë Kushtetuta ka caktuar në nenin 110 (alineja 3) të saj që gardiane e lirisë së shprehjes së individit të jetë Gjykata Kushtetuese (sikurse Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me Konventën Evropiane).

#### *Neni 110*

*Gjykata kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut;*

*- vendos për përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën;*

*- vendos për përputhshmërinë e rregullave të tjera dhe të marrëveshjeve kolektive me Kushtetutën dhe ligjet;*

*- mbron liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimeve, tubimit dhe veprimt politik si dhe ndalimin e diskriminimit të qytetarëve mbi bazë të gjinisë, racës, fesë, përkatësisë kombëtare, sociale e politike;*

*- vendos për konfliktin e kompetencave midis bartësve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor;*

*- vendos për konfliktin e kompetencave midis organeve të Republikës dhe njësisve të vetëadministrimit lokal;*

*- vendos për përgjegjësinë e Presidentit të Republikës;*

*- vendos për kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe të shoqatave civile;*

*- vendos edhe për çështje të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.<sup>479</sup>*

<sup>477</sup> Po aty, faqja 21

<sup>478</sup> Po aty, faqja 22-24

<sup>479</sup> Po aty, faqja 61

Parë nga këndvështrimi i rregullimit të veprimtarisë së gazetarit, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të personave të tretë, neni 16 i cituar më sipër garanton të drejtën e korrigjimit në mjetet e informimit publik, ndërkohë që me rëndësi për ushtrimin e veprimtarisë së gazetarit është edhe garantimi i të drejtës së mbrojtjes së burimit të informacionit në mjetet e informimit publik dhe ndalimi i censurës.<sup>480</sup>

Kur jemi këtu, në të njëjtën linjë përkufizuese vjen edhe Ligji i Medias (versioni më i rinovuar i tij u firmos në vitin 2019).<sup>481</sup> Përveç lirisë së shprehjes dhe mendimit, ky ligj garanton lirinë e shprehjes, të publikimit, të zgjedhjes si dhe të transmetimit të informatave nga ana e gazetarit dhe medias, në nenin 3 të tij.

*Neni 3<sup>482</sup>*

*(1) Garantohet liria e shprehjes dhe liria e mediave*

*(2) Liria e medias përfshin në veçanti; lirinë e shprehjes së mendimit, pavarësinë e medias, lirinë e grumbullimit, investigimit gazetaresk, publikimit, përzgjedhjes dhe transmetimit të informacionit me qëllim informimin e publikut, pluralizmin dhe diversitetin e mediave, lirinë e rrjedhjes së lirë të informacionit dhe hapja e mediave ndaj mendimeve të ndryshme, besimeve dhe përmbajtjeve të ndryshme, qasjen në informatat me karakter publik, respektimin e individualitetit njerëzor, privatësisë dhe dinjitetit, liri të themelimit të personave juridikë për kryerje të aktivitetit mediatik, shtypjen dhe shpërndarjen e medias së shkruar (dhe mediave të tjera)<sup>483</sup> nga brenda dhe jashtë vendit, prodhim dhe transmetim të programeve audio/vizuale, pavarësi të redaktorit, gazetarit, autorëve ose krijuesve të përmbajtjeve të caktuara ose bashkëpunëtorëve në program dhe personave të tjerë, dhe në pajtim me rregullat e profesionit.*

*(3) Liria e mediave mund të kufizohet vetëm në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.*

*(4) Poseduesi i medias duhet të jetë i pavarur në politikën redaktuese ose në zbatimin e konceptit programor të medias, dhe ai është përgjegjës për punën e tij në përputhje me këtë ligj dhe ligje të tjera.<sup>484</sup>*

Në këtë mënyrë, sikurse përcakton edhe neni i mësipërm, ligji dikton pluralizëm të mediave. Pra, ai jo vetëm që nuk e kufizon por e thekson një gjë të tillë nëpërmjet tiparit të diversitetit që e thekson në paragrafin 2. Me këtë nen, po ashtu, theksohet pavarësia e medias, redaktorit dhe gazetarit për të publikuar një përmbajtje të caktuar.

Neni 8 i të njëjtit ligj e bën të detyrueshme median që të ketë kryeredaktor, ndërsa përcakton edhe përgjegjësitë e tij. Kryeredaktori është përgjegjës për çdo lajm që publikohet në media (madje, në rast të një numri më të madh kryeredaktorësh, të gjithë janë përgjegjës për tërësinë e përmbajtjes). Bashkë me kryeredaktorin, përgjegjës janë edhe redaktorët përgjegjës,

<sup>480</sup> Sandra Buzlieva & Mila Isakovska, *Manual për lirinë e shprehjes dhe gjuhën e urrejtjes, Aspekte juridike*, projekt i BE-së dhe Ambasadës britanike mbi gazetarinë, Shkup, Botuar nga Shoqata e qytetarëve “Instituti për të Drejtat e Njeriut” dhe Shoqata për Zhvillim “Qendra për Administrim me Ndryshime” 2016, faqja 10, <[http://www.cup.org.mk/publications/ipa\\_piracnik\\_al-ilovepdf-compressed%20\(4\).pdf](http://www.cup.org.mk/publications/ipa_piracnik_al-ilovepdf-compressed%20(4).pdf)>, [30.11.2019]

<sup>481</sup> AVMU, *Ligji për Shërbime Audio dhe Audiovizuale* – Botuar në Gazetën Zyrtare më 5 shkurt 2019, <<https://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/11/izmena-ZAVMU.pdf>>, [30.11.2019]

<sup>482</sup> AVMU, *Ligji për Mediat* - Botuar në Gazetën Zyrtare të datës 26 dhjetor 2013, <[http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Zakon\\_za\\_mediumi\\_mkd.pdf](http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Zakon_za_mediumi_mkd.pdf)>, [30.11.2019]

<sup>483</sup> Me ndërhyrjet ligjore në 2014, “dhe mediave të tjera” është fshirë. *Ligji për ndryshim dhe plotësim të ligjit për mediat* – 23.01.2014, <[http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/11/Zakon-za-izmenuvanje-i-dopolnuvanje-na-Zakonot-za-mediumi-13\\_14.pdf](http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/11/Zakon-za-izmenuvanje-i-dopolnuvanje-na-Zakonot-za-mediumi-13_14.pdf)>, [1.12.2019]

<sup>484</sup> AVMU, *Ligji për Mediat* - Botuar në Gazetën Zyrtare të datës 26 dhjetor 2013, <[http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Zakon\\_za\\_mediumi\\_mkd.pdf](http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Zakon_za_mediumi_mkd.pdf)>, [1.12.2019]

ndërkohë që në mungesë të kryeredaktorit në një media, përgjegjësinë e mban pronari ose botuesi (i gazetës).

Ndërkaq, për të penguar ndërhyrjen e kryeredaktorit ose botuesit në përmbajtjen e gazetarit, tjetërsimin e mendimit të tij, por edhe atë të presionit dhe zgjidhjes së kontratës së punës së tij, zvogëlimin e pagës etj., Ligji për Media i kushton 3 nene të veçanta.

#### Neni 11

(1) Gazetarit nuk mund t'i ndërpritet kontrata, t'i zvogëlohet paga ose t'i ndryshohet pozicioni në vendin e punës apo redaksia, ose t'i zvogëlohet ose pezullohet pagesa e kompensimit (mëditjes) të rënë dakord ose një pjesë e tij, si dhe t'i reduktohen ose shfuqizohen ndonjëra prej të drejtave të tij të përcaktuara me Ligjin për Marrëdhënie Pune, për shkak të shprehjes së mendimit dhe qëndrimit të tij, nëse ato janë në përputhje me rregullat profesionale të profesionit të gazetarisë.

(2) Gazetari ka të drejtë të refuzojë përgatitjen, shkrimin ose pjesëmarrjen në përgatitjen e një artikulli, përmbajtja e të cilit është në kundërshtim me rregullat profesionale të profesionit të gazetarisë, gjë të cilën duhet t'ia paraqesë me shkrim kryeredaktorit.

(3) Dispozitat e këtij neni nuk e përjashtojnë përgjegjësinë e gazetarëve në rastet e përcaktuara në pajtim me Ligjin për Marrëdhënie Pune.

#### Neni 12

(1) Gazetari ka të drejtë të mos e bëjë të ditur burimin e informacionit ose të të dhënave që mund të çojnë në zbulimin e burimit, në përputhje me Të Drejtën Ndërkombëtare dhe Kushtetutën.

(2) Të drejtën nga paragrafi (1) i këtij neni e gëzojnë edhe persona të tjerë të cilët për shkak të marrëdhënieve të tyre profesionale me gazetarin, vihen në dijeni të të dhënave që mund të çojnë në zbulimin e burimit, përmes mbledhjes, formësimit redaktues apo përhapjes së informacionit.

(3) Para publikimit të informacionit për të cilin burimi nuk është zbuluar, gazetari është i detyruar ta informojë kryeredaktorin për këtë.

#### Neni 13

(1) Përmbajtja, kuptimi i së cilës ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë procedurës së përpunimit redaktues nuk duhet të publikohet me emrin e autorit, pa pëlqimin e tij.

(2) Për përmbajtjen e publikuar kundërshtim me paragrafin (1) të këtij neni, përgjegjës mbahet kryeredaktori.

(3) Nëse autori konstaton se reputacioni i tij është shkelur me përmbajtjen e publikuar në kundërshtim me paragrafin (1) të këtij neni, ai ka të drejtën e kompensimit për dëmin, në pajtim me ligjin.

Pra, nga këto tre nene rrjedhin një sërë detyrimesh por edhe lehtësirash ndaj gazetarit. Ato e bëjnë atë më të ndërgjegjshëm ndaj presionit redaktorial. Gazetari është i lirë të shprehë mendimin e tij, dhe për aq kohë sa veprimtaria e tij është profesionale, ai nuk mund të bëhet subjekt i ndërrimit të vendit të punës, të uljes së pagës, të prishjes së kontratës etj. Po ashtu, pavarësisht çdo presioni, gazetari gëzon të drejtën e mos zbulimit të burimit të tij, ndërsa në rast të përmbysjes së tekstit dhe ndërrimit të kuptimit nga kryeredaktori ose redaktori përgjegjës, ai jo vetëm që nuk e tregon burimin por është i lirë nga përgjegjësia e tekstit që transmetohet ose publikohet. Sa i përket korrigjimit të lajmit, nenet 17, 18 dhe 19 të Ligjit për Media sqarojnë se

kush ka të drejtë të kërkojë korrigjim, cilat janë afatet kohore të korrigjimit dhe se në çfarë mënyre bëhet korrigjimi.

Ndërkaq, lirinë e shprehjes, qasjen te informatat, mbrojtjen e burimit etj., e garanton edhe Ligji për Veprimtari Radiodifuzive. Në nenin 61 të këtij ligji, ku renditen parimet e tij, thuhet:

*Neni 61*

*Radiodifuzerët, gjatë kryerjes së veprimtarisë, duhet të respektojnë parimet si më poshtë:*

*- kultivimin dhe zhvillimin e vlerave humane dhe morale të njeriut dhe mbrojtjen e privatësisë dhe dinjitetit të personalitetit,*

*- barazinë e lirive dhe të drejtave pavarësisht gjinisë, racës, origjinës kombëtare, etnike dhe sociale, bindjes politike dhe fetare, gjendjes pronësore dhe shoqërore të njeriut dhe qytetarit,*

*- nxitjen e frymës së tolerancës, respektimit të ndërsjellë dhe mirëkuptimit ndërmjet individëve me prejardhje të ndryshme etnike dhe kulturore,*

*- mbrojtjen e identitetit të viktimave të dhunës,*

*- respektimin e verifikimit të pafajësisë,*

*- nxitjen e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, ndjenjën e publikut për drejtësi dhe për mbrojtje të lirive demokratike,*

*- transparencën e programeve për shprehjen e kulturave të ndryshme që janë pjesë përbërëse e shoqërisë,*

*- ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, kulturës gjuhësore dhe krijimtarisë vendore,*

*- paraqitjen e ngjarjeve në mënyrë objektive dhe të paanshme me trajtim të njëjtë të pikëpamjeve dhe mendimeve të ndryshme dhe mundësimin e formimit të lirë të mendimit të publikut për ngjarje të caktuara dhe çështje,*

*- respektimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta,*

*- respektimin e fshehtësisë së burimit të informatës,*

*- garantimin e të drejtës së përgjigjes dhe korrigjimit, si dhe*

*- mëvetësinë, pavarësinë dhe përgjegjësinë e redaktorëve, gazetarëve dhe autorëve të tjerë gjatë krijimit të programeve dhe krijimit të politikës redaktuese.*

\*\*\*

Nga ana tjetër, në ligj theksohet edhe neni 48 i cili paraqet ndalesa të veçanta për transmetuesit, pavarësisht se për këto ndalesa nuk paraqitet sanksioni *ex-officio*, (për shkak të detyrës – по службена должност).

*Neni 48*

***Ndalime të veçanta***

*Shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale nuk guxojnë të mbajnë programe me të cilat rrezikohet siguria nacionale, nxitet rrënimi i dhunshëm i rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, thirrret në agresion ushtarak ose në konflikt të armatosur, nxitet ose përhapet diskriminimi, mosdurimi, ose urrejtja në bazë të racës, gjinisë, religjionit ose nacionalitetit.*

Kështu, rastet e gjuhës së urrejtjes që çojnë pikërisht në thirrje agresioni, konflikti apo mosdurim mes komuniteteve, nuk marrin dënim konkret *ex-officio* por i lihen Kodit Penal

vendor, pra institucioneve të drejtësisë (shih dispozitën ndëshkuese të ligjit, nga neni 147 e poshtë).<sup>485</sup>

\*\*\*

Ndërsa Kushtetuta dhe ligjet e tjera mbështetëse në sferën e medias promovojnë lirinë e shprehjes dhe të informimit, kjo e drejtë është subjekt i kufizimit gjithashtu si nga akti themelor (Kushtetuta) ashtu edhe nga vetë ligjet e tjera, përfshi edhe ligjin e veçantë – *Ligjin për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje*. E dënueshme cilësohet shpifja, ofendimi, dëmtimi i reputacionit të tjetrit, dhe përveç korrigjimit të informatës, gazetari, kryeredaktori dhe mediumi janë që të tre *subjekte të ekspozuara ndaj sanksionimit ligjor formal*.

Ligji për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje është në të njëjtën linjë me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e cila siç theksuam më sipër, theksonte se *nuk guxohet të shkelet interesi shtetëror, sekreti shtetëror, integriteti territorial, siguria kombëtare, ajo publike, e madje edhe dinjiteti dhe të drejtat e të tjerëve*. Po ashtu, nënvizohej se *vetë shtetet duhet të vendosin sistem autorizimesh për monitorimin dhe gjykimin e shpifjes*.

Në Maqedoninë e Veriut, shpifja u shkriminalizua në vitin 2012.<sup>486</sup> Deri në atë kohë, ajo ishte e saksionueshme deri në dënim me burg sipas Kodit Penal. Neni 27 i Kodit Penal thekson madje se shpifja, e cila transmetohet në mjetet e informimit (shtyp, media elektronike etj.) që shpërndahet brenda por edhe jashtë vendit, bën përgjegjës jo vetëm gazetarin, redaktorin përgjegjës, botuesin por edhe shpërndarësin.<sup>487</sup>

Shpifjet, në momentin që publikohen dhe dëmtojnë imazhin, reputacionin dhe nderin e tjetrit, bëhen të vështira për t'u zhbërë ose për t'u mohuar. Edhe në rast të korrigjimit të lajmit, dëmi veçse është shkaktuar! Kështu, Kodi Penal ruan attribute tepër të gjera sa i përket nderit të njeriut, në rast të lëshimit të akuzave të rrejshme për të.

Në Dispozitat e Posaçme të Përgjegjësisë Penale për Vepra Penale të bëra përmes Mjeteve të Informimit Publik përcaktohet:

#### ***Përgjegjësia penale e redaktorit përgjegjës***

*Neni 26*

*(1) Për vepra penale të bëra përmes gazetës apo ndonjë publikimi tjetër periodik të botuar, përmes radios, televizionit ose gazetave filmike, penalisht është përgjegjës redaktori përgjegjës, përkatësisht personi i cili e ka zëvendësuar në kohën e publikimit të informatës nëse;*

- 1) ka mbetur i panjohur autori deri në fund të shkallës së parë*
- 2) informata është publikuar pa pëlqimin e autorit, dhe*
- 3) në kohën e publikimit të informatës ka pasur pengesë faktike ose juridike për ndjekjen e autorit, të cilat vazhdojnë edhe më tutje.*

<sup>485</sup> Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë, *Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale*, faqja 70 (Dispozita ndëshkuese), <[http://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/legislation/26.12.2013.pdf](http://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/legislation/26.12.2013.pdf)>, [2.12.2019]

<sup>486</sup> Gazeta Zyrtare Nr. 143 (14 nëntor 2012), *Ligji për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje*, faqja 10, <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/69700BE05B845D4086525EF33D3EA4BD.pdf>>, [2.12.2019]

<sup>487</sup> Gazeta Zyrtare, *Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë*, <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/90E0B29D702D49A48DBCC2239374B927.pdf>>, [3.12.2019]

(2) Nuk është penalisht përgjegjës redaktori përgjegjës, përkatësisht personi që e zëvendëson, nëse për shkaqe të arsyeshme nuk ka ditur për rrethanat e parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të paragrafit 1.

### **Përgjegjësia penale e botuesit, shtypshkruesit dhe prodhuesit**

Neni 27

(1) Kur ekzistojnë kushtet nga neni 26, penalisht janë përgjegjës

1) botuesi – për veprën penale të bërë nëpërmjet publikimit të botuar jo-periodikisht, por nëse nuk ka botues apo pengesa fiskale apo juridike për ndjekjen e tij, shtypshkruesi i cili e ka ditur për atë edhe

2) prodhuesi për veprën penale të bërë nëpërmjet pllakës së gramafonit, shiritit të magnetofonit, filmit për shfaqje publike dhe private, diapozitivit, fonogramit, video-mjeteve, mjeteve audio ose mjeteve të ngjashme për komunikim, të destinuara për një rreth më të gjerë njerëzish

(2) Nëse botuesi, shtypshkruesi ose prodhuesi është person juridik ose organ shtetëror, penalisht është përgjegjës personi që është përgjegjës për botimin, shtypjen ose prodhimin.

### **Zbatimi i dispozitave të përgjithshme për përgjegjësinë penale**

Neni 28

Dispozitat për përgjegjësinë penale të përmendur në nenet 26 dhe 27 zbatohet vetëm nëse ata persona penalisht nuk janë përgjegjës sipas dispozitave të përgjithshme për përgjegjësinë penale në këtë Kod.<sup>488</sup>

Nga Ligji për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje, kuptohet se *shpifje* cilësohet çdo pohim i pavërtetë ose i pavërtetuar nga gazetari që dëmton nderin dhe reputacionin e personit të dytë, i nxjerrë në ekspozim ndaj personit të tretë (publikut).<sup>489</sup> Në të gjitha aktet ligjore theksohet se gazetari *ka për detyrë të dijë dhe ka mundur ta dijë* natyrën e fakteve, por jo *të trillojë ose të lejojë publikimin e tyre në mënyrë të qëllimshme*.<sup>490</sup>

Pra, edhe nëse dëmi ndaj nderit dhe reputacionit është bërë në mënyrë të paqëllimshme, gazetari e ka për detyrë të vërtetojë faktet, përndryshe përballet jo vetëm me shkelje të Kodit të Gazetarëve por edhe me përgjegjësinë për shpifje. Shpifja mund të jetë e një shkalle më të madhe, nëse pohimeve të pavërteta mund t'u atribuohen edhe fakte të dëmshme (që shkon në trillim klasik) ndaj personit të dytë.

Për ta thënë shkurt, nuk përbën *shpifje* nëse gazetari i thotë personit të dytë “*idiot, i paaftë*”, por nëse kësaj fjale (që deri këtu përbën veprën e ofendimit) i thuren edhe “*fakte*” të *tjera të paqëndrueshme*, atëherë ajo përbën veprën e shpifjes.<sup>491</sup> Në konsumimin e kësaj vepre, e rëndësishme është edhe pala e tretë. Nëse shpifja ose ofendimi janë bërë pa praninë e personit të tretë (publikut) atëherë ajo mbetet në kufijtë e ofendimit dhe vërtetësia në gjykatë është e vështirë, pasi mbetet *fjala e njëres palë kundër fjalës së palës tjetër*.

<sup>488</sup> Po aty.

<sup>489</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Ligji për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje*, neni 8, faqja 11, <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/69700BE05B845D4086525EF33D3EA4BD.pdf>>, [4.12.2019]

<sup>490</sup> Elena Mihajlova, Jasna Baçova, Tome Shekerxhiev, *Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes*, OSBE, Polyesterday, Shkup 2013, faqja 21, <<https://www.osce.org/sq/skopje/116609>>, [4.12.2019]

<sup>491</sup> Dragana Kiprijanovska, *Monitorimi i rasteve gjyqësore ku gazetarë janë të akuzuar për shpifje dhe ofendim, shtator 2011*, Koalicioni “Të gjithë për gjykime të drejta”, faqja 22, <<http://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2016/08/Kleveta-i-navreda-ALB.pdf>>, [5.12.2019]



Deri para vitit 2006, dënimi për shpifje *publike* (pra, përmes mjeteve të informimit) sanksionohej deri në 1 vit burg përveç dënimit në të holla (shih Kodin e vjetër Penal). Kjo dispozitë u hoq në vitin 2006... edhe pse mbetet neni 15 i Kodit Penal se kryerësi i veprës (shpifje) dënohet prapëseprapë nëse zbulohet lidhje shkakësie (causal relation) mes dëmtimit nga pala e parë dhe faktorit psikologjik që përjeton pala e dëmtuar. Nuk ka rrethanë lehtësuese edhe nëse pala e parë e ka bërë dëmin nga pakujdesia.

***Përgjegjësia për pasojë të rëndë***

*Neni 15*

*Kur nga vepra penale ka mbetur një pasojë më e rëndë, për të cilën ligji parashikon dënim më të rëndë, ai dënim mund të shqiptohet nëse kryerësi në raport me pasojën ka vepruar nga pakujdesia.<sup>492</sup>*

Ndërkaq, ofendimi, ashtu sikurse shpifja, shkakton dëmtim të reputacionit, nderit dhe nënçmim të personit tjetër (Ligji për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje). Ofendimi, si vepër, mund të konsumohet përmes tre formave, *ofendimit me gojë* (verbal), *ofendimit simbolik* (me shenja me duar) dhe *ofendimit real* (prekje nënçmuese në ndonjë pjesë të trupit të tjetrit).<sup>493</sup>

*Neni 173*

*(1) Ai që do të fyejë tjetrin, do të ndëshkohet me dënim me gjobë ose me burgim deri në 3 muaj.*

*(2) Nëse vepra nga paragrafi 1 është bërë nëpërmjet shtypit, radios, televizionit apo mjeteve të tjera të informimit publik apo tubimit politik, kryerësi do të ndëshkohet me dënim me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj.<sup>494</sup>*

Paragrafi (2) i këtij neni, me ndryshimet në Kodin Penal u formësua plotësisht si vepër penale që konsumohet në sistemin kompjuterik, por iu shtuan edhe format e ofendimit në bazë të racës, etnisë, kombësisë etj.<sup>495</sup>

*(2) Ai i cili e ekspozon dikë tjetër në nënçmim përmes sistemit kompjuterik, për shkak të përkatësisë së tij grupor i cili dallon sipas racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë kombëtare dhe etnike ose që do ta ekspozojë në nënçmim grupin e personave i cili dallon me ndonjërin nga këto tipare do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1 vit.<sup>496</sup>*

<sup>492</sup> Gazeta Zyrtare, *Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë*,

<<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/90E0B29D702D49A48DBCC2239374B927.pdf>>, [6.12.2019]

<sup>493</sup> Elena Mihajlova, Jasna Baçova, Tome Shekerxhiev, *Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes*, OSBE, Polyesterday, Shkup 2013, faqja 31, <<https://www.osce.org/sq/skopje/116609>>, [6.12.2019]

<sup>494</sup> Gazeta Zyrtare, *Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë*,

<<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/90E0B29D702D49A48DBCC2239374B927.pdf>>, [6.12.2019]

<sup>495</sup> Vllado Kambovski, Mirjana L Lazarova Trajkovska, *Analizë Juridike e konceptit të veprës së dënueshme të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes*, shtator 2012, Shkup, <<http://znm.org.mk/wp-content/uploads/2016/03/%D0%90%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%B8%D0%B7%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%BA%D0%B0%D0%B7%D0%BD%D0%B5%D0%BD%D0%BE-%D0%B4%D0%B5%D0%BB%D0%BE-%D0%BD%D0%B0-%D0%BE%D0%BC%D1%80%D0%B0%D0%B7%D0%B0-%D0%B8-%D0%B3%D0%BE%D0%B2%D0%BE%D1%80%D0%BE%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%BE%D0%BC%D1%80%D0%B0%D0%B7%D0%B0.pdf>>, [6.12.2019]

<sup>496</sup> Pravo.org.mk, *Kodi Penal (me ndryshime)*, <<https://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/mk/mk/mk018mk.pdf>>, [6.12.2019]

Ndërkaq, neni 176 i Kodit Penal liron nga përgjegjësia e veprës penale të ofendimit, të gjithë ata që shprehin fyerje ndaj tjetërkujt për vepër shkencore, letrare ose artistike, në kritikë serioze, në kryerje të shërbimit zyrtar, në profesion gazetarie etj.<sup>497</sup>

\*\*\*

Historia e shkriminalizimit në Maqedoninë e Veriut.

Procesi i shkriminalizimit nisi që në vitin 2006, pas një konference të organizuar nga OSBE-ja në Shkup, Instituti i Medias si dhe Shoqata e Gazetarëve (9-10 shkurt 2006), me pjesëmarrjen e ligjvënësve, ekspertëve ligjorë, aktivistëve të lirisë së medias nga disa shtete pjesëmarrëse etj. Në rezolutën e miratuar nga kjo konferencë u garantua mbështetja ndaj Ministrisë së Drejtësisë për përpilimin e ndryshimeve ligjore, ngritja e organeve vet-rregulluese nga vetë gazetarët, ndihmesë nga gjyqtarët lidhur me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut si dhe përmirësim të standardeve profesionale të gazetarisë dhe ruajtjes së etikës në raportim.<sup>498</sup>

Saga e shkriminalizimit zgjati deri në 2012, me miratimin më në fund të Ligjit për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje i cili duhej të përshtatej edhe për shkak të një arsyeje madhore, atë të zhvillimit në botën e internetit, me portalet, mediat online etj. Nga ana tjetër, me këtë ligj, edhe Kodi Penal pësoi ndryshime, duke hequr dënimin me burg, por duke lënë vetëm dënimin me gjobë (p.sh., në nenin 173 më sipër, paragrafi 1, thuhet se: *Ai që do të fyejë tjetrin, do të ndëshkohet me dënim me gjobë ose me burgim deri në 3 muaj*<sup>499</sup> ... me ndryshimet e reja mbeti se: *Ai që do të fyejë tjetrin, do të ndëshkohet me dënim me gjobë.*)<sup>500</sup>

Ligji i ri për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje thekson që në nenin 2 të tij se *“garanton lirinë e shprehjes dhe informimit si një nga themelet më kryesore të shoqërisë demokratike. Kufizimet e lirisë së shprehjes dhe informimit, ligjërisht rregullohen me përcaktim të kushteve të ashpra për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje, në pajtim me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (neni 10) dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.<sup>501</sup>

Por, ligji në fjalë, pavarësisht se shkriminalizon shpifjen, nuk do të thotë se i zbeh rëndësinë reputacionit, nderit dhe jetës private të tjetrit, sikurse garanton neni 22 i Kushtetutës. Akti më i lartë themelor bën të qartë se pa respektuar tjetrin, personalitetin e tij, autoritetin, dinjitetin, të drejtën e privatësisë së tjetrit, nuk mund të ketë marrëdhënie ndërnjerëzore dhe harmoni civile.

Neni 25

<sup>497</sup> Po aty.

<sup>498</sup> OSBE, *Rezoluta e miratuar në konferencën ndërkombëtare “Dekriminalizimi i shpifjes: Shkëmbim i praktikave pozitive”*, Shkup, 9-10 shkurt 2006, <<https://www.osce.org/sq/skopje/18055?download=true>>, [10.12.2019]

<sup>499</sup> Gazeta Zyrtare, *Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë*, <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/90E0B29D702D49A48DBCC2239374B927.pdf>>, [10.12.2019]

<sup>500</sup> Pravdiko.mk, *Kodi Penal (ndryshime në 2013)*, <<https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf>>, [10.12.2019]

<sup>501</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Ligji për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje*, <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/69700BE05B845D4086525EF33D3EA4BD.pdf>>, [10.12.2019]

*Çdo qytetari i garantohet respektimi dhe mbrojtja e privatësisë së jetës së tij personale dhe familjare, e dinjitetit dhe e autoritetit.<sup>502</sup>*

Prej këtu, përforcohet përkufizimi se për shpifje që dëmtojnë dinjitetin, reputacionin dhe jetën private, përgjegjës është ai person që një personi të dytë, me identitet të verifikueshëm, *me qëllim* për të dëmtuar nderin dhe reputacionin e tij, shpalos para një personi të tretë (publikut) fakte të pavërteta, ndërkohë që *e di*, ka për *detyrë ta dijë* dhe *mund ta dijë* se ato “fakte” janë të pavërteta.

Me këtë, kuptohet se nevojiten të paktën 3 elemente që të përmbushet vepra e shpifjes; *qëllimi dashakeq*, “*faktet*” e pavërteta, si dhe *ekspozimi para personit të tretë* (publikut). Përgjegjësi për shpifje ka edhe kur të pavërtetat “*provohen*” jo vetëm ndaj një personi, por edhe ndaj një grupi ose ndaj një personi të vdekur gjithashtu. Kur pala e tretë është *publik* dhe kur shpërndarja e të pavërtetave bëhet nëpërmjet *mjeteve të informimit publik*, atëherë përgjegjës mbahen si *autori* ashtu edhe *kryeredaktori*, *redaktori përgjegjës/personi që e zëvendëson atë*, por edhe *media* (personi juridik).

#### Neni 8

(1) *Për shpifje përgjigjet ai i cili, për personin tjetër me identitet të përcaktuar ose të qartë, me qëllim që të dëmtojë nderin dhe autoritetin e tij, para personit të tretë nxjerr ose bart fakte të pavërteta që janë të dëmshme për nderin dhe autoritetin e tij, ndërsa e di ose ka qenë i obliguar ta dijë se janë të pavërteta.*

(2) *Përgjegjësi për shpifje ekziston edhe kur pohimi i pavërtetë përmban fakte të dëmshme për autoritetin e personit juridik, një grup personash ose personit të vdekur.*

(3) *Nëse nxjerrja ose bartja e pohimeve të pavërteta për fakte është bërë nëpërmjet mjetit për informim publik (gazeta, revista dhe shtyp tjetër, programe të radiotelevizionit, publikime elektronike, teletekst dhe forma të tjera të përmbajtjeve programore të krijuara dhe të redaktuara që publikohen ose transmetohen çdo ditë apo periodikisht në formë shkrimi, zëri apo fotografie, në mënyrë të kapshme për publikun e gjerë) për shpifje mund të përgjigjen autori i deklaratës, redaktori ose personi që e zëvendëson në mjetin për informim publik dhe personi juridik. Paditësi, gjatë parashtrimit të padisë, është i lirë të vendosë se kundër cilit nga personat nga ky paragraf do të ngrëjë padi për përcaktimin e përgjegjësisë dhe kompensimit të dëmit për shpifje.*

(4) *Botuesi, redaktori ose personi që e zëvendëson në mjetin për informim publik dhe personi juridik i cili e boton mjetin për informimin publik, për shpifje të kryer nga gazetari në atë mjet i cili është autor i deklaratës, përgjigjen mbi parimin e përgjegjësisë së eprorit.*

(5) *Gazetari, si autor i deklaratës, nuk përgjigjet për shpifje nëse dëshmon se publikimi i saj i është imponuar nga ana e botuesit, redaktorit ose personit që e zëvendëson ose përmbajtja e deklaratës së tij është ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme nga ana e redaktorit ose personit që e zëvendëson.*

(6) *Gazetari, si autor i deklaratës, nuk përgjigjet nëse ajo ka marrë karakter të shpifjes me pajisjen e saj me vendosjen e titujve, nëntitujve, fotografive, nxjerrjen e pjesëve të deklaratës nga tërësia e saj, paralajmërimin (kokës së lajmit) ose mënyrë tjetër nga ana e redaktorit ose personit që e zëvendëson.<sup>503</sup>*

<sup>502</sup> Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë me amendamentet e kushtetutës I-XXXII*, Shkup 2016, faqja 24

<sup>503</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Ligji për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje*, <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/69700BE05B845D4086525EF33D3EA4BD.pdf>>, [12.12.2019]

Për sa i përket veprës së ofendimit, përgjegjës është ai person i cili, me qëllim *nënçmimin* e një personi tjetër, në formë verbale, me gjeste ose me formë të shkruar të publikuar, lëndon nderin dhe reputacionin e personit të dytë. Edhe në këtë rast, ofendimi përfshin edhe *grup personash* por edhe *person të vdekur*. Njësoj si për shpifjen, në rast se ofendimi bëhet nëpërmjet *mjeteve të informimit publik*, atëherë përgjegjës mbahen si *autori* ashtu edhe *kryeredaktori*, *redaktori përgjegjës/personi që e zëvendëson atë*, por edhe *media* (personi juridik).<sup>504</sup>

#### Neni 6

(1) Për ofendim përgjigjet ai i cili, me qëllim që të nënçmojë, me deklaratë, sjellje, publikim ose në mënyre tjetër, do të shprehë për tjetrin mendim nënçmues, me të cilin cenohet nderi dhe reputacioni i tij.

(2) Përgjegjësi për ofendim ekziston edhe kur me veprimin e tillë nënçmohet reputacioni i personit juridik, grupit të personave ose personit të vdekur.

(3) Për ofendim të kryer përmes mjeteve të informimit publik (gazeta, revista dhe shtyp tjetër, programe të radiotelevizionit, publikime elektronike, teletekst dhe forma të tjera të përmbajtjeve programore të krijuara dhe të redaktuara që publikohen ose transmetohen çdo ditë apo periodikisht në formë shkrimi, zëri apo fotografie, në mënyre të kapshme për publikun e gjerë) mund të përgjigjen autori i deklaratës, redaktori ose personi që e zëvendëson në mjetin për informim publik dhe personi juridik. Paditësi, gjatë parashtrimit të padisë, është i lirë të vendosë se kundër cilit nga personat nga ky paragraf do të ngrëjë padi për përcaktimin e përgjegjësisë dhe kompensimit të dëmit për ofendim.

(4) Botuesi, redaktori ose personi që e zëvendëson në mjetin për informim publik dhe personi juridik i cili e boton mjetin për informimin publik, për ofendim të kryer nga gazetari në atë mjet i cili është autor i deklaratës, përgjigjen mbi parimin e përgjegjësisë së eprorit.

(5) Në rastet nga paragrafët (3) dhe (4), gazetari, si autor i deklaratës, nuk përgjigjet për ofendim nëse dëshmon se publikim i deklaratës ofenduese i është urdhëruar nga redaktori ose personi që e zëvendëson, ose përmbajtja e deklaratës së tij është ndryshuar bindshëm nga redaktori ose personi që e zëvendëson.

(6) Gazetari, si autor i deklaratës, nuk përgjigjet nëse ajo ka marrë karakter ofendues me pajisjen e saj me vendosjen e titujve, nëntitujve, fotografive, nxjerrjen e pjesëve të deklaratës nga tërësia e saj, paralajmërimit (kokës së lajmi) ose mënyrë tjetër nga ana e redaktorit ose personit që e zëvendëson.

Siç shihet nga nenet e mësipërme, subjekt i dënimit përveç gazetarit dhe kryeredaktorit (redaktorit përgjegjës/zëvendësit të tij) është edhe *personi juridik* (pra, gazeta, radioja, televizioni etj., që nënkupton drejtpërdrejt pronarin e mjetit të informimit publik). Ndërkohë, është e qartë se dy nenet e mësipërme nuk e detyrojnë në asnjë mënyrë gazetarin që të tregojë burimin e tij, nëse faktet që ai ka gjetur për lajmin, qoftë të pavërteta, i ka siguruar nga burimi i tij konfidencial (kjo rregullohet me Ligjin për Mediat, neni 12).<sup>505</sup>

Në rast të gjetjes *fajtor* të gazetarit/redaktorit/pronarit për veprën e ofendimit ose shpifjes, neni 18 i Ligjit për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje thekson se kompensimi për palën e dëmtuar duhet të jetë *në proporcion* me dëmin material dhe atë jo-material të shkaktuar.

#### Neni 18

<sup>504</sup> Pravdiko.mk, *Përgjegjësia Civile për Ofendim dhe Shpifje (Граѓанска одговорност за навреда и клевета)*, <<https://www.pravdiko.mk/graganska-odgovornost-za-navreda-i-kleveta/>>, [12.12.2019]

<sup>505</sup> AVMU, *Ligji për Mediat - Botuar në Gazetën Zyrtare të datës 26 dhjetor 2013*, <[http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Zakon\\_za\\_mediumi\\_mkd.pdf](http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Zakon_za_mediumi_mkd.pdf)>, [12.12.2019]

(1) Gjykata nuk mund të vendosë si kompensim të dëmit jo-material të shkaktuar me ofendim ose shpifje nga gazetari gjatë kryerjes së profesionit të tij, shumë më të madhe se 2 000 euro në kundërvlerë me denarë.

(2) Gjykata nuk mund të vendosë si kompensim të dëmit jo-material të shkaktuar me ofendim ose shpifje nga redaktori apo personi që e zëvendëson, shumë më të madhe se 10 000 euro në kundërvlerë me denarë.

(3) Gjykata nuk mund të vendosë si kompensim të dëmit jo-material të shkaktuar me ofendim ose shpifje nga personi juridik, shumë më të madhe se 15 000 euro në kundërvlerë me denarë.<sup>506</sup>

Pra, në total dëmi jo-material llogaritet 27 000 euro. Nga ana tjetër, dëmi material përlllogaritet në rastet e veçanta kur ofendimi ose shpifja ndaj personit të dytë *ka ndikuar materialisht* ndaj tij, p.sh., në bllokimin e biznesit, prishjen e mallit në kufi ose forma të tjera dëmtuese/falimentuese ndaj pronës së tij (nga praktikatat gjyqësore).

Ndërkaq, përveç elementit të proporcionalitetit të dëmit, gjykatat marrin në konsideratë gjatë marrjes së vendimit edhe *rrethana lehtësuese* ndaj gazetarit ose medias. Dënimi mund të zbutet nëse gazetari ose media *pranojnë fajin, kërkojnë falje ose argumentojnë përpjekjet e tyre për shmangien e pasojave nga dëmi i shpifjes ose ofendimit* të personit të dytë.<sup>507</sup>

Por, fatkeqësisht, gjykatat nuk kanë ende një përcaktim të qartë ligjor sa i përket portaleve. Ekspertët ligjorë dhe ata të komunikimit theksojnë se portalet jo vetëm që vjedhin lajme dhe tekste nga mediat e mëdha, por i shtrembërojnë ato duke shkaktuar ofendime dhe shpifje për persona të caktuar (kryesisht funksionarët publikë).<sup>508</sup> Fakti që portalet nuk janë të futura në ligj si media (as në Ligjin për Media, pavarësisht ndryshimeve ligjore në vitin 2013 – neni 2 dhe as në Ligjin për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike – neni 2 / paragrafi 1)<sup>509</sup> sjell dyzim në vendimmarrjen e gjykatave.<sup>510</sup> Po ashtu, lihet një hapësirë që vetë funksionarët t'i përdorin portalet për të larë hesapet ndaj kundërshtarëve të tyre ose ndaj vetë gazetarëve që kritikojnë politikatat e këtyre funksionarëve. Studiuesit ende sot e kësaj dite ngrenë shqetësimin për nevojën e ndryshimeve të reja ligjore, për një përcaktim më të qartë midis mediave online si dhe trajtimit në gjykata të padive ndaj gazetarëve për ofendim e shpifje.

\*\*\*

<sup>506</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Ligji për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje*, <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/69700BE05B845D4086525EF33D3EA4BD.pdf>>, [12.12.2019]

<sup>507</sup> Elena Mihajlova, Jasna Baçova, Tome Shekerxhiev, *Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes*, OSBE, Polyesterday, Shkup 2013, faqja 22, <<https://www.osce.org/sq/skopje/116609>>, [13.12.2019]

<sup>508</sup> Këshilli për Etikë në Media, *Vetërregullimi ose rregullimi i mediave të internetit në Maqedoni*, gusht 2017, Shkup, <<http://semm.mk/attachments/samoregilacija-alb.pdf>>, [13.12.2019]

<sup>509</sup> Ndryshimet ligjore, në nenin 2, theksojnë se media janë mjetet për informim publik, konkretisht çdo lloj komunikimi si gazetatat, revistat, programet radiofonike dhe televizive, teleteksti dhe mjete të tjera për botim ditor apo periodik të përbajtjeve redaksionale në formë të shkruar, audio ose fotografi, me qëllim që të informojnë dhe plotësojnë nevojat kulturore, edukative etj., të publikut më të gjerë". Gjithsesi, kjo nuk nënkupton vis a vis përfshirje të portaleve që informojnë dhe publikojnë vetëm në internet ose platforma tjera të reja digjitale. Nga ana tjetër, ndryshimet në Kodin Zgjedhor (2016) i përmendte mediat elektronike (portalet e internetit) si media që duheshin të monitoroheshin gjatë fushatës zgjedhore. (Neni 75 i Kodit Zgjedhor)

<sup>510</sup> Këshilli për Etikë në Media, *Vetërregullimi ose rregullimi i mediave të internetit në Maqedoni*, Shkup 2017, <<http://semm.mk/attachments/samoregilacija-alb.pdf>>, [13.12.2019]

Sikurse u tha më sipër, liria e shprehjes është virtyt i demokracisë në shoqëritë bashkëkohore. Por në rast të *teprimit* të saj, dëmtimit të imazhit të tjetrit, ajo bëhet subjekt kufizimi. Në shoqëritë tona, janë të shpeshta rastet kur si liria e shprehjes ashtu edhe rregullat për kufizimin e saj shkelen. Shprehje të caktuara të përdorura nga persona fizikë, persona juridikë, funksionarë apo media, shpesh nxitin urrejtje ndaj një personi të dytë, grupi ose komuniteti.

Maqedonia e Veriut është rast i etiketuar për një fenomen të tillë, për shkak edhe të karakterit të saj multi-etnik, multi-fetar dhe multi-kulturor.

Deklarata të ndryshme të bëra në publik; deklarata funksionarësh por ndonjëherë edhe politika të tëra shtetërore kanë shkaktuar urrejtje ndëretnike (si p.sh. rastet e montuara gjyqësore, ngjarjet e Kumanovës të vitit 2015, ngritja e Kryqeve, antikiteti, puçet ndaj BFI-së apo edhe karnavalet e Vevçanit, të cilat shpeshherë kanë vënë në lojë si kulturën kombëtare ashtu edhe atë fetare të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut).

Gjuha e urrejtjes (hate speech), sipas fjalorëve enciklopedikë botërorë, nënkupton *gjuhën e përdorur me qëllim fyerjen, ofendimin, nënçmimin, frikësimin e një personi ose grupi të caktuar për shkak të disa tipareve; sikurse racës, besimit fetar, orientimit seksual, origjinës kombëtare/etnike, invaliditeteve të caktuara etj.*<sup>511</sup> Shtetet demokratike, më së shumti e konsiderojnë gjuhën e urrejtjes si vepër që konsumohet jo vetëm përmes të folurës, por edhe gjesteve, sjelljes, shkrimit, shfaqjes së shenjave ose simboleve të urrejtjes që në fund të fundit nxitin njësoj urrejtje, paragjykimë ose dhunë ndaj grupeve të caktuara, individëve – pjesë e një grupi, pa përjashtuar as personat me të meta fizike (invaliditet). Në shumë përkufizime përmenden edhe dallimet klasore, ato sociale, pengesat trupore dhe mendore. Po ashtu, në rekomandime të ndryshme, sikurse ai i Këshillit të Evropës (1997), përmendet edhe etnocentrizmi ndaj pakicave me origjinë emigrantësh ose vetë emigrantëve që vërshojnë viteve të fundit Evropën.<sup>512</sup> Megjithatë, duhet të theksohet se zanafillat ligjore ndaj gjuhës së urrejtjes datojnë që pas Luftës së Dytë Botërore, me antisemitizmin (pas holokaustit dhe propagandës raciste hitleriane ndaj hebrenjve).<sup>513</sup>

E drejta e mosdiskriminimit është e njohur me instrumentet kryesore ndërkombëtare (të njëjtat dokumente, konventa e akte të përmendura më sipër edhe për lirinë e shprehjes) siç janë; Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha Formave të

<sup>511</sup> “Hate speech” sipas Fjalorit të Merriam Webster në <<https://www.merriam-webster.com/dictionary/hate%20speech>>, [14.12.2019]

<sup>512</sup> *Gjuha e urrejtjes duhet kuptuar si tërësia e formave të shprehjes që shpërndajnë, nxitin, promovojnë ose justifikojnë urrejtje, ksenofobi, antisemitizëm dhe forma të tjera urrejtjeje që bazohen te jo-toleranca, përfshi jo-tolerancën e shprehur nga nacionalizmi dhe etnocentrizmi agresiv, diskriminimi dhe armiqësia kundër minoriteteve, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrantësh.*

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, *Rekomandimi Nr. R (97) 20 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare mbi “Gjuhën e Urrejtjes”*, 30 tetor 1997, <<https://rm.coe.int/090000168090a6da>>, [14.12.2019]

<sup>513</sup> Sipas konventave mbi gjuhën e urrejtjes, në shumicën e rasteve nëpër botë janë gjithnjë e më të pakta mundësitë e nxitjes së gjuhës së urrejtjes për shkak të statusit familjar, martesor, arsimor, bindjeve politike etj. Më së shumti vërehen ato në bazë të ksenofobisë, homofobisë, etnisë dhe fesë. Madje, rastet e mohimit të krimeve të njerëzimit janë konsideruar si shpifje racore dhe urrejtje ndaj grupeve ose popujve ndaj të cilëve është ushtruar krimi. Të njëjtin trajtim kanë edhe rastet që ndodhin në prag të festave etnike ose fetare, kur persona të njëjës palë atakojnë palën e dytë. I njëjti trajtim edhe nëse gjuha e urrejtjes zbatohet ndaj grupeve të tifozëve në ndeshje sportive, apo ndaj ndonjë pjesëtari të komunitetit LGBT që ka marrë pjesë në paradat e këtij komuniteti.

Diskriminimit Racor dhe Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) nr. 111.<sup>514</sup>  
Ndërkaq, në rrafshin rajonal, Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut jep garancinë dhe detyrimin ndaj shteteve në nenin 14 të saj;

*Neni 14  
Parandalimi i diskriminimit*

*Gëzimi i të drejtave dhe lirive të njohura në këtë konventë duhet të sigurohen pa asnjë dallim të bazuar veçanërisht mbi seksin, racën, ngjyrën, fenë, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, prejardhjen kombëtare ose shoqërore, përkatësinë ndaj një pakice kombëtare, pasurinë, lindjen ose çdo rrethanë tjetër.<sup>515</sup>*

Ky nen u bë bazë i Protokollit XII të kësaj Konvente, e cila i detyronte shtetet të garantojnë të drejtën e pavarur të *trajtimit të barabartë*.

*Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, firmosëse;  
sa i përket parimit themelor në bazë të të cilit të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe gëzojnë të drejtën e mbrojtjes së barabartë para ligjit;  
të angazhuar për marrjen e masave për promovimin e barazisë përmes zbatimit kolektiv të ndalesës së përgjithshme të diskriminimit me mjete të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të firmosur më 4 nëntor 1950*

*riafirmojnë se parimi i mosdiskriminimit nuk i parandalon shtetet palë nga marrja e masave në mënyrë që të nxisin barazi të plotë dhe efikase, duke garantuar se ka justifikim të arsyeshëm dhe objektiv për marrjen e atyre masave kanë rënë dakord si më poshtë;*

*Gëzimi i të drejtave dhe lirive të njohura në këtë konventë duhet të sigurohen pa asnjë dallim të bazuar, veçanërisht në seksin, racën, ngjyrën, fenë, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, prejardhjen kombëtare ose shoqërore, përkatësinë ndaj një pakice kombëtare, në pasurinë, lindjen ose çdo rrethanë tjetër.*

*Askush nuk mund të diskriminohet nga ndonjë autoritet publik mbi ndonjë nga bazat që u përmendën më sipër.<sup>516</sup>*

Në legjislaturën e Maqedonisë së Veriut, Kushtetuta nuk ka ndonjë nen eksplicit për gjuhën e urrejtjes, edhe pse në frymën e saj mund të kuptohet se *askush nuk ka të drejtë të cenojë liritë e njeriut*; integritetin personal të tjetrit, lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit, shprehjes, informimit, tubimit (neni 16) lirisë fetare (neni 19), lirisë së tubimit (neni 20), të drejtën e zgjedhjes (neni 22), të marrjes pjesë në funksione (neni 23), lirisë së lëvizjes (neni 27), të drejtën e pronësisë dhe trashëgimisë (neni 30), të drejtën e pagës, pushimit (neni 32), të kompensimit dhe të sigurimit shëndetësor (neni 35-39) e shumë të tjera. I vetmi rast ku në Kushtetutë përdoret fjala “urrejtje” është ai në nenin 20 kur theksohet se *programet dhe veprimtaria e shoqatave civile dhe partive politike nuk mund të orientohen drejt rrënimit të dhunshëm të rendit kushtetues*

<sup>514</sup> Atanas Georgievski, Lençe Kocavska, Dushko Minovski, *Manual Gjyqësor për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi*, British Council, Shkup 2013, faqja 10,

<[https://www.britishcouncil.mk/sites/default/files/sudski\\_priracnik\\_al.pdf](https://www.britishcouncil.mk/sites/default/files/sudski_priracnik_al.pdf)>, [14.12.2019]

<sup>515</sup> Zejnulla Gruda, *Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut*, Libri I-III, Botimi IV, Universiteti FAMA, Prishtinë 2017, faqja 372

<sup>516</sup> Këshilli i Evropës, *Protokollin nr.12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut*, faqja 2, <[https://www.echr.coe.int/Documents/Library\\_Collection\\_P12\\_ETSI177E\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Library_Collection_P12_ETSI177E_ENG.pdf)>, [14.12.2019]

të Republikës dhe drejt nxitjes ose thirrjes së agresionit ushtarak, ose nxitjes së urrejtjes ose mosdurimit kombëtar, racor ose fetar.<sup>517</sup>

Kështu, gjuha e urrejtjes në Maqedoninë e Veriut është e përkufizuar me ligj të veçantë. Duke qenë se ligji vendoset në linjë të njëjtë me aktet ndërkombëtare, ai *synon* të sigurojë të njëjtat vlera sikurse aktet homologe ndërkombëtare; të drejtën e çdo personi për *barazi përpara ligjit; barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë e tij, si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi*.<sup>518</sup>

Në nenin 3 të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi renditet një gamë e gjerë karakteristikash të mbrojtura sikurse gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, origjina, përkatësia në grupin e marginalizuar, përkatësia etnike, gjuha, shtetësia, prejardhja sociale, religjioni ose bindja fetare, lloje të tjera bindjesh, arsimimi, përkatësia politike, statusi personal ose shoqëror, pengesa mentale (mendore) dhe trupore, mosha, gjendja familjare ose martesore, statusi pronësor, gjendja shëndetësore ose cilado bazë tjetër.<sup>519</sup>

Duke qenë se gjuha e urrejtjes nënkupton refuzimin (përbuzjen ose deklinacionin) racor, fetar, ideologjik, etnik, klasor, invalidor, seksual etj., atëherë të gjitha këto karakteristika quhen të mbrojtura dhe ndaj tyre *nuk mund të bëhet thirrje dhe as të përdoret* gjuhë urrejtjeje dhe diskriminuese.<sup>520</sup>

Duke marrë parasysh pasojat, vepra e gjuhës së urrejtjes çon në dëme ndaj individit, dëme emocionale dhe psikike, dëme në vetëbesimin, në të drejtën e barazisë, ndërkohë që në raste të përdorimit *masiv*, krimi i gjuhës së urrejtjes mund të çojë edhe në gjenocide ndaj popujve të tërë. Vepra e gjuhës së urrejtjes është e dënueshme, pasi paragjykimi që ajo nxit mund të prodhojë krim urrejtje<sup>521</sup> ndërkohë që, nga ana tjetër, paragjykimi nga gjuha e urrejtjes prodhon edhe *ofendim* dhe *shpifje*, që siç u theksua më sipër, edhe ato janë të dënueshme sipas Kodit Penal dhe Ligjit për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje.

\*\*\*

Rastet e përjetuara në Maqedoni, më së shumti janë ato për shkak të etnisë, fesë, kulturës dhe orientimit seksual. Fatkeqësisht, gjuha e urrejtjes nuk është regjistruar vetëm në konteste dypalëshe civile, por me përmasa më të gjera kur ato janë përmendur edhe në media. Më poshtë do të sjellim edhe raste konkrete të përdorimit të tyre ndër vite.

Nga ana tjetër, gama më e gjerë e përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit shënohet në internet, në portalet ose mediat online, për një arsye shtesë (siç u përmend më sipër); atë të mos rregullimit ligjor të tyre.

<sup>517</sup> Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë me amendamentet e kushtetutës I-XXXII*, Shkup 2016, faqja 24

<sup>518</sup> Këto parime përbëjnë qëllimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi – Shqipëri. Ndërsa në Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi në Maqedoninë e Veriut, qëllimet e ligjit nuk janë përmendur. [uart.edu.al](https://www.uart.edu.al), *Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi*, <[https://www.uart.edu.al/media/150329-Ligji%2010221\\_%202010%20per%20mbrojtjen%20nga%20%20diskriminimi.pdf](https://www.uart.edu.al/media/150329-Ligji%2010221_%202010%20per%20mbrojtjen%20nga%20%20diskriminimi.pdf)>, [14.12.2019]

<sup>519</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi*, faqja 60, <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/1654343CD9A0E24998781907DC19A99F.pdf>>, [15.12.2019]

<sup>520</sup> Elena Mihajlova, Jasna Baçova, Tome Shekerxhiev, Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes, OSBE, Polyesterday, Shkup 2013, faqja 24, <<https://www.osce.org/sq/skopje/116609>>, [15.12.2019]

<sup>521</sup> Po aty, faqja 34



Pavarësisht se Republikës së Maqedonisë së Veriut i nevojiten shumë harmonizime ligjore të reja për gjuhën e urrejtjes, veçanërisht në internet, Kodi Penal i sotëm sanksionon ato që lidhen me keqpërdorimin e lirisë së shprehjes e cila prodhon shkelje të lirive të tjetrit, diskriminim dhe dhunë. Sipas nenit 417, ai që bën dallime dhe shkel aktet ligjore që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare rrezikon deri në 5 vjet burg, ndërkohë që ai që promovon superioritet race në kurriz të një race tjetër, deri në 3 vjet burg.

*Neni 417*

*(1) Ai i cili në bazë të dallimit në racë, ngjyrë të lëkurës, nacionalitet apo prejardhje etnike, i shkelë të drejtat dhe liritë themelore ndërkombëtare, do të ndëshkohet me burgim prej 6 muaj deri në 5 vjet.*

*(2) Me dënimin nga paragrafi (1) do të ndëshkohet ai i cili bën ndjekje të organizatave ose individëve, për shkak të angazhimit të tyre për barabarësi të njerëzve.*

*(3) Ai që përhap ide të superioritetit të një race ndaj një tjetre, ose propagandon urrejtje racore apo nxit diskriminim racor, do të ndëshkohet me burgim prej 6 muaj deri në 3 vjet.<sup>522</sup>*

Ndërsa sipas nenit 394 të Kodit Penal, vepra e racizmit dhe ksenofobisë dënohet deri në 5 vjet burg, ndërsa ai që e kryen këtë vepër duke shkelur pozitën zyrtare dhe autorizimet (funktionar publik) deri në 10 vjet burg.

*Neni 394*

*Përhapja e materialeve raciste dhe ksenofobe nëpërmjet sistemit kompjuterik*

*(1) Ai që përmes sistemit kompjuterik përhap në publik material të shkruar racist dhe ksenofobik, fotografi ose prezantim tjetër idesh ose teorish e cila ndihmon, promovon ose nxit urrejtje, diskriminim ose dhunë, kundër cilitdo person ose grup, mbi bazën e racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes kombëtare ose etnike si dhe besimit fetar, do të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.*

*(2) Me dënimin nga paragrafi (1) i këtij neni do të dënohet edhe ai që këtë vepër e kryen përmes mjeteve të tjera të informimit publik.*

*(3) Ai që veprën nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni e kryen me shpërdorim të pozitës ose autorizimit, ose nëse për shkak të këtyre veprave ka çuar në prishje rendi dhe dhunë ndaj njerëzve ose dëm pronësor të përmasave të mëdha, do të dënohet me burgim nga një deri në dhjetë vjet.<sup>523</sup>*

Elemente inkriminuese të gjuhës së urrejtjes gjenden edhe në nenin 179 të Kodit Penal i pasuruar më tej me ndryshimet e reja të tij, si më poshtë.

*Neni 179*

*Ai i cili me qëllim të qesëndisjes (përbuzjes), publikisht do ta ekspozojë në tallje (poshtërim) popullin maqedonas dhe pjesëtarët e bashkësive që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, do të dënohet me dënim me para.<sup>524</sup>*

<sup>522</sup> Pravdiko.mk, Kodi Penal (ndryshime në 2013), <<https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf>>, [15.12.2019]

<sup>523</sup> Kodi Penal, po aty.

<sup>524</sup> Kodi Penal, po aty.

Ky nen është ndryshuar me amendimet e Kodit Penal. Së pari, bashkësitë etnike quheshin më herët si *nacionalitete* dhe së dyti, vepra e tillë parashikonte dënim me burg nga 3 muaj deri në 3 vjet. Por, dënimi drastik me burg u shndërrua vetëm në gjobë me para.

Ndërkaq, gjuha e urrejtjes (përbuzja dhe tallja si elemente inkriminuese) përkufizohet edhe në nenin 319, si më poshtë;

*Neni 319*

(1) Ai i cili me forcë, keqtrajtim, rrezikim të sigurisë, vënie në tallje (përbuzje) të simboleve nacionale, etnike ose fetare, me dëmtimin e sendeve të tjerëve, me përdhosjen e monumenteve, varreve ose në mënyrë tjetër do të shkaktojë ose do të nxisë urrejtje nacionale, racore ose fetare, përçarje dhe mosdurim, do të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

(2) Ai i cili, veprën nga paragrafi (1) e kryen me shpërdorim të pozitës ose autorizimit ose nëse për shkak të atyre veprave ka çuar në prishje rendi dhe dhunë ndaj njerëzve ose dëm pronësor të përmasave të mëdha, do të dënohet me burgim nga një deri në dhjetë vjet.<sup>525</sup>

Gjuha e urrejtjes përmendet edhe në Ligjin për Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Pikërisht, notat e gjuhës së urrejtjes gjenden te *thirrja* dhe *nxitja* e diskriminimit si veprë.

*Thirrja dhe nxitja e diskriminimit*

*Neni 9*

Si diskriminim do të konsiderohet edhe çdo aktivitet me të cilin ndonjë person në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë e thirr, inkurajon, jep udhëzime ose nxit personin tjetër që të kryejë diskriminim.<sup>526</sup>

Veprë përbëjnë edhe veprimet që mund të shqetësojnë dhe që përcëmojnë individin ose grupe të caktuara shoqërore.

*Shqetësimi*

*Neni 7*

(1) Shqetësimi dhe veprimi poshtërues paraqesin cenim të dinjitetit të personit ose të grupit të personave, që rrjedh nga baza diskriminuese dhe që ka për qëllim ose rezultat cenimin e dinjitetit të personit të caktuar ose krijimin, qasjen ose praktikimin e mjedisit kërcënues, armiqësor, poshtërues ose frikësues.

(2) Shqetësimi seksual është sjellje e padëshirueshme me karakter gjinor që shprehet në mënyrë fizike, verbale ose në çfarëdo mënyre tjetër, ndërsa ka për qëllim ose pasojë cenimin e dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet mjedis armiqësor, kërcënues, degradues ose poshtërues.<sup>527</sup>

Nga ana tjetër, edhe Ligji i Medias dhe ai për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike kanë nota të vërejtjes për gjuhën e urrejtjes edhe pse, sikurse theksuam më lart, ato nuk bëjnë qartësim për portalet.

<sup>525</sup> Kodi Penal, po aty.

<sup>526</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi*, faqja 62, <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/1654343CD9A0E24998781907DC19A99F.pdf>>, [15.12.2019]

<sup>527</sup> Po aty.

Ligji i Medias, që në nenin 4 të tij thekson ndalime të veçanta transmetuese për programe që nxitin gjuhë që çon në urrejtje ose mosdurim (jo-tolerancë) në bazë të racës, fesë, etnisë etj.

*Neni 4*

*Ndalohet që me publikimin, përkatësisht emetimin e përmbajtjeve në media të cenohet siguria nacionale, të nxitet shkelja e dhunshme e rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, të bëhet thirrje në agresion ushtarak ose konflikt të armatosur, të nxitet ose përhapet diskriminimi, mosdurimi ose urrejtja në bazë të racës, gjinisë, religjionit ose kombit.<sup>528</sup>*

Ndërkaq, më i ashpër është Ligji për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike që thekson të njëjtën përmbajtje sikurse neni 4 i Ligjit të Medias (në nenin 48 të tij), ndërkohë që në nenin 45 shton se operatorët radiodifuzivë nuk guxojnë të transmetojnë programe që bartin, përcjellin, bëjnë thirrje apo nxisin gjuhë urrejtje.

*Neni 45*

*.....(kufizim i shërbimeve nga shtetet e huaja nëse)  
- serviset programore të radiodifuzerëve nga shtetet e tjera në mënyrë evidente, seriozisht dhe rëndë i shkelin dispozitat e nenit 48 dhe nenit 50 të këtij ligji dhe nxisin urrejtje racore, gjinore, fetare ose nacionale dhe mosdurim.<sup>529</sup>*

Ligji për Shërbime Audio dhe Audiovizuale e thekson këtë gjë që në parimet e tij, madje, e ndalon urrejtjen dhe diskriminimin edhe në komunikimin komercial audiovizual (neni 53). Operatorët radiodifuzivë janë të obliguar që të respektojnë parimin e kushtetutshmërisë gjatë formulimit të informacioneve dhe programeve, përfshirë ndalimin për nxitjen e jo-tolerancës kulturore, etnike, religjioze, gjinore, racore, nacionale dhe formave të tjera (neni 111) dhe të mos i shmangen asnjëherë detyrimit të barabarësisë së lirive dhe të drejtave të qytetarit (neni 61).<sup>530</sup>

\*\*\*

Duhet të theksohet se prej kohësh shoqëritë demokratike kanë menduar kornizë ligjore ndaj veprimtarisë mediatike lidhur me gjuhën e urrejtjes. Deklarata për Parimet Themelore e miratuar në vitin 1978 nga UNESCO synon të kontribuojë në forcimin e paqes, mirëkuptimin ndërkombëtar, promovimin e të drejtave të njeriut, luftimin e shfaqjeve raciste, aparteidit dhe nxitjes së luftës... (neni 1).<sup>531</sup>

Kjo deklaratë nuk iu drejtohet vetëm mediave, por edhe shteteve përkatëse të cilat duhet të jenë vigjilente ndaj fenomeneve të tilla dhe jo vetëm që të krijojnë dhe mbështesin trupa ligjorë për monitorimin e mediave, por edhe të bashkëpunojnë ngushtë me gazetarët që t'i përmbahen etikës së tyre në ushtrimin e profesionit.

<sup>528</sup> Gazeta Zyrtare, *Ligji për Media*, faqja 84,

<<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/b063254742a44129b8dfe1221762ddb4.pdf>>, [15.12.2019]

<sup>529</sup> Gazeta Zyrtare, *Ligji për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike*, faqja 52,

<<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/b063254742a44129b8dfe1221762ddb4.pdf>>, [15.12.2019]

<sup>530</sup> Po aty.

<sup>531</sup> UNESCO, *Deklarata e Parimeve Themelore*, [http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL\\_ID=13176&URL\\_DO=DO\\_TOPIC&URL\\_SECTION=201.html](http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=13176&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html)>, [16.12.2019]

Edhe pse në vendet e Ballkanit, ku bën pjesë edhe Maqedonia e Veriut, është tepër e vështirë mosrënia pre e joshjes politike, gazetarët nuk guxojnë të shprehin qëndrime në favor të politikanëve, përveçse të ruajnë respektin ndaj tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë si gazetarë.

Kështu, në Kodin Etik të Gazetarëve, përveç parimeve që burojnë nga neni 16 i Kushtetutës, gazetarët duhet të përbetohen mbi nenin 10 të Kodit, si më poshtë;

*Neni 10*

*Gazetari nuk duhet të krijojë ose përpunojë me vetëdije informata që cenojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, nuk do të përdorë gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë ose diskriminim mbi çfarëdolloj baze (qoftë kombëtare, fetare, racore, gjinore, shoqërore, gjuhësore, politike, orientimi seksual...)<sup>532</sup>*

Po ashtu, neni pasardhës i të njëjtit Kod thekson;

*Neni 11*

*Gazetari duhet t'u përmbahet standardeve të pranuar shoqërore që kanë të bëjnë me mirësjelljen dhe respektimin e dallimeve etnike, kulturore dhe fetare në Maqedoni.<sup>533</sup>*

Gazetarët, mediat, pronarët e tyre, politikanët dhe gjyqësori duhet t'i përmbahen frymës për ndërtimin e demokracisë dhe shoqërisë qytetare, të respektojnë pluralizmin e ideve si dhe të kontribuojnë për forcim të shtetit juridik.

### 6.1.2 Raportimi i dyzuar dhe luftimi i këtij fenomeni

*Raportimi i dyzuar* është një term krejtësisht i ri i shpikur për herë të parë në këtë studim shkencor. Shumëkush në shtetin multi-etnik, multi-kulturor e multi-fetar të Maqedonisë së Veriut, e di se raportimet në media, të dallueshme jo vetëm për shkak të politikës ditore por mbi të gjitha për shkak të ndjenjës ndëretnike, ndërkulturore dhe ndërfetare që politika ka nxitur, kanë luajtur gjithnjë rolin e shkëndijës për të ndezur barutin e përçarjes së mëtejshme mes komuniteteve.

Në fjalorin e gjuhës shqipe, “raportim” nënkupton “njoftimin me shkrim ose me gojë të një personi ndaj një organi më të lartë ose eprori, lidhur me plotësimin e një detyre, një çështjeje ose për gjendjen e një pune; vë në dijeni!”<sup>534</sup> Ndërsa “tjetërsim” ose “tjetrazi” nënkupton “në një mënyrë tjetër; ndryshe, jo ashtu si është. Ia tregoi tjetërsoj çështjen... Ishte krejt tjetrazi!”<sup>535</sup> Po ashtu, “i dyzuar” nënkupton “praninë ose bashkëjetesën në të njëjtën kohë të dy dukurive, të dy trajtave, të dy mënyrave etj., që shpesh kundërshtojnë ose përjashtojnë njëra-tjetrën.”

<sup>532</sup> Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, *Kodi Etik i Gazetarëve*, <<http://znm.org.mk/%D0%BA%D0%BE%D0%B4%D0%B5%D0%BA%D1%81-%D0%BD%D0%B0-%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D1%80%D0%B8%D1%82%D0%B5/?lang=SQ>>, [16.12.2019]

<sup>533</sup> Po aty

<sup>534</sup> Fjalori i Gjuhës Shqipe 2006, <<https://fjalorthi.com/raportoj>>, [17.12.2019]

<sup>535</sup> Po aty

Në raportimet mediatike në Maqedoninë e Veriut, në të kaluarën por edhe tani (sikurse do të shihni në kapitullin pasardhës) është gati-gati e zakonshme që mediat të raportojnë ndryshe njëra-tjetrës, pavarësisht se bëhet fjalë për të njëjtën ngjarje që mbulohet. Raporte të shumta nga institucione ose institute studimore kanë treguar një ndarje të madhe mes mënyrës, kohëzgjatjes, formës dhe cilësimeve (citimeve) të raportimit në media, dhe kjo gjë nuk ka kontribuar në bashkëjetesën multi-etnike, multi-kulturore dhe multi-fetare në vend.<sup>536</sup>

\*\*\*

Cilat janë ato dallime më të shpeshta në raportimin e dyzuar mediatik në Maqedoninë e Veriut?

*Temat ndëretnike* – është e qartë se temat multi-etnike, multi-kulturore dhe multi-fetare zënë një vend të madh në raportimin mediatik në Maqedoninë e Veriut. Shumë prej tyre iniciohen nga mediat shqiptare, nisur nga diskriminimi, shkelja e të drejtave të garantuara me kushtetutë (gjuha, mjetet e identifikimit), garancitë që burojnë nga Marrëveshja e Ohrit (përfaqësimi) etj., ose në rastet kur autoritetet (të komunitetit të shumicës), pjesëtarë të komunitetit të shumicës ose mediat maqedonase, me qëndrimet e tyre kanë nxitur më tej tensionet ndëretnike (rasti “Monstra” në vitin 2012, ngjarjet e Komanovës në vitin 2015), ndërkulturore (karnavalet e Vevçanit), ndërfetare (iniciativa e Kongresit Botëror Maqedonas për Kisha dhe Kryqe nëpër rajone të Shkupit) etj.<sup>537</sup> Shpeshherë, historia ka treguar se edhe vetë partitë në pushtet kanë qenë pjesë e skenarëve të ndryshëm incidentesh ndëretnike (Platforma e Tiranës) dhe ndërfetare (ngjarjet me BFI-në).

Po ashtu, ka pasur raste kur institucionet shtetërore, për shkak të vendosjes në garë politike për vota, kanë vendosur në lojë marrëdhëniet ndëretnike, kanë iniciuar ose mbuluar raste të caktuara, ose i kanë kahëzuar ato sipas qëllimit të tyre politik.<sup>538</sup>

*Cilësimet* – në media, në shumë raste, kthehen plagët e vjetra; gjuha e dikurshme e konfliktit të vitit 2001. Kjo është përdorur në raste të incidenteve, kur shqiptarët marrin cilësime të vrazhda si “terroristë”, apo për raste në ngjarje sportive si “huliganë”, apo rastet kur kërkojnë të drejtat e tyre por ato cilësohen se kanë prapavijë “Shqipërinë e Madhe”.

*Etiketimet* – A është “e domosdoshme” që në lajme qytetarët të ndahen në kategori etnike apo fetare. Në gjuhën e përditshme nëpër raportime, përfshi edhe në televizionet kombëtare, jo vetëm që nuk respektohet e drejta e verifikimit të pafajësisë (prezumimit) por mediat guxojnë të japin detaje mbi identitetin, kombësinë dhe madje edhe dukjen e një personi, veçanërisht nëse është i dyshuar për ndonjë vepër.

*Minutazhi* – në lajmet qendrore shkeleshin (ende shkelen) standardet e paketimit. Në edicionet e lajmeve, televizionet shpeshherë i kushtojnë hapësirë marramendëse ngjarjeve të

<sup>536</sup> Shkolla e lartë e gazetarisë dhe e marrëdhënieve me publikun, *Raportimi mediatik mbi çështjet ndëretnike dhe ndërfetare në Republikën e Maqedonisë*, Analizë kuantitative e përmbajtjeve të publikuara në media brenda periudhës: 16 janar – 12 shkurt 2012 (Analizë konkluzionesh), <[http://iks.edu.mk/attachments/article/138/1138\\_Analiz%C3%AB%20kuantitative%20e%20p%C3%ABrbajtjeve%20t%C3%AB%20publikuara%20n%C3%AB%20media%20brenda%20peridh%C3%ABs%2016%20janar%20E2%80%93%2012%20shkurt%202012%20\(P%C3%8BRMBLEDHJE%20KONKLuzionesh\).pdf](http://iks.edu.mk/attachments/article/138/1138_Analiz%C3%AB%20kuantitative%20e%20p%C3%ABrbajtjeve%20t%C3%AB%20publikuara%20n%C3%AB%20media%20brenda%20peridh%C3%ABs%2016%20janar%20E2%80%93%2012%20shkurt%202012%20(P%C3%8BRMBLEDHJE%20KONKLuzionesh).pdf)>, [17.12.2019]

<sup>537</sup> ALSAT, *Shkupi, “vatër” e kryqeve*, <<https://www.alsat-m.tv/32312/>>, [17.12.2019]

<sup>538</sup> META, *Pse kamerat kanë incizuar Spasovin, por jo “Monstrën”, “Mlladenovin” dhe “Neshkovskin”?*, <<https://meta.mk/sq/pse-kamerat-kane-incizuar-spasovin-por-jo-monstren-mlladenovin-dhe-neshkovskin/>>, [17.12.2019]

caktuara, në disa raste edhe deri në 9 minuta një kronikë. Kjo hapësirë “e paarsyetuar” për një ngjarje të caktuar, zakonisht ka një objektiv, mbërritjen sa më fuqishëm të qëllimit për të cilën është përgatitur kronika. Kur kronika atakon një grup të caktuar shoqëror, ose përmes atakimit të institucioneve për mos reagim në kohë ndaj një grupi shoqëror, nxit ndjenjën e urrejtjes ndaj gjithë komunitetit të cilit i përket individi ose grupi i dyshuar.

*Titujt kryesorë* – në lajme, televizionet shpeshherë nxitin jehonë më të madhe nëse një ngjarje e caktuar renditet si *titull kryesor* ose *kronika e parë* e lajmeve. Tjerrja e një ngjarjeje nga disa kënde, komentimi i saj, kërkesa dhe presioni drejtuar institucioneve për përgjigje lidhur me atë ngjarje, dërgimi i një sinjali *ndëshkimi* ndaj gjithë komunitetit tjetër, është e patjetërsueshme për nga ndikimi. Mediat shpeshherë kujdesen që pavarësisht ndonjë ndodhie akoma më sensacionale, ato të vazhdojnë të mbajnë si titull të parë vazhdimin e lajmit të mëhershëm, vetëm për të çuar deri në fund misionin e caktuar. Po ashtu, te disa media ndeshen edhe praktika që paralajmërimi i titujve të shfrytëzohet si koment (qëndrim subjektiv i gazetarit ose redaktorit, me qëllim që të ndikojë në opinionin e shikuesve).<sup>539</sup>

*Burimet* – siç është vërejtur edhe herëve të kaluara, në media ka raste kur burimet thirren si konfidenciale, por është i vështirë vërtetimi i vërtetësisë së tyre, ose i vështirë vërtetimi i civateve të tyre. Ndodh që, veçanërisht në media të shkruara, burimet të vendosen në forma të pasakta ose që lajmet të mos kenë fare burim, të kenë burime të sajuara ose burime në kushte anonimatit.

*Televizioni shtetëror* – nëse mediat private ndodh që të kenë qëndrime të kundërta, televizionet që përbëjnë transmetuesin shtetëror ndajnë qëndrime akoma më të kundërta. Së pari, duke qenë se janë pjesë përbërëse e një transmetuesi shtetëror, si televizione të tilla, ato duhet të promovojnë kohezionin, bashkëjetesën dhe të mirat e përbashkëta që ndajnë komunitetet. Në realitet ndodh që dy programet televizive të shfaqin lajme, qëndrime, tituj dhe përmbajtje krejtësisht të ndryshme (me burime të njëanshme), duke e thelluar kështu ndarjen mes komuniteteve, në vend që të ndërtojnë ura lidhëse dhe të promovojnë kohezionin.

*Gazetaria e zgjidhjeve* – është një lloj i gazetarisë që përveç raportimit, tenton të ofrojë edhe zgjidhje të çështjeve. Në mediat e Maqedonisë së Veriut, ky koncept është thuajse i paarrtshëm. Mediat, varësisht lidhjeve politike apo etnike që kanë, tentojnë me çdo kusht që të shkojnë deri në fund të hallkës së përgjegjësisë (pra, kërkojnë përgjegjësi nga shteti, nga partitë, nga komuniteti i caktuar duke ia veshur atij të gjithë fajin) por asnjëherë nuk ofrojnë zgjidhje përmes ndryshimit të politikave; të matin perceptimet, të bëjnë analiza, të ofrojnë zgjidhje dhe të mund të parashikojnë edhe rezultatet nga zgjidhja. Përkundrazi, në raste analizash, shpeshherë mediat ekspozojnë analistë të caktuar (edhe ata me bindje politike ose të angazhuar nga parti) për ta përdorur qëndrimin e tyre për të forcuar vetëm tezën dhe qëllimin që duan të përforcojnë përmes raportimit të tyre.

*Marketingu* – për shkak të reklamimit, parave që mediat marrin nga një subjekt i caktuar politik, i bën ato të bien pre e frymës që bartet nga reklamimi. Për shembull, kur një parti financon një fushatë ose reklamë (qoftë për zgjedhje parlamentare, kongres etj.) në një televizion të caktuar, atëherë vis a vis televizioni bëhet i prirur të ndjekë të njëjtën frymë; kjo për shkak të

<sup>539</sup> Shkolla e lartë e gazetarisë dhe e marrëdhënieve me publikun, *Raportimi mediatik mbi çështjet ndëretnike dhe ndërjetare në Republikën e Maqedonisë*, Analizë kuantitative e përmbajtjeve të publikuara në media brenda periudhës: 16 janar – 12 shkurt 2012 (Analizë konkluzionesh), <[http://iks.edu.mk/attachments/article/138/1138\\_Analiz%C3%AB%20kuantitative%20e%20p%C3%ABrmbajtjeve%20t%C3%AB%20publikuara%20n%C3%AB%20media%20brenda%20periudh%C3%ABs%2016%20janar%20E2%80%93%2012%20shkurt%202012%20\(P%C3%8BRMBLEDHJE%20KONKLuzionesh\).pdf](http://iks.edu.mk/attachments/article/138/1138_Analiz%C3%AB%20kuantitative%20e%20p%C3%ABrmbajtjeve%20t%C3%AB%20publikuara%20n%C3%AB%20media%20brenda%20periudh%C3%ABs%2016%20janar%20E2%80%93%2012%20shkurt%202012%20(P%C3%8BRMBLEDHJE%20KONKLuzionesh).pdf)>, [17.12.2019]

mbështetjes financiare (më e pakta që mund të bëj, të heshtë për hir të reklamës). Në tregun mediatik ndodh që në fushata, partia maqedonase VMRO DPMNE të synojë vetëm komunitetin maqedonas, LSDM-ja edhe atë maqedonas por edhe atë shqiptar (me tone delikate sepse sa herë që trumbeton të drejtat e shqiptarëve mund të humb vota në elektoratin maqedonas), partitë shqiptare synojnë kryesisht tregun e reklamave në mediat shqiptare se sa ato maqedonase). Ka pasur raste, në zgjedhje të kaluara, kur partitë maqedonase trumbetonin me të madhe të kërkonin mbështetjen e elektoratit – konkretisht, VMRO DPMNE-ja kërkonte 62 deputetë në mënyrë që të mos varej më nga BDI-ja, ndërsa BDI-ja kërkonte 25 deputetë sepse vetëm ashtu mund ta kushtëzonte VMRO-në.<sup>540</sup>

\*\*\*

Elementet e mësipërme janë vetëm disa nga format më të qarta të vërejtjes së raportimit të dyzuar. Mediat, veçanërisht ato më të mëdha, përdorin edhe aspekte të tjera më të sofistikuara për të bërë politikën e tyre redaktuese, për të mbërritur te qëllimi i caktuar ose qoftë edhe për të kamufluar faktet kur një lajm nuk shkon në favor të interesit që ato mbrojnë.

Për shembull, në këtë radhitje të elementeve të mësipërme nuk u përmendën zhanret e gazetarisë të përdorura në mbulimin e ngjarjeve ndëretnike, ndërkulturore e ndërfetare; nuk u përmend qasja ndaj lajmit (nëse është pozitive, negative, ambivalente apo neutrale), tonaliteti i lajmit, stilistika dhe terminologjia (ngjyrat e termave të përdorur); apo edhe stilizimi i kamuflimit të një ngjarje (shpeshherë mediat maqedonase – duke qenë se janë më të shumta në numër – diktojnë tjetër ngjarje më të rëndësishme në opinion duke dashur të mbivendosin një shqetësim real nga një ngjarje që nuk shkon në favor të interesit të tyre).

\*\*\*

Por, ndërsa flasim për raportimin e dyzuar mediatik dhe nxitjen e tensioneve, është e pamundur që të anashkalohej përgjegjësia e institucioneve me karakter rregullues dhe vetërregullues të mediave, si dhe, mbi të gjitha, e institucioneve shtetërore; të të tre pushteteve – ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit.

Praktikat e kaluara, në raste të caktuara (që do të theksohen më poshtë) kanë treguar se komisionet parlamentare apo shtetërore që luftojnë diskriminimin mbi baza etnike, kulturore, fetare, racore, gjinore etj., nuk kanë reaguar aspak në raste të shkeljeve flagrante të të drejtave të individit. Madje, në historinë e Maqedonisë së Veriut janë regjistruar edhe raste të tilla si ai i vetë drejtores së Komisionit për Marrëdhënie mes Bashkësive Fetare dhe Grupeve Religjioze, Valentina Bozhinovska, me thirrjet e saj “nata e shpatave”<sup>541</sup> apo “përshtëndes “branitellat” – forcat maqedonase të sigurisë gjatë konfliktit të vitit 2001”.<sup>542</sup>

Edhe Prokuroria, si organ i drejtësisë, gëzon të drejtën ligjore të hapjes së hetimeve qoftë edhe nga zërat në opinion, në media e kudo tjetër. Ndaj shumë akteve diskriminuese, thirrjeve të

<sup>540</sup> Admir Qose, *Media në Maqedoni dhe e nesërmyja e saj*, Revista “Shenja” – botim i muajit korrik 2014, faqja 41

<sup>541</sup> Teofil Bllazhevski, *Kundërspin: Nata e gjuhës së urrejtjes*, Vërtetmatës.mk, <<https://vertetmates.mk/kunderspin-nata-e-gjuhes-se-urrejtjes/>>, [19.12.2019]

<sup>542</sup> ALSAT, *Thirrje antishqiptare në protestën e VMRO-së*, <<https://www.alsat-m.tv/300656/>>, [19.12.2019]

tilla nxitëse etj., organet e drejtësisë nuk kanë ngritur hetime. Mos hetimi i rasteve, sikurse theksojnë studiuesit, mund të nxitë të gjitha format e konflikteve, fizike, emocionale etj.

Nga ana tjetër, është çështje e institucioneve mediatike të punojnë në mënyrë sistematike me gazetarët, përfaqësuesit e mediave, organe të tjera relevante etj., për të treguar peshën e vërtetë të nenit më të rëndësishëm të Kodit të Etikës së Gazetarëve – kyç për shtetet multi-etnike, multi-kulturore dhe multi fetare.

#### Neni 10

*Gazetari me vetëdije nuk do të krijojë ose përpunojë informata, që cenojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, nuk do të përdorë gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë ose diskriminim mbi çfarëdo lloj baze qoftë (kombëtare, fetare, racore, gjinore, shoqërore, gjuhësore, politike, orientimi seksual...)<sup>543</sup>*

\*\*\*

Çfarë duhet bërë që mediat të mos nxitin urrejtje dhe mosdurim mes komuniteteve?

Siç bën apel një nga studiueset më të zëshme të diversitetit Milica Peshiq,<sup>544</sup> stereotipat dhe konkurrenca për të nxirë imazhin e tjetrit, duhet të marrin fund! Mungesa e tolerancës bazuar te etnia, kultura, feja, gjinia, statusi shoqëror etj., mund të krijojnë ekstremizmin.<sup>545</sup> Media duhet të përfshijë të dyja palët dhe të ndihmojë audiencën që të kuptojë të drejtat dhe nevojat e komuniteteve. Pa një raportim të drejtë, të saktë dhe afirmues, të kuptuarit e audiencës nuk do kalojë dot prapun e sfidimit të paragjyqimeve...

Sa u takon gazetarëve në Maqedoninë e Veriut, lista e normave ligjore dhe parimeve nuk është aq e madhe;

1) Dispozitat e nenit 10 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, të integruara në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në Ligjin për Radiodifuzion që i referohen parimeve të respektimit të të drejtave dhe lirive të individëve si dhe grupeve dhe komuniteteve të ndryshme (mbi të cilat duhen ndërtuar raportimet).

2) Kodi i gazetarëve (konkretisht neni 10 sipas të cilit “gazetari nuk do të krijojë e as

<sup>543</sup> Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, *Kodi Etik i Gazetarëve*, <<http://znm.org.mk/%D0%BA%D0%BE%D0%B4%D0%B5%D0%BA%D1%81-%D0%BD%D0%B0-%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D1%80%D0%B8%D1%82%D0%B5/?lang=SQ>>, [19.12.2019]

<sup>544</sup> Milica Peshiq, Drejtore e Institutit të Diversitetit. Me projektin e tij të parë që në vitin 1998, ky institut tenton të lidhë mediat, gazetarët, shoqatat e tyre, shkollat e gazetarisë si dhe qendrat e ndihmës në këtë fushë, anembanë Evropës. Peshiq theksonte në parhyrje të Manualit të Raportimit të Diversitetit në vitin 2003 se “pavarësisht dallimeve tona, të gjithë jemi anëtarë të komuniteteve ku jetojmë e punojmë. Të gjithë duam të jetojmë në paqe e të kontribuojmë për shoqëritë tona. Të gjithë duam të jemi në gjendje të ushqejmë familjet tona, të edukojmë fëmijët tanë. Dhe ne duhet të mësojmë ta trajtojmë diversitetin tonë aq befasues si një burim force dhe shprese, të pasurimit dhe të kuriozitetit, jo si një justifikim për dhunë dhe shkak për dëshpërim. Gazetarët kanë mundësi ta lehtësojnë procesin e ripajtimt.

David Tuller, *Manuali i Raportimit të Diversitetit*, Instituti i Diversitetit të Medias & Samizdat B92, Londër 2003, faqja 14

<sup>545</sup> Po aty, faqja 13



të përpunojë me vetëdije informacione të cilat cenojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, nuk do të përdorë gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë dhe diskriminim mbi asnjë bazë (nacionale, fetare, racore, gjinore, sociale, gjuhësore, orientim seksual, politik...), si edhe neni 11 ku thuhet se “gazetari do të respektojë standardet e përgjithshme të pranuar shoqërore të dinjitetit dhe respektit për diversitetin etnik, kulturor dhe religjioz në Maqedoni”.

3) Kodi i parimeve për sjelljen e gazetarëve të Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve i cili, ndër të tjera, përcakton se “gazetarët duhet të jenë të vetëdijshëm për rrezikun e nxitjes së diskriminimit nëpërmjet mediave dhe duhet të bëjnë çdo përpjekje për të shmangur diskriminimin në bazë të racës, gjinisë, orientimit seksual, gjuhës, religjionit, përkatësisë politike apo ndonjë opinionin tjetër si dhe origjinës nacionale dhe shoqërore.”<sup>546</sup>

4. Udhëzimet ndërkombëtare, doracakët e dalë nga media me përvoja më të mëdha se sa Maqedonia e Veriut, studimet e shumta nga rastet e deridjeshme në vend por edhe rajone të ngjashme multi-etnike të cilat mund të na ofrojnë një trase ku media mund të kontribuojë në rritjen e pajtimit dhe promovimin e bashkëjetesës.

### 6.1.3 Aftësia e medias për rregullim/vetërregullim

Termi “rregullim”, në gjenezë përbën rregullat që imponohen nga autoriteti (juridiksioni) i ligjit. Kur bëhet fjalë për “rregullim në media”, pavarësisht dallimeve që ka ky komplet ligjor mes shteteve; me dispozita, norma, rregulla e procedura, qëllimi është thujtse i njëjtë për të gjithë shtetet që aplikojnë ligje mbi median; bëhet fjalë për mbrojtje të interesit të publikut, inkurajim të konkurrencës së ndershme me rregulla të barabarta në veprimtari, treg efikas mediash si dhe standarde të reja teknologjike.<sup>547</sup> Këto shtylla vis a vis diktojnë vizionin për pluralizëm, diversitet, konkurrencë dhe liri.

Termi “rregullim” në pamje të parë duket se bie ndesh pikërisht ne vizionet e “pluralizmit”, “diversitetit”, “konkurrencës” dhe “lirisë” pasi asnjë nga këto ndryshore nuk mund të marrë formë të prerë sikurse dikton ligji. Edhe liria, liria e shprehjes, shumëllojësia dhe promovimi i të qenit ndryshe nuk mund të kenë kufij të përcaktuar qartë nga ligji. Prandaj, si koncepte, këta terma bien më shumë në sferën e vetërregullimit, që në fakt nënkupton organizimin në mënyrë vetjake pa ndihmë nga trupa të jashtëm që mund të ndërhyjnë në veprimtarinë e tij.

Vetë koncepti i vetërregullimit ndryshon nga industria në industri, por sikurse thonë një sërë studiuesish, vetërregullimi rrallë mund të ekzistojë pa ndonjë marrëdhënie mes industrisë

<sup>546</sup> Shkolla e lartë e gazetarisë dhe e marrëdhënieve me publikun, *Raportimi mediatik mbi çështjet ndëretnike dhe ndërjetare në Republikën e Maqedonisë*, Analizë kuantitative e përmbajtjeve të publikuara në media brenda periudhës: 16 janar – 12 shkurt 2012 (Analizë konkluzionesh), <[http://iks.edu.mk/attachments/article/138/1138\\_Analiz%C3%AB%20kuantitative%20e%20p%C3%ABrmbajtjeve%20t%C3%AB%20publikuara%20n%C3%AB%20media%20brenda%20periudh%C3%ABs%2016%20janar%20E2%80%93%2012%20shkurt%202012%20\(P%C3%8BRMBLEDHJE%20KONKLuzionesh\).pdf](http://iks.edu.mk/attachments/article/138/1138_Analiz%C3%AB%20kuantitative%20e%20p%C3%ABrmbajtjeve%20t%C3%AB%20publikuara%20n%C3%AB%20media%20brenda%20periudh%C3%ABs%2016%20janar%20E2%80%93%2012%20shkurt%202012%20(P%C3%8BRMBLEDHJE%20KONKLuzionesh).pdf)>, [20.12.2019]

<sup>547</sup> Des Freedman, *Media Regulation*, Oxford Bibliographies, <<https://www.oxfordbibliographies.com/view/document/obo-9780199756841/obo-9780199756841-0095.xml>>, [20.12.2019]

dhe qeverisë, si dhe natyrën e perceptimit të publikut mbi këtë marrëdhënie mes sektorit privat dhe shtetit.<sup>548</sup>

Maqedonia e Veriut ka një histori të gjatë me median “pluraliste”, sikurse edhe vetë tranzicioni i gjatë dhe beteja e gjatë, nga njëra anë e pushtetit për të ruajtur ndikimin dhe nga ana tjetër e mediave e cila kërkon (ose nuk kërkon) të çlirohet nga ndikimi.

### 6.1.3.1 Institucionet rregulluese dhe vetërregulluese të medias

“Një gazetar nuk thotë kurrë ‘unë mendoj...’. Gazetari ka vetëm faktet dhe kërkon llogari për premtimet e dhëna nga subjekte të caktuara, si dhe kërkon gjithmonë më të mirën, edhe kur një politikë të jetë sado e mirë për qytetarin” – kështu thoshte Al Tompkins në muajin tetor gjatë një vizite në Institutin Poynter, institucionin më të lartë të gazetarisë amerikane.<sup>549</sup> Sigurisht, Tompkins e gjente bazën te një nga nenet më domethënëse të Kodit Etik të Gazetarëve, (neni 10) që thotë “Gazetarët duhet të bëjnë dallim mes fakteve dhe mendimeve, mes lajmit dhe komentit...”<sup>550</sup>

Por, edhe vetë SHBA-ja nuk është e para në listën sa i përket lirisë së shprehjes, zhvillimit të gazetarisë, rregullimit apo raporteve të saj me pushtetin.<sup>551</sup>

Në Maqedoninë e Veriut, media është në një udhëkryq midis idesë së “vetërregullimit”, por reformat mbi median, përvojat mbi ndërhyrjen e politikës, biznesit, grupeve të caktuara të lobimit, mangësive ligjore, mangësive të tregut, mungesës së profesionalizmit etj., nuk mundësojnë formësimin e një kornize drejt kësaj ideje. Në qeverinë aktuale, por sikurse edhe në çdo qeveri (të cilat janë gjithnjë të prirura të kenë ndikim mbi mediat) ka ministër pa resor i obliguar për komunikimin.<sup>552</sup> Po ashtu, një makineri e madhe e PR (Marrëdhëniet me Publikun, dukjes së ministrave dhe qeverisë, qasjes me median etj.) qëndron prapa garniturës jo vetëm në promovimin e saj, por ndonjëherë edhe të bëjë “presione” ndaj medias apo “ndreqje” të situatave të pakëndshme.

Pavarësisht se këto forma komunikimi zbatohen në kushte të sofistikuar, pasi edhe propaganda në ditët e sotme ka ndryshuar formë, strukturë dhe stilizime, në fund të fundit, formalo-juridikisht mund të thuhet se është vazhdimësi e praktikës së dhjetëra viteve më parë, (siç është theksuar më sipër) kur në epokën komuniste kishte edhe *ministër propagande*.

<sup>548</sup> Monroe Edwin Price, Stefaan G. Verhulst, Stefaan Verhulst, *Self-regulation and the Internet*, Kluwer Law International, The Netherlands 2005, faqja 3,

<[https://books.google.mk/books?id=ssIvJfunkO8C&pg=PA3&dq=self+regulation+definition&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwi\\_8MvDscLmAhWPTRUIHSIxAPoQ6AEIKDAA#v=onepage&q=self%20regulation%20definition&f=false](https://books.google.mk/books?id=ssIvJfunkO8C&pg=PA3&dq=self+regulation+definition&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwi_8MvDscLmAhWPTRUIHSIxAPoQ6AEIKDAA#v=onepage&q=self%20regulation%20definition&f=false)>, [21.12.2019]

<sup>549</sup> Shkëputur nga citatet e marra në udhëtimin zyrtar në SHBA, program IVLP i Ambasadës Amerikane në Shkup, nga datat 21 shtator deri në 12 tetor.

<sup>550</sup> Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, *Kodi Etik i Gazetarëve*, <<http://znm.org.mk/%D0%BA%D0%BE%D0%B4%D0%B5%D0%BA%D1%81-%D0%BD%D0%B0-%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D1%80%D0%B8%D1%82%D0%B5/?lang=SQ>>, [21.12.2019]

<sup>551</sup> Vetë presidenti amerikan Donald Trump kishte guxuar t’i kundërvihet ashpër medias duke i quajtur gazetarët deri edhe në “Enemy of People” (armik i Popullit).

The guardian, ‘Enemy of the people’: Trump’s war on the media is a page from Nixon’s playbook, <<https://www.theguardian.com/us-news/2019/sep/07/donald-trump-war-on-the-media-opo-research>>, [22.12.2019]

<sup>552</sup> Në qeverinë 2016-2020, ministër pa resor i obliguar për komunikimin është Robert Popovski.

Institucioni i vetëm rregullator, i cili në bazë të ligjit bart veprimtari *rregulluese*, është Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Kjo agjenci<sup>553</sup> është një trup rregullator i pavarur dhe jofitimprurës dhe në bazë të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale mbi të cilin e bazon veprimtarinë e vet, bart edhe përgjegjësinë e penalitetit (ndëshkimit), filluar që nga vërejtjet e deri edhe te masat konkrete të marrjes së lejeve të transmetimit (s qarohet më poshtë në nenin 6 dhe me nenin 61 të saj). Agjencia kujdeset për pluralizmin mediatik, profesionalizmin, dhënien/heqjen e lejeve të transmetimit televiziv ose radiofonik, mbron interesin e mediave për një treg të barabartë dhe pa përqendrim (monopol mediatik), por njëkohësisht mbron edhe interesin e qytetarit dhe çdo kategorie në përputhje me dispozitat ligjore.

Është pikërisht neni 61 i Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale që i detyron transmetuesit që gjatë veprimtarisë së tyre t'u përmbahen parimeve për shfaqjen në mënyrë objektive dhe të paanshme të ngjarjeve, me trajtim të barabartë të pikëpamjeve dhe mendimeve të ndryshme, si dhe autonomi, pavarësi dhe përgjegjësi për të gjithë ata që marrin pjesë në krijimin e programit dhe krijimin e politikës redaktuese.<sup>554</sup>

*Neni 61  
Parime<sup>555</sup>*

*Radiodifuzerët, gjatë kryerjes së veprimtarisë, duhet të respektojnë parimet si vijojnë: - kultivimin dhe zhvillimin e vlerave humane dhe morale të njeriut dhe mbrojtjen e privatësisë dhe dinjitetit të personalitetit, - barazinë e lirive dhe të drejtave pavarësisht gjinisë, racës, origjinës nacionale, etnike dhe sociale, bindjes politike dhe fetare, gjendjes pronësore dhe shoqërore të njeriut dhe qytetarit, - nxitjen e frymës së tolerancës, respektimit të ndërsjellë dhe mirëkuptimit ndërmjet individëve me prejardhje të ndryshme etnike dhe kulturore, - mbrojtjen e identitetit të viktimave të dhunës, - respektimin e prezumimit (vërtetimit) të pafajësisë, - nxitjen e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, ndjenjën e publikut për drejtësi dhe për mbrojtje të lirive demokratike, - transparencën e programeve për shprehjen e kulturave të ndryshme që janë pjesë përbërëse e shoqërisë; - ruajtjen dhe kultivimin e identitetit nacional, kulturës gjuhësore dhe krijimtarisë vendore, - paraqitjen e ngjarjeve në mënyrë objektive dhe të paanshme me trajtim të njëjtë të pikëpamjeve dhe mendimeve të ndryshme dhe mundësimin e formimit të lirë të mendimit të publikut për ngjarje të caktuara dhe çështje, - respektimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, - respektimin e fshehtësisë së burimit të informatës, - garantimin e të drejtës së përgjigjes dhe korrigjimit dhe - mëvetësinë, pavarësinë dhe përgjegjësinë e redaktorëve, gazetarëve dhe autorëve tjerë gjatë krijimit të programeve dhe krijimit të politikës redaktuese.*

Pikërisht, respektimi i këtyre standardeve themelore të gazetarisë është çështje e etikës të gazetarisë profesioniste. Përveç ndërmarrjes së masave në pajtim me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në rastet kur është bërë shkelje e dispozitave të tij apo

<sup>553</sup> Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, <<https://avmu.mk/sq/kopetencat-e-agjencise-2/>>, [22.12.2019]

<sup>554</sup> Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, *Vetërregullimi në media dhe komunikimi ndërsektorial në funksionimin e Këshillit për Etikë në Media në Maqedoni (KEMM)*, tetor 2017, <<https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2016/03/Vet%C3%ABrregullimi-n%C3%AB-mediat-dhe-komunikimi-nd%C3%ABrsektorial-n%C3%AB-funksionimin-e-K%C3%ABshillit-p%C3%AB-etik%C3%AB-n%C3%AB-media-n%C3%AB-Maqedoni-%E2%80%93-dhjetor-2017.pdf>>, faqja 11, [22.12.2019]

<sup>555</sup> Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë, *Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale*, neni 61, <[http://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/legislation/26.12.2013.pdf](http://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/legislation/26.12.2013.pdf)>, [23.12.2019]

rregullave të miratuara në bazë të tij, si dhe kushtet dhe obligimet nga lejet,<sup>556</sup> kjo agjenci bashkëpunon edhe me institucione vetërregulluese, vendimet e të cilave pavarësisht se nuk kanë penalitete ndaj mediave, shërbejnë për ndërgjegjësimin e mediave dhe respektimin e Kodit të Etikës.

Kështu, rolin kryesor në aspektin e vetërregullimit të mediave, e luan Këshilli për Etikë në Media në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ky institucion, sikurse flet edhe emri i tij, ka në fokus etikën në media ndërkohë që edhe fushëveprimi i saj shtrihet nga ndërtimi dhe pranimi i një Kodi Etik të gazetarëve, përmbajtja e mediave ndaj këtij kodi, e deri te ankesat që institucionet apo edhe vetë qytetari mund të paraqesë kur privatësia dhe dinjiteti i tij shkelen, ose edhe kur ata nuk marrin pritshmëritë e tyre nga një media që është përbetuar t'i përmbahet Kodit të Etikës.

Në shumë vende, këtë rol e bëjnë Këshillat e Shtypit ose Ombucmen-ët, ndërsa në Maqedoninë e Veriut, Këshilli për Etikë në Media, i cili është themeluar në vitin 2014<sup>557</sup> ka organin e tij kryesor, Komisionin e Ankesave. Ky Komision<sup>558</sup> merret me shqyrtimin e ankesave që vijnë nga palë të ndryshme, dhe këtë e rregullon me nenin 3 të rregullores së punës së Komisionit;

#### *Neni 3*

*Komisioni për ankesa shqyrton të gjitha ankesat e pranuar në lidhje me shkeljen e standardeve profesionale dhe etike në mediat e shkruara (në shtyp dhe në agjencitë e lajmeve), mediat elektronike (TV dhe radio) dhe në mediat e internetit në Maqedoni.*

*Ankesat anonime nuk shqyrtohen.*

#### *Neni 4*

*Ankesë lidhur me përmbajtjet e publikuara në media të shtypura, elektronike dhe online, mund të parashtrijë çdo qytetar, person juridik, organizatë qytetare dhe organizatë ndërkombëtare. Ankesa mund të parashtrihet kundër një media të caktuar. Nuk është e mundur të parashtrihen ankesa kundër gazetarëve individualë.<sup>559</sup>*

Sipas rregullores, ky Komision, përveç shqyrtimit të lëndës, inicion shpeshherë edhe formë pajtimi midis palëve, duke ndërmjetësuar që media të shfrytëzojë të drejtën për t'iu përgjigjur parashtruesit të ankesës me argumentet që posedon (neni 14). Në rast të fitimit të kontestit nga pala ankuuese, Komisioni i kërkon shkelësit (medias) që ta shpallë vendimin në të njëjtin vend ku është publikuar edhe artikulli i kontestuar (neni 18).

Vërtetimi (dëshmimi) i përgjegjshmërisë së medias është një nga shtyllat kryesore të qëllimit të vetërregullimit në media.<sup>560</sup> Ndërsa, vlera e një organi vetërregullues qëndron mbi të

<sup>556</sup> Po aty, neni 6

<sup>557</sup> Këshilli për Etikë në Media, <<https://semm.mk/sq-al/>>, [23.12.2019]

<sup>558</sup> Kryetar i Komisionit për Ankesa i Këshillit për Etikë në Media në Maqedoni është Mirçe Adamçevski, dhe Komisioni numëron gjithsej 7 anëtarë (2 përfaqësues të pronarëve të mediave, 2 përfaqësues të gazetarëve dhe 3 janë përfaqësues nga jeta publike).

<sup>559</sup> Rregullorja për Punë e Komisionit për Ankesa pranë Këshillit për Etikë në Media në Maqedoni, <<https://semm.mk/sq-al/komisija-za-zalbi/delovnik>>, [23.12.2019]

<sup>560</sup> OSBE, *Udhëzues për vetërregullimin e mediave, Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet*, <<https://www.osce.org/sq/fom/31500?download=true>>, faqja 13

gjitha te udhëzimet që u jepen gazetarëve dhe sendërtimi i praktikave të saj në raport me publikun. Pikërisht trajtimi i ankesave çon në rritjen e standardeve profesionale.<sup>561</sup>

Në kuadër të faktorëve institucionalë me veprimtari vetërregulluese është edhe Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. Ajo është një nga asociacionet që tubon gazetarët, jo vetëm në mbrojtje të të drejtave të tyre, në ecjen e sigurt të tyre sipas standardeve profesionale, por edhe në shqyrtimin e një sërë çështjeve që lidhen me raportimin e drejtë, Kodin Etik, profesionalizmin etj. Motivi i saj buron nga neni 16 i Kushtetutës, i cili thekson “*Garantohet liria e besimit, vetëdijes, të menduarit dhe e shprehjes publike të mendimit [...] Censura është e ndaluar*”.

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë është shoqatë e pavarur, jo-qeveritare dhe jo-partiake,<sup>562</sup> qëllimi i së cilës është të vihet në mbrojtje të standardeve profesionale dhe lirisë së shprehjes.<sup>563</sup> Edhe kjo shoqatë ka për mision ngritjen e nivelit të profesionalizmit dhe normave etike të gazetarëve, ndërkohë që pikërisht parimet etike, kriteret, standardet e gazetarisë së përgjegjshme dhe profesionale të integruara në Kodin Etik të Gazetarëve, janë detyra themelore e Këshillit të Nderit të saj. 5 anëtarë të këtij Këshilli shqyrtojnë raste kur gazetarë ose media të caktuara devijojnë nga gazetaria e mirë dhe etike në interes të publikut.<sup>564</sup> Pra, në rast se gazetarë ose media të caktuara shpalosin informacione jo të sakta, të paverifikuara dhe të pabalancuara, shfaqin qëndrime të partizuara, komente ose propagandë që bie ndesh me Kodin Etik, atëherë veprimtaria e tyre bëhet subjekt shqyrtimi i Këshillit të Nderit. Çdo qytetar, subjekt apo institucion mund të dërgojë ankesë pranë këshillit, i cili merr në shqyrtim shkeljet e mundshme të Kodit Etik.

Në veprimtarinë mediatike, gjatë viteve të qeverisjes së kaluar ka ekzistuar edhe një shoqatë paralele gazetarësh, Asociacioni Maqedonas i Gazetarëve, i njohur për tubimin e gazetarëve pro-qeveritarë të asaj kohe, por kjo shoqatë nuk është më funksionale në ditët e sotme. Ajo u themelua në vitin 2002 dhe ndër emrat që tubonte ishin Mirka Velinovska, Dragan Pavloviç Latas, Nikolla Mlladenov, Ivona Talevska, Cvetin Çilimanov, Maja Danjanovska, Gjorgji Tomiq etj.; të gjithë nga mediat proqeveritare të qeverisjes së kaluar si Sitel, Kanal 5, Alfa dhe agjencisë shtetërore MIA.<sup>565</sup>

Ndërkohë, përveç këtyre faktorëve institucionalë, ka edhe një sërë faktorësh jashtë-institucionalë që kontribuojnë në sferën e vetërregullimit mediatik në Maqedoni.

Një prej tyre është Instituti i Studimeve të Komunikimit që përfshin edhe Institutin Maqedonas të Medias dhe Qendrën për Studime Komunikimi. Instituti Maqedonas i Medias (MIM) ka si objektiv përmirësimin e aftësive profesionale të gazetarëve dhe profesionistëve mediatikë, të mbështesë zhvillimin e mediave të pavarura, të lira dhe pluraliste, të lehtësojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve mediatike dhe gazetarëve në trajnime rajonale e ndërkombëtare që synojnë forcimin e standardeve dhe etikës profesionale; zhvillimin e marrëdhënieve midis organizatave të mediave profesionale vendase dhe ndërkombëtare dhe organizatave të tjera që punojnë me media etj.<sup>566</sup> Ndër projektet më të zëshme është ai për edukimin mediatik (media literacy).

<sup>561</sup> Po aty, faqja 39

<sup>562</sup> Kjo shoqatë është themeluar në vitin 1946, por, sikurse është folur më sipër gjatë këtij studimi, pavarësia e saj mbetet nën hije dyshimi gjatë periudhës së propagandës komuniste apo socialiste të Federatës së Jugosllavisë.

<sup>563</sup> Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, <[https://znm.org.mk/za\\_nas/?lang=SQ](https://znm.org.mk/za_nas/?lang=SQ)>, [24.12.2019]

<sup>564</sup> Këshilli i Nderit, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, <[https://znm.org.mk/sovet\\_na\\_cest/?lang=SQ](https://znm.org.mk/sovet_na_cest/?lang=SQ)>, [24.12.2019]

<sup>565</sup> Asociacioni Maqedonas i Gazetarëve, <<http://man.mk/zanas.html>>, [24.12.2019]

<sup>566</sup> Instituti Maqedonas i Medias, <<https://mim.org.mk/mk/za-mim/ceci-i-aktivnosti>>, [24.12.2019]

Qendra për Zhvillimin e Mediave (e regjistruar si shoqatë civile që nga vitit 2002) luan një rol të caktuar në krijimin e një klime të favorshme për një mjedis të qëndrueshëm dhe demokratik për zhvillimin e mëtejshëm të mediave dhe shoqërisë civile në përgjithësi. Qendra është një nga organizatat pasardhëse të Qendrës së Shtypit të Maqedonisë dhe punon në analizimin e legjislacionit të mediave në vend si dhe ofron ndihmë juridike për gazetarët dhe mediat, me ekipin e vet të avokatëve.<sup>567</sup> Vizioni i saj është arritja e një sektori të lirë mediatik pluralist dhe të vetëqëndrueshëm, i çliruar nga të gjitha llojet e ndikimeve politike. Ky vizion bazohet te harmonizimi i plotë i legjislacionit të mediave me standardet e BE-së.

Shërbimi për Verifikim të Fakteve në Media<sup>568</sup> është një tjetër faktor bashkëpunues në ngritjen profesionale të gazetarëve. Përmes recensioneve të lajmeve nga media të ndryshme dhe artikujve analitikë, ky shërbim (projekt i USAID) nxit qytetarët të kërkojnë përgjegjësi nga mediat për lajme dhe informata objektive të bazuara në fakte, si dhe të ndihmojë gazetarët në zbatimin e standardeve profesionale përmes shumë instrumenteve online dhe burimeve për edukim dhe ngritje të vetëdijes publike.

Një faktor tjetër jashtë-institucional por i zëshëm në çështjet që kanë të bëjnë me gazetarët apo mbarë punonjësit mediatikë është edhe Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatikë e themeluar në vitin 2010.<sup>569</sup> Kjo sindikatë, në shumë raste, së bashku me organizata apo asociacione të tjera, është inkuadruar në fushata të ndryshme për reforma në media,<sup>570</sup> për një legjislacion më të mirë mediatik në vend, për vetërregullim mediatik, dhe mbi të gjitha për përmirësimin e gjendjes së gazetarëve dhe punonjësve mediatikë në vend.<sup>571</sup> Sindikata, si një organizatë vullnetare, e pavarur dhe jo partiake, ka për qëllim gjithashtu që të përfaqësojë, promovojë dhe mbrojë interesat ekonomike dhe profesionale të punonjësve të mediave.

Emëruesi i përbashkët i të gjithë këtyre institucioneve, asociacioneve dhe projekteve mbi median dhe gazetarët ka një qëllim, *vetërregullimin e medias dhe ecjen e saj në hap me standardet profesionale botërore si dhe tendencat e reja në këtë fushë*. Sa i përket përafrimit me BE-në, media është pjesë e kapitullit X për “*Shoqëri informatike dhe media*”. Por, disa nga pikat kryesore të rregullativave mediatike mbeten ende të papërbushura nga autoritetet vendase. Në raportin e fundit të progresit të KE-së për vendin, ndërsa notohej për ndryshimet e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe qasjen pro-aktive të rregullatorit mediatik mbi gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit, sërish u shprehën vërejtje mbi moszbatimin e reformave në transmetuesin publik, forcimin e kapaciteteve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale si dhe sfera të tjera mbi vetërregullimit mediatik, lajmet e rreme etj.<sup>572</sup>

<sup>567</sup> Qendra për Zhvillimin e Mediave, <<https://mdc.org.mk/%d0%b7%d0%b0-%d0%bd%d0%b0%d1%81/misija-i-vizija>>, [18.12.2019]

<sup>568</sup> Shërbimi për Verifikim të Fakteve në Media, <<http://verifikimiiifakteve.mk/per-projektin/>>, [24.12.2019]

<sup>569</sup> Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatikë, <<https://ssnm.org.mk/za-ssnm>>, [25.12.2019]

<sup>570</sup> KEMM, SHGM, SPGPM dhe IMM: *Presim përpjekje të forta për reformat në media*, <<https://znm.org.mk/%D1%81%D0%B5%D0%BC%D0%BC-%D0%B7%D0%BD%D0%BC-%D1%81%D1%81%D0%BD%D0%BC-%D0%BC%D0%B8%D0%BC-%D0%BE%D1%87%D0%B5%D0%BA%D1%83%D0%B2%D0%B0%D0%BC%D0%B5-%D1%81%D0%B8%D0%BB%D0%BD%D0%B8-%D0%B7%D0%B0%D0%BB/?lang=SQ>>, [25.12.2019]

<sup>571</sup> Në dhjetor të vitit 2018, televizioni ALSAT u nderua me çmimin “Roberto Beliçanec” pikërisht nga kjo sindikatë, jo vetëm si media promotorë e gazetarisë si e mirë publike, por edhe për kushtet dhe trajtimin e mirë të gazetarëve dhe punonjësve të tjerë në këtë media.

<sup>572</sup> Raporti i Progresit i KE-së për Maqedoninë e Veriut, <<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-north-macedonia-report.pdf>>, [25.12.2019]

### 6.1.3.2 Shansi i rregullimit të medias nën syrin vëzhgues të BE-së

Në historinë e përpjekjeve për legjislacion mbi median, Maqedonia ka një eksperiencë jo për t'u lavdëruar, e cila kulmoi veçanërisht me skandalin e përgjimeve (që nga janari i vitit 2015). Opozita e asaj kohe, LSDM-ja, thoshte se pushteti i VMRO DPMNE-së kishte përgjuar mbi 20 mijë qytetarë, ndërsa kryeministri Gruevski thoshte se Zaevi i bënte shantazh me materiale komprometuese nga shërbime të huaja sekrete.<sup>573</sup> Kriza politike e cila detyroi të zbrisnin në Shkup shumë emisarë ndërkombëtarë, përfshi edhe ndërmjetësin e BE-së Peter Vanhoutte (nga mesi i vitit 2013 deri në mesin e vitit 2016)<sup>574</sup> çoi më vonë edhe në hapjen e njërit prej kapitujve kontestues - median. Siç u theksua më sipër, media ishte tejet propaganduese për shkak të pagesës së miliona eurove gjatë viteve në pushtet të qeverisjes së VMRO-së.

Disa herë, përpjekjet e ndërmjetësit Vanhoutte ranë në ujë për shkak të mos arritjes së një pajtimi mbi kornizën ligjore mbi to.<sup>575</sup> Vetëm në vitin 2018, draft-ligji i menduar nga ndërmjetësi me origjinë belge do të merrte dritë jeshile në qeveri.<sup>576</sup> Por, ndryshimi i mënyrës së zgjedhjes së drejtuesve të televizionit shtetëror, i financimit të tij si dhe ndryshimet në Agjencinë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale do e mbanin peng ligjin deri në dhjetor të vitit 2018.<sup>577</sup> Ligji i ri ofronte kompetenca më të mëdha të Këshillit të Agjencisë, si dhe rregullativë të re për Këshillin Programor të transmetuesit publik.<sup>578</sup> Megjithatë, deri edhe një vit më vonë, në dhjetor të 2019, në prag të zgjedhjeve të parakohshme, zgjedhja e anëtarëve të këtyre dy këshillave u mbajt peng në Komisionin për Zgjedhje dhe Emërime të kryesuar nga VMRO DPMNE-ja.<sup>579</sup>

Ky mosbesim i ndërtuar që nga e kaluara, bën që këta dy këshilla të mbeten sërish vegla të mundshme për propagandë zgjedhore, për njërën apo për tjetrën parti. Në këto kushte, Maqedonia e Veriut vazhdon të renditet në nivele të pakënaqshme në Raportin e Progresit të KE-së apo edhe në raportet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mediat.

### 6.1.3.3 Legjislacioni i BE-së për mediat tradicionale, mediat online dhe platformat

BE-ja nuk ka as formulë magjike dhe as organ juridik për mbikëqyrjen, rregullimin dhe monitorimin e mediave në vende të caktuara të këtij kontinenti, veçanërisht vendeve në fazën paraqasëse për në union. Pavarësisht interesit të vetë aktorëve mediatik, i vetmi *asquis* udhëzues për mediat është direktiva “*Aktivitetet transmetuese televizive: Televizion pa kufij*”. Kjo direktivë përbën gurin e themelit të politikës audiovizuale të BE-së si dhe bazën e dy parimeve themelore;

<sup>573</sup> Qeveria e Maqedonisë së Veriut, *Груевски: Заев на директни средби ме уценуваше со материјал добиен од странска разузнавачка служба*, (Gruevski: Zaevi, me takime të drejtëpërdrejta, më shantazhonte me materiale të siguruar nga shërbimet e huaja sekrete), <<https://vlada.mk/node/10110>>, [25.12.2019]

<sup>574</sup> CV-ja e mediatorit Peter Vanhoutte, në profilin e tij LinkedIn, <<https://be.linkedin.com/in/petervanhoutte>>, [25.12.2019]

<sup>575</sup> ALSAT, Vanhojte konfirmon dështimin e bisedimeve për mediat, <<https://www.alsat-m.tv/241786/>>, [25.12.2019]

<sup>576</sup> ALSAT, Qeveria miratoi propozim ligjin për mediat, <<https://www.alsat-m.tv/qeveria-miratoi-propozim-ligjin-per-mediat/>>, [25.12.2019]

<sup>577</sup> ALSAT, *Ligji për media do të miratohet me flamur evropian?*, <<https://www.alsat-m.tv/ligji-per-media-do-te-miratohet-me-flamur-evropian/>>, [25.12.2019]

<sup>578</sup> Portalb, *Miratohet Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale*, <<https://www.koha.mk/miratohet-ligji-per-sherbime-mediatike-audio-dhe-audiovuzuale/>>, [25.12.2019]

<sup>579</sup> ALSAT, *Kostadinov: VMRO-ja po bllokoi reformat në institucionet e mediave*, <<https://www.alsat-m.tv/vmro-ja-bllokoi-reformat-ne-institucionet-e-mediave/>>, [26.12.2019]

*qarkullimin e lirë të programeve televizive evropiane në tregun e brendshëm, si dhe obligimin për rrjetet televizive, që sa më shpejt të jetë e mundur, të rezervojnë më shumë se gjysmën e kohës së transmetimit për vepra evropiane (kuota transmetimi). Sigurisht se kjo direktivë mbron objektivat e rëndësishme që burojnë nga interesi publik, sikurse diversiteti kulturor, mbrojtja e të miturve apo e drejta e korrjimit.<sup>580</sup> Një direktivë e tillë lindi për herë të parë në vitin 1989 dhe në të theksohet parimi kryesor se;*

*Shtetet anëtare duhet të sigurojnë lirinë e pranimit dhe të mos kufizimit të ritransmetimeve në territoret e tyre të programeve televizive nga shtetet e tjera anëtare. Ato munden, gjithsesi, të pezullojnë ritransmetimet e programeve televizive që shkelin dispozitat e Direktivës në mbrojtjen e të miturve.*

Po ashtu, dispozitat e kësaj Direktive rregullojnë kohëzgjatjen e transmetimeve ditore, procedurat e ndërprerjes së programeve, çështjet etike si dhe përmbajtjen brenda normave të kritereve të reklamimit të pijeve alkoolike. Është i ndaluar reklamimi i duhanit dhe i medikamenteve. Lejohen sponsorizimet, por jo sponsorizimi i lajmeve dhe programeve informative dhe politike mbi çështjet e brendshme të BE-së ose të shteteve anëtare.

*Sa i përket mbrojtjes së të miturve;*

*Programet që përfshijnë pornografi ose dhunë ekstreme janë të ndaluara. Ndalesa zbatohet ndaj të gjitha programeve që besohet se kanë ndikim ndaj të miturve, përveç rasteve nëse programet transmetohen në një kohë kur normalisht nuk shihen nga të miturit ose nëse vendosen masa mbrojtëse teknike (transmetim ne kod).*

*Sa i përket të drejtës së korrjimit;*

*Çdo personi, interesi legjitim i të cilit është dëmtuar nga ndonjë pohim i fakteve të pasakta në një program televiziv, duhet t'i garantohet e drejta e ankesës. Kjo e drejtë duhet të garantohet ndaj të gjitha programeve nën juridiksionin e një shteti anëtar.<sup>581</sup>*

Pas shqyrtimeve të gjata, direktiva u amendua në vitin 1999 dhe 2007, ndërkohë që me tendencat e reja në fushën mediatike dhe nevojat e tregut evropian, u rinovua në vitin 2018, pas një propozimi të Komisionit Evropian për vendosjen e një balance mes konkurrencës dhe mbrojtjes së konsumatorit (sidomos të rinjtë).<sup>582</sup> Ajo përfshiu rregullimet mbi përmbajtjet televizive, kuotat e transmetimit, mënyrën e reklamimit, të drejtën e informimit, promovimin e përmbajtjeve evropiane, kompetencave ligjore etj.

Siç mund të shihet në tabelën e mëposhtme, direktiva e re synon rregullimin e veprimtarisë së *transmetuesve tradicionalë televizivë, aplikacionet me video sipas kërkesës së shikuesit* (video on demand), si dhe *platformat online për ndarje videosh*.

Qëllimi i gjithë legjislacionit evropian është që t'i obligojë platformat që ndajnë video dhe mediat sociale në përgjithësi, të mbrojnë të miturit nga përmbajtjet e dëmshme, të mbrojnë qytetarët nga nxitja e dhunës dhe urrejtjes si dhe nga përmbajtjet e paligjshme. Ato duhet të

<sup>580</sup> EUR-Lex, *Direktiva "Aktivitetet transmetuese televizive: Televizion pa kufij"*, <<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=LEGISSUM%3A124101>>, [26.12.2019]

<sup>581</sup> Po aty!

<sup>582</sup> Parlamenti Evropian,

<[http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2016/583859/EPRS\\_BRI\(2016\)583859\\_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2016/583859/EPRS_BRI(2016)583859_EN.pdf)>, [26.12.2019]



respektojnë rregulla të caktuara reklamimi, si dhe të bëjnë dallimin kur video të përdoruesve të caktuar të kenë qëllime reklamimi. Platformat për ndarje videosh duhet të reduktojnë ekspozimin e fëmijëve ndaj reklamave me ushqime jo të shëndetshme. Mbi të gjitha, që të tre këta komponentë, si transmetuesit tradicionalë televizivë, aplikacionet me video sipas kërkesës së shikuesit dhe platformat online për ndarje videosh duhet të forcojnë rregullat kundër përmbajtjeve që nxitin gjuhën e urrejtjes dhe terrorizmin.

#### Neni 6

*1. Pa paragjykuar obligimin e Shteteve Anëtare për të respektuar dhe mbrojtur dinjitetin njerëzor, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë mjetet e duhura që shërbimet mediatike audiovizuale të ofruara nga ofruesit e shërbimeve mediatike nën juridiksionin e tyre, të mos përmbajnë asnjë:*

*- nxitje të dhunës ose urrejtjes drejtuar ndaj ndonjë grupi personash ose qoftë edhe një anëtarit të këtyre grupeve, bazuar në cilindo prej arsyeve të përmendura në nenin 21 të Kartës;*

*- provokim publik që nxit kryerjen e ndonjë vepre terroriste siç përcaktohet në nenin 5 të Direktivës (BE) 2017/541.*

*2. Masat e marra për qëllimet e këtij neni janë të domosdoshme dhe proporcionale, dhe respektojnë të drejtat dhe parimet e përcaktuara në Kartë.<sup>583</sup>*

Pavarësia e rregullatorëve audiovizualë përforcohet në mënyrë që qeveritë respektive, bizneset ose industria të mos ndikojnë ndaj veprimtarisë së tyre. Po ashtu, punët evropiane (kuotat e transmetimit) të promovohen më mirë me videot sipas kërkesës së shikuesit – të paktën 30% e ndarjes së katalogëve të tyre t’i kushtohet përmbajtjeve evropiane.

Transmetuesve iu garantohet fleksibilitet më i madh në reklamim, por hapësira kushtuar reklamimit të mos e kalojë 20% të kohës së transmetimit gjatë ditës (06:00 – 18:00) dhe gjatë kohës kryesore (prime-time) nga 18:00 deri në 24:00.

<sup>583</sup> EUR-Lex, Direktiva “Aktivitetet transmetuese televizive: Televizion pa kufij”, <[https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv:OJ.L\\_.2018.303.01.0069.01.ENG](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv:OJ.L_.2018.303.01.0069.01.ENG)>, [26.12.2019]



## Audiovisual Media Services Directive (AVMSD)

a REVISED media framework for the 21<sup>st</sup> century [#AVMSD](#) [#DigitalSingleMarket](#)




FIGURA 8. OBJEKTIVAT E DIREKTIVËS SË SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIOVIZUALE TË BE-SË<sup>584</sup>

Por, sikurse kuptohet qartë nga të gjitha këto më sipër, këto rregulla aplikohen vetëm në shtetet anëtare të BE-së, dhe ndryshe nga çfarë pritet.... *që BE-ja të ndërhyjë në mënyrë institucionale në rregullimin mediatik të vendeve paraqasëse, një gjë e tillë nuk ekziston!*

Pluralizmi mediatik, diversiteti kulturor, luftimi i gjuhës së urrejtjes, mbrojtja e konsumatorit, tregu i brendshëm dhe promovimi i konkurrencës së ndershme si dhe të drejtat e shikuesit si qytetar, garantohen vetëm nga legjislacioni vendor i një shteti.

Në rastin konkret të Maqedonisë së Veriut, sikurse është theksuar disa herë më sipër, mediat ende nuk janë të çliruara politikisht apo nga aspekti biznesor, ndërkohë që platformat për ndarjen e videove ose mediat online mbeten ende jashtë kornizës ligjore për median.

Autoritetet e çdo shteti duhet të kuptojnë se zgjidhja nuk është të huajt dhe as të arratisja jonë nga realiteti, por kur të pranojmë tërësinë e fakteve dhe të punojmë për t'u ballafaquar me ato.<sup>585</sup>

## 7. KAPITULLI V

<sup>584</sup> Komisioni Evropian, *Rishikim i Direktivës për Shërbime Mediatike Audiovizuale*, <<https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/revision-audiovisual-media-services-directive-avmsd>>, [6.1.2020]

<sup>585</sup> Admir Qose, *Media në Maqedoni dhe e nesërmyja e saj*, Revista "Shenja" – botim i muajit korrik 2014, faqja 43

## 7.1 Shpalosja e rezultateve të studimit; Diada e raportimit mediatik - Nxitja e tensioneve

### 7.1.1 Mediat, realiteti i dyzuar për ngjarje të njëjta

*Raportimi i dyzuar* në media është një fenomen që ndeshet shpesh në çdo shoqëri. Në shtete të ndryshme është e qartë që për shkak të linjave të ndryshme redaktuese, bindjeve politike që mbështeten, të ketë televizione që të njëjtën ngjarje ta trajtojnë në mënyra të ndryshme mes tyre. Edhe SHBA-ja u trondit kur zbuloi se si videoja e Nensi Pelosit nga radhët e demokratëve, kryetares së Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan, u manipulua (duke u zgjatur) me një vonesë disa të dhjetat e sekondës, me qëllim që dukja në ekran e saj të linte përshtypjen se ajo ishte e dehur.<sup>586</sup> Zvarritja e zërit të saj dhe e folura paksa e ngadaltë, i bëri amerikanët të besonin për një moment se “një pijanece po thurte akuza boshe ndaj presidentit Trump”. Në fakt, Pelosi ishte iniciatorja e procedurës për shkarkimin e presidentit Trump.<sup>587</sup>

Por, edhe Rudi Xhuliani, përfaqësuesi personal ligjor i Trump, e kuptoi se diçka nuk shkonte... dhe shkruante në twitter “Çfarë ka Nensi Pelosi? E folura e saj është e çuditshme!”.<sup>588</sup> Po ashtu, vetë media pro-Trump, *Fox News* kishte filluar prej kohësh sulmet ndaj Pelosit. Trump shpërndante madje një video plot lapsuse që Pelosi bënte nëpër konferenca shtypi, të cilat i kishte montuar televizioni Fox News.<sup>589</sup>

Por, çfarë nëse këto manovra që deformojnë lajmin, e tjetërsojnë apo e dyzojnë atë për qëllime të caktuara, shkojnë përtej çdo norme ligjore, normative gazetareske apo etike? Çfarë nëse ky dyzim përdoret në shtete multi-etnike, multi-fetare e multi-kulturore sikurse Maqedonia e Veriut? Sa e predispozuar për nga toleranca është popullata, që të pranojë informata të tilla të manipuluar? Deri ku shkojnë perceptimet e komuniteteve ndaj dyzimeve të tilla, veçanërisht kur nuk e njohin mirë njëri-tjetrin apo kur kanë pak vite që kanë dalë nga konflikti, sikurse në rastin e Maqedonisë së Veriut?

\*\*\*

Lista e rasteve të tilla me informata të manipuluar në median e Maqedonisë së Veriut mund të jetë tepër e gjatë. Ky shtet i vogël nuk është aq imun ndaj këtyre rasteve, përkundrazi, është ndoshta një nga vendet që ka pësuar mjaftueshëm keq kur në vend të ujit, zjarrit i është hedhur benzinë. Madje, në Maqedoninë e Veriut, një ndjenjë e tillë ka ekzistuar edhe atëherë kur promovohet koncepti i *bashkim-vëllazërimit*, se gjoja jemi “të njëjtë”, ndajmë të drejta “të barabarta”, dhe se të mirat e përbashkëta i gëzojmë (ndajmë) sërish në mënyrë të barabartë...

<sup>586</sup> Washington Post, *Faked Pelosi videos, slowed to make her appear drunk, spread across social media (videot e manipuluar të Pelosit, të ngadalësuar që ta bëjnë atë të duket e dehur, përhapen anembanë rrjeteve sociale)*, <<https://www.washingtonpost.com/technology/2019/05/23/faked-pelosi-videos-slowed-make-her-appear-drunk-spread-across-social-media/>>, [6.1.2020]

<sup>587</sup> Dosja.al, Roland Qafoku, *Shkarkimi i Trump dhe 80-vjeçarja armike Nancy Pelosi*, <<https://dosja.al/shkarkimi-i-trump-dhe-80-vjecarja-armike-nancy-pelosi/>>, [6.1.2020]

<sup>588</sup> Mail Online, *Trump's lawyer Rudy Giuliani shares doctored video making Nancy Pelosi appear drunk and then accuses the Democrats of DISHONESTY (Përfaqësuesi ligjor i Trump, Rudi Xhuliani ndan videon e manipuluar që e bën Pelosin të duket si e dehur, dhe pastaj akuzon demokratët për manipulim)*, <<https://www.dailymail.co.uk/news/article-7064669/Social-media-fire-letting-2-MILLION-users-fake-video-slurring-Nancy-Pelosi.html>>, [8.1.2020]

<sup>589</sup> Marrë nga rrjeti social Twitter, statusi i presidentit amerikan Donald Tramp, <<https://twitter.com/realDonaldTrump/status/1131728912835383300>>, [8.1.2020]

Duke marrë në konsideratë shkallën e pasojave që shkaktohen nga raste të tilla, duhet të bëjmë të paktën tre ndarje minimale; atë në suazat e *etnocentrizmit*, atë të *krijimit të stereotipave* (negativë), si dhe atë të *krijimit të incidenteve ndëretnike*.

*Etnocentrizmi*, sipas fjalorit të Merriam Webster, është sjella ose ndjenja superiore e një grupi, etnie ose nacionaliteti ndaj të tjerëve.<sup>590</sup> Me fjalë të tjera, është vendosja e vetes në një pozitë *gjyquese* të kulturës së tjetrit, bazuar në standardet, ritet dhe vlerat e kulturës tënde. Etnocentrizmi, i cili më së shumti lidhet me kulturën, është pozitiv (sikurse ndjenja fëmijërore se ti je më i mirë se tjetri, se shkolla jote është më e mira në gjithë vendin etj.) por edhe negativ (kur ngre barriera *'prej emigranti'* ndaj vetes, në rastet kur gjendesh përballë dominimit të grupeve më të mëdha, sikurse ndjenja e afro-amerikanëve, e amerikano-latinëve apo e indianëve të Amerikës përballë shumicës amerikane).<sup>591</sup> Etnocentrizëm, në median tonë, përbëjnë titujt e lajmeve që shprehin diçka unike dhe mbivlerësuese për njërin grup shoqëror i cili ka diçka që nuk e ka askush tjetër, p.sh., *"Xhejms Oliver promovon ajvarin maqedonas"*,<sup>592</sup> ose kur glorifikojnë vetëm njërin grup shoqëror si p.sh. *"Vardari, kampion evropian në hendboll"*.<sup>593</sup> Këta tituj manifestojnë se Maqedonia ka diçka unike dhe ka rënë në sytë e njërit prej kuzhinierëve më të famshëm të botës... ose glorifikojnë Maqedoninë, si shtet që fiton kampionatin evropian (mes 28 skuadrave të përzgjedhura të kontinentit evropian). Në rastin tjetër, nuk është Maqedonia ajo që vlerësohet vis a vis, por produktet maqedonase të pastra, pra ajvari për të cilën Maqedonia e cilëson si markë shtetërore, si dhe ekipin Vardari... Duke ditur se ky ekip nuk ka asnjë shqiptar, atëherë doza e lavdisë i atribuohet në mënyrë të pastër vetëm maqedonasve. Etnocentrizëm me doza *më dramatike* ka në rastet kur *supremacioni* i njërit grup shprehet në të njëjtin lajm, bashkë me *nëpërkëmbjen* e grupit tjetër, si p.sh. *"Maqedonasit kërkojnë të prishet xhamia në Ohër dhe të ndërtohet kishë në vend të saj"*.<sup>594</sup>

Për Etem Azirin, qasja më korrekte dhe më e pranueshme në marrëdhëniet ndërkulturore është *"relativizmi kulturor"*, e cila e njeh faktin se çdo kulturë është unike, por nga ana tjetër, kjo mënyrë të menduari e përjashton jo-tolerancën dhe paragjykimet ndaj të tjerëve.<sup>595</sup>

Ndërsa *stereotipat* ose stereotipizimi përbëjnë tërësinë (pozitive ose negative) të besimeve që një person ndërton në bazë të karakteristikave të një grupi tjetër.<sup>596</sup> Pra, ndryshe nga

<sup>590</sup> Konsulto fjalorin enciklopedik të Merriam Webster në <<https://www.merriam-webster.com/dictionary/ethnocentrism>>, [8.1.2020]

<sup>591</sup> Diana Kendall, *Sociology in Our Times: The Essentials*, faqja 64, <<https://books.google.mk/books?id=vshwKM3QcMC&pg=PA64&dq=ethnocentrism+in+sociology&hl=sq&sa=X&ved=0ahUKEwIjldD4itTmAhXU5KYKHbjACI4Q6AEIJAA#v=onepage&q=ethnocentrism%20in%20sociology&f=false>>, [8.1.2020]

<sup>592</sup> Press24, *Џејми Оливер го промовира македонскиот ајвар (Xhejms Oliver promovon ajvarin maqedonas)*, <<https://www.press24.mk/dzhejmi-oliver-go-promovira-makedonskiot-ajvar>>, [9.1.2020]

<sup>593</sup> ALSAT, *Vardari kampion evropian në hendboll*, <<https://www.alsat-m.tv/vardari-kampion-evropian-ne-hendboll/>>, [9.1.2020]

<sup>594</sup> Klik, *Maqedonasit kërkojnë të prishet xhamia në Ohër dhe të ndërtohet kishë në vend të saj*, <<http://klik.mk/maqedonasit-kerkojne-te-prishet-xhamia-ne-oher-dhe-te-ndertohet-kishe-ne-vend-te-saj/>>, [10.1.2020]

<sup>595</sup> Etem Aziri, *Sociologjia*, ArbëriaDesign, Tetovë 2007, faqja 207-208

<sup>596</sup> Marko Trashanovski, Vesna Nikodinovska, Petrit Saraçini, Marina Tuneva, Jana Gjorgjinska, Aleksandra Temenugova, Dejan Andonov, Vlladimir Misev, Sead Xhigall, Darko Bulldioski, Biljana Petkovska, Vesna Horvatoviq, Silvana Veteroska, *Doracak për arsimtarë – Përparimi mësimor mediatik në lëndën e gjuhës amtare*, Instituti Maqedonas i Medias, Shkup 2010, faqja 79

etnocentrizmi që ka standardin se ajo që është “legjitime” në kulturën tënde *duhet* të jetë edhe për të tjerët, në rastin e stereotipave kemi të bëjmë me tërësinë e përgjithësimeve paragjyquese rreth një grupi ose kategorie njerëzish që është e papërshtatshme për ty, e tepruar ose primitive (e thjeshtë) për ty.<sup>597</sup>

Ndërsa, kur ky kategorizim (që shfaqet nga stereotipat) lëndon një tërësi të ndjenjave të grupit tjetër, atëherë edhe doza e fyerjes, ofendimit apo përbuzjes, është disa herë më e madhe se sa vetë manifestimi i etnocentrizmit. Rast i tillë është lajmi “*Testimi ekstern, me gabime gjuhësore dhe tendenca raciste*”, që thekson se përballë emrave të shqiptarëve renditen profesione si *druvar, hamall, bari delesh*, kurse përballë emrave maqedonas, profesionet si *profesor, doktor, avokat*.<sup>598</sup>

Kur notat fyese ndaj grupit kalojnë një cak të caktuar, atëherë kemi të bëjmë me krijim të tensioneve ose edhe incidenteve ndëretnike. Këto raste do t’i shohim më poshtë, me ngjarjet në Kalanë e Shkupit, ato në liqenin e Smilkovës, Karnavalet e Vevçanit etj.

#### 7.1.1.1 Ngjarjet në Kalanë e Shkupit!

13 shkurt 2011

Përleshje me disa të plagosur në qendër të kryeqytetit, konkretisht në pikën më të rëndësishme kulturore, historike dhe turistike të tij, Kalanë e Shkupit.<sup>599</sup>

Prej fillimit të shkurtit, në Kala, kishte nisur procesi i gërmimit rreth e qark për artefakte mbi historinë e saj. Ky proces i gërmimit si dhe mungesa e sqarimeve mbi të (lidhur me përbërjen e ekipit të arkeologëve, transparencën me median për artefaktet e gjetura, përfshirjen e shqiptarëve ose ndërkombëtarëve në kërkime etj.),<sup>600</sup> shkaktoi dyshime në opinion. Po ashtu, zbulimi i mëtejshëm i ndërtimit paralelisht të një objekti të ri në Kala, i cili i ngjante një kishe, shtoi dyshimet se VMRO DPMNE-ja me të emëruarin e saj Pasko Kuzman në krye të Drejtorisë për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore po tentonte të përvetësonte historinë e shqiptarëve. Kjo bazohej në dyshimet e vazhdueshme se pushteti veçse kishte nisur projektin famëkeq “Shkupi 2014” me vendosjen e përmendoreve, emërtimin e autostradave dhe aeroportit sipas figurave antike greke, ngritjen e fasadave në stilin barok, duke e deklaruar komunitetin maqedonas *më antik* se vetë grekët.<sup>601</sup> Shqiptarët, të cilët ishin të lënduar edhe nga Enciklopedia Maqedonase<sup>602</sup>

<sup>597</sup> Leksione të universitetit York për studime drejtësie dhe sociale, *Stereotipat raciale*,

<[http://www.yorku.ca/lfoster/2006-](http://www.yorku.ca/lfoster/2006-07/sosi3830/lectures/York_SocialJusticeStudies_EthnocentrismStereotypingPrejudiceDiscrimination.html)

07/sosi3830/lectures/York\_SocialJusticeStudies\_EthnocentrismStereotypingPrejudiceDiscrimination.html>,

[10.1.2020]

<sup>598</sup> ALSAT, *Testimi ekstern me gabime gjuhësore dhe tendenca raciste*, <<https://www.alsat-m.tv/197960/>>,

[11.1.2020]

<sup>599</sup> Evropa e Lirë, *Kisha muze nxit përplasje ndëretnike*, <<https://www.evropaelire.org/a/2307997.html>>, [11.1.2020]

<sup>600</sup> Kuzman pranon se në gërmime nuk janë parashikuar arkeologë shqiptarë apo ndërkombëtarë: “*Çdo shtet, së pari, mbështetet në vlerat dhe burimet që ka. Në rast se nuk i disponon ato, atëherë projektin do ta drejtojë jo vetën në Kosovë e Shqipëri, por edhe në Beograd e Sofje apo në Muzeun britanik nëse ka nevojë për ekspertë të njohur*”, ALSAT-M, *Gërmimet në Kala*, <<https://www.youtube.com/watch?v=76uykjisXhs>>, [11.1.2020]

<sup>601</sup> [“*Shkupi 2014*” i projektuar që në vitet 2005-2006 kishte si qëllim që përmes ngritjes së përmendoreve, të forconte identitetin kombëtar maqedonas, por ekspertët dhe njohësit e çështjeve politike thoshin se projekti tashmë ka treguar efekt të kundërt duke rritur përçarjet në shoqëri, duke tensionuar marrëdhëniet me shtetet fqinje si dhe duke rritur kritikën si nga brenda ashtu edhe nga jashtë, për afera të shumta korruptive që e shoqëronin vetë projektin kundërtshënës.]. Isuf Kadriu, Evropa e Lirë, “*Shkupi 2014*”, projekti i tensioneve dhe shpenzimeve marramendëse”, <<https://www.evropaelire.org/a/26835122.html>>, [11.1.2020]

e dy viteve më herët (2009) ku u quajtën “të zbritur nga mali nga koha e Ali Pashë Tepelenës”, ndërkohë që vetë “shteti i parë shqiptar ishte themeluar nga Gjermania fashiste”, shtuan dyshimet se VMRO DPMNE-ja kishte marrë hov në përpjekjet e saj për uzurpimin edhe të historisë së shqiptarëve, duke vënë në shërbim akademinë, shtetin dhe vetë popullatën shumicë të cilës gjithnjë e më shumë i ofroheshin për konsumin këto teza përmes mediave dhe projekteve të ndryshme.<sup>603</sup>

Në nxitjen e tensioneve luajti rol edhe mungesa e informimit korrekt në lajme, deklaratat politike të partnerëve në koalicionin qeverisës VMRO-BDI, të opozitës dhe gjithë faktorëve të tjerë, përfshi institucionet kulturore apo ato të trashëgimisë kulturore.

Kalaja e Shkupit mendohet se ka qenë ndërtuar në shekullin VI dhe prej atëherë ka qenë rrënuar, rindërtuar e përshtatur sipas nevojave të shumë pushtuesve përgjatë historisë.<sup>604</sup>

3 ditë para ditës së përlëshjes fizike të 13 shkurtit, një grup qytetarësh shqiptarë, përfshi zyrtarë të lartë të BDI-së, shkuan të prishnin punimet për kishën-muze që ndërtohej. Ata kishin pikasur punëtorë të ardhur nga Manastiri të cilët ngrinin murin në orët e vona të mbrëmjes. Të tubuar, diku rreth orës 23:00, qytetarë shqiptarë përfshi edhe zyrtarë të BDI-së (mes tyre edhe Xhevat Buçi, zëvendësministër i Brendshëm) shkuan në vendngjarje dhe rrëzuan muret. Policia e kishte të pamundur ndalimin, por vetëm në orën 1:30 të natës shoqëroi drejt Manastirit punëtorët e sjellë prej atje. Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore shpalli pezullimin e punimeve deri në gjetjen e dialogut, por nga ministria e Brendshme thoshin se përgjegjësi për ngjarjen e një nate më parë do të kërkonin edhe ndaj zëvendësministrit Buçi. Nga ana tjetër, zyrtari i BDI-së theksonte se përgjegjësi i jepte vetëm liderit të tij partiak. Abdilaqim Ademi, sekretar i përgjithshëm i BDI-së theksonte se “nëse bëhet fjalë për një objekt fetar, BDI-ja ka qëndrimin se aty nuk ka nevojë për një objekt të tillë, por duhen objekte që do ta reflektonin të gjithë civilizimin nëpër të cilin ka kaluar Kalaja, dhe lirshëm, dhe gjithë artefaktet e gjetura mund të ekspozohen aty.”<sup>605</sup>

Përveç marrëdhënieve mes partnerëve të koalicionit, edhe nga opozita shqiptare theksuan se “Gruevski, siç i sjellë natën punëtorët për ndërtim, duhet t’i sjellë ditën edhe për shkatërrim sepse Demokracia e Re nuk do të lejojë prishjen e marrëdhënieve ndërfaqetare e ndëretnike në Maqedoni”. Për PDSH-në, “ministrat e BDI-së që protestojnë në Kala, të rikthehen në qeveri dhe të marrin vendim për zhbërjen e vendimit për muzeun-kishë”.<sup>606</sup>

Në frontin tjetër renditeshin edhe shoqatat maqedonase të sigurimit nga viti 2001, “Dinjiteti” i Stojanço Angellovit dhe “Beden” i Zharko Jakovçevskit, të cilët akuzonin BDI-në se “me veprimin e parmbremshëm në Kala ka rikthyer metodat e vjetra të terrorizmit dhe dhunës”.

Me këtë përplasje politike, situata përshkallëzoi në përlëshjen e 13 shkurtit, kur pas njoftimit për një konference për shtyp pranë Kalasë nga një grup organizatash joqeveritare të

<sup>602</sup> Studiuesit dhe akademikët shqiptarë u distancuan nga vepra e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë. Shukri Rahimi dhe Alajdin Abazi thonë se e ka refuzuar me kohë pjesëmarrjen e tyre në këtë botim për shkak se akademikët maqedonas kishin injoruar që në fillim kërkesat e tyre për një përfshirje reale të historisë së popullit shqiptar në studim, Evropa e Lirë, *Enciklopedia maqedonase, fyese për shqiptarët*, <<https://www.evropaelire.org/a/1826002.html>>, [12.1.2020]

<sup>603</sup> Kristo Frashëri, *E vërteta mbi shqiptarët e Maqedonisë dhe shtrembërimi i Enciklopedisë së Shkupit*, <[https://pashtriku.beepworld.de/files/Kosova\\_09/dhjetor09/10-15.09/kristo\\_frasheri\\_e\\_verteta\\_mbi\\_shqiptaret\\_ne\\_maqedoni\\_12.12.09.htm](https://pashtriku.beepworld.de/files/Kosova_09/dhjetor09/10-15.09/kristo_frasheri_e_verteta_mbi_shqiptaret_ne_maqedoni_12.12.09.htm)>, [12.1.2020]

<sup>604</sup> Macedonia-timeless.com, *Kalaja e Justinianit të Parë*, <[https://macedonia-timeless.com/alb/far\\_tbni/turne/turne\\_qytetesh/shkup](https://macedonia-timeless.com/alb/far_tbni/turne/turne_qytetesh/shkup)>, [12.1.2020]

<sup>605</sup> Deklaratat janë zbardhur nga arkivi i televizionit ALSAT, Lajmet e datës 11.02.2011

<sup>606</sup> Po aty!

kryesuar nga Lëvizja “Zgjuhu”, turma qytetarësh të komunitetit maqedonas mbërritën paraprakisht në mbrojtje të asaj çfarë kishte mbetur nga muzeu-kishë i rrënuar ditë më herët. Përleshja përfshiu Lëvizjen “Zgjuhu” e drejtuar asokohe nga Artan Grubi, tifoze të grupit “Shvercerët” si dhe përfaqësues politikë dhe vetë ministrisë së Brendshme (Xhevat Buçi, zëvendës ministër i Brendshëm, Bujar Osmani, ministër i Shëndetësisë, Izet Mexhiti, nënkryetar i BDI-së etj.), si dhe nga ana tjetër, mbështetës të VMRO DPMNE-së dhe tifoze të grupit “Komitet”.<sup>607</sup>

Pas përleshjes që shkaktoi 8 të lënduar, VMRO DPMNE theksoi se nuk dëshironte të krijonte incident ndëretnik dhe destabilizues, madje, të dy partnerët e koalicionit dolën me qëndrimin qeveritar të përbashkët se *“trashëgimia kulturore në Kala është e të gjithë qytetarëve të Maqedonisë dhe vendit tonë të përbashkët, dhe ajo duhet të jetë simbol i bashkimit dhe jo ndarjeve”*.<sup>608</sup> Po ashtu, edhe vetë BDI-ja, theksoi se *“çështjet e tilla të ndjeshme duhet dhe mund të zgjidhen vetëm me dialog të hapur politik, edhe atë në institucionet e sistemit. Askush nuk mund t’i shfrytëzojë çështjet e këtilla të ndjeshme për qëllime tjera”*.<sup>609</sup>

\*\*\*

Në titujt e lajmeve ndërkohë, anembanë mediave gjendej një listë të gjatë epitetes.

*Veçer:* Shqiptari i punësuar në ambasadën holandeze nxit incident ndëretnik  
*Kurir:* Përplasje e përgjakshme mes Komitëve dhe Shvercerëve në Kala<sup>610</sup>  
*Site:* Incident i rëndë në Kala, “Komitet” distancohen nga incidenti - u sulmuan!  
*AI:* Kush e komandon policinë?  
*Kanal 5:* Jankullovska e kënaqur me policinë në Kala – në rrjetet sociale zien!  
*Alfa:* Incident i përgjakshëm në Kala, Buçi: Mund të më ndërroj vetëm Ali

Ahmeti

*Alsat:* Incidenti në Kala, 8 persona të lënduar  
*Telma:* Rrahja në Kalanë e Shkupit, 8 të lënduar  
*Vreme:* Maqedoni – Pushteti e ndezi me gjak fitilin

Siç shihet që nga titujt, thuajse të gjitha mediat kanë përdorur epitetet nxitëse dhe ekzagjeruese si (incident i rëndë, rrahje e përgjakshme, rrahje mes grupeve të tifozeve etj.) por ndonjëherë edhe ekspozimi i qëllimshëm i detajeve se *“një shqiptar i punësuar në ambasadë nxit tensione”* ose *“Kush komandon policinë”*, në një kohë që zëvendës ministri i Brendshëm (nga BDI-ja) ishte në protestë.

Ndërkaq, drejtuesit e mediave (sipas një studimi nga Instituti Maqedonas i Mediave) theksonin se kishin qenë objektivë dhe në përputhje me standardet profesionale dhe normat etike.

<sup>607</sup> Ngjarjet e datës 13 i kishin paraprirë edhe sulmit të të premtes kur zyrtarë të BDI-së shkuan të protestonin kundër punimeve që nuk ndaleshin as gjatë natës për kishën-muze. Mes protestuesve, edhe ministri i Shëndetësisë Bujar Osmani, kreu i Komunës së Çairit Izet Mexhiti (nënkryetar i BDI-së) etj.

Evropa e Lirë, *“Ha Kale ce zpadu u ce ypusa”*, (Në Kala, ndërtohet dhe priset), <<https://www.slobodnaevropa.mk/a/2306274.html>>, [12.1.2020]

<sup>608</sup> Evropa e Lirë, *Kisha muze nxit përplasje ndëretnike*, <<https://www.evropaelire.org/a/2307997.html>>, [25.12.2019]

<sup>609</sup> Evropa e Lirë, *Hetime për incidentin në Kalanë e Shkupit*, <<https://www.evropaelire.org/a/2309051.html>>, [12.1.2020]

<sup>610</sup> Titujt e lajmeve të disa mediave lidhur me ngjarjet e 13 shkurtit në Kala, <<https://time.mk/cw/b27be25891/incident-na-kale.html>>, [13.1.2020]

Sipas gazetarëve, redaktorëve dhe drejtorëve të intervistuar të mediave, gjatë raportimit mbi këtë ngjarje ishte respektuar rregullisht se kur shkruhet për një bashkësi etnike është shumë e rëndësishme që të intervistohen pjesëtarët ose përfaqësuesit e saj, ndërsa mendimet e tyre të përfshihen në shkrimet gazetareske.<sup>611</sup>

Në intervista spikatin disa qëndrime;

- 1) gazetarët kanë qenë të rinj, por pavarësisht kësaj, janë prirur t'i përmbahen standardeve (ALSAT).
- 2) shumë media nuk kanë pasur ndonjë kod ose rregulla të mirëfillta për t'i bërë ballë ngjarjeve të tilla në raportim por gjithsesi janë prirur t'i përfshijnë të gjitha palët (Dnevnik, Telma, A1)
- 3) dyshime se në raportime ka pasur mungesë të qartësisë, nëse objekti ka qenë kishë apo muze-kishë (Sitel)

Megjithatë, pyetja që duhet t'i përgjigjemi në këtë ngjarje është nëse media ka luajtur rol në nxitje apo ka qenë vegël e një nxitjeje për shkak të politikës. Gazetarët, në raportimet e tyre theksojnë se nuk kanë pasur rol nxitës, edhe pse në titujt e tyre nuk mungonin epitetet “*nervoze*” dhe “*dramatike*” për t'i veshur ngjarjes një tisi mllefi. Në media nuk u kërkua asnjëherë llogari se si nga partia shqiptare në pushtet, edhe pse në komunikatën e përbashkët pas incidentit fliste për *dialog*, kishte eksponentë të lartë të saj që dilnin të protestonin.

Media nuk kërkoi përgjegjësi fuqishëm ndaj partisë shqiptare në pushtet se pikërisht ideja e projektit për gërmimin në Kala si dhe leja për ndërtimin e kishës-muze, nuk u ndalua as në qeveri gjatë miratimit, dhe as gjatë hallkave të tjera të ndarjes së parave nga buxheti.

Media nuk kërkoi përgjegjësi fuqishëm as edhe ndaj opozitës, që si rregullatore e pushtetit, duhet të mbante një qëndrim më vigjilent ndaj veprimtarive të tij.

Media, mbi të gjitha, nuk kërkoi përgjegjësi fuqishëm ndaj partisë më të madhe në pushtet, VMRO DPMNE-së e cila kishte një të kaluar ‘uzurpatore’ mbi historinë, duke filluar që nga projekti “Shkupi 2014” me antikitetin, Enciklopedinë për shqiptarët, histori të ngjashme me Car Dushanin etj.

Së fundi, media nuk kërkoi përgjegjësi fuqishëm ndaj qëndrimit të përbashkët të partnerëve të koalicionit, të cilët pas përlëshjes me 8 të lënduar, më në fund dolën bashkë të dënonin dhunën njëzëri, sikur të ishin ambasada të huaja (duhet të kishin shfrytëzuar më herët dialogun dhe të mos lejonin mbërritjen në këtë pikë të situatës).

Ashtu sikurse theksohet edhe në raportet e mëhershme, rreth ngjarjeve në Kala, mediat nuk kanë qenë mbrojtëse të interesave të bashkësive etnike së cilave u takonin, por kanë qenë vëzhguese që kanë tentuar të raportojnë për tërë kompleksitetin e saj. Gazetarët, redaktorët dhe menaxhuesit e mediave kanë tentuar t'i shmangin paragjykimet dhe stereotipat, por nuk i kanë shmangur rrënjët dhe shkaqet politike të kësaj ngjarje. Pikërisht ky konkluzion të çon në gjetjen se mediat kanë qenë më së shumti, *vegël e spineve* dhe betejave të partive politike që përplaseshin me insinuatat nacionaliste mes tyre.<sup>612</sup>

<sup>611</sup> Instituti i Studimeve të Komunikimit dhe Shkolla e Lartë për Gazetari, *Diversitetet nën prizmin e redaksive – Vështrim nga afër mbi krijimin e lajmeve*, faqja 49, <<http://www.unescochair-vs.edu.mk/attach/Pogled-odblizu-vo-sozdavanjeto-vesti.pdf>>, [13.1.2020]

<sup>612</sup> Po aty, faqja 53



Vërejtje për t'u notuar është fakti se tonet e urrejtjes ndëretnike erdhën më së shumti nga rrjetet sociale, nga grupe të hapura për tubim që synonin bashkimin e grupeve etnike maqedonase të tifozeve të futbollit nga qytete të ndryshme. Edhe sipas një studimi të Metamorfozis,<sup>613</sup> komentuesit në Facebook apo blogerët etnikë maqedonas shkruan nëse kjo mes partnerëve në qeveri ishte lojë apo e vërtetë, dhe se a përbënte “*incident diplomatik*” me Holandën fakti që Artan Grubi, krye-protestuesi me Lëvizjen “Zgjohu” ishte këshilltar politik në këtë ambasadë. Siç vërehet në studim, këto informacione u zgjeruan fillimisht nga Veçer dhe më pas u përsëritën nga Sitel, media të cilat kishin të njëjtin redaktor Dragan Pavloviç - Llatasin, dhe ishin në pronësi të *oligarkëve* të afërt me qeverinë. Të dy biznesmenët ishin njëkohësisht liderë të partive të vogla politike, Partisë për Drejtësi dhe Partisë Socialiste, anëtare të koalicionit qeverisës të rreshtuar me VMRO DPMNE-në.

#### 7.1.1.2 Ngjarjet në Smillkovë

12 prill 2012

Writen me armë zjarri 5 persona të komunitetit maqedonas pranë liqenit të Smillkovës; 4 prej tyre nga Radishani dhe i pesti nga Cresheva, fshatra jo larg Shkupit. Vrasja e ndodhur gjatë orëve të natës tronditi opinionin publik ndërkohë që tërhoqi vëmendjen e medias e cila tentoi të raportonte drejt dhe në mënyrë korrekte. Në datën 13 prill, media shpалosi identitetin e viktimave,<sup>614</sup> ndërkohë që policia iu fut punës për profilizimin dhe më pas identifikimin e autorëve të mundshëm.<sup>615</sup> Ministrja e Brendshme Gordana Jankullovсka njoftoi krijimin e një Shtabi Operativ për rastin e emërtuar “*Monstra*”, si dhe për ndalimin dhe marrjen në pyetje të 30 personave të parë lidhur me ngjarjen, numër ky që do i kalonte 100 në ditët në vijim. Gjatë vijimit të procedurave policore (atë të marrjes në pyetje ose të caktimit të masës së arrestit 48-orësh) mediat lejoheshin që të filmonin shoqërimin edhe të nënave shqiptare me mbulesë, ndërkohë që ky detaj i cili bënte ndërlidhjen mes aspektit fetar dhe etnik, *ekspozonte* dhe përgjithësonte gjithë komunitetin shqiptar. Ashtu sikurse edhe pritej, incidenti ngriti tensione edhe në vendbanimet përreth fshatit Smillkovcë. Banorët maqedonas të revoltuar bllokuan rrugët që të çonin drejt fshatit Luboten fillimisht, ndërkohë që revolta u shtri në ditën në vijim edhe në fshatrat e Karshiakës, në lagjen Draçevë. Prania e forcave speciale policore tentonte të parandalonte incidentet ndëretnike në këtë rajon të dominuar kryesisht nga komuniteti shumicë maqedonas. Drejtuesit e komunave të Studeniçanit, Kisella-Vodës dhe Zelenikovës zhvilluan takime me thirrjet për uljen e tensioneve, ndërkohë që efekti “domino” i urrejtjes ndërfetare nuk kurseu as komunitetin mysliman të Velesit, i vendosur nën kërcënime për zjarrvënje që vinin nga grupe të rinjsh të komunitetit maqedonas përmes rrjeteve sociale. Kur në media aludohej se vrasësit mund të kishin dalë në Kosovë, si dhe kur vetë ministrja Jankullovсka kërkonte ndihmën e shteteve fqinje, klasa politike shqiptare qëndroi në kllapi... vetëm LSDM-ja opozitare<sup>616</sup> doli

<sup>613</sup> Filip Stojanovski, *Македонија: Реакции на инцидентот на Кале и говорот на омраза (Македонија – Reagime mbi incidentin në Kala dhe gjuhën e urrejtjes)*, <<https://mk.globalvoices.org/02/18/20277/>>, [13.1.2020]

<sup>614</sup> Të vrarët ishin Filim Sllavkovski, Aleksandar Naqevski, Cvetanço Ackovski, dhe Kire Tërpkovski nga Radishani (nga 18 deri 21 vjeç) si dhe Borçe Stevkovski (45 vjeç) nga Cresheva (peshkatar). MIA, *Shtatë vite nga vrasja e pesëfishtë te Liqeni i Smillkovës*, <https://mia.mk/shtate-vite-nga-vrasja-e-pesefishte-tek-liqeni-i-smillkoves/?lang=sq>, [14.1.2020]

<sup>615</sup> Ministrja e Brendshme Gordana Jankullovсka njoftoi në të njëjtën ditë krijimin e një shtabi operativ për hetimin e vrasjes.

<sup>616</sup> LSDM-ja udhëhiqej në atë kohë nga Branko Cërvenkovski.

me një reagim ku kërkonte që “*Ministrisë së Brendshme t’i jepej më shumë kohë në zbardhjen e rastit, pavarësisht presionit në opinion që vinte nga protestat.*” Vetë partia në pushtet, VMRO DPMNE, do t’i hidhte zjarr ngjarjeve, veçanërisht kur ministrja e Brendshme Jankullovska do të dilte buzagaz në konferencë për mediat, për të shpallur kapjen e autorëve.<sup>617</sup> E shoqëruar nga zëvendësit shqiptarë (politikë) në MPB-së dhe DSK-së së atëhershme, Jankullovska do t’i “gjykonte” pa gjyq shqiptarët e arrestuar, si *vrasës makabër*, të denjë për veprën “*terrorizëm*”.

Gordana Jankullovska, ministre e Brendshme

“Ministria e Punëve të Brendshme i zbuloi autorët e vrasjes makabre në Liqenin e Smilkovës. Bëhet fjalë për një grup personash nga Shkupi, predikues të islamit radikal i cili, si i tillë është i rrezikshëm si për të krishterët ashtu edhe për myslimanët. Ndaj autorëve do të ngrihen padi penale, për veprën penale “terrorizëm”. Më e rëndësishmja është që policia ka punuar ditë e natë për gjetjen e vrasësve makabër të 5 qytetarëve të pafajshëm”.<sup>618</sup>

Një deklaratë e tillë nxiti shqiptarët të dilnin në protestë, dhe të nesërmen, në një qëndrim më të zbutur në median proqeveritare *Sitel*, Jankullovska përpiquej së bashku me kryeredaktorin e këtij televizioni Llatas që të thoshin se “terrorizmi nuk ka etni dhe fe”.<sup>619</sup> Qytetarët shqiptarë gjithsesi u ngritën në marshime me kërkesën e tyre për mosmontim rastesh, një frikë konstante nga qeverisjet maqedonase para pavarësisë por edhe pas pavarësisë së vendit, pavarësisht se në emër të partnerit shqiptar në qeveri, Bujar Osmani theksonte se “*BDI-ja garantonte hetim dhe gjykim të drejtë e transparent për rastin.*”<sup>620</sup>

Ndërsa prokurorja Gordana Geshkovska, në ngritjen e aktakuzës për 5 të arrestuarit (2 prej tyre në arrati në Kosovë) për të cilët kërkonte burg të përjetshëm, theksonte se rasti ishte “*masakër e motivuar nga krijimi i ndjenjës së frikës dhe pasigurisë të qytetarët ortodoksë, në festën fetare “E Enjtja e Madhe” (në prag të festës së Pashkëve)*”.<sup>621</sup> Ky vlerësim nxiti akoma më shumë shqiptarët, të cilët përveç sulmit ndaj komunës së Çairit (sinjal proteste kundër partnerit shqiptar në qeveri, BDI-së) hodhën gurë edhe ndaj Gjykatës së Shkupit, akt për të cilin u dënuan më vonë deri në 3 vite burg, për xhamat e thyer të objektit të Gjykatës. Protestat për këtë rast u bënë të zakonshme çdo të premtë nga shqiptarët, ndërkohë që në qershor të vitit 2014, të ndaluarit për ngjarjen u dënuan me burg të përjetshëm.<sup>622</sup>

Ekspertët kundërshtonin jo vetëm *kualifikimin e veprës, kërkesën për burg të përjetshëm* por edhe *tonet* e prokurores Geshkovska që nxiste urrejti ndëretnike dhe ndërfetare.<sup>623</sup>

\*\*\*

<sup>617</sup> TV Shenja, *Katër vjet nga vrasja në Smilkovë, të dënuarit akoma në kërkim të drejtësisë*, <<https://shenja.tv/kater-vjet-nga-vrasja-ne-smilkove-te-denuarit-akoma-ne-kerkim-te-drejtisesi/>>, [14.1.2020]

<sup>618</sup> ALSAT, *Jankullovska: Zbuluam vrasësit e pesëfishtë në Smilkovë, arrestohen 20 persona*, <<https://www.youtube.com/watch?v=slQIQil7hgw>>, [14.1.2020]

<sup>619</sup> VMRO DPMNE, *Интервју на Гордана Јанкуловска во вестите на Сител (Intervistë e Gordana Jankullovska në lajmet e Sitel)*, <<https://www.youtube.com/watch?v=ELiAIKHkrpE>>, [15.1.2020]

<sup>620</sup> Bujar Osmani, në intervistë për ALSAT. <<https://www.youtube.com/watch?v=59Ux05-t0zk>>, [15.1.2020]

<sup>621</sup> ALSAT, “*Monstra*”, *Prokuroria kërkon dënim maksimal*, <<https://www.alsat-m.tv/36545/>>, [15.1.2020]

<sup>622</sup> Të dënuarit me burgim të përjetshëm, Alil Demiri, vëllezërit Afrim dhe Agim Ismailoviq (në mungesë), Fejzi Haziri, Haki Aziri dhe Sami Luta. Vetëm një prej të akuzuarve, Ramiz Sejdiu, u lirua nga akuza.

<sup>623</sup> Portalb, *Shasivari: ‘Monstra’, proces i montuar dhe monstruoz*, <<https://portalb.mk/81122-shasivari-monstra-proces-i-montuar-dhe-monstruoz/>>, [15.1.2020]

Nëpër lajme në median e shkruar dhe atë elektronike gjendej një listë të gjatë epitetesh.

*Dnevnik*: Radikalë islamikë qëlluan me armë në Maqedoni<sup>624</sup>  
*Press24*: Arrestohet Shukri Alija, islamik radikal nga Maqedonia i lidhur me “Monstrën”<sup>625</sup>  
*Veçer*: Monstra ekstradohet në burgun e Maqedonisë<sup>626</sup>  
*Sitel*: Burg 30 ditë për 9 të arrestuar në aksionin “Monstra”<sup>627</sup>  
*RTVM*: Mentori i vrasjes së pesëfishtë në liqenin e Smillkovës ekstradohet në Maqedoni<sup>628</sup>  
*Kanal 5*: Dhjetë të arrestuar në “Monstra” lëshohen në liri, në burg mbeten 7 ndërsa 2 janë në arrati  
*Alfa*: MPB: Të rinjtë u vranë nga islamikë<sup>629</sup>  
*Sitel*: Kapen ekzekutuesit e masakrës në Smilkovë  
*Alsat*: Jankullovska: Zbuluam vrasësit e pesëfishtë në Smillkovë, arrestohen 20 persona

Nga vështrimi i shkurtër që mund t’i bëhet titujve, bie lehtë në sy doza e orientimit të mediave drejt aspektit fetar, (islamizmit), atij etnik, nxitjes së mëtejshme me përdorimin e epiteteve “monstra” që në fakt buronte nga vetë Ministria e Brendshme, apo i termeve të tjerë të dramatizimit dhe nxitjes së tij me epitetet “masakër”, “akt makabër”, “akt çnjerëzor”, “vrasje masive”, “krim i përgjakshëm”, “vrasje e urreyeshme”, “vrasje brutale”, “vrasës radikalë”, pa munguar edhe detajet se në bastisje janë gjetur emblema të UÇK-së apo këngë të Golden AG “*Për ty o Gostivar*”, detaje këto që duhet të tregonin doemos përkatësinë fetare dhe etnike të sulmuesve.<sup>630</sup> Në titujt e disa mediave thuhej se “*Ministria e Brendshme kishte kapur autorët*”, në Kanal5 për shembull theksohej se “*Në aksionin “Monstra” ranë edhe monstrat e liqenit të Smillkovës*”.<sup>631</sup> Gazetarëve nuk iu lejohet të demonizojnë njërën palë, aq më tepër kur i përdorin në mënyrë të pasaktë epitetet e tilla.

Mediat, gjithsesi, edhe pse ishin të nxitura nga fjalori i politikës, pra i zyrtares së lartë të policisë Jankullovska, shkelën gjithsesi shumë rregulla të tjera... ai numër 1 ishte *ruajtja dhe verifikimi (prezumimi) i pafajësisë*. Media gëlonte nga pamjet e arrestimeve, pa shfoksim fytyrash, e aq më tepër kur shfaqeshin edhe pamje se si nënat ose femrat shqiptare të mbuluara tërhiqeshin nga policë meshkuj. Në mosnjohje të mentalitetit dhe nderit të shqiptarëve, shoqërimi i femrave shqiptare të ndaluara nga policë meshkuj preku ndjenjat e këtij komuniteti.<sup>632</sup>

<sup>624</sup> Nga arkivi i lajmeve në agregatin time.mk, <<https://time.mk/cluster/621770b9cd/islamski-radikali-uapseni-zasmilkovci.html>>, [16.1.2020]

<sup>625</sup> Nga arkivi i lajmeve në agregatin time.mk, <<https://time.mk/cluster/2c3fc299c0/monstrumot-ekstradiran-vo-makedonski-zatvor.html>>, [16.1.2020]

<sup>626</sup> Bëhet fjalë për ekstradimin nga Kosova të një të dyshuari për rastin “Monstra”

<sup>627</sup> Nga arkivi i lajmeve në agregatin time.mk, <<https://time.mk/cw/3ede35276e/protest-za-slucajot-smilkovci.html>>, [16.1.2020]

<sup>628</sup> Nga arkivi i lajmeve në agregatin time.mk, <<https://time.mk/cluster/2c3fc299c0/monstrumot-ekstradiran-vo-makedonski-zatvor.html>>, [16.1.2020]

<sup>629</sup> Nga arkivi i lajmeve në agregatin time.mk, <<https://time.mk/cluster/621770b9cd/islamski-radikali-uapseni-zasmilkovci.html>>, [16.1.2020]

<sup>630</sup> ALSAT, “*Monstra*”, Prokuroria kërkon dënim maksimal, <<https://www.alsat-m.tv/36545/>>, [16.1.2020]

<sup>631</sup> Instituti i Studimeve të Komunikimit dhe Shkolla e Lartë për Gazetari, *Raportimi për tensionet ndërreligjioze dhe ndëretnike – Nënkuptimi i titujve*, faqja 165, <<http://www.unescochair-vs.edu.mk/attach/Znacenjeto-zad-naslovite.pdf>>, [17.1.2020]

<sup>632</sup> Bujar Osmani, në intervistë për ALSAT. (minuta 9:45), <<https://www.youtube.com/watch?v=59Ux05-t0zk>>, [17.1.2020]

Jo vetëm me paraqitjen e pamjeve të pambuluara, paraqitjen e emrave të të ndaluarve por edhe me epitete gjykuese dhe paragjykuese në tekstet e tyre, të gjitha mediat televizive shkelën qartë nenin 8 të Kodit Etik të Gazetarëve, i cili thekson se “*në proceset gjyqësore duhet të respektohet parimi i pafajësisë, të raportohet për të gjitha palët e përfshira në kontest dhe të mos sugjerohet vendimi*”.<sup>633</sup>

Çështje që duhet të konsiderohet si shkelje më vete ishte edhe identifikimi etnik ose përkatësia etnike e theksuar në lajme. Përmes këtij veprimi, mediat shkelën parimin e raportimit në kushte të caktuara në shtete multi-etnike, multi-fetare dhe multi-kulturore. Përkatësia etnike dikton doemos në ekspozimin dhe theksimin e gjithë grupit etnik.

Shkelje në raportime mund të vëreheshin edhe kur media tentonte të bënte *analiza* mbi zhvillimet. Shpeshherë, mediat zgjidhnin figurat *më kritike* nga radhët e protestuesve, qëndrimet më të vrazhda partiake, nga eksponentë të tjerë, dhe nuk synonin në asnjë kohë që të gjenin figura që bënin thirrje për qetësim të situatës. Pra, mediat, duke u thirrur në parimin e raportimit të drejtë, nuk bënin një përzgjedhje të zgjuar për analistë, ekspertë, komunikologë etj., që me teoritë e tyre të ndihmonin sadopak në uljen e tensioneve, veçanërisht gjatë operacioneve të arrestimit ose të protestave masive të qytetarëve nga të dy komunitetet.<sup>634</sup>

Në një raport mbi domethënien e titujve në lajme lidhur me rastin e Smillkovës,<sup>635</sup> theksohet gjithsesi se mediat televizive prapëseprapë kanë qenë më të vëmendshme në raportim, duke synuar qetësimin e marrëdhënieve ndëretnike e ndërftare. Problem është vërejtur më së shumti te transmetuesi publik ku TVM1 i minimizonte bllokadat (e fshatrave shqiptare nga protestuesit e komunitetit shumicë) madje i heshtte sulmet ndaj njerëzve ose pronës së tyre (komunitetit pakicë), ndërkohë që TVM2 nuk raportonte aspak për reagimet apo protestat e banorëve lokalë (të komunitetit shumicë). Kjo përbënte një shkelje të pastër të ligjit të atëhershëm për veprimtari radiodifuzive (neni 121) që thotë se “*Për të arritur interesin publik, RTM duhet të zhvillojë dhe planifikojë një skemë programore në interes të të gjithë publikut, si dhe të prodhojë dhe transmetojë programe për të gjitha segmentet e shoqërisë pa diskriminim, duke marrë parasysh grupet specifike shoqërore*”.<sup>636</sup> Kohezioni social për shërbimin publik është jo vetëm larg ligjit por në vend që të promovojë bashkëjetesën, nxit më shumë ndasi.

Ndërkohë, vërejtjet më të mëdha në raportim për ngjarjet në Smillkovë i atribuohen mediave të shkruara, të cilat kanë përdorur terminologjinë e ndasisë në “ne” dhe “ata”, veçanërisht në kolumna. Ky kategorizim i vrazhdë, sipas shkrimeve, shkonte deri aty sa ngjarjet e Smillkovës të merrnin përmasa problematike për sa i përket sigurisë, duke hequr paralele me konfliktin e kaluar të vitit 2001 apo raste të rrahjeve ndëretnike nëpër autobusë.<sup>637</sup>

<sup>633</sup> Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, *Kodi etik i gazetarëve*, <<https://znm.org.mk/%D0%BA%D0%BE%D0%B4%D0%B5%D0%BA%D1%81-%D0%BD%D0%B0-%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D1%80%D0%B8%D1%82%D0%B5/?lang=SQ>>, [17.1.2020]

<sup>634</sup> Evropa e Lirë, *Shkup: Dilema për operacionin “Monstrum”*, <<https://www.evropaelire.org/a/24570115.html>>, [17.1.2020]

<sup>635</sup> Instituti i Studimeve të Komunikimit dhe Shkolla e Lartë për Gazetari, *Raportimi për tensionet ndër-religjioze dhe ndëretnike – Nënkuptimi i titujve*, faqja 158, <<http://www.unescochair-vs.edu.mk/attach/Znacenjeto-zad-naslovite.pdf>>, [17.1.2020]

<sup>636</sup> Pravdiko.mk, *Ligji për veprimtari radiodifuzive 2005*, <<https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-radiodifuznata-dejnost-21-11-2005.pdf>>, [17.1.2020]

<sup>637</sup> Instituti i Studimeve të Komunikimit dhe Shkolla e Lartë për Gazetari, *Raportimi për tensionet ndër-religjioze dhe ndëretnike – Nënkuptimi i titujve*, faqja 136, <<http://www.unescochair-vs.edu.mk/attach/Znacenjeto-zad-naslovite.pdf>>, [17.1.2020]

Një fenomen tjetër i vërejtur ishte ai i viktimizimit dhe i viktimizimit kthyes. Gazetat në gjuhën maqedonase theksonin me doemos përkatësinë etnike, duke u viktimizuar, në mënyrë që të theksonin se vrasësi është nga “ata”, “të tjerët”, ndërkohë që gazetat në gjuhën shqipe tentonin t’i bëjnë shqiptarët si viktima të institucioneve “maqedonase”. Në titullin e një shkrimi të saj, gazeta Koha shkruante “Maqedonasit i paragjykojnë shqiptarët”.<sup>638</sup>

Gjithsesi, raportimi mediatik lidhur me këtë ngjarje ishte vis a vis pasqyrim i politikës.

Përdorimi i epitetëve diferencuese nga ministrja e Brendshme Jankullovska ishte nxitësi kryesor i gjuhës që tejçohet edhe në media. Po ashtu, taktika “e gabuar dhe naive” e policisë për të thirrur mediat gjatë operacioneve të dërgimit në gjykatë të të ndaluarve, ishte një tjetër shtysë që mediat të mos kujdeseshin për parimin e pafajësisë. Emrat e të ndaluarve, familjet e bastisura etj., dilnin jo pa qëllim nga burime ose vetë Ministria e Brendshme, duke i bërë mediat që të hanin karremin për lajm ekskluziv, dhe me këtë, të tejçonin ndasinë ndëretnike.

Pavarësisht se media kishte pasur plot përvojë me raste të tilla ndëretnike deri më tani, edhe në ngjarjet e Smilkovës ajo bëri shumë gabime, por mbi të gjitha, u bë vegël e vetë politikës.

### 7.1.1.3 Karnavalet e Vevçanit

13 janar 2012

Si çdo vit, në komunën e Vevçanit mbahen të ashtuquajturat Karnavalet e Vevçanit, një traditë mbi 1400 vjeçare për nder të festës fetare ortodokse Ditës së Shën Vasilit.<sup>639</sup>

Karnavalet mbahen në datat 13 dhe 14 janar, ndërkohë që përmes satirës, pjesëmarrësit e saj tentojnë të ironizojnë fenomene të ndryshme nga jeta sociale dhe politike në shtet, duke gërshetuar edhe rrënjët pagane, ashtu edhe ritualet fetare ortodokse ose myslimane. Kjo ngjarje financohet jo vetëm nga komuna por edhe nga shteti, edhe pse raste të shumta kanë treguar se për mbajtjen e tyre nuk ka një organizim të mirëfilltë, veçanërisht kur satira i kalon kufijtë dhe prek ndjenjat e komuniteteve të tjera. Manifestimet e vitit 2012, për shembull, provokuan incidente ndërfitare e ndëretnike në vend.

Në pamjet e kapura nga kamerat televizive tregohet një grup manifestuesish i kryesuar nga një person me çallmë, me një libër në dorë në të cilën shkruhej “Kuron”<sup>640</sup> (në vend të “Qur’an” apo “Kuran”), ndërsa pas tij vinte një grup ndjekësish të veshur me xhybe e hixhab të cilët përkuleshin mbi sexhde (mbi flamurin islam), në të cilin ishte shtrirë një penis i gjatë, e më të luante një tjetër person i maskuar që simbolizonte një prostitutë.<sup>641</sup>

Akti i tillë nxiti reagime të mëdha në rrjetet sociale nga besimtarët myslimanë dhe qytetarët e komunitetit shqiptar. Myftinia e Strugës<sup>642</sup> e dënoi ashpër këtë shfaqje duke kërkuar nga drejtuesit e karnavaleve dhe vetë shteti, t’i kërkonin falje publike komunitetit mysliman. Po ashtu, u kërkuar edhe dorëheqja e kreut të Komunës. Ndërkohë Bashkësia Fetare Islame gjithashtu kërkoi që Ministria e Kulturës të mos financojë më këtë manifestim të përvitshëm

<sup>638</sup> Po aty, faqja 142

<sup>639</sup> The Atlantic, *The Carnival of Vevçani*, <<https://www.theatlantic.com/photo/2014/01/the-carnival-of-vevçani/100661/>>, [18.1.2020]

<sup>640</sup> Në maqedonisht, ky term nënkupton penisin.

<sup>641</sup> Youtub, *Vevçani Karneval 2012 - kako se igraat so muslimanite*, (Karnavalet e Vevçanit 2012 – si luajnë me myslimanë), <[https://www.youtube.com/watch?v=tGTca\\_7cNsU](https://www.youtube.com/watch?v=tGTca_7cNsU)>, [18.1.2020]

<sup>642</sup> Reagim i Myftinisë së Strugës dhe kryetarit të saj Ferat Polisi, <<http://www.nacionalalbania.al/2012/01/karnevali-i-vevçanit-ofendoi-muslimanet/>>, [18.1.2020]

dhe iu bëri apel besimtarëve se “*Besimi ynë nuk na lejon t’i përgjigjemi këtyre sulmeve me të njëjtat armë.*”<sup>643</sup> Në protestë doli edhe kreu i Komunës së Strugës Ramiz Merko, i cili theksoi se “*komuniteti mysliman, ai shqiptar, dhe komuna e Strugës janë angazhuar gjithnjë për bashkëjetesë dhe tolerancë fetare.*” Por, kreu i komunës së Vevçanit, Pero Ilievski, tha se jo vetëm që “*nuk ndjen përgjegjësi për fyerjet dhe ofendimet, por madje, fajtor për protestat është kreu i Komunës së Strugës që i përkrah ato.*”<sup>644</sup>

Doza e revoltave u shtua më shumë kur në të njëjtën periudhë në datat 15 deri në 29 janar në Serbi (Nish e Beograd), në kuadër të Kampionatit Evropian të Hendbollit “Euro 2012”, tifozët që mbështesnin përfaqësuesen e Maqedonisë këndonin këngë antishqiptare; “*shqiptarët e mallkuar*”, “*Maqedoni e pastër*”, “*shqiptar i mirë, shqiptari i vdekur*” etj. Situata mori jehonë edhe kur në pamje u panë se edhe vetë hendbollistët këndonin me tifozët, ndërsa Federata e Hendbollit mohonte fyerjen e shqiptarëve.<sup>645</sup>

Në këto kushte, Komisioni për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive thirri seancë ku propozonte uljen në tryezë të krerëve të komunave, përfaqësuesve të Myftinisë së Strugës dhe organizatorëve të Karnavaleve, si dhe daljen me një qëndrim të përbashkët ku të dënonin aktet dhe të bënin apel për vetëpërmbytje në kuadër të bashkëjetesës.

Partia shqiptare, BDI-ja, bënte thirrje për qetësi, por si pjesëtare e koalicionit qeverisës nuk ndikonte që institucionet shtetërore të merrnin masa për të ndëshkuar urrejtjen ndërfaqetare dhe ndëretnike.

Në 23 janar, një banor i fshatit Shum i vuri flakën flamurit maqedonas para komunës së Strugës, ndërkohë që revolta anti-maqedonase u përshkallëzua me grafitë e mbishkrime nëpër kisha e xhami, dhe pastaj përfundoi me zjarrvënje ndaj kishave të Labunishtës dhe Reçicës së Vogël.<sup>646</sup>

Vetëm në këtë moment do të ndërhynte edhe kreu i shtetit Gjorge Ivanov i cili do të thërriste në takim të përbashkët kryetarin e Bashkësisë Islame, Sulejman Rexhepi, dhe kreun e Kishës Ortodokse, imzot Stefanin, për të dalë me qëndrimin se “*çdo incident i izoluar, kudo që të ndodhë, duhet të dënohet nga ana e të gjithëve*”. As Komiteti për Marrëdhënie Ndëretnike në Kuvend i thirrur për këtë çështje nuk e bindi kreun e Komunës së Vevçanit Pero Ilievski ndaj fyerjeve që iu bënë besimtarëve të fesë islame. BDI-ja, edhe pse në qeveri, kërkonte që shteti të veprojë, ndërsa PDSH-ja opozitare thoshte se “*shqiptarët nuk kanë probleme me popullin maqedonas por me qeverisjen e Nikolla Gruevskit e cila është antishqiptare*”.<sup>647</sup>

\*\*\*

Raportimi mediatik dhe mbulimi i ngjarjeve, sigurisht që bartte edhe diskursin etnocentrik si dhe atë të stereotipave negativë.

<sup>643</sup> Bashkësia Fetare Islame, *Reagim ndaj Karnavaleve të Vevçanit*, <<https://bfi.mk/reagim-ndaj-kanavalit-te-vevcanit/>>, [18.1.2020]

<sup>644</sup> Shkëputur nga arkivi i lajmeve i televizionit ALSAT, *Pero Ilievski flet për ngjarjet dhe përgjegjësinë*.

<sup>645</sup> Nga arkivi i lajmeve në agregatin time.ikub.al, ><http://time.ikub.al/Lajme/38cf464dcc/Lojtaret-e-hendbollit-te-Maqedonise-brohoritje-antishqiptare.aspx>>, [18.1.2020]

<sup>646</sup> Instituti i Studimeve të Komunikimit dhe Shkolla e Lartë për Gazetari, *Raportimi për tensionet ndërreligjioze dhe ndëretnike – Nënkuptimi pas titujve*, faqja 97, <<http://www.unescochair-vs.edu.mk/attach/Znacenjeto-zad-naslovite.pdf>>, [18.1.2020]

<sup>647</sup> Shkëputur nga një kronikë e televizionit ALSAT që mban datën 1.2.2012 në të cilën flasin kreu i komunës së Vevçanit, Pero Ilievski, ai i komunës së Strugës Ramiz Merko, të thirrur për të raportuar mbi incidentet. Në kronikë flasin edhe Xhevat Ademi, deputet i BDI-së si dhe Orhan Ibrahim, deputet i PDSH-së.

*Kurir:* Në Strugë i vihët flaka flamurit maqedonas<sup>648</sup>

*Veçer:* Vevçanasit u hipën tensionin myslimanëve

*Sitel:* Në Strugë, incidente pas protestës së qetë

*Dnevnik:* I vihët flaka flamurit maqedonas, vendoset flamur islamik në Strugë

*RTVM:* Në Strugë, incidente pas protestës së qetë të udhëhequr nga kreu i komunës Merko

*ALSAT:* Ofendimet ndaj myslimanëve, kreu i Vevçanit nuk ndjen përgjegjësi<sup>649</sup>

*Kanal5:* Sulmohet me gurë autobusi i Vevçanit në Veleshtë

*Telma:* Karnavalet e Vevçanit ngrenë në këmbë myslimanët e Strugës

Në tituj vërehet gjuha jo e zgjedhur mirë e mediave, të cilat përveç raportimit synojnë edhe dozën e bërjes së lajmit sa me *sensacional* (dramatike).

Nga ana tjetër, analiza e përmbajtjes së teksteve tregon dyzimin e mediave, maqedonase dhe shqiptare, lidhur me përjetimin e ngjarjeve. Për shembull, mediat shqiptare raportojnë me një mllef lidhur me manifestimin e Vevçanit, duke thënë se paraqitja e simboleve sikurse emri i librit “Kuron” dhe jo “Kuran”, përdorimi i sexhdes (flamurit islam) ose i penisit mbi të, përbënin jo vetëm tallje ndaj fesë por edhe nota të “pedofilisë”. Për mediat maqedonase, paraqitja e karnavaleve të Vevçanit ishte normale, dhe mbahej në heshtje. Ato reaguesh për vetëm kur flamurit maqedonas iu vendos flaka. Më të predispozuara për tone të ashpra ishin sigurisht mediat më afër pushtetit.

Sërish, reagimi jo adekuat i aktorëve institucionalë dhe jashtë-institucionalë zgjeroi më shumë hapësirën për paragjykimë si në opinion ashtu edhe në media. Përveç apeleve “*për ulje tonesh dhe respektim të bashkëjetesës*”, nuk kishte asnjë veprim konkret ku shteti të merrte masa dhe të garantonte përgjegjësi për aktin. Nuk pati arrestime as të performuesve që nxitën këtë krizë ndërfaqetare, dhe as kërkim faljeje publike. Binte në sy edhe fakti se shteti dhe Komuna e Vevçanit që organizojnë këtë traditë shekullore dhe e financojnë atë, nuk mbanin përgjegjësi për monitorimin e shfaqjeve në karnavale, për programin e tyre dhe as llogari për ndjenjat e lënduara të komunitetit mysliman. Nga ana tjetër, Bashkësia Fetare Islame dhe Myftinia e Strugës, përveç kërimit të përgjegjësisë, përdornin një gjuhë që lehtësisht shfrytëzohej si nxitje për urrejtje. Myftinia kërkonte që Vevçani “*të fshihej nga harta e komunave*” të Maqedonisë ndërsa nuk lihej pa përmendur edhe kërcënimin se “*Myftinia nuk do ta lërë këtë çështje, vetëm me këtë reagim për mediat, por do të ndërmarrë një sërë masash për të cilat opinioni do të njoftohet në kohë*”.

Në të njëjtën kohë, gjatë raportimeve, janë vërejtur edhe diskurse përçarëse, sidomos gjatë protestave ku secila palë i adresohet palës tjetër me fjalët të tilla si “*vdisni*”, “*kaurë*”, ose “*shiptar*” etj. Në disa media ato nuk janë hequr nga sinkronet, por janë përcjellë pa përzgjedhje.

Shkelje kanë përbërë edhe pamjet e grafiteve të shkarravitura nëpër kisha e xhami, që përcillnin *pa filtër* urrejtjen ndërfaqetare dhe ekspozimin e grupeve specifike fetare.

Më të ashpra ishin perceptimet e përfutuara nga raportimi në mediat e shkruara, ku rastet shiheshin si një betejë e ashpër mes kategorisë “*ne*” dhe “*ata*”. Madje, ka pasur tituj sikurse ai i Nova Makedonija “*Nuk kanë për t’ia dalë për konflikt të ri si ai i vitit 2001*”, apo kthimi te e kaluara dhe ndezja më e madhe e urrejtjes.<sup>650</sup> I ashpër ishte edhe titulli i fejtimit “*Dosja* –

<sup>648</sup> Nga arkivi i lajmeve në agregatin time.mk, <<https://time.mk/cluster/1085c9cae0/struskite-muslimani-navredeni-od-vevcanskiot-karneval.html>>, [19.1.2020]

<sup>649</sup> Nga arkivi i lajmeve në agregatin time.ikub.al, <<http://time.ikub.al/Lajme/e7bd9a2457/lexo.aspx>>, [19.1.2020]

<sup>650</sup> Instituti i Studimeve të Komunikimit dhe Shkolla e Lartë për Gazetari, *Raportimi për tensionet ndërreligjioze dhe ndëretnike – Nënkuptimi pas titujve*, faqja 107, <<http://www.unescochair-vs.edu.mk/attach/Znacenjeto-zad-naslovite.pdf>>, [22.1.2020]

*Hakmarrja e përgjakshme*” e Utrinski Vesnik më 5 shkurt e cila fliste për islamizmin, hakmarrjen, kanunin e Lekë Dukagjinit etj., dhe përgjithësimin e *familjes shqiptare*. Po ashtu, edhe te gazetatat në gjuhën shqipe, titulli “*Skenarë hitlerianë në Llabunishtë*” i gazetës Lajm është jo më pak nxitës. Kjo ndarje e gjerë në “*ne*” dhe “*ata*”, për fat të keq nuk gjente ndonjë reagim të fortë nga pushteti dhe institucionet, duke nënkuptuar se *vendosja në heshtje ose në harresë* e incidenteve, do të shërbente sërish si fitil për nxitje të tjera në të ardhmen, dhe se rreziku nga “*tjetri*” është evident dhe mbetet po aty.

Ngjarjet e Karnavaleve të Vevçanit treguan edhe njëherë se media jo vetëm që është *vegël* e klasës politike, por edhe se është ende *e papjekur* për t’iu përmbajtur kuadrit specifik të raportimit në shoqëritë multi-etnike, multi-fetare dhe multi-kulturore. Në vend të ndihmesës në përmirësimin e marrëdhënieve ndër-etnike, mediat nxitën jo-tolerancën, përgjithësuan individin me gjithë grupin, glorifikuan stereotipat lokalë nga ata globalë (islamit në Maqedoni, i varur gjoja nga rryma globale islamike radikale), si dhe i provuan politikës se sa e thjeshtë është ndezja e konflikteve përmes vetë mediave.

#### 7.1.1.4 Vdekja e 4-vjeçarit Almir Aliu

1 korrik 2016

Vdes në spital 4-vjeçari i aksidentuar në një nga rrugët dytësore të Kumanovës. Vdekja e të miturit vjen 5 ditë pas përpjekjeve për t’i shpëtuar jetën në Qendrën Urgjente në Shkup, nga përplasje e një makine, autorët e së cilët ishin fjalosur më herët me prindërit e të miturit. E gjitha filloi nga një zënkë verbale, të shtunën e 25 qershorit, kur prindi i të miturit i lëshoi radhën e pritjes për te mjeku një gruajë të moshuar, e sëmurë më rëndë. Por, tre persona të tjerë në radhë (mes tyre 2 vëllezër, dhe personi tjetër, e fejuara e njërit prej tyre), u grindën dhe u shtynë fizikisht për këtë lëshim. Në orët e pasdites, kur prindërit ktheheshin në shtëpi me 4 vjeçarin, nëpër një rrugicë të qytetit, tre personat me të cilët kishte ndodhur grindja, përplasën me makinën e tyre “Mercedes” familjen e 4-vjeçarit. Pas përplases së tyre në murin e një shtëpie, tre personat dalin edhe me shufra për të vazhduar rrahjen.

Ngjarja u paraqit të polici nga vetë sulmuesit e hequr si viktimë të rastit, dhe sikurse theksohet në buletin e Ministrisë së Brendshme, pas marrjes në pyetje, versioni i sulmuesve u hodh poshtë dhe dinamika e ngjarjes u përmbys. Po ashtu, në buletin theksohet se sulmi i paraqitur kishte ndodhur pas një shërri të *mëhershëm*, (detaj i fshehur në denoncimin paraprak në polici) dhe se personi me inicialet B.I. e kishte goditur *me qëllim* familjen Aliu.<sup>651</sup>

<sup>651</sup> Buletini informativ i Ministrisë së Brendshme: “Më 25.06.2016, në orën 22:30 në Stacionin Policor të Kumanovës, personi me inicialet T.D. (i vitit 1993) nga fshati Biljanovë i Kumanovës, denoncoi se pas një shërri të shkurtër në rrugën “Boris Kidriç” pranë Shtëpisë së Shëndetit Publik “Ured” në Kumanovë, ka qenë sulmuar fizikisht nga 3 persona të cilët i kanë dëmtuar automjetin. Nga ana e Prokurorit Publik pranë Prokurorisë Themelore Publike të Kumanovës dhe ekipit hetimor pranë Sektorit për Punë të Brendshme të Kumanovës, u krye hetim i vendit të ngjarjes, pas të cilit u konstatua se më 25.06.2016, rreth orës 22:30, pas një shërri të *mëhershëm* me personin me inicialet S.A. (i vitit 1980) në Kumanovë, personi me inicialet B.I. që drejtonte automjetin privat “Mercedes C200” së bashku me bashkudhëtarët, vëllain e tij me inicialet B.I dhe personin tjetër me inicialet T.D, me anën e djathtë të përparme, *me qëllim*, ka përplasar personin me inicialet S.A., bashkëshorten e tij me inicialet M.K. (e vitit 1980) dhe fëmijën e tyre 4 vjeçar, pas të cilës, me anë të Ndhmës së Shpejtë Mjekësore, personi me inicialet S.A. është dërguar në Qendrën Mjekësore të Kumanovës ndërsa bashkëshortja e tij me inicialet M.K dhe foshnja, si rast urgjent, me automjetin e Ndhmës së Shpejtë janë dërguar për në Klinikën Kirurgjikale për Fëmijë të Spitalit Shtetëror të Shkupit. Tre personat u morën në Sektorin për Punë të Brendshme në Kumanovë, ku pas marrjes në



Si çdo akt dhune mes pjesëtarëve të komuniteteve, ngjarja mori hov debatesh të gjera në rrjetet sociale, pikërisht kur opinioni kishte marrë veçse një “parakualifikim” të veprës penale nga ana e policisë (që theksonte se *përplasja ka qenë e qëllimshme*). Kryetari i Komunës së Kumanovës Zoran Damjanovski thirri një mbledhje urgjente të Këshillit Parandalues për Siguri për të bërë apel për gjakftohtësi dhe ruajtje të raporteve ndëretnike. Në raportimin e policisë para tij, u theksua se ishin dorëzuar 2 kallëzime penale por vetëm drejtuesi i automjetit ishte mbajtur në paraburgim.<sup>652</sup>

Ndërkaq, vdekja e 4-vjeçarit më datën 1 korrik, do t’i nxiste akoma më shumë komentet në rrjetet sociale. Në ditën e varrimit, mijëra banorë të komunitetit shqiptar morën pjesë në ceremoninë e lamtumirës së 4-vjeçarit. Edhe hoxha që kryente ritualet në varrim *i lutej Zotit për dënimin e autorit të krimit*.<sup>653</sup>

Akti i përplasjes me makinë do të dokumentohej edhe me një video e regjistruar nga një kamerë e qarkut të shkurtër, nga një shtëpi aty pranë. Videot u shpërndanë dhe pamjet e përplasjes ngritën shumë dyshime në opinion, nëse ishte përplasje e qëllimshme, përplasje me paramendim pas sherrit të mëhershëm, si dhe a do të merrte dënimin e merituar autori apo jo. Përzierë me komentet, shprehej edhe mllefi ndëretnik me paragjykimet.

Qytetarët ngritën një iniciativë për tubim dhe dolën në marshim paqësor më 4 korrik për të dënuar vrasjen. Në protestën paqësore, vetë familja e Almirit kërkoi që rasti të mos keqpërdorej për politikë, ndërkohë që marshimi mbledhi mijëra njerëz, përfshi edhe nga qytete të tjera.<sup>654</sup>

Megjithatë, tensionet do të mbaheshin ende pezull, veçanërisht për shkak të Prokurorisë e cila vetëm 3 ditë para skadimit të afatit 6-mujor (pas të cilës autori duhej të lihej në liri), më në fund ngriti aktakuzën (e plotësuar, që përveç akuzës për vrasjen e 4-vjeçarit ndaj autorit B.I. përfshinte tani edhe akuzën ndaj babait të të miturve dhe dy personave të tjerë me të, për dhunë ndaj autorit të vrasjes).<sup>655</sup> Nga ana tjetër, Gjykata lejoi kërkesën për vërtetim neuropsikiatrik për sulmuesin, nëse ai kishte qenë në gjendje normale psikike dhe fizike gjatë kryerjes së aktit apo jo, tentativë kjo e palës mbrojtëse të tij për të ulur dënimin e autorit të vrasjes së të miturit.<sup>656</sup> Protestat vijuan edhe kur në media doli se mjeku që e bëri kontrollin neuropsikiatrik e kishte humbur licencën kohë më herët.<sup>657</sup> E dërguar për mendim në organin më të lartë të akuzës,

pyetje, 2 vëllezërit u ndaluan ndërsa personi i tretë me inicialet T.D u la në liri. Sektori për Punë të Brendshme i Kumanovës mori masat për zbardhjen e plotë dhe dokumentimin e rastit.”

<sup>652</sup> Sevdail Xhaferi, Zëvendëskryeshef i Sektorit për Punë të Brendshme në Kumanovë. Shkëputur nga arkivi i lajmeve i ALSAT, datë 27 qershor 2016. “Rasti është zbardhur tërësisht. Janë ngritur 2 kallëzime penale, njëri për dhunë dhe tjetri për tentativë vrasjeje. Të dy kallëzimet janë dërguar në Prokurorinë themelore publike. Ndaj njërit është ndërmarrë masa e paraburgimit.”

ALSAT, *Incidenti në Kumanovë, fëmija në gjendje kritike*, <<https://www.alsat-m.tv/259351/>>, [22.1.2020]

<sup>653</sup> Në fjalën e tij në ceremoninë e varrimit, hoxha theksonte: “Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Almirin 4-vjeçar i cili ndërroi jetë si shkak i një krimi barbar, që i ndodhi para disa ditëve nga një kriminel vrastar, për të cilin e lutim Allahun që ta dënojë në këtë botë dhe në botën tjetër, me dënim më të rëndë, në xhehenem (Ferr).” 2 korrik 2016, shkëputur nga arkiva e televizionit ALSAT

<sup>654</sup> ALSAT, *Vdekja e 4-vjeçarit, protesta në Kumanovë*, <<https://www.youtube.com/watch?v=AOsefU0xN7E>>, [29.12.2019]

<sup>655</sup> ALSAT, *Vrasja e Almirit, Prokuroria Themelore e Kumanovës ka dorëzuar aktakuzën*, <<https://www.alsat-m.tv/vrasja-e-almirit-prokuroria-themelore-e-kumanoves-ka-dorezuar-aktakuzen/>>, [22.1.2020]

<sup>656</sup> Madje, pala mbrojtëse e autorit të vrasjes B.I shkante më tej me kërkesën, që vepra të kualifikohej si “*nevojë ekstreme*”, dispozitë që sipas Kodit Penal nuk paraqet vepër penale, por vetëmbrojtje në rrethana për të shpëtuar jetën (sikurse katastrofat natyrore)

<sup>657</sup> ALSAT, *Alsat-M zbulon: Ekspertiza për “Almirin”, nga ekspertë pa licencë*, <<https://www.alsat-m.tv/alsat-m-zbulon-ekspertiza-per-almirin-nga-eksperte-pa-licence-2/>>, [22.1.2020]

Prokurorinë e lartë Republikane, pas një ndarjeje “etnike” votash mes prokurorëve të komunitetit maqedonas dhe atij shqiptar, 6 me 4, vepra u rikualifikua nga “*vrasje me paramendim*”<sup>658</sup> në “*vepër e rëndë kundër sigurisë së njerëzve dhe pronës në qarkullimin rrugor*”.<sup>659</sup> Kjo i mundësoi autorit B.I të lirohej nga masa e paraburgimit. Në shenjë të lëkundjes së besimit ndaj sistemit gjyqësor, ministri i Drejtësisë Bilen Saliji dha dorëheqjen. Pas protestash të shumta, partia shqiptare në pushtet BDI premtoi grup parlamentar hetimor<sup>660</sup> për rastin. Megjithatë, për kryeprokurorin Joveski, asgjë (përfshi protestat) nuk mund ta ndryshonte vendimin për rikualifikimin e veprës.<sup>661</sup> Sipas Joveskit, pala mbrojtëse e prindit të të miturit duhet ta kishte kundërshtuar më herët lëshimin e bërë me licencën e neuropsikiatrit.<sup>662</sup> Me rikthimin e lëndës në Kumanovë, gjykata nuk mori për bazë asnjë nga momentet e reja, përfshi edhe rikthimin e makinës, që ishte provë materiale, pronarit të saj. Më 5 prill 2018, B.I u dënua me 6 vjet burg, ndërsa babai i Almirit, me 6 muaj.

\*\*\*

Në analizën e lajmeve që iu bë mediave të shkruara dhe televizive vërehet një mungesë e vazhdimësisë së ndjekjes së ngjarjeve mbi rastin e aksidentimit për vdekje të 4-vjeçarit. Raportimi mediatik, mes shumë të metash të njohura deri më tani nga rastet e mësipërme, zhvilloi një fenomen të ri, atë të “*vendosjes në heshtje*” ose në “*harresë*” të ngjarjes. Kjo ndodhte veçanërisht te mediat në gjuhën maqedonase, të cilat nuk raportnin çdo hallkë të ngjarjes, por mjaftoheshin vetëm me lajmet që kishin të bënin me momentet kyçe të ngjarjes sikurse;

- 1) vdekja 4-vjeçarit,
- 2) protestat që tërhiqnin vëmendje të madhe në publik për shkak të manifestimit të mijëra njerëzve, si dhe nga ana tjetër, vigjilencës mediatike nëse protesta përshkallëzohej dhe sillte incidente ndëretnike,
- 3) finalja e madhe – seanca e dhënies së verdiktit nga ana e gjykatës (përciptazi).

Madje, kjo moskonsistencë e mediave në ndjekjen e kalvarit të koklavitur të procesit gjyqësor, rikualifikimit të veprës, përplasjes politike me prokurorët shqiptarë, rikthimit të rastit në gjykim etj., ishte notuar edhe nga homologët-gazetarë të komunitetit tjetër, atij shqiptar. Që në fillim, eksperti i mediave Sefer Tahiri tërhiqte vërejtjen se mediat në gjuhën maqedonase kishin dështuar në raportimin për vrasjen e Almirit të mitur. Tahiri thoshte se “*redaksitë e mediave nuk mund të jenë mono-etnike, por duhet të raportojnë për “tjetrin”, ta njohin “tjetrin” dhe në*

<sup>658</sup> Kodi Penal, neni 123, paragrafi 2, pika 3 (për këtë vepër dënimi është minimalisht 10 vjet burg)

<sup>659</sup> Po aty, neni 300 paragrafi II, i lidhur me nenin 297 (për këtë vepër, dënimi është minimalisht 4 vjet burg)

<sup>660</sup> ALSAT, *BDI-ja propozon komision anketues për rastin e Almirit*, <<https://www.alsat-m.tv/bdi-ja-propozon-komision-anketues-per-rastin-e-almirit/>>, [22.1.2020]

<sup>661</sup> ALSAT, “*Almiri*”, *Joveski: Protestat nuk na ndryshojnë mendjen*, <<https://www.alsat-m.tv/almiri-jovevski-mbron-rikualifikimin-e-lendes/>>, [22.1.2020]

<sup>662</sup> Po aty, citat nga deklarata për ALSAT e Joveskit: “*Ekspertizat neuropsikiatrike ashtu përgatiten. Pyetjet që ju po i bëni ka mundur t’i bëjë mbrojtja në seanca kryesore. Me sa di unë personat që kanë bërë ekspertiza janë dëgjuar detajisht në seanca kryesore përfshi edhe pyetjet e kryqëzuara*”

*radhët e tyre duhet të kenë gazetarë të komuniteteve të tjera, në mënyrë që për diversitetet, të raportojnë gazetarët që i njohin zhvillimet specifike në një komunitet etnik apo fetar.*”<sup>663</sup>

Ndërkaq, mospjesëmarrja e mediave në gjuhën maqedonase në seancën e dhënies së vendimit nga ana e Gjykatës, bëri që të gjithë gazetarët e komunitetit shqiptar (njëri prej tyre, Furkan Saliu) të shprehnin revoltën për standardet e dyfishta që ndjekin redaksitë në gjuhën maqedonase.<sup>664</sup>

Ky *bojkot* i mediave maqedonase mbi këtë rast, shkonte ndonjëherë edhe jashtë normave profesionale. Media të mëdha, sikurse *Sloboden Peçat*, do t’i kushtonin (vetëm në formatin *portal*) disa rreshta shkrim për thirrjet për protesta të shqiptarëve më 28 shkurt të 2017, në kohën kur mbaheshin seancat gjyqësore. Madje, lajmi i tyre nuk ishte burimor i gazetës, por i cituar nga një portal lokal i quajtur “Кумановски муабети” (Muhabete kumanove), gjë që tregonte *mungesën e seriozitetit dhe interesit për raportim mbi çështjen.*<sup>665</sup>

Mediat shqiptare, nga ana tjetër, ndoqën në mënyrë tepër të detajuar çdo seancë, çdo informatë burimore si dhe çdo insinuatë që çonte në dyshime lidhur me rastin në fjalë. Madje, mund të thuhet se pikërisht mbajtja në fokus e këtij rasti, nga mediat në gjuhën shqipe, çoi jo vetëm që lënda të shkonte në Prokurorinë e Lartë për shqyrtim të veprës, por edhe atë të reagimit politik, dorëheqjen e ministrit të Drejtësisë, iniciativën për grup parlamentar hetimor mbi rastin etj. Megjithatë, ashtu sikurse treguan edhe protestat, të cilat ishin paqësore, mbetet e paqartë nëse ishte raportimi korrekt i mediave në shqip apo *amortizimi i sofistikuar* i kësaj çështjeje nga ana e mediave në gjuhën maqedonase, që situata lidhur me këtë rast të mos përshkallëzohej sikurse në rastet e mësipërme.

Titujt e mediave që shkruanin mbi rastin e vdekjes së 4-vjeçarit Almir Aliu tregojnë një formë më të sofistikuar trajtimi, më së shumti për shkak edhe të karakterit të ngjarjes.

*Nova Makedonija:* Boban Iliq do e presë në paraburgim aktvendimin e plotfuqishëm

*Telma:* Rasti “Almiri”: Prokuroria konsideron se nuk është vrasje, i padituri lirohet nga burgu, ndërsa vëllai i tij i tregon gishtin e mesëm prindërve të viktimës 4-vjeçare<sup>666</sup>

<sup>663</sup> Qendrim në Facebook, Sefer Tahiri për dështimin e medias maqedonase në raportimin për vrasjen e Almiri, <[https://www.facebook.com/search/top/?q=Sefer%20Tahiri%20vrasja%20e%20almirit&epa=SERP\\_TAB](https://www.facebook.com/search/top/?q=Sefer%20Tahiri%20vrasja%20e%20almirit&epa=SERP_TAB)>, [22.1.2020]

<sup>664</sup> Një nga ato raste, edhe qëndrimi i gazetarit Furkan Saliu në Facebook: “*Asnjë nga televizionet nacionale me program në maqedonisht nuk ishte sot në Kumanovë ku u shqiptua “dënimi” për Boban Iliqin. Padrejtësia ndaj një vogëlushi 4-vjeçar që rastësisht qëlloi të jetë shqiptar i intereson vetëm mediave shqiptare, e padrejtësia eventuale ndaj një maqedonasi do t’i interesonte vetëm mediave maqedonase... Kurse një vrasës shëtitet lirshëm nëpër rrugët e Kumanovës e nuk besoj që viktimën e radhës do ta pyes se cilit nacionalitet i përket. Çdo ditë e më shumë po e kuptoj se çka i kanë bërë mediat kësaj shoqërie... E kanë përçarë në çdo aspekt të mundshëm, e personat e njëjtë që e kanë përçarë tani po e kontrollojnë mendimin publik e po krijojnë opinion sepse i kanë avancuar në redaktorë e kryeredaktorë. Gjenerata e re e gazetarëve i nevojitet më shumë se kurrë kësaj shoqërie... Është bërë shumë dëm, nëse nuk mundemi që ta riparojmë dëmin, mos të lejojmë që ky zullum të vazhdojë!*”

<sup>665</sup> Sloboden Peçat, Судењето за убиството на малиот Алмир одложено, протестите продолжуваат (Seanca për vrasjen e të miturit Almir shtyhet, protestat vazhdojnë), Nga arkivi i lajmeve në agregatin time.mk, <<https://time.mk/c/5b43e6eee3/odlozeno-rocisteto-za-ubistvoto-na-cetirigodisniot-almir-od-kumanovo.html>>, [22.1.2020]

<sup>666</sup> Telma, Случај Алмир: Обвинителството смета дека не е убиство, обвинетиот пуштен од притвор, а неговиот брат им покажа среден прст на родninите на 4-годишна жртва (Rasti “Almiri”, Prokuroria

*Kanal5*: Vrasja e të miturit 4-vjeçar të mos shfrytëzohet si mosdurim ndëretnik<sup>667</sup>

*Sitel*: Për çfarë vepre do të përgjigjet i pandehuri për vrasjen e të miturit Almir Aliu, do të dihet nesër<sup>668</sup>

*Dnevnik*: Shfaqet vëllai i drejtuesit të automjetit që shkeli Almir Aliun në Kumanovë<sup>669</sup>

*ALSAT*: Rigjykimi i rastit “Almir Aliu”, babai: kërkojmë vetëm drejtësi<sup>670</sup>

*Tv21*: “Almiri”, Gjykata refuzon kërkesën e palës mbrojtëse, Alispahiç: Gjykata do të ndihmojë të akuzuarin

Siç shihet edhe nga titujt, mediat patën një ndërgjegjësim më të madh në momente të caktuara, të cilat reflektonin ndjenjën e *dhembshurisë* dhe atë të trajtimit të ngjarjes si *delikt*.

- 1) Në ngjarje kishim të bënim me vrasjen e një të mituri, edhe pse autori (pjesëmarrësit) tentonte ta paraqiste atë si të kundërtën, duke u *viktimizuar*. (*Kujtesë! – Statusi dhe fotografitë në Facebook të vëllait të autorit i cili thoshte se nuk kishte synuar vrasjen, por kërkonte të shpëtonte kokën për shkak të ndjekjes nga një grup shqiptarësh me thika*).<sup>671</sup> Asnjë media kombëtare nuk e publikoi këtë gjë, përveç ndonjë portali lokal të cilët ishin në numër të vogël. Shkurt e komentuan edhe Kurir dhe Dnevnik, të cilët gjithsesi, siç shihet nga titujt e tyre më sipër, veçse e kanë të qartë *veprën e shkëljes me automjet të të miturit*.
- 2) Ngritja e gishtit të mesëm nga i vëllai i të akuzuarit, apo kërcënimi i tij ndaj gazetarit të televizionit 21 reflektoi një ndjenjë *mospëlqimi në kufijtë e neverisë* (një fenomen i tillë u theksua në lajmet e thuajse të gjitha mediave në gjuhën maqedonase – një distancim total nga akti – dhe kjo mbajti më të kontrolluar rrezikun për rritje tensionesh (*Kujtesë! – Ishte pikërisht vëllai i autorit që përveç statusit në Facebook, ditë më vonë nxori të plotë edhe videon e përplasjes*).<sup>672</sup>

---

*vlerëson se nuk është vrasje, ndërsa vëllai i tij i tregon gishtin e mesëm prindërve të viktimit 4-vjeçar*), <<http://telma.com.mk/sluhuj-almir-obvinitelstvoto-smeta-deka-ne-e-ubistvo-obvinitiot-pushten-od-pritvor-i-im-pokazha-sreden-prst-na-rodninite-na-svojata-4-godishna-zhrtva/>, [23.1.2020]

<sup>667</sup> Kanal5, *Убиството на четиригодишното момче да не се користи за меѓунационална нетрпеливост (Vrasja e të miturit 4-vjeçar të mos shfrytëzohet si mosdurim ndëretnik)*, <<https://kanal5.com.mk/articles/264788/ubistvoto-na-chetirigodishnoto-momche-da-ne-se-koristi-zamegjunacionalna-netrpelivost>, [23.1.2020]

<sup>668</sup> Sitel, *За какво дело ќе одговара обвинетиот за смртта на малиот Алмир ќе се знае утре (Se për çfarë vepre penale do të përgjigjet i padituri për vrasjen e vogëlushit Almir, do të mësohet nesër)*, <<https://sitel.com.mk/za-kakvo-delo-kje-odgovara-obvinitiot-za-smrtta-na-malio-almir-kje-se-znae-utre>>, [23.1.2020]

<sup>669</sup> Nga arkivi i lajmeve në agregatin time.mk, <<https://time.mk/c/0fee44e31a/se-oglasia-bratot-na-vozacot-sto-go-pregazi-almir.html>>, [23.1.2020]

<sup>670</sup> ALSAT, *Rigjykimi i rastit “Almir Aliu”, babai: Kërkojmë vetëm drejtësi*, <<https://www.alsat-m.tv/rigjykimi-i-rastit-almir-aliu-babai-k-rkojm-vet-m-drejt-si/>>, [23.1.2020]

<sup>671</sup> Mkd.mk, *Бојан Илиќ: Тие нe нападнаа, ја искришија колата, бегажки од нив удрихме во детето, не сме психопати (Bojan Iliq: Ata na sultuan, thyen makinën – duke ia mbathur nga ata u përplasëm me fëmijën. Nuk jemi psikopatë!)*, <<https://www.mkd.mk/makedonija/politika/bojan-ilik-tie-ne-napadnaa-ja-iskrshija-kolata-begajki-od-niv-udrivme-vo>>, [23.1.2020]

<sup>672</sup> Sitel, *Братот на Бобан Илиќ ја објави целосната снимка од прегазувањето на малиот Алмир (Vëllai i Boban Iliq publikon video-regjistrimin e plotë të shkëljes me makinë të të miturit Almir)*, <<https://sitel.com.mk/bratot-na-boban-nikolik-ja-objavi-celosnata-snimka-od-pregazuvaneto-na-malio-almir>>, [23.1.2020]

- 3) Protestat nuk u përshkallëzuan asnjëherë në atë masë që të cenonin komunitetin maqedonas ose qoftë edhe një pjesëtar të vetëm të tij. Thirrjet në protesta ishin të qeta, dhe kjo u mirëkuptua nga mediat.
- 4) Çështja adresohet vis a vis ndaj sistemit të drejtësisë, dhe ndryshe nga praktikat e mëhershme me fabrikime politike siç ishte mësuar opinioni, kësaj here të gjitha palët thoshin se *nuk përzihen në drejtësi*. Protestat kishin si fokus vetëm sistemin e drejtësisë. Asnjëherë komunitetin tjetër!
- 5) Angazhimi i BDI-së për hetim të thelluar (parlamentar), u vlerësua nga opinioni publik dhe mediat. Pavarësisht se komisionet hetimore parlamentare nuk kanë rol në zgjidhjen e krizave, për protestuesit shqiptarë, kjo përbente një sinjal se partia në pushtet do të kujdesej që rasti të mos montohet, sikurse kishte ndodhur në të kaluarën ndaj shqiptarëve.

Fenomeni i ri, që u vërejt te pjesa më e madhe e mediave në gjuhën maqedonase (ai i raportimit vetëm të hallkave kryesore të ngjarjes – të numëruara më sipër), shoqërohej gjithashtu edhe me një interesim të ulët në detaje dhe në aspekte tekniko-procedurale të lëndës gjyqësore. Pa hyrë shumë thellë në këtë rast, por me një raportim pak më sipërfaqësor, mediat në gjuhën maqedonase në një farë mënyre tentonin të siguroheshin vetëm te marrëdhëniet ndëretnike, që ato të theksoheshin brenda rrezes së interesit të opinionit. Për shembull, televizioni Sitel, nga gjithë biseda e prokurores së lëndës në takim me gazetarët, nxjerr në lajm vetëm citatin e saj se *“nuk ka drejtësi selektive në bazë etnike dhe se rasti, që nga momenti që ndodhi, është punuar sipas ligjit nga ana e ekipit të prokurorëve.”* Përveç gjuhës së qetë në televizione, ton i moderuar dhe ndërgjegjësues vinte për herë të parë edhe nga analizat që bëheshin në mediat e shkruara. Binte në sy shkrimi analitik në gazetën Dnevnik i Aleksandar Manasievit, me titullin *“Vdekja e Almirit ta ngrin gjakun, pastaj ta bën atë të të vlojë”*, në të cilën, ndër të tjera theksohej se *“nuk mund të kërkohet dimension etnik ose fetar në rastin e Almirit, sepse bëhet fjalë për krim”*.<sup>673</sup>

Ndërkaq, në raportimin e ngjarjeve që mbështollën vrasjen e 4 vjeçarit Almir Aliu, nuk mund të anashkalohen shumë shkelje që bënë mediat në raportim, sidomos mediat në gjuhën shqipe. I tillë ishte rasti kur TV Shenja transmetonte në mënyrë të drejtpërdrejtë varrimin e të miturit,<sup>674</sup> kur televizioni ALSAT dha si sinkron në lajmet kryesore *fjalimin e hoxhës* i cili e quante *kriminel* autorin dhe kërkonte ndëshkim nga Zoti, ose kur portalet transmetuan *videon e përplasjes* me makinë të 4-vjeçarit, duke shkelur haptazi nenin 8 të Kodit Etik të Gazetarëve që

<sup>673</sup> Aleksandar Manasiev, Dnevnik, *Смртта на Алмир ни ја смрзна, на ни ја зове крвта (Vdekja e Almirit ta ngrin gjakun, pastaj ta bën atë të të vlojë)*, <<http://proverkanafakti.mk/zarem-smrtta-treba-da-ja-budi-sovesta-i-svesta/>>, [23.1.2020]

Paragrafi i plotë: *“Është e palogjikshme që raste të tilla, siç e kemi zakon, të marrin dimension etnik, të jenë shkak për ndarje, apo për të ndezur zjarre... mos ndoshta mllëfi i vrasësit të dyshuar do të jetë më i madh apo më i vogël, nëse theksohet se vrasësi apo viktima është maqedonas, shqiptar, serb apo turk? Nacionalizmi ndizet lehtë, duke qëndruar ulur në shtëpi dhe të shkruash statute në rrjete sociale si Facebook apo Twitter, por është e vështirë të dalësh në rrugë, dhe kjo është shumë e njohur në Maqedoni. Është e palogjikshme, jo korrekte dhe plotësisht e gabuar të mendosh që edhe media edhe gazetarët maqedonas e injoruan vdekjen e Almirit të mitur dhe se janë vënë në mbrojtje të autorit meqenëse ishte maqedonas. Kjo nuk është e vërtetë... Kjo është një vrasje klasike e të vërtetës për të cilën flet edhe fakti se askush nuk kërkoi dimension etnik ose fetar në raportimin e këtij krimi por dhe para se Almiri të vdiste, askush nuk kërkoi dimension etnik apo fetar.”*

<sup>674</sup> TV Shenja, *Varrimi i katërvjeçarit Almir Aliu në Kumanovë*, <[http://shenja.tv/video-varrimi-i-katervjecarit-almir-aliu-ne-kumanove/?fbclid=IwAR0CjBL5X6O\\_DrwyPwx5mnZFnI6hY1ZnzLN5s80MLb9K05F3cBH55cTD7pQ](http://shenja.tv/video-varrimi-i-katervjecarit-almir-aliu-ne-kumanove/?fbclid=IwAR0CjBL5X6O_DrwyPwx5mnZFnI6hY1ZnzLN5s80MLb9K05F3cBH55cTD7pQ)>, [24.1.2020]

thotë se: “Mënyra e informimit në raste të tragjedive familjare duhet të jetë pa *sensacionalizëm*.” Ndërkaq, i njëjti nen u shkel që ditën e parë të raportimit, kur mediat publikuan emrat dhe e bënë drejtpërdrejt fajtor drejtuesin e makinës. Sipas të njëjtit nen “Në proceset gjyqësore duhet të respektohet parimi i pafajësisë, të raportohet për të gjitha palët e përfshira në kontest dhe të mos sugjerohet vendimi.”<sup>675</sup>

#### 7.1.1.5 Përplasjet mes ballistëve dhe vojvodëve

4 nëntor 2018

Tifozët e klubit të futbollit “Shkëndija” të njohur me emrin *ballistët*, para pak ndeshjes me ekipin e futbollit “Shkupi” (të dielën në mesditë), dolën në rrugët e Tetovës në një marshim nga vendi i quajtur Monopoli e deri te stadiumi i tyre ku do të luanin ndeshjen me Shkupin. Në marshim, ballistët shprehën zemërimin e tyre ndaj grupit të tifozëve *vojvodët* të ekipit të Teteksit, të cilët gjatë festës me rastin e 30-vjetorit të themelimit të tyre, përveç këngëve dhe thirrjeve në mbështetje të ekipit, hodhën parulla dhe ofendime mbi baza etnike për shqiptarët. Më 2 nëntor, *vojvodët* ishin grumbulluar në një nga restorantet në qendër të Tetovës dhe festonin me fishekzjarrë e këngë, por një grup i tyre këndoi edhe thirrje ofenduese në bazë etnike ndaj komunitetit shqiptar. Në rrugën “Boris Kidriç” u sulmua një 15 vjeçar, u dëmtua një dyqan dhe një makinë. Ndërsa pas mesnate, në rrugën JNA (Jugosllovenska Narodna Armija), policia kishte ndërhyrë në rrahjen mes dy grupeve, njëri përbëhej nga *vojvodë* dhe tjetri nga *ballistë*. Por, nga përlëshja, e kishte pësuar me lëndime një punonjës i forcave të rendit. Megjithatë, pavarësisht ndalimit të disa pjesëtarëve të grupit të tifozëve *vojvodë*, të gjithë u liruan një ditë më vonë.

Pas dy ditësh, ishin ballistët ata që dolën në marshim për të bërë të njëjtën vepër, brohoritjen e thirrjeve nacionaliste “*për t’i treguar vojvodëve*”, - siç thotë kreu i grupit të ballistëve Isak Luma – “*se Tetova është e shqiptarëve dhe vetëm ata janë zot të trojeve shqiptare*”.

Gjuha e urrejtjes e shprehur në tubimet e tifozëve të të dy grupeve zuri vend në publikimet ditore të mediave. Por, ngjarja tregoi një diferencim të madh në trajtimin e ngjarjes.

*Sitel*: Gjuhë urrejtjeje te tifozët nga Tetova - policia ende pa denoncime<sup>676</sup>

*Kurir*: Grupi i tifozëve “ballistët”, me shishe dhe gurë sulmojnë kafanat plot me mysafirë<sup>677</sup>

*Kanal5*: Tifozët e “Shkëndijës”, me brohoritje fyese në bazë etnike<sup>678</sup>

<sup>675</sup> Portalb, *Rasti i Almiri, Këshilli i etikës vërejtje mediave: Mos bëni sensacion!*, <[https://portalb.mk/293361-rasti-i-almirit-keshilli-i-etikes-verejtje-mediave-mos-beni-sensacion/?utm\\_campaign=shareaholic&utm\\_medium=facebook&utm\\_source=socialnetwork&fbclid=IwAR1\\_k06KmvJxdrCOpDBp88BtaCC\\_41MKMuveksbQILyMyt5JP3hlyKNQOE](https://portalb.mk/293361-rasti-i-almirit-keshilli-i-etikes-verejtje-mediave-mos-beni-sensacion/)>, [24.1.2020]

<sup>676</sup> *Sitel*, *Говор на омраза кај навивачите од Тетово - полицијата се уште без пријави (Gjuhë urrejtjeje te tifozët nga Tetova – policia ende pa denoncime)*, <<https://sitel.com.mk/govor-na-omraza-kaj-navivachite-od-tetovo-policijata-se-ushte-bez-prijavi>>, [24.1.2020]

<sup>677</sup> *Kurir*, *ВИДЕО: Навивачката група „Балисти“ со шисhinja и камења фрлаа кон кафуле полно со гости (VIDEO: Grupi i tifozëve “ballistët”, me shishe dhe gurë sulmojnë kafanat plot me mysafirë)*, <[https://kurir.mk/makedonija/hronika/video-navivachkata-grupa-balisti-so-shishinja-i-kamenja-frlaa-kon-kafule-polno-so-gosti](https://kurir.mk/makedonija/hronika/video-navivachkata-grupa-balisti-so-shishinja-i-kamenja-frlaa-kon-kafule-polno-so-gosti/)>, [24.1.2020]

<sup>678</sup> *Kanal5*, *Навивачите на „Шкендија“ со навредливи скандирања на етничка основа (Tifozët e “Shkëndijës”, me brohoritje fyese në bazë etnike)*, <<https://kanal5.com.mk/navivachite-na-shkendija-so-navredlivi-skandiranja-na-etnichka-osnova/a354451>>, [24.1.2020]

*Alfa*: Mesazhe nacionaliste, përhapje të gjuhës së urrejtjes, dëmtohen kafana nga ana e “ballistëve”, denoncime nga MPB-ja nuk ka ende<sup>679</sup>

*ALSAT*: Spasovski: Merren masa kundër të përfshirëve në incidentin e mbrëmshëm në Tetovë<sup>680</sup>

*Veçer*: Komiteti i Helsinkit iu zemërua “ballistëve”, kërkon dënime për gjuhën e urrejtjes<sup>681</sup>

*Vesnik*: “Ballistët” e promovuan më së shumti “bashkëjetesën”<sup>682</sup>

*Tv Koha*: Ballistët: Shqiptarët janë zot shtëpie në Tetovë<sup>683</sup>

Siç vërehet edhe nga titujt, thuajse të gjitha mediat përdorin tituj “sensacionalë” lidhur me ngjarjet. Veçer, Vesnik dhe Kurir tentojnë që përmes stilizimeve letrare të tërheqin më shumë vëmendje, duke i shtuar dozat ngjyruese në raportim. Bien në sy epitetet “*sulmohen kafanat plot me njerëz*”, që të lë përshtypjen në mënyrë të njëanshme se vetëm grupi i tifozëve shqiptarë bën vepra të tilla; Veçeri bën një titull stilizues me tone që nënkupton se më në fund *Komiteti i Helsinkit u aktivizua për diçka*, apo titulli ironizues i Vesnik se *ballistët dinë si ta promovojnë më së miri bashkëjetesën, dhe prej tyre duhet të merret shembull*.

Më korrekt me titujt paraqitet ALSAT, por te kjo media është dalluar mosraportimi konsistent i ngjarjes. ALSAT ka preferuar të *heshtë* për ngjarjen, duke u mjaftuar me një lajm klasik, vetëm në datën 5 nëntor, me disa rreshta në lajmet qendrore dhe me një deklaratë nga ministri i Brendshëm Spasovski. Në tekstin e ALSAT me titull “*Përplasjet mes tifozëve, Spasovski apelon për qetësi*”, theksohet qasja tepër e ftohtë ndaj ngjarjeve, madje në mënyrë kronologjike, së pari sillen incidentet e *vojvodëve* dhe pastaj përmenden *ballistët*. Fillimisht tregohet se “*rikthehen provokimet dhe ofendimet në terrenet sportive. Pasi tifozët maqedonas “vojvodët” ofenduan shqiptarët, tifozët “ballistët” shprehën indinjatën*”.<sup>684</sup> Ky tekst klasik nuk

<sup>679</sup> ALFA, *Националистички пораки, ширање говор на омраза, оштетено кафеуле од страна на „Балистите“, пријави од МРБ се уште нема (Mesazhe nacionaliste, përhapje të gjuhës së urrejtjes, dëmtohen kafana nga ana e “ballistëve”, denoncime nga MPB-ja nuk ka ende)*, <[<sup>680</sup> ALSAT, \*Спасовски: Се преземаат мерки против инволвираните во вчерашниот инцидент во Тетово, \(Spasovski: Merren masa kundër të përfshirëve në incidentin e mbrëmshëm në Tetovë\)\*, <\[<sup>681</sup> Veçer, \\*Хелсиники комитет се налуту на „Балисти“, бара казни за говорот на омраза, \\(Komiteti i Helsinkit iu zemërua “ballistëve”, kërkon dënime për gjuhën e urrejtjes\\)\\*, <<https://vecer.mk/makedonija/helsinshki-komitet-se-naluti-na-balisti-bara-kazni-za-govorot-na-omraza>>, \\[24.1.2020\\]\]\(https://www.alsat-m.tv/mk/%d1%81%d0%bf%d0%b0%d1%81%d0%be%d0%b2%d1%81%d0%ba%d0%b8-%d1%81%d0%b5-%d0%bf%d1%80%d0%b5%d0%b7%d0%b5%d0%bc%d0%b0%d0%b0%d1%82-%d0%bc%d0%b5%d1%80%d0%ba%d0%b8-%d0%bf%d1%80%d0%be%d1%82%d0%b8%d0%b2-%d0%b8/></a>, \[24.1.2020\]</p>
</div>
<div data-bbox=\)](https://alfa.mk/%d0%bd%d0%b0%d1%86%d0%b8%d0%be%d0%bd%d0%b0%d0%bb%d0%b8%d1%81%d1%82%d0%b8%d1%87%d0%ba%d0%b8-%d0%bf%d0%be%d1%80%d0%b0%d0%ba%d0%b8-%d1%88%d0%b8%d1%80%d0%b0%d1%9a%d0%b5-%d0%b3%d0%be%d0%b2%d0%be%d1%80/></a>, [24.1.2020]</p>
</div>
<div data-bbox=)

<sup>682</sup> Vesnik, *„Балистите“ го пуштјува “соживотот” во Тетово на најјакото, (“Ballistët” e promovuan më së miri “bashkëjetesën”)*, <<https://vesnik.com/sport/balistite-go-pushtija-sozhivotot-vo-tetovo-na-najjako-video>>, [24.1.2020]

<sup>683</sup> Tv Koha, *Ballistët: Shqiptarët janë zot shtëpie në Tetovë*, <[https://www.youtube.com/watch?v=Gu\\_oFDan\\_A&feature=youtu.be&fbclid=IwAR0mAqitiGz1ewcbLLQWuJKBj7KGFjkJIDet6E25fjIDWNIWzf\\_1WmD5u3I](https://www.youtube.com/watch?v=Gu_oFDan_A&feature=youtu.be&fbclid=IwAR0mAqitiGz1ewcbLLQWuJKBj7KGFjkJIDet6E25fjIDWNIWzf_1WmD5u3I)>, [24.1.2020]

<sup>684</sup> ALSAT, (mbulim tifozët), Titulli: *Përplasjet mes tifozëve, Spasovski apelon për qetësi*, shkëputur nga lajmet e datës 5.11.2018 (Arkiv), “*Sërish janë kthyer në qendër të vëmendjes provokimet dhe ofendimet e tifo grupeve maqedonasve ndaj shqiptarëve dhe anasjelltas, jashtë dhe në terrenet sportive. Tifozët maqedonas të skuadrës tetovare Teteks, “Vojvodët”, të cilët festonin 30-vjetorin e themelimit të tyre gjatë festës së tyre por edhe rrugës për në stadium kanë ofenduar shqiptarët. Ndryshe nga ata, grupi i tifozëve “Ballistët”, para ndeshjes së të dielës me Shkupin, me një marsh rrugëve të Tetovës ka shprehur indinjatë dhe protestë kundër thirrjeve antishqiptare. Po*

tregon të plotë realitetin, as për detajet se çfarë është dëmtuar, por nënkupton se *ballistët i kanë kthyer haraçin vojvodëve*. Gjithsesi, si narrativ, lajmi është konform standardit gazetaresk; pa nxitje, pa thirrje, pa patos, respekton të dyja palët, dhe madje përfshin edhe qëndrimin e autoriteteve të rendit që hetojnë ngjarjen. Megjithatë, vërehet që ALSAT i ka kushtuar shumë pak kohë dhe vëmendje kësaj ngjarje, pa e ndjekur atë, pa kërkuar llogari lidhur me arrestimet, paditë, gjuhën e urrejtjes, punën e institucioneve për ta dënuar atë, e kështu me radhë.

Rasti më i qartë dhe që i shkel të gjitha standardet gazetareske është ai i televizionit Koha në Tetovë. Në kronikën e datës 3 nëntor, teksti fillon me narrativ realist mbi ngjarjen, duke renditur faktet dhe duke iu referuar edhe të dhënave nga Sektori për Punë të Brendshme i Tetovës. Por, balanca e kronikës prishet afër mesit të kronikës, me paraqitjen vetëm të një sinkroni, atë të kreut të grupit të ballistëve, i cili pranon se “*grupi që u përlesh mbrëmë me vojvodët përbëhej nga ballistë të cilët kanë mbrojtur nderin e kombit*” dhe nga ana tjetër, lejohet viktimizimi i tij, kur thotë se “*ngjarja duhet të zbardhet se faji në fund, mund t’i hidhet shqiptarëve*.”<sup>685</sup> Ndërsa në kronikën e radhës, përsëri në mënyrë të njëanshme, vetëm me një sinkron, gazetari thekson me patos dhe në mënyrë afirmative dhe pajtuese se “*në marshimin e tyre, edhe ballistët kanë brohoritur njësoj, me thirrje nacionaliste, për t’ua bërë mirë me dije vojvodëve se vetëm shqiptarët janë zot shtëpie në trojet e tyre shekullore dhe autoktone*”. Toni glorifikues dhe nxitës shkon më tej kur gazetari thekson se “*me këtë rast, grupi i tifozëve “ballistët” edhe një herë dëshmoi se është gjithmonë i gatshëm të sakrifikojë çdo gjë nga vetja për të mbrojtur nderin kombëtar shqiptar, dhe se kurrë nuk do të lejojë që shqiptarët të fyhen, dhe që të nëpërkëmbet nderi dhe flamuri kombëtar, sidomos në shtëpitë e tyre (Tetovë)*”. Në kronikë jepet vetëm një sinkron, pa qëndrim të palës tjetër, dhe aq më pak, qëndrim i policisë për mbarëvajtjen e protestës.<sup>686</sup>

Duke marrë në konsideratë pamjet dhe ngjatjet që pasqyrojnë media në gjuhën maqedonase për protestat, për shishet, dëmtimin e kafanave etj., Tv Koha i kishte fshehur të gjitha këto detaje.

Një element tjetër i rëndësishëm është edhe fshehja, nga ana e mediave maqedonase, e detajeve të incidenteve që shkaktuan “vojvodët” dy ditë më herët gjatë festës së tyre të themelimit të grupit të tifozëve. Mediat në gjuhën maqedonase nuk kërkuar asnjëherë llogari për atë pjesë të ngjarjes, madje asnjëra prej tyre nuk kishte lajm gjatë ditës së festimeve kur ndodhi rrahja e një 15-vjeçari, dhe as përplasja mes grupeve në natën e 2 nëntorit. Kjo formë e heshtjes së detajeve të tilla, dhe nga ana tjetër, e ngritjes së zërit kur thirrjet ofenduese vijnë nga tifozët shqiptarë, është gjithashtu një formë e raportimit të dyzuar që zhvillohet në kohë dhe në rrethana të caktuara ngjarjesh, në varësi të llojit të ngjarjes dhe të rrezikut që ajo paraqet ndaj marrëdhënieve ndëretnike në vend.

Mund të thuhet se sa më pak të jetë e përfshirë politika në ngjarje të caktuara, aq më pak e tendosur bëhet klima e trajtimit të këtyre ngjarjeve nga ana e mediave. Rastet gjatë periudhës së VMRO DPMNE-së në pushtet nxiteshin shpeshherë nga ajo vetë. *Ashtu sikurse ndodhnin*

---

*ashtu, raportohet nga SPB se edhe ky grup ka prishur rendin publik. Sot në rrjetet sociale ka reaguuar numri një i policisë së vendit Spasovski. “Në kuadër të SPB-së Tetovë, janë duke u ndërmarrë masat për njërin apo grupin tjetër, të cilët kanë brohoritur mesazhe nacionaliste. Nuk guxojmë të lejojmë që konfliktet e tyre të cilat janë përplot me urrejtje të bëhen përditshmëri në Maqedoni.” [25.1.2020]*

<sup>685</sup> Tv Koha, *Festa e vojvodëve shndërrohet në zënkë mes grupeve*, <<https://www.youtube.com/watch?v=bbnxT9Qh1Eg>>, [25.1.2020]

<sup>686</sup> Tv Koha, *Ballistët: Shqiptarët janë zot shtëpie në Tetovë*, <[https://www.youtube.com/watch?v=Gu\\_oFDan\\_A&feature=youtu.be&fbclid=IwAR0mAqitiGz1ewcbLLQWuJKBj7KGFjkJIDet6E25fjIDWNIWzf\\_1WmD5u3I](https://www.youtube.com/watch?v=Gu_oFDan_A&feature=youtu.be&fbclid=IwAR0mAqitiGz1ewcbLLQWuJKBj7KGFjkJIDet6E25fjIDWNIWzf_1WmD5u3I)>, [25.1.2020]



*kacafytjet mes partnerëve të koalicionit, ashtu kacafytej edhe media.* Nëse marrim në konsideratë çështjet ndëretnike dhe ndërftare gjatë viteve të fundit, mund të vërehet një çlirim më i madh i mediave nga ndikimi politik, si dhe për një hapje më tolerante ndaj ngjarjeve. Po ashtu, në këtë zbutje ka ndikuar edhe dominimi i ngjarjeve të mëdha. Viteve të fundit, ngjarjet sikurse Marrëveshja e Prespës, ajo me Bullgarinë, Referendumi, zgjedhjet lokale, presidenciale, anëtarësimi në NATO, pritshmëritë për në BE etj., minimizuan fokusimin e mediave ndaj temave që prekin vis a vis marrëdhëniet ndëretnike. Mediat u përqendruan më shumë te prioritetet madhore të shtetit, dhe jo te ngjarjet social-ekonomike dhe ato kulturore të etnive.

#### 7.1.1.6 Forma të tjera të raportimit të dyzuar

Ashtu sikurse u përmend më sipër, raportimi i dyzuar nuk nënkupton vetëm *dyzimin e ngjarjes...* Ai përfshin edhe rastet kur për një ngjarje të caktuar, media *hesht plotësisht.*

Raste të *vendosjes në heshtje* të një ngjarjeje të caktuar, gjen shumë dhe shpesh - thuajse çdo ditë në mediat e vendit. Ato variojnë së pari, për shkak të *ndikimit ose lidhjes politike* të një mediaje me një strukturë të caktuar politike. Prandaj edhe në vendin tonë ka media “opozitare” dhe media “pushtetare”, ose media të cilat kanë figura “të preferuara” politike që i lënë jashtë trajtimit apo figura “antipatike” politike të cilët i ndjekin më shpesh.

Për shembull, në qarqet gazetareske deri më sot është përdorur konstatimi se shërbimi publik (TVM) ka qenë gjithnjë me pushtetin, pavarësisht se pushteti është ndërruar. Këtë e ka konstatuar edhe Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale në raporte të ndryshme apo edhe Institute të Medias. Një gjë e tillë bie ndesh me misionin e medias, raportimin objektiv dhe të barabartë. Edhe në mediat private, gazeta apo televizione, ekzistojnë afinitete me struktura të caktuara politike, por ka edhe media të cilat dikur nga “pushtetare”, pas kalimit në opozitë të VMRO DPMNE-së, u kthyen menjëherë në mbështetje të LSDM-së, kur kjo e fundit erdhi në pushtet.

Ndërkaq, dyzim ka edhe për shkak të ndikimit biznesor ose afinitetit me kompani ose korporata të caktuara, sikurse korporata të energjisë elektrike, kompani medikamentesh e deri edhe spitale private. Pavarësisht ngjarjeve të caktuara, si për shembull, protesta kundër faturave të larta të energjisë, medikamenteve të skaduara, apo raste denoncimesh ndaj spitaleve private për vdekje të pacientëve, mediat janë përpjekur t'i heshtin këto ngjarje vetëm për shkak të buxhetit të reklamave apo fushatave promovuese që këto kompani u ofrojnë.

Paralelisht, ekziston edhe një fenomen tjetër, ai i anashkalimit të çështjeve sociale apo të të drejtave themelore të grupeve të caktuara. Mediat, në fund të fundit, ndajnë një treg kaotik, me numër të pabarabartë dhe jo përpjesëtimor për sa i përket komuniteteve etnike në vend. Por, sikur të mos mjaftojnë këto parregullsi të tregut, në sferën e medias ekziston edhe fenomeni i “positive blackout” – i heshtjes së plotë ndaj fenomeneve të caktuara – pavarësisht se ato nuk prekin doemos marrëdhëniet ose pozitativat e komunitetit maqedonas. Si rast konkret mund të përmendet ai i televizionit ALSAT, në trajtimin e fenomeneve të caktuara që lidhen ngushtësisht me zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit, të drejtën e përdorimit të gjuhës, të arsimimit cilësor, të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat në institucione.... të gjitha këto tema nuk kanë qenë asnjëherë në fokusin e trajtimit nga ana e mediave në gjuhën maqedonase. Rasti i mungesës së paraleleve në gjuhën shqipe nëpër shkolla të caktuara, ose rasti i mungesës së shkollës në gjuhën shqipe në lagjen “Bardhi” në Bllacë që i detyron fëmijët shqiptarë të kalojnë kufirin në të zezë dhe të mësojnë në Kosovë, kurrë nuk ka qenë në agjendën e lajmeve të mediave maqedonase, edhe pse këta fëmijë e kalojnë kufirin pa dokumente identifikuese, pa prindër etj. Po ashtu, ka tema në komunitetin

maqedonas që edhe mediat në gjuhën shqipe në përgjithësi, nuk i vendosin në agjendën ditore të lajmeve. Ky pozicionim ndarës i mediave, në kushtet kur ndërgjegjësimi për raportim të baraspeshuar është i vakët, lë për të dëshiruar akoma më shumë në trajtimin e çështjeve apo problemeve me të cilat përballen komunitetet më të vogla ose edhe grupet e marginalizuara. Çfarë mund të thuhet për rastin se mijëra pjesëtarë të komunitetit romë, nuk ekzistojnë në asnjë regjistër shtetëror – a duhet të krijojnë media të tyre në mënyrë që zëri i tyre të dëgjohet?

Për këtë, do të mjaftonte diversiteti nëpër redaksi si dhe një ndërgjegjësim më i madh i qarqeve gazetareske për ta parë individin si qenie të barabartë, dhe jo si “tjetër” në bazë të etnisë, fesë, kulturës apo tipareve të tjera dalluese që mund të ketë.

### 7.1.2 Intervista me drejtues institucionesh dhe ekspertë të medias – gjetjet.

Historia e raportimit të dyzuar mediatic, veçanërisht ajo e viteve të fundit, tregon më së miri se çfarë roli të fuqishëm ka media. Në karakterin multi-etnik, multi-fetar dhe multi-kulturor të Maqedonisë së Veriut, si dhe duke qenë shpeshherë instrument i partive politike apo krizave ndërqeveritare, mediat kanë mundur të nxitin lehtësisht edhe konflikte.

Para konfliktit të vitit 2001, është veçse e vërtetuar tashmë që gazetarët nuk raportojnë si profesionistë (duhet të theksohet se në këtë kohë nuk kishte as profesionalizëm dhe as Kod Etik dhe parime që duhet t’i përmbaheshin), por thjesht niseshin nga pozicioni etnik i tyre, si maqedonas ose si shqiptar. Element i rëndësishëm për t’u notuar është edhe fakti se ndikimi i politikës te ata ishte i madh, dhe si në mbarë ish-Jugosllavinë, edhe në Maqedoni ishin forcat nacionaliste ato që erdhën në pushtet, duke ndjekur një gjuhë të ashpër ndarëse në baza etnike e fetare.<sup>687</sup> Me krijimin e paragjykimëve dhe stereotipave nga gazetarët e kohës, të cilat vis a vis përcillnin frymën që diktohej nga politika, përfitohej një bindje se shqiptarët ishin të zotë vetëm për krime, ndërsa nga ana tjetër, (edhe mediat shqiptare bënë të njëjtën gjë) maqedonasit përgjithësoheshin mes soj-soj epitetesh, “*sllavo-maqedonas*” etj.<sup>688</sup>

Gazetari Nenad Sllatina, teksa përshkruante konfliktin e vitit 2001 në fokusin e mediave, në shkrimin e tij “Lufta në Maqedoni ishte një Bosnia-Lite) ngeci në dy mendimet, nëse lufta ishte nxitur nga media, apo “*së pari hidhet një ide e çmendur nga një mendje kriminale, pastaj bashkëngjitet media*”.<sup>689</sup>

Është e vërtetë se raportimi i dyzuar kishte ekzistuar që me lindjen e medias në Maqedoninë e Veriut. Në periudhën komuniste raportohej me qëllim promovimin e kauzës së konceptit të *bashkim-vëllazërimit* dhe jo për të drejtat e komuniteteve; dyzimi në këtë periudhë bëhej vetëm për shkak të propagandës së sistemit, në mënyrë që ai sistem të qëndronte fuqishëm në këmbë. Nuk raportohej për tjetrin, pasi vetë jeta varej nga prerogativat e socializmit, sistem ky

<sup>687</sup> Në Kroaci fitoi e ashtuquajtura HDZ (Hrvatska demokratska zajednica – Unioni demokratik kroat) e Franjo Tuxhmanit, parti konstervatore dhe e qendrës së djathtë, në Serbi fitoi Partia Socialiste e Slllobodan Millosheviqit – parti politike e krahut të majtë dhe pasardhëse e Lidhjes Komuniste Serbe, Në Bosnjë fituan Partia e Aksionit Demokratik të Alija Izetbegoviç dhe Partia Demokratike Serbe e Radovan Karaxhiqit. Në Maqedoni, në pushtet erdhi LSDM-ja (me ngjarje trishtuese në vitet 1996-97), ndërsa më vonë VMRO DPMNE (kur ndodhi konflikti i vitit 2001).

<sup>688</sup> Instituti i Studimeve të Komunikimit dhe Shkolla e Lartë për Gazetari, *Diversitetet nën prizmin e redaksive – Vështrim nga afër mbi krijimin e lajmeve*, faqja 46, <<http://www.unescochair-vs.edu.mk/attach/Pogled-odblizu-vo-sozdavanjeto-vesti.pdf>>, [28.1.2020]

<sup>689</sup> Senad Sllatina, *Lufta në Maqedoni ishte Bosnia-Lite: Një qasje profesionale - Maqedonia; konflikti dhe mediat*, Instituti Maqedonas për Media, Shkup 2003, faqja 31

që tentonte zhveshjen nga dallimet fetare, kulturore dhe etnike, por vetëm ndërtimin e *qytetarit socialist*. Në periudhën e para konfliktit të vitit 2001 raportohej sërish në ruajtje të superioritetit të komunitetit më të madh që kishte pushtetin. Ndarja e Jugosllavisë dhe trashëgimia e pushtetit të shumica (nacionaliste) nuk linte hapësirë as për përfaqësim të shqiptarëve në institucione e jo më, për të drejta bazë apo natyrore të tyre. Pas konfliktit, mes komuniteteve vazhdoi një luftë e ftohtë. Edhe pse klasa politike kishte gjithnjë parasysh që të mos provokonte më konflikt, duke iu përmbajtur parimeve kryesore të Marrëveshjes së Ohrit,<sup>690</sup> sërish mosbesimi mes komuniteteve dhe tensionet ishin vendosur thjesht nën rrogoz. Në periudhën e ashpërsimeve politike, problemet ndëretnike zgjoheshin...

Raportimi i dyzuar (paraqitja e dy realiteteve të ndryshme për të njëjtin fenomen), raportimi jo-objektiv (pasqyrimi i një realiteti të rrejshëm dhe larg të vërtetës), nxitja e një komuniteti dhe nënçmimi i një komuniteti tjetër, heshtja e fakteve apo devijimi i qëllimshëm i tyre, raportimi jashtë standardeve të gazetarisë dhe shkelja e vetë misionit të gazetarit (sikurse i sollëm me rastet e shtjelluara imtësisht më sipër, që nga viti 2010 e këndej), tregojnë sërish se media ka ende një fuqi të madhe në ndarjen e njerëzve dhe popujve, në “*ne*” dhe “*ata*”. Kjo ndarje, sado e vogël, është përsëri aty, edhe sot e kësaj dite – si “*buka e thyer*”! Më së shumti, thyerjen e ndesh gjatë periudhave të krizave ndërqeveritare mes partnerëve në koalicion, strukturave qeveritare<sup>691</sup> apo në relacionin pushtet-opozitë, ose gjatë periudhave zgjedhore kur sërish partitë matin pulsën dhe muskujt në rrafshin etnik (për numër më të madh deputetësh – për të treguar superioritetin e njërit komunitet ndaj tjetrit).

Me këtë sjellje, mediat e vendit kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë shkelje të nenit 10 të Konventës Evropiane (të përmendura shprehimisht në kapitullin IV) lidhur me *lirinë e shprehjes së individit, kufizimin e saj në mbrojtje të dinjitetit dhe të drejtave të tjetrit* si dhe neni 14 lidhur me *gëzimin e të drejtave dhe lirive të njohura nga kjo Konventë, pa bërë dallime mbi prejardhjen kombëtare ose shoqërore, përkatësinë ndaj një pakice kombëtare, mendimet politike etj.*<sup>692</sup> Këto të drejta janë mision rregullues edhe i Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale, e cila e bazon veprimtarinë në ligjin themelues të saj, që thekson në nenin 61 parimet se “*radiodifuzerët duhet të nxitin frymën e tolerancës, respektimin e ndërsjellë dhe mirëkuptimin ndërmjet individëve me prejardhje të ndryshme etnike dhe kulturore - transparencën e programeve për shprehjen e kulturave të ndryshme që janë pjesë përbërëse e shoqërisë*”.<sup>693</sup> Edhe neni 10 dhe 11 i Kodit Etik të gazetarëve janë shkelur gjithashtu, të cilët theksojnë se gazetari nuk duhet të krijojë ose përpunojë me vetëdije informata që cenojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, nuk duhet të përdorë gjuhën e urrejtjes dhe nuk duhet të nxisë dhunë ose diskriminim mbi çfarëdo lloj baze qoftë (kombëtare, fetare, racore, gjinore, shoqërore, gjuhësore, politike, orientimi seksual...) si

<sup>690</sup> Sikurse përmendëm edhe në Kapitullin II, ky dokument u dha garancinë maqedonasve për mosndarjen e shtetit (pra, ruajtjen e karakterit unitar të shtetit) si dhe garancinë se qëllimet politike të shqiptarëve nuk do të synoheshin asnjëherë më përmes dhunës (parimi numër 1 dhe 2 i marrëveshjes).

SIOFA, *Marrëveshja Kornizë e Ohrit*, <[http://www.siofa.gov.mk/data/file/Ramkoven\\_dogovor\\_al.pdf](http://www.siofa.gov.mk/data/file/Ramkoven_dogovor_al.pdf)>, [25.1.2020]

<sup>691</sup> Instituti i Studimeve të Komunikimit dhe Shkolla e Lartë për Gazetari, *Diversitetet nën prizmin e redaksive – Vështrim nga afër mbi krijimin e lajmeve*, faqja 47, <<http://www.unescochair-vs.edu.mk/attach/Pogled-odbliku-vo-sozdavanjeto-vesti.pdf>>, [28.1.2020]

<sup>692</sup> Zejnulla Gruda, *Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Libri I-III, Botimi IV*, Universiteti FAMA, Prishtinë 2017, faqja 371

<sup>693</sup> Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë, *Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale*, neni 61, <[http://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/legislation/26.12.2013.pdf](http://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/legislation/26.12.2013.pdf)>, [28.1.2020]

dhe, gazetari duhet t'u përmbahet standardeve të pranuar shoqërore që kanë të bëjnë me mirësjelljen dhe respektimin e dallimeve etnike, kulturore dhe fetare në Maqedoni....

Raportimi i dyzuar (me standarde të dyfishta) si dhe mungesa e një raportimi inkluziv të diversiteteve konfirmohet edhe nga vetë drejtuesit e institucioneve rregulluese, vetërregulluese si dhe nga ekspertët e fushës së mediave, të cilët u intervistuan për qëllim të këtij studimi. Ata pranojnë se *dyzimi* ka një zbehje vitet e fundit, por për aq kohë sa nuk raportohet për tjetrin, (që tjetri të jetë i pranishëm në jetën tonë dhe të njihemi me të panjohurat e tij) ose për aq kohë sa nuk e vendosim veten në pozitën e tjetrit (pra, “unë” jam “tjetri” dhe kjo ndarje rolesh të zhduket) atëherë *dyzimi* i çdo fenomeni që ka të bëjë me tjetrin, jo vetëm që do të ndodhë, por edhe do të keqkuptohet. Njeriu, në parim, i trembet të panjohurës, dhe në këtë relacion, kur e panjohura tjetërsohet nga media, atëherë ajo konsiderohet shpeshherë edhe si rrezik nga tjetri.

### 7.1.2.1 Raportimi i dyzuar dhe raportimi për tjetrin!

Sa e njohin mediat në Maqedoni konceptin e raportimit të dyzuar (me standarde të dyfishta) si dhe raportimin (përfshirës) për tjetrin? Sa i pranueshëm dhe i zbatueshëm ka qenë ai në periudhën e komunizmit dhe atë të pluralizmit demokratik?

Shumica e gazetarëve dhe shefat e tyre nëpër redaksi (pra mediat në përgjithësi) i njohin standardet. Ndoshta jo në mënyrë thelbësore, por përvojat e tyre në periudhën e demokracisë pluraliste, ngjarjet e rënda që e kanë shoqëruar jetën politike dhe sociale të vendit, forcimi i vetëdijes së medias, hapja më transparente e politikës gjatë viteve të fundit si dhe ulja deri diku e kontrollit politik ndaj saj, kanë bërë që edhe vetëdija e pronarëve të medias, e shefave të redaksive si dhe ajo e vetë gazetarëve, të rritet. Për pasojë, në vitet 2018-2020 ndihet një përmirësim i lehtë i klimës raportuese në media (sikurse notohet edhe nga organizmat vendorë e ndërkombëtarë mbi lirinë e medias); konkretisht, nuk kemi raste klasike të *raportimit të dyzuar që reflekton dy realitete të ndryshme për të njëjtin fenomen*, ndërkohë që mund të theksohet se *raportimi për tjetrin*, ende nuk është në nivelin e pritshëm... përkundrazi, është lënë në harresë për shkak edhe të agjendës politike që ndjekin mediat, si dhe anashkalimit të ngjarjeve shoqërore dhe fenomeneve që na shqetësojnë bashkërisht.

Studiuesja e raportimit të diversiteteve Snezhana Tërpevska ka një qëndrim më kategorik lidhur me termin “*raportim i dyzuar*”.<sup>694</sup> Ajo nuk e mohon këtë fenomen por thekson se “standardet profesionale të gazetarisë janë *një, dhe të vetme*”. “Nuk mund të ketë standarde të dyfishta në raportim” – thotë Tërpevska. “Por, ky fenomen ekziston, për fat të keq, prej një kohe të gjatë” – thekson Marina Tuneva nga Këshilli i Etikës,<sup>695</sup> ndërkohë që Sefer Tahiri<sup>696</sup> vazhdon duke theksuar se “fenomeni i *realiteteve të dyzuara* i ka rrënjët te vetë politika e cila bazohet te etnocentrizmi, ndërsa vetë media pastaj (e cila e njeh shumë pak konceptin e raportimit të drejtë për tjetrin) ndjek nga pas diskursin politik dhe prodhon realitete mediatike që janë në shpërputhje me realitetin objektiv”. Me këtë, Tahiri na rikujton tre botëkuptimet e veçanta të raportimit;

<sup>694</sup> Intervistë me Snezhana Tërpevskën, eksperte në fushën e medias, kornizës ligjore dhe politikave mediatike, profesore dhe studiuese e raportimit të diversiteteve.

<sup>695</sup> Intervistë me Marina Tunevën, drejtore ekzekutive e Këshillit të Etikës në Media, profesore dhe eksperte në fushën e medias mbi multikulturalizmin.

<sup>696</sup> Intervistë me Sefer Tahirin, anëtar i Komisionit të Ankesave në Këshillin e Etikës në Media, profesor i komunikimit, ekspert në fushën e raportit të medias dhe politikës.

raportimin e dyzuar,<sup>697</sup> raportimin për tjetrin<sup>698</sup> dhe raportimin objektiv<sup>699</sup> (shih poshtëshënimet e autorit).

“Pyetja është, përse nuk e shfrytëzojnë mediat parimin për palën e dytë në çdo shkrim që bëjnë” – thekson Zhaneta Trajkoska e Shkollës së Lartë të Gazetarisë.<sup>700</sup> Me këtë pyetje ajo na sqaron se mediat në vend kanë ende probleme me *raportimin objektiv*, e jo më me raportimin përfshirës për tjetrin.

Dejan Georgievski,<sup>701</sup> duke na dhënë një kronologji të raportimit që nga koha e pavarësisë, thekson se ishte *faji* i nacionalistëve, që lirinë e shprehjes që *e siguruam* për herë të parë si shtete të pavarura, ta keqpërdornin deri aty sa të *prishnin* edhe vetë shtetin. “Nacionalizmi ishte motivim i madh në vetë të drejtën e vetëvendosjes, duke shkaktuar ndarjen në “ne” dhe “ata” në aspektin etnik”. “Nëse e sheh sjelljen e partive politike qoftë brenda një kampi (p.sh. maqedonas), edhe përkatësia politike në shoqërinë tonë konsiderohet si një lloj i “një tjetri” – shton Georgievski duke pranuar se ndarja është edhe te bindjet politike, lëri më dallimet e tjera thelbësore të komuniteteve në vend.

Petrit Saraçini,<sup>702</sup> në të njëjtën linjë, shton se ndasia ishte pasojë e dallgës nacionaliste që mori pushtetin në fillim-vitet ’90 gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, (në Kroaci – HDZ, në Serbi – socialistët e Millosheviqit). Luftërat në Ballkan nuk mund të kalonin pa pasoja edhe në politikën e Maqedonisë, ku pas qeverisë së ekspertëve erdhi në pushtet LSDM-ja me një politikë më të butë nga aspekti nationalist, por me dhjetëra raste të nxitjes së incidenteve ndëretnike. Më e vrazhdë erdhi periudha me VMRO DPMNE-së që çoi në konfliktin e vitit 2001. Duke pasuar këtë linjë mendimi – të ndikimit të politikës nacionaliste në raportimin mediatik – Saraçini thekson se periudha tjetër e VMRO DPMNE-së (pas vitit 2006) dhe sjellja e kësaj përbërjeje politike me median pas vitit 2010, (Sitel, Kanal5, Alfa, gazetata e MediaPrintMakedonija), diktimi dhe kontrolli i tyre, përbën një nga njollat më të rënda të historisë së gazetarisë, “*ku çështjet ndëretnike raportoheshin me syze etnike*”.

Ndërsa, sa i përket *raportimit për tjetrin*, një pjesë e të intervistuarve shprehin një distancë lidhur me periudhën socialiste, pasi nuk e kanë jetuar si gazetarë atë periudhë, ata

<sup>697</sup> Raportimi i dyzuar, sikurse u theksua më sipër, është ai i shfaqjes së dy realiteteve të ndryshme për një fenomen të caktuar, që për shkak të nxitjes politike, apo faktorëve të tjerë rrethanor (përfshi edhe vetë kulturën apo linjat e një redaksie) prodhon ndasi që mund të shkojnë deri në kriza të gjera apo konflikte. I ndihmuar nga gjuha e urrejtjes, ky raportim është i dënueshëm, jo vetëm për individët që shfaqen në ekran por edhe për median që ia lejon atyre shfaqjen në ekran, për gjuhë urrejtje, vepër kjo që ndiqet nga Kodi Penal.

<sup>698</sup> Raportimi për tjetrin është raportimi për të ndryshmin nga ty, për nga etnia, besimi, kultura, shtresa sociale, paaftësia fizike, dallimet e tjera, duke synuar jo vetëm një raportim të drejtë por edhe përfshirës, duke tentuar që faktet të marrin zë të gjerë në media, të gjejnë zgjidhje, dhe mbi të gjitha, të raportohet me mirënjohje dhe respekt për tjetrin, në mënyrë që masa e gjerë e publikut të sigurojnë një kontekst më të gjerë të fenomeneve, të mendojnë për të, të ndërjegjësohen dhe të ndikojnë në të.

<sup>699</sup> Raportimi objektiv është ai që i afrohet realitetit. Kur themi “i afrohet” duhet të kemi parasysh se asnjë media, nuk mund ta pasqyrojë 100% realitetin në raportim, por të jetë në suazat e realitetit dhe madje, nëse nuk mund të ofrojë një pikëpamje përfshirëse (inkluzive), atëherë të paktën të jetë korrekt. Për shumë autorë, në shtetet multi-etnike, ky raportim nuk është i mjaftueshëm, pra thjesht të kesh dy palë në artikull (konform standardeve të Kodit apo parimeve të tjera që diktojnë rregullativat ndërkombëtare të gazetarisë), por nevojitet edhe fryma dhe ndjesia që vetë gazetari të ndihet “tjetri” në mënyrë që të shuaj stereotipizimin e shoqërisë – pra, të ndihet sikur raporton për veten.

<sup>700</sup> Intervistë me Zhaneta Trajkoskën, Drejtore e Shkollës së Lartë për Gazetari, eksperte e medias në fushën e menaxhimit të politikave kulturore.

<sup>701</sup> Intervistë me Dejan Georgievskin, Drejtor i Qendrës për Zhvillimin e Mediave, bashkëpunëtor në hartimin e ligjeve të medias.

<sup>702</sup> Intervistë me Petrit Saraçinin, ekspert në fushën e medias dhe marrëdhënieve me publikun.

megjithatë ndajnë qëndrimin se në atë kohë, propaganda politike që synonte konceptin socialist, jo vetëm që nuk siguronte hapësirë për tjetrin, por edhe ajo përmbajtje që shfaqej në gazetat e kohës (“Flaka e Vëllazërimit”, “Birluk”, revistat “Fatosi” dhe “Gëzimi”) duhet të ishte nën kontroll të plotë – ku, përfshirja ose inkluziviteti prekeshin pak, madje në kuadrin e konceptit të bashkim-vëllazërimit dhe idealizmit socialist, por jo lidhur me të drejtat, realitetin dhe shfaqjen në mënyrë objektive të jetës së tjetrit. Edhe në këtë periudhë të pluralizmit – thekson Saraçini – situata nuk është më e mirë. “Ndoshta është rritur hapësira për politikanët shqiptarë nëpër raportime, por sasia apo cilësia e përmbajtjeve për sa i përket jetës së shqiptarëve (apo etnive të tjera), kulturës, artit, ekonomisë, çështjeve sociale etj., mbetet e njëjtë” – sipas tij.

Tuneva shton gjithashtu se realiteti në periudhën socialiste ka ekzistuar në kushtet e idealizmit, *i zbukuruar*, në krahasim me raportimin e sotëm i cili ka një sërë arsyes për këtë gjendje.

Shumica e ekspertëve numërojnë disa shkaqe;

- 1) Reflektimin e bindjeve të vjetra të bartura nga një periudhë e gjatë me stereotipa të nxitur ndër vite në shoqëri
- 2) Reflektimin e rrethanave politike që ende tejçojnë ndasi ose edhe *pronësi* si “gardiane të komuniteteve të tyre të caktuara”
- 3) Reflektimin e brendshëm të redaksive; ato maqedonase janë thujtë të pastra etnikisht ndërsa ato shqiptare janë multi-etnike e multi-fetare. Formatit tradicional dhe mono-etnik i redaksive maqedonase nuk i ndihmon *raportimit për tjetrin*. Tahiri thekson se kjo tendencë që nga koha e monizmit vazhdon edhe sot, duke i lënë po aty paragjykimet dhe stereotipat etnikë e fetarë.
- 4) Tregu jo i barabartë mediatik – mediat maqedonase janë më të mëdha në numër dhe ndikim duke dominuar në ndasi
- 5) Mbetja i përkushtuar te shikuesit besnikë. Pa një ndryshim të mentalitetit të shikuesve s’mund të ketë as ndryshim të mentalitetit të mediave; ato do të vazhdojnë të ofrojnë të njëjtën përmbajtje që kërkon shikuesi besnik i tyre.
- 6) Mungesa e fondeve në investimin e këtij lloji raportimi. Mediat raportojnë për tjetrin vetëm nëse ky lloj raportimi financohet nga ambasadat e huaja, por jo me fonde vetjake. Lëvizja në këtë kurs i raportimit për tjetrin zakonisht ka kosto më të madhe.

Ashtu sikurse kemi theksuar edhe më sipër, raportimi më karakteristik i dyzuar ka ndodhur/ndodh në shërbimin publik (RTVM), ku dy programet, ai në maqedonisht dhe ai në shqip, shfaqnin/shfaqin realitete të ndryshme mediatike. Fatos Musliu<sup>703</sup> pranon se pas konfliktit të 2001, ndërkombëtarët kishin kontribuar me iniciativa për raportimin e diversiteteve, por pas përfundimit të këtyre iniciativave të financuara, redaksitë u tërhoqën nga kjo teori gradualisht duke iu rikthyer formës së tyre të vjetër të raportimit mono-etnik. “Ajo që ndodhte në vitin 2001, ku njëra redaksi i referohej UÇK-së si *terroriste* dhe tjetra si *kryengritës që luftonin për të drejtat e kombit*, u shfaq edhe pas konfliktit. Rast i tillë ishte edhe vrasja e të riut Angel Petrov në lagjen Gjorçe Petrov të Shkupit, ku për TVM2 bëhej fjalë për *incident mes grupeve të adoleshentëve* ndërsa për kolegun e TVM1, *vrasje me motive nacionaliste*. Rasti më i fundit i notuar ka qenë ai i ngjarjeve të 27 prillit (votimit të qeverisë LSDM-BDI dhe konstituimit të kryetarit të parë shqiptar të parlamentit) ku hyrja e turmave në Parlament u cilësua nga TVM2 si *dhunë dhe huliganizëm* ndërsa për redaksinë e TVM1, thjesht *shprehje e revoltës qytetare*” – pranon

<sup>703</sup> Intervistë me Fatos Musliun, redaktor përgjegjës i programit informativ në gjuhën shqipe në RTVM (TVM2)

Musliu. Për Stojan Tërçevskin<sup>704</sup> nga TVM1, “thujse nuk ka periudhë që nga pavarësimi i Maqedonisë e deri më sot, kur kemi thënë *“le të pushojmë pak nga këto tema të ndjeshme”* që prekin para së gjithash momentet etnike, filluar që nga referendumi për pavarësinë, protestat studentore, ngjarjet e Gostivarit, konflikti i armatosur, ngjarjet në Kalanë e Shkupit e deri te vrasja në Smillkovë. Duhet të punohet më shumë në *vetëdijesim*, me qëllim që të mund të themi se po raportojmë në mënyrë të unifikuar për të gjithë popullatën që jeton në vend, pavarësisht se cilës bashkësi i takon” – nënvizon Tërçevski. Me këtë qëndrim, Tërçevski nuk e mohon raportimin e dyzuar, pavarësisht tonaliteteve me të cilat ai shfaqet, nëse shtrembëron realitetin apo nëse e zbut një realitet të caktuar në favor të një komuniteti të caktuar. Tërçevski thekson *rritjen e vetëdijesimit* në përgjithësi të shoqërisë, e që konkretisht të reflektohet edhe në dy këndet e tjera të trekëndëshit, *politikën* dhe *median*. Tërçevski e pranon se në konfliktin e 2001, “kundërshtarët e policisë dhe ushtrisë ishin *terroristët shqiptarë*, ndërsa për mediat shqipe ishin pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe luftëtarë për të drejtat e njeriut... Nëse më pyesni se edhe sa vite do të dëgjojmë thirrje kundër shqiptarëve (*shiptari*) dhe maqedonasve (*kaurëve*), parulla në protesta pavarësisht se cila bashkësi etnike i organizon ato, do të përgjigjesha *“gjithmonë”*. Nëse më pyesni nëse duhet të raportojmë për këtë, do të thosha *“ndonjëherë”*, e me kalimin e kohës *“asnjëherë”*. Ose më konkretisht, deri sa nuk piqemi... por përvoja thërret për *vetëdijesim*” – shprehet Tërçevski. Pra, vetë ky qëndrim përbën një reflektim ndaj pasojave të këtij fenomeni, edhe pse Tërçevski nuk ka qenë kryeredaktor i shërbimit publik RTVM në periudhën e konfliktit, por gjithsesi, ishte gazetar në televizionin Kanal5 i cili gjithashtu i quante *terroristë* pjesëtarët e UÇK-së. Megjithatë, Emilija Petreska-Kamenjarova<sup>705</sup> nga Agjencia për Shërbime Audio e AudioVizuale e refuzon kategorikisht qëndrimin e mosraportimit të rasteve të ndjeshme. “Kur flasim për gjuhën e urrejtjes, është thelbësore të dihet se *nuk është e ndaluar* të raportohet për të. Nëse nuk informohet se gjuha e urrejtjes ekziston në shoqëri, dhe të dënohet si fenomen negativ, nuk fitojmë asgjë të mirë, përveçse e fshehim problemin poshtë rrogosit dhe pastaj, ai vetëm zmadhohet. E ndaluar është që media të jetë *burim* ose *mbështetës* i gjuhës së urrejtjes – thekson Kamenjarova. Ajo sjell ndërmend rastin e dënimit të gjuhës së urrejtjes, në një emision të drejtpërdrejtë televiziv, ku gazetarja reagoi në çast duke thirrur në ndërgjegjësim të të ftuarve”.<sup>706</sup>

<sup>704</sup> Intervistë me Stojan Tërçevskin, redaktor përgjegjës i programit informativ në gjuhën maqedonase në RTVM (TVM1)

<sup>705</sup> Intervistë me Emilija Petreska-Kamenjarovën, udhëheqëse e Sektorit për të drejtat e njeriut dhe edukimin mediatik në Agjencinë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale, eksperte e medias në komunikimin ndërkulturor

<sup>706</sup> Bëhet fjalë për emisionin “Samo Vistina” (Vetëm e Vërteta) në televizionin Kanal5 ku e ftuara nga radhët e VMRO DPMNE-së Ivanka Dodevska, anëtare e komitetit ekzekutiv, e cila tha se “nëse nuk ka Qeveri të Përzhinës në zgjedhjet e mundshme të parakohshme parlamentare, do të ketë gjak deri në gju”. Gazetarja e ndërpreu emisionin duke thënë se fjalët e tilla dhe gjuha e urrejtjes nuk lejohen.

Plusinfo, *Василевска во „Само Вистина“: Ако нема „Пржинска влада“, ќе има „крв до колена“* (Vasilevska në “Vetëm e Vërteta): Nëse nuk ka Qeveri të Përzhinës, do të ketë gjak deri në gju),

<[Po ashtu, një rast i ngjashëm ndodhi edhe në televizionin ALSAT ku gazetarja Arta Tahiri ndërpreu gjuhën e urrejtjes nga Stefan Vllahov Micev nga Instituti i Historisë, i cili u përzu nga emisioni.](https://plusinfo.mk/%d0%b2%d0%b0%d1%81%d0%b8%d0%bb%d0%b5%d0%b2%d1%81%d0%ba%d0%b0-%d0%b2%d0%be-%d1%81%d0%b0%d0%bc%d0%be-%d0%b2%d0%b8%d1%81%d1%82%d0%b8%d0%bd%d0%b0-%d0%b0%d0%ba%d0%be-%d0%bd%d0%b5%d0%bc/>”, [1.2.2020]</a></p>
</div>
<div data-bbox=)

Portalb, *Arta Tahiri e largon nga emisioni Micevin (Video)*, <[199](https://portalb.mk/224918-arta-tahiri-e-largon-nga-emisioni-micevin-video/>”, [1.2.2020]</a></p>
</div>
<div data-bbox=)

Fenomeni i raportimit të dyzuar vazhdon edhe tani, madje Fatos Musliu nga TVM2 pohon tezën e “vendosjes në heshtje” ose të “distancimit” të disa temave ose detajeve që raportojnë mediat. Ai thotë se gjatë kohës që në redaksinë e parë trumbetohej çështja e autoqefalisë së Kishës Ortodokse Maqedonase, kjo temë nuk trajtohej aspak në redaksinë e dytë. E ndërsa në redaksinë e dytë hapeshin lajmet me mungesën e karrigeve në paralelet në gjuhën shqipe, kjo temë nuk trajtohej aspak nga TVM1. E shumta, në raste të rralla, kishte ndonjë temë për mungesë kompjuterësh apo pishinash në shkolla maqedonase, por jo edhe të kushteve elementare në paralelet në gjuhën shqipe – thotë Musliu duke iu referuar raportimit të kohëve të fundit. Ky fenomen i “vendosjes në heshtje” dhe i “distancimit” përbën një formë më të sofistikuar të raportimit të dyzuar. Sipas Musliut, fenomeni nuk ka të bëjë me mosnjohjen e koncepteve të raportimit nga gazetarët dhe shefat e tyre, por më tepër me *auto-censurën* dhe frikën e humbjes së *audiencës besnike* të një mediaje, në rast se kalon në raportimin përfshirës (inkluziv) për tjetrin.

Këtë fenomen që ndeshet në shërbimin publik radiodifuziv – dy redaksi nën të njëjtën çati – e dënojnë si institucionet në fushën e medias ashtu edhe ekspertët.

Marina Tuneva nga Këshilli i Etikës në Media thekson se duhet të punojmë më shumë në raportimin për tjetrin në frymë përfshirëse (inkluzive). “Ai “tjetri” duhet të ndihet si “ti”, dhe “ti” duhet të ndihet sikur je ai “tjetri”. Vetëm kështu mund të shuhet fenomeni i ashtuquajtur “ai tjetri!”. Të ngremë retorikën dhe vetëdijen në një nivel tjetër se “të tjerët” jemi “ne” – pra, “të tjerët” në këto rrethana që jetojmë jemi “ne” në këto rrethana që jetojmë... Ne kemi të njëjtën mbulesë, halle e probleme. Duhet të flasim për gjërat që na shqetësojnë bashkërisht, si të kemi shoqëri bashkëkohore, si të kemi punësime, si ta zhvillojmë jetën politike me njerëzit e duhur në politikë që t’i zgjidhim këto probleme... Këto janë çështje që duhet t’i trajtojmë së bashku, e jo se si një etni e caktuar preket nga një politikë e caktuar” – thotë Tuneva. Ajo thekson se shërbimi publik RTVM nuk e ka përmbushur rolin e duhur në edukimin dhe promovimin e konceptit gjithëpërfshirës (inkluzivitetit). Emilija Petreska-Kamenjarova nga Agjencia për Shërbime Audio e AudioVizuale vijon se *Ligji për Shërbime Audio dhe AudioVizuale* është i qartë në nenet 110 e 111, ku Shërbimi Radiodifuziv Publik RTVM duhet së pari të sigurojë informim të paanshëm dhe të drejtë për të gjitha ngjarjet (politike, fetare, sociale), të mos përfaqësojë apo mbrojë politika ose interesa të veçanta të partive politike dhe grupeve politike, fetare etj., të kontribuojë në respektimin e të drejtave të njeriut, dallimeve, tolerancës, në mbrojtjen e të miturve, barazisë gjinore e zhdukjes së diskriminimit, të krijojë programe që kontribuojnë në kultivimin, avancimin e njohurive dhe kuptimin për identitetin kulturor, të respektojë dallimet kulturore dhe fetare dhe të nxisë kulturën e dialogut publik me qëllim që të përforcohet mirëkuptimi i ndërsjellë dhe toleranca për avancimin e marrëdhënieve ndërmjet bashkësive të ndryshme në mjedis multi-etnik dhe multi-kulturor, të informojë publikun në lidhje me veçoritë fetare si dhe të informojë, edukojë dhe transmetojë emisione për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore..... (neni 110)<sup>707</sup> ndërsa po ashtu, të respektojë parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë gjatë formulimit të informacioneve dhe programeve, përfshirë *ndalimin* për nxitjen e jo-tolerancës kulturore, etnike, religjioze, gjinore, racore, nacionale dhe forma të tjera... (neni 111). Kamenjarova thekson se jo vetëm RTVM-së por të gjitha mediave në përgjithësi u duhet një kulturë redaktimi. “Ka redaksi që nuk kanë kulturë redaktimi. Për një temë të caktuar, një herë informon në një formë, herën tjetër informon në formë tjetër, varësisht cili gazetar ose redaktor ka pasur turnin për të mbuluar informatën. Nuk ekziston harmonizim brenda medias,

<sup>707</sup> Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë, *Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale*, neni 61, <[http://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/legislation/26.12.2013.pdf](http://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/legislation/26.12.2013.pdf)>, [1.2.2020]



dhe media duhet të kujdeset për të vendosur një *kulturë mediatike*” – thekson Kamenjarova. Ajo kujton gjithashtu edhe nenin 48, *për ndalimet e veçanta* ndaj operatorëve radiodifuzivë, se nuk guxojnë të mbajnë programe me të cilat rrezikohet siguria nacionale, nxitet rrënimi i dhunshëm i rendit kushtetues të shtetit, thirret në agresion ushtarak ose në konflikt të armatosur, nxitet ose përhapet diskriminim, mosdurim ose urrejtje në bazë të racës, gjinisë, religjionit ose nacionalitetit.

Sipas normave ligjore por edhe financimit nga shteti, RTVM-ja vis a vis duhet të jetë radiodifuzeri pararojë që duhet të promovojë kohezionin, bashkëjetesën dhe elementin përfshirës në shoqëri.

Gjithsesi, të gjithë drejtuesit e institucioneve mediatike si dhe studiuesit bien dakord tërësisht me faktin se më shumë faktorë e aktorë duhen aktivizuar në funksion të luftimit të fenomenit të raportimit të dyzuar, në promovimin e kohezionit dhe frymës multi-etnike e multi-fetare të vendit; më shumë vigjilencë nevojitet ndaj rasteve të ndjeshme; më shumë masa ndëshkimi (gjyba ose morale) duhen ndaj mediave që nuk i përmbahen standardeve; më shumë kompetenca i nevojiten Këshillit të Etikës; më shumë edukim duhet për pronarët e mediave, dhe më shumë trajnime për vetë gazetarët (do i shohim më poshtë, më detajisht).

7.1.2.2 Sa përpjekje kanë bërë redaksitë që të jenë të kujdesshme për sa i përket raportimit për tjetrin? Sa e njohin gazetarët dhe redaktorët konceptin e gazetarisë që raporton objektivisht për tjetrin?

Raportimi për tjetrin shkon krahe përkrahë dhe i pandashëm me raportimin inkluziv (përfshirës). Nuk janë vetëm shtetet multi-etnike, multi-fetare apo multi-kulturore sikurse Maqedonia e Veriut, por edhe shtete të tjera me një demokraci më të fortë dhe të qëndrueshme të cilat merren me fenomenin e raportimit të diversiteteve. Në këtë gamë përfshihen edhe shtete si Britania, Franca, Gjermania, Zvicra, e shumë shtete të tjera perëndimore, të cilat gjenden në udhëkryqin mes ndjenjës së tyre kombëtare dhe fetare (katolike) nga njëra anë, dhe rrymave të emigrantëve, kulturave dhe besimeve të ndryshme që vijnë nga vala e tyre e zbarkimit në rritje çdo vit.

Ndërsa shtetet perëndimore kanë një ndërgjegje më të lartë shoqërore dhe mediatike, në Maqedoninë e Veriut, sikurse edhe u theksua më sipër, raportimi për tjetrin ndodh vetëm kur financohet nga të huajt. Numri i redaksive që raportojnë për tjetrin është i vogël – thotë Snezhana Tërpevska, studiuese e këtij fenomeni. Ajo thotë se “kur raportohet për çfarëdo teme, gazetari duhet të këmbëngulë që të marrë parasysh dhe t’i reflektojë interesat dhe pikëpamjet e grupeve të ndryshme të qytetarëve sipas statusit shoqëror, ekonomik, gjinisë, moshës, religjionit, përkatësisë etnike dhe attributeve të tjera”. Tërpevska nuk përdor fjalën “dallime” dhe preferon terminologjinë e gazetarisë së sotme profesionale *raportim për diversitetet* dhe *raportim inkluziv*. Duke u bazuar në një sërë analizash, Tërpevska vlerëson rastin e vetëm të *raportimit inkluziv për tjetrin*, televizionin ALSAT. Ajo thotë se ka edhe televizione të tjera si TV21 dhe Shenja, me redaksi të përziera, por nuk mund të thotë nëse politikat e tyre redaktuese promovojnë *inkluzivitetin*. Ajo ndan qëndrimin se gazetarët e njohin konceptin e gazetarisë që raporton për tjetrin, por ngre dyshime se sa e zbatojnë këtë gjë gazetarët, nën presionet e përditshme me të cilat përballen. “Gazetarët në shumë redaksi, nuk kanë as liri dhe as mbështetje profesionale që të fokusohen te inkluziviteti në raportimet e tyre” – nënvizon Tërpevska.

Të njëjtën bindje ndan edhe Marina Tuneva nga Këshilli i Etikës në Media, e cila thotë se “në mediat e vendit duhet të shtohet sasia, prodhimi i informacioneve ose kronikave të tilla ku të flitet për tjetrin, dhe madje me tone inkluzive (përfshirëse). Kemi mjaft shembuj pozitiv, televizionin ALSAT, i cili arrin të krijojë dhe ta ndërtojë këtë integrim të nevojshëm në shoqëri, një lloj tjetër i epokës së Radios Life (projekt ky multi-etnik, multi-kulturor dhe multi-gjuhësor) menjëherë pas konfliktit. Duhet të shtohet numri i mediave të tilla. Nëse nuk kemi shpresa që mediat e vendit do të bëhen ashtu, atëherë të paktën të punojmë me ato media që kanë filluar të funksionojnë kështu” – thekson Tuneva. Ajo vë gishtin te redaktorët dhe gazetarët, duke ngritur shqetësimin se jo rrallëherë, ata mendojnë se vetëm ngjarjet politike mund të na ngrenë dhe të na afirmojnë në shoqëri, se sa temat shoqërore inkluzive. Me këtë, Tuneva për herë të parë lëshon sinjalin se mediat duhet të rishqyrtojnë politikat e tyre redaksionale dhe të orientohen më shumë te çështjet sociale dhe ekonomike se sa ta “bombardojnë” shikuesin me lajme politike dhe të bien në grackat e deklaratave pingpong të përfaqësuesve politikë për pikë ditore. Tuneva shkon më tej kur thotë se gazetarët janë të gozhdur në politikë, sepse “kushtëzohen nga interesat e atyre që qëndrojnë pas mediave – pronarëve – të cilët nuk e njohin domethënien reale të raportimit, por mendojnë më shumë nga një *këndvështrim biznesi* se ato biseda që dëgjohe në rrugë për politikën na qenkan interesi i vetëm dhe i rëndësishëm publik që duhet të mbulohen në media”.

Sefer Tahiri thotë gjithashtu se ende nuk ka përpjekje të dukshme reale sa i përket njohjes më të madhe të “*tjetrit*” për nga kultura, mentaliteti, mënyra e jetesës, traditave dhe zakoneve. Sipas tij, gazetarët dhe redaktorët, shumë pak e njohin frymën e komunikimit ndërkulturor që përfshin tolerancën dhe mirëkuptimin e ndërsjellë mes popujve. Ai fajëson për këtë, faktin që shkollat dhe librat shkollorë nuk i kanë përfshirë këto koncepte, përkundrazi, i kanë dhënë hov stereotipizimit etnik e fetar, i cili më vonë është reflektuar edhe në media nga po këta gazetarë të cilët nëpër shkolla kishin dëgjuar për “tjetrin” vetëm etiketime negative ose nuk kishin dëgjuar fare për të. Ndarja e shoqërisë në baza etnike dhe fetare është prodhim i shkollave, institucioneve kulturore, sistemit politik, institucioneve shkencore, por natyrisht edhe mediave, të cilat ndjekin ata faktorë socialë që prodhojnë ndasi”.

Petrit Saraçini thotë se “pavarësisht se thuajse çdo gazetar ka kaluar ndonjë lloj trajnimi lidhur me raportimin për “*tjetrin*”, prapëseprapë shumë pak përpjekje bëhen që këto shkathtësi të marra, t’i zbatojnë në praktikë. Shkak është edhe shikuesi” – thotë Saraçini. “Nëse e di që të shikojnë *nacionalistët*, dhe papritur fillon të raportosh në mënyrë *kozmpolite*, ti e di që do të humbësh si biznes... për shkak se deri sa ta fitosh publikun e ri, do të humbësh publikun e vjetër. Ky është një investim që pronarët e mediave duhet ta bëjnë; në fillim të humbin pak, për të përfituar një publik më të gjerë dhe më të vetëdijësuar më vonë” – thotë ai.

Trajnime kanë kaluar edhe gazetarët dhe redaktorët e televizionit publik RTVM, por siç thotë Fatos Musliu, “edhe pse në mënyrë deklarative apo në kolegjiomet e përbashkëta redaksitë shprehin gatishmërinë për të raportuar për “*tjetrin*”, praktika flet ndryshe!” Musliu thotë se në përgatitjen e kronikave, “redaksitë mbyllen në formë guaske dhe raportojnë ose i shtjellojnë problemet vetëm për një audiencë të caktuar”. Musliu e arsyeton këtë fenomen me auto-censurën që redaksitë manifestojnë, në mbrojtje të audiencës klasike të tyre. Kjo na ngre shumë dilema lidhur me shikueshmërinë, veçanërisht atë të programit në gjuhën maqedonase, nëse në kronikat e tij do të kishte edhe analistë shqiptarë, ekspertë shqiptarë, profesorë shqiptarë, të anketuar shqiptarë, që do të flisnin shqip në ekranin e TVM1. Si do të ndiheshin shikuesit mono-etnik të vjetër dhe besnik të këtij programi? Po sikur ky program të transmetonte edhe festivale të muzikës shqiptare apo të etnive të tjera? Çfarë do të kishte ndodhur me shikuesit e tij? Për Stojan Tërçevskin nga TVM1, pavarësisht të kaluarës, “përgjegjësia shoqërore e angazhimit gazetaresk

duhet të pengojë besnikërinë ndaj çfarëdo grupi ose individit tjetër. Duke promovuar informimin e mirë, mund të merren vendime që forcojnë shoqërinë dhe perspektivat për zhvillim pozitiv. Kjo është receta për demokratizimin e strukturave të shoqërisë. E kemi detyrim ndaj publikut, ndaj shoqërisë, që të respektojmë të drejtën që opinioni të dijë” – thotë Tërçevski i cili shton se në linjën e ngushtë mes personales dhe profesionale, profesionalja duhet të jetë mbi emocionet, në mënyrë që të sigurohet një pasqyrë reale e situatës për informim. “Nëse gazetari bie pre e emocioneve, propagandës dhe shtrembërimit të të vërtetës, atëherë kjo do të kishte pasoja që mund t’i kushtonin jo vetëm gazetarin, por mbarë shoqërisë.”

Qëndrime të reja paraqesin dy njohësit e tjerë të raportimit dhe gazetarisë. Zhaneta Trajkovska dhe Dejan Georgievski theksojnë se mediat dhe redaksitë e njohin konceptin e raportimit profesional (përfshi edhe raportimin për tjetrin), por nuk sqarojnë vis a vis nëse ky raportim zbatohet, në çfarë mase etj. Ata thonë gjithsesi se mediat tradicionale nuk janë ndoshta në nivelin e duhur për sa i përket përmbushjes së këtij raportimi, ndërkohë që japin alarmin më së shumti për gjendjen e *mediave online*. “Këto media nuk kanë asnjë parim profesional në raportim, dhe në fakt nuk mund të quhen *media*, por makineri propaganduese”- thotë Trajkovska. Ajo shton se këto *media online janë vegël e partive dhe e qendrave të pushtetit*. Në linjë të tillë për mediat online shprehet edhe Dejan Georgievski. Ai thotë se problemi më i madh i kohës së tanishme është interneti, sfera online, epoka digjitale... *Këto media janë burimi i ndasive* – sipas Georgievskit – jo vetëm në bindje politike, por edhe në ato mbi dallimet e tjera në shoqëri. Ai pranon se mediat online dhe rrjetet sociale demokratizuan në mënyrë mbresëlënëse diskursin politik. “Mediat tradicionale nuk e kanë më monopolin e nxitjes së publikut për diskursin... tani, me këtë demokraci, pavarësisht nëse janë qëllimmira ose qëllimkëqija, mediat online dhe rrjetet sociale kanë marrë primatin e përcjelljes ose të nxitjes së qëndrimeve të publikut”. Georgievski pranon se kjo demokraci e diskursit politik është vështirë për t’u kontrolluar, ashtu sikurse vetë mediat online për t’u rregulluar! Sipas tij, nëse ka rregulla në profesionin e gazetarisë, duhet të ketë rregulla edhe në komunikimin publik që zhvillohet në botën online. Ka persona që nuk identifikohen si gazetarë, dhe në bazë të nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, cilido ka të drejtë të mbledhë dhe të shpërndajë informacione. Po ashtu, censura është e ndaluar. Këto tendenca nuk janë në anën tonë – thotë Georgievski – i cili bën apel për rregullim të sferës së komunikimit, veçanërisht tani që qytetari përballë me krizë e besimit në globalizim, krizën e besimit në institucione, ndonjëherë edhe ndaj mediave tradicionale, krizat ekonomike, ndryshimet klimatike, politikat nacionaliste e shumë të tjera”.

Të gjithë studiuesit njëzëri theksojnë se është e patjetërsueshme nevoja e njohjes së raportimit për tjetrin, dhe madje, mediat duhet të bëjnë më shumë në frymën inkluzive, jo vetëm atë etnike por edhe me grupe të tjera shoqërore (të marginalizuara).

### 7.1.2.3 Në çfarë mase arrin që të sigurojë raportim të balancuar Kodi i Gazetarëve?

Studiuesit por edhe drejtuesit e institucioneve që merren me veprimtarinë e mediave kanë qëndrime të ndara lidhur me Kodin e Gazetarëve dhe sigurimin e *raportimit të balancuar dhe raportimit për tjetrin*. Ashtu sikurse kemi përmendur në nenet e këtij Kodi, edhe pse i miratuar që nga viti 2001, ai përbën një bazë të mirë sa i përket raportimit korrekt, të drejtë, të balancuar, por jo në mënyrë të domosdoshme përmban edhe frymën e inkluzivitetit.

Marina Tuneva thekson se Kodi i Gazetarëve skicon *parimet dhe rregullat bazë* kur bëhet fjalë për raportimin objektiv dhe të paanshëm, si dhe bën një dallim mes fakteve, mendimeve, gjuhës së urrejtjes, diskriminimit, tolerancës, madje edhe një distancë të qartë nga politikanët.

Por, pikërisht lidhur me parimin e inkluzivitetit, Tuneva thekson se ai ka nevojë të përmirësohet. “Korniza etike mund të përmirësohet më shumë, dhe praktikrat e deritanishme dhe lloji i etikës në raportim për çështje të ndjeshme, inkluziviteti etj., duhet të inkorporohen në të. “Mediat nuk mund të thonë se ne i kemi të dyja palët, jemi në përputhje me Kodin etj.,... nuk mjafton të ndalet këtu” – thekson Tuneva.

Emilija Petreska-Kamenjarova nga Agjencia për Shërbime Audio e AudioVizuale shton se Këshilli i Etikës në Media, që është përgjegjës për etikën dhe ruajtjen e standardeve të gazetarisë përmes Kodit të Etikës, duhet të përforcohet më shumë dhe ti sigurohen instrumente që të funksionojë në mënyrë të pavarur. “Mediat duhet ta respektojnë autoritetin e Këshillit të Etikës” – thekson Petreska-Kamenjarova, duke kujtuar, për shembull, raste të paraqitjes së ndonjë problemi me ndonjë radiodifuzer, por Agjencia e saj, si institucion rregullator nuk mund të veprojë. “Duhet të merren për bazë edhe praktika të tilla si Belgjika, e cila me ligj parashikon që mediat që kanë programe informative, të jenë *detyrimisht edhe anëtare* të trupit vetërregullues të Këshillit të Etikës dhe po ashtu, t’i respektojnë vendimet e këtij Këshilli.” Ajo nuk është pro “*rregullimit të tepruar*” dhe parashikimit të çdo gjëje me ligj, por vet-rregullimi nuk do të pësonte nëse me ligj theksohej se trupi vetërregullues është organi që merret me këtë gjë”.

Në këtë kuadër, për më shumë kompetenca dhe fushëveprim më të gjerë të Këshillit të Etikës shprehet edhe Petrit Saraçini. Ai thekson se përveç rregullimit, Këshilli i Etikës ose Kodi i Gazetarëve duhet të bartë edhe frymën e bashkë-rregullimit (coregulation – rregullim i njëkohshëm i dy sistemeve përmes instrumenteve të njëjta). Saraçini sjell ndërmend formatin e Këshillit të Etikës në Kosovë, i cili përveç të drejtës së dhënies së verdikteve mbi konteste të caktuara mes palëve, kur shkelen standardet, cakton edhe *dënime simbolike në të holla...* Pavarësisht shumë simbolike, gjoba e ekspozon median në rrethin brendapërbrenda mediave, dhe e vendos atë para përgjegjësisë së mediave dhe kolegëve të tjerë. “Kjo e mbron së pari redaksinë nga proceset gjyqësore për shpifje, të cilat janë të shtrenjta dhe zgjasin shumë kohë, ndërkohë që i jep mundësi opinionit dhe vetë shoqërisë gazetareske të ushtrojë presion moral ndaj shkelësit të standardeve në raportim”. Sipas Saraçinit, në Maqedoninë e Veriut, “disa redaksi nuk i publikojnë vendimet e Këshillit, pavarësisht se ligji garanton që si dëmshpërblim media duhet ta shfaqë përgënjeshtimin në të njëjtën kohëzgjatje, me të njëjtën peshë dhe në të njëjtin vend ku e ka bërë “shpifjen”. Po ashtu, nëse tre herë me radhë media nuk e shfaq përgënjeshtimin, atëherë *të fshihet nga regjistri i mediave profesionale* të vendit. Pa bashkë-rregullim, mediat nuk mund ta marrin seriozisht raportimin objektiv. Përmes bashkë-rregullimit, media do të mbronte vetveten edhe nga presioni politik në raportim”.

Sefer Tahiri thotë se “ka media të cilat janë të ndërgjegjshme edhe për mosrespektimin e Kodit të Gazetarëve, sidomos kur bëhet fjalë për narrativa etnike dhe fetarë.” Tahiri propozon që Kodi, i shkruar që në vitin 2001 ka nevojë të riformulohet duke pasur parasysh edhe tendencat globale. Zhaneta Trajkovska thotë se pavarësisht Kodit të Gazetarëve, vetë redaksitë duhet të krijojnë parimet e tyre dhe direktivat për një praktikë vetjake por gjithnjë, të bazuar në këtë kod. “Për fat të keq, pothuajse asnjë redaksi nuk ka një dokument të tillë ose parime që mbrojnë standardin etik gazetaresk dhe të kujdesen për punën e përditshme të reporterëve”.

Nga drejtuesit e redaksive në gjuhën maqedonase dhe shqipe në shërbimin radiodifuziv publik RTVM, Fatos Musliu thekson se programi në gjuhën shqipe TVM2 që ai drejton, tenton t’i përmbahet Kodit të Gazetarëve, dhe veçanërisht për çështje të ndjeshme etnike merr të paktën prononcime nga bashkëfolës shqiptarë dhe maqedonas, me qëllim që shikuesi të përftojë një vlerë simetrike nga të dy komunitetet në fjalë. Sigurisht që në të ardhmen, redaksitë duhet t’i qasen me më shumë përkushtim dhe ta praktikojnë raportimin për tjetrin, për të siguruar njohje

më të mirë dhe rënie të dallimeve mes “neve” dhe “atyre”. Edhe Stole Tërçevski nga TVM1 thekson se “çdo redaksi e ka për detyrim ndaj publikut që të respektojë të drejtën për informim të tij, në mënyrë objektive.”

Gjithsesi se ka një hendek ende të dukshëm lidhur me frymën inkluzive në Kodin e Gazetarëve, e veçanërisht asaj që u përmend më sipër, mbetjes besnike të opinionit publik, i ndarë në bindje. Dejan Georgievski nënvizon: “Unë nuk pres nga gazetarët që të kenë si moto promovimin e tolerancës, por të paktën, të mos promovojnë stereotipa negative në shoqëri.” “Gazetarët nuk duhet të promovojnë – thotë Georgievski – por ama, para së gjithash duhet të bazohen në fakte dhe te e vërteta”.

Përveç këtij prizmi, Marina Tuneva nga Këshilli i Etikës, e vetëdijshme për tendencat e reja, ngre shqetësimin e vazhdueshëm prej kohësh tashmë, atë të nevojës së përmirësimit të standardeve etike në mediat online. Tuneva shprehet optimiste se nëse ka një unitet dhe vullnet, mund të pranohet edhe ideja e informimit inkluziv (Diversity and Inclusiveness), praktikë kjo që ka rezultuar e suksesshme në shkollat e Bashkimit Evropian, për zhvillimin e praktikave dhe ruajtjen e diversitetit inkluziv.

7.1.2.4 Sa hapësirë gjen raportimi për tjetrin në programet studimore universitare të gazetarisë dhe komunikimit? A duhet të shtohet niveli i njësive mësimore që trajtojnë këtë çështje?

Për të folur mbi hapësirën që gjen raportimi për tjetrin, si koncept në programet studimore universitare, së pari duhet të jemi të vetëdijshëm për faktin se në Maqedoninë e Veriut, thuajse të gjitha universitetet i kanë modifikuar degët studimore të gazetarisë, dhe ditët e sotme fokusohen më së shumti te komunikimi ose komunikimi ndërkombëtar. Ky largim nga studimet për gazetari – drejtim i posaçëm për raportimin dhe shkrimin e lajmit si dhe diversitetet – ka ndikuar në varfërimin e mëtejshëm të prurjeve për gazetarë.

Nëse në programet studimore të dedikuara për gazetari, sikurse gjithkund nëpër botë, theksi i jepet shkrimit dhe raportimit, gazetarisë radiofonike, gazetarisë televizive, gazetarisë telegrafike (e rinovuar tani për web), lirisë së shprehjes, zhanreve të gazetarisë, reportazhit, dokumentarit etj., tani në universitetet e Maqedonisë së Veriut (përveç Universitetit “Shën Kirili e Metodij”) më së shumti i kushtohet vëmendje marrëdhënieve ndërkombëtare, institucioneve të BE-së dhe integritit, marrëdhënieve me publikun, të drejtës administrative, ekonomisë, sociologjisë së komunikimit etj. Në kuadër të programeve gjendet tek-tuk edhe ndonjë lëndë që ka të bëjë me *Komunikimin ndërkombëtar dhe identitetin kulturor* (UEJL), por jo me theks të veçantë studimin e identiteteve, diversiteteve e të ngjashme.

Shifrat e regjistrimit të të rinjve në gazetari janë gjithnjë në rënie, madje analizat tregojnë se vitin e fundit, në të gjithë territorin e Maqedonisë së Veriut janë regjistruar vetëm 19 studentë. Shkolla e Lartë e Gazetarisë, për shembull, prej vitesh nuk mund ta aktivizojë shkallën e magjistraturës për shkak të mungesës së studentëve. Kjo shifër shënon rënien më drastike ndonjëherë të interesit për gazetarinë, që për disa nga studiuesit e fushës nënkupton edhe reflektimin e rënies së vetë imazhit si profesion të gazetarisë. Të njëjtës logjikë i ndihmon edhe pozicionimi i Maqedonisë së Veriut, përkrah vendeve afrikane, sa i përket lirisë së medias. Zhvlerësimin e profesionit të gazetarit e pranojnë në mënyrë absolute të gjithë të intervistuarit për qëllim të këtij studimi (shumica e tyre janë edhe profesorë universitarë, shkollash gazetarie ose institutesh).

Emilija Petreska-Kamenjarova, duke u referuar konkluzioneve të dala nga një sërë debatesh të organizuara gjatë vitit 2019 në kuadër të Agjencisë për Shërbime Audio e AudioVizuale, vëren se në fushën e medias nevojiten ndryshime drastike, jo thjesht trajnime... “Publiku duhet të rikthejë vëmendjen te media, ose e kundërta, mediat të kthejnë vëmendjen te publiku. Kur i pyesni njerëzit se “*cilës media i besoni*”, ata thonë “*asnjërës*”. Ekziston bindja se në gazetari mund të punosh me çfarëdolloj fakulteti. Po, mundesh... por prapëseprapë, duhet të kesh bazën dhe të jesh i aftë, dhe gazetaria nuk është vetëm profesion por edhe mënyrë jetese. Kur je gazetar, nëse e bën punën si duhet dhe nëse e bën sepse e do atë punë, atëherë ke formuar të menduarit kritik. Çdo gjë që sheh në televizor apo kudo tjetër, e sheh me syrin kritik. Por, si do ta ndërtojme të menduarit kritik në opinion kur vetë gazetari nuk i zotëron këto cilësi” – thekson Petreska-Kamenjarova. “Për momentin, nuk mund të flasim për probleme në programet studimore kur nuk kemi së pari studentë. Nuk kemi kuadër për formim, që më vonë të flasim se si do ta formojmë.”<sup>708</sup>

Ndërsa lidhur me raportimin për tjetrin në programet studimore, Petrit Saraçini thekson se leksione mbi këtë materie ka, por deri tani, vetëm Shkolla e Lartë për Gazetari ka pasur një lëndë të veçantë. Ai këmbëngul se raportimi për diversitetet duhet të jetë *lëndë ose provim i veçantë*, pasi, bazuar në rrethanat ku jetojmë, Maqedonia është shtet multi-etnik, multi-fetar, multi-kulturor, me shtresa të ndryshme identitetesh etj. “Kur mbaroni studimet e gazetarisë, ju duhet të jeni i pajisur me këto shkathtësi, por nëse futeni në një redaksi pa dijet adekuate, atëherë redaksia duhet të ketë doemos redaktorë të posaçëm që merren me gazetarë fillestarë. Kjo ndodh në perëndim, ku redaktorë në prag të pensionit, marrin rolin e mësimdhënësit ose edukatorit për të rinjtë, për t’u përcjellë atyre përvojat” – thekson Saraçini.

Zhaneta Trajkovska thotë se nga studimet e deritanishme të Institutit për Studime Komunikimi, shkollat e gazetarisë kanë pak a shumë leksione të tilla për raportimin mbi diversitetet. Por, për fat të keq, programet mësimore duhet të rishikohen tërësisht dhe të modernizohen – thotë ajo – në përputhje me *mediat e reja, mediat sociale, gazetarinë mobile* etj. “Tek ne, përshtatja e programeve studimore shkon ngadalë, prandaj këto programe janë të vjetërsuara.”

Edhe Sefer Tahiri në të njëjtën linjë thotë se raportimi për tjetrin është i pranishëm por jo sa duhet. Ekziston lënda “Komunikimi Ndërkulturor” por jo edhe lënda “Raportimi i Diversiteteve” e cila do të ishte një udhërrëfyes për formimin dhe shkollimin e gazetarëve që nuk janë të njëtrajtshëm etnikisht kur raportojnë për ngjarjet e ditës.

Fatos Musliu tregon raste konkrete të mungesës së njohjes së tjetrit, nga përvoja e tij me studentë të gazetarisë që vijnë në programin në gjuhën shqipe të RTVM-së për të zhvilluar praktikën. “Në vazhdimësi, këta studentë tregojnë njohuri ose shkathtësi tejet të pakta gjatë ushtrimeve për lajmin, raportimin, për problemet që kanë qytetarët shqiptarë, ndërkohë që, sa iu përket qytetarëve të përkatësisë maqedonase, për shembull në Maqedoninë Lindore, nuk kanë aspak informacion. Në fakultete duhet patjetër të ketë lëndë mbi kulturalizmin ose praktika rreth trajtimit të çështjeve në një shoqëri multi-kulturore” – thotë Musliu. Ai hedh madje tezën se

<sup>708</sup> Petreska-Kamenjarova jepte alarmin më herë të dytë të dështimit të mundshëm të një prej trajnimeve më të rëndësishme në fushën e medias – gjuhës së urrëjtjes. Në një email drejtuar të gjitha mediave të vendit (4 mars 2020), ajo apelonte për pjesëmarrje në seminarin 1-ditor të 6 marsit që kishte të bënte me gjuhën e urrëjtjes, seminar tepër i rëndësishëm në prag të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 12 prillit (të anuluar më vonë për shkak të krizës me virusin Korona). Përfaqësuesja e lartë e Agjencisë së Shërbime Audio dhe Audiovizuale pranoi madje se deri në datën 4 mars, vetëm një media kishte garantuar pjesëmarrjen e një gazetari në të. Dy ditë më vonë, erdhi njoftimi tjetër zyrtar për anulimin e këtij seminary, njësoj sikurse ndodhi edhe muaj më herët, i anuluar pikërisht për shkak të mosparaqitjes së gazetarëve dhe interesit të dobët ose pamundësisë së mediave për pjesëmarrje.

përveç pasurimit të programeve studimore, do të ishte mirë që fakultetet të lidhnin bashkëpunime edhe me gazetarë të etnive të ndryshme, të cilët të sillnin praktika të veçanta nga raportimi.

Stojan Tërçevski nga redaksia në gjuhën maqedonase thekson se përveç praktikës të gazetarët e rinj, një problem më vete përbën gjendja reale e katedrave të gazetarisë në universitetet e vendit. “Nëse këto katedra duan të kthejnë kohët e arta të studimit të gazetarisë, duhet të angazhohen që të freskojnë programet studimore në shumë fusha, jo vetëm lidhur me raportimin për tjetrin, por edhe të nxisin punën praktike të tyre, me përvoja që nuk i kishim parashikuar kur unë isha student. Asnjëherë nuk është vonë” – porositi Tërçevski.

Njohësja e raportimit mbi diversitetet Marina Tuneva thotë se programet studimore jo të përditësuar janë vetëm një nga faktorët për rënien e interesit për studimin e gazetarisë. Kjo rënie ka ardhur edhe për shkak të rënies së kredibilitetit të profesionit të gazetarit, në sytë vendorë, ata ndërkombëtarë (listimet mbi lirinë e medias) si dhe vetë publikut. “Si t’i lejojnë familjet fëmijët e tyre të ndjekin gazetari, diçka të cilës as ata vetë nuk i besojnë?!...” – pyet Tuneva – “... si mund ta nxitin fëmijën e tyre në një profesion që nuk ka sukses, që është i shtypur, i rrezikuar, që ka shantazhe, kërcënime, frikë, nuk është i vlerësuar si duhet për nga pagesa, që është nën ndikime e presione të vazhdueshme nga qendrat e pushtetit... Ky është rezultat i asaj që ka ndodhur deri tani. Kemi parë raportet e pushtetit me disa redaksi, dhe se si qasja e regjimit ka shkatërruar gjenerata të tërë.. dhe ato të ardhshme” – shton Tuneva.

Për sa i përket raportimit mbi diversitetet, Tuneva thotë se “kultura, mësimi për dallimet, inkluziviteti, diversiteti shoqëror në përgjithësi duhet të jenë pjesë e programeve studimore që nga mosha parashkollore e deri në vitet e studimeve. Po ashtu, institucionet shtetërore, media, biznesi, sektorit civil dhe çdo hallkë tjetër shoqërore duhet të mundësojë afirmim të dallimeve.”

7.1.2.5 Si mund të përmirësohet gjendja e raportimit për tjetrin në redaksitë tona? A mund të ndihmojnë trajnimet dhe seminarët e ndryshme?

Trajnimet dhe seminarët janë një nga format më të suksesshme të mësimin, të shkëmbimit të përvojave si dhe të sendërtimit formues të gazetarëve. Por, studiuesit thonë se edhe për trajnimet nuk ka interes të dyanshëm, aq më pak nga mediat të cilat janë të zhytura me raportimet ditore dhe nuk e kanë luksin të ndajnë gazetarë që të marrin pjesë në to, për shkak edhe të kushteve të punës, intensitetit, redaksive gjithnjë e më të varfra për nga numri i gazetarëve etj.

Zhaneta Trajkovska shpreh zhgënjim të madh lidhur me ndërmarrjen e reformave në sistemin e mediave. Ajo thotë se trajnimet ndihmojnë, por më parë duhen reforma rrënjësore. “Kemi një sistem të ngrirë mediatik i cili në tre vitet e fundit (2017-2020) nuk ka bërë asnjë reformë, si rezultat i mungesës së vullnetit nga krerët politikë apo partitë parlamentare. Kjo tregon se partitë, në fakt, duan një gazetari të tillë sikurse tani, një gazetari të keqe, e cila është plotësisht e varur nga qendrat e pushtetit... treg mediatik që nuk ekziston dhe klientelizëm të thellë mes pronarëve të mediave dhe partive politike” – thotë Trajkovska.

Studiuesi Sefer Tahiri thekson se trajnimet duhet të jenë tepër specifike, kushtuar së pari gazetarëve që merren me raportimin mbi diversitetet ose hulumtimet (gazetarëve investigativë). Trajnimet duhet të organizohen nga institucione relevante që merren me median dhe komunikimin, dhe jo nga Organizata Joqeveritare që raportimin për tjetrin e kanë thjesht një nga projektet e shumta që u sjell atyre para.

Dejan Georgievski thotë se ndihet sërish nevoja e trajnimeve në këtë prizëm, por në fokus të tyre duhet të jenë së pari shefat e mediave, redaktorët dhe pronarët, sepse një pjesë e mirë e politikës redaktuese varet nga *politika e pronarëve të televizioneve*, të cilët i shohin mediat si

mjet për mbështetjen e bizneseve të tjera që kanë, ose për mbështetjen e partisë që iu konvenon (në pushtet) për të rritur biznesin e tyre falë ndihmës nga ajo. Georgievski thekson se trajnimet, edhe pse të rëndësishme, shpeshherë dështojnë sepse asnjë redaktor nuk do që t'i humbasë gazetaret për 2 apo 3 ditë trajnime. Të njëjtin shqetësim e ngre edhe Emilija Petreska-Kamenjarova, e cila kujton se ka pasur raste të anulimit të trajnimeve nga Agjencia për Shërbime Audio e AudioVizuale për shkak se nga gjithë mediat e vendit, interes ka shprehur vetëm një ose dy prej tyre.

Snezhana Tërpevska thotë se vetëm trajnimet, nuk mund të ndihmojnë. Është çështje e integritetit dhe pavarësisë së politikës editoriale e secilit medium, në mënyrë që raportimi të jetë profesional dhe gjithëpërfshirës. “Gazetari punon në një ambient të tillë ku nuk mundet të vendosë çdoherë vetë se si do të duket kronika ose raportimi i tij. Së pari, media duhet të jetë e pavarur nga ndikimet e ndryshme, ndërsa më pas vetë redaksia dhe redaktorët duhet të kujdesen vazhdimisht që të kenë si synim profesionalizmin dhe raportimin për diversitetet” – thekson Tërpevska.

“Trajnimet luajnë rol të caktuar, por jo edhe kyç” – thekson Stojan Tërpevski nga TVM1. Ai kujton përvojën personale në televizionin ALSAT, një përvojë shumë e mirë për perceptimin e gjërave ndaj “tjetrit”, dhe me këtë, edhe *raportimin për tjetrin*. “Të jetojmë me njëri-tjetrin, dhe jo thjesht afër njëri-tjetrit!” – thekson ai. Tërpevski thotë se me rrëzimin e tillë të barrierave dhe me njohjen e problemeve arrihet më lehtë të synimi – raportimi profesional dhe objektiv për tjetrin... Kur në vendin tonë, lajmi kryesor në median që raporton në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe të jetë identik, të tregojë se nuk udhëhiqet nga interesat e njëjës apo tjetres etni por nga interesi i të gjithëve, atëherë do të jemi të pjekur që t'i ndajmë përfitimet në botën demokratike.”

Ndërkaq, Marina Tuneva thekson se përveç trajnimeve, programeve studimore, edukimit që në moshë të re, praktikës në redaksi etj., është mirë që redaksitë të nisin nga vetja, ta kenë “tjetrin” në mesin e tyre. “Të ketë diversitet të njerëzve... nuk është patjetër të jenë të punësuar nëse media nuk ka kushte, por të jenë bashkëpunëtorë, studentë, vullnetarë, të cilët do të angazhoheshin për të bërë emisione të gërshetuara bashkërisht” – thekson Tuneva. Duke iu referuar RTVM-së, dy redaksi nën të njëjtën çati me dallime në raportim dhe pa inkluzivitet, Tuneva thotë se për këtë fenomen nevojitet një analizë e detajuar. Ku është lidhja mes redaksive? Ku është shkëmbimi i përmbajtjeve? Ku është unifikimi i politikës së raportimit? Ku është bashkëpunimi i përgatitjes së një kronike bashkërisht mes gazetarëve maqedonas dhe shqiptarë? Nuk është puna që të kemi numra, shifra, minutat, të dhëna si recetë për “*pudding*”. Nuk mjafton! Ky bashkëpunim, përzierje në redaksi etj., në favor të raportimit për tjetrit, duhet të jetë si erëzat në çdo ushqim, duhet të jetë pasqyrim i të gjithë asaj që konsumojmë si opinion” – thekson Tuneva.

Petrit Saraçini përforcon këtë tezë të Tunevës kur thotë se redaksive tona iu nevojitet heterogjenizim. “Pa pasur shqiptarë në një televizion maqedonas si mund të raportohet për festa të caktuara si 28 Nëntori, Dita e Alfabetit, Festa e Bajramit etj. Si do të shkoni në Çair apo në ndonjë fshat tjetër që nuk ka kontakt me maqedonishten dhe flet vetëm shqip” – thekson Saraçini? “E njëjta vlen edhe anasjelltas!”

Me idenë e bashkëpunimit në raportim bashkëngjitet edhe Fatos Musliu nga redaksia në shqip e RTVM-së. Ai kujton projektin “Balkan Booster” të Deutsche Welle me gazetarë të rinj nga vendet e rajonit, të cilët shqyrtojnë tema mbi problemet në rajon. Për shembull, problemet me liqenin e Ohrit i trajton gazetari nga Greqia me atë nga Maqedonia e Veriut, ndërsa të njëjtin problem me liqenin e Shkodrës e trajton ai nga Mali i Zi me atë nga Kosova. Musliu, bazuar në



këtë përvojë të raportimit të diversitetit, thekson se “është vështirë të bësh bashkë dhe të menaxhosh realizimin e një kronike me dy gazetarë nga etni dhe vende të ndryshme, por rezultati përfundimtar është i dukshëm kur kemi raportim të mirëfilltë për tjetrin.

Këto përvoja dhe rekomandime që dalin nga qëndrimet e të intervistuarve janë thirrja më e qartë se në fushën e medias në Maqedoninë e Veriut ka nevojë për ndërhyrje.

...ka nevojë për rregullim ligjor, masa adekuate në vet-rregullim, reforma nga shteti, masa ndërgjegjësimit që duhet të burojnë nga vetë gazetarët, e shumë e shumë të tjera. Në Maqedoninë e Veriut, vend me karakteristika të veçanta multi-kulturore por edhe me një të kaluar konflikti, duket se zgjidhja më e mirë është të mësojmë për “tjetrin” dhe të mendojmë për të, njësoj siç edhe për veten. Nëse gazetarët dhe redaksitë do të udhëhiqeshin nga kjo premisë në raportime, atëherë në vend të urrejtjes do të ishin zgjidhur shumë probleme dhe do të shihnim përmirësim të cilësisë së jetës së përbashkët.

Me pranimin e dallimeve dhe karakteristikave që e bëjnë të veçantë çdo komunitet, gazetarët do të kontribuonin në një klimë po aq shumëngjyrëshe dhe të harmonishme nëse do të përdornin herë pas here edhe dozën e inkluzitetit.

Në fund të fundit, pa një Christiane Amanpour as CNN nuk do të shihej me kërshtëri nga iranianët. Nëse nuk do të ishte një Jao Ming në Huston Rockets, basketbolli nuk do të bënte miliona adhurues deri në Kinë.

Në Maqedoninë e Veriut mund të numërohen me gishta rastet e vetme të bashkëpunimeve në fushën e gazetarisë, ku gazetarë shqiptarë kanë dhënë kontributin e tyre në media në gjuhën maqedonase, sikurse Muhamed Zekiri në Kanal5, Naser Selmani në gazetën Vest, Lirim Dullovi dhe më pas Bekim Murati dhe Naim Vrenezi në televizionin A1 e A2.

## 8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

### 8.1 Konkluzione

As vetë Gutenbergu që shpiku makinën e printimit nuk ishte i ndërgjegjshëm se sa revolucionare do të ishte shpikja e tij, e aq më pak të imagjinonte asokohe se çfarë drejtimi do të merrte lajmi, gazeta dhe vetë gazetaria falë kësaj shpikjeje. Që nga viti 1453, njeriu tipografik do të evoluonte aq shumë, sa sot në shekullin XXI, ai rend pas klikimeve në internet për lajmin.

Rrugëtimi i teknologjisë dhe i gazetarisë shkoi krahpërkrah, edhe pse që nga makina e printimit, njerëzimi shpiku makinën me avull, elektricitetin, mjete më të sofistikuara pune, armatime dhe mbrojtje etj. Por, nëse ndjekim linjën e shpikjeve në telekomunikim, një pjesë e mirë e tyre u vu në shërbim të lajmit, sikurse telegrafi, telefoni, kamera, televizori e deri te interneti.

Hapësira dhe koha po ngushtohen aq shumë ditët e sotme, sa njerëzimi i është dorëzuar tashmë *glokalizimit*. Ky mentalitet i ri po e çon njerëzimin drejt *Evernetit*, hapit të ri ku teknologjia do të logjikojë vetë falë inteligjencës artificiale, për të qenë veçse e unifikuar me njeriun dhe nevojat e tij.

Lajmi, në formën se si transmetohet sot, mund të thuhet se ka pushtuar botën falë të ashtuaquajturës *www*. (world wide web), sistemit gjikand të miliarda kompjuterëve të lidhur online që tejçojnë informatën në të qindtat e sekondës. Gazetat, televizionet apo portalet informative kanë faqet e tyre në internet, ndërsa agregatorët e shumë të ndihmojnë në shtrirjen shumëfish të lajmit.

Përveç mjeteve klasike, rrjetet sociale janë tendenca më e re dhe akoma më e zëshme në shtrirjen e lajmeve, jo vetëm në kuptimin gjeografik por edhe drejt krijimit të botëkuptimeve, tjerres së tyre me komente, mendime, vënien në objekt të diskutimeve e ndonjëherë edhe thashethemeve.

\*\*\*

Maqedonia e Veriut, në historinë e saj të komunikimit masiv përfshin shumë gurthemele, që nga alfabeti cirilik i vëllezërve Kiril e Metodij në vitin 863, gazetat e para nga emigrantët maqedonas në Bullgari në vitin 1878, fotografia e parë me ngjyra nga emigranti Dimitrija Çupovski në Rusi në 1913, zyrtarizimi i maqedonishtes si gjuhë e maqedonasve në vitin 1944 nga Kuvendi i Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare si dhe kodifikimi i gjuhës letrare në 1945.

Por, periudha e gazetarisë dhe lajmit në Maqedoninë e Veriut nisi pas Luftës së Dytë Botërore kur ajo ishte në kuadër të Republikës Popullore Federale dhe më vonë Republikës Socialiste Federale Jugosllave. I ashtuquajtur *pushteti i katërt*, pavarësisht se ishte vegël e njëmendësisë së komunizmit dhe propagandës totalitare për të trumbetuar *forcën e masave*, nga shumë studiues konsiderohet prapëseprapë si një hallkë e pandashme e asaj se ku gjendet sot media jonë. Deri para Luftës së Dytë Botërore, Maqedonia ishte thjesht *Vardarska-Banovina* (Qarku i Vardarit) në kuadër të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene. Në dhjetor të vitit 1918 u krijua entiteti i ashtuquajtur *Jugosllavia*, gjithashtu mbretëri, e cila rezistoi deri në vitin 1929. Me lindjen e lëvizjes partizane, Tito shpalli *Jugosllavinë Federale Demokratike* e cila pas daljes nga Lufta e Dytë Botërore u shndërrua në *Republikën Popullore Federale Jugosllave*. Pikërisht në periudhën mes dy luftave, radioja ishte media kryesore për informim, ndërkohë që gazetat, sikurse u përmendën më sipër, mbaheshin nga emigrantë në Bullgari e gjetkë. Radio-Shkupi e kishte siguruar licencën në vitin 1931, dhe deri në vitin 1941 ajo ishte nën Ndërmarrjen Shtetërore të Radio-Beogradit, me transmetime që siç thonë kronikanët e kohës, synonin kolonizimin dhe asimilimin e maqedonasve.

Epoka e *“informimit të lirë”* nisi me lëvizjen për shtet komunist të Titos.

Fundi i vitit 1944 në Maqedoni shënoi themelimin e gazetës Nova Makedonija, si e para gazetë e vendit, organ i Frontit Popullor Çlirimtar të Maqedonisë. Menjëherë pas saj u çelën *“Birlik”* dhe *“Flaka e Vëllazërimit”* (1945). Po ashtu, në fillim të vitit 1945, Radio -Shkupi filloi për herë të parë transmetimet (3 orë e gjysmë në ditë) me punimet e Mbledhjes së Dytë të ASNOM-it. Pas çlirimit, ashtu sikurse ishin destinuar për veprimtarinë e tyre në fitoren e luftës dhe përzënien e pushtuesve, këto media mbetën organe të propagandës së pushtetit komunist e socialist. Kontrolli i plotë që zbatohet nga Komisioni për Censurë e Propagandë i PKJ-së nisi të zbutet disi pas vitit 1974, kur kushtetuta e re i dha pak frymim lirisë së informimit. Për herë të parë, neni 216 theksonte *lirinë e mendimit dhe përcaktimit*, neni 217 theksonte *lirinë e shtypit dhe formave të tjera të informimit* dhe neni 218 theksonte se *mediat... dhe mjetet e tjera të komunikimit e kanë për obligim që ta informojnë publikun në mënyrë të drejtë dhe objektive*.

Megjithatë, fakti që media financohej nga shteti, e bënte të pamundur çlirimin nga ndikimi shtetëror. Në mungesë edhe të kodit etik të gazetarëve, praktikave të punës, vetëdijes editoriale, por edhe për shkak të frikës së mbjellë nga sistemi i ashpër shtetëror që zbatonte përndjekje e burgosje, mediat mbajtën trasenë e vjetër. Ndarja e botës në dy linja të ashpra si dhe qëndrimi i palëkundër i Maqedonisë në Bllokun e Lindjes, tregoi qartë fatin e medias.

Rusia ishte maja e piramidës me teorinë e *agjitacion-propagandës*. Ish RSFJ-ja ndoqi të njëjtën linjë duke përdorur teorinë e *bashkim-vëllazërimit*, ndërkohë që Shqipëria zgjodhi

ndoshta formën më të ashpër të kontrollit mbi median, e nxitur nga teoria e vet-sakrificës dhe vet-izolimit pas *tradhëtimit të idealit komunist* nga Jugosllavia – siç akuzonte sistemi i Enver Hoxhës. Marrëdhëniet me Jugosllavinë u prishën që në vitin 1948, me BRSS-në në vitin 1960 ndërsa me Kinën në vitin 1975.

Megjithatë, falë vëzhgimit empirik të sjellë në këtë studim, kuptohet qartë se forma, struktura e lajmit dhe raportimi nuk ishte asgjë më shumë se sa *propagandë* e mediave të robëruara. Gazeta “Pravda”, “Zëri i Popullit” dhe “Nova Makedonija” kishin thuajse të njëjtat attribute. Në fokus ishte *mobilizimi i masave* sipas direktivave të partisë, si dhe përhapja e urrejtjes ndaj të ashtuquajturve *kapitalistë, revizionistë, imperialistë*. Kur bëhej fjalë për mobilizimin e masave, informacioni bartej me frymën nxitëse se si *kooperativistë heronj plotësonin dy ose tre herë më shumë normën ditore të punës*, ndërsa kur bëhej fjalë për propagandën, *merrnin dënimin e merituar të gjithë ata tradhtarë* që shfaqnin mendime dhe opinione që rrezikonin shtetin. Një vend tepër të gjerë zinin edhe lajmet nga bota – edhe ato të kontrolluara dhe përshtatura me analiza të ashpra ndaj vendimeve e deri edhe sjelljet shoqërore të vendeve perëndimore.

Në Maqedoni, në vitet 1968 kur zhvilloheshin demonstratat në Tetovë, media fliste gjuhën e shtetit i cili nuk pyeste për të drejtat e *kombësive*, sikurse quheshin në atë kohë komunitetet e tjera në vend. Shteti diktonte që kurrësi të mos devijojë nga teoria socialiste e *bashkim-vëllazërimit*. Edhe gazeta në shqip “Flaka e Vëllazërimit” i cilësonte *armiqësore* demonstratat si dhe vinte gishtin te *organizatorë të orientuar kundër fitoreve socialiste*, e madje i dënonte pa gjyq demonstruesit si *armiq të shtetit dhe reaksionarë*.

Pavarësisht ndryshimeve kushtetuese në vitin 1974, që në fakt theksonin se *kombësitë kanë të njëjtat të drejta dhe obligime sikurse kombi maqedonas*, se *secilës kombësi ose grup etnik i garantohet përdorimi i gjuhës dhe flamujve të vet*, si dhe se *komunat dhe shteti do të garantonin zhvillimin e shtypit, radios dhe televizionit edhe në gjuhët e kombësive*, përsëri ato nuk u përmbushën sipas ligjit, jo vetëm për shkak të represionit që vazhdonte por edhe për shkak të paaftësisë së udhëheqësve të atëhershëm shqiptar.<sup>709</sup> Për pasojë, edhe raportimi dhe klima në media, veçanërisht mbi komunitetet, mbeti e cunguar.

Ndryshimet kushtetuese të vitit 1990, në periudhën kur shpërbërja e Ish Jugosllavisë u përgjakë, i shkurtuan edhe këto të drejta që shqiptarët i kishin marrë nga kushtetuta e vitit 1974. Kushtetuta shpallte si gjuhë zyrtare vetëm maqedonishten, ndërkohë që neni 8 i saj që garantonte “*të shprehurit e lirë të përkatësisë kombëtare*”, kontestonte simbolet, nuk parashihte të drejta të arsimimit të lartë për shqiptarët, etj. Shqiptarët mbetën *nacionalitet* dhe jo faktor *shtet-formues* sikurse pretendonin. Po ashtu, ardhja e forcave nacionaliste në krye, thellimi i stereotipave ndaj shqiptarëve si dhe rastet e shtypjes me dhunë të kërkesave të shqiptarëve, bënë që edhe media të përçahej. Ajo asnjëherë nuk kishte raportuar në mënyrë gjithëpërfshirëse (inkluzive), as përpara konfliktit. Megjithatë, në vitin 2001, dalja e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare bëri që media të ndahej në dy taborë, shqiptare dhe maqedonase, ku secila raportonte në mënyrë të ndryshme, në mungesë të burimeve si dhe me gjuhë urrejtjeje. Mediat u shtuan në numër por raportimi i tyre mbeti i dirigjuar etnikisht.

Sikurse e pamë edhe nga vëzhgimi empirik, në këtë periudhë, Nova Makedonija u vu përballë Flakës. Njëra i cilësonte shqiptarët *terroristë* dhe udhëheqësit shqiptarë *tradhtarë*, ndërsa tjetra thoshte se UÇK-ja është formacion i *luftëtarëve të lirisë* dhe se sjellja e autoriteteve maqedonase ishte *represion*. Edhe në raportimin e mediave elektronike, pavarësisht se

<sup>709</sup> Qerim Lita, *Statusi i shqiptarëve pas vitit 1974*, TV Shenja, <<https://shenja.tv/statusi-shqiptareve-pas-vitit-1974/>>, [9.2.2020]

komuniteti shqiptar nuk kishte media të numërta sikurse komuniteti shumicë, ndeshej e njëjta gjuhë. Dallimi më i madh shihej në median publike, RTVM, e cila ndante të njëjtat studio, kamera etj., por raportonte e ndarë për nga bindja dhe sillte realitet të dyzuar. Jo vetëm struktura e lajmit, por edhe burimet, toni, përzgjedhja e fjalëve etj., përftonin dy realitete paralele për konfliktin, shoqërinë dhe jetën në Maqedoninë.

Marrëveshja e Ohrit dhe korniza e re juridike që iu imponua klasës politike në Maqedoni për më shumë të drejta shqiptarëve, në fakt i zgjeronte por nuk i barazonte këto të drejta (natyrore që nga lindja). Megjithatë, në këtë periudhë të brishtë, perëndimi, i cili kishte lehtësuar dhe ndihmuar në arritjen e kësaj marrëveshjeje, *investoi* edhe në media me projekte dy-gjuhësore dhe gjithëpërfshirëse që do të ndihmonin në këtë mënyrë komunitetet në njohjen më të mirë mes tyre dhe në krijimin e një klime më të mirë bashkëjetese.

Që në vitet 1990, Kushtetuta e re mundësonte që cilido qytetar mund të themelonte institucione të informimit publik (neni 16, kushtetuta e vitit 1991) ndërkohë që vite më vonë, “Instituti për Shoqëri të Hapur” i filantropistit Xhorxh Soros ndihmoi financiarisht mbi 50 operatorë transmetues. Në periudhën 1991-2001, më shumë se 250 operatorë u themeluan në Maqedoni. Megjithatë, lulëzimi i mediave në gjuhën shqipe ndodhi më vonë, i nxitur nga konflikti i vitit 2001 dhe i ndihmuar më vonë nga jashtë (edhe televizionet kryesore shqiptare sot në Maqedoninë e Veriut janë ALSAT, TV21, Klan-Maqedoni, si degë nga Shqipëria e Kosova). Aktualisht, arena transmetuese e vendit numëron 158 operatorë.

Megjithatë, nëse në periudhën komuniste, dirigjimi ishte përmes shtetit – falë financimit por edhe kontrollit të drejtpërdrejtë nga Komiteti për Propagandë – në periudhën e re u krijua një fenomen i ri, media pluraliste por jo të pavarura. Pronarët e mediave të reja pas pavarësisë së vendit, vinin kryesisht nga radhët e *privatizuesve të fuqishëm* dhe sigurisht kishin krahë të forta në politikë. Kjo marrëdhënie e dyanshme, ku pronarët e mediave synojnë të lidhen më shumë me politikën për të pasur stabilitet dhe prosperitet me bizneset e tyre, dhe nga ana tjetër ku politika synon të vendos nën kontroll fjalën e lirë, median por edhe bizneset, vetëm ndryshoi formën e marrëdhënies media-politikë, por jo edhe çlirimin e medias nga ndikimi, të rriste lirinë e fjalës, raportimit etj.

Në periudha të vrazhda politike, sikurse vërtetua më sipër, kur politikës i konvenonte (veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore, gjatë ngjarjeve të mëdha apo për interes të politikave të antikitetit etj.,) mediat që ajo kontrollonte falë biznesit nuk shqetësoheshin aspak për propagandën e komanduar. Madje, i njëjti tekst i komanduar nga partia ose qeveria shfaqej njëzëri në disa media.<sup>710</sup> Fenomene të gjuhës së urrejtjes, shpifjes, lëndimeve, si dhe krijimit apo thellimit të stereotipave, ishin aq të zakonshme sa jo vetëm realitetet mediatike ishin të dyzuara, por edhe shoqëria ndahej përmes Vardarit.

Ndërhyrja më flagrante e politikës në kontrollin e mediave ishte veçanërisht gjatë periudhës së VMRO DPMNE-së, me gazetatat e grupit WAC, pastaj edhe me vendosjen nën kontroll të televizioneve Kanal5, Alfa, e kështu me radhë.

Po ashtu, kjo “përndjekje” e *gazetarisë së lirë*, përndjekjes së gazetarëve me përgjime (siç u vërtetua nga afëra masive e përgjimeve), përndjekjes me gjykime jo të drejta gjyqësore etj., e sollën median në një gjendje që, në listat e institucioneve ndërkombëtare të radhitej me shtete afrikane. Po ashtu, organet rregullatore dhe vet-rregullatore ishin në gjendje të mjerueshme. Kodi i Gazetarëve u shkrua për herë të parë si një akt iniciator për vet-rregullim në vitin 2001. Ndërsa në periudhat e ashpra politike, përveç Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, kishim edhe

<sup>710</sup> Ilustrim nga “*Sabotazhi*”, rubrika satirike e autorit Sreçko Popovski, në emisionin 360 gradë në ALSAT. SABOTAZA br.99 18/05/15, <<https://www.youtube.com/watch?v=p3clqWq1ac4>>, [16.02.2020]

shoqata paralele që vepronin me gazetarë nga *mediat pushtetare*, për të bërë oponencë brenda llojit (gazetarëve).

Po ashtu, ligjet dhe veprimtaritë që rregulloheshin nga shteti, ishin gjithnjë të njëanshme dhe në favor të *të përkëdhelurve* të pushtetit, e jo të fjalës së lirë. Siç u theksua edhe më sipër, deri në 2015, Ligji për Veprimtari Radiodifuzive kishte një sërë të metash, veçanërisht lidhur me televizionin publik RTVM dhe këshillin e saj drejtues, lidhur me radiodifuzerët privatë dhe koncesionet që jepeshin me pëlqim nga qeveria.

Epoka e ndryshimeve ligjore në media njeh përpjekjet e ekspertit të huaj Vanhoutte, që nga viti 2013, por zgjidhja ligjore për mediat do të vinte vetëm në vitin 2018 pas ndryshimit të pushteteve. Pavarësisht interesit të shprehur për një situatë më të favorshme për raportimin e lirë, fatkeqësisht as BE-ja nuk ofron një zgjidhje kontrolluese për median e vendit, sikurse jemi mësuar në Ballkan që zgjidhja të vijë me zarf nga të huajt. I vetmi legjislacioni i BE-së është direktiva “*Aktivitetet transmetuese televizive: Televizion pa kufij*” – një udhëzues që thekson programet nga shtetet anëtare të BE-së, frymën e *diversitetit kulturor, mbrojtjen e të miturve* etj., por jo edhe rregullimin mediatic të vendeve paraqasëse. Është vetëm legjislacioni vendor dhe vullneti i aktorëve mediaticë që media të jetë plurale, të promovojë diversitetin kulturor, t’i thotë “stop” gjuhës së urrejtjes, të çlirohet nga ndikimi politik, i biznesit, i grupeve të interesit e kështu me radhë.

\*\*\*

Edhe gjendja e sotme nuk është ajo e duhura në media. Në studimin empirik për këtë studim shkencor, dolën në pah raste të theksuara të gjuhës së urrejtjes, por edhe fakti tjetër se si politika e ka përdorur median për to, si një mashë për sjelljen e shoqërisë në prag konflikti, ndarje e përçarje.

*Ngjarjet në Kalanë e Shkupit* na treguan ndarjen e thellë të mediave, e cila shkeli normat etike, jo vetëm të gazetarisë por edhe misionin e saj për tolerancë, të parashikuar në ligjin për radiodifuzion (tani, ligji për Shërbime Audio dhe Audiovizuale). Ndërsa mediat maqedonase bënin vlerësime *nervoze* mbi ngjarjet dhe nuk kërkonin llogari ndaj tendencave për antikitet të VMRO DPMNE-së (uzurpimet e historisë dhe kulturës së të tjerëve), ato shqiptare nuk kërkuan asnjëherë përgjegjësi nga partia shqiptare që ishte në koalicionin qeveritar dhe që kishte votuar në Qeveri jo vetëm gërmimet, por edhe ndërtimin e objektit të diskutueshëm (kishë apo muze) në Kalanë e Shkupit. Shumë media pranonin ndërkohë se ishin pa përvojë, me gazetarë të rinj, pa një kod të caktuar që t’i ndihmonte me mënyrën e menaxhimit të situatave të ndjeshme etnike sikurse ngjarjet në Kala.

Realitete të dyfishta do të paraqiteshin edhe në *ngjarjet e Smillkovës*. E nxitur nga zyrtarët politikë në qeveri, media mori si të mirëqenë faktin se vrasësit ishin shqiptarë, terroristët e zakonshëm në shtet, islamikët dhe keqdashësit e bashkëjetesës fetare, ndërkohë që e përgjithësuan kështu gjithë komunitetin shqiptar. E pakujdesshme në këto epitete, si dhe në mosrespektimin e pafajësisë (prezumimin) duke shfaqur emra dhe fytyra të femrës shqiptare që shoqëroheshin në pranga nga policët në sy të kamerave, media maqedonase nxiti tonet, ndërsa ajo shqiptare tentonte t’i kundërvihet për këto përgjithësime por më kot, pasi dominimi i mediave maqedonase diktonte edhe kontrollin e opinionit publik. Sërish u shkelën parimet e raportimit në kushte të caktuara në shtete multi-etnike, multi-fetare dhe multi-kulturore siç është Maqedonia e Veriut. Përveç ndasisë në “ne” dhe “ata”, televizioni publik sërish shënonte rastin më të qartë të paraqitjes së dy realiteteve. Po ashtu, u shënua edhe fenomeni i ri, ai i vendosjes në *heshnje të*

*disa detajeve*; TVM1 i minimizonte bllokadat në fshatrat shqiptare, ndërsa TVM2 nuk raportonte për protestat që zhvillonte komuniteti maqedonas. Doli në pah edhe fenomeni i *viktimizimit*. Mediat maqedonase shfaqnin ndjenjën se ishin viktima të akteve terroriste e islamike, ndërsa ato shqiptare theksonin se ishin viktima të institucioneve shtetërore që dirigjonin (montonin) raste të tilla.

Rasti me *Karnavalet e Vevçanit* vetëm se ndryshoi temë por jo edhe fenomenin. Në këtë rast doli në pah akoma më shumë kriza ndërjetare në vend, si dhe heshtja e institucioneve. Nëse në rastet e mëparshme politika ishte aktive në ndezjen e gjakrave, në këtë rast, institucionet nuk vepruan sipas ligjit (detyrës zyrtare). E vetmja thirrje që vinte nga politika ishte ajo e uljes së toneve dhe respektimit të bashkëjetesës. Mediat shqiptare kapeshin te ofendimi ndaj besimit islam dhe etnisë shqiptare, ndërsa ato maqedonase te aktet se në protestat e besimtarëve digjej flamuri maqedonas. Në median e shkruar, lajmi i kalonte format e komentit duke shkruar deri në trillime, që e përgjithësonin reagimin e besimtarëve myslimanë me familjen shqiptare, kanunin e Lekë Dukagjinit apo rrymat islamike terroriste nga jashtë, ndërsa gazetatat shqiptare hiqnin paralelet për “*skenarë hitleriane*”. Politika, kësaj here qëndronte anash, edhe pse Karnavalet e Vevçanit financoheshin nga Ministria e Kulturës ndërsa agjenda dhe numrat që luhen nga grupet pjesëmarrëse në karnavale, nuk kontrollohen por janë veprimtari e lirë e pjesëmarrësve.

*Vdekja e 4 vjeçarit Almir Aliu*, pavarësisht se ndodhi në vitin 2016 dhe nuk përkonte me ndonjë krizë politike, sërish nxorri në pah stereotipat e krijuara prej kohësh në shoqërinë multi-etnike të Maqedonisë së Veriut. Videoja e përplasjes me makinë të të miturit, edhe pse nuk e bindi gjykatën si provë materiale, duket se bindi median e cila e cilësoi atë si akt makabër. Media maqedonase, në kuadër të *viktimizimit* e dënoi aktin si krim ndaj një të mituri, ndërsa media shqiptare tentonte të vihej në mbrojtje të familjes së viktimës duke iu kundërvënë organeve të drejtësisë për një sërë shkeljesh në hetim dhe gjykim, si dhe madje, për pazaret politike që bëheshin rreth rikualifikimit të veprës së autorit të krimit. Kishte raste që ndonjë media, sikurse Kanal5, të kishte shkrime me thirrjen që rasti të mos përdorej si *mosdurim etnik*. Kjo nuk tregonte asgjë tjetër veçse viktimizimin për shkak se, siç tregohet në studimin e rastit, mediat kombëtare maqedonase nuk ishin të pranishme as në dhënien e verdiktit nga ana e gjykatës, ndërsa lajmi mori shumë pak jehonë vetëm në portale. U dallua fenomeni i moskonsistencës, ai i mosndjekjes në mënyrë të vazhdueshme të rastit, që nënkuptonte se media maqedonase synonte ta vendoste në rrogoz atë. Media u tregua *emotive* kur autori i veprës penale i ngriti gishtin e mesëm familjes së viktimës apo kur kërcënoi vetë gazetarët, duke shprehur neverinë që më shumë vërtetonte tezën që synonte të justifikonte edhe pala mbrojtëse, se autori kishte probleme psikike. Pavarësisht tendencës së mediave maqedonase për një realitet më të zbutur, mediat shqiptare nga ana tjetër shkelën kodin duke theksuar jo vetëm identitetin etnik të viktimës, por edhe duke lëshuar deklarata që pavarësisht se nuk përbënin thirrje të drejtpërdrejta, linin hapësirë në përgjithësimin e autorit me komunitetin maqedonas.

Gjuhë urrejtje u gjet edhe në vitin 2018, në trazirat sportive mes grupeve të tifozëve në Tetovë. “*Ballistët*” e ekipit “*Shkëndija*” iu kundërpërgjigjën me marshime dhe parulla ofenduese “*Vojvodëve*” të ekipit “*Teteksi*”, të cilët një natë më herët, në 30-vjetorin e themelimit të tyre thërrisnin ofendime ndaj komunitetit shqiptar dhe u përplasën me një grup të rinjsh duke dëmtuar edhe një dyqan. Media raportoi sërish në mënyrë të ndarë. Natën kur grupi i vojvodëve dhe të nesërmen kur policia nxorri njoftimin zyrtar me pasojat, media maqedonase heshti. Ishte media shqiptare ajo që ngriti zërin. Ndërsa, të nesërmen kur ballistët dolën në marshim si kundërpërgjigje, media shqiptare në përgjithësi heshti (kjo ndodhi edhe me ALSAT i cili nuk e ndoqi aspak ngjarjen) ndërsa media maqedonase doli me tone të ashpra për gjuhë urrejtje, shkelje

të bashkëjetesës etj. Rasti më i qartë i shkeljeve u shënua me televizionin lokal Koha i cili përmes raportimit të pabalancuar nxiste jo vetëm urrejtjen por madje trumbetonte nëpërmjet gjuhës me pathos në raportim se *kush është zot i Tetovës*. Ndërsa lidhur me dëmtimet që bënë tifozët shqiptarë, nuk përmendte asnjë fjalë.

Megjithatë, sikurse vërehet edhe në studimin e rasteve, pavarësisht se stereotipat janë ende në mes të shoqërisë, vërehet fakti se ndërhyrja gjithnjë e më pak e politikës në këto raste, ka kontribuar në një klimë jo aq të tensionuar që mund të shkaktonte akte të rënda dhune. Rastet janë rralluar në numër, por gjithashtu edhe në intensitet. Studimi nxjerr në pah edhe faktin se media nuk i ka kushtuar shumë vëmendje rasteve shoqërore dhe etnike, por viteve të fundit ka ndjekur kryesisht *agjendën e madhe* me temat e rëndësishme si Marrëveshja e Prespës, Referendumi, samitet e BE-së për datën e negociatave e kështu me radhë.

\*\*\*

Fenomeni i raportimit të dyzuar, edhe pse nuk është i njohur si i tillë në terminologjinë shkencore të gazetarisë (sikurse thotë edhe studiuesja Tërpevska) fatkeqësisht ekziston jo vetëm në shoqërinë tonë në Maqedoninë e Veriut, por në të gjitha shoqëritë multi-etnike, multi-fetare dhe multi-kulturore. Në intervistat e realizuara me drejtues institucionesh rregullatore, vet-rregullatore dhe ekspertë të medias, pranohet ideja se raportimi mediatik në Maqedoninë e Veriut përfton dy realitete të ndryshme, sikurse gjatë periudhës së monizmit, asaj gjatë luftrave që shoqëruan shpërbërjen e Ish-Jugosllavisë, para-konfliktit, gjatë-konfliktit dhe pas-konfliktit të vitit 2001. Ky raportim i dyzuar ekziston edhe sot, por ai ndryshon formë bazuar në rrethanat, ndërhyrjet politike, lidhjes së biznesin, influencës së grupeve të caktuara, mungesës së mjaftueshme të edukimit të gazetarëve etj.

Në pyetjen se “*Sa e njohin mediat në Maqedoni konceptin e raportimit të dyzuar si dhe raportimit për tjetrin?*”, shumica e të intervistuarve thonë se gazetarët duhet të jenë të njohur tashmë me fenomenin, falë përvojave të marra nga situata të ndryshme, falë njohjes së standardeve gazetareske përmes Kodit Etik, falë trajnimeve të ndryshme (edhe pse në numër të vogël) etj. Edhe pse Tërpevska thotë se *ka vetëm një raportim*, sikurse edhe standardet janë një dhe të vetëm, të tjerë autorë si Tuneva e Tahiri theksojnë se raportimi i dyzuar i ka rrënjët te politika. Kur flasim për periudhat para konfliktit, Georgievski e Saraçini theksojnë se ishte faji i nacionalistëve që nxiti etnocentrizmin, patriotizmat dhe ndasitë ndaj etnive. Fenomeni pranohet edhe nga Tërpevska e Musliu (përgjegjës të informimit në RTVM), redaksitë e të cilëve raportin/raportojnë ende të ndarë në qëndrime. Si arsye për këtë fenomen, Tuneva që drejton institucionin më të rëndësishëm në sferën e vet-rregullimit të medias – Këshillit të Etikës në Media – thekson se janë së pari *bindjet e vjetra* të bartur nga stereotipa të ndërtuar prej një kohe të gjatë, reflektimi i rrethanave dhe pronësisë që media tregon ndaj *shikuesit të saj besnik*, reflektimi i brendshëm i *redaksive që mbeten ende të pastra* etnikisht (përveç atyre shqiptare që transmetojnë në dy gjuhë), *tregu jo-përpjestimor* i medias si dhe *mungesa e financimit të gazetarisë* së duhur – jo thjesht objektive por edhe përfshirëse. Megjithatë, të gjithë studiuesit shprehin nevojën e ndryshimit dhe se mediat duhet të raportojnë në frymën e tolerancës dhe bashkëjetesës, si dhe interesit përfshirës të shoqërisë.

Në pyetjen se “*Sa përpjekje bëjnë redaksitë që të jenë të kujdesshme për sa i përket raportimit për tjetrin dhe sa e njohin gazetarët dhe redaktorët konceptin e gazetarisë që raportin objektivisht për tjetrin?*”, vetëm Tahiri ka qëndrim më të ashpër. Ai thotë se redaksitë nuk e kanë prioritet raportimin për tjetrin, dhe madje, gazetarët dhe redaktorët e njohin shumë pak

raportimin për tjetrin. Tërpevska bën dallimin se ekzistojnë shumë lloje raportimesh, dhe ndonjëherë, raportimi objektiv nuk do të thotë raportim për tjetrin. Po ashtu, edhe Tuneva thotë se gazetarët mund t'i përmbahen standardeve, por kjo nuk është e mjaftueshme për të thënë se me këtë përmbushet edhe raportimi për tjetrin. Tërpevska edhe Tuneva theksojnë idenë e raportimit përfshirës, jo thjesht raportim objektiv për tjetrin. *“Duhet të raportohet për tjetrin, njësoj sikur ai tjetri të ishte ti!”* Studiuesit tërheqin vërejtjen se pronarët e medias duhet të heqin dorë nga bisedat (politike) që dëgjojnë nëpër kafene, por të fokusohen te informimi përfshirës për hallet e të gjithëve njësoj, përderisa ndajmë të njëjtat probleme dhe jetesë. Tërpevski e Musliu ndajnë qëndrime të ndryshme; njëri thirret në nevojën për më shumë ndërgjegjësim ndërsa tjetri fajëson autocensurën. Saraçini nga ana tjetër thotë se çdo gazetar ka kaluar tashmë nga një lloj trajnimi, i cili do të ishte i mjaftueshëm për ta, për të raportuar objektivisht dhe në mënyrë përfshirëse për tjetrin. Ndërkaq, Trajkovska e Georgievski ngrënë shqetësimin se nëse mediat e mëdha bëjnë sadopak përpjekje, mediat online janë ende në një kaos total, dhe mbeten burim i urrejtjes dhe stereotipave ndarës dhe dallues në shoqërinë e vendit.

Në pyetjen se *“Në çfarë mase arrin Kodi i Gazetarëve që të sigurojë raportim të balancuar?”*, studiuesit ndajnë qëndrimin: *“jo mjaftueshëm!”*. Tuneva nga Këshilli i Etikës dhe Kamenjarova nga Agjencia për Shërbime Audio e Audiovizuale thonë se Kodi i Gazetarëve – si udhërrëfytes – ofron bazën të mirë për raportim të saktë, tolerant etj., por nuk garanton frymën inkluzive të raportimit, duke marrë për bazë kulturën e komuniteteve që jetojnë në Maqedoninë e Veriut. Të gjithë studiuesit shprehin njëzëri se Kodi ka nevojë për përmirësime, jo vetëm në frymën e praktikave të përjetuara në të kaluarën por edhe në përshtatjen me rrethanat e reja, veçanërisht mbi mediat online. Tuneva, Tahiri, Saraçini etj., thonë se në raportim nuk mjaftojnë vetëm palët, si numër, por në kronika ose artikuj duhet të inkorporohen edhe burime ose ekspertë të komuniteteve të tjera që do të tregojnë se çdo komunitet ka njerëz intelektualë, çdo komunitet e ndjen njësoj situatën dhe ndan të njëjtat shqetësime si cilido komunitet tjetër etj. Një gjë e tillë do të përmirësonte bindjet se “tjetri” është po aq i barabartë sikurse “ti”. Kur flitet për Kodin e Etikës, Kamenjarova e Saraçini ndajnë qëndrime të blinduara se Këshilli i Etikës në Media duhet të ketë jo vetëm më shumë pushtet, por edhe tone të dispozitivit ndëshkues (gjoha simbolike) ose të demaskimit të gazetarëve dhe mediave që i shkelin standardet. Në kushtet e sotme, Këshilli i Etikës i zbulon shkeljet, por nga ana tjetër, mediat nuk janë mjaftueshëm të ndërgjegjshme ta marrin përsipër fajin ose përgjegjësinë për shkeljet, dhe e fshehin vendimin ose nuk e publikojnë atë, sikurse thotë kushtetuta (neni 16), Ligji i Medias (nenet 17, 18 dhe 19), Kodi Penal etj në dispozitat për korrigjimin e lajmit. Nga ana tjetër, Trajkovska shkon më tej duke theksuar se përveç Kodit Etik dhe standardeve botërore, redaksitë duhet të krijojnë edhe parimet dhe kodin e tyre redaksional (gjë të cilën thuajse asnjë media në vend nuk e ka).

Në pyetjen se *“Sa hapësirë gjen raportimi për tjetrin në programet studimore universitare të gazetarisë dhe komunikimit?”*, të gjithë shprehin pakënaqësitë e tyre mbi nivelin arsimor të gazetarisë. Ata thonë se së pari, universitetet tona nuk i kushtohen më gazetarisë, raportimit, etikës në raportim etj., por më së shumti merren me studimin e komunikimit të gjerë, komunikimit ndërkombëtar dhe njohurive të përgjithshme politike e ekonomike. Sipas Tahirit, pavarësisht se ekzistojnë lëndë si “Komunikimi Ndërkulturor”, nuk ekziston lëndë e mëvetësishme e “Raportimit të Diversiteteve”, aq e nevojshme për vendet shumë-etnike e shumë-kulturore. Duke vendosur theksin te rënia drastike e interesit për të studiuar gazetari, përveç devijimit të programeve studimore, të gjithë të intervistuarit thonë se për aq kohë sa sfera më të rëndësishme në këtë fushë nuk rregullohen, atëherë numri i të të regjistruarve për këtë degë, do të jetë i vogël. Ata kërkojnë ndërhyrje urgjente në programet studimore, në rikthimin e



gazetarisë dhe raportimit si një drejtim i mirëfilltë, investime më të mëdha në këtë fushë, si dhe mundësisë që edhe vetë mediat të ofrojnë redaktorë me përvojë, të gatshëm për të zhvilluar trajnime me gazetarët e rinj lidhur me praktikën në raportimin mbi diversitetet (Saraçini). Përkeqësimi i situatës së medias, dhe rangimi i lirisë së saj në raportet ndërkombëtare, e arsyetojnë qartë pozitën reale të programeve studimore, të presioneve politike, të mosvlerësimit financiar të duhur të punës së gazetarëve, sipas Tunevës. Të gjithë shprehën njëzëri se multikulturalizmi, si lëndë, duhet të mësohet që në sistemin parashkollor në vendin tonë.

Në pyetjen se “Si mund të përmirësohet gjendja e raportimit për tjetrin në redaksitë tona?”, të gjithë ekspertët vlerësojnë se trajnimet dhe seminarët janë një nga format më të mira në kuadër të këtij qëllimi. Në mungesë të programeve studimore universitare apo programeve profesionale për gazetari, Georgievski thekson se veç gazetarëve, trajnim duhet të ketë edhe për krerët e mediave, pasi politika editoriale realisht varet vetëm nga ata. Trajkovska shkon më tej, duke thënë se trajnimet ndihmojnë, por medias i nevojiten reforma rrënjësore. Pranohet njëzëri se gazetarët duhet të punojnë pa presion, si dhe të trajnohen herë pas here, lidhur me raportimin e diversitetit. Shumë media nuk e kanë luksin të dërgojnë në trajnime gazetarët, por, sipas ekspertëve, një zgjidhje adekuate mund të gjendet – fryma e diversitetit mund të mësohet dhe edukohet edhe në redaksitë e mediave, të cilat nuk duhet të jenë të pastra etnikisht. Për të raportuar për çështje etnike ose kulturore, duhet të ketë edhe gazetarë të komuniteteve të tjera. Kjo nuk ndihmon vetëm në raportim, por edhe në një redaksi më heterogjene dhe shuarje të stereotipave edhe mes vetë gazetarëve. Praktikën më të mira të përmendura janë televizioni ALSAT dhe përpjekjet që bëjnë redaksitë shqiptare në përgjithësi.

\*\*\*

Në këtë studim dhe me konkluzionet e deritanishme vërtetohet hipoteza kryesore se;

*Mediat në Maqedoni krijojnë realitete të ndryshme nga raportimi për ngjarje të njëjta!*

Rastet e marra në shqyrtim në këtë studim hodhën dritë mbi format e raportimit të mediave, si dhe paraqitjen e realiteteve të dyzuara nga ato. Në periudhën e monizmit, ky fenomen ishte krejtësisht ndryshe, me dallimin se për një ngjarje të caktuar shfaqej vetëm një realitet (mediat në shqip dhe maqedonisht kishin të njëjtët tekste), për shkak të vendosjes nën kontrollin e propagandës së regjimit... Ndërsa në periudhën e pas-pavarësisë e deri më sot, kemi fenomenin që për një ngjarje të caktuar shfaqen dy realitete, varësisht politikave nacionaliste, stereotipave të krijuar prej kohësh e kështu me radhë. Ky lloj raportimi dikton që qytetarët e etnive të ndryshme të krijojnë perceptime të ndryshme mbi të njëjtën ngjarje, e për rrjedhojë botëkuptime të ndryshme që thellojnë ndarjen dhe nuk promovojnë gjithëpërfshirjen shoqërore.

Po ashtu, vërtetohen edhe hipotezat ndihmëse;

*Politizimi i medias ndikon thekshëm në politizimin e dimensioneve të tjera të shoqërisë, dhe anasjelltas!*

Në rastet e shqyrtuara por edhe nga intervistat e realizuara vërtetohet se sa më e madhe të jetë ndërhyrja politike në media dhe diktimi i agjendës redaksionale në to, aq më fort tejçohen politikat e njëanshme shtetërore, aq më fort nxitet patriotizmi i rrejtshëm, aq më fuqishëm

theksohen stereotipat dhe po aq urrejtje transmetohet poshtë në nivelin shoqëror. Politizimi i shoqërisë është reflektim që nxitet nga politika por gjithashtu, i kthyeshem te politika. Në rast të politikave mono-etnike apo thellimit të stereotipave dominuese e etnocentrike, komunitetet e një vendi shumë-etnik e shumë-kulturor kanë gjasa gjithnjë e më të mëdha për të manifestuar ndarje, akte dhune e madje edhe konflikte.

*Raportimi mediatik i njëanshëm dhe prodhimi i realiteteve paralele krijojnë tendosje dhe forma të tjera irritimi mes etnive në vend!*

Rastet e numëruara më sipër na treguan qartë se gjuha e urrejtjes e përhapur nga media apo edhe vetë politika, nuk ka përfunduar aty.... Ajo është instrumentalizuar me akte të pakëndshme dhe përparje shoqërore. Aktet e tilla kanë përfshirë protesta, grafite, sulme me gurë, djegie dyqanesh, djegie flamujsh, rrahje mes të rinjve, sulme ndaj grupeve të caktuara, rrënim institucionesh, vrasje, mosdurim ndëretnik etj. Këto rrjedhoja, duhet të jenë gjëja e parë që media duhet të mendojë përpara se të raportojë në mënyrë të dyzuar apo të ndjekë në mënyrë të verbër politikën e pushtetit.

*Në sferën e medias nevojitet vet-rregullim, si mekanizëm për avancimin e cilësisë së informimit.*

Pasi vërtetua një sërë problemesh që ndërlidhen me median, por edhe kornizën ligjore dhe dispozitivin ndëshkues, si dhe faktin që portalet nuk llogariten ende si media, gjithnjë e më shumë rritet nevoja për vet-rregullimin, forcimin e institucionit kryesor – Këshillin e Etikës në Media – si dhe respektimin e vendimeve të këtij organi. Vet-rregullimi nuk mund të funksionojë kështu si është, pa një fuqi më të madhe ndëshkuese dhe demaskimi të gazetarëve ose mediave që shkelin etikën dhe standardet e gazetarisë, e aq më shumë të ngjallin urrejtje, të shpalosin shpifje apo edhe të lëndojnë ndjenjat e komunitetit të caktuar, grupeve të ndryshme, apo edhe individëve të caktuar

## 8.2 Rekomandime

Kur ky studim u inicua, qëllimi kryesor ishte ai i vërtetimit të një sërë fenomeneve, së pari atë të raportimit të dyzuar, atë të gjuhës së urrejtjes, të ndarjes së komuniteteve, monitorimit të politikave të shtetit, ndërhyrjes së shtetit, interesi i bashkëjetesës në vend si dhe interesi dhe prosperiteti i shoqërisë sonë të përbashkët drejt strukturave euro-atlantike. Maqedonia e Veriut është një shtet me karakteristika të veçanta krahasuar me shtetet e tjera; është një shtet multi-etnik, multi-kulturor dhe multi-fetar, e madje, ka një traditë tepër të gjatë me këto tipare. Por, pavarësisht kësaj tradite, vendi përballlet ende me dilema të cilat vënë në pikëpyetje tolerancën, bashkëjetesën, të ardhmen e përbashkët, përparimin e shtetit dhe shoqërisë. Media, si pushtet i katërt, është një nga aktorët më të fuqishëm që mund/duhet të kontribuojë, pasi, për nga vizioni që shpalos përmes misionit të saj, duhet t'i kontribuojë bashkëjetesës, tolerancës, e madje, të jetë e aftë që të dënojë në mënyrë të pavarur politikën e gabuara, fenomenet negative, stereotipat, si dhe të ofrojë një pasqyrë "inkluzive dhe solucioniste" (gjithpërfshirëse dhe të ofrojë zgjidhje) për fenomenet me të cilat përballemi, falë edhe karakterstikave që ka shoqëria jonë. Diversiteti duhet të na bashkojë, dhe jo të na ndajë!

Por, sikurse pamë nga praktikat e deridjeshme, media nuk e kryen si duhet misionin e saj. Nuk është vetëm media, si faktor, por edhe për shkak të rrethanave dhe ndikimeve që vijnë nga faktorë të tjerë institucionalë, jashtë-institucionalë, biznesorë etj. Më poshtë, ofrohet një listë rekomandimesh që mund ta ndihmojnë median të jetë më e ndërgjegjshme në misionin e saj.

*Respektim i burimeve dhe palëve* – kjo është një nga shkeljet bazike që është vërejtur më së shpejti në bërjen e lajmeve në disa media. Në periudha të caktuara, ato kanë marrë vetëm një palë, dhe kanë ofruar një realitet ndryshe ose të pakompletuar.

*Respektim i Kodit të Etikës* – shumë media ende nuk e respektojnë si duhet Kodin e Etikës, i cili thekson se gazetari nuk mund të krijojë apo përpunojë të dhëna që cenojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, nuk duhet të përdorë gjuhë urrejtoje, të nxisë dhunë apo diskriminim, mbi çfarëdolloj baze, të respektojë privatësinë e personit, prezumimin e pafajësisë, të bëjë dallim mes lajmit dhe komentit etj. Nga sa pamë më sipër, mediat jo vetëm që kanë shpalosur emra, kanë treguar para kamerave persona, fajësia e të cilëve nuk është provuar ende

*Ndryshime të Kodit të Etikës* – praktikat e deritanishme të raportimeve kanë treguar të paktën dy të meta madhore, njëra ka qenë mospërfillja aspak e nenit 11, ajo e respektimit të standardeve të pranuar shoqërore që kanë të bëjnë me respektimin e dallimeve etnike, kulturore dhe fetare në Maqedoni, dhe së dyti, mosparashikimi i sjelljes së mediave online, dhe përshtatja e tyre me një kornizë të qartë ligjore (siç theksuam më sipër, portalet nuk konsiderohen media, janë të peregjistruara dhe me domene jashtë shtetit, dhe ndjekja e tyre është vetëm përmes përgjegjësisë individuale dhe Kodit Penal. Kodi daton i pandryshuar që nga viti 2001.

*Raportim inkluziv dhe zgjidhës* – Sikurse u theksua edhe nga të intervistuarit, mediat nuk bëjnë përpjekje të raportojnë në mënyrë përfshirëse. Nuk mjafton vetëm ruajtja e palëve, por për të ofruar një pasqyrë inkluzive është e preferuar që të ofrohen edhe burime dhe palë nga grupet e tjera, etnike, kulturore, fetare, shoqërore, të marginalizuara etj. Po ashtu, përveç bërjes së lajmit, mediat nuk merren shumë me analizimin konkret dhe dhënien e zgjidhjeve për një sërë fenomenesh, por thjesht kujdesen që të kenë debat në studio me çdo kusht.

*Dispozitivi ndëshkues në Këshillin e Etikës në Media* – Studiuesit e mediat kërkojnë që Këshilli i Etikës në Media të ketë më shumë pushtet, veçanërisht në caktimin e gjobave. Pavarësisht se ky trup është vullnetar dhe synon vetëm si lehtësues mes palëve që paditen, studiuesit theksojnë se mediat nuk e respektojnë mjaftueshëm Këshillin, madje edhe në rast të vendimit, mediat nuk e transmetojnë atë. Në rast të gjobës, mediat do të bënin dyfish kujdes, dhe do të ekspozoheshin ose demaskoheshin në radhët e tyre, në rast të mos pagesës së gjobës. Po ashtu, në rast të mos publikimit të vendimit, mediat mund të përjashtohen nga shoqatat e gazetarëve ose nga pjesëmarrja e veprimtarisë së Këshillit të Etikës.

*Ligje dhe mekanizma dhe jo ndërhyrje apo fushata afatshkurtra* – siç u theksua edhe më sipër, rregullativa ligjore për mediat ka ende nevojë për përshtatje. Gjithashtu, si një mesazh për të frenuar ndërhyrjen e politikës, nevojiten ligje të mira dhe mekanizma ligjore, e jo fushata nga ana e partive (sikurse fushatat anti-sorosoizimit nga ana e qeverisë “Gruevski”, apo fushatës për lajmet e rreme nga qeveria “Zaev”). Pikërisht financimet nga ana e shtetit, por edhe përdorimin e

portaleve nga vetë politika shënojnë paradoks, dhe jo zgjidhje apo ndihmë në vet-rregullimin mediatik.

*Edukim i gazetarëve* – pasi u vërtetua se për bashkëjetesën ose në mënyrë inkluzive raportohet vetëm kur zhvillohen projekte të financuara, nevojitet që aktivitetet trajnuese, socializuese dhe shkëmbimi i përvojave të vazhdojnë në mënyrë të rregullt, për të mbajtur gjithnjë në lupë një edukim në radhët e gazetarëve lidhur me inkluzivitetin si dhe tolerancën në raportimin mediatik.

*Edukim i drejtuesve të mediave* – Përveç gazetarëve, lind nevoja për trajnime edhe për vetë krerët e mediave. 99% e tyre janë biznesmenë dhe thuajse të gjithë e shohin raportimin si mjet për të mbërritur te një qëllim i caktuar. Për hir të tolerancës, gjithpërfshirjes, dhe bashkëjetesës që dikton karakteri shumetnik e shumëkulturore i Maqedonisë së Veriut nevojiten trajnime, që pronarët e mediave dhe menaxherët e tyre të njihen më shumë me misionin gazetaresk se sa me fokusin fitimprurës apo për ndikim në shoqëri.

*Aleanca mes mediave* – një praktikë e mirë është treguar me Asociacionin Maqedonas të Mediave, e cila tubon mediat kombëtare terrestre. Mediat mund të arrijnë së bashku një sërë qëllimesh, të mbrohen më mirë, por edhe të kultivojnë një marrëdhënie më transparente mes tyre në rast të bashkëveprimit mes tyre. Kjo do t'i bënte më të fortë përballë ndikimeve politike (shpeshherë parti të caktuara manovrojnë me media të caktuara). Po ashtu, ndërjegjësimi në këtë rast do të ofronte edhe një kontribut në përmbajtjen e ligjeve, kodit, dhe praktikave të mira në veprimtarinë mediatike. Nga ana tjetër, në rast të ndërhyrjeve politike ndaj ndonjë media, të tjerat do të solidarizoheshin dhe do të tregonin pushtetin e tyre kundër shkeljeve.

Rekomandime të tjera në përmirësimin e sferës mediatike, të medias, të vetë gazetarëve janë edhe

*Redaksi heterogjene* – për të ndërtuar një klimë më njohëse dhe më të mirëkuptueshme mes gazetarëve, nuk mjafton vetëm ndjekja në përpikëri e Kodit të Etikës në media. Njohja më e mirë me “tjetrin”, bashkëpunimi në të njëjtën redaksi dhe sendërtimi i ideve të përbashkëta, kontribuon fuqishëm në krijimin e një klime multi-etnike, multi-kulturore dhe multi-fetare nëpër redaksi. Një shembull i mirë dhe i frytshëm konsiderohet redaksia e televizionit ALSAT, i cili falë formatit dygjuhësor dhe transmetimit vetëm i një mendimi – redaksia funksionon si një e vetme dhe lajmi është i njëjtë në të dyja edicionet e lajmeve shqip e maqedonisht – tejçon jo vetëm objektivitet por edhe frymë inkluzive.

*Përsosje të programeve studimore* – Sikurse u vërejt edhe përgjatë studimit, programet e gazetarisë janë të pakta dhe universitetet kanë zgjedhur forma të tjetërsuara studimore. Është e nevojshme që përveç studimit të gazetarisë, të ketë më shumë lëndë lidhur mbi raportimin për diversitetet, dhe jo thesht njohje e kulturave në shtet.

*Njohja e inter-kulturalizmit më herët* – studiuesit bëjnë thirrje që kulturat, toleranca, dhe fryma e bashkëjetesës të kultivohet që në moshë të herët me brezin e ri, nëpër kopshte, shkolla fillore, si dhe jeta të pasurohet me më shumë aktivitete të përbashkëta. Vetëm kështu mund të vihet te shuarja e stereotipave të vjetër, të krijuara gjatë pushteteve të mëhershme.

Në fund të këtij studimi, vjen natyrshëm thirrja për një ndërgjegjësim të të gjithë aktorëve në mbrojtje dhe në promovimin e inkluzivitetit. Po ashtu, si mangësi e këtij studimi, mediat online kërkojnë një studim më të thekshëm dhe vëmendje të veçantë për trajtim si në aspektin ligjor ashtu edhe në shprehjen e fjalës së lirë.

## 9. BIBLIOGRAFIA

### LIBRA

Afërdita Hysa, *Statusi i gazetarit shqiptar në shtypin e viteve 45-90*, Autoreferat, Universiteti i Tiranës, 2015

A. Ross Johnson, R. Eugene Parta, *Cold War Broadcasting: Impact on the Soviet Union and Eastern Europe, A Collection of Studies and Documents*, Central European University Press, Budapest-Nju Jork 2010

Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipëri, 1912-2008*, UFO Press, Tiranë 2009

Alan Fogelquist, *Politics and Economic Policy in Yugoslavia, 1918-1929*, Global Geopolitics Net, Los Angeles, California 2011

Alban Tartari, *Mediat Turkofone në Ballkan*, Studim doktrate, Universiteti i Tiranës, Tiranë 2015

Alfred North Whitehead, *Science and the Modern World*, The Free Press, New York 1967

Alma Davenport, *The History of Photography: An Overview*, University of New Mexico Press, Albuquerque 1999

Aisling Lyon, *Decentralization and the Management of Ethnic Conflict: Lessons from the Republic of Macedonia*, Routledge 2016, Nju Jork

Artan Fuga, *Monolog: mediat dhe propaganda totalitare*, Dudaj, Tiranë 2010

Atanas Georgievski, Lençe Kocevaska, Dushko Minovski, *Manual Gjyqësor për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi*, British Council, Shkup 2013

Asa Briggs, Peter Burke, *A Social History of the Media, From Gutenberg to the Internet*, Polity Press 2002

Aurora Ndrilo, *Multikulturalizmi dhe media shqiptare në Maqedoni: modelet moderne globale dhe problematika lokale*, Studim shkencor, 2015

Admir Qose, *Ndërhyrja Parandaluese Ndërkombëtare në Libi, Shmangia e Gjenocidit*, Logos-A, Shkup 2015

Barbie Zelizer, Stuart Allan, *Journalism After September 11*, Routledge, Londër – Nju Jork 2011

Bllagoja Nineski, *Локалните електронски медиуми во Македонија (Mediat elektronike lokale në Maqedoni)*, Qendra për shtyp, Radio-Televizioni Prilep 1998, faqja 19

Bruce Laurence, *Messages to the World, The statements of Osama Bin Laden*, Verso 2005, Londër-Nju Jork

Charlotte Wagnsson, *Developing the “moral” arguments: Russian rhetorical strategies on security post-Kosovo?*, Institute for Security Studies – Western European Union, Paris 2001

Chester. W. Nimitz, *History of communications, Electronics in the United States Navy, Bureau of Ships and Office of Naval History*, Washington 1963

Colin Sparks, Anna Reading, *Communism, Capitalism and the Mass Media*, Sage publications 1998, London – Thousand Oaks – New Delhi

Dona Kolar Panova, *Историја на масовните комуникации (Historia e komunikimit masiv)*, Ligjërata të autorizuara, Shkup 2007

Dragan Gjoković, *Larg nga Serbia Jugore - Maqedonia; konflikti dhe mediat*, Instituti Maqedonas për Media, Shkup 2003

Edward L. Bernays, *Propaganda*, New York, Horace Liverlight, 1928

Enver Hoxha – *Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre*, Tiranë, 1973

Elena Mihajlova, Jasna Baçova, Tome Shekerxhiev, *Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes*, OSBE, Polyesterday, Shkup 2013

Elliot King, Jane Chapman, *Key Readings in Journalism*, Nju Jork 2012

Eric Maigret, *Sociologjia e Komunikimit dhe e Mediave*, Papirus, Tiranë 2010

Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Formimi, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit demokratik*, SEEU, Tetovë 2012

Etem Aziri, *Sistemet politike*, SEEU, Tetovë 2012

E. W. Hobson, *John Napier and the invention of logarithms, 1614*, Cambridge University, 1914

Everett M. Rogers, *Communication technology, The new media in Society (Teknologjia e komunikimit, Media e re në shoqëri)*, Free Press, 1986

Frederick Williams, *The communications revolution*, Sage Publication, Nju Jork 1982

G. R. M. Garrat. *The Early History of Radio: From Faraday to Marconi, From Faraday to Marconi*, Institution of Engineering and Technology, London, UK, Introduction

George Shiers, *Early Television, A Bibliographic Guide to 1940*, Routledge, New York, 2013

Hamit Boriçi, Bashkim Gjergji, Genc Tirana, Sadri Ramabaja, *Gazetaria (Njohuri të përgjithshme)*, Libri Universitar, Tiranë 2003

Haqif Mulliqi, *Keqkuptime dhe rreziku i ndarjes së përhershme - Maqedonia; konflikti dhe mediat*, Instituti Maqedonas për Media, Shkup 2003

Hugh F. C line, *Information Communication Technology and Social Transformation: A Social and Historical Perspective (Teknologjia e komunikimit të informacionit: Një perspektivë sociale dhe historike)*, Routledge New York – London 2014

Huw David Jones, *The Media in Europe's Small Nations*, Cambridge Scholars Publishing, Newcastle 2014

Ilda Londo, *Albania*, Instituti i Medias, Tiranë 2014

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, Studime Albanologjike, Volumi 4, Shkup 2011, Kristo Frashëri, *E vërteta mbi shqiptarët e Maqedonisë dhe shtrembërimet e Enciklopedisë së Shkupit*.

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, *70 vjetori i botimit të gazetës "Flaka e Vëllazërimit"*, Tribunë shkencore 2015, Vëllimi 10

Instituti Shqiptar i Medias, *Monitorim për zbatimin e ligjeve për shpifjen dhe fyerjen*, Tiranë 2015

Jacques Ellul, *Propaganda, The Formation of Men's Attitudes*, Vintage Books, New York, 1968

James H. Wittebols, *Watching M\*A\*S\*H, Watching America: A Social History of the 1972–1983 television series*, McFarland & Company, Inc., Publishers, Jefferson, North Carolina, and London 2003, faqja 155

Janusz Bugajski, *Ethnic Politics in Eastern Europe: A Guide to Nationality Policies, Organizations and Parties*, Qendra për Studime Ndërkombëtare dhe Strategjike, M.E. Sharpne, Londër – Nju Jork 1995

Jasmina Udovički & James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë, Historia e vërtetë e dhimbjes së pashprehur të Europës*, Tiranë, Libra për një shoqëri të hapur, Albin 1998

Jasper Griffin, *Homer: The Odyssey*, Second Edition, Cambridge, 2004

John Logie Baird, *Television Apparatus and the Like*, Patenta Amerikane e Shpikjes e skeduar në Mbretërinë e Bashkuar në 1928

John Calhoun Merrill, Harold A. Fisher, *The world's great dailies: profiles of fifty newspapers*, Hasting House, Nju Jork 1980

Joseph Needham, Tsien Tsuen-Hsuei, *Science and Civilization in China (Shkenca dhe civilizimi në Kinë)*, Cambridge University Press, 1885

Joseph R. Dominick, *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Universiteti i Xhorxhias, Athinë. UET Press 2010

Jozo Tomasevich, *War and Revolution in Yugoslavia: 1941-1945, Occupation and collaboration*, Stanford University Press, California 2001

Keith Brown, *Transacting Transition: The Micropolitics of Democracy Assistance in the Former Yugoslavia*, Kumarian Press 2006, SHBA

Lirie Dina, *Human Rights Defenders School*, Tiranë 2018

Lisen Bashkurti, *Diplomacia e vet-izolimit*, Tiranë, GEER 2004

Lisen Bashkurti, *Diplomacia Shqiptare në fillimet e Luftës së Ftohtë*, Tiranë, GEER 2003

Ludmila Pöppel, *The rhetoric of Pravda editorials: A diachronic study of a political genre*, Stockholm U. 2007

Llazar Semini, *Mediat e Shqipërisë: Një qasje profesionale - Maqedonia; konflikti dhe mediat, Instituti Maqedonas për Media*, Shkup 2003

Lubomir Kostovski, *Газда Велија во костумот на Берлускони (Bosi Velija në kostumin e Berluskonit)*, Media Development Investment Fund, <<https://www.mdif.org/>>

Marshall McLuhan, *Instrumentat e komunikimit (Media si një zgjatim i njeriut)*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2008

Marija Jovanović, *Prosvetno-političkite priliki vo Vardarska Makedonija: (1918-1929)*, NIO: Studentski izbor, Skopje 1983



Mark Thompson, *Slovenia, Croatia, Bosnia and Herzegovina, Macedonia (FYROM) and Kosovo International Assistance to Media*, OSCE – Representative on freedom of the Media, Vienna 2000

Marshal McLuhan, *The Gutenberg Galaxy, The making of typographic man*, University of Toronto Press, 1962

Mersim Maksuti, *Aspekti juridiko-kushtetues dhe politik i statusit shtet-formues të popullit shqiptar në Maqedoni*, Logos-A 2005, Shkup-Prishtinë-Tiranë, faqja 149-151

Megan Baker, *"The Impact of Social Networking Sites on Politics."* The Review: A Journal of Undergraduate Student Research, Published by Fisher Digital Publications, 2009, Article 12 (2009)

Naim Flamuri, Sami Flamuri, *E përjetshme është Shqipëria, bisedë rreth të drejtës mbi kombin më të vjetër në Evropë, popullin shqiptar*. Shtëpia Botuese Naim Frashëri, 1999

Nebi Dervishi, Skënder Asani, Xhemil Daci, Isak Sherifi, Sefer Tahiri, Sevdail Demiri, *Demonstratat popullore të vitit 1968 në Tetovë*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup 2018

Nikolaj Petrov, *Maqedonia, nyja e Ballkanit - Maqedonia; konflikti dhe mediat*, Instituti Maqedonas për Media, Shkup 2003

Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara, *Gazetaria profesionale dhe vet-rregullimi, media të reja - dilema të vjetra në Evropën Juglindore e Turqi*, UNESCO 2010, faqja 60

OSBE, *Rezoluta e miratuar në konferencën ndërkombëtare "Dekriminalizimi i shpifjes: Shkëmbim i praktikave pozitive"*, Shkup, 9-10 shkurt 2006

Patrick H. O'Neil, *Post-Communism and the Media in Eastern Europe*, Londër&Nju Jork, Routledge 2013

Raphael Cohen-Almagor, *The Scope of tolerance: Studies on the costs of Free Expression and Freedom of the Press*, Routledge, SHBA 2006

Robert J. McKeever, Philip Davies, *Politics USA*, Toutledge, Londër – Nju Jork 2012

Rhodri Jeffreys-Jones, *In Spies We Trust: The Story of Western Intelligence*, Oxford Press, United Kingdom 2013

R. A. C. Parker, *The Second World War: A Short History*, Oxford 1989, faqja 209

Sabrina P. Ramet, *The Three Yugoslavias: State-building and Legitimation, 1918-2005, State Building and Legitimation 1918-2005*, Woodrow Wilson Press and Indiana University Press, SHBA 2006

Sandra Meucci, *Antonio and the Electric Scream: The Man who Invented the Telephone*, Branden Books Boston

SHGM & Fondacioni “Konrad Adenauer”, *Raportimi etik i mediave në Evropë dhe Maqedoni, Etika mediatike dhe vetërregullimi në Maqedoni*, Shkup, SHGM 2016

Steven W. Ellingson, *Radio Systems Engineering*, Cambridge University Press, 2016

Takis Diamantis, *Ku përfundoi objektiviteti? - Maqedonia; konflikti dhe mediat*, Instituti Maqedonas për Media, Shkup 2003

Tatiana Smorodinskaya, Karen Evans-Romaine, Helena Gosciolo, *Encyclopedia of Contemporary Russian Culture*, Routledge, Londër – Nju Jork 2007

Thomas F. Remington, *The Truth of Authority: Ideology and Communication in the Soviet Union*, Pittsburgh Press 1988

Valbona Sulçe Kolgeci, *Hyrje në media dhe komunikim*, cikël leksionesh, faqja 26

Vllado Kambovski, Mirjana L Lazarova Trajkovska, *Analizë Juridike e konceptit të veprës së dënueshme të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes*, shtator 2012, Shkup

Zejnulla Gruda, *Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Libri I-III*, Botimi IV, Universiteti FAMA, Prishtinë 2017

Zheng Yan, *Encyclopedia of Mobile Phone Behavior*, University of Albany, State University of New York, USA, IGI Global, 2015

Wagner, Bettina; Reed, Marcia, *Early Printed Books as Material Objects: Proceedings of the Conference Organized by the IFLA Rare Books and Manuscripts Section Munich, 19-21 August 2009*

Sabrina Petra Ramet, *Religious Policy in the Soviet Union*, Cambridge University Press 1993, faqja 218

Sami Nezaj, *Gazeta - Menaxhimi i krizës në median e shkruar*, Tiranë 2014, UET Press (Shtëpia botuese universitare e Universitetit Evropian të Tiranës)

Sandra Buzlieva & Mila Isakovska, *Manual për lirinë e shprehjes dhe gjuhën e urrejtjes, Aspekte juridike*, projekt i BE-së dhe Ambasadës britanike mbi gazetarinë, Shkup, Botuar nga Shoqata e qytetarëve “Instituti për të Drejtat e Njeriut” dhe Shoqata për Zhvillim “Qendra për Administrim me Ndryshime” 2016

Senad Sllatina, *Lufta në Maqedoni ishte Bosnia-Lite: Një qasje profesionale - Maqedonia; konflikti dhe mediat*, Instituti Maqedonas për Media, Shkup 2003

Sokol Paja, *Shtypi komunist, si një element i rëndësishëm në propagandën ateiste në regjimin totalitar shqiptar 1960-1970*, Studim shkencor

Sokol Paja, *Roli i mediave në propagandën ateiste në periudhën totalitare*, Studim Doktorate, Universiteti i Tiranës, Tiranë 2018

Zejnulla Gruda, *Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Libri I-III, Botimi IV*, Universiteti FAMA, Prishtinë 2017

Zhidas Daskalovski, *Walking on the Edge: Consolidating Multiethnic Macedonia, 1989-2004*, Globic Press, USA

## DOKUMENTE

*Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut*

*Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e vitit 1991*

*Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë 1974*

*Kushtetuta e Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë*

*Gazeta Zyrtare të Maqedonisë së Veriut*

*Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut*

*Ligji për Shërbime Audio dhe Audiovizuale*

*Ligji për Mediat*

*Ligji për Përgjegjësi Civile për Ofendim dhe Shpifje*

*Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi*

*Ligji për Veprimtari Radiodifuzive 1997*

*Ligji për Informim Publik, 1974*

*Ligji nr.5591 i datës 15.6.1997 i Kodit Penal të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*

*Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian*

SIOFA, *Marrëveshja Kornizë e Ohrit*

UNESKO, *Deklarata e Parimeve Themelore*

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, *Rekomandimi Nr. R (97) 20 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare mbi “Gjuhën e Urrejtjes”, 30 tetor 1997*

Këshilli i Evropës, *Protokolli nr.12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut*

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, *Kodi Etik i Gazetarëve*

EUR-Lex, *Direktiva “Aktivitetet transmetuese televizive: Televizion pa kufij”*

Komisioni Evropian, *Rishikim i Direktivës për Shërbime Mediatike Audiovizuale*

Shënime stenografike nga Seanca e Shtatëmbëdhjetë e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, e mbajtur më 15 prill 1999

Regjistrimi i popullsisë, amvisërive dhe banesave në Republikën e Maqedonisë 2002

Dokumente kryesore të PPSH - Vëllimi I (1941 – 1948), *Kryeartikulli i Numrit të Parë të “Zërit të Popullit” 25 gusht 1942*

Dokumente kryesore të PPSH - Vëllimi I (1941 – 1948), *“Deklaratë e Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare me anën e së cilës hidhen poshtë shpifjet e Komitetit Central të Partisë Komuniste të Maqedonisë” shtator 1948*

Wikileaks, *Macedonia & NATO membership: Defense reforms on track; Political & Economic reforms key obstacles*

Reporterët pa kufij (Reporters without borders), *Indeksi për lirinë e medias në botë (World Press Freedom Index)*

## STUDIME

Shkolla e lartë e gazetarisë dhe e marrëdhënieve me publikun, *Raportimi mediatik mbi çështjet ndëretnike dhe ndërjetare në Republikën e Maqedonisë, Analizë kuantitative e përmbajtjeve të publikuara në media brenda periudhës: 16 janar – 12 shkurt 2012 (Analizë konkluzionesh)*

Këshilli për Etikë në Media, *Vetërregullimi ose rregullimi i mediave të internetit në Maqedoni, gusht 2017, Shkup*

Dragana Kiprijanovska, *Monitorimi i rasteve gjyqësore ku gazetarë janë të akuzuar për shpifje dhe ofendim, shtator 2011*, Koalicioni “Të gjithë për gjykime të drejta”

Adrianna Ciccone, *La sfida del terrorismo ai media e ai social network*, Valigiablu.it

Instituti i Studimeve të Komunikimit dhe Shkolla e Lartë për Gazetari, *Raportimi për tensionet ndërreligjioze dhe ndëretnike – Nënkuptimi i titujve*

Monroe Edwin Price, Stefaan G. Verhulst, Stefaan Verhulst, *Self-regulation and the Internet*, Kluwer Law International, The Netherlands 2005

Marko Trashanovski, Vesna Nikodinovska, Petrit Saraçini, Marina Tuneva, Jana Gjorgjinska, Aleksandra Temenugova, Dejan Andonov, Vlladimir Misev, Sead Xhigall, Darko Bulldioski, Biljana Petkovska, Vesna Horvatović, Silvana Veteroska, *Doracak për arsimtarë – Përparimi mësimor mediatik në lëndën e gjuhës amtare*, Instituti Maqedonas i Medias, Shkup 2010

Instituti i Studimeve të Komunikimit dhe Shkolla e Lartë për Gazetari, *Diversitetet nën prizmin e redaksive – Vështrim nga afër mbi krijimin e lajmeve*

Leksione të universitetit York për studime drejtësie dhe sociale, *Stereotipat raciale*

Stephen Badsey, *Propaganda: Media in War Politics*, International Encyclopedia of the First World War

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, *Vetërregullimi në media dhe komunikimi ndërsektorial në funksionimin e Këshillit për Etikë në Media në Maqedoni (KEMM)*, tetor 2017

OSBE, *Udhëzues për vetërregullimin e mediave, Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet*

St.Paul's University, *Le relazioni pericolose: mass media e terrorismo*, Focus On

Ervis Martani, *Orgjigjina dhe evoluimi i të drejtave të njeriut*, Studim shkencor

Qendra Miller (Miller Center) e Universitetit të Virxhinias, *September 11, 1990: Address Before a Joint Session of Congress*

David Bastiani, *Terrorismo e Media, La comunicazione del terrore*, Difesa.it

Geneva US Mission, *The U.S. strongly supports the concept of Responsibility to Protect (R2P)* NATO, “A short history of NATO”, Uebfaqja e NATO-s

Kuvendi i Maqedonisë së Veriut, *Historia e Parlamentarizmit në Maqedoninë e Veriut*,

UN, *Teksti i Paktit të Varshavës*, Koleksioni i Traktateve të Kombeve të Bashkuara,

Qeveria e Maqedonisë së Veriut, *Marrëveshja finale për zgjidhjen e kontestit maqedono-grek për emrin dhe për partneritet strategjik*

Open Society Institute, *Televizioni në Evropë: Raporti për mbikëqyrjen e situatës 2008*, Budapest 2008

Sevdail Demiri, *Gazetat me histori – shkojnë në histori*, Centrum 9

Instituti i Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve, *“Flaka e Vëllazërimit”*, abetare e dytë për shqiptarët

European Commission, *The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2010 Progress Report*  
Renaud de la Brosse, *Political Propaganda and the Plan to Create a "State for all Serbs" - Consequences of Using the Media for Ultra-Nationalist Ends - Part 1*, Report compiled at the request of the Office of the Prosecutor of the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia, by Renaud de la Brosse, senior lecturer at the University of Reims, Champagne, Ardennes, France

Stephen Engelberg, *Carving out a Greater Serbia*, The New York Times Magazine,

Marija Ristic, *Vojislav Seselj: Faded Cheerleader for a 'Greater Serbia'*, BIRN, Beograd,

Minir Ademi, *Dëshmorët e kombit (UÇK 2001)*, Shoqata e Historianëve Shqiptarë, Shkup, 2010

Admir Qose, *Media në Maqedoni dhe e nesërmja e saj*, Revista “Shenja” – botim i muajit korrik 2014

Teofil Bllazhevski, *Kundërspin: Nata e gjuhës së urrejtjes*, Vërtetmatës.mk

David Tuller, *Manuali i Raportimit të Diversitetit*, Instituti i Diversitetit të Medias & Samizdat B92, Londër 2003

Des Freedman, *Media Regulation*, Oxford Bibliographies

Diana Kendall, *Sociology in Our Times: The Essentials*

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, *Regjistri i operatorëve radiodifuziv që transmetojnë program televiziv (Регистар на радиодифузери што емитуваат телевизиска програма)*

Jeannette Goehring, *Nations in Transit 2007: Democratization from Central Europe to Eurasia*, (Zhidas Daskallovski) Freedom House 2007, Hungari

ALDA – European Association for Local Democracy, *Mediat e lira dhe liria e të shprehurit në Maqedoni (Free media and freedom of expression in Macedonia)*

Michael Biggins, Janet Crayne, *Publishing in Yugoslavia's Successor States*, The Hauworth Press, SHBA 2000

Balkanmedia, *Media and Democracy in South East Europe, Gazetat e përditshme (Daily Newspapers)*

Dimitar Bechev, *Historical Dictionary of the Republic of Macedonia*, The Scarecrow Press, SHBA 2009

Qerim Lita, *Statusi i shqiptarëve pas vitit 1974*, TV Shenja

Filip Stojanovski, *Македонија: Реакции на инцидентот на Кале и говорот на омраза (Macedonia – Regime mbi incidentin në Kala dhe gjuhën e urrejtjes)*

Aleksandar Manasiev, Dnevnik, *Смртта на Алмир ни ја смрзна, на ни ја зовре крвта (Vdekja e Almiri ta ngrin gjakun, pastaj ta bën atë të të vlojë)*

Krishto Frashëri, *E vërteta mbi shqiptarët e Maqedonisë dhe shtrembërimi i Enciklopedisë së Shkupit*

Nikolla Osillo, *Историја на расколи: Ќе се родат ли нови партии со предзнаком ВМРО (Historia e përçarjeve: A do të lindin parti të reja me parashenjën e VMRO-së)*, E-magazin

Sead Rizvanović, *Negociata për rregullimin e medieve dhe luftë për situatë status-quo*, Shërbimi për verifikimin e fakteve në media

Kristina Ozimec, *“Sitel”-i, „Сител“, „Канал 5“ и „Алфа“ се офајдиле најмногу, „Телма“ и „Алсат-М“ најмалку од колачот за владини реклами (“Kanal 5” dhe “Alfa” kanë përfituar më së shumti, “Telma” dhe “Alsat-M” kanë marrë më së paku nga kulaçi i reklamave qeveritare)*, PINA

Uebfaqe

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Zyra e Statistikave Shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe AudioVizuale

Komisioni shtetëror i Zgjedhjeve

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Asociacioni Maqedonas i Gazetarëve

Instituti Maqedonas i Medias

Qendra për Zhvillimin e Mediave

Shërbimi për Verifikim të Fakteve në Media

Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatikë

Bashkësia Fetare Islame

#### TË TJERA

Dokumentar në Youtube, 20 години независност: Македонија е се што имаме, 1991 година [EP02] (20 vjet pavarësi: Maqedonia është gjithçka që kemi, 1991 [EP02])

Dokumentar në Youtube, Admir Qose, “10 vjet ALSAT”

Nazim Rashidi, *Programi 200: "Burgosësi" dhe "i burgosuri" ballë përballë për Maqedoninë e të ardhmes!*

Nazim Rashidi, *Programi 200: Zymeri dhe Angellov - Dikur përballë në luftë, tani në ballë për paqe!*

“Sabotazha”, rubrika satirike e autorit Sreçko Popovski, në emisionin 360 gradë në ALSAT.  
SABOTAZA br.99 18/05/15

Ekspozitë e realizuar nga Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC) me mbështetjen e Arkivit Qendror Shtetëror (AQSH), *Propaganda gjatë diktaturës komuniste*